

Ibrahim KERMENDI

 **islami** 
religjion agresiv (?!)

zero print

(Faksimili i kopertinës)

Përmbajtja e librit

PARATHËNIE	3
Muhamedi / Islami - kronologji historike tabelare	21
I. MUHAMEDI	33
I. 1. Jeta dhe veprimtaria	34
I. 2. Martesa e parë e Muhamedit	48
I. 3. Muhamedi - luftërat 623-632	66
I. 4. Muhamedi - vdekja nga helmimi	87
I. 5. Muhamedi - seksomania poligamiste	94
I. 6. Muhamedi - dhunues pervers seksual	114
I. 7. Muhamedi - prokuror, gjyqtar, ekzekutor	139
II. KURANI	
II. 1. Kurani - mënyra e shpalljes	149
II. 2. Kurani - dilemat rreth autorësisë.....	163
II. 3. Kurani - mënyra e shpalljes	168
II. 4. Kurani – kundërthëniet	178
II. 5. Kurani - (mos)kuptueshmëria	229
II. 6. Kurani - (pa)saktësitë historike	240
II. 7. Kurani - (pseudo)shkencor.....	255
II. 8. Kurani - ajete skandaloze.....	288
II. 9. Kurani - abrogimi i ajeteve paqësore me shpatare.....	312
II. 10. Kurani - përkthimi dhe interpretimi	320
III. ISLAMI	
III. 1. Islami - debate polarizuese	337
III. 2. Islami: Pozicioni dhe roli i femrës.....	351
III. 3. Islami – shamia, hixhabi, burka, khimari	375
III. 4. Islami - platformë e imperializmit arab	387
III. 5. <i>Kurani</i> - kundër çifutëve dhe kristianëve	431
III. 6. Islami zanafillor - agresiv dhe fashistoid.....	471

PARATHËNIE

Mrekulli të vogla në fatkeqësi të mëdha!

Sa herë shkruhen libra “kundër” religjioneve abrahamike, besimtarët fundamentalistë rëndom irritohen. Reagimet e tyre janë irracionale, madje edhe agresive. Ata ia kanë dalë të imponojnë një lloj ndalese, që të mos guxohet të kritikohen religjionet e tyre. Ta zëmë, nëse ua kritikon dogmën dhe traditën e tyre, islamistët fundamentalistë menjëherë të akuzojnë për islamofob (!).

Megjithëkëtë, unë e shkrova këtë libër.

Uroj që myslimanët të mos ndihen të fyer nga përpjekjet e mia për të përgënjeshtuar mitizimet për “Kuranin” dhe “profetin”. Dhe, nëse ata do të ndihen të fyer, nuk jam unë fajtori. Fajtori është besimi dhe mendësia e tyre moniste muhamedane dhe ata s’janë tjetër veçse viktima të asaj mendësie.

Të drejtën dhe lirinë time për të shkruar atë që mendoj, nuk e sakrifikoj për asgjë, as për hir të shumo miqve që deklarohen se i përkasin religjionit mysliman, edhe pse në fakt nuk janë besimtarë myslimanë...

Jam “i prodhuar” nga prindër shqiptarë, fatkeqësisht besimtarë injorantë myslimanë, viktima të indoktrinimit muhamedan. As unë s’mund të isha tjetër, veçse viktimë, si miliona fëmijë të tjerë anembanë botës, viktima të lindur aksidentalisht, që, përveç të tjerash, vuajnë edhe nga uria.

Prindërit e prindërve të mi ishin ishin gjithashtu myslimanë injorantë, ashtu siç ishin edhe prindërit e prindërve të tyre. Pra, të gjithë viktima zinxhirore të mendësisë moniste muhamedane.

Unë, si çdo fëmijë i botës, isha i privuar nga e drejta dhe mundësia për të vendosur për (mos)lindjen time, për të përzgjedhur prindërit, popullin, vendin, gjuhën, fenë, emrin...

Zinxhiri i paraardhësve të mi, të konvertuar në myslimanë, shkon deri në hallkën e 8-të. Katragjyshi i atij brezi rezultoi të ketë qenë kristian. Koha e konvertimit në myslimanë të paraardhësve tanë përcaktohet lehtë, në bazë të emrit, sepse, siç dihet, të konvertuarve u janë imponuar emrat arabë*. [Ja emrat e paraardhësve nga ana e babait: Haxhi, Ramë, Kadri, Hysë, Ibër, Ahmet, Bic, Bruç, Nrel, Balë... Bici ka qenë aktolikë, meqë jetonim në Malësi, e quajtur Vuthaj, tani Komuna e Plavës në Mal të Zi. Ndërsa në Rrafshnalzën e Kosovës shumica duhet të kenë qenë kristianë ortodoks...]

Para tri vitesh isha në ceremoninë mortore të dajës Rexhep.**

Cufa, siç e thërrasim Jusufin, djalin dajës më të moshuar, Mustafës, i pranonte ngushëllimet dhe u përgjigjej qindra ngushëllimtarëve gjatë javës së ceremonisë mortore. Në përmbyllje të njëres prej ditëve të asaj jave mbetëm rreth pesëdhjetë “pritës”. Ata, me praninë e tyre, nderonin dajën e sapovarrosur. Aty vazhdonte të qëndronte edhe imami i disa fshatrave, që kanë xhami të përbashkët në fshatin Ruhot (Pejë).

* Çështja e emërtimeve arabe të të konvertuarve është një dëshmi konkrete, se islami ishte dhe është platformë nacionaliste arabe, meqë emrat arabë jo domosdoshmërisht ishin emra myslimanë. Të njëjtë praktikë “myslimane” ka përdorur edhe pushteti turk, kur pati bërë marrëveshje me Jugosllavinë mbretërore dhe, më vonë, atë socialiste, për t’i shpërngulur shqiptarët nga Jugosllavia në Turqi. Xhaxhait të nënës sime, Jakup Iberdemaj (nga Rugova e Pejës), me grua e fëmijë, në Shkup, në vitin 1957, shpërnguljen ua kushtëzuan me mbiemrin turk “Güzel” (bukurosh), të cilin e mbajnë edhe tani. Kur u lindën fëmijët në Turqi, nuk i lejuan t’u vënë emra shqip, por u kanë vënë listën përpara me emra “turq” (Tajfun, Timur, Akan...).

** Rexhep (Ibish) Iberdemaj, i lindur më 21.03.1942, në Shtypeq i Vogël, Rugovë, Pejë, me banim në Naberqjan dhe në ekzil në Vjenë, vdekur më 14.09.2012 në Klinikë Universitare në Bon (Gjermani). Qysh nga viti 1979 policia jugosllave ka filluar ta survejonte e keqtrajtonte, për shkak se ishte daja im dhe dyshonin se ai po përkrahte veprimtarinë time. Atëherë policia përndiqte edhe të afërmit e mi familjarë, jo vetëm personin e angazhuar politikisht kundër atij sistemi monist, diktatorial, pushtues.

Në Dukagjin të Kosovës shumë fshatra kanë një xhami të vockël të përbashkët, me një imam, i cili më shumë shërben për ceremonitë mortore sesa për lutjet fetare...

Për të nxitur bisedën në një moment të heshtur, Cufa e pyeti imamin: “Imam i nderuar, meqenëse për momentin nuk kemi ngushëllimtarë të ardhur nga larg, a mund të na informoni, cili brezi i juaji është konvertuar në mysliman?”

Imami, megjithëse u befasua nga kjo pyetje e papritur, u përgjigj: “Brezi i 8-të”.

Imamët e islamit tradicional rëndom i kishim komunikues, shumë tolerantë dhe nuk mbanin as mjekër muhamedane.

“Për sa t’holla do të konvertoheshin Ju, tani, në të krishterë?” – i bëri pyetjen pasuese Cufa.

“As për mall të krejt dynjasë!” – ia ktheu shkurt e prerë imami.

“Aferim!” – e uroi Cufa dhe vazhdoi me pyetjen tjetër:

“Për sa shuplaka e dhunë fizike do të konvertoheshin?”

Imami, pa hezituat, u përgjigj:

“Do të rezistojta aq sa mund ta duroja dhunën, pastaj... nuk e di.”

Cufa priti pak, hodhi sytë rreth e rrotull se mos po i hidhërohej ndonjë i pranishëm, dhe vazhdoi:

“Si mendoni, imam i respektuar, a jeni ju më me karakter e më fisnik sesa stërgjyshi juaj i brezit të 8-të?! Ai u konvertua nga kristian në mysliman, ndërsa ju nuk pranoni të konvertohemi në të krishterë?!”

Imami zuri të qeshte me zor, me shpresë se me aq do të përfundonte ajo bisedë, gjithsesi, torturuese për të. Por Cufa e përsëriti pyetjen.

“Nuk e di pse stërgjyshi është konvertuar, por unë nuk konvertohem!” – iu përgjigj shkurt imami, tashmë paksa i irrituar.

“Meqenëse nuk do të na i rrëfeni arsytet pse ka ndodhur konvertimi i stërgjyshërve tanë, pothuajse në të njëjtën kohë në krahinën tonë, para rreth 170 vjetëve, unë po rrëfej këtu njëri nga arsytet, nëse do të më lejoni!” – vijoi Cufa.

Imami bëri sikur ishte dakord.

“Më ka treguar një plak i anëve tona, se në krahinën tonë pushtuesit osmanë paskëshin përzgjedhur disa burra më të afirmuar dhe u kishin vënë kusht: konvertim ose tredhje, që të mos shumoheshin *kufarët*, që do të thotë të mos shumoheshin jomyslimanët! Disa prej tyre, duke qenë të krishterë fundamentalistë, nuk kishin pranuar të konvertoheshin. Dhe vërtet i kishin tredhur. Të tjerët, duke dëgjuar britmat e atyre që po i tridhnin, kishin pranuar të konvertoheshin. Ja, imam i respektuar, stërgjyshërit tanë janë konvertuar që të ruajnë koqet e tyre, përndryshe ne nuk do të ishim këtu etani...”

Plasi e qeshura. Qeshi edhe vetë imami...

Aspak më të lumtur nuk duhet të kenë qenë as paraardhësit e paraardhësve të paraardhësve tanë, ata të brezit të 8-të ose 9-të, që ishin të krishterë, sepse u duhej t'i paguanin tatime ekstra kalifatit pushtues islam.

Para se osmanët të pushtonin Europën Juglindore, paraardhësit tanë, besimtarë të krishterë, duhet të kenë vuajtur rëndë luftërat e shpeshta mes kishave romake, bizantine, bullgare, serbe, për primat e sundim. Dhe nëse do të ndiqja hallkat e paraardhësve tanë, më duket se do të takohesha me pjesëtarët e celulës së parë kristiane në Europë, e cila duhet të jetë formuar pikërisht në Makedoninë Ilire, në qytetin Filipi¹, buzë Selanikut të sotëm, në vitin 49. Nuk e di se për cilat arsye, i vetëquajturi “Shën Pali”, i sapokonvertuari nga Saulus në Paulus, respektivisht nga besimtari jahudi në besimtar kristian, që ai po e sajonte, duhet të ketë qenë pikërisht në qytetin Filipi, për të qëndruar për disa kohë si mysafir i gruas iliro-makedone, ndoshta me emër **Lydia**². Duket se takimi i tyre i parë, gjithsesi rastësor, kudo që të ketë ndodhur, duhet të ketë qenë miqësim seksual (?!). E pra, pikërisht aty Pali duhet të ketë formuar celulën e kristianëve të sapokonvertuar,

¹ Është fjala për një qytet të formuar nga mbreti Filipi II, babai i Aleksandri të Madh.

² Bibla, Besëlidhja e re, historia e apostujve, 16:14

ndoshta edhe për hir të asaj miqësie seksuale me Lydian; ajo duhet të ketë qenë njeriu i parë në Europë, i konvertuar në të kristiane! Ajo është bërë edhe personazh biblik dhe kishtar, sepse është evidentuar në “letrën e parë” që Pali ua drejtoi pikërisht filipasve³...

Për formimin e asaj celule duhet të jetë informuar policia romake. Ajo duhet ta ketë burgosur Saulusin. Dhe për ta çliruar nga burgu, Hyji (zoti kristian) paskësh tundur me një tërmet qytetin Filipi, po atë natë, gjoja për hir të Saulusit, i cili deri atëherë duhet të ketë qenë marioneta e policisë politike romake, i angazhuari në Jerusalem për përgjim e përndjekje të Jezusit me bashkëveprimtarë, por ja që përmes të një vegimi aksidental, siç besojnë kristianët, është shndërruar në “Shën Paulus” për ta sajuar religjionin kristian...

Fatkeqësisht, celula e parë e krishterë në Makedoninë europiane, e krijuar nga semiti aziatik Paulus, duhet të ketë qenë, ta quaj figurativisht, mikrobi i parë kancerogjen që duhet ta ketë ngulfatur në zanafillë demokracinë e paraardhësve tanë etnik! Perandoria Romake vërtet e kishte pushtuar Europën Juglindore, por demokracia zanafillore dhe qytetërimi antik i paraardhësve tanë ishin “hakmarrë”, duke “e pushtuar” Perandorinë republikane Romake në aspektin kulturor, religjioz e filozofik...

Si e sa ishte përhapur ai virus kancerogjeni krishterë në hapësirat tona gjatë tre shekujve vijues, nuk jam i informuar dhe nuk duhet të ketë informacion të bollshëm. Por ishte Konstandini i Madh, perandori i përkatësisë etnike iliro-dardane (i lindur në Naisus - Nishin e sotëm, tani në Serbi), i cili fesë kristiane ia mundësoi lirinë e legalizuar dhe prandaj ajo u bë virus kancerogjen, fillimisht për qytetërimin e Perandorisë Romake, kur e legalizoi atë, në fillim të shekullit të 4-të⁴,

³ Bibla, Besëlidhja e re, (letër) Filipianëve, 1:1-30.

⁴ Marrëveshja (edikt) e Milanos më 13. 06. 313, në mes të Konstandinit I, Perandor i Perëndimit, dhe Licinius, Perandorit të Lindjes. Përmes asaj marrëveshje miratohet liria për të gjitha religjionet (edhe kristiane) dhe shprehja e mendimit të lirë. Ndërsa Krishterimi, si religjion zyrtar perandorake u katapultua në vitin 380, me vendim të Perandorit Teodosius I.

për ta njohtëmbytur pothuajse gjithë Europën gjatë mjëveççarit pasues. Qysh në vitin 394, kur Perandori përkatës e dekretoi Krishterimin si fe të vetme zyrtare perandorake, atë religjion aty e tutje e imponoi Perandoria me dhunon e saj perandorake. Qytetarët e Perandorisë tashmë nuk (vetë)qeveriseshin përmes zgjedhjeve, si deri atëherë. Aty e tutje kisha i përcaktonte mbretërit e perandorët...

Dhe mbase do të bindet secili, se vetëm religjionet që u imponuan me dhunë mundën të katapultohen në fe botërore!

Në atë fatkeqësi të madhe, - të tjetërsimit kulturor, fetar e antropologjik përmes kristianizimit, - ndodhi një mrekulli e vogël: mbijëtoi gjuha shqipe! Fatkeqësisht “vdiqën” greqishtja* dhe latinishtja, të cilat duhet t’i kishin sajuar misionarët e paraardhësve tanë, - greqishtja nga protoshqipja e dialektit gegërisht, latinishtja nga etruskishtja, përkatësisht nga protoshqipja e dialektit toskërisht⁵, si gjuhë misionare e filozofike, që të mos i kuptonin masat e gjera!

Babanë e kisha besimtar tepër fanatik, analfabet, hoxhë autodidakt. Dinte përmendsh me qindra vërse (ajete) të *Kuranit* **, pa ua ditur fare përmbajtjen. Besonte në islamin e dëshiruar, atë që shqiptarët e kishin modifikuar për nevojat e tyre të mbijetesës, dhe jo në islamin e vërtetë, të sanksionuar në *Kuran*, meqë atë as që e njihte. Këtë e kuptova sidomos gjatë studimeve të islamit këto vitet e fundit. Babai ishte i

* Për mendimin tim, nuk kemi gjuhë "greqishte të vjetër" dhe "greqishte të re", por vetëm greqishte dhe helenishte; uroj që ndonjëherë heleoofilët të ndërgegjësohen për t'i korrigjuar disa shtrembërime romantike, lidhur me historinë antike të Europës Juglindore, meqë qytetërimi antik "grek" ishte "prodhim" i popullsisë pellazgjike (ilir, makedon, epiriot, grek, alban, dardan...) dhe jo ardhacakëve nga Afrika, pjesëtarë të fiseve doriane, gegjësisht helenëve pasues...

⁵ Robert d'Angely, "Enigma...", Tiranë;
<http://association-albania.com/Albania-presentation-de-L-ENIGME.html?lang=fr>
Është përkthyer dhe botuar edhe në gjuhën shqipe.

** Për të thjeshtuar kuptueshmërinë e tekstit, në libër do të praktikoi tre terma kryesisht terminologjinë arabe: „Kuran“ / القرآن (al-Kuran) që në shqip i bie „reciatat“; Sura / سورة (sura), në shqip: kapitull; ajet / آية (aja), shqip: shenj, vers.

dyzuar: fanatik mysliman dhe patriot shqiptar, apo anasjelltas. Për të dy përkatësitë ka rrezikuar disa herë jetën e tij...

Pothuajse asnjë shqiptar i besimit mysliman nuk e ka ditur biografinë e vërtetë të Muhamedit, as përmbajtjen e *Kuranit*. Ndërsa ata pak veta që duhet t'i kenë ditur dhe kanë vazhduar t'i adhurojnë Muhamedin dhe *Kuranin*, në fakt nuk duhet të kenë qenë më shqiptarë, por të hibridizuar, edhe nëse kanë vazhduar të jenë shqipfolës!

Po t'ia përktente dikush Babait tim, ta zëmë ajetet 37, 38, 50 të sures 33, - tematikë e të cilave janë martesat e Muhamedit me Zejneben (vajzë halle), dhe me vajza të tjera të xhaxhallarëve, - ose do ta vriste si shpifës blasfemik, ose do të dezertonte vetë nga islami! Ja, vetëm kaq mjafton për të shpjeguar dallimin e madh të islamit tradicional, tolerant, të popullit tonë, me islamit vandal burimor, të sanksionuar në *Kuran*. Gjithsesi, Kanuni i Lekës, si mënyrë e rregullimit të jetesës, ishte çdoherë mbi *Kuranin* dhe *Sharian*, derisa u krijuan shtetet moderne, sekulariste...

Në vitin '60 u përhapën doracakët e parë me ca *ajete* të *Kuranit*, të përkthyer në shqip. Vetëm një herë pata shansin t'ia lexoja babait tim lutjen, me të cilën fillon çdo namaz [*Elham'duli'lahi... / kaptina (surja) e parë*] dhe ai më ndaloi t'ia lexoja gjëra të përkthyer, me arsyetimin se *qafirët* (jomyslimanët, armiqtë e islamit) i kanë falsifikuar ato për ta kompromentuar islamit. Njëherë tjetër gati plasi një skandal, kur një imam, pas ushqimit të drekës në odën e madhe të miqve, e tha uratën në gjuhën shqipe. Meqë përmbajtja e asaj urate Babait tim iu duk hiçgjë, i tha me zë urdhërues imamit: "Në shtëpinë tonë nuk mund të thuhet uratat në shqip, sepse ato kanë vlerë vetëm në gjuhën e Allahut!"

Pikërisht ky islam, islami ynë tradicional, ishte mrekullia e vogël në fatkeqësinë tonë të madhe të islamizimit të përdhunshëm! Ky lloj

islami, pos që ishte tolerant ndaj bashkëkombësve të feve të tjera, nuk i pengonte shqiptarët, shumica besimtarë myslimanë, që të ngrinin krye, bashkë me shqiptarë të besimit të krishterë, kundër kalifatit pushtues islamik osman! Dhe ngritën krye, sepse u frymëzuan nga rilindësit tanë iluministë (bija e bijë të prindërve ortodoksë, myslimanë, kristianë), prioritet i të cilëve ishte ardhmëria emancipuese, sekulariste, qytetëruese, europiane! Fatkeqësisht, europianët kristianë nuk i përkrahën mjaftueshëm ato kryengritje çlirimtare, vetëm sepse shumica e shqiptarëve ishin besimtarë myslimanë. Pas gati njëqind vjetësh, europianët dhe amerikanët, tashmë sekularistë, përkrahën kryengritjen e shqiptarëve në Kosovë (1999), gjithashtu me përcaktime sekulariste, për çlirimin e tyre nga pushtimi fashistoid i serbëve kristianë, edhe pse shumica e popullatës në dukje ishte islame...

Ja, kështu, babai im, vetë viktimë fatkeqe me emër arab, Haxhi, e tjetërsoi edhe identitetin tim të sapolindur, duke më vënë emër arab: Ibrahim. Ky emër ishte vetëm fatkeqësia ime fillestare, kundër së cilës nuk kam qenë në gjendje të mbrohësja. Pas saj erdhën fatkeqësi të tjera. Ai më dhunoi qysh fëmijë, ndoshta edhe para moshës 4-vjeçare, duke më detyruar të mësoja përmendsh lutjet kuranore në arabisht, pa ua ditur fare përmbajtjen. As ai dhe as unë! Pra, qysh fëmijë u indoktrinova me myslimanizëm, si babai im. Madje kisha dëshirë që t'ia kaloja...

Shkolla e mesme, të cilën e frekuentoja, ishte në Pejë (paralagjën Vitomericë), 14 kilometra larg fshatit tim. Shumë herë, bashkë me kushërinjtë, rrugëtonim këmbë, meqë orari i trenit nuk ishte i përshtatshëm dhe shpeshherë nuk kishim as të holla për biletë. Në vitin 1969, në moshën 15-vjeçare, u sëmura. Ishte muaji i agjërimit (*ramadan*, siç quhet në arabisht, dhe *ramazan* në turqisht, por edhe në shqip). Isha gdhirë pa ngrënë *syfyr*, siç i thuhet ushqimit para lindjes së diellit. Në prag të *iftarit* (darkës) isha tepër i uritur. Rastësisht e pashë një mollë

në bankën e një shoqeje. Ia vodha. Ika në fund të oborrit të shkollës që ta haja, pa më parë askush, meqë po e prishja agjërimin. Përfundova në spital. Mjeku Mustafë Ademaj (edhe ai shqiptar, me emër e mbi-emër të arabizuar) më këshilloi: “Mos beso më në Allah të shpifur! Edhe sikur të ekzistonte, ai është kriminel, sepse ka sëmure një fëmijë që nuk e ka përballuar dot urinë...!”

E dëgjova! Që atëherë e tutje nuk agjërova më dhe fillova të çlirohem nga *Islami!** Ajo fatkeqësi ishte hapi i parë, por i madh, i çlirimit tim nga kjo dogmë skllavëruese...

Edhe kjo ishte një mrekulli e vogël, në fatkeqësinë time të madhe!

Në vitin 1976 u detyrova të arratisem në Gjermani. Me ndihmën e albanologut kroato-gjerman (i lindur në Janjevë të Kosovës), prof. dr. Lazar Dodiç, u regjistrova në *Ruhruniversität* në Bohum (Bochum), ku ai ishte i angazhuar si ligjërues i albanologjisë. Fillimi i studimeve aty ishte përvojë interesante, befasuese dhe e mrekullueshme për mua. Fare pak studentë gjermanë, për të mos thënë asnjëri që e njoha, nuk praktikonin ndonjë religjion! Në konvikt studentor (të kishës katolike) të gjithë studentët e katit ishin jofetarë. Ndërsa vetëm një sllovak dhe një çek deklaroheshin fetarë. Në kuzhinën e përbashkët na rastiste të debatonim për tema të ndryshme. Fqinji im, Mihaeli, në vitin 1978, më dhuroi librin e filozofit Niçe, *Antikrishti / Mallkim krishterimit...*

Edhe arratisja ime në Gjermani ishte një mrekulli e vogël në fatkeqësinë time të madhe (në 24 vjet ekzil, nuk pata kontakte me nënën, vëllazërinë, shoqërinë e vendlindjes...)!

* Islam [إسلام], që i shqipëruar i bie nënshtrim, gjegjësisht skllavëri.

Gjatë gjithë jetës sime më kanë interesuar dhe shqetësuar në vazhdimësi mentaliteti dhe mendësia e mbishtresuar e popullit tim, të sajuara nga prejardhja e tij e largët pellazge, ariane, albane, ilire, make-done, dardane, epirote, greke; të pushtuar nga romakët; të mbijetuar si arbëreshë e shqiptarë; të pushtuar nga bullgarët, serbët, osmanët; të konvertuar nga besimtarë politeistë në monoteistë - kristianë, muhamedanë...

Me gjithë këto fatkeqësi të mëdha, ndodhi mrekullia e vogël e mbi-jetesës së serishme të gjuhës shqipe, që duhet të ketë ngjashmërinë më të madhe me gjuhën zanafillore indoeuropiane (pellazgjishja?)! [Rreth tre mijë vjet para Aleksandrit të Madh, disa pellazgo-ariano-albanë duhet të jenë shpërngulur në Indi dhe gjuha e simbolet e tyre, po përmes tyre, duhet të jenë rikthyer në Europë. Për këtë arsye, ndoshta, përdoret shprehja “gjuhët indoeuropiane”. Këtë histori duhet t’ia ketë rrëfyer Aristoteli nxënësit të tij, Aleksandrit. E ai duhet të jetë mahnitur aq shumë nga rrëfimi i Aristotelit, sa të ndërmernte aventurën deri në Indi për t’i “vizituar” sivëllezërit pellazgo-ariano-albanë, pasi e mundi Perandorinë Perse, superfuqi e kohës, e cila po e kërcënonte me pushtim Europën...]*

Shqetësimi im është rritur shumë, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, kur në Kosovë, në Shqipëri e në Makedoni, mori hov agresioni i islamistëve fundamentalistë, për të cilët unë po e përdor emërtimin pezhorativ: lesh-arapë⁶. E përdor këtë emërtim pezhorativ, në dukje racist, qëkur kam marrë vësh se Muhamedi kishte urdhëruar myslimanët zanafillorë (selefistë) të mbajnë mjekër muhamedane, që të

* Mbajtur mend nga leximi i monografisë „Aleksandri i Madh“, i egiptologut anglez Artur Vajgal (Arthur Weigall).

⁶ Në një intervistë televizive, ministri i Brendshëm i Republikës së Kosovës, më datë 24. 07. 1915, informoi përreth 300 qytetarë shqiptarë, pjesëmarrës në luftimet sektare islame në Siri dhe Irak dhe deri më tani 40 të vranë nga Kosova në ato luftime: <https://www.youtube.com/watch?v=f4wmKH0YznU>

dallohen nga jomyslimanët, për të shmangur mbyttjet aksidentale mes tyre, të “vëllezërve myslimanë”, gjatë sulmeve luftarake të falangave xhihadiste muhamedane ndaj jomyslimanëve. Mundet që nazifashistët kanë qenë të informuar për atë praktikë muhamedane, për qëllime diskriminuese, prandaj i kanë urdhëruar çifutët të bartin shënjjimet dalluese dhe identifikuese...

Dhe këta lesh-arapë, ende shqipfolës, agresivitetin e parë kryesor e ndërmorën kundër shqiptarëve që deklarohen dhe praktikojnë një të ashtuquajtur Islam tradicional (i cili, në fakt nuk është Islam).

Ndieja gjithmonë keqardhje për shokë e miq që deklaroheshin me këmbëngulje, ndonjëri edhe me krenari fodulle, se janë myslimanë, madje edhe kur bashkë pinim alkool dhe nuk e praktikonin fare Islam-in, as atë tradicional. Më interesonin karakteri e mendësia jonë, të mbishtresuara aq vulgarisht: shqiptarë, deklarativisht besimtarë myslimanë, me emra arabë, me mendësi turkofile dhe antiturke, arabofile dhe antiarabe, tejet konfuz; fizikisht europianë, me mentalitet muhamedano-orientalë edhe shqiptarët e beimit kritian (katolik dhe ortodoks)... Shkurt e shqip: një hibrid i shpifur! Sa herë e kam pyetur veten, çfarë mendësie kemi ne, pjesëtarët e popullit shqiptar të besimit mysliman, kur flasim shqip e mendojmë orientalisht-muhamedanisht?! E përsëris: madje edhe shqiptarët e besimit të krishterë, duke qenë fqinjë të shumicës myslimane, dukshëm janë orientalizuuar...

Përkundër fatkeqësive të mëdha historike të shqiptarëve, ruajtja e gjuhës shqipe është mrekulli më vete! Po të ishin të vetëdijshëm për këtë mrekulli, popujt europianë do të na mirëkuptonin për fatkeqësitë tona deeuropianizuese dhe do të na përkrahnin për integrim të përsheptuar europian, të paktën për shkak të ruajtjes së gjuhës, si vlerë muzeale. Kultura muhamedano-orientale ka mbizotëruar mbi ne, shqiptarët, jo sepse ne kemi dëshiruar, por sepse paraardhësit tanë nuk

kishin më shumë potencial t'i rezistonin pushtimit osman, edhe pse në disa raste bënë rezistencë e luftë titanike mbrojtëse e çlirimtare. Prandaj, shqiptarët nuk mund të bëhen fajtorë dhe të dënohen, vetëm sepse jetuan në zonën kufitare (ushtarake) ndërmjet Europës dhe Azisë, dhe sepse nuk i rezistuan dot islamizimit të përdhunshëm, që na e imponoi superfuqia osmane e kohës...

Megjithëkëtë, të frymëzuar nga rilindësit tanë iluministë europianofilë, gjatë shekullit 19-të kemi bërë hapa të mëdhenj drejt europianizimit. Kjo është dëshmuar me kryengritje të shumta kundër kalifatit pushtues mysliman osman dhe me kryengritjet e dekadës së fundit të shekullit 20-të kundër pushtimit serb, gjithmonë si sekularistë evropianë dhe pa ndikime të dogmave fetare...

Edhe këto janë mrekulli të vogla në kuadër të fatkeqësive tona të mëdha!

Në verën e vitit 2011, në qendër të Shkupit (tani kryeqytet i Republikës së Makedonisë, para vitit 1913 kryeqytet i Vilajetit të Kosovës) po përgatitej bazamenti për të vendosur përmendoren e Lekës së Madh, siç e quajnë shqiptarët, përkatësisht Aleksandrit të Madh, siç quhet ndërkombëtarisht.

Emri dhe tashmë përmendorja e Aleksandrit të Madh ishin politizuar skajshmërisht në konfliktin Athinë-Shkup. Qeveria helene (pra, jogreke), siç dihet, pretendon padrejtësisht monopolin e “pronësisë historike” të Makedonisë antike, kurse qeveria e Shkupit, e përfshirë nga euforia nacionaliste “makedone”, përpiqet të sajtojë një identitet autentik kombëtar, hibrid, si pasardhës të makedonëve antikë...

Meqenëse në atë kohë isha i angazhuar si gazetar korrespondent në Shkup (për gazetën “Epoka e re”, që botohet në Prishtinë), më duhej patjetër të informohesha për këtë tematikë: kujt i takonte prejardhja etnike nga makedonët antikë: helenëve, makedonëve, shqiptarëve?

Shqiptarët, në fakt, si hibridë që janë, më së paku janë të interesuar për t'i dalë zot prejardhjes etnike nga makedonët, ilirët, dardanët, epirotët, grekët...

Krahas konflikteve të tjera, ngritja e kësaj përmendoreje të Aleksandrit të Madh në Shkup, nxiti edhe një shqetësim tjetër. Shqiptarët e besimit mysliman, sidomos myslimanët fundamentalistë, kërcënuan se do ta eksplodonin në ajër përmendoren e atij *kufari*...

Kisha lexuar goxha shumë për Aleksandrin e Madh, por monografia e egjiptologut anglez, Artur Vajgal (Arthur Weigall)⁷, më ofroi informacion më të përmbledhur për atë personalitet historik. Ajo monografi më freskoi edhe mua krenarinë, si pasardhës i Lekës së Madh. I provokuar edhe nga kërcënimet e myslimanëve fundamentalistë, bëra shumë sqarime, si masë preventive, për të mos ndodhur një sulm terrorist mbi përmendoren e Aleksandrit të Madh. Takova shumë myslimanë lesh-muhamedanë. Po mundohesha t'i bindja se nuk duhej ta bënin atë krim ndaj Përmendoreje, sepse ai ishte paraardhës etnik i shqiptarëve, por argumenti im nuk kishte vlerë për islamistët fundamentalistë. Ata tashmë nuk ndiheshin shqiptarë, por vetëm pjesëtarë të *umetit* (bashkësisë) mysliman dhe Aleksandrin e Madh e urrenin si *kufar*.

Një klerik mysliman*, me kualifikime të larta teologjike, më këshilloi që ta shfrytëzoja *Kuranin* për t'i informuar islamistët se Aleksandri i Madh në *Kuran* figuron si profet. Ai më sqaroi se emri i Aleksandrit, figurativisht, është i përshtatur me emërtimin në arabisht: *Dhulkarnejni* (*Dybrirëshi*); ajetet 83-111 të sures nr. 18 (El-Kelf / Shpella), i dedikohen atij.

⁷ <http://www.ebay.com/itm/Alexander-The-Great-ARTHUR-WEIGALL-1947-3rd-Impression-/371372328049>.

* Për shkaqe të sigurisë fizike të tij nuk po ia them emrin.

Menjëherë bëra një shkrim, të cilin e titullova: “*Kurani* madhëron Aleksandrin e Madh për profet”. E publikova në shumë gazeta e portale (në gjuhën shqipe në Makedoni). Njëkohësisht e shumëfishova dhe e shpërndava edhe si trakt. Islamistët fatmirësisht, u qetësuan...

Qysh atëherë u irritova nga ai fragment i *Kuranit*, për pasaktësinë e tij historike dhe përmbajtjesore.

Shqetësimin ma rriti angazhimi i disa ish-bashkëkombësve të mi, tashmë të tjetërsuar në muhamedanë fashistoidë në Siri e Irak, duke ushtruar atje krime barbare ndaj civilëve, sidomos ndaj atyre që nuk janë myslimanë suni, si dhe angazhimi i disa të tjerëve në krime terroriste në Gjermani, në SHBA, në Shqipëri, në Kosovë. Implikimi në krime i bashkëkombësve të mi më nxiti të angazhohem më me përkushtim për të përgënjeshtuar dogmën zanafillore të islamit, sepse pikërisht ajo po i indoktrinon e viktimizon të rinjtë tanë, duke i bërë kriminelë që viktimizojnë veten e tyre, fatkeqësisht duke vrarë të tjerë, për të zbatuar përcaktimet që përmban *Kurani* dhe porositë fashistoide të Muhamedit!

Tashmë duhet të kuptojmë se me (vetë)mashtrimin “islami është fe paqësore”, nuk i pengojmë dot indoktrinimet fundamentaliste të të rinjve, për t’u angazhuar e viktimizuar në luftime barbare e në sulme terroriste. Shumë të rinj, tashmë, janë indoktrinuar me dogmën bazike islame, e cila, siç do të lexoni, është jo vetëm diskriminuese e shoviniste, por edhe tepër agresive dhe fashistoide!

Si jofetar i deislamizuar, jam shokuar nga përmbajtja tepër fashistoide e *Kuranit* dhe haditheve muhamedane. Nëse ndokush do të ma rrëfente para katër vjetësh këtë që po shkruaj tani, sigurisht nuk do ta kisha besuar.

Gjatë studimeve të literaturës për islamin, kryesisht literaturës bu-
rimore islame, ndieja vazhdimisht keqardhje për besimtarët myslima-
në, të cilët, në mënyrë të pavetëdijshme janë indoktrinuar, janë sklla-
vëruar dhe po viktimizohen nga kjo dogmë. Çlirimi i besimtarëve
myslimanë nga ky skllavërim është në përputhje të plotë me interesin
tonë të përbashkët kombëtar e qytetërues.

Ky është dhe qëllimi im kryesor pse shkrova këtë libër! Uroj të
mirëkuptohem, ose të paktën të mos keqkuptohem deri në armiqësim
muhamedan!

Mos u irritoni para kohe, ju lutem!

Në këtë studim jam kufizuar në rreth 370 ajete diskriminuese, agre-
sive e fashistoide të *Kuranit*. Ato nuk i kam trilluar unë. Ato mund t'i
gjeni në *Kuran*, të përkthyer në qindra gjuhë të botës! Pra, shkrimi i
këtij libri nuk është i motivuar, as është nxitur nga islamofobia, si truk
për të bllokuar kritikuesit iluministë, por nga shqetësimi im, i
provokuar nga agresiviteti i islamistëve fashistoidë, të cilët pozbatojnë
dogmën e sanksionuar në *Kuran*.

Në këtë studim do të provohet se *Kurani* nuk është vepër e Allahut,
meqë ai është vetëm personazh, i sajuar ekstra nga Muhamedi; do të
provohet se *Kurani* ka përmbajtje që ndalon bashkëjetesën harmonike
ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve; do të provohet, gjithashtu,
se myslimanë të vërtetë, që po zbatojnë *Kuranin* dhe hadithet
muhamedane, janë xhihadistët vrasës, të angazhuar në Siri dhe në Irak,
në të ashtuquajturin kalifat islamit [ISIS]! Pra, praktikimi taksativ i
Kuranit dhe i haditheve përkatëse po ndodhin në "ISIS".

Revista gjermane “Die Geschichte” më pati irrituar deri në egërsim! Citoj:

Disa thonë sedo të jetë e turpshme nëse do të imitohet, gjithnjë, në detaje, Muhamedi. Jo! Ai, megjithatë, është ideali! Problemi është se myslimanët nuk po i përmbahen islamit të vërtetë, atij që ka praktikuar Profeti dhe dishepujt e tij. Nëse një vrojtues i jashtëm i sheh tani gabimet dhe problemet e myslimanëve, ai mendon se ato vijnë nga islami. Por kjo nuk është e vërtetë. Nëse ka diçka të keqe te ne, atëherë është nga ne. Dhe në qoftë se kemi ndonjë të mirë, atëherë e kemi nga islami, të cilin Perëndia na e ka dhuruar.

Shansi i vetëm për myslimanët (në kundërshtim me shumë fe të tjera), nuk janë reformat e rinovimet, por pikërisht e kundërta, orientimi reflektues në vlerat e vjetra dhe të bëhemi sa më konservatorë e fundamentalistë, siç ka jetuar Profeti atëherë (që atëherë ishte gjithçka tjetër, por jo konservator; në mesin e jobesimtarëve dhe veprimeve të këqija ai ishte një reformator).⁸

Skandaloze! Propagandë fundamentaliste islamike! Uroj që botuesi e kryeredaktori i kësaj reviste të mos mendojnë që myslimanët duhet të vazhdojnë të besojnë bërthamën e dogmës fashistoide të islamit - islamin zanafillor dhe sajuesin e saj, Muhamedin! Kësi propagandimesh stereotipe, mashtruese, hasim gjithandej. Prandaj, ky është edhe një motiv më shumë për të shkruar këtë libër: që t’u kundërvihem propagandistëve të tillë mashtrues!

Kam dëgjuar edhe presidentin amerikan, Obama dhe kancelaren gjermane, Merkel, të lavdërojnë fenë islame dhe sajuesin e saj, Muhamedin, si paqësorë, duke kritikuar vetëm islamistët ekstremistë që po bëjnë krime(!) Gënjeshtër! Skandaloze dhe irrituese! Këto mashtrime,

⁸ <http://www.g-geschichte.de/forum/religion/2168-beweise-dafuer-mohammed-koran-erfunden-hat-2-a.html#post51016>.

qofshin edhe taktike e pragmatike, sponsorizojnë islamin agresiv, terrorizmin fashistoid islamik!

Këso prononcimesh nuk e ndihmojnë politikën paqësore, sigurinë, bashkekzistencën paqësore fetare e qytetare, dhe as 90 % të myslimanëve paqësorë, të cilët, në fakt, nuk janë besimtarë të përkushtuar myslimanë.

E vërteta është se islamistët terroristë janë viktima të indoktrinimit islam: ata vetëm po zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet që i përmban *Kurani* dhe porositë e tjera fashistoide, që duhet t'i ketë bërë Muhamedi!

Unë, megjithëkëtë, këmbënguli se dogma islame duhet të përgënjeshtrohet e të çmitizohen, si dogmë e dëmshme, e sajuar nga autorë tokësorë, aspak dogmë hyjnore, e krijuara nga Allahu muhamedan. Përndryshe, duke u indoktrinuuar me mashtrime të tilla, si: "*Kurani* është vepër e Allahut dhe Muhamedi është profet", të rinjtë do të eska-lojnë në xhihadistë muhamedanë dhe detyrimisht do të zbatojnë porositë dhe urdhëresat vërtet agresive e fashistoide që i përmban dogma fundamentale islame!

Si argumentim i nevojës për ndalimin e *Kuranit* nga ndonjë gjykatë ndërkombëtare, siç i është ndaluar *Mein Kampf* e Hitlerit, mbase do të mjaftonin vetëm dy ajete të *Kuranit*:

"Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë nuk është vetëm të mbyten ose të gozhdohen, t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, por edhe të dëbohen nga vendi. Ky është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. "

[Kurani, surja 5: ajeti 33 / shqipëruar Sh. Ahmeti]

"Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë... "
[9:29]

Uroj që myslimanët fundamentalistë dhe (psudo)myslimanët tolerantë, të kenë vullnet të mirë për ta lexuar këtë libër, të cilin e kam shkruar parësisht për ta, meqë dua t'i ndihmoj për t'u ndërgjegjësuar se po bashkëjetojmë në botën e shekullit XXI, e cila është emancipuar e zhvilluar shumë në krahasim me botën e shekullit VII dhe, prandaj, është i pamundur rikthimi në atë botë të zymtë.

Është në interes të të gjithë myslimanëve që të bëhen realistë, se përcaktimet fashistoide që i përmban *Kurani* mesjetar nuk duhet dhe nuk mund të praktikohen e zbatohen tani, sidomos jo në shtete e shoqëri sekulariste. Përndryshe, më së shumti pasoja do të kenë kryesisht vetë besimtarët myslimanë!

Uroj që islamistët fundamentalistë të mos e zbatojnë edhe kundër meje ajetin e sipërcituar (5:33) dhe hadithin përkatës për apostezi (“dezertim”) nga Islami, që parasheh ekzektimin, siç më kanë kërcënuar shpesh, gjatë debateve në FB, dhe siç e kanë zbatuar me krimet në Paris e gjetiu, meqë nuk i sjell dot fitore përcaktimit për islamizim të dhunshëm të gjithë njerëzimit, siç urdhëron *Kurani*. Rreth 6 miliardë njerëz nuk e njohin Allahun për Zot dhe as Muhamedin për profet. Me veprime të tilla kriminele e terroriste provokohet vetëm reaksioni: edhe ne jomyslimanët, fatkeqësisht, jemi të detyruar të vetëmbrohemi nga agresioni i tyre fashistoid!

Gusht, 2015

I. 1. Muhamedi / Islami - kronologji historike tabelare⁹

Viti	muaji	data	Ngjarja
569	06	17	• Lindja e Muhamedit, ditë e hënë (?)
571	04	20	• Lindja e Muhamedit (?)
575			• Vdekja e nënës së Muhamedit, Amina, në Abja, dhe kalimi i Muhamedit në përkujdesje të gjyshit Abdulmuttalib, në Mekë.
577			• Vdekja e gjyshit Abdulmuttalib; përkujdesja nga xhaxhai, Ebu Talib.
578			• Udhëtimi me karvan për në Siri, me xhaxhanë EbuTalib.
589			• Pjesëmarrja e Muhamedit në marrëveshjen për Al-Fudul.
594			• Udhëtimi në Basra, si udhëheqës i karvanit të Hatixhesë.
			• Martesa e tij me Hatixhenë.
605			• Restaurimi i Qabesë nga fisi Kurejsh, nën përkujdesjen e Muhamedit.
610	09	27	• Zbulesa e ajetit “Ikra”, të sures së parë El-Alak, në shpellën e malit Hira (e renditur nga komisioni “redaktues” i kalifit Utman nën nr. 96). Gjatë tri viteve në vazhdim, asnjë zbulësë.
613	Ose	01	• Apeli i parë publik i Muhamedit për konvertim në islam.
615	02		• Shpërngulja (hixhra) e parë e myslimanëve në Abisini.
616			• Shpërngulja (hixhra) e dytë në Abisini.
			• Xhaxha Hamzai konvertohet në mysliman.
			• Umeri (Omeri) konvertohet në mysliman.
			• Takimi i fiseve Hashim dhe Muttalib në rrethin e Ebu Talibit për të mbrojtur Profetin Muhamed.
			• Fillimi i bojkotit social dhe ekonomik ndaj të pafeve.
619			• Fundi i bojkotit.
620			• Vdekja e Ebu Talibit dhe e Hatixhesë (viti i zisë).
			• Martesa e Profetit Muhamed me Savda bint Zama.
			• Udhëtimi në Taif me Zejd b. Harisa dhe kthimi në Mekë nën mbrojtjen e Mutim b. Adi (Sheval).
			• Profeti takohet në Akabe me një grup prej Benu Hasraxh nga Medina në sezonin e pelegrinazhit.
621			• Isra dhe Miraxh (fluturimi i Muhamedit);
	07	27	• Shpallja e detyrës ritual lutje (pesë herë në ditë).

⁹ E përpiluar duke u bazuar kryesisht në kronologjinë e bërë nga fondacion islam në Turqi, e cila me rastin e inaugurimit kishte mysafir kryeministrin turk Erdogan, ministrin e arsimit, shefin e drejtorisë për çështje fetare dhe shumë personalitete shtetërore, kulturore e fetare. Ja portali zyrtar:

<http://www.derletzteprophet.info/chronologie-der-epoche-des-propheten-mohammed-sav>

- Betimi i parë i besnikërisë (baya) në Akaba.
- Dërgimi si misionar i Islamit i Musab b. Umair në Medinë.
- 622 • Betimi i dytë i besnikërisë ndaj Akabasë.
- Fillimi i migrimit të myslimanëve në Medinë, pas betimit të dytë të besnikërisë ndaj Akabasë.
- 622 07 • Takimi i jobsimtarëve në Dar al-Nadva (Shtëpia e Nadvës, takimi në Mekë) dhe vendimi për ta vrarë Muhamedin (26 Sefer / 9 shtator).
- 9 • Strehimi i përbashkët me Ebu Bekrin në shpellën Teur.
- 09 • Arratia nga shpella Teur për në Medinë (1 Rebiulal Aval.); në burime të tjera përmendet data 16.07.622.
- 9 • Arritja në qytetin Kuba (8 Rebiulal Aval).
- 09 • Ndërtimi i xhamisë në Kubë (Rabiel Euel).
- Shfaqja e Muhamedit në Kubë, lutja e parë e përbashkët e së premtes në luginën Ranuna;
- 24 • Arritja e tij në Medinë dhe strehimi i tij në Abu Ejub-el-Ensariut (12 Rabiel Euel).
- 09 • Fillimi i ndërtimit të xhamisë në Medinë (Xhamia Al-Nabavi) (Rabiel Euel).
- Ezani është vendosur të thirret para lutjes (namazit).
- 623 01 • Vëllazëria midis ensarëve dhe muhaxhirëve.
- 03 • Marrëveshja në mes të fiseve të Medinës.
- Sulm plaçkitës për nevoja jetësore ndaj Alls Karvan Raid¹⁰
- Vendimi për luftime.
- 03 • Beteja në Xhesh (Siful-Bahr), nën udhëheqjen e Hamzait.
- 04 • Përfundimi i Xhamisë së Muhamedit.
- Sulm për plaçkitje të kafshëve¹¹.
- 05 • Beteja në Harrar, nën udhëheqjen e Sad b. Ebu Vakës.
- 05 • Sulm plaçkitës ndaj karvanëve të fisit Kurejsh¹²

¹⁰ Watt, W. Montgomery (1956). *Muhammad at Medina*. Oxford University Press. p. 2. ISBN 978-0195773071. "In the first two or three expeditions the numbers involved are given as from 20 to 80. In those of the later part of 623 (ii-vi/2), however, when Muhammad himself took part, they are said to have ranged up to 200." (free online);

Mubarakpuri, The Sealed Nectar, p. 127. (online)

Hawarey, Dr. Mosab (2010). *The Journey of Prophecy; Days of Peace and War (Arabic)*.

Islamic Book Trust. Note: Book contains a list of battles of Muhammad in Arabic, English translation available here;

Muhammad Ibn 'Abdal-Wahhāb, Mukhtaşarżādal-ma'ād, p. 345.

¹¹ Al-Bukhari, 5:57:74;

Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 4.

¹² Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 4.

- | | | | |
|-----|----|---|--|
| | 10 | • Krijimi i tregut në Medinë. | |
| 07 | | • Themelimi i institucionit <i>Sufa</i> në Xhaminë e Muhamedit. | |
| | | • Muhamedi agjëron për Ashure dhe rekomandon atë për myslimanët (Muharrem / 14). | |
| 08 | | • Sulm në Vadan ndaj karvanëve të kurejshëve ¹³ . | |
| 09 | | • Beteja në Abja (Vadan). | |
| 09 | | • Beteja në Buva. | |
| 10 | | • Sulm në Buva ndaj karvanëve ¹⁴ . | |
| 11 | | • Beteja e parë në Bedër (Safavan). | |
| | | • Beteja për Ushar (Zul'ushayra). | |
| 12 | | • Sulm në Dula shir ¹⁵ | |
| | | • Sulm në Safvan, përndjekje Jabir Al-Fihri. | |
| 624 | 01 | • Beteja në Batnal-Nahle, udhëheqës Abdullah b. Xhahsh, një i vrarë ¹⁶ . | |
| | 01 | • Ekspeditë xhihadiste për vrasjen e Asmabint Marvan ¹⁷ . | |
| | 02 | 26 | • Ekspeditë për vrasjen e poetit Ebu Afak ¹⁸ . |
| | | | • Ndryshimi në drejtimin e lutjes (kibles) nga xhamia Al-Aksa në Jerusalem në Xhami el-Haram (Qabeja) në Mekë. |
| | 02 | | • Futja e lutjes Taravih (gjatë Ramadanit). |
| | 03 | 13 | • Sulm ndaj fisit Banu Kajnuka ¹⁹ |
| | | 13 | • Beteja në Bedër (e martë /17 ramadan 2 AH), të vrarë 14 myslimanë dhe 70 jomyslimanë. ²⁰ |
| | 03 | | • Zbulimi i sures <i>El-Enfal</i> . |
| | 03 | | |

¹³ Ibn Hisham , Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's SīratrasūlAllāh*. Oxford University Press. p. 345.

¹⁴ Muslim, 42:7149

¹⁵ Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's SīratrasūlAllāh*. Oxford University Press. p. 345.

¹⁶ Kuran [2:217]; Mubarakpuri, Saifur Rahman Al (2005), *The sealed nectar: biography of the Noble Prophet*, Darussalam Publications, p. 246; Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's SīratrasūlAllāh*. Oxford University Press. p. 345.

¹⁷ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir, By Ibn Sad, Volume 2*. Pakistan Historical Society. p. 31. ASIN B0007JAWMK. ""Then occurred the "sariyyah" of Salim IbnUmayr al-Amri against Abu Afak, the Jew, in [the month of] Shawwal in the beginning of the twentieth month from the hijrah"

¹⁸ Ibn Sad, vep. e cituar.

¹⁹ Watt, *Muhamed at Medina*, p. 209.

²⁰ Kuran [8:5; 8:6; 68:25]; Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's SīratrasūlAllāh*. Oxford University Press. p. 210.

	03	27	Sulm për vrasje të Ebu Sufjan; të vrarë 2 myslimanë ²¹
	03		• Vdekja e vajzës së Muhamedit, Rukija.
	03		• Taksa lëmoshë (Fiter) në ramadan.
	04		• Festimi i parë pas agjërimit (Eidal-Fitr) dhe falja e namazit
	04	29	festiv (Fiter-Bajrami).
	05		• Martesa e Muhamedit me Aishen.
	06	03	• Beteja kundër fisit Bani Kajnuka.
			• Beteja në Savik.
	06		• Sulm befasues i fisit hebre Banu Salim në Al Kudër ²² .
			• Martesa e Aliut (djali i xhaxhait të Muhamedit) me Fatimen
	06	04	(vajza e Muhamedit).
			• Festa e parë e Kurban Bajramit.
	06		• Vdekja e muhaxhirit Utman b. Mazun dhe krijimi i
	08		mëvonshëm i varrezave Xhannatel-Baki.
			• Tatimi vjetor (zekati).
	10		• Martesa e Utmanit me vajzën e Muhamedit, Umm Khultum.
			Vrasja e Kab b. Ashraf. ²³
			• Sulm fiseve Banu Muharib dhe Talabah në Dhi Amr ²⁴ .
			• Beteja në Bahran kundër fisit Bani Sulejm ²⁵ .
			Plaçkitje karvanit të kurejshëve në Nejd: 3 myslimanë robër ²⁶ .
			Vrasja e satiristit kritik Abu Rafi' ibn Abi Al-Huqaiq ²⁷ .
			• Martesa e Muhamedit me Hafsanë.
			• Lindja e Hasanit, nipi i Muhamedit.
625	01	27	• Martesa e Muhamedit me Zejneb bint Huzaima.
	01	28	• Beteja e Uhudit; mbrojtje kundër sulmit të kurejshëve, të
	02	23	vrarë 70 myslimanë dhe 37 jomyslimanë ²⁸ .
	03		• Beteja në Hamra al-Asad (Agimi i Medinës), të vrarë 2
		25	myslimanë dhe 3 jomyslimanë (prerje koke) ²⁹ .
	03		• Sulm fisit Asad bin Khuzajmah ³⁰ .
	06		• Beteja në Raxhi (nën udhëheqjen e Marsad b. Ebu Marsad).
			• Ngjarja e Birimaunes.

²¹ Ibn Hisham , Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq'sSīratrasūlAllāh*. Oxford University Press. p. 675.

²² Po aty. P. 656

²³ Bukhari, 5:59:369; Muslim, 19:4436

²⁴ Bukhari, 5:59:458

²⁵ Mubarakpuri, The Sealed Nectar, p. 153.

²⁶ Bukhari, 5:59:627; Muslim, 19:4330; Dawood, 14:2672

²⁷ Bukhari, 4:52:264; 5:59:370; 5:59:371, 5:59:372

²⁸ Kuran [8:36; 3:122]; Mubarakpuri, The Sealed Nectar, p. 181.

²⁹ Mubarakpuri, The Sealed Nectar, pp. 181-183; Kuran 3:173; 3:174

³⁰ Muslim, 19:4330, Bukhari, 5:59:627

	07		Ekspeditë në Bit Maona ³¹ .
	07		• Beteja kundër fisit Bani Nadir. Trilli i Muhamedit për urdhrin që ka marrë për sulmim nga Xhibrili ³² .
	07		• Ndalimi i alkoolit.
			• Vdekja e gruas së Muhamedit, Zejneb bint Huzaima.
			Ekspeditë Abdullah Ibn Unais; vrasja e Khalid bint Sufyan ³³ .
	08		
	10		Ekspeditë në Dhat Al-Rika, shumë gra robinja ³⁴ .
			Misioni Amrbin Umajjahal-Damri: 3 jomysliman të vrarë ³⁵
			• Ardha e delegacionit të fisit Bani Abs në Medinë dhe konvertimi i tij në islam.
626	01	5	• Betejë e kurejshëve të udhëheqjen e Ebu Sufjan në Bedër ³⁶ .
	01		• Lindja e Huseinit, nipi i Muhamedit, djali i Aliut.
	03		• Martesa me Umm Selemen.
	04		• Beteja në Badrul-Mavid.
			• Vdekja e nënës së Aliut, Fatima bint Asad. [Burimet islame (dez)informojnë se Muhamedi ka dhunuar kufomën e saj, me arsyetim gradimi i saj si “nënë e besimtarëve”...]
	06	10	• Sulm fisit Ghatafan në D. Xhandal ³⁷
	07		• Beteja në Zaturrika dhe kryerja e lutjes së frikës (Salatu'l-Havf) (viti 5, muaji muharrem / 11.).
	08	24	• Beteja në Dumetulxhendel.
			• Eklipsi hënor në Medinë dhe kryerja e namazit Khusuf (një lutje dedikuar eklipsit hënor ose diellor) nga Muhamedi.
			• Ardha e një delegacioni prej 400 myslimanësh nga Muzaina në Medinë.
627	01		• Beteja kundër fisit Bani Mustalik (Muraisi ').
	01		• Ngjarja Ifk (shpifje kundër Aishes ose seksi i saj “ilegal”).
	01		• Martesa me Xhuvairia bint Haris.
	02		• Numërimi i popullsisë në Medinë.
	02		

³¹ Kuran 3:169; Bukhari 5:59:405

³² Kuran 2:256; Bukhari 3:39:519; Tabari, Al (25 Sep 1990), *The last years of the Prophet* (translated by Isma'il Qurban Husayn), State University of New York Press

³³ Musnad Ahmad 3:496; Davut, b. 2 no. 1244

³⁴ Kuran 4:101; 5:11; Muslim 4:1830

³⁵ Tabari, Al (2008), *The foundation of the community*, State University of NY Press, p. 147

³⁶ Mubarakpuri, *The Sealed Nectar*, p. 193. (online); Kuran 3:173-176; Bukhari 5:59:627

³⁷ Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's Sīratasul-Allāh*. Oxford University Press. p. 657

- 04 Beteja në Trenh kundër Banu Nadir, Banu Kajnuka dhe Kurejsh³⁸
- 04 Sulmi fisit Banu Kurajza (sipas porosisë se Xhibrilit), të vrarë 2 myslimanë dhe 600-900 jomyslimanë (me prerje koke, në qendër të Medinës)³⁹.
- 04 • Beteja e llogoreve (Ahzab) / barrikadimi i Medinës.⁴⁰
- 06 • Martesa me Zejneb bint Jahsh (vajzë e hallës dhe nuse e djalit të birësuar) dhe zbulesat mbi ndalimin e adoptimit (ajetet El-Ahzab 33:4-5).
- 07 • Sulm plaçkitës, 10 të vrarë⁴¹
- 08 • Sulm plaçkitës fisit Banu Assad bin Khuzajma⁴².
- 08 • Beteja kundër fisit hebre Bani Kuraiza.
- 08 • Sulmi i parë ndaj Banu Talabah⁴³
- 09 • Beteja kundër fisit hebre Bani Lihjan.
- 09 • Beteja e parë në Dhulkasa nën udhëheqjen e Muhamed b. Maslama.
- 09 • Beteja e dytë në Dhulkasa nën udhëheqjen e Ebu Ubaidah b. Jarrah.
- 09 • Sulm ndaj Banu Lahjan⁴⁴.
- 10 • Sulm në Al-Ghabah⁴⁵.
- 12 • Sulm ndaj Dhul Karad⁴⁶.
- 12 • Beteja në Tarif, e udhëhequr nga Zejd b. Harise.⁴⁷
- 12 • Sulm ndaj fisit hebre Banu Mustalik, të vrarë 1 mysliman dhe 10 jomyslimanë⁴⁸
- Sulm ndaj A.R. binAuf; 700 kristianë të konvertuar në myslimanë brenda tri ditësh⁴⁹.

³⁸ Kuran 33:10-13; 3:22; Bukhari 5:59:435; Muslim 31:4940

³⁹ Kuran 33:9; 10:33:26; Bukhari 4:52:68

⁴⁰ Kaptina (Surja) 33, ajete (ajetet) 9-25.

⁴¹ Bukhari 5:59:658; Muslim 19:436

⁴² Mubarakpuri, The Sealed Nectar, p. 205; Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 105.

⁴³ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 105.

⁴⁴ Muslim, 20:4672

⁴⁵ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 105.

⁴⁶ Muslim 19:4450

⁴⁷ Bukhari 2:52:191

⁴⁸ Bukhari 76:1:422; Muslim 19:4292

⁴⁹ Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). *The life of Muhammad: a translation of Ishāq's Sīratrasūl Allāh*. Oxford University Press. p. 672.

- 628 01 • Beteja në Vadilkura, e udhëhequr nga Zejd b. Harise.⁵⁰
01 • Sulm kundër fisit Sad bin Bakr⁵¹
01 • Misioni i Abdurrahman b. Avf pas Dumetulxhendel nga Muhamedi.
01 • Beteja e Medjenit, e udhëhequr nga Zejd b. Harise.
01 • Beteja e Fadakut nën udhëheqjen e Aliibn Talib.
01 • Beteja e dytë në Vadilkurra, udhëhequr nga Zejd b. Harise⁵².
02 • Sulm ndjekëse kundër Abdullah b. Ravaha pas Hajbar.
02 • Sulm Abd. in Ravaha; vritet Al-Xhusair, i dyshuar si atentator ndaj Muhamedit, 30 jomyslimanë të vrarë⁵³.
02 • Thatësira në Medinë dhe lutja për shi e Muhamedit.
03 Marrëveshja në Hudajbijah për pelegrinazh në Mekë (Umrah)⁵⁴
03 • Eklipsi hënë-diell dhe lutja Khusuf e Muhamedit.
03 • Utman zihet rob nga kurejshët.
03 • Marrëveshja *Hudajbiaa*.
04 • Zbulimi i sures *El-Feth*.
04 • Vizita e udhëheqësve të fiseve Bani Huzaa, Bani Aslam dhe Bani Hushani në Medinë dhe konvertimi në islam.
05 • Kërkesa e fiseve dhe vendeve fqinje, veçanërisht Perandorisë Bizantine dhe Perandorisë Sasanide, për kalim në islam.
05 • Maria, skllave kopte - dhuratë Muhamedit nga mbreti egjiptian.
05 • Beteja dhe pushtimi i Fidakut, shpronësimi i hebrejve⁵⁵.
05 • Beteja në Khajbar, të vrarë 16 myslimanë dhe 93 hebrej⁵⁶.
05 Sulmi i tretë ndaj hebrejve në Vadilkurra, të vrarë 1 myslimanë dhe 11 hebrej⁵⁷.
05 • Islamizimi i Abul As dhe martesë e tij me të bijën e Muhamedit, Zejneben.
05 • Përpjekja e Zejneb bint Harise për helmim të Muhamedit.

⁵⁰ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir, By Ibn Sad, Volume 2*. Pakistan Historical Society. p. 108.

⁵¹ Po aty.

⁵² Muslim 19:4345

⁵³ Tirmidhi nr. 3923

⁵⁴ Kuran 48:24; Muslim 19:2961

⁵⁵ Kuran 59:6-7; Mubarakpuri, *The Sealed Nectar*, pp. 214-215.; Abu Khalil, Shawqi (1 March 2004). *Atlas of the Prophet's biography: places, nations, landmarks*. Dar-us-Salam. p. 180.

⁵⁶ Kuran 48:15; 48:20; Mubarakpuri, *The Sealed Nectar*, pp. 214-215.

⁵⁷ Tabari, Al (25 Sep 1990). *The last years of the Prophet (translated by Isma'il Qurban Husayn)*, State University of New York Press. "Enumerating with them the expedition of Wadi al-Qura. He stated that he fought there with his slave Mid'am"

- 05 • Martesa me Safija bint Hujaj.
10 • Beteja në Vadilkurra.
• Marrëveshja me çifutët e Tajmas.
12 • Beteja në Turaba, nën udhëheqjen e Umerit.
12 • Beteja për Naxhid, nën udhëheqjen e Ebu Bekr.
12 • Beteja e Fedekut, nën udhëheqjen e Bashr b. Sadi.
12 • Sulm ndaj fisit Banu Kilab⁵⁸.
12 • Sulm ndaj fisit Banu Murrah⁵⁹.
• Beteja e Majfa, nën udhëheqjen e Galib b. Abdullahut.
629 01 • Sulm plaçkitës e konvertues kundër fisit Banu Talabah⁶⁰
01 • Martesa me Umm Habiba bint Ebu Sufjanit.
01 Sulm ndaj B. Ibn Sad (Jemen).
02 • Martesa me Majmuna bint Haris.
03 • Khalid b. Valid Amr dhe Uthman b. Talha konvertohen në
05 31 islam.
• Sulm plaçkitës ndaj fisit Banu Murah⁶¹.
05 • Sulm ndaj fisit Banu Al-Mulavi⁶².
05 • Vdekja e vajzës së Muhamedit, Zejneb.
06 • Sulm ndaj fisit Banu Lajdh⁶³.
06 • Sulm ndaj fisit Banu Amir⁶⁴.
06 • Sulm ndaj fisit Banu Kuda, 14 të vrarë⁶⁵.
06 • Beteja në Mutah, 12 myslimanë dhe shumë jomyslimanë të
08 vrarë⁶⁶.
• Sulm fisit Banu Kudah⁶⁷.
10 • Beteja në Zatusalasil, udhëhequr nga Amr b. Si.
11 • Sulm fisit Juhanah⁶⁸.
11 • Sulm për vrasjen Rifaha bin Kais, 4 të vrarë⁶⁹.
• Sulm fisit Ghatafan për konvertim në islam⁷⁰.

⁵⁸ S. E. Davod 14:2632

⁵⁹ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 146.

⁶⁰ Bukharit 5:59:568

⁶¹ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society.

⁶² Davod, 14:2672

⁶³ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Hist. Soc. p. 157.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Kuran 19:71; Bukhari 5:59:565; Mubarakpuri, The Sealed Nectar, p. 245.

⁶⁷ Bukhari 5:59:644

⁶⁸ Bukhari 3:44:663; Muslim 21:4757

⁶⁹ Al Tabari, Michael Fishbein (translator) (1997), *Volume 8, Victory of Islam*, State University of New York Press, p. 151

⁷⁰ Po aty.

12			• Beteja në Sifulbahr (Habat), nën udhëheqjen e Ebu Ubaidah b. Xhrrah.
12			Sulm i dytë në Abu Katad (parapërg. për sulm ndaj Mekës) ⁷¹ .
			• Shkelja e marrëveshjes <i>Hudajbija</i> , nga kurejshët politeistë dhe përpjekja e Ebu Sufjani për të mbajtur paqen.
630	01		• Sulm në Amr për shkatërrim të skulpturave idhujtarë ⁷² .
			• Sulm fisit Xhadhimah dhe konvertimi i dhun. në islam ⁷³
	01	04	• Nisja në betejën për pushtim të Mekës.
	01	11	• Pushtimi i Mekës (në dhjetor 629) ⁷⁴ .
			• Beteja në Hunajn, të vrarë 5 myslimanë dhe 70 jomyslimanë ⁷⁵
	01		• Fisi Bani Mahzum konvertohet në islam.
	01		• Sulm i komanduar nga Hisham b. Si, për të shkatërruar idhullin Uza.
	01		• Sulm i komanduar nga Sad b. Zejdel-Ashhali Mushallal, për shkatërrimin e idhullit Menat.
	01		• Shkatërrim i idhullit Jagudh dhe përgatitje për sulm Taif. ⁷⁶
	01		• Sulm për të shkatërruar idhullin Suva.
			Beteja në Auta (për konvertim të dhunshëm) ⁷⁷ .
			Rrethimi i Taifës, 12 myslimanë dhe shumë jomyslimanë të vrarë. ⁷⁸
	01		• Sulm i komanduar nga Tufail b. Amrel-Amrb. Humama Davsi, për shkatërrimin e idhullit Dhulkaffain
	02	10	• Beteja e Hunejnit.
	02	19	• Ekspedita e Khalid b. Valid në Bani Xhaime, për konvertim.
	02		• Beteja në Taif.
			• Muhamedi takon “motrën e qumështit” Shajma, vajza e Halimas, të cilën nuk e kishte parë që nga fëmijëria.
	03		
	03	10	• Umra e “Profetit”.

⁷¹ Kuran 4:94; Muslim 43:7176; Ibn Kathir, Muhammad Saed Abdul-Rahman (translator). *Tafsir Ibn Kathir Juz' 5 (Part 5): An-Nisaa 24 to An-Nisaa 147 2nd Edition*. p. 94

⁷² Ibn al Kalbi, Hisham (1952). *The book of idols: being a translation from the Arabic of the Kitāb al-asnām*. Princeton University Press. p. 25.

⁷³ Bukhari 5:59:628; Sad, Ibn (1967). *Kitāb al-tabaqat al-kabir, By Ibn Sad, Volume 2*. Pakistan Historical Society. p. 181.

⁷⁴ Kuran [12:91-92; 34:49; 49:13]; Bukhari 5:59:582; Mubarakpuri, The Sealed Nectar, pp. 251-253.

⁷⁵ Kuran 9:25-26; Bukhari 4:53:370; Mubarakpuri, The Sealed Nectar, pp. 261-262.

⁷⁶ Sad, Ibn (1967). *Kitāb al-tabaqat al-kabir, By Ibn Sad, Volume 2*. Pakistan Hist. Soc. p. 194.

⁷⁷ Kuran 9:25; Bukhari 5:59:612

⁷⁸ Tabari, Al (25 Sep 1990), *The last years of the Prophet (translated by Isma'il Qurban Husayn)*.

- 03 19 • Beteja e Sana, nën udhëheqjen e Ebu Umaja.
- 04 • Beteja e Hadhramaut, e udhëhequr nga Zijad b. Labid.
- 04 • Sulm fisit Banu Tamim që të paguajnë taksat (zakat)⁷⁹.
- 04 • Ekspedita e Ala b. Hadrami dhe Ebu Hurejre, si lajmëtarë për udhëheqësit e Bahrein, Munzir b. Sava.
- 04 • Lindja e Ibrahimit, djalit të Muhamedit dhe Maries.
- 04 • Sulm fisit Beni Temim, nën udhëheqjen e Ujaina b. Hisn, ardhja e Beni Temim në Medinë dhe konvertimin e tyre në islam.
- 04 • Sulm fisit Banu Khadham në Kutbah⁸⁰.
- 05 • Vizita e delegacioneve të fiseve Banit Salaba, Bani Suda , Bahila Beni Beni Sumala, Bani Dsharm, Ahabish, Beni Beni Ak dhe Huzail, në Medinë dhe konvertimi në islam.
- 07 • Sulm për grumbullimin e përdhunshëm të “tatimit”.
- 07 • Sulm fisit Beni Asad dhe konvertimi në islam.
- 07 • Beteja e parë detare, nën udhëheqjen e Alkama b. Muxhaziz.
- 07 • Beteja për shkatërrimin e idhujve Fuls të Banit Taj.
- 10 • Sulm fisit Banu Kilab në Dahak⁸¹.
- 10 • Sulm për shkatërrim të idhullit Al-Kullus, i komanduar nga Aliu⁸².
- 10 • Sulm fiseve Udhrah dhe Bali⁸³.
- 10 • Beteja kundër fiseve Bani Bali dhe Beni Uzra, nën udhëheqjen e Ukkashe b. Mihsan.
- 10 • Vdekja e mbretit të Abisinisë dhe lutja e Muhamedit.
- 10 • Beteja e Tebukut, ballafaqim me Bizantin⁸⁴.
- 10 • Beteja kundër udhëheqësit të Dumetulxhendel, Ukaidir b. Abdul Malik, nën udhëheqjen e Khalid b. Valid dhe përfundimi i një marrëveshjeje ndërmjet Profetit dhe Ukaidir⁸⁵.
- 10 • Vizita e delegacionit të fisit Bani Xharba, Azruh, Makna, Ayla (Akaba) dhe Tabuk dhe përfundimi i një marrëveshjeje paqeje me Muhamedin.
- 10 • Ekspedita *Dihya b. Halifa* në Tabuk të Perandorit Bizantin, Herakliut, për konvertim në islam.

⁷⁹ Kuran 49:1; Muhammad Husayn Haykal, *The Life of Muhammad*, p. 477.

⁸⁰ Sunan Abu Davud, 14:2639

⁸¹ Sad, Ibn (1967). *Kitab al-tabaqat al-kabir*, By Ibn Sad, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 202.

⁸² Po aty

⁸³ Po aty

⁸⁴ Kuran 9:29/49; 9:42-48; 9:81; Bukhari 5:59:702; 6:60:199

⁸⁵ Davut 19:3031

- Vdekja e vajzës së Muhamedit, Umm Kuldhum.
- Vizitë e delegacionit të fiseve Bani Ukail, Beni Kalb, Kilab Beni Tuxhib, Gatafan Bani Hanzala b. Malik, Bani Kuda, Bali dhe Bani Bahra në Medinë dhe kalimi në islam.
- Konvertimi i Kab b. Zuhair në islam.
- Vizita e Dimam b. Salaba e Bani Sad b. Bekri në Medinë dhe konvertimi në islam.
- Vizita e delegacionit të fisit Bani Xhuzam në Medinë dhe konvertimi në islam.
- Urdhri për betejë shkatërrimi të xhamisë rebeluese Dirar.
- Ftesa e mbretërve të Himjar dhe konvertimin i tyre në islam.
- Vizita e delegacionit nga fiset e Beni Hamdan, Bani Fazara, Beni Murraden dhe Sakif e Taifit dhe konvertimi në islam.
- Ekspedita e Ebu Sufjani dhe Mugira b. Shuba, për të shkatërruar idhullin Lat.⁸⁶
- 631 02 • Vdekja e udhëheqësit rebelues, Abdullah b. Ubej b. Salul.
- 03 • Ebu Bekri emërohet udhëheqës i pelegrinazhit.
- 03 • Aliu dërgohet në Mekë, për të shpallur ajetet e sures *El-Teube*.
- Sulm fisit Banu Kilab për shkatërrim të idhullit Vad.
- Vizita e një delegacioni të krishterëve nga Nexhranit, refuzimi, mallkimi i tyre reciprok dhe marrëveshja e tyre me Muhamedin.
- Beteja në Nexhranit, e udhëhequr nga Khalid b. Valid, ardhja e një delegacioni të fisit Beni Haris në Medinë dhe konvertimi në islam⁸⁷.
- Sulm fisit Banu Nakhla, komanduar nga Aliu, të vrarë 20 jomyslimanë⁸⁸.
- Beteja në Jemen, nën udhëheqjen e Aliut dhe konvertimi i fisit Banit Mazhixh në islam.
- Sulm në Hamdan⁸⁹
- Sulm i komanduar nga Xheriri b. Abdullah për shkatërrim të idhullit Zulhalasa.
- Muhamedi shkon për njëzet ditë në xhami; ai lexon *Kuranin* dy herë para Xhibrilit.

⁸⁶ Kuran 17:73; Muir, William (Aug. 1861), *The life of Mahomet*, Smith, Elder and co., p. 206

⁸⁷ Kuran 3:61

⁸⁸ Bukhari 2:24:573

⁸⁹ Tabari, *The last years of the Prophet*, p. 90.

- Vizitë e delegacioneve të fiseve Banit Azd Abna, Bani Taj, Bani Amir b. Sasa, Bani Kinda, Tudshib Bani, Bani, Rahavijjin, Gafik Bani Bani Mahra, Bani Hanife, Bani Ans, Murad Bani Bani Abdulkays, Bani Hilal, Bani Bani Ruha dhe Zubaida në Medina dhe konvertimi tyre në islam.
- Musailima pretendon se ai ishte një profet.
- 632 01 28 • Vdekja e Ibrahimit, djali 2-vjeçar i Muhamedit.
- 02 23 • Muhamedi niset në Haxhin lamtumirës.
- 03 07 • Fjalim lamtumirëse (khutbaVeda).
- 03 12 • Vizita e delegacionit të fisit Banit Muharib në Medinë dhe konvertimi i tyre në islam.
- 03 • Vizita e delegacioni të fisit Banit Muharib në Medinë dhe konvertimi i tyre në islam.
- Vdekja e Bazanës, guvernator i Jemenit.
- Emërimi i njëmbëdhjetë guvernatorëve të rinj nga Muhamedi.
- 03 • Zbulimi i sures *El-Nasr*.
- 04 15 • Vdekja e gruas së Muhamedit, Rajhana bint Shamun.
- Vizita e delegacionit të fundit të fisit Banit Naha në Medinë dhe konvertimi i tij në islam.
- 05 24 • Pushtimi i Palestinës / sulme moab dhe darum⁹⁰.
- 06 03 • Emërimi i Usame b. Zaid, komandant i ushtrisë në Siri.
- 06 05 • Muhamedi vuan nga dhembja e kokës dhe ethet e forta.
- Vrasja e profetit të vetëshpallur Esvedel-Ansi nga Muhamedi.
- Muhamedi vdes (e hënë).
- 06 08 • Varroset Muhamedi (e mërkurë).
- 10

⁹⁰ Gil, Moshe (1997), *A history of Palestine, 634-1099*, Cambridge University, pp. 31-32.

I. MUHAMEDI

Muhamedi ishte, pa mëdyshje, një personalitet i madh historik. Sikur të mos ekzistonte ai, e gjithë historia e njerëzimit do të kishte një rrjedhë ndryshe. (...) Edhe pse propagandistët islamikë e paraqesin atë si të pamëkat, Muhamedi vetë nuk pretendoi asnjëherë për veten e tij përsosmërinë apo pagabueshmërinë; ai ishte gjithmonë i vetëdijshëm për gabimet e veta. Prandaj bënte vetëkritikë.

Ibn Warraq⁹¹

Emri i plotë i Muhamedit është: Muhamed ibn‘Abd Allah ibn‘Abdal-Muttalib ibn Hashim ibn‘Abd Manāfal-Kurashi (محمد بن عبد الله بن عبد المطلب بن هاشم بن عبد مناف القرشي).

Për (mos)ekzistencën e Muhamedit debatohet gjithandej. Ata që e mohojnë ekzistencën e tij bazohen në mungesë të burimeve autentike historike. Legjendat e krijuara 5-6 breza pas vdekjes së tij nuk i pranojnë për burime historike. Ndërsa unë do të bazohem kryesisht në ajetionin „zyrtar“ islam për biografinë e Muhamedit, meqë idhujtaria e muhamedanëve (myslimanëve) ndaj Muhamedit është më e madhe sesa ndaj fiksionit *Allah*, i sajuar po nga Muhamedi, njëherazi edhe sajues i religjionit islam.

Muhamedi duhet të ketë lindur në Mekë më 17. 06. 569 ose më 20. 04. 571⁹², dhe duhet të ketë vdekur në Medinë, ndoshta më 8 qershor 632 (ditë e hënë).

⁹¹ Ibn Warraq, *Warum ich kein Muslim bin*, Matthes & Seitz, Berlin 2007, f. 466; Versioni elektronik në anglisht (falas): <http://www.conflicts.rem33.com/images/books/Ibn%20Warraq%20-%20Why%20I%20Am%20Not%20a%20Muslim.pdf>

⁹² <http://www.derletzteprophet.info/chronologie-der-epoche-des-propheten-mohammed-sav>

1. Jeta dhe veprimtaria

Orientalisti gjerman Rudolf Sellheimi, i cili nuk e fsheh muhamedanofilinë e tij, (dez)informon: „Për asnjërin nga themeluesit e mëdhenj fetarë orientalë nuk kemi kaq shumë të dhëna biografike, sa për Muhamedin. Shumica prej tyre janë të dhëna të përafërta me të vërtetën“⁹³.

Çështja është se si të seleksionohen këto të dhëna biografike, cilat të merren si të përafërta me të vërtetën, dhe cilat të (dis)kualifikohen si propagandë.

Autori Sellheim dhe shumë orientalistë e islamologë jomyslimanë pranojnë ajetonin zyrtar të fesë islame, edhe pse, në fakt, nuk ekzistojnë burime historike për Muhamedin, respektivisht për jetën dhe veprimtarinë e tij. Që të gjithë bazohen kryesisht në legjendat e grumbulluara e të sistemuara nga biografët e parë të Muhamedit, si Ibn Isaku [Muhammad ibn Is'hak (محمد بن إسحاق)], i cili ka jetuar gjatë viteve 704-768. Ai duhet ta ketë shkruar biografinë e parë për Muhamedin rreth 120 vjet pas vdekjes. Por as biografia e tij nuk është ruajtur. Për atë biografi dihet vetëm përmes Ibn Hisham [‘Abdal-Malik ibn His’hām ibn Ajybal-Himyarī, Aby Muhammed (عبد الملك بن هشام بن أيوب الحميري، أبو محمد)], i cili duhet të ketë vdekur në vitin 834, rreth 65 vjet pas vdekjes së Ibn Isakut. Vepra e tij është përkthyer në shumë gjuhë. Në gjermanisht vjen edhe në variantin digjital⁹⁴.

Ibn Isaku ka sajuar trungun familjar të Muhamedit, bazuar në rrëfimet e vetë Muhamedit, të transmetuara nga pasardhësit e tij. Ato të dhëna mund të jetë gjithçka, por vetëm të vërteta jo, sepse brezat nuk e mbulojnë dot gjatësinë kohore mes Muhamedit dhe Adamit (i

⁹³ Rudolf Sellheim, *Muhammed serstes Offenbarungserlebnis (Përjetimet e Muhamedit gjatë shfaqjes së parë)*. Në revistën: *Jerusalem Studies in Arabic and Islam* 10 (1987), f. 3.

⁹⁴ http://books.google.de/books?id=t6lZAAAAAMAAJ&printsec=frontcover&hl=de&source=gb_s_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false.

ISLAMI, religion agresiv (!)

arabizuar në Adem). Megjithatë, po e ofroj sa për të kënaqur kureshtjen e të interesuarve:

- Muhamed
- Abdullah
- Abd al-Muttalib
- Hashim (Paraardhës i Hashemitëve)⁹⁵
- Abd al-Manaf
- Kusaj (ringritës i Qabesë)
- Kilab
- Murrat
- Kab
- Luaj
- Ghalib
- Fihir (themelues i fisit Kurejsh)
- Malik
- Nadr
- Kinana
- Kuzaima
- Mudrika
- Iljas
- Mudar
- Nizar
- Mad
- Adnan
- Udad
- Mukavam
- Nahur
- Tairah
- Jarub
- Jashdshub
- Nabit
- Ismail (Ismael; „babai“ i arabëve)
- Abraham (Ibrahim; „babai“ i Judenjve dhe Arabëve)
- Tarih
- Nahur
- Sarugh
- Rau
- Fahlik

⁹⁵ Nga këtu e tutje janë të dhëna që historikisht nuk mund të vërtetohen.

- Aibar
- Kasir
- Shalih
- Arfahshadh
- Sam („babai“ i Semitëve)
- Noah (Nuh; mbijetues i „përmbytjes së përbotshme“)
- Lamk
- Matushalah
- Ahnuh
- Jard
- Mahlil
- Kainan
- Janish
- Shit (hebr. Set)
- Adam (Adem; „babai“ i njerëzimit)⁹⁶

Siç (dez)informon *Besëlidhja e Vjetër* (Tora), gjegjësisht sipas kalendarit izraelit, Adami duhet të jetë krijuar nga „zoti“ (Jhv / Jehovahi izraelit) më 10 tetor 3761 p. e. s. , që i bie para 5776 vjetësh. Gati 44 shekuj mes Muhamedit dhe Adamit nuk mund të mbulohen me vetëm 51 breza, të sajuar si „trung i prejardhjes“ së Muhamedit.

Rëndom demografët janë përcaktuar për 25 vjet, si një mesatare brezi (gjenerate). Po të pjesëtohen vitet që kur „është krijuar“ Adami, deri në lindjen e Muhamedit, na dalin rreth 175 breza. Por sajuesit e feve abrahamike, njerëzve të brezave para Abrahamit iu kanë dhënë jetëgjatësi shumëshekullore, për të mbuluar pasaktësitë që kanë lënë mbrapa sajuesit e atyre religjioneve...

Nga këto që u paraqiten, rezulton se kjo tabelë është sajuar për konsum propagandistik, në variant të shkruar për herë të parë nga Ibn Isaku. Qëllimi i sajuesve për këtë prejardhjeje të Muhamedit duhet të ketë qenë në shërbim „nacional“ të arabëve, për ta paraqitur atë si pasardhës të „profetëve“ Adam dhe Abraham, e cila mbartte vete edhe „të drejtën historike“ për të qenë trashëgimtar i gjithë botës. Ta zëmë, objekti i kultit pagan Kabeja (Qabeja) është uzurpuar nga

⁹⁶ <http://www.derletzteprophet.info/der-stammbaum-der-propheten-bis-mohammed-sav>

muhamedanët me „argumentim“ se e ka ngritur Adami dhe e kanë restauruar Abrahami dhe Ismaili, që të tre „myslimanë“. Kjo vlen edhe për „të drejtën historike“, për pretendime hapësinore, gjithandej nga „është sorollatur“ Abrahami e sidomos djali i tij, Ismaili.

Tjetër, të gjithë paraardhësit e Muhamedit, që nga Adami, duhet të kenë qenë myslimanë, siç dezinformohet edhe në *Kuran*.⁹⁷

Një doracak biografik, përmbledhës dhe propagandistik, kanë shkruar Aishe Guvernuer dhe Leila Azam. Këto bashkautore, amerikania Guvernuer, e konvertuar në islam, dhe islamologia Leila Azam, nuk duhet të na befasojnë me biografitë afirmative për Muhamedin, meqë janë besimtare pasionante muhamedane.⁹⁸

Këtë doracak e kemi edhe të shqipëruar,⁹⁹ prandaj do ta shfrytëzoj për të ofruar të dhëna elementare për jetën dhe veprimtarinë e Muhamedit. Po përcaktohem për këtë variant, - edhe pse ka monografi më autentike, si ajo e Ibn Is'hak,¹⁰⁰ - meqë është konceptuar si doracak për informimin e fillestarëve që nuk duan të thellohen në hulumtime. Dhe po përzgjedh autorë myslimanë, sepse autorët jomyslimanë do të paragjykoreshin si antiislamistë dhe islamofobë.

Meqë po trajtoj personalitetin, të cilin qindra milionë besimtarë e adhurojnë për profet, është e dobishme të kemi të dhëna edhe për rrethanat para lindjes së Muhamedit dhe për familjen e tij.

⁹⁷ Muhamedi "mysliman i parë": *Thuaj: "(...) më është urdhëruar që të bëhem myslimani i parë"*. [39:12]

Ibrahimi- mysliman: "Ibrahimi u rekomandoi këtë fëmijëve të tij, po edhe Jakubi: "O bijtë e mi! Perëndia me të vërtetë ka zgjedhë për ju fenë e vërtetë, dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë myslimanë!" [2:132]

Musai i pari i besimtarëve: "...E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti, dhe unë jam i pari i besimtarëve!" [7:143]

⁹⁸ <http://www.islamicbookstore.com/b7975.html>

⁹⁹ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer;
http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf

¹⁰⁰

https://ia801702.us.archive.org/25/items/TheLifeOfMohammedGuillaume/The_Life_Of_Mohammed_Guillaume.pdf

Nga Abrahami deri te Muhamedi

Meqë vetë Muhamedit ka (dez)informuar se ka paraardhës familjar Abrahamin, po sjell fragmente për Abrahamin nga doracaku i koautorëve Aisha G. dhe Leila A.:

Para afër katër mijë vjetësh, në qytetin sumer Ur, në luginën e lumit Eufrat, jetonte një djalë që quhej Ibrahim. Në fillim banorët e Urit e adhuronin Zotin, mirëpo me kalimin e kohës, ata e harruan fenë e tyre të vërtetë dhe filluan të adhurojnë idhujt e ndryshëm, skulpturat e bëra nga druri apo argjila, e disa herë edhe nga gurët e çmuar.¹⁰¹

Këto autore myslimane i besojnë (dez)informimit të profetit të tyre, Muhamedit, se njerëzimi, që kur Zoti paska krijuar çiftin e parë, Adamin dhe Evën (të arabizuar në Adem e Hava), ka qenë mysliman, por ai ka devijuar. Dhe tashmë Abrahami po i rikthehet besimit të të parëve të largët. Interesante është se vetë Zoti nuk është përkujdesur që „prodhimi“ i tij, njerëzit, të mos devijojnë, por është dashur të paraqitet një i përhumbur, me emrin Abraham (nëse vërtet ka ekzistuar, ose edhe ai është personazh vetëm legjendar, i sajuar nga ëndërrimtarët), për të mos lejuar devijimin e njerëzisë. Shkenca ende nuk ka zbuluar gjë për ekzistencën e tij.

Sipas *Torahës* (Tevratit / Besëlidhja e Vjetër), të cilin Muhamedi e njuh si libër të zbritur nga Allahu, Adamin dhe Evën Zoti i paskësh krijuar më 10 tetor 3761 p. e. s. Abrahami na qenkësh pasardhës i brezit të 20-të të Adamit. Edhe Muhamedi ka (dez)informuar pothuajse njësoj, si *Tevrati*, sa i përket krijimit të çiftit të parë, Adam dhe Eva, duke falsifikuar se ata i kishte krijuar Allahu si myslimanë të parë.

Në vazhdim po paraqes (dez)informimin vijues, të cilin këto autore, siç vetëkuptohet, e bazojnë në *Kuran*:

¹⁰¹ Po aty, f. 3.

Një ditë, kur të gjithë bashkëqytetarët gjendeshin jashtë qytetit, Ibrahim i zemëruar, me dorën e tij të djathtë i theu të gjithë bustet e idhujve, përveç njërit prej tyre, i cili ishte shumë i madh. Kur njerëzit u kthyen, ata u zemëruan shumë. Atyre iu kujtuan fjalët që Ibrahim i kishte thënë rreth idhujve. E sollën Abrahamin para të gjithëve, për t'i bërë gjyq dhe filluan ta marrin në pyetje:¹⁰²

E bërë ti këtë me zotat tanë, o Ibrahim? [21:62]

Ai u përgjigj: „Jo, atë e bëri i madhi i tyre, ju pyetini ata nëse mund të flasin?“ [21:63]

Autoret kanë ofruar vetëm dy ajetet e para. Interesante do të ishin edhe ajetet deri në përfundim të kësaj sureje, për të parë se sa përcart është rrëfyer legjenda për Abrahamin. Vetëkuptohet, është rrëfyer më ndryshe se në *Torahë*. Në ato ajete përmenden një mori „profetësh“. Fatkeqësisht, këto rrëfime janë nën nivelin e seriozitetit për t'u shfrytëzuar si burime historike. Nuk janë edhe aq letrare, për t'i shijuar si letërsi krijuese. Nga mënyra e rrëfimit, rezulton se as Allahu nuk është autor.

Abrahami, pasi duhet t'i ketë shpëtuar zjarrit, siç (dez)informohet në ajete përkatëse, provoi të bindë babanë e tij, Ezerin, që të besonte vetëm në një zot, por ai nuk e dëgjoi. Ja ajetet që i dedikohen kësaj tematike:

Përkujtoju në Libër Ibrahimin. Ai vërtet ishte shumë i drejtë dhe peygamber. [19:41]

Kur babai të vet i tha: „O babai im, pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh e as nuk ke asgjë prej tij?“ [19:42]

O babai im, mua më është dhënë nga dituria çka ty nuk të është dhënë, ndaj më dëgjo se unë të udhëzoj në rrugë të drejtë. [19:43]

O babai i im, mos adhuro djallin, sepse djalli është kundërshtar i Mëshiruesit. [19:44]

O babai i im, unë kam frikë se do të godasë ndonjë dënim prej të Gjithëmëshirshmit e do të jesh shok i djallit!“ [19:45]

¹⁰² Po aty, f. 3.

Ai (babai) tha: „A ti, Ibrahim, i refuzon zotat e mi? Nëse nuk ndalesh (së fryeri ndaj zotave të mi), unë do të të gurëzoj, ndaj largohu prej meje për një kohë të gjatë!“ [19:46]

Ai (Ibrahimi) tha: „Qofsh i lirë prej meje! Unë do ta lus Zotin tim për të falur ty, sepse ai (babai) ishte i kujdesshëm ndaj meje. [19:47]

Unë po largohem prej jush dhe prej çka adhuronit ju pos Allahut, e shpresoj se me adhurimin ndaj Zotit tim nuk do të jem i humbur!“ [19:48]

E pasi u largua prej tyre dhe prej çka adhuronin ata pos Allahut, Ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin dhe që të dy i bëmë pejgamberë. [19:49]

Autoret në vijim (dez)informojnë:

Më në fund Ibrahim, pas një rruge të gjatë, arriti në një vend pranë detit Mesdhe, jo fort larg Egjiptit. Atje u martua me një grua bujare, që quhej Sara dhe u vendosën në tokën e Palestinës. Edhe pse kishin disa vjet martesë, Ibrahim dhe e shoqja e tij nuk patën fëmijë. Me shpresë që të kenë fëmijë dhe në pajtim me traditën, Sara i sugjeroi Ibrahimit që të martohet me Haxheren, shërbëtoreshën e saj egjiptiane. Pasi u realizua kjo, Haxherja lindi një djalë që e quajtën Ismail.

Pas një kohe Allahu i premtoi Ibrahimit edhe një djalë tjetër, mirëpo kësaj radhe nëna e fëmijës ishte gruaja e parë, Sara. Djali i dytë u quajt Isak. Gjithashtu, Allahu i tha Ibrahimit se nga dy bijtë e tij, Ismaili dhe Isaku, do të krijohen dy popuj e tri fe, dhe për këtë shkak ai do të duhej ta merrte Haxheren dhe Ismailin dhe t'i çonte larg Palestinës në një tokë të re.

Këto ngjarje ishin pjesë e rëndësishme e planit të Allahut, sepse pasardhësit e Ismailit do të krijonin një popull, nga i cili do të dilte I Dërguari i madh, që do t'i udhëhiqte njerëzit drejt rrugës së Allahut. Ky ishte Muhamedi (s. a. v.), I Dërguari i Allahut. Nga pasardhësit e Isakut, djalit të tij me Sarën, erdhën Musai dhe Isai.¹⁰³

Kapitullin „Fëmijët e Ismailit“, këto autore e fillojnë si vijon:

Gjatë shumë viteve, edhe fëmijët e Ismailit patën fëmijët e tyre. Pasardhësit e tij u shtuan dhe formuan fise të shpërndara nëpër tërë Arabinë. Njëri nga këto fise ishte ai i kurejshëve. Këta njerëz asnjëherë nuk u larguan nga Meka dhe çdoherë jetonin pranë Qabesë. Një nga

¹⁰³ Po aty, f. 6.

detyrat e udhëheqësit të kurejshëve, ishte që të kujdeseshin për ata që vizitonin Qabenë, për të bërë haxhin. (...)

Me kalimin e kohës, arabët e ndërprejnë adhurimin e drejtpërdrejtë të Allahut, dhe nga vendet e ndryshme filluan sërish të sjellin idhujt e tyre. Këta idhujt ishin të vendosur në Qabe, e cila nuk konsiderohej më si shenjtore, që kishte qenë edhe vetë qëllimi i Ibrahimit. Sidoqoftë, arabët ende e respektonin atë. Gjatë kësaj kohe, burimi i Zemzemit u zhduk nëpër rërë. Në këtë kohë Kuseji, njëri nga udhëheqësit e kurejshëve, u bë sundues i Mekës. Ai mbante çelësat e fatoes dhe kishte të drejtën që t'u jepte ujë haxhilerëve, t'i ushqente ata, të drejtonte mbledhjet dhe t'i shpërndante flamujt e luftës para fillimit të betejës. Në shtëpinë e tyre vendosej edhe për çështjet e kurejshëve.

Pas vdekjes së Kusejit, udhëheqjen e kurejshëve e mori i biri, Abdulmenafit, i cili ishte bërë i njohur gjatë jetës së të atit. Pas tij erdhi i biri, Hashimi. Thuhej se Hashimi ishte i pari, i cili filloi dy udhëtimet e para me karvanë të kurejshëve: atë të verës drejt Sirisë dhe veriut; dhe atë të dimrit drejt Jemenit dhe jugut. Si pasojë e kësaj, Meka u zgjerua, u pasurua dhe u shndërrua në qendër të madhe tregtare.

Me vdekjen e Hashimit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij i mori i vëllai, El-Muttalibi. (...)

Pas vdekjes së El-Muttalibit në Jemen, ku kishte shkuar për tregti, vendin e tij e zuri Abdulmuttalibi. (...) Sido që të jetë, ai është njëri nga ata arabë, që ishin dhënë pas mësimëve të Ibrahimit.¹⁰⁴

Me konstatimin e fundit, se ai paskësh qenë ithtar i Abrahamit (mysliman), mbase këto islamologe bien ndesh me konstatimin në *Kuran*, që Muhamedi ishte myslimani i parë. Citoj:

Thuaj: (...) Dhe jam i urdhëruar të jem i pari mysliman! [39:12]

Ky konfuzion nuk është i pranishëm vetëm te këto islamologe, por edhe brenda vetë *Kuranit*, i cili përmban përcaktimi, si në ajetin 39:12, por edhe në të tjerat, që e paraqesin Abrahamin, por edhe Moisiun (Musain), si myslimanë të parë.

¹⁰⁴ Po aty, f. 9.

Ja ajeti për Ibrahimin:

E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), edhe Jakubi. (U thanë): „O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë!” [2:132]

Ja ajeti për Moisiun (Musanë):

...E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti, dhe unë jam i pari i besimtarëve!
[7:143]

Por ta lëmë këtë konfuzion, për t'iu kthyer sërish tematikës.

Autoret paraqesin një legjendë, sikur Abdulmuttalibi kishte ëndërruar se për Zotin duhet të sakrifikonte njërin nga dhjetë djemtë e tij. Shorti i bie Abdullahut (babait të Muhamedit). Sërish edhe një rast kriminal, pas atij të Abrahamit. Baballarët ëndërrojnë se duhet t'i sakrifikojnë djemtë e tyre për Zotin dhe vendosin të therin njërin prej djemve. Pra, nuk ëndërrojnë të therin veten e tyre, ose nuk i rezistojnë ëndërrës (nëse vërtet kanë ëndërruar), për të mos therur djemtë. Dhe Abdullahu shpëtoi nga një plakë që bënte profeci...

Abdullahu u rrit dhe u bë një i ri i pashëm. I ati i zgjodhi për grua Eminen, të bijën e Vehbit. Kjo qe një zgjedhje e mirë, sepse ajo ishte më e mira nga vajzat e kurejshëve, ndërkaq Abdullahu ishte më i miri nga të gjithë djemtë. Ai kaloi disa muaj me të, mirëpo më vonë u detyrua ta lërë vetëm, pasi me njërin nga karvanët shkoi në Siri. Duke u kthyer nga Siria për në Mekë, Abdullahu u sëmur dhe u ndal në Jethrib (siç quhej atëherë Medina - sqarim imi), me qëllim që të shërohej. Karvani e vazhdoi rrugën drejt Mekës. Me të dëgjuar për sëmurdjen e të birit, Abdulmuttalibi dërgoi djalin tjetër, E- Harithin, që ta sjellë Abdullahun në Mekë, mirëpo qe tepër vonë. Kur arriti ai në Jethrib, Abdullahu kishte vdekur. Emineja mbeti me zemër të thyer për humbjen e burrit të saj dhe të babait të fëmijës, që duhet të lindte së shpejti. Vetëm Allahu e dinte se ky fëmijë jetim një ditë do të bëhej I Dërguari i madh. ¹⁰⁵

Fjalja e fundit dëshmon për tifozerinë e autoreve, që do të thotë se nuk kemi të bëjmë me biografi të mirëfilltë historike.

¹⁰⁵ Po aty, f. 12.

2. Lindja dhe rritja e Muhamedit

Këtë kapitull bashkautorët Aisha G. dhe Leila A. e fillojnë me (dez)informim të legjendarizuar:

Një ditë, duke udhëtuar për në veri, njerëz nga fiset arabe të Mekës në shkretëtirë takuan një murg (eremit). Disa nga njerëzit u ndalën që të flasin me të. Murgjit njiheshin si njerëz të mençur e të urtë dhe arabët shpesh i pyetnin për këshilla. Murgu i pyeti prej nga vinin. Kur ata iu përgjigjën se janë nga Meka, ai u tha se Allahu së shpejti do t'u dërgojë një Të Dërguar, i cili do të rridhte nga njerëzit e tyre. Ata e pyetën për emrin e këtij Të Dërguari, ndërsa murgu u përgjigj se emri i tij do të jetë Muhamed dhe se ai do t'i udhëheqë ata drejt një rruge të re të jetës.¹⁰⁶

Përgjithësisht, në *Kuran*, por edhe në shkrime të tjera islame, myslimanëve të kompleksuar qysh nga „myslimani i parë“, Muhamedi, u duhej legjitimiteti nga paralajmërimet e priftërinjve e të murgjve, nga „librat e shenjtë“ të hebrenjve dhe kristianëve, për lindjen e „të dërguarit“ (Muhamedit). Pra, meqë e dinin se nuk është i tillë Muhamedi, u duheshin, atëherë e tani, „prova“, sidomos nga kundërshtarët fetarë, për të bindur besimtarët muhamedanë se vërtet Muhamedi është „I Dërguari i Allahut“. Shtrohet pyetja: *Nga e dinte ai murg që do të lindte I Dërguari i Zotit?* Mos ndoshta Allahu kishte biseduar me atë murg dhe e paskësh paralajmëruar për lindjen e „profetit“, madje edhe për emër konkret?!

Edhe një legjendë e radhës nga këto autore myslimane:

Të hënën, ditën e dymbëdhjetë të Rebi-ul Euelit të Vitit të Elefantit, Emineja lindi djalë. Allahu u dërgoi njerëzve shumë shenja kur lindi njëri nga të Dërguarit e Tij të zgjedhur. Edhe në atë ditë të dymbëdhjetë të Rebi-ul Euelit, në vitin 570, ishin vërejtur shumë shenja të tilla. Disa ishin vërejtur nga dijetarët hebraikë, të cilët nëpër librat e tyre kishin lexuar për ardhjen e të Dërguarit. Për shembull, njëri nga këta njerëz të

¹⁰⁶ Po aty, f. 15.

mësuar në Jethrib, vërejtë një yll të bukur e të shkëlqyeshëm, që nuk e kishte parë kurrë më parë, ndërkohë që studionte natën qiellin. Ai i ftoi njerëzit rreth tij dhe duke u rrëfyer për yllin dhe u tha se sigurisht kishte lindur një I Dërguar.*

Në të njëjtën natë, një tjetër hebre ishte duke kaluar pranë vendbanimit të udhëheqësve kurejshë në Mekë. Ai pyeti se mos vallë në atë çast kishte lindur ndonjë djalë dhe nëse kjo është e vërtetë, atëherë ky do të jetë I Dërguari i kombit arab.¹⁰⁷

Sërish „argumente“, që e kanë autorësinë e dijetarëve hebraikë:

Lajmet për lindjen e djalit, Emineja ia dërgoi Abdulmuttalibit, i cili në atë kohë ishte ulur në afërsi të Qabesë. Ai u gëzua shumë dhe menjëherë filloi të mendojë për emrin e djalit. Një emër i rëndomtë nuk do t'i përgjigjej. Shkuan ditë të tëra dhe ai akoma nuk kishte vendosur. Mirëpo ditën e shtatë, pasi ishte shtrirë pranë Qabesë dhe e kishte zënë gjumi, Abdulmuttalibi ëndërroi se fëmijës do të duhej t'i jepej emri i pazakonshëm Muhamed, pikërisht ashtu siç kishte ëndërruar edhe Emineja vetë. Dhe kështu fëmija u quajt Muhamed (s. a. v.), që do të thotë „I Lavdëruar“.¹⁰⁸

Këto fragmente mund të (keq)kuptohen sikur arabët janë ëndërrimtarë, që udhëhiqen nga ëndërrimet dhe jo nga arsyeja racionale...

Edhe një legjendë e ngjashme, injorante:

As Halimeja nuk dëshironte ta merrte Muhamedin e sapolindur, mirëpo nuk ishte e vetmja nga gratë e fisit të vet, e cila do të kthehej pa fëmijë. Ajo e pyeti burrin e vet se a mund ta merrte Muhamedin (s. a. v.) apo jo. Ai e këshilloi që ta bënte këtë dhe shtoi: „Ndoshta për këtë Allahu do të na bekojë“. Ata u nisën të kthehen prapë, dhe kur Halimeja filloi ta ushqejë Muhamedin (s. a. v.) asaj papritmas iu shtua qumështi, sa që tani mjaftonte si për atë, edhe për foshnjën e saj. Kur u kthyen në shtëpi çdo gjë filloi të ndërrohet. Toka u gjelbërua, kurse hurmat, që ishin ndër burimet kryesore të ushqimit, dhanë shumë fryte. Madje edhe delet e

* Emri i Medinës para islamizimit.

¹⁰⁷ JETA E PROFETIT MUHAMED, Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 15.

¹⁰⁸ Po aty.

deveja e tyre plakë filluan të japin gjithnjë e më shumë qumësht. Halimeja dhe i shoqi i saj e dinin se ky fat i mire erdhi ngaqë ata e kishin fëmijën e vogël, Muhamedin (s. a. v.), të cilin e donin sikur ta kishin birin e tyre.

Kur Muhamedi (s. a. v.) ishte dy vjeç, Halimeja e ktheu prapë tek e ëma e tij. Ajo iu drejtua Eminesë, që ta lejonte ta mbante edhe më gjatë dhe, për habi të madhe të saj, e ëma ra dakord.

Gjatë kohës, të cilën e kaloi në shkretëtirë me familjen e Halimesë, Muhamedi (s. a. v.) luante me fëmijët e saj dhe së bashku i kullosnin delet. Ndërkaq, kishte raste kur Halimeja e gjente shpesh atë teksa rrinte ulur dhe i vetmuar.

Thuhet se në një rast, te Muhamedi (s. a. v.) erdhën dy engjëj dhe ia shpëlanë zemrën me borë. Në këtë mënyrë Allahu ia bëri zemrën të pastër, sepse Ai kishte për qëllim që Muhamedi (s. a. v.) të ishte më i madhi nga të gjithë njerëzit dhe të bëhej më i Larti i të Dërguarve.¹⁰⁹

Paraprakisht shpjegohej se Halimeja ishte një grua e varfër, prandaj merrte një fëmijë për t'u kujdesur, duke qenë se paguhej. Ajo kishte një fëmijë të vogël, që nuk po e ngopte dot me qumësht, për shkak të urisë që i kishte kapluar. Por ja, tani, sapo mori Muhamedin, iu shtua qumështi...

Të tilla sajimeve e legjendave mund t'u besojnë vetëm ata, muhamedanët. Pse Zoti nuk u përkujdes që „profeti“ të mos mbetej nën mëshirën e varfanjakëve të tjerë?! Bashkautorët janë të mendimit se kësaj mirësie të Halimesë i është dedikuar surja 94, e cila ka vetëm tetë ajete të shkurtra (që nuk ia vlen të citohen).

Kur më në fund Halimeja ia ktheu Muhamedin (s. a. v.) prapë Eminesë, ai ishte bërë një djalë i shëndoshë e i fuqishëm. Ai, me një kënaqësi të madhe, do ta kujtonte kohën e kaluar me Halimenë dhe çdoherë do ta konsideronte veten si njërin prej Beni Sadëve.¹¹⁰

¹⁰⁹ Po aty, f. 17

¹¹⁰ Po aty, f. 18.

Kështu e përmbyllin këtë kapitull këto bashkautore, duke mos na informuar se cilin besim fetar praktikonte kjo familje. Rëndom, autorët myslimanë sikur e kanë siklet të informojnë se Muhamedi po rritej në besimin pagan (politeist), si gjithë fisi i tij Kurejsh.

Kapitullin e ri këto autore e nisin:

Në moshën trevjeçare Muhamedi (s. a. v.) u kthye në Mekë, që të jetonte me të ëmën. Tre vjet më vonë Emineja vendosi që ta marrë të birin për të vizituar dajat e tij në Jethrib. Ajo i tha shërbëtores së vet, Berekesë, që të përgatisë çdo gjë të nevojshme për një udhëtim të gjatë e pastaj iu bashkëngjiti njërit prej karvanëve që ishin nisur për atje. Ata qëndruan në Jethrib afër një muaj, ndërsa Muhamedi (s. a. v.) u gëzua shumë që i vizitoi dajat. Atje klima ishte shumë e përshtatshme, kurse ai u mësua të notonte dhe të fluturonte fluturaket. Mirëpo, duke u kthyer prapë në Mekë, Emineja sëmuret dhe vdes. Ajo varroset në fshatin El Ebue, jo fort larg Jethribit. I pikëlluar, Muhamedi (s. a. v.) së bashku me shërbëtoren e së ëmës kthehet në Mekë. Tani ai ishte vetëm gjashtë vjeç dhe kishte humbur të dy prindërit. Atë e mori gjyshi i tij, Abdulmuttalibi, i cili e donte shumë, ndaj çdoherë e përkrahte. Pas dy vjetësh Abdulmuttalibi u sëmur, ndërkaq Muhamedi (s. a. v.) tërë kohën qëndroi pranë tij. Abdulmuttalibi i tha të birit, Ebu Talibit, që pas vdekjes së tij të kujdesej për Muhamedin (s. a. v.), gjë të cilën ai e bëri.

Ebu Talibi kishte shumë fëmijë, mirëpo Muhamedi (s. a. v.) menjëherë u bë pjesë e familjes së tij dhe fëmija më i dashur. Erdhi koha që kurejshët të përgatisin karvanin e tyre për të shkuar në Siri. Me ta do të shkonte edhe Ebu Talibi, i cili mori me vete edhe Muhamedin (s. a. v.). Ky qe udhëtimi i parë i Muhamedit (s. a. v.) për në veri. Pas disa ditësh udhëtimi, karvani arriti deri në një vend afër Sirisë, i njohur për tregtinë që romakët bënin me arabët. Afër këtij tregu jetonte një murg i quajtur Behira. Selia e tij ishte shfrytëzuar nga gjeneratat e murgjve para tij dhe përmbante shumë dorëshkrime të lashta. Behira e pa karvanin nga larg dhe u habit kur pa se mbi të qëndronte një re e bardhë. Ajo ishte reja e vetme në qiellin e kthjellët e të kaltër dhe ishte shfaqur, me qëllim që t'u bënte hije udhëtarëve. Murgu u befasua edhe më tepër kur vërejti se reja që ndiqte karvanin, çdoherë zhdukej kur njeriu, të cilit ajo i bënte hije, ulej nën hijen e ndonjë druri. Nga shkrimet e vjetra, Behira e dinte se pas

Isaita. s., pritej të vinte një i dërguar dhe dëshira e tij ishte që ta shihte këtë të Dërguar para se të vdiste. Kur e kuptoi se e tërë kjo që ndodhi para pak çastesh ishte një mrekulli, ai filloi të mendojë se, më në fund, dëshira e tij po plotësohej. Murgu i ftoi mekasit që të vinin dhe të hanin me të. Arabët u befasuan, ngaqë ata shpesh i kishin kaluar pranë, mirëpo Behira nuk i kishte ftuar asnjëherë. Kur u mblodhën për të ngrënë, murgu pyeti: „A jeni të gjithë?“ „Jo!“, - u përgjigj dikush. „Një djalë mbeti që të ruajë devetë“. Behira nguli këmbë që edhe djali të bashkohej me ta. Ai djalë ishte Muhamedi (s. a. v.). Kur arriti ai, Behira nuk tha asgjë, por gjatë tërë kohës së drekës, vetëm e shikonte. Ai vërejti shumë gjëra, të cilat cekeshin edhe në dorëshkrimet e vjetra lidhur me paraqitjen e tij. Pastaj e tërhoqi Muhamedin (s. a. v.) mënjanë dhe i bëri shumë pyetje. Së shpejti kuptoi se çfarë ndiente ai rreth idhujve të Qabesë. Kur Behira u përpoq ta binde që të betohet mbi to, ashtu siç bënin edhe arabët e tjerë, Muhamedi (s. a. v.) i tha: „Nuk ka gjë në botë, të cilën e urrej më tepër“. Ata biseduan së bashku për Allahun dhe rreth jetës dhe familjes së Muhamedit (s. a. v.). Nga e tërë ajo që u tha, Behira u bind se ai, me të vërtetë, ishte I Dërguar që vjen pas Isait. Pastaj murgu shkoi tek Ebu Talibi dhe e pyeti se ç’ë kishte Muhamedin (s. a. v.). Ebu Talibi iu përgjigj se Muhamedi (s. a. v.) ishte biri i tij. Behira ia ktheu se nuk mund të jetë kështu, se fëmija ishte i paracaktuar të jetonte si jetim, dhe pastaj e urdhëroi që ta ruante Muhamedin (s. a. v.) dhe të kujdesej mirë për të.¹¹¹

Sërish duhej një murg çifut si „argument“, për të dëshmuar se Muhamedi ishte „I Dërguari“ i Zotit, edhe pse vetë ai këtë ende nuk po e dinte. Pra, sërish spekulim me „dorëshkrimet e vjetra“, të cilat paskëshin paralajmëruar „profetin“ Muhamed. Asnjë citim konkret. Krejtësisht mjegullnajë mistike e profecira. Të bën të qeshësh fakti kur lexon, se pikërisht murgu hebre na qenkësh merakosur për mbarëvajtjen e rritjes dhe ruajtjes së Muhamedit, meqë i bie sikur e paskësh dëshiruar të sajohet edhe në një fe konkurruese, e cila do t’i urrente, denigronte e luftonte për vdekje sidomos hebrenjtë. Broçkulla të palogjikshme!

¹¹¹ Po aty, f. 19.

Martesa e parë e Muhamedit

Njëra nga tematikat më intriguese janë martesat e Muhamedit. Martesa e parë mbase duhet të ketë qenë shkas për gjithë rrjedhat e mëvonshme. Këto bashkautore kanë ofruar propagandë folklorike. (Dez)informatat e tyre janë argëtuese:

Në moshën njëzetepesëvjeçare Muhamedi (s. a. v.) u bë i famshëm për bujarinë e tij. Ishte i respektuar nga çdokush, saqë çmohej edhe nga vetë pleqtë e Mekës. (...) Ai besonte në një Zot - Krijues të botës - dhe e adhuronte atë me tërë zemrën dhe shpirtin e tij. (...) Ai kaloi shumë orë të qeta në shpellën e malit Hira, jo fort larg Mekës, duke menduar për Allahun xh. sh.¹¹²

Muhamedi vetvetiu zuri të besonte në një Zot, apo e kishin frymëzuar misionarët hebrenj e kristianë? Në shpellën e malit Hira nuk shkonte vetëm Muhamedi, por edhe shumë të rinj paganë. Shkuarja në atë shpellë, për të medituar e agjëruar, ishte pjesë e rriteve të tyre pagane. Por, edhe pse shkonte në atë shpellë, Muhamedi ende nuk kishte ëndërruar, sikundër nuk kishte filluar „t’i zbriste“ ndonjë porosi nga Allahu. Atëherë, si paskësh besuar në një Allah, që ende nuk e kishte sajuar?! Çfarë, në fakt, e dërgonte Muhamedin në atë shpellë? Këto dy autore propaganduese thonë se shkonte për të menduar për Allahun. E pamundur! Askush nuk ka ofruar asnjë (dez)informim, se ai, para vitit 610, kur u bë dyzetvjeçar, ishte shpreh ose kishte praktikuar fe të re monoteiste. Ai ende po vazhdonte të praktikonte ritin pagan.

Këtë e dëshmon edhe ajeti kuranor:

Thuaj: „Sikur të kishte dashur Perëndia, unë nuk do t’jua mësoja dhe as që do të bënte Ai që ta mësoni ju atë. Unë kam jetuar një kohë në mesin tuaj - para Pejgamberllëkut, a nuk po mendoni?“ [10:16]

¹¹² Po aty, f. 22

Nga interpretimi konkretizues rezulton se Muhamedi, para se të gradohej „profet“, në vitin 610, ishte dikush që jetonte në mesin e besimtarëve paganë, rronte e besonte si ata.

Hatixheja, e lutur nga Ebu Talib (xhaxhai i Muhamedit dhe babai i Aliut, kalifit të 4-rt, njëherazi edhe dhëndër i Muhamedit), e ka angazhuar si skllav kushëririn e vet, Muhamedin. Më vonë ndodhi martesë mes Muhamedit 21-vjeçar, dhe Hatixhesë, rreth 45-vjeçare. Kjo nuk duhet të ketë qenë martesë mes të barabartëve, as mes të dashuruarve. Hatixheja e bleu varfanjakun Muhamed si skllav. Por, si duhet ta ketë përjetuar Muhamedi pabarazinë e madhe ekonomike dhe diferencën në moshë ndërmjet tij dhe Hatixhesë? Mbase pikërisht për shkak të pozicionit në atë martesë, ai ikte nga shtëpia dhe shkonte në atë shpellë, ku duhet ta ketë ekuilibruar dëshpërimin me një grua, që në të njëjtën kohë ishin edhe pronarja, edhe tutorja e tij. Në atë kohë, nuk njiheshin punësime me ndonjë të drejtë sociale për të punësuar, ata ishin vetëm skllavë. Dhe pas rreth 15 vjetësh martesë, Muhamedit i ndodhi „mrekullia“ e ëndërrimit në shpellën e malit Hira, më 01.02.610.

(Dez)informata e radhës:

Ata u bekuan me gjashtë fëmijë, dy djem dhe katër vajza. Fëmija i tyre i parë, djali me emrin Kasim, vdiq shpejt, pas ditëlindjes së tij të dytë, ndërkaq fëmija i fundit, që gjithashtu ishte djalë, jetoi vetëm pak kohë. Për fat të mirë, katër vajzat e tyre, Zejnebja, Rukija, Kult'humu dhe Fatimeja, jetuan që të gjitha.¹¹³

Dyshimet e para mund të jenë këto: një grua aq e moshuar, a mund të lindë gjashtë fëmijë?! Pastaj, pse duhej t'i vdisnin dy djemtë „të dërguarit“ të Allahut, edhe pse ai duhet të jetë lutur shumë që t'i rronin për të pasur trashëgimtarë? Ose ndoshta Zoti ende nuk e dinte se Muhamedi do të bëhej „I Dërguari“ i tij, edhe pse tashmë e dinin një mori murgjish?!

¹¹³ Po aty, f. 23.

Kapitulli i ri i këtij libri biografik titullohet „Ardhja e engjëllit Xhibril“, që do të thotë *kthesa e madhe*. Ja çfarë (dez)informojnë këto autore:

Në moshën dyzetvjeçare Muhamedi (s. a. v.) e kaloi Ramadanin, muajin e agjërimit në shpellën Hira. Në gjysmën e dytë të Ramadanit, Allahu filloi që, nëpërmjet Muhamedit (s. a. v.) t'i zbulonte njerëzimit porosinë e Tij. Shpallja e parë ndodhi si vijon: Meleku Xhibril erdhi në shpellë te Muhamedi dhe e urdhëroi: „Lexo!“. Muhamedi (s. a. v.) u përgjigj: „Unë nuk di të lexoj“. Në këtë çast meleku e mori Muhamedin (s. a. v.) në duart e veta dhe e shtrëngoi shumë. Pastaj e lëshoi atë dhe përsëri e urdhëroi: „Lexo!“. „Nuk mundem“, - u përgjigj Muhamedi (s. a. v.) e pas kësaj meleku e përqafoi. Për të tretën herë meleku e urdhëroi Muhamedin (s. a. v.) që të lexojë, mirëpo ai sërish tha se nuk lexon dot dhe përsëri e përqafoi. Sidoqoftë, duke e lëshuar, këtë herë jeleku Xhibril i tha:

*Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili [96:1]
krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. [96:2]
Lexo për Zotin tënd Bujar! [96:3]
Është Ai që ua mësoi pendën. [96:4]
Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte. [96:5]*

Muhamedi (s. a. v.) i përsëriti këto ajete ashtu siç i kishte thënë meleku. Kur meleku u sigurua se Muhamedi (s. a. v.) i mësoi këto përmendsh, atëherë u largua.

Tani kur mbeti vetëm, Muhamedi (s. a. v.) nuk mund të kuptonte se çfarë kishte ndodhur me të. Ai ishte i frikësuar dhe menjëherë nxitoi jashtë shpellës. Ndoshta shpella ishte e magjepsur? Ndoshta shejtani (djalli) kishte zënë vend në mendjen e tij?

Mirëpo, atë e ndaloi një zë, i cili erdhi nga qielli dhe i tha: „O Muhamed (s. a. v.), ti je I Dërguari i Allahut dhe unë jam Xhibrili“. Ai e ngriti kokën lart, nga qielli, dhe ngado që kthehej, shihte jelekun Xhibril.¹¹⁴

Me këtë rast, autoret nuk kanë informuar, siç kemi informime konkrete në një hadith përkatës, por kjo tematikë do të trajtohet më

¹¹⁴ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 25;
http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf

konkretisht në kapitullin, ku do të shtjellohen mënyra e „zbritjes“ së *Kuranit* dhe autorësia e tij.

Këtu është interesante të bëhet vërejtja lidhur me muajin Ramadan, si muaji i agjërimit. Ai muaj paskësh ekzistuar edhe para se Muhamedi të shpallej „i dërguar“ i Allahut. Kjo do të thotë se muaji Ramadan paska ekzistuar para se të niste „zbritja“ e dogmës së islamit (Kurani) dhe para se Muhamedi të shpallej myslimani i parë?! Pastaj mungon informimi konkret: kishte ëndërruar Muhamedi vërtet, apo atij i kishte shkuar Xhibrili në shpellë?!

Në hadithin përkatës (dez)informohet se Muhamedi kishte qenë në gjumë dhe se e kishte ëndërruar Xhibrilin. Nëse nuk ishte ëndërrim, siç është rrëfyer këtu, çfarë i ka ofruar Xhibrili Muhamedit për të lexuar, dhe pse duhej ta urdhëronte dhe ta shtrëngonte deri në ngufatje?!

Edhe përmbajtja e kësaj sureje (Al-Alak, 96) do të komentohet në kapitullin për autorësinë e *Kuranit*. Citim nga biografia e këtyre dy propagandistëve të Muhamedit:

Në gjendje të hutuar, ai u kthye në shtëpi, te Hatixheja, gruaja e tij. Kur ajo e pa se dridhej, sikur të kishte ethe, u bregos shumë. Ai e luti që ta mbulonte me batanije, gjë të cilën ajo e bëri menjëherë. Pas një kohe u qetësua dhe tregoi se çfarë i kishte ngjarë në shpellën e malit Hira. Hatixheja i besoi çdo gjë që tha dhe me një respekt të madh i tha: „Lumturohu, o djali i xhaxhait tim dhe bëhu i besueshëm! Unë me të vërtetë betohem në Allahun, i cili ka në duart e Tij shpirtin tim, se ti do të jesh I Dërguari i njerëzve tanë“. Muhamedi (s. a. v.), I Dërguari i Allahut, u qetësua nga besimi që ajo kishte tek ai, mirëpo pas gjithë atyre që kishin ndodhur, e ndiente veten tepër të lodhur dhe e zuri gjumi menjëherë.¹¹⁵

Këtu duhet të bëhet pyetja: mbase bashkautorët nuk kanë qenë të sakta, meqë është i vetmi rast ku thuhet se Hatixheja, gruaja e Muhamedit, i drejtohet atij me „o djalë i xhaxhait tim“ dhe, pyetja tjetër, si

¹¹⁵ Po aty, f. 26

qe e mundur që ajo, mbesa e një misionari kristian, menjëherë besoi se Muhamedi është „I Dërguari“ i Allahut? Pra, ishin apo nuk ishin Muhamedi dhe Hatixhja, fëmijë xhaxhallarësh? Fragmenti i radhës:

Hatixheja e la të Dërguarin (s. a. v.) duke fjetur dhe shkoi të takojë kushëririn e saj, Varaka ibn Neufelin, për ta pyetur se çfarë mendonte rreth asaj që kishte ndodhur. Varaka ishte një njeri shumë i urtë, i cili kishte lexuar mjaft libra, ndërsa pas leximit të Ungjillit, ishte konvertuar në të krishterë. Ai i tha Hatixhesë se Muhamedi (s. a. v.) kishte qenë i zgjedhur nga Allahu që të jetë I Dërguari i tij. Ashtu sikundër edhe më parë, kur meleku Xhibril kishte ardhur te Musai dhe e kishte urdhëruar që ta udhëhiqte popullin e vet, ashtu edhe Muhamedi (s. a. v.) do të bëhet Pejgamber i njerëzve të tij. Mirëpo Varaka paralajmëroi se Të Dërguarin nuk do ta dëgjojnë të gjithë njerëzit, ndërsa disa nuk do t'i shihnin me sy të mirë ithtarët e tij. Sido që të jetë, ai duhet të jetë i durueshëm, sepse ka një porosi të madhe për tërë botën.*

Prej asaj dite, meleku Xhibril vinte shpesh tek I Dërguari (s. a. v.), kurse ajetet që ai i thoshte se ishin porositi e Allahut drejtuar njeriut, më vonë filluan të shkruhen dhe tashmë njihen si Kurani i Shenjtë.¹¹⁶

Është interesant fakti, si po na del në skenë një personalitet, siç duhet të ketë qenë Varaka, xhaxha i Hatixhesë, i konvertuar në të krishterë, i angazhuar si misionar për propagandimin e Ungjillit?! Hatixheja shkoi të konsultohet pikërisht me atë misionar të krishterë (në një hadithe përkatëse thuhet se kanë shkuar bashkë me Muhamedin). Ky misionar (dez)informon se Muhamedi është „i dërguar“ i Zotit dhe se ky lloj mandatimi, paskësh qenë i njëjlojtë me mandatimin e Moisiut. Edhe Varaka, njëri nga shumë misionarët e krishterë, paska qenë i sigurt se Muhamedi ishte mandatuar nga Zoti, edhe pse vetë Muhamedi po dyshonte në mos kishte qenë vetëm një ëndërr e trishtë. Pra, vërtet i ka informuar paraprakisht Zoti ata

* Varaka ibn Naufal ib n Asadibn 'Abdal-'Uzzā ibn al-Kusajj Kurashi (ورقه بن نوفل بن أسد بن عبد العزى بن قصي القرشي); http://www.eslam.de/begriffe/w/waraka_ibn_naufal.htm

¹¹⁶ Po aty, f. 26.

misionarë jomyslimanë për mandatin të Muhamedit, para se ta informonte Muhamedin?! Duket sikur është një lloj taktizimi skandaloz, të cilin e kanë sajuar vetë Muhamedi dhe njerëzit e tij. Ata duhet të kenë menduar, se kështu do t'i mashtronin më bindshëm njerëzit, se vërtet Muhamedi është mandatuara nga Zoti si „i dërguar“ i tij, duke shpërdoruar edhe të tilla „argumentime“, që po ofronin murgj e misionarë hebrej e të krishterë. Duket sikur murgj e misionarë të tillë iu dukeshin më të besueshëm, ndaj edhe më influencues!

Na rezulton që mashtrimi për mandatin e Muhamedit nga Zoti për „të dërguarin“ e tij, muhamedanët e kanë kopjuar nga legjenda që i dedikohej mandatimit të Moisiut. Edhe legjenda e mbarësimit të Marisë nga Zoti, për të lindur Jezusin, duhet të ketë qenë e kopjuar nga (dez)informimi i Olimpisë epirote, Nënës së Lekës së Madh. Ajo duhet të ketë (dez)informuar për lindjen e Aleksandrit (tetor 356 p. e. s.), se ishte mbarësuar me zotin Zeusin Amon...¹¹⁷

Po paraqes hadithin, i cili përmban (dez)informimin e Muhamedit, se si i „zbrisnin“ ajetet:

Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, ky nga Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i tij, ky nga Aishe hr. a. , e cila transmeton se Harith b. Hishamir. a. e ka pyetur Pejgamberin s. a. v. s.: „O Resulullah, si të vjen ty Shpallja (Vahji)?“ Pejgamberi s. a. v. s. i qe përgjigjur: „Herë-herë më vjen si tingujt e ziles. Kjo për mua është mënyra më e vështirë e Shpalljes, e më ndërpritet pasi ta kem mbajtur në mend atë që më është thënë. Dhe, herë-herë meleku (Xhibril) më paraqitet në formë njeriu. Ai më flet dhe unë e mbaj në mend atë që më thotë. „ Aishe hr. a. është shprehur kështu: „E kam parë atë (Pejgamberin s. a. v.

¹¹⁷ Arthur Weigall (1830-1934), *Alexander The Great* (ISBN 9989-920-86-9); <http://www.amazon.de/Alexander-Great-Arthur-Weigall/dp/B00007GTZO>
Varianti i shqipëruar, f. 29.

s.) duke i zbritur atij Shpallja në ditët shumë të frohta dhe kur i ndërpritej (Shpallja), vërtet, ballin ende e kishte qullë me djersë“.¹¹⁸

Broçkulla pa shije, që nuk të bëjnë as të qeshësh!

Për një kohe Shpallja u ndërpre. I Dërguari (s. a. v.) ishte i shqetësuar dhe i pikëlluar duke menduar se Allahu xh. sh. e ka lënë ose ndoshta ai në njëfarë mënyrë e ka zemëruar Allahun, kështu që Allahu nuk e konsideron më të denjë për Shpalljen e Tij. Mirëpo meleku Xhibril përsëri erdhi tek ai dhe i solli suren apo kaptinën e Kuranit:¹¹⁹

Pasha paraditen! [93:1]

Pasha natën kur shtrin errësirën! [93:2]

Zoti yt nuk të ka lënë, as nuk të ka përbuzur. [93:3]

Dhe se bota e ardhshme është shumë më e mirë për ty se e para. [93:4]

E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh. [93:5]

A nuk të gjeti ty jetim, e Ai të bëri vend (të dha përkrahje). [93:6]

Dhe të gjeti të paudhëzuar e Ai të udhëzoi. [93:7]

Dhe të gjeti të varfër, e Ai të begatoi. [93:8]

Pra, mos e përul jetimin! [93:9]

As lypësin mos e përzë! [93:10]

E me të mirat që t'i dha Zoti yt, trego (udhëzo njerëz)! [93:11 /shq. Sherif Ahmeti]

Sipas këtyre dy autoreve, kjo ishte surja e dytë që duhet t'i jetë rrëfyer Muhamedit nga engjëlli Xhibril, e cila gjatë „redaktimit“ të *Kuranit* është vendosur nën nr. 93 të sureve (kapitujve). Kjo dilemë e Muhamedit ishte njerëzore për njeriun e kësaj bote, sepse ai kishte ëndërruar në shpellën e malit Hira dhe, tashmë, ishte në dilemë, nëse ishte ose jo „I Dërguari“ i Zotit. Dikush duhet ta ketë këshilluar që të fillonte me aktrimin e rolit të „të dërguarit“, prandaj ishte sajuar kjo sure përkatëse, e cila reflekton dilemën e Muhamedit dhe vendosjen e tij, më në fund, për t'iu përkushtuar misionit për krijim të një religjioni të ri.

¹¹⁸ Buhari, Libri I, nr. 3, cituar sipas:

http://www.kuranifisnik.net/Kurani_Fisnik/Download/UploadedFiles/2007.9.30%20-%2044%20Sahihul-Buhari-1.htm

¹¹⁹ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 27.

Por shumë studiues të tjerë suren *Al-Muddathir* (e radhitur nga „redaktorët“ e mëvonshëm nën numrin 74), e radhisin si sure të dytë, meqë fillon me ajetet:

O ti i mbuluar! [74:1]

Ngrihu dhe tërhiq vërejtjen. [74:2]

Dhe madhëroje Zotin tënd! [74:3]

Dhe rrobat tua pastroji! [74:4]

Këto ajete përshkruajnë gjendjen fizike dhe shpirtërore të Muhamedit, të sapokthyer nga shpella, i mbuluar me batanije nga gruaja e tij, Hatixheja, për t'i kaluar frika nga ëndërrimi në shpellë. Ai, siç mund të merret me mend, duhet të ketë qenë me rroba të ndyra, si të të sëmurëve psikikë, të cilët ngujohen në shpella të errëta për meditim...

Bashkautorët na (dez)informojnë për rrjedhën e jetës familjare:

I Dërguari (s. a. v.) filloi t'u flasë fshehurazi për lajmin e Allahut atyre që i kishte të afërt dhe të cilëve mund t'u besonte. Asokohe Meka po kalonte nëpër vështirësi të mëdha. Ndihej mungesa e madhe e ushqimit. Xhaxhai i të Dërguarit, Ebu Talibi, i cili pas vdekjes së gjyshit ishte kujdesur për Muhamedin, pa se e kishte shumë të vështirë të ushqente familjen e tij të madhe. I Dërguari (s. a. v.) i tha se ai dhe xhaxhai tjetër Abasi, i cili ishte njeri i pasur, në vend të ndihmës së tyre, do të rrisnin nga një fëmijë të Ebu Talibit. I Dërguari (s. a. v.) mori Aliun, ndërsa xhaxhai i tij mori Xhaferin.¹²⁰

Po rezulton se Muhamedi e kishte djalë xhaxhai Aliun. Megjithatë e marton me Fatimenë, vajzën e tij. Edhe Hatixheja duhej ta kishte Aliun djalë xhaxhai, siç e pamë nga (dez)informata e mëhershme, që kanë ofruar këto bashkautore.

E vetëkuptueshme, - sipas këtyre autoreve, - Muhamedi fillimisht u kishte pëshpëritur të afërmeve të tij për mandatimin e ri si „I Dërguari“ i Zotit, meqë pothuajse gjithë popullsia e Mekës me

¹²⁰ Po aty, f. 27

rrethinat, i përkiste kryesisht besimit pagan, me disa fise të besimit hebre dhe pak të krishterë. Ata do të alarmoheshin, sapo të dëgjonin për „profetin“ dhe fenë e re. Deri këtu gjithçka ishte njerëzore, por ku është Allahu i tij, i gjithëfuqishëm, që nuk i krijon hapësirë „të dërguarit“ të tij, që të flasë me zë dhe pa frikë?! Por, vetëkuptohet, që këtu kemi të bëjmë vetëm me improvizime dhe sajime të njeriut Muhamed.

Dilema se Muhamedi u ka pëshpëritur të afërmeve të tij për fenë e re që po sajonte, ofron surja nr 111, e cila përmban konfliktin dhe mallkimin e Muhamedit ndaj xhaxhait të tij, Ebu Lehab.¹²¹

„Në fillim, - vazhdojnë autoret, - këto gjëra i dinin vetëm I Dërguari (s. a. v.) dhe e shoqja e tij. Mirëpo një ditë, Aliu hyri në dhomë dhe e gjeti të Dërguarin (s. a. v.) me Hatixhenë duke u falur. Ai i hutuar i pyeti se ç'janë duke bërë. I Dërguari (s. a. v.) i shpjegoi atij se ishin duke iu lutur Allahut dhe duke e falënderuar Atë. Atë natë Aliu mbeti zgjuar duke menduar shumë rreth tërë asaj që I Dërguari (s. a. v.) i tha; ai e admironte shumë dhe e çmonte kushërin e tij. Më në fund mori vendimin e të nesërmen shkoi tek I Dërguari (s. a. v.) dhe i tha se dëshironte që ta ndiqte. Kështu, Hatixheja ishte gruaja e parë që përqafoi Islamin, mësimet e të cilit I Dërguari (s. a. v.) i sollli prej Allahut kurse Aliu ishte i riu i parë. Pas pak kohe, atyre iu bashkëngjiti edhe Zejd ibn Harithi, që ishte një skllav, të cilin e kishte çliruar me pagesë vetë I Dërguari (s. a. v.) Herë pas here shkonin jashtë qytetit, në malet rreth e qark Mekës, që ta dëgjojnë atë duke lexuar Kuranin dhe të bisedojnë me të. E tërë kjo bëhej fshehurazi, dhe në këto ditë të hershme vetëm një numër i vogël njerëzish dinte për Islamin.¹²²

¹²¹ Ebu Leheb (أبو لهب), ishte njëri nga xhaxhallarët e Muhamedit, i cili u shqua si kundërshtar i angazhuar i Muhamedit. Dy djemtë e Ebu Lehebit, Utba ibn Abu Lahab dhe Utayba bin Abu Lahab, ishin të martuar me dy vajza të Muhamedit, Umm Kulthum bint Muhammad dhe Ruqayya bint Muhammad. Muhamedi u armiqësua për vdekje me xhaxhanë e tij, Ebu Leheb, kur thirri fisin në një kuvend për t'ua prezantuar fenë islame dhe veten si "të dërguar" të Allahut. Aty xhaxhai autoritativ e mallkon nipin, Muhamedin: "Shporru te xhelati Yt, që të na dërgosh tek ai na paske grumbulluar! "

¹²² JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 28-29.

Vërtet do të ishin për keqardhje peripecitë torturuese të Muhamedit dhe Hatixhesë, që po detyroheshin të praktikonin në fshehtësi fenë e re të tyre, të cilën ata po e sajnin. Ata po e praktikonin fshehurazi edhe nga Aliu 14-vjeçar, të cilin, tashmë, e kishin pjesëtar të familjes së tyre të ngushtë, meqë e kishin marrë për ta rritur. Deri këtu, megjithatë, gjithçka është njerëzore, e kësajbotshme. Por ku ishte Allahu i Muhamedit, i cili të paktën nuk u jepte atyre më shumë guxim, që ta praktikonin hapur fenë e tyre?!

Vetëm besimtarët trushpërlarë, të indoktrinuar edhe përtej pikës kritike, mund ta (keq)kuptojnë këtë rrjedhë të islamit **zanafillor**, si diçka hyjnore, e bërë me porosi e skenar të Allahut...

Si ta kuptojmë (dez)informimin se „*shkonin jashtë qytetit, në malet rreth e qark Mekës, që ta dëgjojnë atë duke lexuar Kuranin*“, kur gjithandej është thënë se Muhamedi ishte analfabet, që nuk kishte ditur të lexonte as suren e parë, kur e kishte urdhëruar Xhibrili?! Pastaj, *Kurani* ende nuk i „kishte zbritur“. Ajeti i fundit duhet t'i ketë zbritur pak ditë para se të vdiste Muhamedi.¹²³

Broçkulla ato të atëhershmet, mashtrime këto që po ofrojnë tani këto dy bashkautore propaganduese!

Ja në çfarë rrethane konkrete po prodhoheshin ajetet:

Pas kalimit të tri viteve, një ditë, meleku Xhibril erdhi tek I Dërguari (s. a. v.) dhe u tha njerëzve të Mekës se ka për t'u treguar diçka shumë të rëndësishme. Ai qëndroi në rrezen e Mekës, të quajtur Safa, ndërsa ata u mblodhën rreth e qark tij që ta dëgjonin se ç'kishte për të thënë. Ai filloi duke i pyetur ata se: a thua vallë do t'i besonin, në qoftë se u thoshte se do t'i sulmojë një ushtri. Ata u përgjigjën se me të vërtetë do të besonin, sepse ai kurrë nuk i kishte gënjer. Më pas ai u tha se ishte Lajmëtar i Allahut, i dërguar që t'u tregojë rrugën e drejtë dhe t'i mbronte nga dënimet e tmerrshme, të cilat do t'i pësonin „në qoftë se nuk do të ndiqnin atë drejt adhurimit të Allahut e askujt tjetër. Ebu Lehebi, njëri nga

¹²³ „...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe...” [5:3]

xhaxhallarët e të Dërguarit, i cili gjendej në mesin e turmës, papritmas u ngrit në këmbë e tha: „A mbarove? Vetëm për të na treguar këtë na thirre këtu?“ Në këtë çast, Allahu xh. sh. i dërgoi Të Dërguarit suren si vijon:

Qoftë i shkatërruar Ebu Lehebi, e ai është shkatërruar! [111:1]

Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! [111:2]

Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. [111:3]

E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), [111:4]

E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur. [111:5]

Pastaj turma u shpërnda, ndërsa I Dërguari (s. a. v.) mbeti i vetmuar. Disa ditë me vonë, I Dërguari (s. a. v.) u përpoq përsëri. Ai shtroi një gosti në shtëpi për të gjithë xhaxhallarët e vet. Pas darkës, u foli atyre: „O bijtë e Abdulmuttalibit! Unë e di se asnjë arab nuk i ka ardhur këtij populli me porosi më të mirë sesa kjo e imja. Unë ju kam sjellë juve lajmet më të mira për këtë jetë dhe për të ardhmen. Allahu më ka urdhëruar që t'ju ftoj në rrugën e Tij. Pra, cili nga ju do të më ndihmojë?“ Të gjithë njerëzit heshtën. Pastaj Aliu, kushëriri i tij, u ngrit dhe tha: „O I Dërguari i Allahut! Unë do të ndihmoj“. Pastaj të gjithë u ngritën dhe ikën duke qeshur, sepse vetëm një djalë i ri kishte rënë dakord që ta ndihmojë Të Dërguarin (s. a. v.).¹²⁴

Rrëfim i përçartë. Fillohet me një paraqitje të engjëllit Xhibril, i cili papritmas shndërrohet në „të dërguarin“ e Zotit. Dhe Muhamedi, aty për aty, sajon një përgjigje dogmatike ndaj pyetjes së xhaxhait, tepër vulgare! Xhaxhai duhet t'i ketë bërë një pyetje njerëzore (nëse mund t'u besohet të tilla rrëfimeve), e cila përmban edhe një dozë zhgënjimi, të arsyeshëm në kohë e hapësirë, meqë ai ishte pagan, kurse nipi i tij, Muhamedi, po sillej si harbut kundër tij, para të pranishmëve, duke e mallkuar kaq brutalisht. Dhe jo vetëm xhaxhanë, por e mallkon edhe gruan e tij të mjerë, që po mblidhte ferra për të gjallëruar. Dhe, që mallkimi të duket më i fuqishëm, më imponues, e paraqet sikur sapo i „zbriti“ nga Allahu.

¹²⁴ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 30

Edhe pas tre vjetësh Muhamedi nuk kishte bindur më shumë se katër veta, të cilët do ta përkrahnin në atë tubim. Pastaj, ai u shtron darkë xhaxhallarëve dhe kushërinjve. Sërish asnjëri nuk e përkrah, pos Aliut, të cilin e kishte përvetësuar më herët (e ku do të shkonte për të jetuar, i mjeri bonjak, nëse nuk do të konvertohej). Është e arsyeshme të pyesim: Çfarë roli kishte Allahu i tij, i cili askund nuk dukej se po e ndihmonte „të dërguarin“ e tij?!

Autoret, duket sikur kanë harruar, që më herët kishin (dez)informuar se Muhamedi, qysh kur ishte 20-vjeçar, kishte filluar ta propagandonte përcaktimin e tij monoteist - besimin në një Zot të vetëm...

Rrjedha e deritanishme dëshmon për zhvillime njerëzore, pra aspak hyjnore e profetike. Muhamedi rezultoi si një njeri i rëndomtë, gjithsesi fatkeq e i përvuajtur, që pandeh se është „profet“ dhe „I Dërguari“ i Zotit dhe provon të sajohet doktrinë mashtruese, që të mund të imponohet. Qindra njerëz rezistojnë, e tallin, e keqtrajtojnë, por ndodhin edhe të tilla konvertimesh aksidentale, si rasti i Hamzait, i konvertuar jo nga bindja, por nga inati e sedra e cenuar...

Peripeçitë e Muhamedit u shtuan kur i vdiq gruaja, Hatixheja (në vitin 619 ose 620). Në të njëjtin vit i vdiq edhe xhaxhai, Ebu Talib.

Jeta e mëtejme e Muhamedit dhe e një grushti të besimtarëve të tij në Mekë po bëhej e papërbalueshme. Tashmë, krerët e fisit Kurejsh nuk po i duronin predikimet dhe vandalizmin agresiv të Muhamedit dhe, prandaj, morën vendim ta vrisnin. Përpjekja për vrasje u bë në Dar al-Nadva, në Mekë, më 9 shtator 622 (në burime të tjera thuhet më 26 shtator 622)¹²⁵. Muhamedi mezi mundi t'i shpëtojë vrasjes dhe vendosi të arratisesh nga Meka për në Medinë. E shoqëroi Ebu Bekri. Para arratisjes, fillimisht fshihen në shpellën Teur, në jug të Mekës. Ja çfarë rrëfejnë këto bashkautorë:

¹²⁵ <http://www.derletzteprophet.info/chronologie-der-epoche-des-propheten-mohammed-sav>

Kur dolën jashtë qytetit, I Dërguari (s. a. v.) shikoi një herë prapa dhe tha: „Nga e gjithë toka e Allahut, ti je vendi më i dashur për Allahun dhe për mua, dhe po të mos më kishte përzënë populli im, unë kurrë nuk do të braktisja“. Kur kurejshët e kuptuan se Muhamedi (s. a. v.) dhe shoku i tij kishin ikur, filluan t'i kërkojnë nga të gjitha anët. Tri ditë më vonë arritën deri te shpella ku fshihen I Dërguari (s. a. v.) dhe Ebu Bekri, mirëpo aty ndodhi diçka e çuditshme. Në hyrje të shpellës kishte thurur rrjetën e saj një merimangë, kurse aty pranë, një pëllumb kishte ngritur folenë. Kur mekasit ndodheshin në hyrje të shpellës dhe vetëm rrjeta e merimangës i ndante nga të arratisurit, Ebu Bekri u frikësua shumë për sigurinë e tyre. Ai i pëshpëriti të Dërguarit (s. a. v.): „Ata janë shumë afër. Në qoftë se dikush prej tyre kthehet këtej, atëherë do të na shohin“.

Por përgjigjja e Të Dërguarit (s. a. v.) e qetësoi: „Çfarë mendon ti për dy njerëz, që si të tretë midis tyre kanë Allahun?“ Pas disa çastesh, ndjekësit u pajtuan me mendimin se askush nuk mund të ketë hyrë në këtë shpellë për një kohë të gjatë, sepse përndryshe rrjeta e merimangës s'do të ishte e paprekur dhe se aty nuk do të bënte dot folenë pëllumbi, prandaj edhe u larguan pa hyrë brenda.

Tri ditë më vonë, I Dërguari (s. a. v.) dhe Ebu Bekri u bindën se janë të sigurt për ta lënë shpellën. I biri i Ebu Bekrit, Amiri, u siguroi tri deve dhe i ndihmoi që ta vazhdonin rrugën e tyre për në Jethrib.

Ndërkohë, udhëheqësit e kurejshëve u kthyen në Mekë dhe ofruan një shpërblim prej njëqind devesh për atë që do të kapte Të Dërguarin (s. a. v.). Në mesin e atyre që vajtën për ta kërkuar ishte edhe një luftëtar i famshëm. Në të vërtetë, ai ishte i vetmi që mund ta kapte, mirëpo sa herë që i afrohej Të Dërguarit (s. a. v.), kali i tij zhytej në rërë deri në gjunjë. Kur kjo ndodhi tri herë me radhë, atëherë ai kuptoi se Të Dërguarin (s. a. v.) e mbron një fuqi që është shumë më e madhe nga çdo gjë që kishte njohur më parë, prandaj edhe u kthye në Mekë. Kur arriti atje, ai i paralajmëroi të tjerët për rrezikun e kërkimit të mëtejshëm, duke i njoftuar se ç'kishte ndodhur me të.

Udhëtimi i Të Dërguarit nga Meka u quajt shpërngulje (hixhret). Në të vërtetë, ky ishte hapi i parë i përhapjes së islamit nëpër botë, kurse prej këtij viti të hixhretit, myslimanët filluan kalendarin e tyre.¹²⁶

Nga ky rast myslimanët do ta çmojnë merimangën si shpëtimtare të profetit të tyre. Por, kush po e ndiqte Muhamedin për ta vrarë? E ndiqte farefisi i tij, sepse Muhamedi, tashmë, ishte bërë i bezdisshëm dhe i rrezikshëm për banorët e Mekës. Ai po u ofendonte atyre zotat dhe kultet, po kërkonte që Qabeja t'i dorëzohej atij, meqë paskësh qenë islame që nga koha e Adamit etj. Ishte një gjendje fatkeqe për të dyja palët, pra aspak profetike, as hyjnore. U krijuan keqkuptime, sherre e hasmëri, të nxitura nga njeriu, tashmë, psikikisht i lajthitur, që pretendonte të ishte „I Dërguari“ i Allahut.

Më 24 shtator 622 (në burime të tjera flitet për muajin tetor), Muhamedi dhe Ebu Bekri arrijnë në Jethrib, të cilin Muhamedi, më vonë, do ta emëronte Medina (qyteti vezullues).

Meqë veprimtaria e Muhamedit, aty e tutje, ishte kryesisht luftarake, angazhimet e tij do të paraqiten në kapituj të tjerë.

Këtë kapitull po e përmbyll me disa (dez)informime e (ç)vlerësime të studiueses arabe Fatima Mernisi (Mernissi), sociologe dhe islamologe, ligjëruese në disa universitete, kryesisht në universitetin „Muhammad V“ në Marok:

Profeti është afirmuar si njeri i përmbajtur. Ai asnjëherë nuk vepronte në bazë të ideve spontane. Kur ballafaqohej me problemin, mendonte shumë ditë për zgjidhjen. Njerëzit qenë ambientuar me vonesën e tij për vendimmarrje. (...) Fotoja „zyrtare“ që la ai në librat e historisë, është ajo e njeriut të butë dhe të trembur. „Profeti kishte trup mesatar (...) kishte një lëkurë shkëlqyese, paksa të përskuqur. Sytë i kishte të zinj,

¹²⁶ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 49-50.

*kishte flokë të dendur, të zinj, shkëlqyes dhe të bukur. Fytyra e tij ka qenë e rrethuar me lesh të harlisur rreth mjekrës. Ai kishte flokë të gjatë deri mbi supe. Qafa e tij ishte e bardhë (...) Fytyra e tij rrezatonte shumë mirësi, që të përvetësonte të mos i largoheshe, kur kishe rastin të ishe pranë tij. (...) Kush e ka parë atë, ka pranuar se asnjëherë, para dhe pas tij, nuk ka takuar një burrë, fjalimet e të cilit të magjepsnin aq shumë (...)*¹²⁷

Por, paraprakisht, ajo i bën edhe një portretizim lavdërues:

Viti 5 i hixhrit (627) nuk ishte si vitet e tjera. Ishte vit i rëndë për Profetin, si kryekomandant ushtarak i një komuniteti me besim monoteist, i cili insistonte t'i imponohej Arabisë politeiste. Të kthehemi te momenti kur Muhamedi, për t'u ikur përndjekjeve, u detyrua të ikte nga Meka dhe të kërkonte azil te fiset në Medinë. Një qytet si Medina nuk do të duhej të tregohej i gatshëm t'i ofronte strehim një rebeli, i cili i kishte shpallur luftë krejt Arabisë dhe shumë zotave të saj paganë dhe Mekës së fuqishme e frikësuese, sikur të mos shpresonte në një përfitim nga ky strehim. Shikuar realisht: Muhamedi mundi të korrë sukses vetëm pse iu përku-shtua misionit e qëllimit të tij me tërë qenien, duke dalë i fituar në konfliktet që i ndodhnin. (...)

Kush i ofronte strehim Profetit, rrezikohej të përballej luftarakisht me fisin Kurejsh të Muhamedit, i cili ishte njëri nga fiset më të fuqishme në Arabi, dhe aleatëve të tij. (...)

Këto fragmente me kanë bindur se as autorja Mernisi nuk e posedon seriozitetin e studiueses shkencore, meqë është mbisunduar nga simpatia dhe tifozeria e saj për Muhamedin, jo vetëm si sajues i islamit, por edhe si hero arab, i cili e konsolidoi Arabinë një fuqi rajonale, për t'u shndërruar shpejt në perandori. Në vitin 640, islami ia doli të pushtojë Egjiptin dhe vende të tjera, duke imponuar nismën për asimilimin - arabizimin e popujve të tyre.

¹²⁷ Fatima Mernisi, "Derpolitische Harem / Muhamed und seine Frauen", Herder Verlag, Freiburg 1992, . f. 117; Autorja MERNISSI ka cituar historian Muhamed TABARI.

Ndoshta do të kishte qenë interesante të sillja edhe vlerësime madhëruese që personalitetet jomyslimane i kanë bërë për „profetin“ Muhamed, por nuk po harxhoj kohë e hapësirë, për dy arsye kryesore:

E para, sepse ato po i propagandojnë vulgarisht myslimanët fundamentalistë. E dyta, vetëm pse ishin personalitete në fusha të ndryshme, duhet tu besohen vlerësimeve të tyre madhëruese për Muhamedin?! Assesi! Ata duhet ti kenë bërë për arsye të tyre subjektive, por gjithsesi duke e devaluuar veten e tyre, ose si të painformuar, ose si mashtrues, ose si interesaxhinj. Ndër ta, fatkeqësisht, janë edhe emra eminent, si **George Bernard Shaw, Johann Wolfgang von Goethe etj.**¹²⁸

Por as personalitet që e kanë demaskuar e denigruar Muhamedin nuk po i citoj, për dy arsye kryesore: që të mos më keqkuptojnë besimtarët myslimanë si tendencioz dhe, e dyta, dua t'i paraqes kryesisht vlerësimet e mia për jetën, veprën dhe dogmën e Muhamedit, duke u bazuar kryesisht në burime autentike islame, siç janë *Kurani* dhe hadithet (rrefimet) islame. Përndryshe, diskualifikime të mëdha i kanë bërë Voltaire [Volter / emri origjinal: *François-Marie Arouet*], **Alexis de Tocqueville (Aleksis Tokvill), Winston Churchill (Winston Çerçill) etj.**¹²⁹

Nga kjo paraqitje, pothuajse telegrafike (me përjashtim të legjendave propagandistike të dy autoreve të angazhuara myslimane), rezulton se kur Muhamedi kishte filluar sajimin e dogmës islame (në vitin 610), Meka dhe Medina nuk ishin vendbanime të pushtuara dhe të sunduara nga të huajt. Aty jetonin disa fise beduinësh, që i përkisnin

¹²⁸ Vlerësime madhëruese për Muhamedin:

<http://www.meine-islam-reform.de/index.php/artikel/allgemein/243-zitate.html>

¹²⁹ Citate diskualifikuese për Muhamedin mund të gjeni të përmbledhura:

<http://www.islam.kritik-objektiv.com/islamkritische-zitate/>

kryesisht besimit fetar politeist, por kishte edhe fise të besimit hebre dhe një numër i vogël të krishterësh. Përgjithësisht, ata duhet të kenë bashkëjetuar me një tolerancë të theksuar multifetare dhe multikulturore. Në Kaba (Qabe), kryeqendrën e kulteve pagane, ku organizoheshin pelegrinazhe pagane edhe nga hapësira të largëta, toleroheshin të ekspozonin rekuizitat fetare edhe besimtarët hebrej e të krishterë. Muhamedi e prishi atë paqe sociale. Ai u bë agresiv me predikimin e tij për islamin, si „të vetmen fe të vërtetë të Allahut“ dhe me falsifikimin historik, se „Qabeja kishte qenë myslimane qysh nga Ademi, Ibrahim dhe Ismaili“ dhe, prandaj, i takonte atij dhe besimtarëve të tij.

Derisa Muhamedi vetëm predikonte si një lloj misionari, qoftë edhe kundër besimeve të tjera fetare dhe me pretendime uzurpuese ndaj Qabesë, tolerohej, meqë në Mekë primatin e kishte fisi Kurejsh, të cilit i përkiste edhe Muhamedi dhe, sepse, kryepleq „qeverisës“ në Mekë ishin gjyshi dhe xhaxhallarët e Muhamedit. Por kur ai u bë agresiv edhe fizikisht, duke thyer skulptura e rekuizita të idhujtarëve paganë, paria e fisit Kurejsh morën vendim për ta vrarë Muhamedin, për blasfemitë që bënte kundër besimit dhe idhujtarëve të tyre shekullorë e tradicionalë.¹³⁰

Fatkeqësisht, Muhamedi ia doli të arratisë nga Meka. Shpëtimin e tij e vuajtën fisi Kurejsh dhe fiset e tjera beduine në Medinë, dhe është duke e vuajtur njerëzimi edhe tani! Agresivitetin në Mekë dhe në Medinë e nisi dhe e imponoi njëanshmërisht vetëm Muhamedi! Është mendësi e inkriminuar ajo që edhe tani mbron luftimet e Muhamedit, si mbrojtëse e çlirimtare, kur ato ishin vetëm luftime plaçkitëse, për konvertim të dhunshëm dhe për zhdukje të besimeve politeiste, çifute e të krishtera! Në shërbim të atyre luftimeve agresive është edhe doktrina, të cilën Muhamedi me bashkëmendimtarë duhet ta kenë

¹³⁰ Takimi i krerëve të Mekës u bë më 26 Sefer 1 / 9 shtator 622 në Dar al-Nadva dhe aty mor vendimi për të vrarë Muhamedin. Sipas Dr. CasimAvcı, "Kronologjia..." ; shih kronologjinë tabelare historike dhe në:

<http://www.derletzteprophet.info/chronologie-der-epoche-des-propheten-mohammed-sav>

ISLAMI, religion agresiv (!)

sajuar gjatë kohës së sundimit të tij despotik në Medina. Doktrina e tij është e sanksionuar në kanunin beduin muhamedan, të quajtur në ndërkohë „Kuran“ (recital).

Vetëm myslimanët idiotë mund ta çmojnë çlirim pushtimin e Mekës nga Muhamedi dhe falangat e tij xhihadiste! Vetëm besimtarët injorantë dhe mashtruesit e llojllojshëm e quajnë islamin fe paqësore!

Paraqitjet e mëtejshme do të ofrojnë prova kokëforta se Muhamedi, *Kurani* i tij dhe dogma muhamedane dominoheshin nga përcaktimet diskriminuuese, amorale, shoviniste, agresive, fashistoide!

Veprimet e Muhamedit, *Kurani* dhe dogma muhamedane ndoshta do të mund të arsyetoheshin me rrethanat kohore e hapësinore, me nivelin kulturor të fiseve beduine në atë kohë, me të drejtën e individit për t'u bërë ideator, udhëheqës, ushtarak etj. , por fatkeqësia qëndron te konservimi i dogmës islame si e përjetshme, meqë *Kurani* dhe hadithet muhamedane nuk janë të reformueshme.

I. 3. Muhamedi - luftërat 623-632

Muhamedi fenë e tij, të cilën e emërtoi *islam* [arabisht: إسلام], shqip: *nënshtrim*, duhet të ketë filluar ta sajonte e ta predikonte në Mekë më 01. 02. 610 (ose më 27.09.610). Tri vitet e para duhet të ketë qenë pothuajse klandestin. Gjatë viteve në vazhdim, deri në vitin 619, ishte paqësor. Ai nuk kishte konfrontime serioze me banorët e Mekës, por nuk gëzonte as simpati, as përkrahje. Për 12 vjet predikim, ai mundi të konvertonte në islamin e tij vetëm rreth 140 veta, kryesisht skllëvër.

Në vitin 619 ose 620, Muhamedit duhet t'i jetë përkeqësuar gjendja psikike, sepse i vdiqën gruaja, Hatixheja¹³¹ dhe xhaxhai, Ebu Talib¹³². Që të dy i kishte mentorë. Këto vdekje duhet t'i kenë shkaktuar Muhamedit trazime, pasiguri e trauma. Në këtë gjendje ai kërkonte me ngulm shndërrimin e Qabesë në objekt kulti për islamin. Kërkesa e tij ishte provokim për besimtarët paganë të Mekës. Ata u tronditën nga kjo kërkesë, sepse Qabeja ishte afirmuar si kryeqendër shekullore për besimin politeist të fiseve beduinë, në siujdhesën “arabe”.

Përkeqësimi i situatës nga konfrontimet ndërmjet fisit beduin Kurejsh, të cilit i përkiste edhe Muhamedi, dhe Muhamedit, të nxitura nga ky i fundit, i detyroi Muhamedin dhe ithtarët e tij të arratiseshin nga Meka, më 13 korrik 622, dhe të strehoheshin në Medinë. Këtë vit, kalifi i parë, Ebu Bekri, e ka përcaktuar si vitin **një** të kalendarit islam, i quajtur arabisht: at-takvim al-hixhri / التوقيت الهجري.¹³³

¹³¹ Hatixheja ishte gruaja e parë e Muhamedit. Ajo ishte vajza e Kuvailidit të fisit Banu Kurejsh. Të njëjtit fis i përkiste edhe Muhamedi, madje në disa burime (dez)informohet se ata ishin kushëri të brezit të parë mes tyre. Hatixheja kishte pasuri të madhe, ishte dy herë e ve kur u martua me Muhamedin dhe rreth 20 vjet më e madhe. Duhet të jenë martuar në vitin 595, që i bie të kenë bashkëjetuar si bashkëshortë rreth 25 vjet. Disa vite para martesës Muhamedi ishte shërbëtor i Hatixhesë.

¹³² Ebu Talibi ishte xhaxhai i Muhamedit, babai i kalifit Ali. Ai u përkujdes për Muhamedin, pasi atij i vdiqën prindërit. E ushtronte tregtinë me karvanë, deri edhe në Siri. Në Mekë ishte kryeplak i degës “Banu Hashim” të fisit “Banu Kurejsh”.

¹³³ Ky kalëndar është „hënor“, ka rreth 354 ditë e 8 orë. Kalëndari „botëror“ që po e përdorim ka rreth 365 ditë e 6 orë. Rreth 33 vite të Kalendarit Islam janë të barabartë me rreth 32 vjetë të kalëndarit „tonë“ diellor. Emri i Kalendarit islami Hixhra bazohet në këtë shprehje, që e ka

Para se të arratisëj Muhamedi, Medina quhej Jatrib (يثرب)¹³⁴, por ai e tjetërsoi në *Madinaal-munavara / qyteti i ndriçimit* (المدينة المنورة).

Në Medinë dhe rrethina të saj Muhamedi gjeti fise që po grindeshin mes tyre. Fisi kryesor politeist Banu Khazraxh, ishte në aleancë me fiset hebre Banu Kuraiza dhe Banu Nadir. Fisi politeist Aus ishte në aleancë me fisin hebre Kainuka. Te fiset Khazraxh gjetën strehim refugjatët myslimanë (të quajtur arabisht *muhaxhirun*).

Fisi Khazraxh, me ndërmjetësimin e Muhamedit, ofroi pajtim me fiset e tjera. Ato u takuan gjatë rrugëtimit të pelegrinazhit (haxhit) në Akaba dhe bënë marrëveshjen për paqe. Kjo marrëveshje, siç (dez)informojnë historianët e islamit dhe biografët e Muhamedit, më të hershmit, Muhamed Ibn Is'hak¹³⁵ dhe Ibn Hisham¹³⁶, duhet të jetë quajtur *Rregullorja e Bashkësisë së Jatribës*¹³⁷. Ajo përmbante rregullat e bashkëjetesës mes fiseve të Medinës me rrethina. Propagandistët myslimanë atë marrëveshje e quajtën "Kushtetuta e parë islame".

kuptimin në shqip: emigrim; Kalifi i dytë, Utmani, duhet ta ketë vendos që dita një e Kalendarit islam të jetë ditë kur Muhamedi është emigruar nga Maka në Jatrib (Medina), që duhet të ketë qënë 13 korriku 622...

¹³⁴ Vendbanimi Jatrib njihej qysh në vitin 552 p. e. s., kur e pushtoi mbreti babilonas Nabonid, duke e zgjeruar sundimin e tij në të gjithë siudhesën "arabe".

¹³⁵ Muhamed ibn Isak (محمد بن إسحاق), lindur në vitin 704 në Medinë, i cili vdiq më 767 në Bagdad, ka qënë biografi i parë dhe më autentik i Muhamedit. Vepra origjinale është zhdukur, por janë botuar recensionet të shumta, duke sajuar vepër të ngjashme me atë të Ibn Isakut. Ishte i njohur edhe si kronikan i luftërave të komanduara nga Muhamedi.

Versioni elektronik i librit të Ibn Isakut, i përkthyer në gjermanisht nga orientalisti/islamologu Gustav Vajl (Gustav Weil), i botuar në vitin 1864 në Stutgart:

https://ia600501.us.archive.org/32/items/DasLebenMohammedsNachMohammedIbnIshak/LebenMohammedNachMohammedIbnIshak_text.pdf

¹³⁶ Ibn Hisham, emri i plotë: Abd al-Malik ibn Hishām ibn Ayyūbal-Himyarī, Abū Muhammed (عبد الملك بن هشام بن أيوب الحميري، أبو محمد), ka lindur në Basra dhe ka vdekur më 8 maj 829 në Fustat (Egjipt). Ishte historian islam dhe arabolog i afirmuar. Vepra e tij kryesore "Sīrat Muḥammadrasūli' llāh / سيرة محمد رسول الله / Biografia e Muhamedit, të dërguarit të Allahut".

¹³⁷ Originali i kësaj marrëveshjeje është zhdukur, kurse një variant është përfshi në "Kitābal-Amwāl", të autorit Abū Ubaidal-Qāsīm ibn Sallām. Studiuesi Mihael Lecker (Michael Lecker) këtë marrëveshje e ka sistemuar në 64 paragrafë. § 1: "Marrëveshje e Muhamedit, Profet, në mes të besimtarëve dhe myslimanëve Kurejshën e të Jatribit dhe atyre që u shkojnë prapa, janë aleatë dhe luftojnë bashkë me ta". Në vazhdim vijjnë paragrafët që emërtojnë përfaqësuesit e tetë fiseve, marrëdhëniet mes fiseve të arabëve dhe judenjve etj.

Një vit më vonë, me rastin e shënimit të njëvjetorit të marrëveshjes, disa pjesëtarë të fisi Khazraxh u konvertuan në islamë, ndërsa me rastin e shënimit të dy-vjetorit, u konvertuan edhe disa pjesëtarë të fisit Aus.

Fillimisht Muhamedi dhe imigrantët furnizoheshin nga plaçkitja që u bënë karvanëve. Pas këtyre stërviqeve, ata bënë beteja më të organizuar. Ata, tashmë, ndihmoheshin edhe nga banorë të Medinës, të cilët Muhamedi i quajti Al-Anzar. Sulmet ndaj karvanëve, që kalonin tranzit për të bërë tregti në Mekë, Muhamedi i arsyetonte me dëbimin e tij e të ithtarëve nga mekasit dhe si nevojë e domosdoshme për ekzistencë. Sulmet dhe plaçkitjet e karvanëve të fiseve të tjera ishin traditë e fiseve të varfra të beduinëve, për të siguruar jetesën.

Sipas Ibn Is'hak, përpos sulmeve ndaj karvanëve, betejën e parë sulmuese Muhamedi e ndërmori në gusht të vitit 623. Atëherë ai ishte 53 vjeç. Ky sulm ndodhi ndaj fisit të Kurejshëve (të cilit i përkiste vetë Muhamedi) dhe fisit Damra, aleat të Kurejshëve. Pas një muaji, në shtator 623, Muhamedi sulmoi sërish Kurejshët, në rrethina të Mekës. Atje qëndroi disa ditë, ku planifikonte sulmet kundër atyre fiseve, por, ndërkohë, bëri marrëveshje për miqësi me fiset Mudlidh dhe Damra dhe u kthye në Medinë.

Beteja në Bedër (غزوة بدر)¹³⁸

Sipas historianëve islamë, në Bedër, më 17 mars 324 (17 Ramadan të vitit 2 të Hixhrit), Muhamedi me bashkëluftëtarët e tij u përballën me forcat e fisit Kurejsh, të përbëra nga 950 luftëtarë. Ata udhëhiqeshin nga Amr ibn Hisham, të dërguar për të mbrojtur karvanin nga sulmet plaçkitëse të Muhamedit.

¹³⁸ Bedra ndodhet në jugperëndim të Medinës, rreth 150 kilometra larg saj. Beteja në Bedër u zhvillua më 17 të muajit Ramazan në vitin e dytë pas hixhretit (13 ose 17 mars 624); Ibn Hisham, Ibn Isak, Alfred Guillaume (translator) (1998). The life of Muhammad: a translation of Ishāq's SīratasūlAllāh. Oxford University Press. p. 210.

Kësaj beteje i janë dedikuar ajetet 3:123, 124, 125 dhe 8:5-6, 68:25etj¹³⁹.

Allahu ju ka ndihmuar edhe në Bedër, kur ishit të pafuqishëm, prandaj frikësohuni Allahut, që të jeni mirënjohës. Kur u pate thënë besimtarëve: "A nuk u mjaftonte që Zoti juaj ju dërgon në ndihmë tre mijë engjëj?" Po, si jo! Nëse jeni të qëndrueshëm dhe të devotshëm, dhe nëse ata ju sulmojnë menjëherë, Zoti juaj do t'ju dërgojë në ndihmë pesë mijë engjëj, të gjithë të shënjuar. [3:123-125]

Këto ajete duhet të jenë sajuar nga Muhamedi ose bashkëpunëtorët e tij, pas betejës në Bedër, për të motivuar xhihadistët muhamedanë për beteja të tjera, përkatësisht për t'i mashtruar ata me ndihmën që ua dërgonte Zoti, sidomos në rastet kur ishin më pak se kundërshtari. Mesazh të njëjtë ka edhe ajeti tjetër, ku është paraqitur roli i Zotit për dobësimin e shpirtit luftarak të luftëtarëve të Mekës:

Keni një argument për model, dy grupet që u kacafytën: Njëri grup që luftonte në rrugë të Allahut dhe tjetri, mosbesimtar, të cilit iu duk se ka përpara vetes dy herë më tepër kundërshtarë¹⁴⁰. Dhe Allahu, me ndihmën e vet, përkrah kë do. Në këtë ka me të vërtetë mësim për ata që shohin. [3:13]¹⁴¹

Bazuar në përmbajtjet e këtyre ajeteve, mund të konstatohet se *Kurani* nuk përmban vetëm doktrinë ekskluzive fetare, hyjnore, por një pjesë e madhe e tij iu dedikohet konkretisht betejave dhe luftërave.

Sipas Al-Buharit, në këtë betejë vdiqën 70 mekas dhe 14 muhamedanë¹⁴². Me urdhër të Muhamedit, kufomat e 20 mekasve duhet të jenë hedhur në bunar¹⁴³. Kurse mekasit i ekzekutuan myslimanët e zënë robër¹⁴⁴.

¹³⁹ Mubarakpuri, *The Sealed Nectar*, pp. 133-138. (online); <http://www.webcitation.org/612cLy78j>.

¹⁴⁰ Bëhet fjalë për betejën në Bedër.

¹⁴¹ Ata të cilëve u ka ardhur Libri, d.m.th. Bibla janë hebrejtë dhe të krishterët, kurse të përfunduarit janë arabët analfabetë politeistë paganë.

¹⁴² Sahihal-Buhari: vëll. 4, libri 52, nr. 276.

¹⁴³ Al-Muslim, libri 040, nr 6870.

¹⁴⁴ Sahihal-Buhari: vëll 4, libri 52, nr. 276.

Beteja në kodrën Uhud

Kjo betejë ndodhi një vit pas betejës në Bedër, më 23 mars 625. U zhvillua në Uhud, siç quhej kodra buzë Medinës. Palët luftuese ishin pjesëtarë të fisit Kurejsh me aleatët e tyre të Medinës, kundërbanditëve të Muhamedit. Mekas ishin 3000, ndërsa xhihadistë rreth 700 veta.

Në prag të betejës, forcat muhamedane kishin dilema: ku dhe si të përballen me mekasit. Muhamedi ishte i mendimit të pozicionoheshin në oazë dhe të vetëmbroheshin, por xhihadistët më të rinj këmbëngulnin që të përballeshin në Uhud dhe Muhamedi u pajtua me mendimin e tyre. Për të motivuar xhihadistët, të cilët kërkonin që ai të mos merrte pjesë në luftë, Muhamedi u përgjigj: "Nuk është e dinjitetshme për një profet që të ikë nga beteja, pasi ta ketë ngjeshur njëherë shpatën¹⁴⁵".

Përfundimisht, xhihadistët myslimanë u mundën. Për këtë betejë Muhamedi ose bashkëpunëtorët sajuan ajete kuranore:

E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sigurtë. [3:139]

Në qoftë se juve ju preku çka ju dhemb (në Uhud), edhe atë popull (armikun) e pati prekur dhembje si kjo e juaja (në Bedër). Ne këto ditë i ndërrojmë mes njerëzve, për t'u ditur tek Allahu ata që besuan dhe për t'i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë. Allahu nuk i do zullumqarët. [3:140]

Ajo që ju goditi juve ditën e ballafaqimit të dy grupeve, ishte me lejen e Allahut, për t'u dalluar besimtarët e sigurtë. [3:166]

Dhe, për t'u ditur ata që ishin hipokritë. E atyre u është thënë: "Ejani e luftoni në rrugën e Allahut ose mbronin veten!" E ata thanë: "Sikur të dinim se do të luftohej, ne do të vinim pas jush!" Në atë moment ata ishin më afër mosbesimit se besimit. Flisnin me gojë të tyre atë që nuk e kishin në zemrat e tyre, po Allahu e di mirë për atë që fshehin. [3:167]

Dhe ata që nuk luftuan u thanë të vetëve: "Sikur të na dëgjoni neve, nuk do të mbyteshit!" Thuaju: "Largojeni pra vdekjen prej vetes suaj, nëse jeni të sigurt çka

¹⁴⁵IbnIs'hak, Das Lebendes Propheten (Jeta e Profetit). Kandern, 2004. F. 146.

thoni?" [3:168]

Dhe kur largoheshit e nuk përfillnit as njëri-tjetrin, ndërsa i dërguari ju thërriste mbrapa. Atëherë u goditi me dëshpërim për dëshpërim, ashtu që mos pikëlloheni për atë që ju shpëtoi (preja e luftës) e as për atë që ju goditi. Allahu është i njohur hollësisht me atë që veproni. [3:153]

Pas kësaj beteje Muhamedi dhe bashkautorët sajuan një mori ajetesh, sepse xhihadistët ishin dëshpëruar nga humbja dhe ishin zhgënjyer nga mosndihma e Allahut, si në Bedër. Mosndihmën e Allahut Muhamedi e arsyeton me përcaktimin e tij për të sprovuar besimtarët e tij, ndërsa për ata që kishin ngurruar të merrnin pjesë, për t'i diskredituar u thotë: *"Largoni vdekjen prej vetes suaj, nëse jeni të sigurt çka thoni."*Këta të fundit ishin gjithashtu myslimanë, por frikoheshin të merrnin pjesë në betejë. Përmes këtij ajeti, për herë të parë bëhet diferencimi i myslimanëve në besimtarë të vërtetë dhe në më pak besimtarë.

Në këtë betejë u vra edhe xhaxhai i Muhamedit, Hamzai. Muhamedi duhet të jetë betuar për hakmarrje, që vetëm një profeti nuk i kishte hije: "Betohem, në qoftë se një ditë Perëndia do të më ndihmojë të fitoj kundër Kurejshëve, do të gjytoj tridhjetë njerëz për hakmarrje!" Dhe myslimanët u betuan kur panë pikëllimin dhe zemërimin e Profetit për vrasjen e xhaxhait të tij: "Për Allah, në qoftë se Perëndia një ditë na bën fitimtarë mbi ta, ne do t'i gjytojme ata më tmerrshëm se çdo gjymtim që kanë bërë ndonjëherë arabët!"¹⁴⁶

Ja, këta barbarë ishin myslimanët zanafillorë (selefishë)!

Duket se kjo nuk ishte e mjaftueshme, prandaj Muhamedi ka sajuar edhe ajetin vijues:

"Në qoftë se doni të merrni hak, atëherë ndëshkoni në atë masë sa jeni ndëshkuar ju..." [16:126]

Aspak profetike, as hyjnore. Gjithçka tokësore e barbare, si edhe betejat e luftërat e tjera për pushtet e sundim.

¹⁴⁶ Ibn Isak, vep. cit., f. 154.

Dëbimi i fiseve çifute

Në vitin 624 Muhamedi dëboi nga Medina fisin çifut Kainuka.

Në vitin 625 Muhamedi dëboi fisin çifut Banu Nadir.

Në vitin 626 Muhamedi komandoi sulmet ndaj fiseve pagane Banu Muharib dhe Banu Talaba, pjesë të popullsisë Gatafan.

Ekspedita në Dhatel-Rika u zhvillua në tetor 625. Muhamedi mori lajmin se disa fise të Benu Gatafan ishin grumbulluar në Dhatel Rika me qëllime të dyshimta.

Muhamedi vazhdoi drejt Nejdit në krye të 400 apo 700 xhihadistëve, për të sulmuar, pastaj, Dhatel Rikën. Në ballafaqim e sipër, pjesëtarët, burra të fisit Gatan, ikën në male. Forcat xhihadiste zunë robër gra e fëmijë dhe plaçkitën gjësendet e tyre. Kur erdhi koha e namazit, ata kishin frikën se mos po i sulmonin gatanët. Këtij rasti, Muhamedi ia ka dedikuar ajetin vijuese¹⁴⁷:

Kur të jeni në udhëtim e sipër, nuk është mëkat për ju të shkurtoni namazin, nëse frikoheni se jobesimtarët do t'ju sjellin ndonjë të keqe. Jobesimtarët janë armiq tuaj të hapur. [4-101]

Pas këtyre sulmeve, kur Muhamedi po pushonte nën hije, një gatan i afrohej për ta vranë¹⁴⁸. Këtij rasti duhet t'i jetë dedikuar ajeti:

O ju që besuat! Përkujtojeni të mirën e Allahut ndaj jush, kur një popull tentoi të zgjasë duart e veta kundër jush, kurse Ai i zmbropsi duart e tyre prej jush. Respektojeni Allahun dhe vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët. [5:11]

Mbase nuk teprhet të konstatohet se, duke pasur parasysh përmbajtjet e këtyre ajeteve dhe të ajeteve të tjera, që iu dedikohen tematikave konkrete të luftimeve, vetvetiu e diskreditojnë *Kuranin* si platformë luftarake agresive...

¹⁴⁷ Haykal, Husayn, The Life of Muhammad, Islamic Book Trust (1976), p. 327.

¹⁴⁸ Rahman al-Mubarakpuri, Saifur (2005), "The Sealed Nectar", Darussalam, p. 240;
<http://books.google.co.uk/books?id=ppPqzawlrIC&pg=PA240#v=onepage&q&f=false>.

Beteja e Ilogoreve

Në vitin 627, Kurejshët e Mekës dhe fiset aleate vendosën ta sulmonin sërish Medinën, meqë muhamedanët nuk po i linin të qetë karvanët e tyre. Për këtë qëllim, ata mobilizuan rreth 7000 trupa, prej tyre 700 kalorës, kurse Muhamedi mundi të mobilizonte rreth 3000 xhihadistë.

Muhamedi, i këshilluar nga një skllav, urdhëroi ta hapnin një kanal (Ilogore) të gjërë dhe të thellë rreth e rrotull Medinës, që sulmuesit të mos e kalonin.

Pas dy javësh rrethimi, sulmuesit u tërhoqën pa sulmuar¹⁴⁹. Në këtë përballje gjetën vdekjen vetëm tre xhihadistë muhamedanë dhe tre luftëtarë mekas. Por befasuese që dezinformata, sikur Muhamedit i erdhi Xhibrili dhe e urdhëroi ta dëbonte fisin çifut, Kuraiza, sepse paska qenë aleat me Kurejshët. Muhamedi e mbajti të rrethuar këtë fis 25 ditë, derisa ata u dorëzuan nga uria. Pasi u dorëzuan, Muhamedi urdhëroi të hapen varre në qendër të Medinës dhe burrave të fisit t'u pritej koka. Mes tyre ishte edhe kryeplaku i fisit, Kab Ibn Assad. U mbytën me kokëprerje rreth 600-700 burra. Muhamedi ua shpërndau ithtarëve të tij pasurinë e grabitur të këtij fisi, duke mbajtur për vete 20% të saj. Njëerën nga robëreshat, Raihana bint Amr, Muhamedi e mbajti për vete, edhe pse ia vrau babanë dhe burrin. Nëse Muhamedi e martoi ose e mbajti si skllave këtë grua, ka (dez)informata kontraverse. Ibn Sad është i mendimit se, me lutjen e Raihanës, Muhamedi e ka toleruar si konkubinë. Ajo këmbëngulte të ruante besimin e saj hebre, të cilin do ta humbiste po të pranonte martesën me Muhamedin¹⁵⁰.

¹⁴⁹ W. Montgomery Watt: Muhammad. Prophet and Statesman. Oxford University Press, 1961. S. 168.

¹⁵⁰ Ibn Saad: Bd. VIII: Biographiender Frauen. Carl Brockelmann. Brill, Leiden 1904. S. 92–93.

Kjo fitore e motivoi Muhamedin për të sajuar një mori ajetesh, që i dedikohen kësaj lufte, rrjedhimisht fitores:

O ju që keni besuar, përkujtojeni të mirën e Allahut ndaj jush, kur juve ju erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e Allahu e shihte atë që ju vepronit. [33:9]

Kur ata ju erdhën juve edhe prej së larti, edhe prej së poshtmi, dhe kur shikimet u shtangën, e zemrat arritën në fyt, e ju sajoni mendime të llojlojta për Allahun. [33:10]

Atje, në atë vend qenë sprovuar besimtarët, dhe qenë tronditur me një dridhje të fortë. [33:11]

Kur hipokritët dhe ata që në zemrat e tyre kishin sëmundje, thoshin: "Allahu dhe i dërguari Tij nuk na premtuan tjetër, vetëm se mashtrim!" [33:12]

Dhe kur një grup prej tyre thanë: "O banorë të Jetricit, nuk ka qëndresë për ju, ndaj kthehuni!" E një grup prej tyre kërkoi lejen e Pejgamberit, duke thënë: "Shtëpitë tona janë të pambrojtura!" Edhe pse ato nuk ishin të pambrojtura, në realitet ata nuk donin tjetër, por vetëm të iknin. [33:13]*

Dhe sikur t'u hynin atyre nga anët e saj (Medinës) dhe prej tyre të kërkohet tradhtia, ata do të ishin të gatshëm për të dhe nuk do të vononin aspak. [33:14]

E ata ishin ata që i patën dhënë besën Allahut më parë se nuk do të kthehen prapa, pra premtimi i dhënë Allahut mban edhe përgjegjësi. [33:15]

Thuaj: "Nëse ikët prej vdekjes ose prej mbytjes, ikja nuk do t'ju bëjë dobi, sepse edhe atëherë nuk do të (shpëtoni) përjetoni vetëm për pak kohë".

Thuaj: "Kush do t'ju mbrojë prej Allahut, nëse Ai jua ka caktuar ndonjë të keqe, ose nëse Ai jua ka caktuar ndonjë të mirë. Po përveç Allahut ata nuk do të gjejnë për vete ndonjë ndihmëtar". [33:16]

Allahu i ka njohur shumë mirë ata që ndër ju pengonin dhe ata që vëllezërve të vet u thoshin: "Ejani me ne!" E ata nuk vijnë në luftë, vetëm një pakicë. [33:17]

...E kur u vjen frika, i sheh ata të të shikojnë ty, e sytë e tyre rrotullohen si të atij nga të fikët pranë vdekjes, e kur largohet frika, ata ju shpojnë juve me gjuhë të mprehta, lakmues për pasuri (për plaçkë). Të tillët nuk kanë besuar, ndaj Allahu ua asgjësoi veprat e tyre, e kjo për Allahun është e lehtë. [33:18]

Ata mendonin se grupet aleate ende nuk kishin shkuar, dhe nëse aleatët kthehen edhe njëherë, ata (hipokritët) do të dëshironin të kishin qenë beduinë diku me arabët dhe prej atje të pyesin për çështjen tuaj, por edhe sikur të ishin në mesin tuaj, ata shumë pak do të luftonin. [33:19]

* Me këtë ajet, kushtuar kësaj beteje, informohemi se Medina ende quhej me emrin e saj shekullor *Jetrica*.

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh Allahun. [33:20]

E kur myslimanët e panë ushtrinë aleate, thanë: "Kjo është ajo që Allahu dhe i dërguari i Tij na premtuan neve, e Allahu dhe i dërguari i Tij e thanë të vërtetën". Ajo (ushtria e armikut që e panë) vetëm ua shtoi atyre besimin dhe mbështetjen. [33:21]

Prej besimtarëve kishte burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi. [33:22]

Dhe Allahu i zbrapsi ata që nuk besuan me atë mllëfin e tyre, duke mos arritur asnjë të mirë. Dhe Allahu ua largoi luftën besimtarëve. [33:24]

Neveritëse! Të quhen hyjnore përmbajtje të këtilla, është skandal që iu ndodh vetëm besimtarëve pa asnjëfarë dinjiteti njerëzor!

Pushtimi i Benu Mustaliqit ndodhi në dhjetor 627 (8 shaban 6)¹⁵¹. 200 familje janë marrë si robër, 250 deve dhe 5000 dele dhe dhi, si dhe një sasi e madhe e gjësëndeve shtëpiake janë marrë pre. Vetëm një mysliman u vra, por jo nga armiqtë. Ai u vra gabimisht nga një ndihmës i tij. Xhuvaurija, bija e kryeplakut të fisit Banual-Mutalik, ishte njëra nga robërit. Atë e martoi Muhamedi, në këmbim për lirimin e 100 të burgosurve, që do të konvertohen në islam (sipas historianit Saifur Rahmanal-Mubarakpuri)¹⁵².

Marrëveshja e Al-Hudaibijas

Në mars të vitit 628, Muhamedi shkon për haxh në Qabe, në Mekë, në krye të 1400 pelegrinëve. Këtë ia kishte mundësuar një marrëveshje me parinë mekase, e quajtur *Marrëveshja e Al-Hudaibijas*. Me këtë marrëveshje Muhamedit iu lejua të quhej "I Dërguari i Allahut". Një prej pikave të marrëveshjes u lejonte myslimanëve haxhintëditor në

¹⁵¹ <http://books.google.co.uk/books?id=8BziirH6UKMC&pg=PA242#v=onepage&q&f=false>

¹⁵² Za'd Al-Ma'ad 2/112,113; Ibn Hisham 2/289,290,294,295.

Qabe. Muhamedi, si kundërshpërblim, iu premtoi mekasve se nuk do të sulmohen karvanët e tyre, as Meka. Shumë xhihadistë nuk e mirëpritën këtë marrëveshje. Muhamedi u detyrua t'i mashtrojë të pakënaqurit, kinse nga Allahu i kanë zbritur ajetet vijuese:

Ne ty të dhamë një fitore të sigurt. [48:1]

Ashtu që Allahu të liroi ty prej mëkateve të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje e të orienton ty në rrugën e drejtë. [48:2]

Dhe që Allahu të ndihmon ty me një ndihmë të fortë. [48:3]

Edhe nga këto formulime rezulton se zoti muhamedan, Allahu, nuk është autor as i këtyre ajeteve, por besimtarët vazhdojnë të besojnë naivisht, se ajetet i ka formuluar personazhi gogol, Allahu.

Beteja në Kaibar

Në maj-qershor të vitit 628, Muhamedi komandon sulmin në krahinën Kaibar (150 km në veri të Medinës), ku jetonin fiset jude: Nadir, Kuraiza dhe Kainuka. Ishin ato fise, që ishin dëbuar nga Medina dhe kishin ngulur në këtë luginë. Në këtë sulm u mobilizuan 1600 - 1800xhihadistë. Pasi i nënshtuan, i detyruan që gjysmën e prodhimit nga bujqësi t'ua jepnin xhihadistëve.

Edhe në këto sulme Muhamedit i takoi një robinjë, Safija, gruaja e një udhëheqësi të këtyre fiseve. Ai e martoi edhe atë, pasi e zuri robinjë¹⁵³. Kaibar ishte krahina e parë që u pushtua e u nënshtua nga muhamedanët¹⁵⁴. Ky pushtim rezultoi i suksesshëm për Muhamedin, sepse pjesëtarët e këtyre fiseve zunë të konvertoheshin në islam dhe, kështu, sundimi i tij në Medinë u përforcua.

Për të legjitimuar këto sulme e detyrime, Muhamedi sajoi ajetet:

¹⁵³ W. Montgomery Watt: Muhammad. Prophet and Statesman. Oxford University Press, 1961. S. 195 sowie S. 102 f.

¹⁵⁴ Më gjerësisht për këtë ekspeditë: Khaybar në Encyclopaedia of Islam (New Edition. Brill, Leiden. Bd. 4, S. 1137).

A tyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë, e Allahu ka fuqi për t'i ndihmuar ata". [22:39]

Ata, të cilët vetëm pse thanë: "Allahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur Allahu të mos i zmburste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat dhe xhamitë, që në to përmendet shumë emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. [22:40]

Muhamedi i arsyetonte sulmet e plaçkitjet e tij me dëbimin e tij nga Meka, që i kishte bërë fisi i tij, Kurejsh, i cili e kishte toleruar 12 vjet, sa kohë që ai predikonte paqësisht dogmën e tij. Por, kur ai këmbëngulte për të uzurpuar Qabenë, që ta shndërronte në kryeqendër të kultit muhamedan, ata u egërsuan, sepse Qabenë e kishin objektin qendror të kultit të tyre pagan. Edhe sulmet e karvanëve, ai i arsyetonte me hakmarrje për dëbimin e tij nga Meka, por Muhamedi, tashmë, ishte përcaktuar të ushtronte pushtet e të pasurohej, duke ushtruar dhunë luftarake.

Beteja kundër Bizantit

Në maj të vitit 629, Muhamedi komandoi forcat e tij xhihadiste për marrshim në Muta (rreth 800 km në veri të Medinës), kundër forcave bizantine. Për këtë betejë mobilizoi rreth 3000 xhihadistë. Për këtë mobilizim Muhamedi duhet të ketë sajuar ajetin¹⁵⁵:

A tyre beduinëve që ngelën pas, thuaju: "Ju do të ftohemi te një popull luftarak e i fuqishëm, t'i luftoni ata ose të dorëzoheni (ta pranojnë fenë islame), e nëse përgjigjeni (në thirrje), Allahu ju jep shpërblim të mirë, e nëse nuk dilni sikurse mbetet pa dalë më parë, Ai ju ndëshkon me një dënim të padurueshëm. [4:16]

Kur arritën në Maan të Jordanisë, u informuan se perandori bizantin Heraklius kishte dërguar 100000 luftëtarë. Edhe 100000

¹⁵⁵ <http://derprophet.info/inhalt/das-leben-mohammeds4.htm/#Belagerung%20von%20Taif>

luftëtarë arabë, nga fiset aleate arabe, iu ishin bashkangjitur forcave bizantine. Për të përballuar humbjen, paraprakisht Muhamedi, sajoi ajetin:

Thuaj: "Ç'prisni për ne tjetër, pos njëres nga dy të mirat (o fitore, o xhenet)? Ndërsa ne presim për ju, që nga ana e Allahut, ose nëpërmjet duarve tona, t'ju godasë me dënim. Pra, ju pritni, e bashkë me ju presim edhe ne". [9:52]

Forcat kundërshtare u përballën në Balka, por forcat myslimane u tërhoqën në fshatin Mutah. Në këtë betejë forcat myslimane u mundën nga forca bizantine dhe aleatët e tyre, fiset arabe.

Gjasat e xhihadistëve për fitore nuk ishin aspak reale, por, megjithatë, Muhamedi sajoi ajete kundër atyre që nuk dolën në këtë luftë dhe atyre që ikën nga fushëbeteja:

O ju që besuat, ç'është me ju, që kur ju thuhet: "Dilni në (luftë) rrugën e Allahut!", ju u rënduat në vend. A mos ishit më të kënaqur me jetën e kësaj bote sesa me atë të së ardhmes? Përjetimi i jetës së kësaj bote ndaj asaj të së ardhmes nuk është asgjë. [9:38]

Nëse nuk dilni (në luftë), Ai do t'ju dënojë me një dënim të rëndë; ju zëvendëson me një popull tjetër dhe Atij nuk i bëhet fare dëm. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë. [9:39]

Nëse nuk e ndihmoni atë (Muhamedin), atë pra, e ka ndihmuar All-llahu, kur e përzunë ata që nuk besuan të dytin prej të dyve. Kur ishin në shpellë, ai (Muhamedi) i tha shokut të vet (Ebu Bekrit r. a.): "Mos u brengos, vërtet Allahu është me ne!" E Allahu zbriti qetësinë (sekinën) e Vet mbi të, dhe e fuqizoi me fuqi që ju nuk e patë dhe e bëri fjalën e atyre që nuk besuan më të ulëtën, kurse fjala e Allahut është më e larta. Allahu është i Fuqishmi, i Urti. [9:40]

Dilni me lehtësi ose vështirësi, dhe luftoni me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj në rrugën e Allahut; kjo është për ju më e dobishmja, nëse e dini. [9:41]

Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen në Allahun: "Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju". E shkatërrojnë veten e tyre; Allahu e di se ata janë rrenacakë. [9:42]

Allahu ta fali ty gabimin, se atyre u dhe leje para se të bëhej për ty e qartë se cilët ishin të drejtë dhe t'i dije me kohë rrenacakët. [9:43]

Ata që besojnë Allahun dhe botën tjetër, nuk të kërkojnë leje për të mos luftuar me pasurinë dhe veten e tyre. Allahu i di të sinqertit. [9:44]

Vetëm ata që nuk besojnë Allahun dhe botën tjetër dhe që zemrat e tyre janë të

dysshimta, të kërkojnë leje, pra ata, sillen vërdallë në dyshimin e tyre. [9:45]

E sikur të kishin dëshiruar ata të dalin, do të bënin për të (për luftë) ndonjë përgatitje, por Allahu nuk e pëlqeu ngritjen e tyre, ndaj i zbrapsi, dhe atyre iu është thënë: “Rrini me të paafit.” [9:46]

Edhe sikur të dilnin me ju, ata nuk do t’ju shtonin tjetër pos ngatërresës dhe shumë shpejt do ta përçanin mesin tuaj, duke kërkuar t’ju turbullojnë. E ndër ju ka të tillë që i dëgjojnë ata. Allahu i di shumë mirë hipokritët. [9:47]

Ata edhe më parë tentuan përçarjen tuaj, t’i ngatërruan çështjet derisa të erdhi e vërteta dhe ngadhënjeu vendimi i Allahut, përkundër asaj që ata e urrenin. [9:48]

Këto ajete, si edhe qindra të tjera, dëshmojnë se *Kurani* nuk është aspak libër i shenjtë e hyjnor i Zotit, por njësi platformë, respektivisht kanun i Muhamedit për mobilizim luftarak, për rregullimin e tatimit, ndarjen e plaçkës, të robërve..., për sanksionimin e sundimit absolut të tij, të kamufluar si sundim i “Të Dërguarit të Allahut”etj.

Pas kësaj beteje, Muhamedi vendosi njësi tatim ekstra ndaj jomuslimanëve, specifikuar për besimtarët çifutë dhe kristianë, të cilën e quajti *xhizje* dhe e legalizoi përmes këtij ajeti:

Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloi Allahu dhe I Dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur. [9:29]

Nga përmbajtja e këtij ajeti rezulton se duhet të luftohen të gjithë jomuslimanët, ndërkaq çifutët dhe kristianët të tolerohen, por pasi të paguajnë *xhizjen* (haraçin).

Uzurpimi i Mekës¹⁵⁶

Në shtator të vitit 630, muajin e shenjtë për muhamedanët, Ramadan, viti 8 i Kalendarit Haxhri, pas humbjes në Mutah,

¹⁵⁶ <http://www.derletzteprophet.info/36-die-eroberung-von-mekka>.

Muhamedi komandoi uzurpimin e Mekës. Megjithëse kishte një marrëveshje për armëpushim, ai e injoroi atë marrëveshje dhe rreth 10000 xhihadistë e sulmuan Mekën. Shumica e mekasve ishin arratisur nga frika. Vetëm 28 veta vdiqën gjatë mbrojtjes së Mekës.

Sapo nënshtrori Mekën, Muhamedi urdhëroi "të pastrohet" Qabeja dhe qyteti nga bustet dhe reliktet pagane. Ai shpalli amnisti për të gjithë ata që konvertohen në islam, me përjashtim të 10 vetave, kundër të cilëve ai ishte përcaktuar të hakmerrej. Mes tyre urdhëroi vrasjen e Sarës, bijë e fisit Banu Abdalmutallib, sepse ajo e kishte kritikuar dhe denigruar Muhamedin. Edhe skllavja e Ibn Khatal, Mikjas, këngëtare, dhe pronari i saj, vriten me urdhër të Muhamedit, me arsyetim se kishte kënduar këngë ironike kundër "profetit". Disa të tjerë, që ishin në listë të atyre që duhej të vriteshin, pasi i kërkuan falje Muhamedit dhe pasi u konvertuan, ai i amnistoi.

Për këtë rast Muhamedi sajoi ajetin:

Muaji i shenjtë (i sivjetmi) është për muajin e shenjtë (të vjetit), e shenjtërit janë masë ndëshkuese. Pra, kush ju sulmon juve, kthejani sulmin atij po në atë masë dhe kini frikë nga Allahu e ta dini se Allahu është me të devotshmit. [2:194]

Formulim i përçartë, ala-Muhamed...

Ja çfarë (dez)informon hadithi vijues:

Transmetuar nga Ibn Abasi: Pejgamberi i Allahut ka thënë: "Nuk ka më tërheqje pas këtij pushtimi të Mekës. Vetëm nëse ju jeni të thirrur nga udhëheqësit myslimanë për xhihad, atëherë duhet të tërhiqeni menjëherë dhe të ndiqni thirrjen"¹⁵⁷.

Beteja pranë Hunejnit

Në tetor të vitit 630, Muhamedi ndërmori ekspeditë të re ushtarake në rrethina të Hunejnit. "Shumica e degëzimeve të fisit Havazin, të

¹⁵⁷ Bukhari 4:52:311;

<http://derprophet.info/inhalt/das-leben-mohammeds4.htm/#Eroberung%20von%20Mekka>.

udhëhequra nga Ibn Malik, u mblohdhën për të mbrojtur lirinë e tij. (...) Për këtë fushatë ishin mobilizuar rreth 12 mijë trupa”¹⁵⁸.

Forcat xhihadiste të Muhamedit mundën pjesëtarët e fisit Havazin dhe zunë robër rreth 9 mijë gra e fëmijë dhe plaçkitën shumë krerë bagëtish. Për këtë betejë, Muhamedi sajoi disa ajete. Këtu po sjellim vetëm dy prej tyre:

“Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë, dhe me gjerësinë e saj që e kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zbrapsët (ikët)”. [9:25]

“Pastaj Allahun zbriti qetësinë e vet në të dërguarin e Tij dhe në besimtarë, zbriti një ushtri që ju nuk e patë, i dënoi ata që mohuan, e ai ishte ndëshkim ndaj mosbesimtarëve”. [9:25]

Muhamedi, edhe kësaj radhe, arsyetoi fitoren e forcave të tij xhihadiste me ndihmën e Allahut të tij.

Rrethimi i Taifës

Po në vitin 630, pas betejës në Hunain, ndodhi ekspedita tjetër, tash kundër Taifës (rreth 70 km në juglindje të Mekës). Banorët e saj u barrikaduan në kështjellën e tyre. Muhamedi dhe xhihadistët e tij rrethuan Taifën, por, në pamundësi për ta marrë, pas 20 ditëve, u tërhoqën. Por me presionin e vazhdueshëm, pas një viti, edhe banorët e Taifës, nga frika se do të sulmoheshin përsëri, detyrohen të konvertohen në islam¹⁵⁹.

Pas pushtimeve të Mekës e Taifës, Muhamedi zgjeroi territorin e tij sundues. Ai vendosi të caktojë ndihmat që duhej të jepnin banorët, për të varfrit dhe përfalangat e tij xhihadiste. Këto ndihma ai i ka sanksionuar në ajetet: 9:58-60.

¹⁵⁸ Theodor Néldeke (orientalist, i lindur në vitin 1836 në Hamburg, vdekur 1930 në Karlsruhe), “Das Leben Mohammeds” / Jeta e Muhamedit” (1863), f. 156.

¹⁵⁹ <http://derprophet.info/inhalt/das-leben-mohammeds4.htm/#Belagerung%20von%20Taif>.

Meqë kishte informata se banorët e stepave, edhe pse ishin konvertuar në islamë, sa për të mbijetuar dhe për të mos paguar tatim ekstra, nuk po e praktikonin tamam ritin e tij *isla*, Muhamedi sajoi ajetet, të cilat përmbajnë kërcënime për ata që nuk janë besimtarë të vërtetë: 9:90-99. Për rabinët dhe priftërinjtë, që kishin grumbulluar pasuri (ari, argjend) nga besimtarët e tyre, por që nuk po e jepnin për të ndihmuar falangat muhamedane, Muhamedi sajoi ajetet vijuese:

O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudinje, rabinët, dhe e të krishterëve, priftërinjtë, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e Allahut, lajmëroi për një dënim të dhembshëm. [9:34]

Atë ditë kur ajo (pasuri e deponuar) fërgohet në prushin e xhehenemit, e me të (ashtu zharavë) lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t'u thuhet): "Kjo është ajo që e depozituat për veten tuaj, pra shijoni atë që e depozitonit!" [9:35]

Allahu bleu prej besimtarëve shpirtat dhe pasurinë e tyre me xhenet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. (Allahu dha) Premtim, të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kuran. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzoju tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. [9:111]

Edhe përmbajtja e këtyre ajeteve dëshmon se Muhamedi po zhvillonte "luftëra të shenjta", kryesisht për interesa materialë, për pasurimin e tij dhe të bashkëluftëtarëve të tij xhihadistë.

Pasi e kishte zgjeruar shumë territorin, të sunduar prej tij, Muhamedi u përqendrua në konvertimin e përdhunshëm, sidomos të paganëve. Për këtë qëllim, ai sajoi ajete përkatëse (ose urdhëroi këshilltarë poetë që t'i sajnin ato). Ja disa prej tyre:

Denoncim nga Allahu dhe i dërguari i Tij ndaj idhujtarëve me të cilët ju patët lidhur kontratë. [9:1]

Pra, ju (idhujtarë) qarkulloni nëpër tokë (lirisht) katër muaj, e dijeni se fuqinë e Allahut nuk mund ta bëni të paaftë dhe se Allahu i mposht mohuesit". [9:2]

Dhe (ky është) një kumtim nga Allahu dhe i dërguari i Tij drejtuar të gjithë njerëzve në ditën e haxhit të madh, se Allahu është tërhequr prej (marrëveshjes së) idhujtarëve, e njëkohësisht edhe i dërguari i Tij. Po nëse pendoheni, do të jetë më mirë për ju, e nëse ia ktheni shpinën (rrugës së drejtë), ta dini se nuk mund t'i shpëtoni (ndjekjes së) Allahut. E përgëzojini ata që mohuan me një dënim të

padurueshëm. [9:3]

Pos atyre idhujtarëve me të cilët keni lidhur marrëveshje, e të cilët nuk ju kanë shmangur asgjë dhe nuk e kanë ndihmuar askënd kundër jush, pra, edhe ju përmbushni marrëveshjen e tyre deri në afatin e caktuar. S'ka dyshim se Allahu i do të devotshmit. [9:4]

E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t'i gjeni, robëroni dhe ngujoni ata, e vëruni pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatën, atëherë lëshojuni rrugën, se vërtet Allahu është mëshirues. [9:5]

Si mund të kenë idhujtarët besë (marrëveshje) tek Allahu dhe tek i dërguari i Tij, përveç atyre me të cilët keni lidhur marrëveshje pranë xhamisë së shenjtë (Qabesë), e derisa ata i përmbahen (marrëveshjes) përmbahuni edhe ju. Allahu i do ata që ruajnë besën. [9:7]

"Si (mund të kenë besë) ata, të cilët nëse ju mundin, nuk përfillin ndaj jush as farefisni e as marrëveshje. Ata ju bëjnë lajka me fjalët e tyre kurse zemrat e tyre kundërshtojnë ngase shumica e tyre janë besëthyes. [9:8]

“Idhujtarë” janë banorët paganë të Mekës. Me ta Muhamedi kishte lidhur një marrëveshje armëpushimi, të cilën e shkeli. Nga përmbajtja e saj rezulton vendosmëria dhe rreptësia e tij për luftimin e tyre.

Në prag të vdekjes, Muhamedi la këtë porosi:

“Raporton Said bin Xhubejr:

Ibn Abas ka thënë: "E enjte. Çfarë gjërash të mrekullueshme kanë ndodhur të enjten?" Pastaj ai filloi të qante. Ai më tej tha: "Të enjten u përkeqësua gjendja shëndetësore e të Dërguarit të Allahut", dhe ai tha: "Sillni mjetet që të shkruaj diçka për ju, që ju të mos gaboni kurrë". Njerëzit e pranishëm kishin mendime të ndryshme. Megjithatë, njerëzit nuk duhet të kishin mendime të ndryshme në prani të Profetit. Ata thanë: "I Dërguari i Allahut është sëmurë rëndë". Profeti ka thënë: "Më mirë është të më lini vetëm në këtë gjendje, sesa të thirreni në emrin tim". Në shtratin e vdekjes Profeti i dha tre urdhra: "Dëboni jehudinjtë e kristianët nga Gadishulli Arabik, respektoni dhe jepuni dhurata delegacioneve të huaja, siç keni parë se si veproja unë". E kam harruar urdhrin e tretë¹⁶⁰.

¹⁶⁰ Bukhari/Buhariu, 4:52:288.

Pra, nga përmbajtja e këtij hadithi rezulton se Muhamedi ka lënë amanete që të luftohen me ngulm jomyslimanët.

Ndërsa ajeti i fundit që ka sajuar Muhamedi, duhet të jetë ky:

(...) Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe. (...) [5:3]

Nëse kjo është e vërtetë, siç (dez)informojnë islamologët, atëherë rezulton se *Kurani*, në këtë formë e në këtë radhitje "zyrtare" që ka tani, nuk është i kohës para vdekjes së Muhamedit, përndryshe, ky ajet do të duhej të ishte ajet përmbyllës i *Kuranit*. Po kështu, varianti i tanishëm i *Kuranit* nuk është nga koha e Muhamedit, sepse ai nuk e ka redaktuar vetë as ka angazhuar ekip për përmbledhje, radhitje dhe redaktim.

Gjatë viteve 623-632, Muhamedi ka pasur angazhim kryesor betejat agresive, sulmet plaçkitëse të karvanëve, sulme të fiseve, rëndom pas faljes së namazit të mëngjesit dhe të *iqindisë* (lutjes së tretë ditore, rreth tri orë pas mesdite), kur njerëzit ishin në gjumë. Prandaj mund të konstatohet se ai ka qenë një personalitet tokësor, me prirje kriminale për sundim autoritar, por që për popullin arab ka imponuar ndryshime të mëdha, duke e çuar drejt faktorizimit, si fuqi botërore.

Muhamedi vdiq ditën e hënë, më 8 qershor 632. Kufoma e tij që harruar në dhomë të Aishes, dhe natën e së mërkurës e kanë varrosur. "Trupi i profetit që mbuluar me një mantel. Meqë të gjithë po merreshin me zgjedhjen e pasuesit, askush nuk po mendonte ta lante dhe ta varroste"¹⁶¹.

Nga paraqitja kronologjike, tabelare, e veprimtarisë luftarake të Muhamedit gjatë viteve 623-632, rezulton se ai, aksidentalisht, duhet të jetë katapultuar në sundimtar të Medinës dhe, me ekspansion të tij

¹⁶¹ Fatima Mernisi, "Derpolitische Harem / Muhamed und seine Frauen", Herder Verlag, Freiburg 1992, f. 51; Autorja MERNISI ka cituar historian e islamit Muhamed TABARI.

agresiv luftarak, edhe i Mekës dhe rrethinave të mëdha të gadishullit “Arab”. Ndoshta më meritori për sundimin e tij është vetë fisi i Muhamedit, i cili mori vendim për ta vrarë atë, por nuk ia doli, sepse Muhamedi, me ndihmë të Ebu Bekrit, ia doli të arratisë në Jatribë (Medinë). Atje, me rreth 70 ithtarë të tij, u imponua si forcë luftarake ndaj fiseve të përvuajtura beduine të besimeve fetare pagane e jehudi.

Angazhim paqësor i Muhamedit mund të quhet vetëm ndërmjetësimi i tij mes fiseve të armiqësuar në Medinë. Aty e tutje, kënaqësia që ndiente nga kusaria ndaj karvanëve, e tjetërsoi Muhamedin dhe e bëri tepër agresiv e luftarak, por, gjithsesi, të suksesshëm. Kjo është e kuptueshme, sepse atyre fiseve u mungonte aftësia e organizimit të mbrojtjes se tyre, qoftë edhe vetëm kundër një bande muhamedane, numerikisht tejet të vogël.

Sajimi i dogmës së tij, tepër agresive, e abrogoi shumicën e formulimeve të tij, në dukje paqësore, gjatë kohës së qëndrimit në Mekë, gjatë viteve 610-622, dhe nga ajo kohë deri tani, solli pasoja të mëdha për njerëzimin. Kushdo që e lexon *Kuranin*, mund të bindet për dallimin e madh mes ajeteve të sajura nga Muhamedi me bashkëpunëtorë, gjatë viteve në Mekë, dhe atyre të sajura në Medinë. Rëndom, për këtë arsye, flitet për seleksionim të sureve paqësore Mekës dhe atyre shpatore medinase.

Myslimanët fundamentalistë, në fakt të gjithë myslimanët, i arsyetojnë të gjitha sulmet plaçkitëse të karvanëve dhe agresionet luftarake të Muhamedit. Sipas tyre, ato janë të drejta, për vetëmbrojtje, çlirimtare, të udhëzuara e të miratuara nga Allahu. Dhe, meqë numri i myslimanëve duhet të jetë rreth një miliard veta, edhe jomyslimanët janë detyruar ta pranojnë muhamedanizmin për fe legjitime botërore, edhe pse baza e tij dogmatike (*Kurani* dhe hadithet) përbajnë përcaktime eksplicite diskriminuese, shoviniste, agresive, fashistoide.

Fatkeqësisht, institucionet ndërkombëtare, ta zëmë OKB-ja, nuk kanë formuar komisione ekspertësh për t'i vlerësuar religjionet, në

bazë të përmbajtjes së dogmave të tyre dhe për të marrë qëndrime përkatëse ndaj tyre.

Lavdërimet dhe miratimet që u bëhen mashtrimeve të klerikëve myslimanë dhe dogmës së tyre fetare nuk i ndihmojnë myslimanët. Ato s'mund të shkojnë në interes tjetër, veçse në interes të ruajtjes së injorancës ndër myslimanët dhe të lloj-lloj sundimtarëve.

Myslimanët duhet të ndihmohen që të ndodhë çmitizimi i *Kuranit*, si vepër e krijuar nga Muhamedi me bashkëveprimtarë, dhe assesi as personazhi muhamedan, i emëruar Allahu (sipas Zotit pagan të hënës).

Në qoftë se myslimanët vazhdojnë të besojnë se *Kurani* është vepër e Allahut, atëherë ata do të ndihen të detyruar t'i zbatojnë udhëzimet, porositë e urdhrat diskriminuese, shoviniste, agresive, fashistoide, në emër të Allahut, kundër jomyslimanëve, por edhe urdhrat diskriminuese e shoviniste kundër vetë myslimanëve dhe, sidomos, kundër grave myslimane.

Pjesë e lirisë së praktikimit të fesë islame janë edhe krimet që ka bërë Muhamedi atëherë, por që myslimanët, edhe sot, i arsyetojnë dhe i madhërojnë si të drejta.

Pjesë e lirisë së praktikimit të fesë islame janë edhe udhëzimet e urdhrat për krime, që tani po ushtrohen në botë, të cilat nxirren nga urdhëresat e sanksionuara në *Kuran!*

Pothuaj secili krim, që po bëjnë aktualisht fundamentalistët myslimanë, del nga përcaktimet kuranore!

Fatmirësisht, rreth 95 % e myslimanëve nuk janë fundamentalistë! Fatkeqësisht, rreth 5 % (pra, rreth 50 milionë) e tyre, që janë fundamentalistë, selefistë, vehabistë..., janë numër i madh për të rrezikuar vazhdimisht bashkëjetesën e harmonishme dhe paqen sociale në çdo vend të botës!

I. 4. Muhamedi - vdekja nga helmimi

Për mënyrën e vdekjes së Muhamedit është spekuluar dhe spekulohet shumë, sepse mënyra e vdekjes së tij e vë në pikëpyetje nëse Muhamedi ishte apo jo profet.

Njëri nga variantët është ai i helmimit të tij nga një grua çifute, për motive hakmarrjeje.

Sheik Jaseral-Habib¹⁶² në portalin e tij ka ofruar të dhëna burimore për dy variantet kryesore të helmimit të Muhamedit. Për të vërtetuar variantin e helmimit të tij, Al-Habib ofron dëshminë e bashkëveprimtarit të Muhamedit, Abdullah in Masaud: “Unë jam i gatshëm të betohem nëntë herë se Profeti është vrarë, por nuk jam i gatshëm të betohet qoftë vetëm një herë, se ai nuk është vrarë”¹⁶³.

Variantin e helmimit të Muhamedit nga një grua çifute, e kanë përhapur ithtarët e kalifëve Ebu Bekr dhe Ebu Omer, ndërsa ithtarët e kalifit Ali përfaqësojnë variantin se helmimi i Muhamedit ishte komplet nga kalifët Bekr dhe Omer, përmes vajzave të tyre, Aishe dhe Hafsa. Motivi i helmimit ishte pengimi i trashëgimisë së sundimit të Muhamedit nga Aliu, i cili ishte djalë xhaxhai dhe dhëndër.

Ithtarët e Ebu Bekrit dhe Omerit thonë se, pas Betejës në Khaibar (maj 628), kur u mundën çifutët, çifutja Zainab bint Al-Harith i ofroi Muhamedit një banket pajtimi. Ajo duhet ta ketë helmuar mishin e deles, për t’u hakmarrë për krimet e falangës së Muhamedit. Pasojë e atij helmimi duhet të ketë qenë vdekja e tij e parakohshme¹⁶⁴.

Sheik Jaseral-Habib e përjashton mundësinë e këtij helmimi, sepse ajo betejë kishte ndodhur katër vjet para vdekjes së Muhamedit.

Për variantin e dytë, sheik Al-Habib ofron edhe hadithe të bazuara në rrëfimet e Aishes, e cila ka dashur të kamuflonte vrasjen:

¹⁶² <http://www.alqatrah.net/de/edara/index.php?id=72>.

¹⁶³ Musnad Ahmad, vëll. 1, f. 408; Mojam Al-Tabarani, vëll. 10, f. 109, Musannaf Al Sanaani, vëll. 5, f. 268.

¹⁶⁴ Jaseral-Habib ofron burimin: Al-Bukhari, vëll. 4, f. 66 dhe Sunan Al-Darmi, vëll. 1, f. 33.

*Aishja ka rrëfyer: “Pejgamberi i Allahut më tha në shtratin e vdekjes: “Aishe, pasi kam konsumuar mish të helmuar, kam pasur dhimbje. Tani është koha që zemra ime të ndalet për shkak të këtij helmimi”.*¹⁶⁵

Sheiku Al-Habib ofron edhe dëshmi tjetër burimore, për të argumentuar bindjen e tij, se helmimi i Muhamedi ishte komplot:

Imamët¹⁶⁶ kanë dëshmuar se gjyshi i tyre, Profeti, në ditët e tij të fundit është helmuar nga Aishja dhe Hafsa me urdhër të etërve të tyre, Ebu Bekrit dhe Omerit. Ebu Bekri dhe Omeri konspiruan komplotin për marrje të fronit pas vdekjes së Profetit, meqë ai kishte thënë se pasardhësi i tij i ligjshëm do të jetë kushëriri dhe dhëndëri i tij, imam Ali (Paqja qoftë mbi të!).¹⁶⁷

Autori al-Habib citon edhe hadithen e përcjellë nga Ali Ibrahim al-Kumi:

Profeti i ka thënë Hafsës: “Unë po të them një sekret. Nëse ti e dekonspiron, Allahu, engjëjt e tij dhe njerëzit do të të mallkojnë”. “Pra, çfarë sekreti?”, e pyeti Hafsaja e befasuar.

Profeti ka thënë: “Është e mundur që Ebu Bekri, pas vdekjes sime të uzurpojë kalifatin dhe pushtetin dhe të pasohet nga babai yt, Omeri”.

Hafsaja e habitur: “Kush të ka njoftuar Ty?”

“Allahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëpranishëm më njoftoi”, - iu përgjigj Profeti (Paqja qoftë mbi të dhe familjen e tij të pastër!).

Në të njëjtën ditë Hafsaja dekonspiroi sekretin para shoqes saj, Aishes. Pastaj Aishja ia rrëfeu sekretin babait të saj, Ebu Bekri. Ebu Bekri takoi Omerin dhe i tha: “Vajza ime, Aishja, më tha një sekret, bazuar në atë çfarë i kishte rrëfyer Hafsaja, por meqë unë shumë herë nuk i besoj Aishes, pyete ti vajzën tënde, Hafsanë, meqë ajo është e saktë, dhe më trego”.

Omeri shkoi te Hafsaja dhe e pyeti. Fillimisht Hafsaja u habit dhe e mohoi atë. “Nëse vërtet ke dëgjuar këtë sekret, na trego, që ne të mund të kapim

¹⁶⁵ Sahihal- Bukhari, vëll. 5, f. 137.

¹⁶⁶ Është fjala për nipat e Muhamedit, djemtë e Fatimes dhe Aliut.

¹⁶⁷ <http://www.alqatrah.net/de/edara/index.php?id=72>

pushtetin menjëherë dhe ta heqim qafe Muhamedin”, i foli Omeri asaj. Hafsaja pranoi: “Po, ai ma ka thënë”. Në këtë kohë ata të katërt u bashkuan dhe konspiruan për të helmuar Profetin.¹⁶⁸

Për të përforcuar këtë variant, ofrohet edhe hadithja tjetër:

Aishja ka rrëfyer: “Kur Pejgamberi i Allahut u sëmur nga një sëmundje vdekjeprurëse, ai na tha: “Mos më shti ilaçe në gojë”, por ne nuk e dëgjua, sepse asnjë pacient nuk i preferon ilaçet. Pra, ne i futëm substanca në gojën e tij. Kur ai u zgjua, i habitur dhe pyeti: “Kush e bëri këtë? A nuk ju kisha urdhëruar të mos e bëni këtë gjë?”

Ne u arsyetuam: “Xhaxhai yt, El-Abas, ishte i mendimit që ti mund të kishe një tumor lateral. Profeti pati thënë: “Këtë sëmundje e shkakton djalli e mua nuk mund të më ngjitet”.

Profeti i urdhëroi që të gjithë në shtëpi se duhet të merrnim nga e njëjta substancë, përveç El-Abasit.¹⁶⁹

Sheik Jaseral-Habib citon edhe ajetet pasuese për të përforcuar argumentimin e tij, se Muhamedi ishte viktimë e helmimit komplotist nga dy ihtarët e tij më të ngushtë (Ebu Bekri dhe Omeri) dhe dy vajzat e tyre, që duhet të kenë qenë gratë më të dashura të Muhamedit (Aishja dhe Hafsaja):

Nëse ju të dyja pendoheni tek Allahu, sepse zemrat tuaja tanimë kanë rrëshqitur, e nëse bashkëveproni kundër tij (Muhamedit), ta dini se Allahu është mbrojtës i tij, si dhe Xhibrili dhe besimtarët e ndershëm; e kur është kështu, edhe engjëjt i dalin në ndihmë. [66:4]

Përmbajtja e ajetit, ndoshta aksidentalisht, i përngjan rastit të pjesëmarrjes së tyre në komplot.

¹⁶⁸ Sheik Al/Habib ofron burimin: Tefsir Al-Kummi, vëllimi 2, faqe 367 dhe Bihara-Anwar e Allama el-Mexhlisi, vëll. 22, faqe 239).

¹⁶⁹ Cituar sipas "Sahih Bukhari, vëllimi 8, faqe 42 "Ai nuk ishte me ty. "; Sahih Muslim, Sahih Bukhari vëllimi 7, faqe 42; Musnad Ahmed Ibn Hanbel, vëllimi 6, faqe 53; Biografia e Pejgamberit nga Ibn Kethiri, vëllimi 4, faqe 446).

Atyre që mohuan, Allahu u sjell si shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fe) ata të dy dhe ata nuk mundën t'i mbronin ato fare tek Allahu, e atyre djave u thuhet: "Hyni në zjarr së bashku me ata që hyjnë!" [66:10]

Edhe ajeti tjetër, me shembujt e grave të "profetëve" pararendës, ofron mundësi spekulative për krahasime:

Muhamedi nuk është tjetër, vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit. [3:144]

Këtë ajet Muhamedi duhet ta ketë sajuar pas Betejës së Uhudit, për të tërhequr vëmendjen e ithtarëve.¹⁷⁰ Për autorin Habibi, mëdyshja "nëse vdes ose mbytet" te profeti nuk është mëdyshje, sepse Allahu nuk ka shpreh mëdyshje, por paralajmërim të sakta: vrasjen e Profetit.

Edhe një paralajmërim tjetër i Muhamedit, i përcjellë si hadithe, është pikant në kuadër të teorisë së komplotit:

... Profeti ka thënë: "Në ditën e gjykimit, kur unë do të jem te burimi në pellg për t'u sjellë ujë shokëve të mi të etur, një grup shokësh të mi do të vijnë për të pirë ujë, por engjëjt do t'i përndjekin për në ferr. Unë do të them: "Oh, Zot, shokët e mi?!" Perëndia do të përgjigjet: "Ti nuk e di se çfarë kanë bërë ata pas vdekjes sate. Ata degraduan veten e tyre duke na braktisur (apostazi)". Më pas do të vijë për të pirë ujë edhe një grup tjetër nga ish-shokët e mi, por engjëjt do t'i dëbojnë edhe ata për në ferr (xhehenem). Unë përsëri do të thërras: "Oh, Zot, këta janë shokët e mi?!" Perëndia do të më përgjigjet sërish: "Ti nuk e di se çfarë kanë bërë ata pas vdekjes sate. Ata degraduar veten e tyre duke na braktisur". Vetëm një numër i vogël nga shokët e mi do të shpëtojnë, si devetë e braktisura në shkretëtirë."¹⁷¹

Ky (dez)informim flet për karakterin, përcaktimin e mendësinë e ithtarëve të hershëm të Muhamedit, që tashmë, me gjuhë të politizuar,

¹⁷⁰ Sheik Jaseral-Habib, po aty.

¹⁷¹ Sahih Al-Bukhari, vëll. 7, f. 206.

po i quajnë salafistë. Që disa dekada ekziston një rrymë agresive për ripërtërije të islamit, për t'u bërë myslimanët siç ishin të parët. Ata (salafistët) vetë Muhamedi i paskësh diskredituar si devijantë dhe dezertorë (apostazistë)!!!

Për ta rritur pikanterinë muhamedane të kësaj tematike kontroverze, po ofrojmë edhe një (dez)informim, që ia shton kontroversitetin mënyrës së vdekjes, respektivisht vrasjes së Muhamedit dhe, sidomos, komplotistëve të mundshëm dhe pasuesve të tij, meqë duhet të ketë lënë gjurmë në mendësinë kolektive të muhamedanët.

Imami i shkollës së drejtësisë malike, Malik ibn Enesi, transmeton se Profeti u ka parathënë martirëve (shehidëve), se ata do të shkojnë në qiell. Ebu Bekri i befusuar e pyet Profetin: "A nuk jemi edhe ne vëllezërit e tyre, të cilët u konvertuam në islam dhe si ata vepruam e luftuan për Xhihad?! Pra, pse nuk na jep lajmin e mirë, se edhe ne do të shkojmë në xhenet?!" Pejgamberi është përgjigjur: "Është e vërtetë që ju jeni vëllezërit e tyre, por unë nuk e di se çfarë do të bëni ju pas vdekjes sime."¹⁷²

Mbase ndokush e beson variantin e dytë të helmimit komplotist të Muhamedit, nga gratë dhe nga bashkëveprimtarët më të ngushtë të tij, por shumica e myslimanëve besojnë se atë e ka helmuar një grua çifute. Mua, në fakt, pak më intereson varianti i vërtetë i vdekjes së tij. Po ofroj sa më shumë informacione nga tradita islame, vetëm për të kuptuar mendësinë kontroverze të muhamedanëve. Edhe këto dilema të vdekjes së Muhamedit i kanë fraksionuar myslimanët në sekte, të cilat kanë luftuar barbarisht mes tyre, qysh në zanafillë të islamit.

Megjithatë, edhe dy klerikë egjiptianë, si miliona myslimanë të tjerë, nuk duan të besojnë se Muhamedi ishte viktimë e helmimit komplotist nga Ebu Bekri e Omeri. Sheik Saidal-Afani dhe sheik Muhamed Abd al-Salam, në një debat në televizionin egjiptian "Al-Rahme-TV", më 17. 01. 2009, mes të tjerash kanë thënë:

¹⁷² Cituar nga: Al Muattaaal-Malik ibn Enes (Anas), vëll. 2, f. 642.

“Çifutët janë popull i mallkuar, sepse shkaktojnë tërbimin e Allahut. Ata janë pjellë gjarpërinjsh e nepërkash, janë vrasësit e Profetit tonë Muhamed, vdekja e të cilit ishte pasojë e helmimit nga një grua çifute. Ne duhet ta dimë se çifutët janë vrasës të profetëve. Ata vranë profetin e drejtë Jahja (Gjon Pagëzuesin) dhe kokën e tij ia dhanë si dhuratë një prostitute izraelite. Ata vranë profetin Zakarija. Urrejtja jonë kundër tyre është e motivuar fetarisht dhe jo për shkak të tokës së pastër e të shenjtë që e ka bekuar Allahu, apo për shkak të Gazës a për shkak të Al-Akses etj.”¹⁷³

Islamologia dhe sociologia arabe, Fatima Mernisi, në studimin e saj(dez)informon se kur vdiq Muhamedi, besimtarët, duke u grindur për zënieën e vendit të tij sundimtar, harruan ta varrosin kufomën e tij. [Më konkretisht në kapitullin për islamin, si nacionalizëm arab].

Arabisti holandez, Hans Jansen, në monografinë e tij tejet analitike dhe informative për Muhamedin, paraqet rastin e helmimit në Khaibar, por të mbetur në tentativë. Çifutja Zejneb kishte provuar ta helmonte Muhamedin, por ai e ka hetuar se mishi ishte i helmuar. As kafshatën e parë nuk e kishte gëlltitur dhe e kishte nxjerrë jashtë, ndërsa shoku i tij, Bishri, kishte vdekur po nga ai helmim¹⁷⁴.

Rëndom, shumica e arabistëve, orientalistëve, islamologëve jomyslimanë pranojnë qëndrim konvencional: variantin e sajuar nga biografi i parë i Muhamedit, Ibn Isak¹⁷⁵. Edhe arabisti Jansen është orientuar sipas Ibn Is'hak. Citoj:

“Një ditë pasi pushtimi kishte përfunduar dhe Profeti i sigurt po ndiente kënaqësi, Zejneb bint Harith, një nga gratë e zëna robinja lufte, i dhuroi atij një dele të pjekur. Paraprakisht, ajo ishte informuar se Muhamedi preferonte më shumë shpatullën. Ajo helmon tërë delen, por shpatullën e helmoi më shumë. Atëherë ajo vendosi hellin e deles para Profetit. Ai mori

¹⁷³ <https://www.youtube.com/watch?v=RFCQH4eMNM4#t=18>

¹⁷⁴ Hans Jansen, Mohammad, eine Biographie, C. H. Beck Verlag, 2008, f. 362;

<http://www.amazon.de/Mohammed-Eine-Biographie-Hans-Jansen/dp/3406568580>.

¹⁷⁵ Ibn Is'hak ka jetuar në vitet 704-768, ai ka shkruar një mori veprash, por biografia për

Muhamedin çmohet orientimisht më e para dhe më e sakta;

http://www.eslam.de/begriffe/i/ibn_ishaq.htm.

shpatullën, e kafshoi, por nuk e gëlltiti. Bishri Ibn-el-Bara, i cili ishte pranë profetit, mori një copë nga helli dhe e gëlltiti. Profeti e pështyu kafshatën dhe tha: "Kjo kockë më tha se mishi është helmuar". Ai urdhëroi t'ia sillnin atë grua. Ajo pranoi. Kur ai e pyeti atë se pse ajo e kishte bërë këtë, ajo u përgjigj: "Ju e dini se çfarë krimesh i keni bërë popullit tim. Mendova me vete: "Nëse Ju jeni vetëm një mbret, kështu do të çliroheshim, por në qoftë se Ju jeni një profet, atëherë do të paralajmërohemi". Profeti urdhëroi që ajo të mos ndëshkohej. Bishri Ibn-el-Bara vdiq nga ai helmim".

Sipas disa rrëfimeve, - vazhdon (dez)informimin kjo “enciklopedi islame”, e publikuar në portalin “Elsam”, - rezulton se familja e Bishri Ibn-el-Bara nuk ia fali atë krim Zejneb bint Harith dhe prandaj e ekzekutuan me varje. Ndërsa burime të tjera thonë se ndaj saj nuk pati hakmarrje, sepse e kishte falur Profeti.¹⁷⁶

Tepër irritues është shkrimi i publikuar në revistën gjermane *Die Geschichte* (Historia), e cila ka publikuar shkrimin me titull: “Dëshmi se Muhamedi nuk e ka sajuar *Kuranin*”, citoj:

Njëherë një grua çifute provoi ta helmonte Muhamedin. Ajo pyeti miqtë e tij, cila pjesë e mishit i pëlqen atij. Pastaj ajo e helmoi këtë pjesë të mishit pa e vërejtur askush. Më vonë, kur Profeti deshi ta hante, mishi i foli: “Mos më ha mua, sepse jam i helmuar”.¹⁷⁷

Pse duhej t’u ofrohet lexuesve ky mashtrim kaq skandaloz?! Sikur të ishte ndonjë revistë islame, mund të (keq)kuptohej si propagandë për sajuesin e asaj feje, por pse revista gjermane dezinformon më shumë sesa propagandistët e islamit?!

Fatkeqësisht, disa njerëz dhe disa institucione jomyslimane janë të interesuar që myslimanët të jenë sa më besimtarë, respektivisht sa më injorantë...

¹⁷⁶ http://www.eslam.de/begriffe/z/zaynab_bint_harith.htm.

¹⁷⁷ <http://www.g-geschichte.de/forum/religion/2168-beweise-dafuer-mohammed-koran-erfunden-hat-2-a.html#post51016>.

I. 5. Muhamedi - seksomania poligamiste

Për Muhamedin nuk duhet të ketë qenë asgjë më komprometuese sesa shthurjet e tij morale në marrëdhënie me gratë. “Martesa” e tij me fëmijë 6-vjeçar dëshmon mendësinë e tij kriminale prej pedofili. Dhe kjo mendësi është e pranishme edhe sot në shoqëritë islame, ku janë të legalizuara “martesat” me vajza edhe 6-vjeçare, vetëm sepse atë e kishte praktikuar Muhamedi dhe prandaj duan ta imitojnë...

Fillimisht po paraqes një listë, por të pakompletuar, të grave të Muhamedit:

<u>Nr.</u>	<u>Emri e mbiemri</u>	<u>viti i martesës</u>	<u>pjesëtare e fisit</u>
1.	Khadixha (Hatixhe) Bint Khuvajlid	595 ¹⁷⁸	Kurejsh
2.	Savda Bint Zama	619 ¹⁷⁹	Benu Amir
3.	Sauda Bint Zama ibn Kajisibn Abd	619 ¹⁸⁰	Kurejsh
4.	Aishe Bint Abu Bakër as-Siddiq	619 ¹⁸¹	Kurejsh
5.	Hafsa Bint Umeribn ul-Hattab	625 ¹⁸²	Kurejsh
6.	Zajneb Bint Khuzejma	626 ¹⁸³	Banu Hilal
7.	Salama Bint Ebu Umejje	626 ¹⁸⁴	Kurejsh
8.	Hind Bint Abi Umajja/UmSelema	626 ¹⁸⁵	Kurejsh
9.	Berrehu (Xhuvrejrija) Bint Al-Harit (robinjë)	627 ¹⁸⁶	hebreje
10.	Zajneb (Barrah) Bint Xhahsh/	626 ¹⁸⁷	vajza e hallës

¹⁷⁸ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 102;

http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf

http://www.islamswomen.com/articles/khadijah_bint_khuwaylid.php

¹⁷⁹ Po aty;

¹⁸⁰ Fatima Mernissi, “Derpolitische Harem. . .”, HerderVerlag, Freiburg 1992, f. 102

¹⁸¹ Fatima Mernissi, vep. cit., f. 51.

¹⁸² JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 102;

¹⁸³ Po aty; El-Tabari, vol. 7. F. 150 dhe 216.

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁸⁴ https://de.wikipedia.org/wiki/Liste_der_Ahnen_und_Familienmitglieder_Mohammeds

¹⁸⁵ Fatima Mernissi, vep. cit., f. 113/137.

¹⁸⁶ JETA E PROFETIT MUHAMED, nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 102;

http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf

¹⁸⁷ Fatima Mernissi, vep. cit., f. 113;

http://www.islamswomen.com/articles/zaynab_bint_jahsh.php

ISLAMI, religion agresiv (?!)

- | | | |
|---|--------------------|--------------|
| 11. Remla (Habiba) Bint Ebu Sufjan | 628 ¹⁸⁸ | Kurejsh |
| 12. Safija Bint Hujajj | 629 ¹⁸⁹ | Banu Nadir |
| 13. Majmuna Bint Al-Harit | 629 ¹⁹⁰ | Havazive |
| 14. Maria al-Kibtijja (Bint Shaun)
egjiptiane | 629 ¹⁹¹ | Kopte |
| 15. Kila Bint Al-Ashath (sipas Tabarit) | 629 ¹⁹² | |
| 16. Rejhana Bint Zejd | 627 ¹⁹³ | Banu Kuraiza |
| 17. Fatima (Sara) Bint el-Dahabi ¹⁹⁴
(robinjë) | | hebreje |
| 18. Hind...(e martuar përpara me Ebu Sufjan) ¹⁹⁵ | | |
| 19. Sana Bint Esmael-Kripa ¹⁹⁶ | | Banu Harm |
| 20. Esma Bint el-Numan Bint Ebiel-Xhavn ¹⁹⁷ | | fëmijë |
| 21. Ghazijah Bint Xhabiri ¹⁹⁸ | | |
| 22. Khawlah Bint el-Hudayl ¹⁹⁹ | | |
| 23. Mulaykah Bint Davudiel-Laythiyyah ²⁰⁰ | | |
| 24. Shanba Bint Amrel-Ghifariyyah ²⁰¹ | | |
| 25. Aliyyah Bint Zabyan bint Amrbin Auf bint Kab ²⁰² | | |
| 26. Amrah Bint Yazid ²⁰³ | | |

¹⁸⁸ http://de.wikipedia.org/wiki/Familie_Mohammeds.

¹⁸⁹ http://de.wikipedia.org/wiki/Familie_Mohammeds.

¹⁹⁰ Fatima Mernissi, vep. cit. , f. 113

¹⁹¹ Maria ishte dhuratë e guvernatorit të Aleksandrisë; Al-Tabari, vëll. 39, 193.

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Maria_al-Qibtijya

¹⁹² Fatima Mernissi, vep. cit. , f. 229-230. ; El-Tabari, vol . 8, f. 39.

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁹³ http://bs.wikipedia.org/wiki/Rejhana_bint_Amr

¹⁹⁴ El-Tabari, vol. 39, f. 186; http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#UmmSalama

¹⁹⁵ http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_SoMany_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁹⁶ El-Tabari, vol. 39, f. 166;

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁹⁷ al-Tabari, vol. 10, f. 185; Buharî Vol. 7 Libri 63 No. 181, p. 131, 132.

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁹⁸ El-Tabari, vol. 9, f. 139;

http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

¹⁹⁹ El-Tabari, vol . 39, f. 166;

²⁰⁰ El-Tabari, vol. 39, f. 165;

²⁰¹ El-Tabari, vol. 9, f. 136;

²⁰² El-Tabari, vol. 9, f. 138 dhe vol. 39, f. 188.

²⁰³ http://www.muslimhope.com/Why_Did_Mohammed_Get_So_Many_Wives.htm#Umm_Salama

1. Khadixha (Hatixhe) Bint Khuvajlid Ibn Asad Ibn Abdal-Ussaibn Qusaïy (arab. : خديجة بنت خويلد). Duhet të ketë qenë kushërirë e Muhamedit, e lindur në vitin 555, vdekur në vitin 619. Ishte dy herë e martuar (me secilin burrë kishte nga një fëmijë). Burrat e saj ishin Abu Hala al-Tamimi dhe Utayyik (Atik) Ibn Adidh²⁰⁴. Ishte më e moshuar se Muhamedi rreth 15 vjet (burime të tjera thonë 25), por ishte pasanike. U martua me Muhamedin në vitin 594. Jetuan bashkë rreth 25 vjet dhe patën katër vajza (Zejneb, Rukaija, Umm Kulthum dhe Fatime) e dy djem (Al-Qasim dhe Abdullah), të cilët vdiqën që në fëmijëri të hershme. Njërën nga vajzat e tij, Fatimen, e martuan me Aliun, djalin e xhaxhait të Muhamedit.

Khadixha duhet t'i ketë folur Muhamedit (pasi kishte ëndërruar ajetin "Ikra" [96:1] në vitin 610, në shpellën e malit Hira, ku prej vitesh shkante për të medituar):

*"Bëhu i lumtur, o djali i xhaxhait tim dhe bëhu i besueshëm. Unë me të vërtetë betohem në Allah, i cili shpirtin tim e ka në duart e tij, se ti do të jesh i Dërguari i Allahut për njerëzit tanë."*²⁰⁵

Ky duhet të ketë qenë momenti tepër vendimtar, që Khadixha e bindi Muhamedin, se është "i dërguar" i Zotit.

Ajo filloi të blinte skllëvër, që t'i bëheshin shërbëtorë e roja fizike të Muhamedit, i cili kërcënohej nga kushërinjtë e tij, pjesëtarë të fisit Kurejsh. Ata skllëvër konvertoheshin në islam, besimin që po sajnin Muhamedi, Khatixha dhe bashkëveprimtarët e tyre.

2. Sevda bent Amir

Pas vdekjes së Khadixhas, Pejgamberi (s. a. v.) u martua me Sevdanë nga fisi Benu Amir, i ati i së cilës e kishte pranuar ndër të

²⁰⁴ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Khadidscha_Bint_Khuwaylid

Watt, W. Montgomery. "KHadiċja." Encyclopaedia of Islam, Second Edition. Edited by: P. Bearman, Th. Bianquis, C. E. Bosworth, E. van Donzel and W. P. Heinrichs. Brill, 2009. Brill Online. Missing Link International Bookseller. 30 May 2009.

http://www.brillonline.nl/subscriber/entry?entry=islam_SIM-4116.

²⁰⁵ Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, JETA E PROFETIT MUHAMED, f. 26;

parët islamin. Ajo ishte vejtshë e njërit prej shokëve myslimanë, që u shpërngulën në Abisini, por që vdiq gjatë kthimit në Mekë²⁰⁶.

3. Sauda Bint Zama ibn Qayisibn Abd Schams (arab.: سودة بنت زمعة). Kushëriri e Muhamedit, ishte e martuar me Al-Sukran Ibn Amr, njëri nga muhamedanët e parë, por ngeli e ve. Pas vdekjes së Khatixhasë, Muhamedi u martua së pari me Saudanë, pastaj me Aishen dhe gra të tjera, seriale.²⁰⁷

4. Aishe bint Abu Bakr as-Siddiq (arab.: عائشة بنت أبي بكر),²⁰⁸ emri i nënës Umm Rumman, duhet të ketë lindur në vitin 615 dhe vdiq më 17 ramadan 57 (kalendar islamik). Abu Bakri, babai i Aishes, ishte shok dhe kushëri i Muhamedit (fisi Kurejsh) dhe i konvertuari i katërt në islam. Martesa e Aishes me Muhamedin u bë në vitin 621, në moshën 6-vjeçare, ndërsa “konsumimi seksual” (siç shprehen myslimanët për dhunimin pedofil të Aishes nga Muhamedi) në vitin 624, në moshën 9-vjeçare. Pjesa më e madhe e haditheve vjen nga Aishja. Kur vdiq Muhamedi, më 08. 06. 632, Aishja ishte vetëm 18 vjeçe.

Aishja qe përfolur në një rast për amoralitet, por Muhamedi, për ta shpëtuar nga dënimi, sajoi këtë ajet:

“S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që barti pjesën e madhe (të shpifjes), i takon dënimi i madh”. [24:11].

Edhe një ajet i dedikohet një rasti kur Aishja dhe Hafsa e tallin Muhamedin për erën e ndyrë që i lëshonte goja, kështu që për këtë rast Muhamedi duhet të ketë sajuar ajetin vijues:²⁰⁹

“O ti pejtamber (o ti, që të është sjellë kumtesa nga qielli), pse ia ndalon vetes atë që Allahu ta lejoi? A kërkon me të pajtimin e grave tua? Allahu është

²⁰⁶ http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf.

²⁰⁷ Fatima Mernissi, vep. cit. , f. 102;

http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Sauda_Bint_Zama

²⁰⁸ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Aisha_Bint_Abu_Bakr

²⁰⁹ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Aisha_Bint_Abu_Bakr

mëkatfalës, mëshirues. [66:1]

5. Hafsa bint Umar Ibn al-Hattab (arab. : حفصة بنت عمر) ishte nga fisi Kurejsh. Emri "Hafsa" do të thotë "*luanësja e re*". Lindi në vitin 606 dhe vdiq në vitin 665. Me burrin e parë, Khumais Ibn Huzafa Al-Sahmi, u martua në moshën 12-vjeçare. “Kur i vdiq i shoqi, pas plagëve të marra në betejën e Uhudit, ajo ishte 21 vjeçe. Muhamedi u martua me të tre vjet pas hixhrit (625)²¹⁰”. Babai i saj, Umar, i ishte lutur Ebu Bakrit dhe Utmanit, për t’u martuar me vajzë të tij, por ata kishin refuzuar, sepse maniaku seksual, Muhamedi, kishte shfaqur vendimin për martesën me Hafsanë, për shkak të sharmit të saj.

Hafsaja kishte një ekzemplar të ajeteve të grumbulluara nga shënimet që mbanin bashkëveprimtarët e Muhamedit. Ajo ia dorëzoi komisionit që formoi kalifi Utman, për “kompletim” të *Kuranit*.²¹¹

6. Zejneb bint Huzajma ibn al-Harith (arab. : زينب بنت حزيمة). Lindi në vitin 593 dhe vdiq në vitin 623. Herën e parë ajo ishte martuar me djalën e Al-Harith (xhaxha i Muhamedit). Shpejt i vdiq burri i parë dhe pastaj u martua me vëllanë e burrit të sapovdekur, Abu Ubeida Ibn Al-Harith Ibn 'Abd Al-Mutalib, por edhe ky vdiq në betejën e Bedrës dhe Muhamedi u martua me të në muajin ramadan të vitit 622, kur ishte 29-vjeçe. U bë gruaja e 5-të e Muhamedit, por jetuan bashkë vetëm 8 muaj, sepse ajo vdiq shpejt.²¹²

7. Salama Bint Abu Umayya Al-Machzumiya (arab.: هند بنت أبي أمية) e njohur edhe si Umm Salama (arab.: أم سلمة), i përkiste fisit Kurejsh. E lindur në vitin 596, ajo vdiq më 680. Burri i parë i saj ishte

²¹⁰ JETA E PROFETIT MUHAMED , nga Leila Azzam dhe Aisha Gouvernuer, f. 102; http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf,
Versioni anglisht: http://www.amazon.de/Life-Prophet-Muhammad-Vitae-Islam/dp/1887752536/ref=la_B0026BTNMC_1_1?s=books&ie=UTF8&qid=1400514609&sr=1-1.

²¹¹ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Hafsa_Bint_Umar.

²¹² http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Zaynab_Bint_Khuzayma.

'Abdullah bin' Abdul Asad Makhzumi (djali i hallës dhe vëllai i gjirit të qumështit me Muhamedin; i konvertuari i njëmbëdhjetë). Ai vdiq në Betejën e Uhudit. Muhamedi u martua me Salamën në muajin Shual, më 326.²¹³

8. Xhujerija bint Haris²¹⁴ (جویریة بنت الحارث), e lindur më 608. Ishte e bija e El-Harith ibn Ebi Dirar, prijësit të fisit Benu Mustalik. Ajo u detyrua të martohej me Muhamedin, meqë xhihadistët, të komanduar nga ai, e kishin zënë rob lufte. Burri i saj ishte IbnSafvan, të cilin e vranë xhihadistët. Kur u detyrua të martohet me Muhamedin, 58-vjeçar, ajo ishte vetëm 18 vjeçe.

9. Zejneb Bint Xhahsh (arab.: زینب بنت جحش) ishte vajza e hallës së Muhamedit. Lindi më 592 dhe vdiq më 641. Nëna e saj ishte Umayma Bint 'Abd Al-Mutalib, halla e Muhamedit. Zejneb qe martuar me djalin e birësuar të Muhamedit, i quajtur Zejd ibn Harith. Sipas rrëfimit të islamologes dhe sociologes arabe, Fatima Mernisi, në librin e saj “Muhamedi dhe gratë”, Muhamedi shkon një ditë për t’u konsultuar me djalin e tij, Zejdin. Nuk e gjen aty. Gjen vetëm Zejneben duke rregulluar flokët. Me këtë rast Muhamedi dashurohet me të. Ai e detyron Zejneben të ndahet me bashkëshortin e saj dhe martohet me të në vitin 627. Farefisi këtë rast e përgojonnë në ekstrem, sepse deri atëherë nuk praktikohesh që babai të martohej me nusen e djalit. Për të përballuar diskreditimin, Muhamedi sajoi ajetet vijuese:

(Përkujto) Kur i the atij që Allahu e kishte shpërblyer (me besim) edhe ti i pate bërë mirë: "Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga All-llahu!", e ti e mbaje fshehtë në veten tënde atë që Allahu do ta zbulojë dhe u frikësohesh njerëzve, por më e drejtë është që t'i frikësohesh vetëm Allahut. E pasi Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzuar ty atë, e për të mos pasur

²¹³ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Umm_Salama_Hind_Bint_Abi_Umayya.

²¹⁴ http://bs.wikipedia.org/wiki/D%C5%Xhujerija_bint_Haris.

besimtarët vështirësi (mëkat) në martesë me gratë e të adoptuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i Allahut është kryer. [33:37]

Ky është një ajet tepër skandaloz e komplotist, i sajuar ekstra për rastin e dashurisë së tij në Zejnaben. Cili zot do të kishte qenë kaq idiot, që t'i vihet në shërbim një maniaku seksual?! Pra, Zejnebeja i kërkon divorcin burrit të saj, meqë Muhamedi e kishte urdhëruar “në emër të Allahut” për t’u bërë grua e tij. Këtë shans, siç (dez)informon studiuesja Fatima Mernisi, e kishte mirëpritur Zejnebeja, meqë kishte qenë e dëshpëruar për martesën e imponuar me ish-sklavin Zejd ibn Harith. Atë e kishte blerë dhe “çliruar” më herët Muhamedi, duke e shpallur publikisht edhe djalë të birësuar. Për të kamufluar komplotin që po i bënte djalit, ai shtiret sikur e ka këshilluar të mos e ndante gruan. Pason naiviteti, sikur vetëm Zoti zbuloi dëshirat e ndrydhura dhe prandaj vetë Zoti ia paskësh imponuar Zejneben atij...

Këto perversitete brenda kopesë së Muhamedit nuk kanë pse të shndërrohet në përcaktime hyjnore, universale, që duhet të vlejné gjithherë dhe gjithandej.

“S’ka kurrfarë ngushtësie për Pejgamberin, për atë që i ka caktuar Perëndia. E tillë ka qenë dispozita e Perëndisë edhe për ata (pejgamberë) që kanë qenë më parë, e urdhri i Perëndisë është dispozitë definitive.” [33:38; shqipërimi nga H. E. Nahi]

Sikur nuk i ka mjaftuar ajeti paraprak dhe ai sajoi edhe ajetin pasues, për të arsyetuar vetveten, se vetëm po zbatonte urdhrat e Zotit. Kjo taktikë edhe mund të ketë funksionuar tek injorantët e atëhershëm muhamedanë, por pse duhet të vlejë edhe tani, kur kanë evoluuar normat e moralit dhe të mirësjelljes?!Madje, do të thosha, ajo as atëherë nuk do të kishte funksionuar, sikur të ishte në pyetje zbatueshmëria paqësore e saj, por tashmë, ajo taktikë ishte shndërruar në ajet medinas dhe Muhamedi ishte komandant i bandave të tij xhihadiste, të cilat zbatonin dëshirat dhe urdhrat e këtij maniaku seksual.

Për të përballuar atë fushatë të përfoljes së qytetarëve, Muhamedi bën edhe dasmë, fton shumë njerëz në gosti, me shpresë se do t'i korruptojë dhe, prandaj, do t'ia miratonin këtë martesë me nusen e djalit (të birësuar). Që e kishte edhe vajzë halle, nuk shqetësohej njeri, atëherë dhe as sot, në hapësirën “arabe” dhe orientale. Dasmorët vazhdonin të zhatnin e të bënin gallata, por maniakut seksual nuk po i pritej t'i vardisej kushërirës Zejneb, prandaj angazhon një ithtar të tij që t'i shpërndante dasmorët. Në fund mbetën dy veta, miqtë tij. Në atë moment Muhamedit, të cilit tashmë i kishte humbur durimi duke pritur largimin e tyre, sajon ajetin 33, surja 53, i cili i dedikohet një lloj perdeje, që e tërheq Muhamedi për t'ua pamundësuar dasmorëve të vështrojnë veprimet intime të Muhamedit me Zejneben. Po sjell këtë ajet, i quajtur ndryshe ajeti i “hixhabit” (i perdes), i sajuar enkas për këtë rast:

“O besimtarë, mos hyni në dhomat e Pejgamberit, përveç nëse u lejohet juve për të ngrënë, por jo të pritni përgatitjen e tij (ushqimit); vetëm kur t'ju thërrasin, atëherë hyni dhe, pasi të hani, shpërndahuni pa biseduar me njëri-tjetrin. Kjo (ndalja) me të vërtetë e shqetësonte Pejgamberin, e ai turpërohej (që t'jua thotë këtë); e Perëndia nuk turpërohet që t'ju thotë të vërtetën. E, kur të kërkonte prej atyre diçka, kërkonte (atë) prapa perdes. Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyreve. Juve nuk u lejohet që ta shqetësoni Pejgamberin e Perëndisë, as që t'i kurorëzoni gratë e tij - kurrë pas tij. Kjo, me të vërtetë, te Perëndia është mëkat i madh.” [33:53 / shqipëruar nga H. E. Nahi]

Rrethanat kur është sajuar ky ajet, i shtjellon më gjerësisht islamologia dhe sociologia Fatima Mernisi. Ajo u kushtoi atyre rrethanave një kapitull të zgjeruar, të titulluar “Hixhabi” (havalja)²¹⁵.

Vërtet është për keqardhje sajimi i këtyre ajeteve dhe mvëshja e tyre Zotit, për t'u imponuar më shumë, ndërsa mjerues është besimi i kaq shumë njerëzve edhe tani, që ajete si ky i konsiderojnë hyjnore, universale, profetike, të përrjeshme, të pareformueshme...

²¹⁵ Fatima Mernisi, vep. cit., f. 113-135.

10. Remla Bint Abu Sufyan (رملة بنت أبي سفيان), e njohur si Umm Habiba (أم حبيبة), ²¹⁶e lindur më 589 dhe vdekur më 644, ishte vajza e kundërshtarit më të ashpër të Muhamedit, Abu Sufjanit, kushëri i Muhamedit. Burri i saj i parë ishte Ubaidullah Ibn Xhahsh dhe u pasi ai u konvertua në kristian. Muhamedi u martua me të në vitin 628, pasi u kthye nga ekzili në Abisini.²¹⁷

11. Safija bint Hujajj (صفية بنت حياي) lindi më 610 në Jatrib (Medina) dhe vdiq më 670²¹⁸. Safija ishte bija e prijësit të fisit hebre Benu Nadir, Hujai Ibn Ahtab. Në vitin 624, Muhamedi e dëboi fisin e saj nga Medina. Ata u vendosen në Khaibar. Edhe atje u sulmuan në vitin 628. Në vitin e 7-të të Hixhrit, Safija u zu robinjë nga xhihadistët. Për të shpëtuar jetën, pasi i mbytën babanë, burrin dhe gjithë familjen, u konvertua në islam dhe u martua përdhunshëm me Muhamedin²¹⁹. Ajo ishte gruaja e 11-të e tij.

12. Maimuna bint al-Harith²²⁰ (arab. : ميمونه بنت الحارث) lindi më 595 dhe vdiq më 674. Emri Majmuna do të thotë “fatlumja”. Ishte nga fisi i Havazinëve dhe kunata e El Abasit, xhaxhait të Pejgamberit . Zejneb bint Khuzaymën e kishte motër nga nëna. Ajo ishte e ve. Muhamedi u martua me të në vitin 629, kur ajo ishte 31 vjeçe. Vdes gjatë rrugëtimit për pelegrinazh në Mekë.²²¹

13. Maria al-Kibtija (arab. : مارية القبطية). Ishte kopte egjiptiane²²². Pas marrëveshjes së Hudejbijës, kalifi Muhamed ftoi sundimtarët e Sirisë, Egjiptit, Persisë dhe viset e tjera që t'i bashkohen islamit. Në

²¹⁶ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Umm_Habiba_Ramla_Bint_Abu_Sufyan

²¹⁷ http://www.islamswomen.com/articles/ramlah_bint_abi_sufyan.php
Fatima Mernisi, vep. cit. , f. 200.

²¹⁸ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Safiyya_Bint_Huyayy

²¹⁹ Po aty.

²²⁰ http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Maimuna_Bint_al-Harith

²²¹ Po aty.

²²² http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Maria_al-Qibtiyya.

vitin 629 Mukaukisi, kryetari i koptëve të Egjiptit, i dërgoi Muhamedit si dhuratë Marien, e cila ishte një vashë kopte, shërbëtore në oborrin e sundimtarit. Ajo ishte e vetmja grua pas Hatixhesë, e cila lindi një djalë, të cilin e quajtën Ibrahim, por vdiq në moshën 2-vjeçare, siç i kishin vdekur edhe dy djemtë e parë që kishte me Hatixhenë. Maria vdiq më 16. 02. 637.²²³

14. Alia bint Dabijan ose Kila bint al-Ash'ath (sipas Tabarit). Historiografët e Muhamedit janë në dilemë për emrin saj, por thonë se vetëm ajo u martua pas vdekjes së Muhamedit.²²⁴

15. Rejhana bint Amribn Hunafa²²⁵ (ريحانة بنت زيد بن عمرو) ishte hebreje, pjesëtare e fisit Banu Nadir, por e martuar te fisi Benu Kurejz. Në vitin 627 bandat xhihadiste të Muhamedit sulmojnë fisin Benu Kurejz. Të gjithë burrat i vrasin, edhe babanë dhe burrin e Rejhanës. Gratë e fëmijët u zunë robër luftime. Meqë ishte e bukur, Muhamedi i vë kusht: o martesë, o viktimitë e përdhunuar nga xhihadistët dhe pastaj dalja në treg. Ajo pranon martesën, por nuk pranon konvertimin në islam. Meqë ishte shumë e bukur, Muhamedi e toleron. Vdes në vitin 631.

Nga këto gra "legale", gjashtë janë kushërira, katër janë arabe, një hebreje, dy kokobina, një vajzë e mitur me emrin Xhamila.²²⁶

Për të legalizuar këtë lloj shturjeje poligamiste, Muhamedi ka sajuar ajetin vijues, tepër skandaloz:

²²³ El-Zayat, Farouk (1996): Die Frauendes Propheten: Mütter der Gläubigen, herausgegeben von der Muslim Studenten Vereinigung in Deutschland e. V. ISBN 3-932399-01-3.

²²⁴ Po aty, f. 229-230.

²²⁵ http://bs.wikipedia.org/wiki/Rejhana_bint_Amr.

²²⁶ <http://eshaykh.com/history/prophets-wives/>

O ti Pejgamber, ne t'i kemi lejuar gratë, të cilave u ke dhënë shpërblimin e kurorës, dhe ato që me ndihmën e Allahut hynë në posedimin tënd (robërshat e luftës) dhe bijat e axhës tënd, bijat e hallave tua, bijat e dajës tënd, bijat e tezeve tua (të janë lejuar, pos grave të kurorëzuara), të cilat kanë migruar (kanë bërë hixhret) si ti, dhe një grua besimtare nëse ajo ia fal veten Pejgamberit dhe nëse Pejgamberi dëshiron të martohet me të (një martesë e tillë pa shpërblim të kurorëzimit) duke qenë kjo (leje) vetëm për ty e jo edhe për besimtarët. Ne e dimë se ç'u kemi bërë atyre obligim rreth grave të tyre dhe rreth atyre që i kanë në pronësinë e vet, ashtu që ti të mos kesh vështirësi, e Allahu është që fal shumë, është mëshirues. [33:50]*

Edhe shqiptarët, që i përkasin islamit tradicional, irritohen nga përcaktimet në këtë ajet! Pikërisht ndalimi i zbatimit të këtij ajeti është karakterizues i islamit tradicional, sepse pranon konfrontimin me *Kuran* për hir të traditave të veta autentike!

Cili prej besimtarëve vazhdon të besojë se këtë ajet e ka formuluar Zoti? Vetëm ata që nuk kanë fare dinjiteti personal. Pra, këto përcaktime i ka sajuar ai, të cilit i janë dashur, për të legalizuar degjenerimin e tij, sikur gjoja janë porosi dhe leje nga Zoti!

Rëndom, myslimanët demagogë, të tilla martesë i arsyetojnë me tradita arabe të kohës. Kjo mund të ketë qenë e vërtetë, por shthurje të tilla morale e poligamiste nuk i shkojnë profetit dhe nuk do të duhej të ishin pjesë e doktrinës (kuranore), e cila është e përcaktuar të vlejë gjithkund dhe gjithherë.

Por nuk mjafton as vetëm me kaq, Muhamedi duhet të ketë sajuar edhe ajetin pasues, për aventura edhe më konkrete:

"Ti je i lirë të lëshosh dhe të mbash pranë vete atë që do, e edhe të kërkosh afrimin e asaj nga e cila ke qenë larguar, dhe nuk ke mëkat. Kjo është më së afërmi që ato të qetësohen shpirtërisht e të mos brengosen dhe të jenë të kënaqura me atë që ti

* Bëhet fjalë për sulmet që bënin xhihadistët ndaj fiseve të ndryshme, të komanduara nga Muhamedi, me ç'rast pos plaçkitjes së kafshëve shtëpiake dhe gjësendeve, grabisnin edhe gra, vajza e fëmijë, pasi i vrisnin burrat. Ja çfarë mashtrimi ordiner, sikur gjoja i paskësh urdhëruar e ndihmuar Zoti për të bërë ato krime; martesë e përdhunshme e Muhamedit me gra të zëna robinja vlerësohet si çlirim nga skllavëria e tyre...

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

*ua ofron të gjitha atyre. Allahu e di çka mbani në zemrat tuaja, Allahu është më i dijshti, më i buti". [33:51]**

Krijohet ndjesia sikur, duke komentuar e interpretuar këto ajete, bëhesh bashkëfajtor!

Për të pasur nën kontroll “kopenë” e tij të haremit, Muhamedi ka sajuar ajete përkatëse. Ja disa prej tyre:

O ti, Pejgamber, thuaju grave tuaja: "Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani: unë po ju jap furnizimin dhe po ju lëshoj ashtu siç është e udhës". [33:28]

E në qoftë se e doni Allahun, të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për secilën prej jush që bën punë të mira. [33:29]

Patjetër, “punë të mira” janë ato të shërbimeve ndaj Muhamedit dhe xhihadistëve të tij, si skllave të seksit.

Në kuadër të tematikës, Muhamedi sajton edhe ajete kërcënuese:

O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish, e kjo për Allahun është shumë lehtë. [33:30]*

Se cilat janë punë të liga e të shëmtuara, duhet të gjykon vetëm “i dërguari”, maniaiku seksual, Muhamedi. Kërcënimi duhet t’i disiplinohë ato skllave, që të jenë sa më të dëgjueshme ndaj padronit të tyre. Por ka miratuar edhe ajete me premtime mashtruese joshëse:

* Meqë nuk rezulton të jetë gjithaq i qartë shqipërimi nga Sherif Ahmeti, po sjell edhe shqipërimin e Hasan Naihiti:

“Ti mund ta shmangësh kë të duash nga ato e ta ofrosh kë të duash, e nuk është mëkat për ty t’i kërkosh (ato) prej të cilave je larguar. Kjo është më e përshtatshme që ato të gëzohen, që të mos pikëllohen dhe që të jenë të kënaqura me atë që u ke dhënë (grave) - të gjithave, e Perëndia di çfarë ka në zemrat tuaja; Perëndia është i Gjithëdijshme dhe e butë”. [33:51]

* Rëndom, shqipëruesi Sherif Ahmeti ka përdor vetëm variantin e arabizuar të emërimit profet.

E kush prej jush i përvishet adhurimit të Allahut dhe respektimit të të dërguarit të Tij dhe bën punë të mira, asaj do t'i japim shpërblimin e dyfishtë dhe për të kemi përgatitur furnizim të këndshëm. [33:31]

Në ajetin pararendës ishte shkopi, tani vjen karota...

O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse kini kujdes e ruheni, ndaj mos u llastoni në të folur e t'ju lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thoni vetëm fjalë të matura. [33:32]

Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos e shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme; faleni namazin, jepni zeqatin dhe respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij. Allahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit) të largojë ndyrësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj. [33:33]

E, përkujtojeni atë nga ajetet e Allahut dhe rregullat e fesë që po ju lexohen në shtëpitë tuaja; vërtet, Allahu është i kujdesshëm dhe i njohur hollësisht për çdo gjë. [33:34]

Për zbatimin e këtyre përcaktimeve skllavëruese, se si duhet të sillen skllavet seksuale të Muhamedit, janë shpërblyer edhe me epitelin mashtrues: “nëna të myslimanëve”.

Kur Allahu ose i dërguari i Tij ka vendosur për një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i asnjë besimtareje, që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës. [33:36]

Këtë ajet, Muhamedi duhet ta ketë sajuar për të martuar vajzën e hallës (Zejneben) me djalin e birësuar. Ajo refuzoi urdhrin e Muhamedit, me arsyetim se ajo i përkiste një familjeje të pasur e fisnike, kurse Zejdi kishte qenë skllav, që e kishte blerë dhe birësuar Muhamedi. Përmes atij ajeti ai e detyroi Zejneben të martohet me djalin e birësuar. Por, më vonë, ai vetë u dashurua në Zejneben, të cilën, pos që e kishte vajzë halle, tashmë e kishte edhe nuse të djalit të birësuar.

Pra, kur Muhamedi vendos, nuk duhet të kundërshtohet. Të gjitha dëshirat dhe interesat personale të individëve janë baras me një zero të madhe, kur janë në pyetje veset e “profetit”.

Meqë ajeti i dedikohet një ngjarjeje konkrete, pse do të duhej të zinte vend në *Kuran* të përhershëm!? Kësaj pyetjeje nuk i përgjigjen dot viktimat e islamit...

Profeti nuk e ka mëkat të veprojtë ashtu si e ka ngarkuar Allahu; ashtu ka qenë ligji i Allahut edhe më herët, dhe urdhri i Allahut është i caktuar plotësisht. [33:38]

Një mori e këtyre ajeteve janë sajuar kur ndodhi skandali i dashurisë së Muhamedit në vajzën e hallës, të cilën e kishte edhe nuse të djalit (të birësuar). Përcaktimi i këtyre ajeteve duhej të mundësonte dhe të arsyetonte martesën e Muhamedit me Zejneben, të kamufluara sikur kanë qenë vullnete e vendime të vetë Zotit.

Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguari i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve... [33:40]

Sërish duhet të bëhet edhe ky arsyetim bastard, sikur Muhamedi nuk ishte babai i Zejdit (edhe pse e kishte birësuar). Ishte rast i rëndë dhe e përfllisnin të gjithë banorët e atyre anëve, prandaj duhej kaq shumë përkushtim e taktika për t'i sfiduar opinionet tradicionale.

Mos i dëgjo jobesimtarët e hipokritët dhe mos u vër veshin angazhimeve torturose të tyre ndaj teje, e mbështetu tek Allahu, se Allahu është mbrojtje e mjaftueshme. [33:48]

Banorët e atyre anëve, që ishin politeistë paganë, sigurisht që kishin tradita dhe norma të moralit të tyre, prandaj i gjykonin si një sakrilegj veprimet amorale të Muhamedit. Për t'i përballuar gjykimet e tyre, Muhamedi i diskualifikon ata si jobesimtarë, të cilët nuk duheshin dëgjuar. Por, sikur të kishte thënë se janë përcaktime të tij, ato nuk do t'i respektonin as besimtarët myslimanë, prandaj mashtronte, duke bërë autor Allahun e tij.

Nuk është mëkat për ato (gratë e pambuluara) ndaj etërve të tyre, as ndaj djemve të tyre, as ndaj djemve të vëllezërve të tyre, as ndaj djemve të motrave të tyre, as

ndaj grave të tyre, e as ndaj robërshave të tyre. E, frikësohuni (o ju gra) Allahut! Allahu është pranë çdo sendi. [33:55]

Formulimi është i përçartë. Njësoj si edhe në variantet e tjera. Duhet të jetë menduar se para kujt mund të paraqiten gratë të pambuluara. Por edhe përfshirja e “grave të tyre” mund të (keq)kuptohet sikur edhe gratë paskëshin gra të tyre.

Muhamedi ka pasur të drejtë të propozojë norma sjelljeje, si kushdo, por jo të mashtrojë sikur ato po i “zbrisnin” nga Zoti dhe, prandaj, duhet të vlejnjë përherë, për gjithë njerëzimin. Aq më pak ka pasur të drejtë t’i imponojë ato me dhunë fizike.

Është e vërtetë se Allahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë profetin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra, atë dhe përshëndeteni me selam. [33:56]

Një mashtrim tepër naiv, që duhet ta kenë zbatuar vetëm besimtarët naivë! Çfarë narcizisti duhet të ketë qenë Muhamedi, i cili ka sajuar kaq shumë ajete, që t’i mbushë mendjen vetes dhe të tjerëve, se vërtet është “profet”, “I Dërguari” i Zotit...

E s’ka dyshim se ata të cilët e fyejnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, ata i ka mallkuar Allahu në Dynja e në Ahiret dhe për ta ka përgatitur një dënim të dhembshëm. [33:57]

Për ata që e fyejnë Muhamedin, ja dënimet! Por, siç do të shohim në ajete të tjera dhe në disa fetva (ekspertizë)aktuale, dënimet nuk mjaftojnë me kaq; ka dënime konkrete fizike, tepër të tmerrshme...

O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, që le të mbulohen krejtësisht, sepse mundësojnë që ato të njihen e të mos ofendohen. Allahu fal gabimet e kaluara, Ai është mëshirues. [33:59]

Rëndom këtë ajet duhet ta ketë sajuar Muhamedi në kohën kur e kishte rritur “kopenë” e grave të tij, dhe ndonjëra prej tyre po përflitej për marrëdhënie të fshehta seksuale. Muhamedi kishte përzgjedhur femra të bukura, sharmante, nga ato që i zinin robinja lufte. Sa herë dilnin në rrugë, ato tundonin epsheet e burrave beduinë. Si masë

preventive u mendua mbulesa, që ato të “konservoheshin” vetëm për Muhamedin. Sigurisht, njeriu që ka dhunti të manipulojë njerëzit edhe me truke tepër skandaloze, di të prodhojë edhe masa për të disiplinuar e mbrojtur “kopenë” e tij dhe gratë e ithtarëve të tij.

Po nëse hipokritët, ata që kanë zemra të sëmura dhe ata që përhapin gënjeshtria në Medinë, nuk ndalen, ne do të bëjmë që ti të mbizotërosh mbi ta e pastaj ata do të jenë fqinjë me ty vetëm një kohë të shkurtër. [33:60]

Të mallkuar, kudo që të ndeshen, do të kapen dhe do të mbyten. [33:61]

(Ky është) Ligji i Allahut edhe ndër ata që ishin më parë, e në ligjin e Allahut nuk mund të gjesh ndryshim. [33:62]

Përkundër vendosjes së mbulesës, gratë sërish përfliteshin. Për këtë qëllim Muhamedi sajoi ajete, përmes të cilave paralajmëronte se ka ndërmend të fuqizohet për të mbizotëruar mbi ta, pastaj me dhunë do t’i disiplinonjë, mbytë, dëbojë...

Tepër të qarta e brutale! Aspak paqësore, profetike, hyjnore e universale! Fatkeqësisht, myslimanët besojnë se janë të formuluar nga Allahu i tyre dhe prandaj edhe duhet të zbatohen.

Muhamedi ka praktikuar edhe një lloj kurvërie të shthurur seksuale, por të legalizuar si të moralshme. Për këtë lloj kurvërie, ai ka sajuar të ashtuquajturat *kontrata të përkohshme martesore*, që ndryshe i kanë quajtur *kontrata qejfi*. Ta zëmë, skllavet e seksit ose kurvat i martonin në mbrëmje dhe i divorconin në mëngjes [*Për kontratat e qejfit do të ofroj një fetva përkatëse, që do të pasojë pas haditheve.*]

Po ofrojmë edhe disa emra grash, që Muhamedi i "ka përpunuar" kalimthi, nëse mund të përdoret zhargoni i rrugaçërisë, duke (sh)përdorur kontratën e qejfit. Këtë listë e kanë publikuar një mori faqesh interneti. [*Po ofroj vetëm emrin e parë dhe të fundit, për të kursyer letër.*]:

1. Al-`Aliya bint Zhibyan / Zhabyan

(...)

45. *Khuvajla bint Hakim b. Umajja al-Sulamiyya*²²⁷

No comment!

“Kur vdiq Muhamedi, duhet të ketë lënë mbrapa një mori grash të veja. Ai i parapëlqente marrëdhëniet seksuale me gratë që ishin më të bukura, sepse ato që e joshnin më shumë. Kurse me Aishen dhe Salmën, Muhamedi edhe komunikonte në nivel intelektual. Luftimet nuk e ndanin nga gratë, pavarësisht nëse ishin të gjata ose të shkurta. Të paktën dy gra i merrte me vete për shoqërim”.²²⁸

Interesante janë informacionet nga burimet islame për këtë tematikë, siç janë këto në vijim:

Bukhari, vëll. 1, libri 5, nr. 268:

Pejgamberit i është dhënë forca seksuale sa e tridhjetë burrave. Profeti mund të bëjë dashuri me të gjitha gratë e tij brenda një nate. Profeti i ka vizituar të gjitha gratë e tij gjatë ditës dhe natës dhe ato ishin njëmbëdhjetë në numër...

Bukhari, 1:5:270:

Allahu i kishte dhënë profetit Sulejman potencë të ngjashme. Aftësi të tilla seksuale janë mrekulli të Allahut, që u ka dhënë vetëm profetëve. Profeti Sulejman ka bërë seks me 100 gra brenda një nate.

Bukhari, libri 008, numër 3450:

...Allahu jo vetëm që i dha Profetit potencë të jashtëzakonshme për aktivitetin seksual, por edhe i dha privilegje të veçanta për të përdorur këtë potencë.

Muslim, libri 8, nr. 3240:

Një ditë i dërguari i Allahut hyn në shtëpinë e djalit të tij të birësuar Zejd. Ai nuk ishte aty. I Dërguari i Allahut me atë rast u magjeps nga paraqitja e Zejnebit, e cila ishte kushërira e parë Profetit.

²²⁷ <http://eshaykh.com/history/prophets-wives/>.

Janë ofruar si burime: Ibn Sejjidel-Nas, `Uyunel-Athar (2:367-377). Al-Salihi, Subulel-Huda-el-Rashad (12:15-162). al-Zurqani, Sherhelmauahid (3:297-309).

²²⁸ Fatima Mernisi, vep. cit. , f. 138.

El-Tabari ka shkruar:

Një ditë Muhamedi shkoi në kërkim të Zejdit. Dera e kasolles ka pasur një mbulesë stofë, por era e hoqi mbulesën. Zejnebi ishte brenda, e zhveshur, dhe kështu ajo i hyri në zemër Profetit. (...)

El-Tabari ka shkruar:

Njëherë Muhamedi hyri në dhomën e gruas së tij, Hafsasë. Hafsaja nuk ishte aty, por ai gjeti shërbëtoren e re, atraktive, Marinë. Ai e pushtoi atë për beli dhe u hodh me të në shtrat. Por meqë nuk ishte mjaftueshëm i shpejtë për të mbaruar punë, erdhi Hafsaja dhe i gjeti duke bërë seks. Ajo filloi të bërtiste. Për ta qetësuar, ai i premtoi asaj se kurrë nuk do ta prekte më shërbëtoren. Por Allahu nuk e miratoi këtë sakrificë të Profetit, prandaj zbuloi ajetet vijuese:

"O Pejgamber! Pse ia ndalon vetes atë që ta ka lejuar Perëndia ty, në kërkimin e kënaqësisë së grave të tua. Perëndia është falës dhe mëshirues. [66:1] Perëndia ju ka bërë të mundshme që të liroheni nga betimet tuaja...[66:2]"

Maniaku seksual, Muhamedi, edhe për seks ilegal me shërbëtore, ka sajuar ajet, për të arsyetuar seksomaninë e tij perverse. Dhe vetëm të vëmendësohen besimtarët në xhami, kur janë duke dëgjuar recitim-këndimin e këtyre ajeteve. Edhe pse i dedikohen arsyetimit të amoralitetit të Muhamedit, ndonjërit edhe i rrjedhin lotët nga mallëngjimi, duke e menduar Muhamedin në ndonjë betejë kundër armiqve, meqë gjuhën origjinale të *Kuranit* nuk e kuptojnë 99 % e besimtarëve...

El-Tabari ka shkruar:

Kur Profeti ishte në shtrat me nusen e tij të re dhe të bukur Shanba bint Amr bin Xhufarija, ajo i tha atij:

"Nëse ti do të ishe një profet i vërtetë, djali yt i dashur, 2-vjeçar, Ibrahim, nuk do të kishte vdekur nga sëmundja, pasi ti u lute ditë dhe natë për të..."

Profeti u hidhërua, e nxori atë me shkelma jashtë dhe e divorcoi. (Ajo ishte me fat që Profeti vetëm e nxori jashtë me shkelma. Përndryshe Allahu do ta vdiste, po të kishte dëshiruar Muhamedi.)²²⁹

²²⁹ Tabari, vol. 9, faqe 136;

<http://www.faithfreedom.org/Articles/AyeshaAhmed50918.htm>.

Në praktikën islame njihen edhe *Fetvat*, që ngjasojnë me ekspertizat ligjore. Rëndom, për nxjerrjen e Fetvave janë të autorizuar institucione islamike dhe personalitete, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në shtete islamike. Qytetarët drejtohen me pyetje për çështje të caktuara fetare, dhe nga institucione të tilla kompetente marrin *Fetva*. Në vazhdim po sjellim disa shembuj.

Fetva në pyetjen nëse një mysliman mund të ketë pesë gra në të njëjtën kohë, lëshuar nga paneli i ekspertëve ligjorë të televizionit mysliman “Al-Furat”, më 08. 10. 2011.

(Pyetje:) “Një burrë është martuar me katër gra. Të parën e ka përzënë dhe është martuar me një grua të re. Ndërkohë është penduar që ka divorcuar gruan e parë. Ai do të rimartohet me gruan e parë. A ka të drejtë?”

(Përgjigje:) “Jo, sepse në këtë rast numri i grave do të bëheshin pesë.

Burri ka të drejtë të ketë vetëm katër gra në të njëjtën kohë, jo pesë. Megjithatë, ka një zgjidhje që mund ta ndihmojë burri në fjalë. Ai mund të kurorëzohet me gruan e parë me kontratë, e cila quhet *martese kënaqësie* [një martesë e përkohshme me një shpërblim financiar]. Përmes kësaj martese për kënaqësi nuk bëhet shkelje [kundër ligjit islam]. Kështu, burri mund të ketë katër gra të përhershme dhe një me kontratë të përkohshme, me afat prej 10, 20 ose 30 vjet. Një gjë duhet të jetë e qartë: po vdiq burri, gruaja me kontratë të afatizuar për martesë kënaqësie, nuk ka të drejtë trashëgime, siç e kanë gratë e përhershme”.²³⁰

Fetva: Mbulimi i fytyrës është i detyrueshëm për gratë

²³⁰ <http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M5849458563a.0.html>.

Nga eksperti ligjor Sheikh Abdul-Aziz bin Baz, ish-ekspert zyrtar ligjor shtetëror i Arabisë Saudite, njëri nga dijetarët më me ndikim të islamit sunit në shekullin e 20-të (v. 1999).

Pyetje: "Ju lutem, na tregoni dëshmitë për detyrim të grave për të mbuluar fytyrën. Allahu ju bekoftë!"

Përgjigje: "Fytyra [e gruas] duhet të mbulohet. Këtë e thonë mendimet më të sakta të dijetarëve myslimanë. Ata janë bazuar në ajetet 53 dhe 59, surja 33.

Kjo vlen për gratë e Profetit (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!), si dhe për gratë myslimane në përgjithësi.

Termi "mbulesë" [arab. *xhilbab...*] do të thotë që të mbështillen me një stof nga koka deri te këmbët. (...) Ajo që mbulon vetëm kokën quhet *khimar*.

Allahu ...ka thënë: "Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i mbulojnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet, baballarëve, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet (...) Le të mos rrapëllojnë me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre...[24:31]

(...) Gruaja duhet të mbulojë bizhuteritë, në mënyrë që ajo të mos jetë tërheqëse për burrat e huaj. Ky fakt është konfirmuar në dy koleksionet autentike të haditheve [nga Al-Bukhari dhe Muslimi].

Aishja (Allahu e pastë bekuar!) ka thënë: "Kur dëgjova zërin e Safvan bin el-Mutil, menjëherë e mbulova fytyrën time. Ai më kishte parë edhe para detyrimit për t'u mbuluar."

Nga kjo rezulton se gratë kanë filluar të mbulohen pas shpalljes së ajeteve përkatëse (...) ²³¹.

²³¹ <http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M57b00801fdc.0.html>.

I. 6. Muhamedi - dhunues pervers seksual

Kriminaliteti pedofil i Muhamedit, me viktimën fatkeqe, Aishen 6-vjeçare, është problematizuar kryesisht jashtë hapësirave arabe, në Europë, kur pedofilia ndalohet me ligj dhe dënohet si krim i rëndë.

Aktualisht, për këtë çështje po debatojnë edhe shqiptarët. Në hapësirat arabishtfolëse por edhe në shoqëritë fundamentaliste islame, martesë e pleqve me vajza të mitura ishte dhe është e tolerueshme dhe shpesh e praktikueshme, atëherë, por dhe sot. Bile, më se shpeshi ndodh duke dëshiruar të imitohet sa më shumë „profeti”.

Muhamedanët fundamentalistë të ne këto krime të Muhamedit i arsyetojnë me traditat e arabëve të asaj kohe. Fatkeqësisht, atë traditë pedofile e kishin dhe e kanë, por njeriu që pretendonte të ishte „I Dërguari i Allahut”, pra profet, do të duhej t’u kundërvihej atyre traditave, e jo t’i praktikonte vetë!

Meqenëse kjo temë mund të shkaktojë irritime te myslimanët fundamentalistë, për të mos u akuzuar se po i qasemi nga pozicionimi islamofob, po japim të modifikuar një shqyrtim të publikuar në një portal islam.²³²

Në vitin 620 (ose 619) vdes Hatixheja, gruaja e parë e Muhamedit, më të cilën ishte martuar në vitin 595. Pas vdekjes së Hatixhesë (...)*, plaka Khavla bint Hakem shkon te Profeti dhe i thotë: „Ti duhet të martohesh, o I Dërguari i Allahut?” Profeti shpërtheu në vaj dhe iu përgjigj: „Vërtet, a ka kuptim të martohem me një grua tjetër, pas vdekjes së Hatixhesë?!”

Ajo i përgjigjet: „Por, I Dërguar i Allahut, kush do të përkujdeset për shtëpinë e fëmijët?” Atëherë Profeti pyet nëse ajo ka ofertë konkrete.

²³² <http://muslimwelt.wordpress.com/2007/12/28/war-der-prophet-ein-kinderschander/>.

* Urimet e përsëritura për “nënë të besimtarëve” dhe për profetin po i menjanojë, që mos të ngarkohet teksti.

„Dëshiron vejushë ose beqare?” - e pyeti ajo dhe vazhdoi: „Vejusha Sauda Bint Zama është e gatshme”. (Sauda u bë gruaja e dytë e Muhamedit, pas Hatixhesë. Ajo ishte edhe kushërirë e tij).

Pastaj Profeti pyeti: „Kush është vajza, që do të më ofrosh?” Um Khalva Bint Hakem përgjigjet: „Vajza e Njeriut tënd më të dashur, Aisha Bint Abu Bekri El-Seddik”.

Muhamedi, pa u hamendësuar, i thotë: „Shko te prindërit e saj dhe luti që të ma japin Aishen për grua”.

Um Khalva shkon menjëherë të shtëpia e Ebu Bekrit. Ajo thotë:

„Sapo hyra në shtëpi, tek Ebu Bekri, aty gjeta gruan e tij Um Ruman, së cilës i thashë: „Oh, Um Ruman, çfarë lavdie të dërgon Allahu!”

Ajo pyet: „Çfarë lavdie?” Khavla përgjigjet: „I Dërguari i Allahut më ka dërguar, që t’ju lus për t’ia dhënë Aishen për grua“. Um Ruman e luti të priste derisa të kthehej Ebu Bekri. Sapo Ebu Bekri u kthye dhe dëgjoi lutjen, pyeti: „A është e mundur kjo, sepse Aishja është vajza e vëllait të tij?”

Khavla shkon menjëherë te Profeti. Muhamedi, përmes saj, i ktheu përgjigjen: „Ti je vëlla imi dhe unë jam vëlla yt, por në islam, vajza jote bën të martohet me mua”.

Pasi Ebu Bekri dëgjoi këtë sqarim, luti Khavlën që të ketë durim, të priste pak kohë. Ai doli menjëherë jashtë, ndërsa Khavla nuk po kuptonte çfarë shqetësimi kishte. Um Ruman e sqaroi: „Al-Mutam Ibn Adi ka kërkuar Aishen për djalin e tij dhe Ebu Bekri i ka dhënë një gjysmë miratimi. Ai është burrë që mban fjalën. Prandaj shkoi për t’u sqaruar me atë familje”.

Meqë babai i djalit, që kishte kërkuar Aishen për djalin e tij nuk po pranonte të konvertohej në islam, Ebu Bekri i tha se, përfundimisht, ishte kundër asaj martese. Sapo u kthye i thotë shkueses që ta thërriste Profetin për të marrë miratimin e martesës. Kështu, kur Aishja ishte 6 vjeçe, bëhet kontrata për martesë. Por, Ebu Bekri i vuri Muhamedit

kushtin, të mos bënte marrëdhënie seksuale derisa Aishja të bëhej 9 vjeçe.

Kundërshtarët e atëhershëm të Muhamedit nuk e problematizuan këtë martesë, sepse atëherë ishte traditë normale e beduinëve që t'i martonin vajzat në këtë moshë.

Duke u ndier i shqetësuar nga debati kritik për martesën e Muhamedit me Aishen 6-vjeçare, teologu dhe kleriku mysliman Abd Ar-Rahman ka publikuar një studim, që trajton tematikën e kësaj martese dhe arsyetimin e saj. Varianti i përkthyer në gjermanisht, mund ta shkarkoni nga portali i evidentuar në fusnotë²³³.

Në vazhdim ofrohen hadithet që i dedikohen kësaj martese.

Sahih Bukhari, vëllimi 5, libri 58, numër 234:

Aishja ka rrëfyer: „Profeti u martua me mua kur unë isha 6 vjeçe. Ne po jetonim në shtëpinë e Bani-al-Harith bint Khazraj. Ndërkohë u sëmura dhe më ranë flokët. Më vonë problemi me flokët m'u shërua. Nëna ime, Um Ruman, erdhi tek unë, ndërsa unë isha duke luajtur me disa shoqe të mia. Ajo më thirri, unë shkova tek ajo, duke mos ditur se çfarë donte të bënte me mua. Ajo më mori për dore dhe më bëri të qëndroja te dera. Ajo mori pak ujë dhe ma lau kokën. Pastaj më mori në shtëpi. Në shtëpi pashë disa gra Ansari, që thanë: „Urimet më të mira dhe Zoti e bekoftë e pastë fat të mirë në martesë“. Pastaj ato më përgatitën (për martesë). Papritur erdhi I Dërguari i Allahut dhe nëna ime me dorëzoi në duar të tij. Në atë kohë unë isha një vajzë nëntëvjeçare”.

Sahih Bukhari, vëllimi 5, libri 58, numër 236:

Babai i Hishamit ka rrëfyer: „Hatixheja vdiq tre vjet para se Profeti të shkonte në Medinë. Ai ka qëndruar atje për afro dy vjet dhe u martua me Aishen kur ishte një vajzë gjashtëvjeçare dhe e konsumoi martesën kur ajo ishte nëntëvjeçare“.

²³³ http://www.way-to-allah.com/dokument/Die_Junge_Ehe_Der_Aisha_Ra_01.pdf.

Sahihel-Buhari, vëll. 7, libri 62, nr. 64:

Aishja ka rrëfyer: „I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi qofshin mbi të, ndërmori martesën e tij me mua kur isha gjashtë vjeçe, dhe pati marrëdhënie martesore me mua kur isha nëntë vjeçe.

Sahihal-Bukhari, vëllimi 7, libri 62, numër 18:

„Ursa ka rrëfyer: „Profeti ishte të Ebu Bekri për të kërkuar Aishen për nuse. Ebu Bekri i tha: „Por unë jam vëllai yt“. Profeti iu përgjigj: „Ti je vëllai im në fe të Zotit dhe në librin e tij, por Aishja nuk ka pengesë të martohet me mua“.

Aishja ka rrëfyer: „I Dërguari i Zotit u martua me mua në muajin sheval në vitin e dhjetë të profecisë, tre vjet para se të emigronte, kur unë isha gjashtë vjeçe. I Dërguari i Perëndisë, i emigruar, arriti në Medinë të hënën, 12 Rebial-Aval, dhe organizoi dasmën me mua në muajin e shevalit, pas tetë muaj emigrimit. Martesën e konsumoi me mua kur isha nëntë vjeçe“.

Sahih Buhari, vëllimi 7, libri 62, numër 15:

„Transmeton Aishja: “Profeti i Allahut më qe rrëfyer: „Ti më je shfaqur dy herë në ëndrrat e mia. Një burrë të mbante të mbështjellë me një pëlhurë të mëndafshhtë dhe më tha: „Kjo është gruaja jote“. E zbulova atë paksa dhe thashë me vete: „Nëse kjo ëndërr është prej Allahut, Ai do ta realizojë“.

Ka mundësi që Muhamedi të mos e ketë ëndërruar fare Aishen, por e ka sajuar ëndrrën për t'i bindur prindërit që t'ia japin Aishen për grua dhe për ta joshur atë fëmijë fatkeq, por edhe mund ta ketë ëndërruar, sepse ai prej kohësh, tinëzisht, e ledhatonte Aishen për të kënaqur epshet e tij prej pedofili. Muhamedi duhet të ketë kuptuar se nëna e

Aishes u shqetësua nga kërkesa e tij, prandaj ia kërkoj Ebu Bekrit vajzën për grua.

Çdo psikiatër këtë ëndërrim të Muhamedit do ta interpretonte si sindromë të një devijanti pedofil.

Dhe ndodhi krimi: profeti u fejua me vajzën 6-vjeçare të ëndrrave të tij dhe u martua me të në moshën e saj 9-vjeçare...

Rasti tjetër i pedofilisë perverse:

Muhamedi pa vajzën-fëmijë të Um Habibabin Abasit, ndërsa ishte për vizitë, dhe tha: „Kur ajo të rritet, nëse unë do të jem ende gjallë, do të martohet me të“ (Musnad Ahmed, nr. 25. 636).

Tabari, vëll. 17, faqe: 7:

„Aishja tha: „Frymëzimi erdhi, kur ai dhe unë ishim nën një batanije“.

Bukhari 5:7:119:

„Profeti tha: „Pasha Allahun, frymëzimi hyjnor erdhi tek unë kur isha nën batanije me Aishen“.

Rëndom, në islam nuk është përkufizuar mosha minimale për martesë, por ka ca sugjerime në *Kuran*, si në ajetin ku flitet për vlerësimin e pjekurisë:

„Provoni bonjakët kur të bëhen për martesë, e nëse çmoni pjekuri tek ata, atëherë jepuni pasurinë e tyre...“ [4:6]

Por edhe përmes ajetit tjetër sugjerohet kur duhet të bëhen martesat:

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

„Martoni të pamartuarit dhe të pamartuarat, edhe skllavet dhe skllavet tuaja, besimtarë të ndershëm...” [24:32]

Në *Kuran*, Aishja nuk përmendet me emër konkret, por në dy sure bëhet fjalë për të²³⁴. Ajeti në vijim i dedikohet përfoljes për aferën e saj seksuale, me një mik të saj, gjatë një rrugëtimi të gjatë. Për shkak të pozicionit të Ebu Bekrit, babait të Aishes, Muhamedi u detyruar të sajtojë kritere dëshmie, që nuk plotësoheshin dot, vetëm që ta shpëtojë divorcin dhe dënimin e Aishes, dhe për shpifësit përcaktoi dënimet vijuese:

„Me të vërtetë, ata që bënë shpifje (ndaj Aishes, bashkëshortes së Muhamedit), janë një grup prej jush. Mos e konsideroni këtë (shpifje) të keqe për ju. Jo, kjo është mirë për ju. Çdonjëri prej tyre do të dënohet për atë që ka bërë, e atë, prej tyre që ka bërë më së shumti, e pret dënimi i madh. [24:11 / shq. H. E. Nahi]

Ndërsa ajetet e tjera kanë të bëjnë me një rast, kur Hafsaja ka dekonspiruar një fshehtësi, që ia kishte besuar Profeti, duke ia rrëfyer Aishes.

„O Pejgamber! Pse ia ndalon vetes atë që ta ka lejuar Perëndia ty, në kërkimin e kënaqësisë së grave tuaja. E, perëndia është falës dhe mëshirues”. [66:1]

„Perëndia ju ka bërë të mundshme që të liroheni nga betimet tuaja; Perëndia është Zoti juaj; Ai është i Plotëdijshëm dhe i Gjithëdijshëm”. [66:2]

„Kur Pejgamberi ia shfaqti një fjalë të fshehtë njëres prej grave të tij; e ajo pastaj e shpalli këtë fjalë, - e Perëndia ia zbuloi këtë Pejgamberit- ai një pjesë të këtij zbulimi e tregoi, kurse pjesën tjetër jo. Kur Pejgamberi e informoi atë (gruan) për këtë fshehtësi, ajo e pyeti: „E kush të ka treguar ty për këtë (se nuk e paskam ruajtur bisedën e fshehtë)?” Ai i tha: „Ma tregoi ai që di gjithçka dhe për të cilin çdo gjë është e njohur”. [66:3]

„Nëse ju të dyja pendoheni te Perëndia, se zemrat tuaja kanë anuar (Perëndia ju fal). Nëse ju të dyja bashkoheni kundër tij (kurrjë nuk mund të arrini), se, me të

²³⁴ <http://www.orientdienst.de/muslime/minikurs/aischa-die-liebblingsfrau-mohammeds/>.

vërtetë, Perëndia është mbrojtësi i tij, dhe Xhibrili dhe besimtarët e mirë; e pastaj edhe gjithë engjëjt janë përkrahësit e tij". [66:4]

Përmbajtja e këtyre ajeteve tregon se sa banale mund të jenë ajetet kuranore, duke iu dedikuar një aksidenti krejt minor , dhe këto ajete duhet të vlejnjë gjithherë e kudo(!).

Biografi i Muhamedit, Al-Tabari (838-923), në „Historia e profetëve, mbretërve dhe kalifëve“, ka rrëfyer një rekomandim të profetit:

„Martohuni me vajza të virgjëra, për shkak se ato janë në gjendje të lindin, kanë gjuhë e buzë të ëmbla. Papjekuria e tyre shmang pabesitë dhe janë dakord për çdo gjë. Në jetën seksuale janë të përkushtuara, atraktive. Organin seksual e kanë të papërdorur, mund t'i përshtatet organit tuaj dhe të sjellë më shumë kënaqësi”²³⁵.

Fetvaja në pyetjen se sa vjeçe ishte Aishja kur u martua me Muhamedin:

Nga sheiku Mahmud el-Masri, një nga predikuesit më të popullarizuar të islamit në Egjipt:

(Përgjigje:) „...Dëgjoni nga unë çfarë shkruan nga përmbledhja e Sahihel-Buhari (...) Në moshën 6-vjeçare e ka fejuar Aishen, ndërsa martesën e ka konsumuar kur ajo ishte 9 vjeçe. Kjo është e vërtetë burimore, edhe pse disa nuk duan ta pranojnë. Ju ndoshta doni të më pyesni: „Kjo nuk është e mundur, sepse si mundet Profeti(Paqja dhe bekimet qofshin mbi të!) të martohet me vajzë që ishte 9-vjeçare?“ E pra,

²³⁵ <http://koptisch.wordpress.com/2012/12/15/hadith-beweist-mohammed-hatte-sex-mit-tieren/>.

më dëgjoni mua, vëllezërit e mi, do t'ua vërtetoj me një mijë për qind duke shfletuar 7 arsye, që provojnë vërtetësinë e kësaj të vërtete që ju thashë:

1. Ai [Muhamed] është urdhëruar nga Allahu për këtë martesë. Mund ta imagjinoni dikë që mund të kundërshtojë urdhrat e Allahut? Si do të mundej profeti ynë, njeriu më i devotshëm në përgjithësi, të kundërshtojë urdhrat e Allahut? Pra, [martesa] ishte një urdhër i Allahut. Në Sahihel-Buhari dhe Muslimi (...) thuhet:

„Allahu: - Aishja, ti më je shfaqur tri herë në ëndërr. Çdo herë Xhibrili më tha: „Kjo është gruaja jote në këtë botë dhe jetën e përtejme”.

Muhamed i është përgjigjur: „Nëse kjo [martesë me Aishen] është e mirë për mua, uroj që Allahu të ma mundësojë”.

Thënë përmbledhtas, martesa e tij me Aishen ishte urdhër dhe inspirim i Zotit.

2. Një vajzë në Gadishullin Arabik ose në një vend tjetër mesdhetar ka menstruacione në moshë të re. Pra, në Gadishullin Arabik, Somali, Mozambik etj. , një vajzë mund të ketë menstruacionin e parë në moshën 8-9 vjeçare. Kjo ndodh edhe në kohën tonë. (...)

3. Profeti donte për të treguar mirënjohjen ndaj një farefisi, meqë Ebu Bekrit i ka shërbyer shumë islamit. Kështu, Pejgamberi [Muhamed] donte të shpërblente Ebu Bekrin, duke u martuar me nënën tonë, Aishen [një nga bijat e Ebu Bekrit].

4. Mjedisit ishte përcaktuar për këtë martesë. Martesa në moshë të re në atë kohë ishte një procedurë e zakonshme. Martesa e nënës tonë, Aishe, nuk ishte një rast i izoluar. Nëna jonë, Safija bint Hu'aibintal-Akhtab, për shembull, ishte martuar në moshën 11-vjeçare, para se të martohej me profetin tonë. Edhe nëna jonë Hafsa bint Umar ishte 12-vjeçe kur u martua për herë të parë, para se të martohej me profetin tonë.

Nuk kam nevojë të sjell shembuj të tjerë nga e kaluara e largët. Tani, në kohët tona, dy tezet e mia janë martuar kur ishin 11-vjeçare. Pra, pse duhet të habitemi që nëna jonë, Aishja, u martua para 1400 vjetëve në moshën 9-vjeçare. Një vajzë e atëhershme 9-vjeçare ngjan me një grua të sotme 25-vjeçare; Pra, atëherë një vajzë 9-vjeçare ishte e fortë, e madhe dhe mund t'i bënte të gjithë punët e shtëpisë.

5 politeistët e urrenin pejgamberin - paqja dhe bekimi qofshin mbi të - dhe donin gjithsesi t'i bënin dëme. Megjithatë, askush nuk e ka kritikuar

atë [Muhamedin], për shkak të martesës së tij me Aishen. Nëse kjo martesë do të ishte turp, politeistët do ta kishin kritikuar. Meqë askush nga politeistë nuk e bëri këtë, do të thotë se të tilla martesë atëherë ishin normale.

6 Profeti (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) u martua me Aishen në vitin e dytë pas emigrimit [Arabe:Hixhra]. Që prej atij viti, ligji islamik [El-Sheriati] është miratuar [nga Allahu, Muhamedi]. Prandaj, ishte e nevojshme që një grua e re të jetonte me peygamberin. Kjo do të thotë, një grua e re, që do ishte në gjendje të të informohej shumë mbi Sheriatin, dhe atë njohuri t'ua përcillte myslimanëve. Kjo ishte urtësia e Zotit tonë [Allahut].

Ju lutem vini re çfarë mundësoi urtësia e Allahut:

1. Aishja nuk lindi fëmijë. Kjo i mundësojë që të koncentrohen plotësisht në mësimet e Islamit.

2. Peygamberi u dashurua shumë në Aishen. Kështu ai i tregon asaj çdo gjë [për Islamin], atë që ajo dëshironte të dinte.

3. Ajo ka jetuar nëntë vjet me të Dërguarit të Allahut - paqja dhe mëshira qofshin mbi të! Ai vdiq kur ajo ishte 18 vjeçe. Ajo ka jetuar edhe 47 vjet të tjera. Prandaj ajo ka ia ka mësuar gjithë botës mësimet [e Muhamedit].

7 Akuza [e martesës së hershme me Aishen] doli vetëm para 50-60 vjetësh. Pra, po të ishte një turp kjo martesë, në fakt, do të ishte problematizuar qindra vjet më parë. Përndryshe, politeistët do të kishin thënë në atë kohë: „Shikoni, ai [Muhamedi] është martuar me një vajzë të vogël!”²³⁶

Është i neveritshëm, në kohë të sotme, arsyetimi përmes *fatvafë* (ekspertizave ligjore), i vendimeve dhe veprimeve përvese, që kanë ndodhur para 1400 vjetësh. Fatkeqësisht, ato i janë imponuar gjithë njerëzimit. Kjo është bindja e islamistëve, e sanksionuar në doktrinën kuranore, së cilës janë duke i shërbyer xhihadistët.

Të mjerat gra myslimane...

²³⁶ <http://www.youtube.com/watch?v=NFTbik7qG-Q>.

Mendësia prej maniaku seksual e Muhamedit është aq vulgare, sa të krijohet dyshimi nëse ai duhet të ketë qenë një pervers unikat. Dhe prandaj, pikërisht për shkak të atij lloj perversiteti, ai është adhuroar dhe po adhurohet nga besimtarët e tij, madje edhe më shumë se Allahu!

Ta zëmë, mund të jetë vizatuar gjithandej ndonjë karikaturë ironizuese për Allahun dhe mund të mos ketë reaguar asnjë mysliman. Ndërsa, nëse vizatohet ndonjë karikaturë për Muhamedin, krijohen turbulenca të mëdha protestuese, dhunuese e terroriste nga islamistët fundamentalistë. Kjo është një dëshmi kokëfortë për një dogmë fashistoide, ku Führeri (Fyhreri) është më i madh se Zoti...

Dhuna seksuale e Muhamedit ndaj grave të robëruara në luftëra do të konkretizohet me shembullin e veprimit të tij ndaj Safija bint Hujaj²³⁷. Këtë rrëfim do ta sajoi si një plagjiaturë, bazuar në rrëfimin e Ayesha Ahmed.²³⁸

Në vitin 625 Muhamedi dëboi nga Medina fisin arab Banu Nadir, që i përkiste besimit hebre. Ai u vendos në Kaibar, oazë rreth 150 km në veri të Medinës. Një pjesë e fisit u shpërngul në Siri. Shkak për dëbim duhet të ketë qenë përkrahja e disa pjesëtarëve të fisit Banu Nadir ndaj fisit Kurejsh në betejën e Uhudit (19.03.625 / 3 shaval 3 të kalendarit muhamedan), ku rreth 700 falangistë muhamedanë u përballën me rreth 3 mijë pjesëtarë të fisit Kurejsh. Në këtë betejë u vranë rreth 70 muhamedanë dhe rreth 20 kurejshë. Megjithatë, luftëtarët kurejshë, të komanduar nga Abu Sufjan in Harb, nuk ia dolën

²³⁷ Safijja bint Hujaj (صفية بنت حبي) ishte gruaja e njëmbëdhjetë e Muhamedit (e lindur në vitin 610 në Jatrib, e vdekur në vitin 670). Në vitin 627, në moshë 17-vjeçare, u martua me Kinana ibn al-Rabi (كتانة بن الربيع), një udhëheqë i judenjëve në Jatrib dhe rrethinë. Në vitin 628, me urdhër të Muhamedit, atij iu pre koka.

²³⁸ <http://www.islam-watch.org/AyeshaAhmed/Muhammad-and-Safiyah.htm>.

të zhduknin komunitetin muhamedan, siç duhet të kenë qenë të përcaktuar, me atë mobilizim të madh²³⁹.

Safiya, vajzë e Hujaj ibn Ahtab dhe e Barra bint Samaval (e fisit Banu Kuraiza), në moshë 17-vjeçare u martua me Kinan ibn al-Rabi, i cili ishte afirmuar si udhëheqës i hebrenjve në Medinë.

Në maj të vitit 628, Muhamedi me rreth 1700 xhihadistë sulmon Kaibarin, me pretekst hakmarrjen për pjesëmarrje të disa hebrenjve të Kaibarit, në Betejën e Llogoreve (prill 627)²⁴⁰. Por arsyeja e vërtetë duhet të ketë qenë dështimi i Muhamedit për të bërë pelegrinazh në Qabe dhe dështimi për arritjen e një marrëveshjeje me fisin e tij Kurejsh për një haxh të mëvonshëm. Prandaj, për të rikthyer autoritetin te muhamedanët, i duhej një sulm i suksesshëm kundër jomuslimanëve²⁴¹.

Pasi bënë lutjen e mëngjesit, në mes të errësirës dhe agimit, falangat muhamedane sulmuan fshatarët e Kaibarit. Ata ishin duke dalë në arat e tyre dhe ky sulm i zuri në befasi (siç rrëfëhet edhe nga Sahih Muslim, lib. 19:4450).²⁴²

Por, meqë pjesa më e madhe e popullsisë ishte barrikaduar në shtëpitë e tyre dhe falangat muhamedane nuk kishin mjete për sulm të efektshëm, Muhamedi u përcaktua t'i mbajë në rrethim, duke i sulmuar herë pas here. Kjo gjendje zgjati rreth 6 javë dhe, në fund, *Banu Nadirët* hebrenj u dorëzuan, duke bërë marrëveshje përkatëse, në të cilën parashihej që gjysmën e prodhimeve bujqësore hebrenjtë t'ua jepnin xhihadistëve muhamedanë.²⁴³

²³⁹ W. Montgomery Watt: *Muhammad. Prophet and Statesman*. Oxford University Press, 1961. S. 140

²⁴⁰ *The Encyclopaedia of Islam*. New Edition. Brill, Leiden. Bd. 4, S. 1137.

²⁴¹ Norman A. Stillman: *The Jews of Arab Lands. A History and Source Book*. The Jewish Publication Society of America, 1979. S. 18

²⁴² www.usc.edu/org/cmje/religious-texts/hadith/muslim/019-smt.php#019.4450

²⁴³ Bernard Lewis: *Die Juden in der islamischen Welt. Vom frühen Mittelalter bis ins 20. Jhd.* Beck, 2004. S. 20

Që këto informacione të jenë sa më autentike, po sjellim (dez)informimin nga burimi më autoritativ islam, siç janë hadithet e Sahihal-Buharit, 5/59/510:

Enesbin Malik rrëfen: - Ne arritëm në Kaibar herët në mëngjes, kur banorët po dilnin për punë në ara. Ata thirrën: - Ja, Muhamedi me ushtrinë e tij!

Profeti thirri: - Allahu Ekber! Kaibari duhet shkatërruar! (...)

Kinane, kryeplaku i Kaibarit, i plagosur, iu soll para profetit.

Muhamed: - Kinane, ku e keni fshehur thesarin?

Kinane: - Thesar? Ne nuk kemi thesar? Ne jemi bujq, nuk jemi banditë si ju...

Muhamed: Kujdes çfarë po flet, Kinane, je duke folur para një profeti të Perëndisë ...

Kinane: - Profet i Zotit të prapanicës sime. Ti je një vrasës dhe një përdhunues...

Muhamedi: - Zubejr, merre, shporre dhe preja gjuhën!

(Ibn Ishaq / nr. 595: „Profeti i tha: - Merreni, largojeni nga unë dhe prejani gjuhën!“)

Zubejri: - Rasulullah, në qoftë se ia presim gjuhën, si do ta detyrojmë atë të flas?

Muhamedi: - Tamam, atëherë torturoje, që ta detyrosh të flasë.

Zubejri mbledh dru të thatë dhe ndez një zjarr në gjoksin e Kinanes dhe me një shkop ngacmon zjarrin, për t'i shkaktuar atij dhimbje të mëdha. Kinane tashmë ishte pa vetëdije. Ai vdiq pa folur.

Muhamedi: - Bastardi tashmë pavetëdije. Maslamah, preja kokën!

Tabari VIII: 122; Ishaq: 515:

Profeti i dha urdhër Zubejrit: „Torturo atë [Kinanen] derisa të tregojë për thesarin e fshehur“.

Zubejri ndezi një zjarr në gjoksin e Kenanes, e torturoi derisa e çoi në prag të vdekjes. Pastaj I Dërguari urdhëroi Maslamahun që t'ia priste kokën.

Kinane ishte burri i Safijjes. Këto skena barbare ndodhin në prani të saj. Më herët i kishin prerë kokën edhe babait të saj²⁴⁴.

Bilali, bashkëlufëtari i Muhamedit, kishte rrëmbyer gruan e bukur 17-vjeçare, Safija, dhe dy kushërirat e saj më të reja, të cilat ishin vetëm rreth 9 dhe 10 vjeçe. Ato u dërguan para profetit. Gjatë rrugës ato panë kufomat e anëtarëve të familjes së tyre dhe, kur i dërguan para Muhamedit, ato panë skenën duke iu prerë koka Kinanes.

Muhamedi ishte duke pirë verë rrushi (ende nuk ishte ndaluar) me Aliun, Usmanin, Omerin, Zubejrin dhe Dihyan pranë trupit pa kokë të Kinanes, shtrirë në një pellg gjaku.

Bukhari 7/69/486:

Tregon Enesi: „... Safija zuri të sillej si e çmendur para Profetit, i cili po festonte me miqtë pranë trupit pa kokë të burrit të saj. Ajo nisi të mallkonte me zë të lartë. Muhamedit i ra nga duart kupa me vërë. I nevrikosur ai i thirri:

„Shih çfarë bëre, bushtë! Nuk sheh se unë po pi? Dihja, largoma sysh këtë shejtane!“

Dihja: „Çfarë do që unë të bëj me të?“

Muhamedi: „Merre në çadrën tënde, kënaqu me të, ajo të takon ty“.

Dihja: „Shukran, Resulullah, Shukran“.

Dihja e mori në çadrën e vet. Safija po i rezistonte duke ulëritur. Së shpejti disa xhihadistë rrethuan çadrën për të parë çfarë po ndodhte. Ata po mahniteshin nga bukuria e Safijës...

Sahih Muslim 8:3329:

²⁴⁴ *The Encyclopaedia of Islam*. New Edition. Brill, Leiden. Bd. 8, S. 817.

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon: Safija (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ra hise Dihjës si plaçkë e luftës. Ai e lavdëroi në prani të Të Dërguarit të Allahut (Paqja qoftë mbi të!): „Asnjëherë nuk kam parë këso bukurie në mesin e robërve të luftës“.

Epsi sa i 30 burrave e tundoj Profetin, i cili iu drejtua Aliut:

„Ali, shko menjëherë, merre Safijën nga Dihja dhe ma kthe!“.

Ali shkoi menjëherë dhe gjeti Dihjën duke u përpjekur të mposhte Safijën. Ai e urdhëroi atë ta linte të qetë, por Dihja e injoroni urdhrin. Aliu pastaj filloi ta godiste Dihjën me sandalen e tij, me thembër të metaltë, derisa i plasi currili i gjakut dhe rrodhi sipër Safijës. Ali e mori Safijjën dhe e çoi te Profeti. Duke çaluar, Dihja e ndiqte nga pas për të protestuar... Muhamedi e mbështolli me mantelin e tij Safijën. Por Dihja po protestonte...

Bukhari 5:59:512:

„Safija ishte në mesin e robërve; ajo fillimisht ishte plaçkë e Dahja Alkalit, por më vonë ajo iu dha Profetit.

Por për t'i kaluar Muhamedit, Dihja bëri pazar.

Dihja: „Rasulullah, nuk është e drejtë, Ju ma patët dhënë Safijën mua“.

Muhamedi: „E ndryshova mendimin. Unë do të të jap dy kushërirat e reja të Safijës si kompensim. Ju do t'i doni ato, sepse janë shumë të reja dhe të virgjëra. Ju do të keni një treshe sonte“.

(Muslim 8:3329: „Profeti ia dha Dihjës dy kushërirat e reja të Safijës, si kompensim për Safijën“).

Dihja: „Rasulullah, mua nuk më duhen vajzat e vogla, Ju mund t'i mbani ato. Dua të më kthesh Safijën“.

Muhamedi: „Dihja, mos u bëj grindavec! Unë do të ëmbëlsoj, duke shtuar edhe pesë të rinj. Ju mund të shijoni një kënaqësi të dyfishtë sonte, dy vajza dhe pesë djem“.

Dihja: „Nuk më duhen djemtë, ju lutem, ma ktheni Safijën time“.

Muhamedi: „Atëherë je dakord që të të jap edhe pesë deve?”

Dihja: „Rasulullah, unë kam mjaftueshëm deve nga sulmi i fundit. Dua Safijën”.

Muhamedi: „Dihja, mos u bëj kokëfortë si mushka, merr atë që të kam ofruar, para se të më ndryshojë mendja!”

Dihja e dinte se Profeti e realizonte atë që thoshte. Ai mori dy vajzat e reja dhe pesë deve dhe u largua me nxitim.

Sahih Muslim 8:3328:

I Dërguari i Allahut (...) mori Safijën në këmbim të shtatë krerëve.

Muhamedi atëherë nxiton për në çadër me Safijën. Aty kishte edhe tri vajza. Profeti e kaloi natën bashkë me to. Muhamedi thirri Usmanin, Alin dhe Umarin.

Muhamed: „Ali merre Rajtahun, Usman merre Zejneben! Umar, ty të pëlqejnë vajza të vogla, prandaj merre këtë, ajo është e vështirë sa pesë vajza të rritura”.

Nga pjesa e tij e femrave të zëna robinja, profeti ia dha kushëririn të tij, Aliut, vajzën skllave Rajtah bint Hilal për ta shijuar sipas dëshirës së tij. Ai i dha Uthman b. Affan, të adhuruarit të tij, vajzën tjetër skllave Zejnebb. Hajan, ndërsa një tjetër vajzë (emri i së cilës është i panjohur) e rezervoi për vjehrrin e tij, Omar Ibn Hatab. Omerit i dha atë vajzë për të birin e tij, Abdullah.

Safija: - Muhamed, si mund të jesh kaq mizor, çfarë nuk ju bëre atyre vajzave! Së pari i le jetime duke iu vrarë prindërit, më pas i përdhunove tërë natën dhe ditën pasuese dhe, së fundi, ua dhe burrave të tjerë.

Muhamedi: - Ajeti 04:20²⁴⁵ u jep burrave myslimanë këto privilegje.

²⁴⁵ Ajeti 4:20: "Në qoftë se ju dëshironi të ndërroni gruan, duke e lëshuar njëren për të marrë tjetrën, ndërsa njëres nga ato i keni dhënë shumë pasuri, mos merrni nga ajo asgjë. A do ta merrnit ju atë duke bërë shpifje dhe gabime sheshazi?"

Safija: - Po kjo vajza pesëvjeçare që kishe ti dhe tani ia dhe Umarit, si mund ta përballojë ajo marrëdhënien seksuale?!

Muhamedi: - Kush të tha se unë pata marrëdhënie seksuale me të?! Unë vetëm e kam ledhatuar. Rregulli im është, që kurrë të mos bëj seks me vajzat nën moshën 8-vjeçare.²⁴⁶

Nga Muftiu i madh Ebu Abdullah Muhamedel-Shemari, dijetari i madh i komitetit *Fetva*, numër reference 1809/1421/03/08:

„Ajo ishte gjashtë vjeçe dhe ai nuk mund të kryente marrëdhënie me të, për shkak të moshës së saj të vogël. Kjo është arsyeja pse Profeti (Paqja dhe lutja e Allahut qoftë mbi të!) vendos k... e tij midis kofshëve të saj dhe e ledhaton në tulet e buta”.

Kur Muhamedi eci drejt Safijës, ajo rezistoi. Si mund të pranonte ajo një njeri që sapo i kishte vrarë burrin.

Muhamedi: - Çfarë halli ke, Safija?

Safija: - Muhamed, nuk më pëlqejnë ata që vrasin njerëz të pafajshëm dhe dhunojnë gratë e tyre!

Muhamedi: - Çfarë po flet, nuk ishim ne, por Allahu ishte ai që i vrau përmes duarve tona. Këtu është ajeti 8:17: „Ju nuk i keni mbytur ata, por i ka mbytur Perëndia!...²⁴⁷”

Përveç kufarëve, të tjerët janë të pafajshëm, por janë viktime të shkreta. Pasi të kemi vrarë ata që na lejohen t'i vrasim, kryejmë marrëdhënie seksuale me gratë dhe vajzat e tyre në bazë të ajeteve 4:3, 4:24, 23:6, 33:50 dhe 70:30. Pra, harro këto brenga e shqetësime dhe më lejo tani të kënaqem. Unë nuk kam kohë për të humbur. Nëse ti reziston, do të të kthej përsëri te Dihja dhe do të kënaqem me vajza të tjera...²⁴⁸

²⁴⁶ Historia e Tabarit, vol. 8, faqe 29-30

²⁴⁷ Ajeti 8:17: “Ju nuk i keni mbytur ata, por i ka mbytur Perëndia! E ti nuk ke hedhur, por i ka hedhur Perëndia (ajo ishte hedhje e mrekullueshme) që nga vetja e besimtarëve, t'u dhurojë dhuratë të bukur. Perëndia, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë.

²⁴⁸ <http://www.islam-watch.org/AyeshaAhmed/Muhammad-and-Safiyah.htm>.

Safija mendoi se rezistenca është e kotë. Ajo, gjithsesi, do të përdhunohej nga profeti ose nga një tjetër xhihadist. Profeti, të paktën, furnizohej rregullisht me skllave (20 % e skllaveve të zëna robinja i takonin atij). Pastaj profeti kishte shumë gra të përherëshme dhe ajo do të tronditej më pak nga seksi me Profetin. Me cilindo xhihadist tjetër, ajo do të përdhunohej shpesh, madje edhe do të shitej më pas në një treg të skllëve, për ofertuesin me çmimin më të lartë. Ajo iu dorëzua Profetit, ndërsa ai zuri të shfryjë epshin e tij...

Në mes të natës Pejgamberi vuri re një njeri që përgjonte përmes një vrime në çadër, duke shikuar kënaqësinë e tij...

Bukhari 9/83/38:

Tregon Enesi: Një njeri përgjonte në çadër Profetin. Ai u ngrit, me synim që ta therte tinëzish me teh të majës së shigjetës. Por përgjuesi iku. Pas disa orësh të lutjeve dhe të gjumit, profeti iu afrua sërish Safijës për seks, por tashmë dëgjoji sërish disa lëvizje në afërsi të çadrës së tij. Përgjuesi ishte rikthyer. Këtë herë Profeti i egërsuar shkoi jashtë dhe ia preu k... përgjuesit kokëfortë.

Ibn Hisham, f. 766:

Safija ishte zënë robinjë gjatë sulmit në Kaibar dhe Profeti e kishte marrë me kompensim. Ajo atëherë ishte shtatëmbëdhjetë vjeçe. Herët në agim Profeti diktoi disa lëvizje në afërsi të çadrës. Ishte Ebu Ejubi (me gjasë përgjues edhe i mëhershëm). Muhamedi e pyeti çfarë po bënte në afërsi të çadrës së tij (Ebu Ejubi nuk kishte zënë ndonjë skllave gjatë atij sulmi, kështu që po e kompensonte këtë mungesë duke përgjuar të tjerët në çadra.) Ai u përgjigj: „Kisha frikë për ju me këtë grua të re. Ju i keni vrarë babanë, burrin dhe shumë të afërm dhe deri tani ajo ishte një jobesimtare. Sinqerisht kisha frikë për ju, mos po ju bënte ndonjë gjë, prandaj isha duke ju ruajtur“. Profeti (i besoi ose ndjeu mëshirë për njeriun fatkeq që kishte ngelë pa zënë robinjë) u lut për Ebu Ejub el-Ensarin.

Profeti 58-vjeçar pati një natë të bujshme me atë grua, së cilës sapo i kishte vrarë burrin. Ditën pasuese ai e mbuloi me një burkë (ferexhe) dhe e shpalli grua të tij.

Pas sulmit të befasishëm ndaj fisit jahudi Bani Mustaliq²⁴⁹, në dhjetor 627, natën, pa paralajmërim, Muhamedi dhe banda e tij xhihadiste bëjnë kërdrinë: therin shumicën e burrave, ndërsa gratë, fëmijët, kafshët, gjësendet me vlerë i grabisin si plaçkë lufte.

Bukhari, 3/46:717:

Profeti kishte sulmuar papritmas fisin Bani Mustaliq pa paralajmërim, ndërsa ata ishin të pavëmendshëm dhe bagëtia e tyre ishte duke u tallaz në vendet e ujit. Burrat e fisit u vranë dhe gratë dhe fëmijët e tyre u morën si robër.

Gjatë ndarjes së plaçkës, plasin grindjet mes xhihadistëve. Shumë prej tyre grumbullohen para kasolles së Muhamedit për të kërkuar drejtësi.

Muhamedi pyet xhihadistin Abu Zar: - Çfarë problemi ka?

Abu Zari: - Resulullah, mua më takojnë si plaçkë lufte një grua dhe burri i saj. Unë kreuva marrëdhënie seksuale me gruan në prani të burrit, të cilin e kisha lidhur. Tani po ndihem fajtor për seksin që kreuva me atë grua në sy të burrit të saj. Mund të më tregoni, ajo çfarë bëra ishte hallall?

²⁴⁹ Abū Khalīl, Shawqī (2003). Atlas of the Quran. Dar-us-Salam. p. 242. ISBN 978-9960-897-54-7; Mubarakpurī, Saifur Rahman Al (2005), The sealed nectar: biography of the Noble Prophet, Darussalam Publications, pp. 386–387; http://books.google.co.uk/books?id=r_80rJHlaOMC&pg=PA386#v=onepage&q&f=false http://en.wikipedia.org/wiki/List_of_expeditions_of_Muhammad Sunan Abu Dawood, 38:4390; Sahih al-Bukhari, 4:52:68; Sahih al-Bukhari, 4:57:66; Al Tabari, Michael Fishbein (translator) (1997), Volume 8, Victory of Islam, State University of New York Press, pp. 35–36. <http://www.islam-watch.org/AyeshaAhmed/Muhammad-Juwairiya-Aisha-Adultery.htm>

Profeti: - Po, është hallall! Allahu në ajetin 4:24 e ka bërë hallall seksin me gratë e zëna robinja lufte.

Abu Said Khudri (dhe tre xihadistë të tjerë): - Resulullah, ne na takuan gra të bukura si plaçkë luftime. Pasi t'i kemi shkërdhyer, duam që t'i shesim me çmim të mirë në tregun e skllëvërve në Medinë. Por, nëse i mbarësojmë gjatë seksit, u bie çmimi. E kem hallall që t'i q... dhe të mos ua derdhim spermën brenda (metoda „coitusinterruptus“), që të mos i mbarësojmë?

Profeti: - Mosderdhja e spermës brenda është e ndaluar (makrûh), meqë asnjë trup nuk ngjitet me barrë pa miratim të Allahut.

Muslim 19/4292:

I Dërguari i Allahut (paqja...) kreu sulm plaçkitje ndaj fisit hebre Benu Mustaliq (...). Ai i vrau ata që luftuan dhe burgosi të tjerët që u dorëzuan. Po atë ditë, ai skllavëroi Xhuvairija bint el-Harith.

Xhuvairija bint al-Harith (جويرية بنت الحارث), e lindur në vitin 608, u zu robinjë nga xihadisti Thabit bin Kajsbin Al-Shammas. Burri i saj ishte Mustafa bin Safva. Ai u vra në betejë²⁵⁰.

Thaibi u paraqit te çadra e Muhamedit, i shoqëruar me Xhuvairija, tepër e bukur. Ai thirri Profetin. Aishja doli jashtë.

Thaibi: - A është Resulullah në çadër?

Aishja: - Po, por tani është në krevet me një skllave. Mund t'ju ndihmoj unë.

Thaibi: - Kjo është Xhuvairija, vajza e kryefamiljarit të Harithit, tani është plaçka ime e luftës. Unë kam vendosur ta shes. Dua mendimin e të dërguar të Allahut...

Aishja (me zë të lartë): - Resulullah, nëse mbarove me Salmën, eja bisedo me një zonjë të re...

²⁵⁰ Alfred Guillaume, The Life of Muhammad: A Translation of Ibn Ishaq's Sirat Rasul Allah, p. 490-493.

Profeti e kishte dëgjuar paraprakisht bisedën. Doli jashtë, pa gruan të veshur lehtë, që kishte një bukuri magjepsëse.

Profeti: - Thaib, ke fjetur ti me këtë grua?

Thaib: - Ju betohem, unë as që e kam zhveshur.

Profeti: - Për këtë do të të jap dy deve dhe dy skllave nga plaçka që më takon mua. Këto kanë më shumë vlerë, sesa çmimi prej 9 kovash me arra që kërkove ti.

Thaibi: - Ky është pazar dhe varet krejtësisht nga ju.

Profeti: - Aishe, jepja skllavet e mia, Salmën dhe Barrën, Thaibit dhe thuaji Aliut që nesër t'i dorëzojë dy deve nga kopeja ime²⁵¹.

Pastaj Xhuvairija u martua me Muhamedin dhe e luti që t'i lironte robërit. Raportohet se rreth 100 familje të fisit e fituan lirinë prej saj.

Aishja, gruaja më e dashur e Muhamedit, në të shumtën e rasteve ndihej keq kur detyrohej të ndante çadrën me Muhamedin, i cili bënte seks me skllave. Ajo sapo futi në çadër skllaven e re, bukuroshen Xhuvairije, u egërsua nga xhelozia. Doli nga çadra dhe shkoi tek i riu bukurosh Safvan bin Muattal dhe i pëshpëriti një propozim.

Gjatë kthimit për në Medinë, kur terri mbuloi tokën dhe karvani u ndal për një pushim të shkurtër, Aishja u fsheh pas një kaçube dushku, derisa karvani u largua. Safvani bëri sikur po rrinte prapa për të parë mos karvani kishte harruar ndonjë plaçkë. Ata u takuan në vendin që kishin planifikuar. Natën e kaluan në qiellin plot e përplot me yje, duke bërë seks tepër epshor.

Në mëngjes Aishja i tha: - Safvan, të falënderoj. Kalova natën më të mirë në gjithë jetën time.

²⁵¹ Muslim, vëll. 19, nr. 4292.

Safvani: - Nuk ke nevojë të më falënderosh, se edhe unë përjetova shumë kënaqësi. Si t'u duka unë në krahasim me Resulullahin? Kam dëgjuar se Zoti i ka dhënë atij potencë seksuale sa të 30 burrave.

Aishja: - E tëra kjo është një mashtrim, që ai të madhërohet. Ai është një burrë i moshuar, tashmë i lodhur, si të gjithë moshatarët e tij. Tani ai provokohet vetëm nga vajzat e reja, skllave të zëna robinja në sulme plaçkitëse.

Safvani: - Le të largohemi tani dhe, të lutem, mendo një alibi të mirë.

Aishja: - Unë do të them dola të shëtis pak në natyrë, por me atë rast humba zinxhirin e qafës. U ndala për të pritur mëngjesin që ta gjej. Askush nuk do të shfaqë dyshim ndaj meje.

Safvani: - Kjo do të funksionojë. Unë do të them, ndenja për të kryer detyrimin tim si roje.

Aishja: - Askush nuk duhet të marrë vesh për fshehtësitë tona të ëmbla...

Ditën pasuese, pasdite, gjatë një pushimi, karvani pa Safvanin dhe Aishen sipër devesë në rrugëtim e sipër.

Abdullah bin Obaj (i njohur si përfolës): - E habitshme, natën e fundit Safvani dhe Aishja e kanë kaluar së bashku. Ata me siguri kanë...

E ndërpret një xhihadist: - Kjo tashmë po duket, shihni si duken të lodhur dhe të pagjumë, ata nuk duhet të kenë fjetur fare...

Abdullah: - Edhe unë po të isha në vend të tij, nuk do të flija fare.

Aishja dhe Safvani rrëfyen variantet e tyre, secili i pasigurt, por asnjëri nuk i besoi historisë së zinxhirit të humbur.

Për shkak të kësaj afere, Muhamedi e ktheu Aishen në shtëpi, tek Ebu Bekri (babai i saj). Në Medinë zuri të përflietj kjo ngjarje. Njerëzit po mendonin të fillonin të gjuanin me gurë Aishen, sipas traditës dhe normave islame.

Babai i Aishes, Ebu Bekri, ishte shtyllë qendrore e „misionit” të Muhamedit, prandaj ai nuk mund t'i prishte marrëdhëniet me të. Profeti vendosi ta merrte në mbrojtje Aishen. Caktoi rregullin e dëshmisë së katër burrave, të cilët duhej të dëshmonin se kishin parë

një marrëdhënie ilegale seksuale (e sanksionuar edhe në *Kuran*). Me këtë truk Muhamedi e shpëtoi kurorën me Aishen, sepse nuk mund të gjendeshin katër burra që të dëshmonin.

Në të dy rastet e përdhunimit të këtyre dy viktimave, Muhamedi nuk i ka respektuar përcaktimet kuranore, siç janë: s'kishte pritur përfundimin e stazhit dymujor të të qenit vejushë dhe kishte bërë seks me gra, me të cilat ende nuk ishte martuar. Në të dyja rastet ai i ka paguar bashkëlufëtaret e tij, meqë ata i kishin grabitur të parët ato viktima gjatë luftimeve. Ndërsa besimtarët injorantë myslimanë, blerjen e tyre nga Muhamedi e çmojnë si vullnet të mirë dhe humanitar të tij, për të paguar çlirimin e tyre nga skllavëria.

Të dyja rastet janë dëshmi për mendësinë prej dhunuesi seksual që kishte Muhamedi, maniaku unikat seksual...

Tematikë akoma më perverse për mendësisë kriminale të Muhamedit është edhe nekrofilia.

Deri tani kam lexuar për disa raste, ku përflitet Muhamedi si nekrofil. Rasti i parë është hadithja që do të paraqes në vazhdim. Tjetri është dhunimi që i Muhamedi i ka bërë kufomës së gruas së xhaxhait (nënës së Aliut), me arsyetimin se ajo do të kualifikohej si „nënë e myslimanëve”, sepse e ka pasur grua „I Dërguari i Allahut”. Po e tregoj edhe një rast tjetër, kur Muhamedi ka bërë seks me një kufomë në varr, për të dëshmuar edhe këtë lloj perveristetit të „profetit” .

Sahihal-Bukhari (dez)informon:

Tregon Anas bint Malik: „Ne gjendeshim në varrimin e njëjës prej vajzave të Profetit dhe ai ishte ulur anash varrit. Unë pashë sytë e tij që lotonin. Ai tha: „A ka këtu mes jush ndonjëri që nuk ka bërë seks me gruan e tij natën e shkuar?” Abu Talha u përgjigj në mënyrë pohuese. Dhe

*Profeti i tha atij të hynte brenda varrit. Dhe ai u fut në varr, sipër kufomës së saj*²⁵².

Raymond Ibrahim ka dhënë sqarime rreth karakterit nekrofil të Muhamedit, kur në parlamentin egjiptian u ashpërsuan debatet, në prill e në maj 2012, lidhur me insistimin e partisë në pushtet, Vëllazëria Myslimane, për ta legalizuar këtë lloj perversiteti. Ai shpjegon se parlamentarët e kësaj partie ndihen të detyruar ta legalizojnë me ligj nekrofilinë, meqë e kishte praktikuar Muhamedi. Këtu ofrohet edhe një hadithe për marrëdhëniet seksuale të Muhamedit, me kufomën e një gruaje të sapolëshuar në varr²⁵³.

Kundër projektligjit për legalizimin e nekrofilisë ka protestuar edhe Këshilli i Grave të Egjiptit në muajin prill 2012.²⁵⁴

Edhe për zoofili të Muhamedit janë transmetuar informata burimore. Hadithet e mbledhura nga Sahih Al-Bukhari, vëll. 2, nr. 357 dhe vëll. 1, nr. 213, (dez)informojnë për marrëdhëniet e Muhamedit me devenë e tij. Është e neveritshme të paraqiten tekstet e këtyre haditheve. Duke u bazuar në këtë perversitet të Muhamedit, Ajatollah Ruhollah Khomeini e ka legalizuar në Iran, në vitin 1990, marrëdhënien seksuale me kafshë (dele, lopë, deve), por e ka kushtëzuar me therje të asaj kafshe „të fëlliqur“ nga orgazma e burrit, dhe me shitjen e mishit të viktimës larg katundit ku është praktikuar ky perversitet.²⁵⁵

Për një lloj tjetër të perversitetit të Muhamedit ka informuar edhe Imam Xhafar as-Sādiq (إمام جعفر الصادق). Ai ka jetuar në vitet 700 -

²⁵²Sahihal-Bukhariu, hadithja numër 374, Libri 23, Volumit 2; edhe në hadithen *Al-Bukhariu* 7:65:366 (dez)informohet për nekrofilin të Muhamedit.

²⁵³<http://www.raymondibrahim.com/islam/islamic-death-sex-in-context/>.

²⁵⁴<http://english.alarabiya.net/articles/2012/04/25/210198.html>.

²⁵⁵ <http://koptisch.wordpress.com/2012/12/15/hadith-beweist-mohammed-hatte-sex-mit-tieren/>.

765, ka qenë imami i 6-të i Imamëve dhe themelues i shkollës së parë juridike islame. Ai ka (dez)informuar:

Aishja, e kapluar nga zilia, i thotë Muhamedit: „O i Dërguari i Allahut, unë shoh shpesh se Ju po puthni Fatimen (e bija e Muhamedit) në gojë dhe gjuhën Tuaj e fusni në gojën e saj dhe e mbani gjatë brenda. Pse?“

I Dërguari i Allahut i është përgjigjur: „Po, unë e puth Fatimen në gojë dhe gjuhën time e fus në gojën e saj, kur përmallem për parajsën. Te Fatimja unë ndiej aromën e parajsës dhe të pemës tubi, e cila gjendet në parajsë, sepse Fatimja është një femër hyjnore.²⁵⁶

[Teksti në origjinal i kësaj haditheje:]

يارسواللهميينمدهانفاطمهرازيادميوسيوزياتتر :گفت [ازرويحسادت] عايشه :فرمود امامصادق
ادردهانشفقاراميدهي .

بله، هرگاه مشتاقی به شومد هانفاطمه را میبوسموزباندردهانشمیگذارم : پیامبر اکرم فرمودند

”بوی بهشت را استشمام میکنم بوی شجر هطوبیر امیایم، زیرا اوز نیاسمانیست فاطمه مناز

اینرو ایندر کتابا علامالور یصفحه ۵۰ نیز آمده است)

Edhe disa të dhëna të tjera, që na janë përcjellë nga burimet autentike islame, të cilat dëshmojnë edhe për dhunti të tjera perverse të Muhamedit:

Bukhari 3/34/432:

Transmeton Ebu Saidel-Hudri: „Ndërsa ai ishte me të dërguarin e Allahut tha: „O i dërguari i Allahut! Ne kemi robër femrat, si pjesë e presë tonë të sulmit. Jemi të interesuar që çmimet e tyre të mos ulen, nëse i mbarësojmë, meqë nuk mund ta tërheqim penisin pa e zbrazur“. Profeti tha: „Vërtet mendoni se ashtu do të ndodhë? Është më mirë për ju që të mos e bëni. Asnjë shpirt nuk krijohet pa vullnetin e Allahut“.

Bukhari 7/62/130:

Tregon Abdullahu: „Në betejat e shenjta, të udhëhequra nga Profeti i Allahut, nuk kishim gra me vete. E pyetëm Profetin: „A duhet ta tregohim

²⁵⁶ <http://nimari.blogspot.de/2013/12/the-perverse-muhammad-der-perverse.html>.

veten?” Profeti na e ndaloi, duke na lejuar të marrim gra me kontratë të përkohshme”.

Safvan Bin Muatal (një djalë bukurosh): - Rasulullah, unë kam qenë larg nga gruaja ime për një kohë të gjatë. Në këtë sulm munda të grabis vetëm dy dhi. Ju lutem, mos më thoni për të bërë seks me dhitë, sepse unë nuk kam shije për kafshët, si disa nga xhihadistët e tjerë... Po ndizem si zjarri i xhehenemit. Çfarë mund të bëj?

Profeti: - Shko huazo një vaginë nga ndonjë mik.

Bukhari, 1183:

Profeti kapi një djalë të zënë rob. Profeti (Allahu e bekoftë dhe i dhëntë paqe!) hapi gojën dhe gjuhën e tij e vuri në gojën e tij.

Sunan Bejhekiu dhe Al Halabi shpjegojnë:

Sipas kësaj haditheje, një njeri me emrin Zahir pati deklaruar: „Profeti më do”, tha se një ditë Muhamedi, në befasi, m’u ngjit prapa dhe më përqafoi. Zahiri, i alarmuar, thirri: „Më liro!” Kur kthen kokën, sheh se ishte profeti Muhamed i dorëzuar. Muhamedi po fërkonte gjoksin e tij me gjoksin e Zahirit.

Sunan Ebu Davud (njëri nga gjashtë koleksionet e haditheve) vë në dukje se Muhamedi ngriti këmishën e tij, që Zahiri t’ia puthte gjithandej gjoksin, „duke e lëpirë deri në mes të këmbëve“.

Safvani: - Rasulullah, kurrë nuk kam zhvilluar një shije për burrat.

Profeti: - Fatkeqësia jote, sepse është një kënaqësi e mrekullueshme!

Këto paraqitje dhe shumë të tjera janë aq perverse, sa provokojnë dyshimin se i kanë sajuar islamofobët, por meqë janë përcjellë nga personalitet më autentike islame, jemi detyruar t’i pranojmë si të dhëna burimore islamike. Dhe pikërisht këto e nxitin një kategori besimtarësh, që ta adhurojnë akoma më shumë „profetin” e tyre. Fatkeqësisht!

I. 7. Muhamedi - prokuror, gjyqtar, ekzekutor

Muhamedi, i afirmuar si profet, respektivisht si I Dërguar i Allahut, paqësor, sipas trashëgimisë islame, në fakt duhet të ketë qenë një diktator tepër vulgar e mizor. Ai vetë i identifikonte dhe i dënonte refuzuesit e islamit. Kritikuesit dhe kundërshtarët i hetonte, i gjykonte, urdhëronte që të vriteshin dhe, në ndonjë rast, edhe i ekzekutonte.

Nuk janë të rralla rastet kur ithtarët e „profetëve” ishin të bindur se Zoti po i ngarkonte ata për të udhëhequr e sunduar, që të krijonin rend e rregull në tokë. Një kategori e atyre njerëzve ia kanë dalë të imponohen, fillimisht duke indoktrinuuar e përvetësuar përkrahësit e tyre.

Sipas dogmës fundamentale të religjionit islam, të sanksionuar në të ashtuquajturin *Kuran* (shqip: recital), 27 veta janë të evidentuar me emër si profetë (për dy prej tyre, Imran dhe Benjamin, vazhdon diskutimi, nëse ishin ose jo profetë). Në *Kuran* dhe në burime të tjera autentike islame thuhet se secili popull kishte profetët e tij dhe se gjithsej janë hiç më pak se 124.000.²⁵⁷

Krahas procesit të eskalimit të tij në diktator të dhunshëm e mizor, Muhamedi sajoi edhe doktrinën përkatëse zakonore, që në atë kohë e quanin kanun. Ato që sajonte kryesisht Muhamedi, por edhe ndonjë poet pagan e misionar çifut akristian, që i kishte grumbulluar Muhamedi si bashkëmendimtarë e bashkëveprimtarë, u përmblodhën, pas vdekjes së tij, në veprën tashmë të njohur: *Kuran*.

Ja përcaktimet „juridike”, të sajuara nga Muhamedi, për t’i dhënë të drejtë vetvetes, për të ushtruar diktaturën e tij mizore:

Nëse hipokritët, ata që kanë zemra të sëmura dhe ata që përhapin gënjeshtër në Medinë, nuk ndalen, Ne bëjmë që ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë më fqinjë me ty, pos vetëm në një kohë të shkurtër. [33:60]

Të mallkuarit, kudo që të ndeshen, do të kapen dhe do të mbyten. [33:61]

²⁵⁷ <http://www.eslam.de/begriffe/p/prophet.htm>.

Ky është Ligji i Allahut... [33:62]

Vetëm ndonjë mysliman fanatik fundamentalist mund të gjejë ndonjë arsyetim që bie ndesh me këto përcaktime të qarta - vendimi i Muhamedit për t'i zhdukur „hipokritët”, „zemërsëmuret”, „gënjesh-tarët”, më saktësisht: gjithë jomyslimanët. Pothuajse të gjitha përkthi-met e *Kuranit* që kam konsultuar, kanë të njëjtën përmbajtje. Në përkthimet në gjermanisht nuk përmendet emri *Medinë*, por vetëm emri *qytet*, që vetëkuptohet se është fjala për Medinën.

Muhamedi nuk ishte aq analfabet, siç e pandehnin dhe e pandehin ende myslimanët. Analfabetizmin e tij ata e shpërdorin si truk për të mashtruar se Muhamedi nuk i ka lexuar “librat” pararendës dhe, prandaj, nuk ka mundur të jetë plagjiator.

Muhamedi ka sajuar legjitimitetin juridik për diktaturën e tij vrastare, duke e kamufluar atë si vullnet e përcaktim të Allahut. Dhe, tashmë, dihet se Muhamedi ishte „vula” e profetëve, që do të thotë kryeprofeti, siç e kishte sanksionuar ai vetveten me ajetin 33:40.

Që të mos ngelim vetëm në planin e „juridiksionit” muhamedan, po ofrojmë (dez)informime konkrete, për angazhimet e Muhamedit në likuidimin e kritikëve dhe kundërshtarëve të tij fetarë e politikë.

1.1.1 • Vrasja e poetes **Aşmā' bint Marwān** (عصماء بنت مروان), më 26 janar 624, ishte fillimi i serisë së vrasjeve të kritikëve të tij (këto vrasje sot do të quheshin *vrasje politike*). Ajo ishte çifute, nënë e pesë fëmijëve. Më i vogli ishte ende në gji.

Në një poezi ajo ka mallkuar vrasjen e pastrit plak Ebu Afak dhe ka bërë thirrje për kryengritje kundër Muhamedit. Sipas Ibn Isakut, nga frika, i gjithë klani i fisit të saj, po atë ditë, u konvertua në islam...²⁵⁸

²⁵⁸ William Muir, *The life of Mahomet*, Smith, Elder and co, p. 130, 1861;
<https://books.google.co.uk/books?id=YDwBAAAAQAAJ&pg=front#v=onepage&q&f=false>;

1.1.2 • Vrasja e **An-Nadrbinal-Harit'h** (النضر بن الحارث), në mars 624, u bë për shkak të armiqësisë së krijuar qysh në kohën e angazhimit të Muhamedit në Mekë. Al-Nadër i përkiste fisit Kurejsh, që i bie se ai ishte kushëri i Muhamedit.

Në Mekë organizohet një debat për misionarizimin e fesë së re të Muhamedit. Po ofrojmë fragmente të atij debati, bazuar në monografinë e Ibn Isakut:

Mekasit i thanë Muhamedit: „Nëse nuk do të pranosh çfarë të kemi kushtëzuar, ta dish, do të kemi një jetë të vështirë, sepse ne po na mungon uji dhe lugina jonë është shumë e ngushtë. Prandaj lutju Zotit tënd që të ka dërguar, ti heqë bjeshkët, që të na zgjerohen fushat dhe të na sjellë lumenj si në Siri dhe Irak. (. . .) Ne duam të sprovohet nëse po thoni të vërtetën apo po gënjeni. Po u realizuan kërkesat tona, ne do të njohim gradën tuaj të lartë nga Perëndia, dhe do t'ju respektojmë si të Dërguarit të Tij”.

Muhamedi u përgjigj: „Unë nuk jam dërguar për ato që dëshironi ju, unë ju kam sjellë atë që Zoti më ka ngarkuar për ju. Nëse e pranoni, do të jetë fati juaj në këtë dhe në jetën tjetër, në qoftë se jo, unë do të pres me durim, derisa Perëndia të vendosë çfarë duhet të ndodhë mes nesh“.

Ata ia kthyen: „Nëse ti nuk e bën këtë, atëherë përkujdesu vetë për veten tënde...”²⁵⁹ „

Ebu Xhahl, i fisit Kurejsh, ka raportuar për atë debat: „Ju e shihni se Muhamedi nuk dëshiron asgjë tjetër, pos të fyejë baballarët tanë, të na paraqesë sitë marrë dhe t'i blasfemojë zotat tanë”. Ai u betua po atë mbrëmje, se do ta vriste me gur Muhamedin gjatë lutjes së mëngjesit. Megjithatë, kjo vrasje nuk ndodhi dhe për të u thurën legjenda.

Muhamedi ishte armiqësuar me Al-Nadër bin Alharith jo për pjesëmarrje në këtë debat, por për (dez)informimin e tij:

Sad, Ibn. Kitabal-tabaqatal-kabir, Volume 2. Pakistan Historical Society. p. 35; Ibn Hisham, Ibn Ishaq, Alfred Guillaume (translator), The life of Muhammad: a translation of Ishāq's Sīratrasūl Allāh, p. 210.

²⁵⁹ Cituar sipas Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, 1. Band, Seite 140.

„Mua më është thënë, se Ibn Abas ka thënë: El-Nadër kishte sajuar tetë ajetet e Kuranit”.²⁶⁰

Kjo duhet të ketë qenë pika më nevralgjike, sepse Muhamedi me bashkëmendimtarë e bashkëveprimtarë është dashur të imponohet përmes Kuranit, të cilin Allahu ia paska dërguar Muhamedit. Edhe tani besimtarët irritohen dhe egërsohen kur përpiqesh t’u sqarosh se Allahu nuk është autor i *Kuranit*, por Muhamedi me bashkëmendimtarë, si në rastin konkret, El-Nadri.

Vrasje duhet të jetë konkretizuar si vijon:

„Muhamedi u kthye (nga beteja buzë Bedrit) me të zënë robër, që ishin idhujtarë nga Medina. Mes tyre ishte edhe Okba Ibn Ebi Mueitdhe el-Nadrbin Alharith. (...) Kur Muhamedi arriti në Safra, në gjysmë të rrugës për në Medinë, urdhëroi Aliun që ta vraste Al-NadrbinAlharith.”²⁶¹

• Vrasja e **Ka’bibnal-Aschraf**(كعب بن الأشرف), poeti fisit çifut Nadir, është bërë po me urdhër të Muhamedit²⁶². Vrasja duhet të ketë ndodhur pas betejës në Badër (17. 03. 624 / 17 Ramadan viti 2 i hixhrit). Sipas islamologut Gustav Weil, vetë Muhamedi duhet ta ketë urdhëruar **Muhamed Ibn Maslama**, për të organizuar vrasjen e Kaab ibn al-Aschraf. Për këtë vrasje është dhënë ky (pseudo)-arsyetim: Kaab paskësh marrë shkas nga vrasjet që kishin bërë falangat xihadiste ndaj kurejshëve në betejë, buzë Bedrit, dhe e paskësh kritikuar Muhamedin, por **Muhamed Ibn Maslama** e kishte therur me thikë Kaab ibn al-Aschraf, për t’u shkaktuar frikë të gjithë arabëve çifutë, se aty e tutje do të jenë përherë të rrezikuar nga muhamedanët.²⁶³

²⁶⁰ Ibn Isak, cituar sipas Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, 1. Band, Seite 143.

²⁶¹ Ibn Isak, cituar sipas Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, 1. Band, Seite 342;

²⁶² Uri Rubin: *The Assassination of Ka’b b. al-Ashraf*. In: *Oriens* 32 (1990). S. 65

²⁶³ Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, 2. Band, Seite 6-8.

Për këtë vrasje kaq mizore (dez)informon edhe hadithja përkatëse, e publikuar nga Sahihal-Buhari:

„Transmeton Xhabir bin 'Abdullah: I Dërguari i Allahut pyeti: Kush është i gatshëm që ta vrasë Kaab ibn al-Ashraf, i cili ka lënduar Allahun dhe të dërguarin e Tij?“ Muhamed bin Maslama u ngrit duke thënë: „O I Dërguar i Allahut, do t'ju pëlqen që unë ta vras atë?“ Profeti u përgjigj: „Po!“ (...)²⁶⁴

• Vrasja e Sallam in Abual-Huqayq (سَلام بن أبي الحقيق), poet, gjithashtu i fisit çifut Nadir, tashmë të shpërngulur në Khajbar. Edhe për këtë vrasje urdhrin e dha Muhamedi, ndërsa vrasjen e bëri **Abdullah ibn 'Atik**²⁶⁵. **Sërish akuza ishte pjesëmarrja në organizim të kundërshtarëve, në Betejën e Llogoreve.**

Edhe për këtë vrasje ekzistojnë hadithe përkatëse, të cilat (dez)informojnë pse dhe si duhet të ketë ndodhur kjo vrasje. Citoj:

Ka rrëfyer El-Bera bin Azib: „I Dërguari i Allahut angazhoi disa burra nga ensarët për të vrarë çifutin Sallam bin Abual-Huqayq dhe e emëroi Abdullah bin Atik si udhëheqësin e tyre. (...)”²⁶⁶

• Vrasja e **Ukba bin Ebu Muajt** (عُقبَة بن أبو معيط), i fisit Kurejsh, është e ndërlidhur me armiqësinë e Muhamedit ndaj Al-Nadër bin Alharith. Ai ishte fqinji i parë i Muhamedit. E kundërshtonte dhe e kritikonte monoteizmin e tij, nga pozicioni tradicional i paganizmit, të cilit i takonte fisi Kurejsh. Thuhet se ai e kishte denigruar rëndë Muhamedin, kur ai po lutej para Qabesë pagane. Ia kishte tërhequr disa herë vërejtjen, por njëherë kishte marrë plëndësin e një deveje të sapotherur dhe ia kishte vendosur sipër, kur Muhamedi ishte me kokë në sezhde...²⁶⁷

²⁶⁴ Sahih al-Bukhari v. 5/59/369; <http://www.usc.edu/org/cmje/religious-texts/hadith/bukhari/059-sbt.php>.

²⁶⁵ Al-Tabari, f. 100;

<https://books.google.co.uk/books?id=ctvk-fdtklYC&pg=PA100#v=onepage&q&f=false>.

²⁶⁶ Sahih al-Bukhari v. 5/59/371.

²⁶⁷ Sahihal-Bukhari, 6/60/339 dhe 1/9/499.

Ekspertët e *Kuranit* kanë (dez)informuar se me atë rast, Muhamedit i „kanë zbritur“ ajetet:

Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart eveta dhe do të thotë: „I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” [25:27]

O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! 25:28]

Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej saj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar. [25:29]

Krerët e Kurejshëve duhet t'i kenë dërguar Ukbën dhe Al-Nadrin në Medinë, që t'i kontaktonin rabinët dhe t'i informonin ata për raportet konfliktuale që kishin kurejshët e Medinës me Muhamedin.

Muhamedi dha urdhër për ta ekzekutuar edhe Ukba bin Ebu Muajt. Në prag të ekzekutimit me heqje koke, ai e pyeti Muhamedin: „Kush do të përkujdeset për fëmijët e mi?”. Muhamedi iu përgjigj: „Ferri”! (xhehenemi)”.²⁶⁸

• Vrasja e **Umajjah ibn Khalaf ibn Safvan** (أمية بن خلف). Ai ishte pjesëtar i krerëve të fisit Kurejsh dhe kryeplak i klanit Beni Xhumah, por kundërshtar fetar i Muhamedit. Qe eksponuar për torturën që i bëri skllavit Bilal ibn Rabah, për shkak të konvertimit të tij në islam. Edhe ky u vra në betejën buzë Bedrit, po me urdhër të Muhamedit, të cilin e kishte marrë para se të ndodhte beteja. E vrau Bilalli, ish-skllavi i tij, meqë e kishte dëgjuar Muhamedin, komandantin e tij, se ai duhej vrarë²⁶⁹.

Armiqësia e Muhamedit ndaj Umajjës, sipas Ibn Isakut, e ka zanafillën qysh nga koha kur Muhamedi po misionarizonte hapur në Mekë.

Kur Muhamedi po rrotullohej rreth Qabesë u ballafaqua me El Esved Ibn Almuttalib, Vied ibn Umejje dhe Halef Almughira, të gjithë

²⁶⁸ Ibn Isak, cituar sipas Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, I. Band, Seite 342.

²⁶⁹ Sahihal_Buhari, 4/65/826 dhe 3/38/498.

njerëz të respektuar ndër fiset e tyre. Ata i thanë: „E pra, Muhamed, ne do t’i lutemi Zotin tënd, lutju edhe ti zotave tanë, në mënyrë që të gjithë të lutemi së bashku;nëse ai që iu lute ti është më i mirë, do të kemi edhe ne pjesën tonë, ndërsa nëse ata që ju lutemi ne janë më të mirë, do të kesh edhe ti hisen tënde²⁷⁰ „.

Me atë rast, si kundërpërgjigje ndaj propozimit të tyre, Muhamedit duhet t’i „ketë zbritur” nga Allahu surja *Al-kafirun* (jobesimtarët), e renditur ndoshta nga „komisioni redaktues” i kalifit Utman (në vitin 651) në nr. 109 në *Kuran*:

Thuaj: „O jobesimtarë, [109:1]

Unë nuk adhuroj atë çka adhuron ju, [109:2]

Por as ju nuk adhuron atë që adhuroj unë, [109:3]

Unë nuk jam adhures i atyre që ju i adhuron, [109:4]

Por edhe ju nuk jeni adhures të asaj që adhuroj unë. [109:5]

Ju keni fenë tuaj, kurse unë kamë fenë time”. [109:6]

Po vetëkuptohet se Muhamedi duhet t’i ketë sajuar ajetet e suret, sipas nevojave e ballafaqimeve, si ky rast, dhe Allahu i tij ishte vetëm një personazh, si gjetje mashtruese e Muhamedit, sipas modelit të „profetit” Moisi. Gjithashtu, duhet të thuhet se kjo sure, e sajuar në Mekë, ka përmbajtje të tolerancës reciproke mes feve pagane dhe islamit, por fatkeqësisht kjo sure dhe të tjera me frymë të ngjashme, duhet t’i ketë abroguar Muhamedi më vonë, me sajim të ajeteve luftarake të Medinës.

• Urdhri i Muhamedit për vrasjen e **Ibn Sunejnës**²⁷¹, mund të (keq)kuptohet si urdhër i përgjithësuar, për të vvarë gjithë çifutët. Sipas

²⁷⁰ Ibn Isak, cituar sipas Gustav Weil, Das Leben Mohammeds, I. Band, Seite 178.

²⁷¹ IbnIsak, Sirat Resul Allah, sipas përkthimit në anglisht nga Alfred Guillaume, f. 369;

<https://archive.org/stream/IbnIshaq-SiratuRasulAllah-TranslatorA.Guillaume/IbnIshaq-SiratuRasulAllah#page/n207/mode/2up>.

hadithes së Sahihal-Bukharit, Muhamedi në rastin kur ka marrë vendim për vrasjen e çifutit Ibn Sunejna, duhet të ketë thënë:

Rrëfyer nga Ebu Hurejre: I Dërguari i Allahut ka thënë: „Dita e gjykimit nuk do të ndodhë derisa ju nuk keni mbaruar luftën me çifutë, dhe secili gurë, prapa të cilit fshihet një hebre, do të thërrasë: “Oh mysliman! Është fsheh një çifut pas meje, prandaj vrite”.²⁷²

Ne këtë rast Muhamedi duhet të ketë sajuar edhe ajetin:

Perëndia, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e vet trupin dhe pasurinë e tyre, për t’iu dhuruar atyre xhenetin. Ata luftojnë në rrugën e Perëndisë, vrasin dhe vriten. Ky është premtimi i tij i vërtetë në Teurat, Inxhil dhe Kuran. E kush është më i saktë se Perëndia në premtim? Ndaj, gëzojuni këtij pazari që keni kontraktuar me Të, dhe kjo është fitore e madhe. [9:111 / shq. nga H. E. Nahi]

Ndoshta komentimi i këtij ajeti është i panevojshëm, meqë është një formulim tepër konkret, gjithsesi irritues, që reflekton mendësinë e shpërfytyruar të Muhamedit.

Mes'udinn Muhajjisa ishte dorasi i urdhëruar nga Muhamedi.²⁷³

Se duhet të ketë pasur program kundër çifutëve, gjatë sundimit të Muhamedit në Medinë, këtë e dëshmon edhe fakti se tri fiset çifute të Medinës, Banu Kuraiza, Banu Kainuka dhe Banu Nadir, që përbënin shumicën e popullsisë, u dëbuan dhe u asgjësuan nga falangat xhihadiste muhamedane. Kundër Banu Kuraizës (بنو قريظة; بنو قريظة) u bë një masakër e madhe, me vendim të Muhamedit, i cili urdhëroi Sad ibn Muadh që të ekzekutonte me prerje koke të gjithë burrat e fisit. Kjo duhet të ketë ndodhur menjëherë pas Betejës së Llogoreve (mars 627), e cila përfundoi pas rreth dy javësh shtettrrethimi. Muhamedi akuzoi fisin Kuraiza se kishin bashkëpunuar me rrethuesit e Medinës, të cilët ishin kurejshët e Mekës. Mu për këtë arsye, në qendër të

²⁷² Sahihal-Bukhari, hadithe 4/52/177.

²⁷³ <http://islamicresponse.blogspot.de/2008/07/allegation-that-muhammad-killed-ibn.html>.

Medinës i detyrojnë burrat t'i hapin vetë varret dhe, pastaj, falangat xhihadiste muhamedane ua presin kokat. Brenda ditës duhet të jenë ekzekutuar 600 ose 900 veta, duke marrë pjesë aktive në vrasje edhe vetë Muhamedi.²⁷⁴

Ja çfarë ajetesh duhet t'i „kenë zbritur“ vrasësit Muhamed për këtë masakër, vërtetësisht ja çfarë ajetesh ka sajuar vrasësi Muhamed për të arsyetuar atë masakër:

E ata nga ithtarët e librit (jehudinjtë), të cilët i ndihmuan ata (idhujtarët), Ai (All-llahu) i nxori prej kështjellave të veta dhe në zemrat e tyre futi frikën, dhe një grup e mbytni, kurse grupin tjetër e robëroi. [33:26]

E juve ju la trashëgim tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasurinë e tyre dhe tokën që ende nuk e keni shkelur. All-llahu është i gjithëfuqishëm për çdo send. [33:27]

Duhet të kesh mendësi fashistoide muhamedane, për të arsyetuar atë masakër, që mund të krahasohet me shifrat e krimeve të shek. 20. Është fjala për një popullsi të Medinës me rrethinë, që ndoshta nuk duhet të ketë qenë as 15 mijë banorë dhe Banu Kuraiza duhet të ketë pasur rreth 4 mijë banorë. Pastaj, po të kishte pas Muhamedi teknikën vrastare të shek. 20, me atë mendësi fashistoide që kishte, përmasat e masakrave dhe krimeve të tij do të ishin shumë më të mëdha.

Fatkeqësia bëhet akoma më tragjike, kur të gjithë myslimanët fundamentalistë, intimisht dhe publikisht, e arsyetojnë atë masakër, duke e shpërdoruar edhe agresionin agresiv të nacionalistëve izraelitë në territorin e Palestinës, të pushtuar prej tyre. Të dy palët, reciprokisht, ushqehen me ideologji të tyre fashistoide, që burimin e kanë në „libra“ përkatës dogmatikë fetarë, që vetëm të shenjtë nuk meritojnë të quhen!

²⁷⁴ W. Montgomery Watt: *Muhammad at Medina*. Oxford University Press, 1962. S. 214; <https://archive.org/stream/muhammadatmedina029655mbp#page/n235/mode/2up>.

Meir J. Kister: *The Massacre of the Banū Qurayza: A re-examination of a tradition*. In: *Jerusalem Studies in Arabic and Islam* 8 (1986). S. 62.

• Vrasja e **Umm Kirfa Fatimas**²⁷⁵ duhet të ketë ndodhur në vitin 630, po me urdhër të Muhamedit. Ajo ishte një plakë arabe, moshatare e Muhamedit. Ajo i përkiste një fisi pagan, të quajtur Benu Fazara, në Vadiel-Kurra. Kjo plakë protestoi kundër vrasjes së kryeplakut të fisit, që ishte burri i saj, me rastin e një sulmi plaçkitës të Muhamedit dhe falangës se tij xhihadiste. Ajo u mor robinjë dhe, me urdhër të Zejd bin Harithe, u ekzekutua mizorisht: i lidhën dy deve në secilën këmbë të saj dhe devetë i tërhoqën në drejtim të kundërt dhe plakën fatkeqe e ndanë në dysh...²⁷⁶

• Vrasja e profetit të vetëshpallur **Esved el-Ansi**²⁷⁷ duhet të ketë qenë vrasja e fundit e Muhamedit. „Faji” i kësaj viktime ishte afirmimi i tij si „profet”, sipas modelit mashtrues të Muhamedit, dhe prandaj Muhamedi e përjetonte afirmimin e tij si diskreditim dhe konkurrencë. Kjo vrasje duhet të ketë ndodhur më 3 qershor 632, pesë ditë para vdekjes (gjegjësisht helmimit komplotist) të Muhamedit.

Emrat e 43 personave, ndaj të cilëve Muhamedi mori vendim dhe urdhëroi vrasjen e tyre, ndodhën në një listë tepër të kompletuar me të dhëna të shumta burimore, të publikuar nga portali „wikiislam”²⁷⁸. Ata u vranë siç u vranë edhe personat e cekur më lart, sepse ishin kritikues e kundërshtarë politikë të Muhamedit.

²⁷⁵ http://www.wikiislam.net/wiki/The_Story_of_Umm_Qirfa#cite_ref-1.

²⁷⁶ The History of Al-Tabari: the Victory of Islam, trans. Michael Fishbein, vol. 8, SUNYP, 1997, pp. 95-97;

²⁷⁷ <http://www.derletzteprophet.info/chronologie-der-epoche-des-propheten-mohammed-sav>.

²⁷⁸ http://wikiislam.net/wiki/List_of_Killings_Ordered_or_Supported_by_Muhammad.

II. 1. Kurani - mënyra e shpalljes

Një nga tematikat për çmitizimin e *Kuranit*, si vepër e sajuar prej njerëzve, është diskualifikimi i mashtrimit të madh, kinse Allahu ia paskësh komunikuar Muhamedit tekstin e *Kuranit*.

Ndoshta është me rëndësi të analizojmë vetë tekstin e *Kuranit*, për të parë se si autorët e tij janë përpjekur të kamuflojnë autorësinë e tyre, duke dezinformuar se teksti i *Kuranit* si „libër“ i qenkësh „zbritur“, „shpallur“, „zbuluar“ Muhamedit nga Allahu, duke e përdorur engjëllin Xhibril si korrier, ose vetë Muhamedi duke i zhurmuar Allahu në vesh me tone që u ngjasonin zileve (siç thuhet në *hadithin* përkatës).

Për të mos e rënduar këtë shqyrtim, po bazohemi vetëm në përkthimin e autorizuar të *Kuranit* nga teologu Sherif Ahmeti.

Në gjithë tekstin e *Kuranit*, kur ndodh dezinformimi, kinse se teksti, si ajet, si: ajet (ajet), kaptinë (sure), si libër, si *Kuran*, i “paskësh zbritur” Muhamedit nga Allahu, folja *zbrit* është përdorur 63 herë.

Muhamedi me bashkautorë, kur duhet kenë menduar për zbritjen e *Kuranit*, tokën duhet ta kenë përfytyruar të rrafshët. Sipas tij, prej kupolës së 7-të të qiellit, të vendosur mbi tokë, paskëshin zbritur ajetet, respektivisht suret, libri ose *Kurani*. Pra, autorët nuk e kishin idenë se toka ka formë sferike dhe, prandaj, edhe në gjysmën tjetër të kësaj sfere jetojnë njerëz, që qëndrojnë me këmbë të tyre mbi tokë.

Kjo dëshmon sa injorantë ishin autorët e *Kuranit*. Ata nuk dinin as aq sa dinin dijetarët antikë për kozmosin, të cilët kishin rrojtur rreth njëmijë vjet para Muhamedit.

Në 63 ajete, ku është përdorur folja *zbrit*, 16 herë bëhet fjalë për „zbritje“ të *Kuranit* në format „librit“ si tërësi, 9 herë si *Kuran*, ndërsa 3 herë si ajete. Pra, dezinformohet 25 herë, sikur Allahu ia „paskësh zbritur“ Muhamedit njëherësh, si tërësi „librin“, respektivisht *Kuranimin*. Në një rast tjetër do të konkretizoj kundërthëniet mes ajeteve, që

dezinformojnë kinse teksti i Kuranit qenkësh „zbritur”njëherazi si tërësi, në format *Kurani* ose si „libër”, herën tjetër kinse ajetet, njëri pas tjetrit „kishin zbritur” gjatë 23 vjetëve.

Ja në cilat ajete është përdor folja „zbrit”.

2:97 (Kuranin); 3:3 (librin); 3:7 (librin / ajete të qartë e të paqarta), 3:84, 4:47, 4:60, 4:61, 4:105 (librin), 4:136 (gradualisht), 4:166 (atë / dëshmojnë engjëjt), 4:174 (dritë të qartë), 5:44 (atë), 5:45 (asaj që zbriti), 5:47 (asaj), 5:48 (librin) (atë), 5:49 (atë), 5:59 (atë), 5:64 (kjo), 5:66 (Kuranin), 5:67 (atë), 5:68 (atë) (kjo), 5:81 (atë), 5:83 (atë), 5:101 (gjatë kohës kur zbritej *Kurani*), 5:104 (ajo), 6:7 (libër në letër/papirus?), 6:91 (librin), 6:92 (ky është libër), 6:93 (atë), 6:114 (librin) (ai), 6:155 (ky është libri), 6:157 (libri), 7:2 (libri), 7:3 (atë), 7:196 (librin), 8:41 (atë), 9:86 (një kaptinë), 9:97 (dispozitat), 10:94 (këtë), 11:14 (ai), 12:2 (atë *Kuran*), 16:44 (*Kuranin*), 17:105 (atë), 22:16 (këtë), 25:32 (*Kurani*... ajet pas ajeti), 29:46 (asaj), 29:47 (librin), 36:5 (ai), 38:8 (*Kurani*), 41:2 (...), 41:42 (atij), 42:17 (librin), 43:31 (*Kurani*), 44:3 (Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar), 45:2 (librit), 47:9 (atë), 56:80 (ai), 57:16 (atë), 57:25 (librin), 59:21 (këtë Kuran), 65:10 (shpalljen), 69:43 (ai), 97:1 (atë në Natën e Kadrit).

Nga shqyrtimi i tekstit të *Kuranit* rezulton se folja *shpall* (arabisht: *vahj*), është përdorur në 98 ajete. Prej tyre 22 herë është përdorur si shpallje e „librit”, 11 herë si shpallje e *Kuranit* dhe 2 herë si shpallje e ajeteve. Në rastet e tjera janë përdorur përemrat.

Ndoshta ka nevojë të shihet, nëse folja „shpall” do t’i shkonte një procesi, kur „profetia” duhet t’i jetë komunikuar teksti i *Kuranit* nga Allahu, por vetëm përmes Xhibrilit, siç (dez)informojnë edhe hadithet. Edhe në këtë rast, kemi të njëjtat kundërthënie mes këtyre 98 ajeteve, meqë një herë ka ndodhur „shpallja” e librit si tërësi, herën tjetër „shpallja” e *Kuranit*, ndërsa në disa raste „janë shpallur” herë pas here ajetet.

Ja ajetet që përmbajnë foljen „shpall” (*vahj*):

2:4 (atë), 2:23 (shpallëm gradualisht), 2:41 (atë), 2:90 (atë), 2:91 (atë), 2:99 (argumente), 2:136 (atë), 2:170 (atë), 2:174 (atë), 2:185 (*Kurani* filloi të shpallet në ditët e Ramadanit), 2:231 (*Kuranin*), 2:285 (asaj), 4:113 (librin dhe shariatin), 4:136 (librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij), 4:140 (librin), 4:162 (atë),

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

4:163 (shpallje), 6:19 (ky *Kuran*), 6:50 (atë), 6:106 (atë), 6:145 (atë), 7:62 (shpalljen), 7:63 (shpallja), 7:69 (shpallja), 7:158 (shpalljet), 7:203 (ky), 10:15 (atë), 10:109 (asaj), 11:12 (ajo), 11:49 (disa rrëfime), 12:3 (këtitj *Kurani*), 12:102 (këto), 13:1 (këto ajete dhe ajo), 13:19 (ajo), 13:30 (atë), 13:36 (atë), 13:37 (atë), 14:1 (libër), 15:6 (përkujtimi), 15:9 (*Kuranin*), 16:2 (Me urdhrin e Tij zbret engjëjt me shpallje atij që Ai dëshiron nga robtë e vet), 16:24 (ajo), 16:64 (*Kuranin*), 16:89 (librin), 17:39 (urtësia), 17:82 (*Kuranin*), 17:86 (Po të kishim dëshiruar, Ne do ta shlyenim nga gjoksi yt atë që ta shpallëm ty), 17:106 (Dhe *Kuranin* që Ne e ndamë pjesë - pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.), 18:1 (librin dhe në të nuk lejoi ndonjë kundërtënie), 18:27 (Lexo çka të është shpallur ty nga libri i Zotit tënd!), 20:2 (*Kuranin*), 20:3 (Ta shpallëm vetëm këshillë për atë që frikësohet.), 20:4 (shpallja), 20:14 (Unë të zgjodha ty, prandaj dëgjo mirë se ç'po të shpallet!), 20:41 (shpallje), 20:113 (këtë *Kuran*), 20:114 (Ti mos nxito me *Kuranin* para se të përfundojë shpallja e tij te ti), 21:10 (librin), 21:45 (shpalljeje), 21:50 (ky), 24:1 (?), 25:1 (*Furkanin* / *Kuranin*?), 25:6 (atë), 26:192 (ai), 26:198 (atë), 28:86 (Ti as nuk ke shpresuar se do të shpallet ty libri), 28:87 (meqë ato t'ua kanë shpallur ty), 29:45 (libri), 29:51 (librin), 32:2 (librit), 33:2 (asaj), 34:6 (kjo), 35:31 (libri), 38:29 (libër), 39:1 (librit), 39:2 (librin), 39:23 (librin), 39:41 (librin), 39:55 (asaj), 39:65 (?), 40:2 (librit), 40:56 (shpalljen), 42:3 (ajete?), 42:7 (*Kuranin*), 42:13 (atë), 42:15 (librat), 42:52 (shpirtin), 43:43 (Ndaj ti përmbaju asaj që po të shpallet), 46:2 (libri), 46:9 (atë), 46:30 (libër), 47:2 (atë), 53:4 (Ai nuk është tjetër, pos shpallje që i shpallet.), 53:10 (Dhe i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli), 54:25 (shpallja), 65:10 (zbriti shpalljen), 72:1 (atë), 76:23 (Ne ta shpallëm ty *Kuranin* në intervale, pjesë-pjesë)

Në vetëm 3 ajete është përdorur pjesorja *zbuluar*, në vend të foljes *zbrës* ose *shpall*:

2:72 (asaj), 9:64 (atë), 72:26 (fshehtësinë).

Ndërkaq, vetëm në një ajet është përdorur pjesorja *inspiruar*: 20:38.

Edhe për „librat” pararendës, *Tevratin* / *Furkanin* / *Ungjillin*, forma foljore „me zbritur” është përdorur 16 herë, meqë edhe „profetëve” pararendës Allahu (gjegjësisht Jehova izraelit ose Hyji kristian) ua paskësh zbritur ata “libra”. Ja për cilat ajete është fjala:

2:176; 2:213; 2:253; 3:4; 3:53; 3:84; 3:105, 4:60, 4:136, 5:44, 5:47, 5:59, 5:66, 5:68, 6:156, 17:102

Folja „shpall” është përdorur 7 herë në lidhje me Tevratin (*Dhiatën e Vjetër*):

5:32 (ligj), 7:144 (shpalljen), 11:36, 12:109 (shpallje), 28:51, 29:27, 47:26 (atë)

Derisa në shumicën e ajeteve, në të cilat janë të pranishme këto katër folje (shpall, zbrit, zbuloj dhe inspiroj), bëhet fjalë për *Kuranin* si libër si tërësi, që ka ajete, në të cilat thuhet se nuk ka ndodhur „zbritja”, „shpallja” as „zbulimi” i tekstit kuranor, si libër dhe si tërësi, por ajet pas ajeti, sipas nevojave që kishte komuniteti (umeti) muhamedan.

Në ajetin 2:185 thuhet se „. . . muajit të Ramadanit, në të cilin muaj ka zbritur Kurani...”, e që nuk duhet të jetë e saktë, sepse më 01. 02. 610, kur Muhamedi duhet të ketë ëndërruar në shpellën e malit Hira paraqitjen e Xhibrilit, ende nuk kishte fe islame, as muaj të agjërimit, të quajtur *ramadan*. Kalendarit islam filloi të praktikohet 12 vjet më vonë, duke caktuar ditën e arratisë (hixhrës) së Muhamedit, më 16 korrik 622, si data **një** e vitit **një** (sipas kalendarit muhamedan / Hixhri). Në ajetin 4:136 thuhet „. . . Librin, që ia ka dërguar Pejgamberit të Vet. . .”. Kjo do të thotë që Allahu ia „paskësh dërguar“ *Kuranin* Muhamedit si „libër”, siç thuhet në gjithë atë mori ajetesh. Në ajetin 5:101 thuhet „. . . gjatë kohës kur zbriti Kurani...”, që do të thotë se *Kurani* nuk „është zbritur” njëherësh as si „libër”, as si *Kuran*. Në ajetin 17:106 shkruhet e zeza mbi të bardhën: „*Dhe Kurandin, që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t’ua lexuar njerëzve, dalëngadalë, dhe ashtu e shpallëm atë një pas një*”.

Që të mos zgjatemi, po ofrojmë numrat e disa ajeteve, sipas të cilave teksti i *Kuranit* është zbritur kohë pas kohe, ajet pas ajeti, që

nuk përputhen me ajetet e tjera, sipas të cilave *Kurani*“paskësh zbritur“njëherësh:13:1, 20:214, 25:32 (ajet pas ajeti), 76:23, etj.

Kjo kakofoni kundërthëniesh të jep të drejtë të bësh pyetje vulgare: nëse Allahu na qenkësh autor i *Kuranit*, kur ka gënjyer? Në ajetet që thuhet se ia ka komunikuar Muhamedit tekstin njëherësh, si „libër” e si *Kuran*, apo në ajetet që flitet për „zbritje”, „shpallje” e „zbulim”, ajet pas ajeti, ose pjesë pas pjese?! Po të kishte qenë autor i *Kuranit* Allahu i gjithëditur, nuk do të duhej t’i shpëtonin këto kundërthënie!

Kjo lloj kakofonie duhet t’u ketë ndodhur vetëm autorëve gjysmanalfabetë!

Deri këtu u paraqitën katër folje, që janë përdorur për të njëjtën gjë, veprim - atë që Allahu ia paskësh komunikuar tekstin e Kuranit Muhamedit. Kjo paraqitje u bë për të vënë në pah se „zoti” nuk do të duhej ta ngatërronte kaq shumë mënyrën e komunikimit me Muhamedin.

Është domethënës diskreditimi i *Kuranit* si vepër njerëzore, nëse do të paraqesim rrjedhën kohore të sajimit të tekstit. Burimet islame dezinformojnë se pak më shumë se dy muaj, para vdekjes, Muhamedit duhet t’i jetë zbritur ajeti i fundit:

... Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju islamin fe... ” [5:3]

Nëse kjo do të ishte e vërtetë, atëherë i bie se, sa herë që është thënë më herët për „Kuran” ose „libër” „të zbritur“, „të shpallur“, „të zbuluar” njëherësh, si tërësi, është dezinformuar, sepse pa „zbritur” edhe ajeti i fundit nuk ka qenë e mundur të kompletohet as si „libër” dhe as si *Kuran*!

Ajeti i parë (i renditur në *Kuran* nga „redaktorët” në 96:1), që myslimanët e quajnë „ikra” (lexo / recito), duhet të jetë sajuar më 01.

02. 610 ose më 27. 09. 610 (momenti kur Muhamedi duhet të ketë ëndërruar në shpellë të malit Hira)! Pra, bie poshtë spekulimi se ajo ditë paskësh qenë Nata e Kadrit, nata e 27 e muajit të agjërimit, Ramadan, muaji i 9 i vitit! Atëherë nuk kishte ende kalendar islam, meqë kalendari islam daton nga koha e sundimit të kalifit Ebu Bekr, i cili për ditë **një** të kalendarit islam ka 16 korrikun 622. Pra, 16 korriku i vitit 622 duhet të ketë qenë dita kur Muhamedi duhet të ketë marrë arratinë nga Meka në Medinë. Kalkulimet i kam bërë sipas programimit që ka sajuar Universiteti i Cyrihut: 1 shkurti i vitit 610²⁷⁹ (kur Muhamedi duhet të ketë ëndërruar në shpellën e malit Hira), i bie më 01. 03/ Rabi -12²⁸⁰, dhe jo më 27. 09/Ramadan viti -12.

Hadithe që (dez)informojnë për mënyrën e „transformimit“ të Muhamedit nga i njeriu psikopat në „profet“, më 01. 02. 610 ose më 27. 09. 610 (01. 03. viti -12, sipas kalendarit islam):

„Na ka treguar Jahja b. Bukejri, këtij Lejthi, ky nga Ukajli, ky nga Ibn Shihabi, ky nga Urve b. Zubejri, ky nga Aishe hr. a. , e cila ka thënë: „Kur Pejgamberi s. a. v. s. për herë të parë ka filluar të marrë Shpalljen, ishin ato ëndërrime të mira që i përjetonte në gjumë. Nuk ka pasur ndonjë ëndërr që nuk do t'i dilte qartë si agimi i mëngjesit. Pastaj ai u dashurua në vetmi. Vetmohej në shpellën Hira dhe aty ruhej (nga gabimet) dhe lutej me net të tëra, para se të zbriste te familja e tij, që të furnizohej me ushqim për këtë qëllim. Pastaj kthehej te Hatixheja dhe furnizohej si më parë. (Kështu veproji), derisa i erdhi E VËRTETA kur ai ndodhej në shpellën Hira.

I erdhi meleku dhe i tha: „Ikre“, d. m. th. „Lexo, recito!“

„Nuk di të lexoj“, – iu përgjigj (Pejgamberi s. a. v. s.).

„Më mori, - tha ai (Muhamedi a. s.) – dhe më shtrëngoi, aq sa më kaploi mundimi, e pastaj më lëshoi dhe më tha: „Lexo!“

„Nuk di të lexoj“, – iu përgjigja, e ai (Xhibrili) më mori për herë të dytë e më shtrëngoi, derisa më kapi mundimi, pastaj më lëshoi dhe më tha:

²⁷⁹ <http://www.schoolwork.de/mekka/mohammedislam.php>

<http://www.islam.de/1422.php>

²⁸⁰ <http://www.oriold.uzh.ch/static/hegira.html>

„Lexo! Me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Ka krijuar njeriun nga Alak (copë gjaku e mpiksur në mitrën e nënës). Lexo! Dhe Zoti yt është dhuruesi më i Begatë” (Al Alak /96:1-3).

Pastaj, Pejgamberi s. a. v. s. u kthye, e duke iu dridhur zemra nga frika, hyri te Hatixhe b. Huvejlidir. a. , së cilës i tha: „Më mbulo! Më mbulo!”

E mbuluan derisa i kaloi frika. Pasi ia tregoi ndodhinë Hatixhes, tha: „Po frikohem!” Ndërkaq Hatixheja ia ktheu: „Jo, për Zotin, kurrsesi! Allahu nuk të turpëron dhe nuk të lëshon ty asnjëherë, sepse ti i viziton të afërmit, u ndihmon jetimëve dhe atyre që nuk janë të aftë, u jep të varfërve, je mikpritës dhe po ndihmon ata, të cilët mbrojnë të vërtetën“.

Atëherë Hatixheja e çoi te djali i xhaxhait të vet, Varaka b. Neufel b. Esed b. Abdi Uzza²⁸¹. Ky njeri e kishte pranuar krishterimin në kohën e xhahilijetit. Dinte mirë shkrim-leximin hebrej dhe përshkruante (transkriptonte) nga Inxhili në gjuhën hebreje, atë që Allahu xh. sh. donte të shkruhej. Ishte plak i këputur (shumë i moshuar) dhe ishte verbuar.

Hatixheja i tha (Varakës):

„O djalë i xhaxhait, dëgjo diç nga djali i vëllait tënd!”

Varaka i tha (Muhamedit a. s.):

„O djalë i vëllait tim, ç’është ajo që ke parë?”

Pejgamberi s. a. v. s. i shpjegoi Varakës ndodhinë që kishte përjetua e Varaka i tha: „Ai është Namusi, të cilin Allahu ia dërgoi Musait. Ah, ta kisha fatin të isha i ri në ditët e thirrjes sate. Ah, ta kisha fatin të isha gjallë kur populli yt do të dëbojë“.

„A thua do të më dëbojë? – pyeti (Pejgamberi s. a. v. s.).

„Po, – tha ai, – sepse asnjëherë askush nuk ka sjellë diçka të ngjashme si ti, e që nuk është sulmuar. Po të jem gjallë, do të të ndihmoj sa të mundem“.

Nuk kaloi shumë pas kësaj e Varaka vdiq. Edhe shpallja pushoi për pak kohë.

[Sahihul-Buhari, Libri 1, kreu 1, nr. 3]²⁸²

Këtë hadithe klerikët dhe besimtarët fundamentalistë myslimanë e kanë halë në fyt, meqë kjo e diskrediton vulgarisht Muhamedin; ai na qenkësh frikësuar nga ëndërrimi në shpellë dhe nuk paskësh besuar në ato që ai ka ëndërruar. Përfundimisht, Muhamedin e paskësh bindur

²⁸¹ Waraqa ibn Naufal ibn Asadibn ‘Abdal-‘Uzzāibnal-Qusaiy Quraschī (ورقة بن نوفل بن أسد بن عبد العزى بن قصي القرشي).

https://de.wikipedia.org/wiki/Waraqa_ibn_Naufal.

²⁸² <http://www.kuranifisnik.net/KuraniFisnik/Download/UploadedFiles/2007.9.30%20-%2000.44%20Sahihul-Buhari-1.htm>.

misionari kristian, Varaka, që ai na qenkësh profet, meqë rasti i ngjasonte atij të Moisiut (Musait).

Gjashtë hadithe të tjera, për ngjarjen në shpellën Hira, të interesuarit mund t'i gjejnë në linkun e evidentuar në fusnotë (janë në gjermanisht, por mund të gjenden edhe në shqip, në bazë të të dhënave burimore).²⁸³

Edhe përmbajtja e sures së dytë (e radhitur në *Kuran* me nr. 97) e vërteton (dez)informimin që ofron hadithja e mësipërme, sepse bën fjalë për Muhamedin, që mbulohet nga gruaja e tij, Hatixheja,²⁸⁴ pas kthimit nga shpella, meqë nga frika e kishin zënë të dridhurat:

„O ti i mbuluar! [97:1]

Ngrihu dhe tërhiq vërejtjen (duke i thirrur). [97:2]

Dhe madhëroje Zotin tënd! [97:3]

Dhe rrobat tua pastroji! [97:4]

Dhe të keqes së ndyrë largoju! [97:5]

Edhe historiani i islamit, Ibn Hisham, informon se Muhamedi, kur u kthye nga shpella në shtëpi, nuk po i besohej se vërtet Allahu e kishte graduar „profet“. Madje Tabari informon se kishte ndër mend të bënte vetëvrasja nga paniku që e kishte kapluar²⁸⁵.

Kjo hadithe përmban (dez)informimin më të zgjeruar, se si ka ndodhur „zbulimi“ i ajetit të parë, i cili kur „është redaktuar“ *Kurani* nga komisioni i kalifit Utman, është radhitur në suren me nr. 96.

(Dez)informimi në këtë hadithe përputhet pothuajse krejtësisht me (dez)informimin në hadithen pararendëse. Në të dyja hadithet (dez)informohet për shfaqje të engjëllit Xhibrili, i cili i ka përcjellë „shpalljet“ nga Zoti deri te Muhamedi.

Çfarë duhet t'i ketë ofruar për të lexuar Xhibrili Muhamedit? Këtu nuk është (dez)informuar, si në një rast tjetër, se Muhamedin e ka zënë

²⁸³ <http://islamische-datenbank.de/option>,

²⁸⁴ http://www.eslam.de/begriffe/e/erste_offenbarung.htm.

²⁸⁵ http://islamische-datenbank.de/option,com_buchari/action,viewhadith/chapterno,1/

gjumi në shpellën Hira, dhe ka ëndërruar gjithë komunikimin me Xhibrilin. Ka edhe autorë që (dez)informojnë se Xhibrili i paskësh ofruar Muhamedit njëfarë bëzi (stofi), sipër të cilit ishte e shkruar surja e parë. Sidoqoftë, taktika e këtyre (dez)informimeve është që të mashtrohen besimtarët, se Muhamedi ishte analfabet, prandaj nuk mund të ketë lexuar *Teuratin* dhe *Ungjillin*, dhe, meqë nuk ka ditur të lexojë, nuk ka mundur të sajojë plagjiatura. Por, në ajetin tjetër [62:2]* thuhet se Muhamedi ua lexonte besimtarëve ajetet e *Kuranit*, kur dilnin në natyrë për t'u frymëzuar.

I diskutueshëm është edhe (dez)informimi i lidhjes farefisnore të Muhamedit me xhaxhanë e Hatixhesë, i cili rezultoi në tërësi qenë misionar kristian, skribist (që ka përshkruar tekste nga *Teurati* e *Ungjilli*, për t'i propaganduar). Nëse Muhamedi e kishte xhaxha Vereken, i cili ishte edhe xhaxha i Hatixhesë, rrjedhimisht edhe Hatixheja (bashkëshortja e Muhamedit), na qenkësh vajzë e xhaxhait të Muhamedit.

Rreshti i fundit prodhon dilemën provokuese: pse Muhamedit i janë ndërprerë „shpalljet” disa kohë pas vdekjes së xhaxhait të Hatixhesë, misionarit kristian Varaka? Mos ndoshta ishte ai që i sajonte ajetet për Muhamedin “analfabet” dhe ky, pastaj, i recitonte?!

Nga ana tjetër, po kjo hadithe, me përmbajtje goxha të ngatërruar, ka informata tepër interesante. E para, afërsia e gjakut e bashkëshortëve Muhamed dhe Hatixhe. E dyta, Muhamedi paskësh pasur një xhaxha (Varaka), i konvertuar në të krishterë, i angazhuar si misionar. E treta, Muhamedi kishte filluar prej kohësh të shkonte në shpellën e malit Hira për të medituar e për t'u lutur (si pagan). E katërta, pse Varaka është marrë me përkthimin e ungjillit (ndoshta nga greqishtja)

* “Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’ju lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.” [62:2 / shq. Sherif Ahmeti]

në hebraisht dhe jo në arabisht? E pesta, ka mundësi që Muhamedi të ishte inspiruar nga xhaxhai Varaka, që edhe ky të bëhej një si misionar, pse jo, edhe profet (meqë ishte trend i kohës që individët sharlatanë provonin të imponoheshin si profetë), prandaj kishte filluar të qëndronte në shpellë (ku shkonin edhe të tjerë devijant) etj.

Siç ndodh rëndom në ëndërr, që ngjarjet ëndërrohen ngatërrueshëm, edhe në këtë „ëndërr” nuk është e qartë çfarë duhej të lexonte Muhamedi, kur Xhibrili duhet ta ketë urdhëruar (madje tre herë, herën e dytë duke e shtrënguar): „Lexo!” („Recito!”)

Me ngjan të mos ketë qenë as ëndërr, por sajësë për të përgatitur terrenin që Muhamedit t’i besohej se Allahu kishte komunikuar me të përmes Xhibrilit. I impresionuar nga mbamendja e tyre, ai po sajonte doktrinën e tij, të cilën, ndoshta ai vetë, e quajti *islam* (nënshtrim).

Po sjellim hadithen nga Bukhari, libri i parë, hadithja nr. 2, që informon se si Muhamedi i „ka pranuar“ ajetet nga Allahu i tij:

„Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, ky nga Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i tij, ky nga Aishe hr. a. , e cila transmeton se Harith b. Hishamir. a. e ka pyetur Pejgamberin s. a. v. s. : „O Resulullah, si të vjen ty Shpallja (Vahji)?“ Pejgamberi s. a. v. s. i qe përgjigjur: „Herë-herë më vjen si tingujt e zules. Kjo për mua është mënyra më e vështirë e Shpalljes, e më ndërpritet pasi ta kem mbajtur mend atë që më është thënë. Dhe, herë-herë meleku (Xhibril) më paraqitet në formë njeriu. Ai më flet dhe unë e mbaj në mend atë që më thotë“. Aishe hr. a. është shprehur kështu: „E kam parë atë (Pejgamberin s. a. v. s.) duke i zbritur atij Shpallja në ditët shumë të ftohta dhe kur i ndërpritej (Shpallja), vërtet, ballin ende e kishte qull me djersë”²⁸⁶.

Nga kjo hadithe rezulton se Muhamedi ose ka gënjyer kur e ka sajuar ajtin [12:2],²⁸⁷ ose ka gënjyer kur i është përgjigjur Harith bint Hishamit. Edhe përgjigjja e Muhamedit, sipas kësaj haditheje, është

²⁸⁶ <http://www.kurani-fisnik.net/Kurani-Fisnik/Download/UploadedFiles/2007.9.30%20-%2000.44%20Sahihul-Buhari-1.htm>

²⁸⁷ Na e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju. [12:2].

më tepër se naive, qesharake. Atij mund t'i besojnë vetëm besimtarët tru-shpërlarë.

Në hadithen pasuese, me nr. 4:

Ka treguar Shihabi: „Më ka njoftuar Ebu Seleme b. Abdurrahmani, se me të vërtetë, Xhabir b. Abdullahu Ensariu ka thënë: Ai (Pejgamberi s. a. v. s.) në një fjalim të tij, duke folur për pushimin (ndërprerjen e përkohshme) e Shpalljes, ndër të tjera tha: „Unë duke ecur, dëgjova një zë nga qielli. Ngrita sytë lart dhe pashë të njëjtin melek, i cili më vinte në shpellën Hira; rrinte ulur një në pozitë mes qiellit dhe tokës. U ktheva (në shtëpi) dhe ashtu i frikësuar, thashë: „Më mbuloni!“

Për këtë shkak, Allahu i Madhëruar shpalli ajetet e Kuranit: „O ti (Muhamed) i mbështjellë me rroba! Ngrihu dhe këshillo! Dhe madhëroje Zotin tënd! Dhe pastroji rrobat e tua! Dhe larg nga Er-Ruxhz (idhujt) qëndro!“ (El Muddethir: 1-5).

Prej këtij momenti, Shpallja vazhdoi t'i vijë rregullisht.

Edhe një rrëfim: „Jahjain e ndjek Abdullah b. Jusufi dhe Ebu Salihu, këta i ndjek Hilal b. Reddadi duke transmetuar nga Zuhriu. Ndërkaq, Junusi dhe Ma'meri kanë thënë: 'I janë dridhur nënsqetullat'. ”²⁸⁸

Broçkulla pa ndonjë shije, edhe për t'u lexuar. Sërish na qenkësh trembur Muhamedi nga Xhibrili dhe ka shkuar në shtëpi që ta mbulojë Hatixheja. Ai, xhibrili, „i ulur” mes tokës e qiellit, e pakësh urdhëruar Muhamedin të bëhet misionar. Pra, nuk paskësh qenë përzgjedhje e tij. Vetëm besimtarët mund t'u besojnë trilleve kaq të trasha, sikur Muhamedi e paskësh pa engjëllin, në mes të tokës e qiellit, pa pasur idenë se ku është ky mes. Rëndom, kjo vazhdon të jetë në kuadër të mendësisë, sikur toka është e rrafshët, e mbuluar me kupolë qielli.

(Dez)informimi tjetër, se Muhamedit i qenkëshin dridhur nënsqetullat, është për t'ia dhënë kujën kësaj injorance!

Hadithja tjetër me nr. 5 sjell (dez)informimin vijues:

²⁸⁸ Po aty.

Na ka treguar Musa b. Ismaili, këtij i ka treguar Ebu Avane, këtij Musa b. Ebi Aishe, këtij Seid b. Xhubejri nga Ibni Abbasi. a. , i cili për fjalën e Allahut të Madhëruar: „ (O Muhamed) mos e shqipto me gjuhën tënde kur e këndon atë (Kurani), për ta përvetësuar me të shpejtë! (El Kijameh: 16), tha: „Pejgamberi s. a. v. s. përpiqej shumë për ta mbajtur në mend Shpalljen dhe për këtë shkak i lëvizte buzët gjithnjë“. Duke e thënë këtë, Ibn Abasi vazhdoi: „Edhe unë po i lëviz buzët para jush, ashtu siç i lëvizte Pejgamberi s. a. v. s. , kurse Seidi i ka thënë (Musait): „Ja, edhe unë po i lëviz buzët ashtu siç e kam parë Ibn Abasin duke i lëvizur“.

Allahu i Madhëruar lidhur me këtë, e ka shpallur ajetin e Kuranit: „(O Muhamed) mos e shqipto me gjuhën tënde kur e këndon atë (Kurani), për ta përvetësuar me të shpejtë! Është për Ne ta mbledhim atë dhe të të japim ty aftësinë për ta kënduar atë (Kurani). (El Kijameh: 16, 17).

Ibn Abasi (këtë ajet) e ka shpjeguar:

‘Të është tubuar (Kurani) në gjoksin tënd dhe ti me lehtësi do ta lexosh atë‘. Pastaj ajetin: „Dhe kur Ne ta lexojmë atë ty (me anë të Xhibrilit), atëherë ti përcille leximin e tij“. (El Kijameh: 18).

Ibn Abasi e komenton: „Dëgjo dhe hesht!“ Ndërkaq ajetin: „Dhe pastaj është detyrë e Jona që ta bëjmë atë ty të qartë“. (El Kijameh: 19).

(Ibn Abasi) e komenton: „Vërtet, detyra jonë është që ti, pastaj, ta mësosh atë me lehtësi

”

Pas kësaj, sa herë që vinte Xhibrili, Pejgamberi s. a. v. s. vetëm do ta dëgjonte, e kur shkonte ai, Pejgamberi s. a. v. s. i përsëriste (ajetet e Kuranit) pikërisht ashtu siç i kishte lexuar Xhibrili.

Këto (dez)informata kaq primitive janë vërtet edhe irrituese. Megjithëkëtë, besimtarët, këto viktime mjerane, janë të detyruar t’u besojnë.

Meqë në këtë hadithe nuk është përfshirë e tërë kjo sure (El-Alek / nr. 96), po e sjellim vazhdimin, sepse vetëm triajetet fillestare ia cungojnë përmbajtjen integrale sures së parë (e cila, kur është shkruar dhe redaktuar *Kurani*, nga komisioni i kryesuar nga kalifi Utman, rreth 20 vjet pas vdekjes së Muhamedit, për çudi, është radhitur në suren me nr. 96):

*Lexo në emër të Zotit tënd, i cili ka krijuar (të gjitha), [96:1]
i cili e krijoi njeriun nga gjaku i mpiksur (embrioni), [96:2]
lexo, se Zoti yt, është më bujari, [96:3]
që ia mësoi njeriut pendën (të shkruajë), [96:4]
që njeriut ia mësoi atë që nuk e diti. [96:5]
Jo, jo! (megjithatë), me të vërtetë, njeriu ka kaluar kufirin (në të keqe), [96:6]
posa e ka ndier veten të pasur (se nuk i nevojitet askush), [96:7]
e, me të vërtetë, kthimi është te Zoti yt! [96:8]
A e ke parë ti atë që pengon [96:9]
njeriun (adhuruesin) kur falet (bënë namaz)? [96:10]
Më thuaj ti (o Muhamed!), nëse ai mendon se është në rrugën e drejtë, [96:11]
apo rekomandon që të adhurohen idhujt, [96:12]
e, çka mendon ti nëse ai i përgënjeshtron (argumentet Tona) dhe kthehet? [96:13]
A nuk e di ai, se Zoti i sheh të gjitha (e dhuron të mirin, ndërsa e dënon të keqin)? [96:14]
Jo, jo! Me të vërtetë, nëse nuk tërhiqet nga kjo, do ta kapim për flokësh (gërsheti), [96:15] gënjeshтарin dhe fajtorin [96:16]
e, ai le ta thërrasë shoqërinë e vet (në ndihmë). [96:17]
Na do t'i thërrasim Zebanijt (rojet e Skëterrës). [96:18]
Jo, jo! Mos iu përul ti atij; por bëj sexhde dhe afroju (Zotit tënd)! [96:19]*

Kjo sure, tashmë e kompletuar, pra, nuk rezulton të ketë qenë një ëndërr, por një sajesë e Muhamedit “analfabet”. Qe edhe një informatë, për ata që dëshirojnë të analizojnë këtë sure: teksti brenda kllapave (në këtë sure dhe në gjithë *Kuranin*) nuk është pjesë përbërëse e „teksteve” zanafillore, por të imputuar nga transkriptuesit e *Kuranit* gjatë përshtatjes në arabishten standarde (për herë të fundit në vitin 1924*), përcjellë edhe nga shqipëruesit. Kjo e dhënë do t'i ndihmojë ata që duan t'i bëjnë vlerësime letrare, ideore, logjike, filozofike „tekstit” zanafillor dhe këtij që e përmban tani *Kurani*. Mbase ka bazë edhe dilema, se autori i kësaj sureje e ka paraqit personazhin fikSION

* Me urdhër të mbretit të Egjiptit, Fuad I, dhënë universitetit islam “Al-Az’har” në Kajro, Kurani duhet të jetë transkriptuar nga arabishtja e pa kuptueshme mesjetare, në arabishten egjiptiane të vitit 1924.

Xhibrili si autor, sepse kjo sure nuk është formuluar në vetën e parë njëjës, as në vetën e parë shumës. Kjo do të thotë se kjo sure nuk është formuluar nga Zoti.

Sa shumë është gënjyer me urdhrin“ikre” (recito), sikur Allahu paskësh urdhëruar myslimanët të studiojnë, të arsimohen, ndërsa në rastin konkret, sipas edhe hadithes së sipërcituar, pjesë e ëndërrimit të Muhamedit, duhet të ketë qenë urdhërimi i Xhibrilit që ai të recitonte (ose lexonte) brenda në shpellë, dhe nuk të bëjë aspak me porosi të Allahut për arsimim...

II. 2. Kurani - dilemat rreth autorësisë

Kurani më i vjetër dhe më autentik është ai i vitit 1002, i cili ruhet në muzeun Tarik, në Kuvajt. Kurani aktual, standardizim botëror, është i vitit 1924, nga Egjipti.²⁸⁹

Për besimtarin mysliman, vetëkuptohet, autori i *Kuranit* është Allahu. Ndërsa për studiuesin dhe analistin jomysliman, identifikimi i autorit të *Kuranit* është një përballje e vështirë dhe shqetësuese. E vështirë, sepse ka pak të dhëna burimore, ndërsa burimet islame janë të karakterit legjendar, propagandistik e afirmativ, orientimi kryesor i të cilave është mosvënia në dyshim e autorësisë së Allahut. Ndërsa shqetësuese, sepse për muhamedanët fundamentalistë, kontestimi i autorësisë së Allahut është herezi (arabisht: *shirk*), dhe çon në rrokullisjen e kokave të atyre që guxojnë të konstatojnë autorësinë e Allahut - personazh i sajuar nga Muhamedi!

Në mungesë të interesimit për t'u marrë me studime gjithëpërfshirëse, them se është e mjaftueshme që të analizohet vetëm teksti i *Kuranit*, për të konstatuar se Allahu nuk është autor i tij!

Atëherë, kush është autori i *Kuranit*?

Me këtë tematikë janë marrë shumë studiues, ndër të cilët po veçoj islamologun bangladeshas Abul Kasam.²⁹⁰ Nga studimi i tij po ofroj një fragment paksa të gjatë:

Duke analizuar, shqyrtuar dhe interpretuar me kujdes përmbajtjen e Kuranit, haditheve (rrëfimet e Muhamedit) dhe Sirahut (biografia e

²⁸⁹ <http://europenews.dk/de/node/46039>.

²⁹⁰ http://islammonitor.org/index.php?option=com_content&view=article&id=793:abul-kasem&catid=222:abul-kasem&Itemid=6.

Muhamedit), autori ka identifikuar një sërë palësh, të cilat, padyshim, kanë kontribuar në kompozimin e vargjeve të Kuranit. Nuk ishte Allahu që e shkroi Kuranin; nuk ishte as Muhamedi, i vetmi. Kurani nuk është krijim i një njeriu ose i një grupi të vetëm. Ishin disa të përfshirë në kompozimin, shkrimin, ndryshimin, vënien dhe heqjen e vargjeve të Kuranit. Personalitetet më të rëndësishme, të përfshira në krijimin e Kuranit ishin: Imrul Kays, Zajd b. Amri, Hasan b. Thabit, Salman, Bahira, Ibn Kumta, Varaka dhe Ubaj b. Kab.

Vetë Muhamedi ishte përfshirë në krijimin e një numri të caktuar vargjesh, por personi me më tepër ndikim dhe që e motivoi Muhamedin në krijimin e islamit dhe opusin e Kuranit, ishte ndoshta Zajd b. Amri, i cili predikoi Hanifismin. Më vonë Muhamedi do ta shndërronte Hanifismin e Zajdit në islam. Prandaj, pohimi se islami nuk është një fe e re, del se është i vërtetë. Megjithatë, një gjetje e rëndësishme është se, në Kuran nuk janë aspak fjalët e Allahut - ai është një formulim i bërë nga njerëzit, të cilin Muhamedi thjesht e serviri si të ishin fjalët e fundit të Allahut, drejtuar njerëzimit. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kësaj eseje, është se mes gjithë besimeve të lashta, që hartues të Kuranit përfshinë në të, ndoshta praktikant e Sabejve ishin më vendimtarët. Në fakt, rituallet e 5 lutjeve dhe 30 ditëve të agjërimit (dy nga pesë shtyllat e islamit), u përshtatën prej **Sabejve**. Kurani, pra, është një përpilim i librave të ndryshëm fetarë, që kanë ekzistuar gjatë kohës së Muhamedit. Muhamedi, dhe jo Allahu, thjesht përshtati, mblodhi dhe përzgjedhi nga burime të ndryshme dhe krijoi Kuranin. Për ta thënë më qartë, shumë palë kontribuuan në Kuran, kurse Muhamedi u bë koordinatori kryesor.

Gjatë kërkimeve kam zbuluar se shumë njerëz kanë qenë të përfshirë në hartimin e Kuranit. Të panjohura për shumicën dërrmuese të myslimanëve dhe të varrosura thellë brenda Kuranit. Hadithet dhe Sirahi kanë me bollëk dëshmi për ta rrëzuar pretendimin se Kurani është krijim i Allahut. Unë mendoj se paraqitja e Allahut si autori i Kuranit është gënjeshtër kryesore e kryer mbi njerëzimin, për më shumë se një mijëvjeçar. Me siguri mund të themi, se as Muhamedi nuk ishte i vetmi autor i Kuranit. Në të vërtetë, pjesa më e madhe e Kuranit është ose e hartuar, ose e frymëzuar dhe e shkruar nga disa individë të tjerë. Më të shquarit prej tyre ishin:

- *Imrul Kajs* - një poeti lashtë i Arabisë, i cili vdiq disa dekada para lindjes së Muhamedit.
- *Zajd b. Amri b. Naufal* - një “renegat” i kohës së tij, që predikoi dhe përhap *Hanifismin*.
- *Labid* - një tjetër poet.
- *Hasan b. Tabit* - poeti zyrtar i Muhamedit.
- *Salman, persian* - shok i ngushtë dhe këshilltar i Muhamedit.
- *Bahira* - një murg i krishterë nestorian i kishës siriane.
- *Xhabri* - një fqinj i krishterë i Muhamedit.
- *Ibn Kumta* - një skllav i krishterë.
- *Khadixhah (Hatixheja)* - gruaja e parë e Muhamedit.
- *Varaka* - xhaxhai i Hatixhesë.
- *Ubaj b. Kab* - sekretari i Muhamedit dhe shkruesi i Kuranit.
- *Vetë Muhamedi*.

Ishin gjithashtu të përfshira edhe palë të tjera, si:

- *Sabejtë*
- *Aishja* - gruaja-fëmijë e Muhamedit
- *Abdallahb. Salamb el-Harith*, një hebre i konvertuar në islam.
- *Mukhjarij*, një rabi dhe një tjetër hebre i konvertuar në islam.

Natyrisht, lista ime e autorëve të mundshëm të Kuranit nuk është përfundimtare. Mund të ketë shumë të tjerë të përfshirë, për të cilët unë edhe mund të mos kem dëgjuar.²⁹¹

Në vazhdim të studimit, islamologu Abul Kasem identifikon dhe seleksionon ajete dhe sure, me autorësi të emrave që i ka evidentuar ai. Por nuk po e ofrojmë atë listë, meqë lexuesit mund të ndihen të bezdisur.

²⁹¹ http://www.islam-watch.org/Abul_Kasem/Who_Authored_Quran/who_authored_the_quran.htm.

Linguisti, islamologu dhe interpreti i shquar *i Kuranit*, As-Sajuti [جلال الدين السيوطي (1445-1505)] ka shprehur mendimin se, të paktën, në pesë fragmente të *Kuranit* Allahu nuk është autori.²⁹²

Islamologu Ali Dashti bën seleksionim të disa pasazheve të *Kuranit*, përmes të cilave dëshmon se Zoti nuk është autor i tij.²⁹³ Ai nis shqyrtimin me suren e parë, duke pohuar se Muhamedi i drejtohet me lutje Allahut.

Islamologu dhe arabisti Nasër Hamid Abu Zaid (نصر حامد أبو زيد), profesor në universitetin e Kajros, i ka bërë analiza gjuhësore (hermeneutike) *Kuranit* dhe ka konstatuar se teksti i tij është formulim i njerëzve, të inspiruar nga Allahu, që do të thotë se Allahu nuk është autor i *Kuranit*.²⁹⁴

Islamologia dhe sociologia arabe, Fatima Merinsi, spekulon:

*Profeti i pranoi porosinë e Zotit gojarisht dhe gojarisht i përcolli tutje. (...) Radha e sureve që i janë zbuluar Muhamedit u përgjigjet domosdoshmërive konjunkturale: ato që iu zbuluan në Mekë përmbajnë dogmën dhe obligimet e myslimanëve. Suret e zbuluara më vonë në Medinë ishin përgjigje e problemeve, me të cilat Profeti konfrontohej dhe e pyetjeve që i bënin myslimanët e parë.*²⁹⁵

²⁹² Ibn Warraq, "Warumichkein Muslimbin", Matths & Seitz, Berlin 2007, S. 157.
<http://www.amazon.de/Warum-ich-kein-Muslim-bin/dp/388221838X>.

²⁹³ Po aty.

<http://www.amazon.de/23-Jahre-Karriere-Propheten-Muhammad/dp/3932710800>

²⁹⁴ http://www.zeit.de/2003/05/Abu_Zaid.

²⁹⁵ FatimaMerinssi, Der-politische-Harem-Mohammed-Frauen, f. 40-41; <http://www.amazon.de/Der-politische-Harem-Mohammed-Frauen/dp/3451052806>.

Sa i përket radhitjes së rregulluar të sureve në Kuran, si tekst i shkruar, sipas ekspertëve, ka pasur më shumë karakter pedagogjik: suret e para janë përcaktimet më me rëndësi të islamit sa i përket martesës dhe trashëgimisë. Mund të thuhet se në Medinë islami është krijuar si një shari'a (kanun) për rregullimin e rendit shoqëror, me prejardhje nga Zoti. Profeti ka shkuar në ekzil, pas vitit 622, në Medinë. Viti 622 është me rëndësi, sepse është viti ZERO për kalendarin islam.²⁹⁶

Islamologu “Ibn Warraq” (pseudonim për shkaqe sigurie), ka sjellë shembull ajetet 102-104 të sures 6, me shpjegim se mungon imperativi në fillim “thuaj:...”. Ja ajetet:

*“Ky është Perëndia, Zoti juaj. S'ka Zot tjetër përveç Tij, Krijuesi i çdo gjëje, ndaj adhurojeni Atë! Ai është mbikëqyrës i çdo gjëje! [6:102]
Shikimet nuk mund ta përfshijnë Atë. Ai i përfshin shikimet e të gjithëve. Ai është bamirës i pakufti dhe di çdo gjë. [6:103]
Me të vërtetë, juve ju kanë ardhur nga Zoti juaj argumente të qarta; ai që i studion ato i sjell dobi vetes; e ai që nuk i vëren ato, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj”. [6:104]*

Sipas Ibn Warraq, fjalia e fundit [6:104] “unë nuk jam rojtari juaj”, dëshmon katërçipërisht se Muhamedi duhet të jetë autori!

Po sipas Ibn Warraq, në *Kuran* urdhri “thuaj” është i futur gjatë “redaktimeve” të mëvonshme të *Kuranit*, për të kamufluar pak a shumë autorësinë e Muhamedit.²⁹⁷

Ibn Warraq sjell edhe ajetet 15 dhe 19 të sures 81, duke bërë sqarimin se është betim i Muhamedit. Citim:

“Dhe betohem në yjet që perëndojnë [81:15](...) me të vërtetë, Kurani është fjala e të Dërguarit fisnik”. [15:19]

²⁹⁶ Po aty, fa. 41.

²⁹⁷ Ibn Warraq, “Warumichkein Muslim bin”, Matths & Seitz, Berlin 2007, S. 157.

II. 3. Kurani - mënyra e shpalljes

Sigurisht, nuk do të ishte e logjikshme që Allahu, krijuesi i yjeve, të betohet në yje. Pra, është Muhamedi, i cili duhet të jetë betuar në yje, meqë ende nuk ishte çliruar krejtësisht nga tradita e paganizmit.

Ibn Warraq sjell edhe ajetet:

Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit, [84:16]

Dhe në natën dhe çka ajo tubon, [84:17]

Dhe në hënën kur ajo është e plotë. [84:18]

Ju patjetër do të përjetoni gjendje pas gjendjeje. [84:19]

E, çka kanë ata që nuk besojnë? [84:20]

Dhe kur u lexohet atyre Kurani, nuk përulen? [84:21]

Në këtë sure nuk është evidente urdhëresa: “Thuaj: ...”, që të kishim të bënim me rrëfim të tërthortë.

Ngjashëm është rasti edhe në 91:1-10 dhe 100:1-10, ku Muhamedi betohet tejet naivisht, duke dashur të shpaloste talent prej poeti, por ama të shpifur.

Ibn Warraq sjell edhe vlerësimin e islamologut (për të mos thënë edhe islamofilit) skocez William Montgomery Watt (1909-2006):

“Megjithatë të krijohet vështirësia kur do të pranosh se vetë Zoti është autori i gjitha pjesëve të Kuranit, sepse shpesh flitet për Zotin në vetën e 3-të, njëjës. (...) Ndonjëherë sikur ndodhin tallje me Zotin, i cili na genkësh betuar në Zot...”²⁹⁸

Montgomery sjell si shembuj ajetet 75:1-2, 90:1, 19:65-66.

Ibn Warraq sjell edhe vlerësimin e filologut dhe islamologut arab, As-Sujuti, i cili ka evidentuar 275 fjalë të huaja në tekstin original të *Kuranit*, që u përkisnin gjuhëve: armenisht, hebraisht, sirishte e vjetër,

²⁹⁸ Ibn Warraq, “Warumichkein Muslimbin”, Matths & Seitz, Berlin 2007, S. 159.

etiopisht, persisht e greqisht. Edhe emërtimi *Kuran* është nga sirishtja e vjetër.

Mbase mund të keqkuptohet Allahu, se paskësh qenë mosnjohës i gjuhës arabe, ose arabishtes i mungonin ato fjalë. Këto huazime mund të keqkuptohen edhe si njohuri që duhet të ketë pasur Muhamedi ose bashkëveprimtarët e tij për gjuhë të tjera.

Rëndom, kur diskutohet për autorësi të Kuranit, klerikët myslimanë e citojnë ajetin:

“Ne, me të vërtetë, kemi shpallur Kuranin dhe Ne, me të vërtetë, do ta ruajmë atë”. [15:9]

Kështu do të duhej të qëndronte, sikur Muhamedi, i cili duhet të kenë qenë publikuesi i parë i “zbritjeve”, do të kishte sqaruar se këtë ia kishte thënë Allahu, ose të kishte dhënë sqarimin se xhibrili më tha, që Zoti i kishte thënë atij etj. Meqë askund nuk është thënë se Allahu ka folur vetë me Muhamedin, atëherë si mund të rezultojë ky formulim, sikur vetë Allahu e ka shkruar *Kuranin*. Deri këtu, në këtë sure, mungon urdhërimi: “thuj: ‘...’, siç është evidente 350 herë në tekstin zanafillor të *Kuranit*,²⁹⁹ të futur nga “komisioni redaktues” i kalifit Utman (651 ose 653).

Ekzistenca aktuale e *Kuranit* në rreth 20 variante në gjuhë (dialekte) arabe është edhe një demant i gënjeshtres se mitizuar, që e përmban ajeti i sipërcituar [15:9]. Këto dallime janë përvijuar nga “shkollat” (rrymat / sektet) e ndryshme, të përvijuara fill pas sajimit të Islamit, në epiqendrat Meka, Medina, Kufa (Abdallah ibn Masud),

²⁹⁹ Ibn Warraq, “Warumichkein Muslimbin”, Matths & Seitz, Berlin 2007, S. 157.

Në variantin e shqipëruar nga Hasan Efendi Nahiu, urdhërimi “thuj” është i pranishëm 203 herë, në shqipërimin nga Sherif Ahmeti është evident 277 herë, ndërsa në shqipërimin e Feti Mehdiut 267 herë. Ekziston edhe një shqipërim i katërt nga grup autorësh (Darus-Salam) dhe aty urdhërimi “thuj” është i pranishëm vetëm 115 herë. Variantin e katërt (edhe të tjerët) e kam gjetur në linkun: <http://www.kuranifisnik.net/kuranifisnik/Download/>

Basra (Ebu MUSAAL-ASCH'ARI), Siri (UBAIY IBN KAB) etj. Edhe “dijetarë” tjerë përvijuan variante të tyre, të cilat “dijetarët” islamë i kamuflojnë si “mënyra interpretimi”. Ndër ta edhe ABU HURAIRA, 'URVAIBNAZ-ZUBAIR, MUHAMMADAL-BAKIR, i dhe DSCHA'FAR AS-SADIK në Medina, 'ABDALLAHIBN 'ABBAS dhe MUXHAHID IBN XHABR në Meka, AL-HASANAL-BASRI dhe KATADA IBN DIAMA në Basra, AL-A'MASH në Kufa si dhe ATËJA IBN KAIS in Syrien.³⁰⁰

Në traditën sunite, siç informonte Ibn Muxhahid, ishin të legalizuar shtatë variante [arabisht ahruf / أحرف]. Ndërsa Ibn al-Xhzari shton edhe tri variante të tjera³⁰¹. Varianti *Hafsh ibn Sulaman* është më i shpërndari ndër sunit. Varianti *Varsh* kryesisht në Afrikën e Veriut.

Ibn Waraq vazhdon me konkretizime, cituar edhe ajetet:

...Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe një libër i qartë. [5:15]

Allahu me atë vë në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave dhe i udhëzoi në rrugë të drejtë. [15:16]

³⁰⁰ Sipas orientalistëve Gotthelf Bergsträßer dhe Otto Pretzl, në “*Die Geschichtedes Qorāntexts* in Theodor Nöldeke, *Geschichtedes Qorāns*”, Leipzig 1938; varianti elektronik, f. 157-205.

http://muhammadanism.org/German/Noldeke/geschichte_3/geschichte_noldeke_3.pdf
Informacion edhe më të zgjeruar: Gotthelf Bergsträßer, “*DieNegationen im Kur'an*”, 1911, varianti digjital:<https://archive.org/details/dienegationenimk00berg>

³⁰¹ *Nāfi'* nga Medina (689-785), përcjellë nga *Warsh* (728-813) dhe *Kalyn* (738-835); *Ibn Kaṭīr* nga Meka (665-738), përcjellë nga *Al-Bazī* (786-864); *Ibn 'Emir* nga Damaskus (629-736), përcjellë nga *Hisham* (770-859).

Ebu 'Amr nga Basra (687-771), përcjellë nga *Ad-Durī* (vdekur 860) dhe *As-Susi* (806-875) *'Aṣim* nga Kufa (vdiq 745), përcjellë nga *Shu'ba* (714-803) dhe *Hafṣ ibn Sulaimān* (709-796)

1. *Ḥamza* nga Kufa (699-755), përcjellë nga *Ḥalaf* (vdekur 844) dhe *Ḥallad*
2. *Al-Kisā'ī* nga Kufa (737-804), përcjellë nga *Abu-l-Ḥarīṭ* (vdekur 854) dhe *Ḥafṣad-Dūrī* (vdekur 763)
3. *Abu Xha'far* nga Medina (vdekur 748), përcjellë nga *Ibn Vardan* (vdekur 777) dhe *Ibn Xhammaz* (vdekur 786)
4. *Ja'kub* nga Basra (vdekur 820), përcjellë nga *Ruvais* (vdekur 852) dhe *Ravḥ* (vdekur 849)
5. *Ḥalaf* nga Kufa, përcjellë nga *Is'haq* (vdekur 899) dhe *Idris* (vdekur 905)

Gjithsesi, po të ishte Zoti autor i tekstit, nuk do të thoshte as shkruante “*Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe një libër i qartë*”, por do të duhej të thoshte ose shkruante: “Nga unë ju erdhi *Kurani*” (sikur të kishte “zbritur” *Kuranin* të kompletuar, dhe jo sure pas sures, ajet pas ajeti).

Ja dy ajetet e para të sures *Az-Zumar*:

“Shpallja e librit nga Allahu i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm!” [39:1 / shqipëruar nga Hasan Efendi Nahi]

“Njëmend, ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën e qartë. Ndaj adhuroje Perëndinë singërisht në besim!” [39:2 / shq. Hasan Efendi Nahi]

« [39:1] تنزيل الكتاب القرآن مبتدأ «من الله» خبره «العزیز» في ملكه «الحكيم» في صنعه»
نا أنزلنا إليك» يا محمد «الكتاب بالحق» متعلق بأنزل «فاعبد الله مخلصا له الدين» من الشرك: أي موحدًا له. [39:2]

Meqë fjalia ajeti 39:1 nuk rezulton e konkretizuar, po ofroj edhe shqipërimin e Sherif Ahmetit. Ata që zotërojnë arabishten, e kanë në arabisht.

“Shpallja e librit është prej Allahut, të gjithëfuqishmit, të urtit”. [39:1 / shq. Sherif Ahmeti]

“Ne ta shpallëm ty librin për hir të së vërtetës, ndaj ti adhuroje Allahun duke qenë i singërtë në adhurimin e Tij!” [39:2 / shq. Sherif Ahmeti]

Në të dy variantet e shqipëruara rezulton se dikush tjetër (dhe jo Allahu) ka (dez)informuar se “libri” na qenkësh shpallur nga Allahu. I njëjti autor teksti, në ajetin pasues, porositi Muhamedin që ta adhurojë Allahun. Siç është evidente, nuk e kemi as urdhërimin “thuj” (arabisht: “kul”), që të mund të arsyetohej se është autorësi e Allahut, por i rrëfyer indirekt, qoftë nga Xhibrili, qoftë nga një autor tjetër.

Orientalisti Charles Hamilton (përkthyesi i *Kuranit* në anglisht, që çmohet si më profesionalisti) ishte i mendimit:

*“Se kush ishte me të vërtetë autori i këtij koleksioni të jashtëzakonshëm të deklarimeve dhe rekomandimeve, do të mbetet përherë e dyshimtë, veçanërisht pasi ka dhe kishte shumë mendime të ndryshme për këtë çështje, madje edhe në mesin e kundërshtarëve më të hershme të Muhamedit dhe misionit të tij mashtrues. Që ky person i jashtëzakonshëm ishte iniciatori kryesor, kjo është krejtësisht e pakundërshtueshme, edhe pse ka të ngjarë që ai u ndihmua në sajimin e veprës së tij nga të tjerët”.*³⁰²

Ndërsa orientalisti gjerman Rudi Paret, i cili është vlerësuar për përkthimin më profesional të *Kuranit*, në gjermanisht, ka bërë edhe këtë vlerësim:

*“Teksti, siç na prezantohet sot dhe që ribotohet vazhdimisht, është sipas edicionit të mrekullueshëm të Kajros në vitin 1925, i cili duhet të jetë i mbështetur në variantin e redaktuar në mbikëqyrjen e kalifit Utman” [rreth 20 vjet pas vdekjes së Muhamedit.].*³⁰³

Ndërsa orientalisti dhe islamologu tjetër gjerman, Karl-Heinz Ohlig, është i mendimit:

“Sa i përket autorësisë të tekstit origjinal [të Kuranit], mbetet kryesisht çështje besimi, sepse nuk është gjendur asnjë dëshmi historike për këto opinione, as për origjinën e tekstit kuranor të Muhamedit, vetë Kurani nuk mund të çmohet si dëshmi historike, por as për sajimin e gjithë Kuranit nën direktiva të kalifit Utman, gjithashtu, nuk ekziston asnjë dëshmi autentike historike, që botimi i vitit 1925 në Kajro është vërtet identik me tekstin e Kuranit të kalifit Utman. Rrëfime që janë shkruar dy apo treqind vjet pas ngjarjeve mund të merret historikisht parasysh vetëm

³⁰² Charles Hamilton: The Hedaya: Commentary on the Islamic Laws. New Dehli: Kitaphavan, 1985, Band 1 S. VIII.

Kjo vepër monumentale është përgatitur me porosi të qeverisë britanike...;

Cituar sipas islamologut turk, dr. Hamza Mustafa Njozi, në studimin e tij "Origjina e Kuranit", publikuar në portalin:

http://www.way-to-allah.com/dokument/Ursprung_des_Korans.pdf.

³⁰³ Rudi Paret, Der Koran als Geschichtsquelle, in: Der Islam 37, 1961, f. 27.

nëse ato janë të konfirmuara nga burime autentike historike të kohës, por jo nëse ato përmbajnë një stilizim të mëvonshëm, krejtësisht teologjik dhe "politik". (...) Atëherë mund të thuhet se disa nga thëniet e Kuranit ndërlidhen me ngjarjet në kohët e sundimit të sasanidëve, por pastaj gjithnjë më shumë është shtuar e përshtatur teksti i Kuranit".³⁰⁴

Po filloj me analizim të tekstit të *Kuranit*, për të vërtetuar se as Allahu muhamedan nuk është autor. Ata që e kanë sajuar tekstin e *Kuranit* nuk janë përkujdesur ta formulojnë, që të rezultojë se Allahu është autor i tij.

Surja (kapitulli) e parë, ajetet 1-7 (sipas renditjes gjatë “redaktimit” të *Kuranit*, dhe jo sipas radhës se “zbritjes”, “shpalljes”, “zbulimit”*):

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:1]

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! [1:2]

Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:3], Sunduesit të Ditës së Gjykimit (përgjegjësisë-shpërblimit)! [1:4]

Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë! [1:5]

Udhëzona (përforcona) në rrugën e drejtë! [1:6]

Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira, jo në të atyre, që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten! [1:1-7 / shqip. nga Sherif Ahmeti].

Vetëm besimtari injorant dhe i frikësuar thotë se ky formulim ka për autor Allahun, kurse një njeri me arsimim, edhe vetëm fillor, menjëherë do të thotë: *Allahu nuk është autor i tekstit!*

Autori Muhamed (ndonjë këshilltar i tij, komisioni i kalifit Utman ose “komisione redaktuese” të mëvonshme) e kanë filluar tekstin e

³⁰⁴ Karl-Heinz Ohlig, "Werhatden Koran geschrieben?" (Kush e ka shkruar *Kuranin*?), botuar në portalin: http://www.imprimatur-trier.de/2014/Imprimatur-2014-04_7.pdf

* Islamologët propagandues kanë vështirësi me përdorim të shprehjeve që duhet të përmbajnë “transmetimin” e tekstit të *Kuranit* nga zoti te Muhamedi, prandaj herë thonë shpallje, herë zbulim, herë zbritje etj.

Kuranit duke iu drejtuar Allahut. Po të ishte autor Allahu, teksti do të duhej të ishte: “*Me emrin tim...Falënderimi me takon mua...*”

Kurse në ajetet (ajetet) 5 dhe 6, është akoma më e qartë, se formuluesi i drejtohet Allahut: “*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm te Ty kërkojmë ndihmë! Udhëzoni në rrugën e drejtë!*”

Vetëm injorantët, besimtarët fanatikë, mund të thonë se këto dy ajete janë formulim i Allahut. Ata që ia mveshin, gjithsesi, autorësinë Allahut të tyre, nuk janë të vetëdijshëm se, me këtë rast, nuk e bëjnë autor Allahun, por po i drejtohet një zoti tjetër, akoma më të madh se Allahu.

Po përzgjedh ajetin 11:2, i cili nuk lë hapësirë për mëdyshje, se kryeautor i *Kuranit* duhet të jetë Muhamedi:

Që të mos adhuroni tjetër përveç Allahut. Unë jam (dërguar) nga Ai, qortues e përgëzues për ju. [11:2 / përk. Sh. Ahmeti]

Adhuroni vetëm Perëndinë, unë jam për ju nga Ai, paralajmërues dhe sihariques, [11:2 / përk. H. E. Nahi]

Që të mos adhuroni tjetër, përveç Allahut - unë jam dërguar nga ana e Tij qortues dhe përgëzues; [11:2 / përk. F. Mehdiu]

Edhe ajetet në vijim ofrojnë mundësinë konkrete për të kuptuar se Allahu nuk është autor i *Kuranit*!

“Falënderim i qoftë vetëm Allahut që krijoi qiejt dhe tokën, që formuloi errësitat e dritën, e megjithëkëtë ata që mohuan, i barazojnë (idhuj) me Zotin e tyre”. [6:1] Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh...” [7:54]

Shpallja e librit është prej Allahut, të gjithëfuqishmit, të urtit. [39:1]

Ja edhe disa ajete që nuk lënë hapësirë për mëdyshje se personazhi Allah nuk është autori i *Kuranit*:

Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre...[2:7]

...ata përpiqen ta mashtrojnë Allahun...[2:9]

...në zemrat e tyre kanë sëmundje, e Allahu u shton sëmundje...” [2:10]

Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, ...” [2:26]
Ata që e thyejnë besën e dhënë Allahut pasi që është lidhur ajo...[2:27]
Si e mohoni Allahun, e dihet se ju ishit të vdekur e Ai ju ngjalli...?” [2:28]
Është Ai, që për ju krijoi gjithçka që ka në tokë...[2:29]
Kur Zoti yt u tha engjëjve:...[2:30]
E Ai ia mësoi Ademit të gjithë emrat...[2:31]
E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë, prandaj Ai ia fali...[2:37]
...Kjo për ju është më së miri te Krijuesi juaj. E Ai ua pranoi pendimin...[2:54]
Përkujto kur Zoti i tij Ibrahimin e provoi me disa obligime...[2:124]
E nëse heqin dorë Allahu është Ai që fal dhe që mëshiron. [2:192]
...Pra, kini kujdes Allahun dhe dijeni se ju tek Ai tuboheni. [2:203]
Njerëzit ishin një popull e Allahu dërgoi pejgamberët...[2:213]
E nëse keni frikë (...) përkujtoni Allahun...[2:239]
Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë, Ai t’ia shtojë atij...[2:245]
Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës...[2:255]
Vetëm të Allahut janë gjithçka ka në qiej dhe në tokë...[2:284]
Ai ta zbret ty (Muhamed) librin me argument...[3:3]
Allahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij...[3:18]
Vërtet, çështja e Isait tek Allahu është sikurse çështja e Ademit...[3:59]
O ju që besuat, kini frikë Allahun...! [3:102]
Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut...[3:103]
Vetëm e Allahut është gjithçka në qiej e në tokë, Ai i fal...[3:129]
Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e Allahut...[3:145]
O besimtarë (...) vetëm Allahu është ndihmësi juaj...[3:149-150]
Nëse Allahu dëshiron t’ju ndihmojë, s’ka kush mund t’ju mposhtë...[3:160]
Allahu nuk i lë besimtarët ashtu siç janë...[3:179]
Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atë në asnjë send...[4:36]
S’ka dyshim se Allahu nuk bën pa drejtësi as sa grimca...[4:40]
S’ka dyshim se Allahu nuk fal t’i përshkruhet Atij shok...[4:48]
Allahu vlerëson atë që do...[4:49]
Shiko se si shpifin kundër Allahut! [4:50]
Kush shpërngulet për hir të Allahut...[4:100]
Ata fshihen prej njerëzve, e nuk turpërohen prej Allahut, e Ai është...[4:108]
...Allahun falës dhe mëshirues. [4:110]
Është e vërtetë se Allahu nuk falë t’i bëhet Atij shok...[4:116]
Nëse Ai dëshiron, ju zhdok juve, or njerëz...[4:133]
Ata që i besuan Allahut dhe iu përmbajtën Atij, Ai...[4:175]
E kush pendohet (...) Allahu ia pranon pendimin...[5:39-40]
Vetëm i Allahut është sundimi ndaj qiejve e tokës...[5:120]

Pasha Allahun, ty të është shpallur, edhe atyre para teje:....[39:65]

Po të vazhdohet me konkretizim të të gjitha ajeteve, sigurisht do të ngarkohet trajtimi deri në bezdisje.

Po provoj të sjell informime të karakterit tjetër, që tërthorazi sqarojnë se Allahu nuk ishte autor i tekstit të *Kuranit*.

Kalifi i tretë Ut'hmanibn' Afan (عثمان بن عفان) duhet të ketë formuar një ekip prej katër vetash, nën drejtim e "sekretarit" të Muhamedit, Zajd in Tabit. Ai i mbledh ajetet dhe i redakton pesë ekzemplarë (651), duke u bazuar në përmbledhjen nën përkujdesje të kalifit Ebu Bekri. Si tekst bazë u përzgjedh dialekti i fisit Kurejsh, sepse Muhamedi dhe bashkautorët i përkisnin atij fisi dhe, prandaj, kishin sajuar në atë dialekt. Kalifi Utman urdhëron që të gjitha përmbledhjet e mëhershme të digjen³⁰⁵.

Sipas (dez)informimit të Ibn Umar, bashkëkohës i kalifit *Utman*, askush nuk do të duhej të thoshte se e zotëron *Kuranin* origjinal, meqë pjesët më të mëdha janë humbur. Pas vdekjes së kalifit Utman, guvernatori i Kufasal-Haxhaxh ka ndërmarrë edhe 11 ndryshime të vogla në *Kuran*.³⁰⁶

Edhe me anë të *fetvave* (ekspertiza ligjore) do të ofroj argumente se *Kurani* është sajuar nga njerëzit dhe jo nga ndonjë lloj zoti, as nga Allahu muhamedan.

³⁰⁵ Sahihal-Buhari, vëll. 6, faqe 479, nr. 410; libri 61.

³⁰⁶ <http://www.orientdienst.de/muslims/minikurs/koranentstehung/>.

Më gjerësisht edhe në studimin e Ahmadvon Denffer, "ULUM AL-QUR'AN" (Einführung in die Koran wissenschaften / Hyrje në shkencën për Kuran)", ajetioni elektronik: http://www.way-to-allah.com/dokument/ULUM_AL_QURAN.pdf.

Fetvaja për çështjen e teksteve që janë larguar nga Kurani me udhëzim të Allahut:

- Nga ekspert ligjor, dietar autoritativ mysliman sunit dhe predikuesi i islamit, Muhamedi as-Shughbi.

Pyetje [moderatori]: “Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me t ...” [2:106]

Përgjigje: “Parimi i heqjes se ajeteve nga Kurani ndodh në tri mënyra të ndryshme:

1. Nëse janë hequr pjesë të tekstit [të një ajeti kuranor], atëherë është hequr i gjithë ajeti. Në njërën anë nuk ekziston më ajeti në Kuran, nga ana tjetër, përmbajtja e tij nuk është më e vlefshme për ne. Dëshmi për këtë lloj të zhdukjes është një transmetim autentik [arab. sahih hadith] nga imam Ahmad. Ai thotë: “Njëri nga bashkëkohësit e Profetit (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) kishte mësuar një sure kuranore përmendsh. Ai donte ta recitonte këtë sure në namazin e natës. Megjithatë, atij nuk po i kujtohej për momentin. Dy myslimanë të tjerë gjithashtu e kishin harruar atë sure. Që të tre shkuan te Pejgamberi i Allahut (Paqja dhe mëshira qofshin mbi të!). Ai i pyeti për shqetësimin që kishin. Ata i treguan për harresën e sures. Profeti i Allahut (Paqja dhe mëshira qofshin mbi të!) u tha: “Ajo sure është larguar dje nga Allahu”. Pra, ajo sure ishte hequr kudo, si nga kujtesa e atyre që e kishin mësuar përmendsh, ashtu edhe nga teksti i Kuranit.

2. Teksti i Kuranit është hequr, por përmbajtja / mësimi i tij është ende i vlefshëm. Për shembull, shohim ajeti për gurëzim (gjuajtje me gurë): Ky ajet thotë: “Nëse një e/i rritur bën marrëdhënie seksuale jashtëmartesore, gjuani me gurë derisa ta mbytni. ” Përmbajtja e këtij ajeti është i vlefshëm në Kuran [edhe pse ky ajet nuk ekziston më në Kuran]. Pra, gjuajtja me gurë e një të martuari/e, që shkel kurorën është [ende] obligative. Informimi për këtë [ajet Kurani] është nga Buhari. Këtë e thotë Umar Ibn el-Hatab [vjehrii i Muhamedit].

3. Një ajet nuk obligon fare, edhe pse ende ekziston në tekstin e *Kuranit*”.³⁰⁷

Nga shtjellimet që paraqita rezulton se as Allahu muhamedan nuk është autor i tekstit të *Kuranit*. Autor i *Kuranit* është Muhamedi me bashkëvendimtarë e bashkëveprimtarë të tjerë.

II. 4. Kurani - kundërthëniet

Aktualisht jemi të ballafaquar edhe me një propagandë të zhurmshme, agresive: „*Kurani* është vepër e përkryer, sepse e ka krijuar Allahu!”

Edhe kryeautori i *Kuranit*, Muhamedi, është përpjekur të mbrojë sajësën e tij, prandaj në shërbim të këtij qëllim duhet të ketë sajuar ajetet vijuese:

Sikur (Kurani) të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie. [4:82]

Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca. [6:38]

Përkundër kësaj, ata thonë se atë e trilloi ai (Muhamedi). Ti thuaj: „Silleni pra ju një kaptinë të ngjashme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos Allahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni”. [10:38]

Apo, pse ata thonë: „Ai (Muhamedi) e trilloi atë“. Thuaj: „Formuloni, pra, dhjetë kaptina si ai, ashtu të trilluara...” [11:13]

Ne me të shpallur të këtij Kurani po të rrëfejme ty më të bukurin rrëfim, edhe pse para tij ishe nga të painformuarit. [12:3]

Kurani nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i shpalljeve para tij dhe shpjegues i çdo gjëje, dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin besimtarë. [12:111]

Këto ajete të kësaj kaptine dhe e tërë ajo që t'u shpall ty nga Zoti yt janë realitet, por shumica e njerëzve nuk besojnë. [13:1]

³⁰⁷ <http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M51ac8fe26d5.0.html>.

ISLAMI, religion agresiv (?!)

Ne e shpallëm atë (Kurani) kushtetutë në arabisht. Nëse ti pasi të kanë ardhur argumente të qarta, shkon pas dëshirave të tyre, ti nuk ke prej Allahut as ndihmë, as mbrojtje. [13:37]

Ky (Kurani) është në gjuhën e qartë arabe. [16:103]

Duke qenë Kuran arabisht, nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar. [39:28]

S'ka dyshim se Ne e bëmë atë Kuran arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni. [43:3]

Ne Kurani e bëmë të lehtë për mësim, po a ndokush që merr mësim? [54:17]

Vetëlavdërim! *Kurani*, megjithatë, ka ajete që pohojnë se ai përmban edhe formulime të pakuptueshme, siç (dez)informohet në ajetin pasues:

Është ai që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjera që nuk janë krejtësisht të qarta. E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, kinse po i komentojnë. Po, pos Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë... [3:7]

Po ta bënte ndonjë jomysliman këtë (dis)kualifikim që përmban ky ajet, islamistët do të thoshin se ka qenë i shtyrë nga motivet islamofobe; kush është ai që i identifikon ajetet e pakuptueshme, kuptimin e të cilave e di vetëm Allahu?! Pastaj, kush mund t'i gjurmojë ato, pa u akuzuar se paskësh përcaktime dashakeqëse?!

Vetëm besimtarët injorantë mund të këmbëngulin se autori i këtij ajeti është Allahu. Në fakt, po të ishte Allahu autor, ai nuk do ta fillonte ajetin me përemrin, në vetën e tretë njëjës *ai*. Nga ky formulim rezulton sikur përveç Allahut, si autor i *Kurani*, paskësh edhe një Allah tjetër, por më të madh.

Për të kundërshtuar lavdërimet e këtilla propagandistike do të përgjedh disa ajete, që kanë përmbajtje kundërthënëse e kontroverse.

Kundërthëniet për „zbritje” të *Kuranit*:

Muaji i ramadanit, që në të shpallet Kurani, i cili është udhërrëfyes për njerëzit, sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues... [2:185]

Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit. [97:1]

Në kundërthënie me:

... Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islam in fe... [5:3].

Dhe Kuranin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një. [17:106]

Ne e sollëm atë ajet pas ajeti. [25:32]

Tematikës së „zbritjes”, „shpalljes” dhe „zbulimit” të *Kuranit* si tërësi, ose ajet pas ajeti gjatë 23 vjetëve, do t'i kushtoj një kapitull më vete. Kjo është njëra nga kundërthëniet më skandaloze, para së cilës edhe propagandistët më të shkathët detyrohen të belbëzojnë, sepse, ta zëmë, nuk dihet fare as kur është Nata e Kadrit, ndërkohë që në të gjithë botën besimtarët myslimanë e festojnë në natën e 27 të muajit ramadan, vetëm pse dikujt duhet t'i jetë tekur të thotë se atë natë duhet të festohet etj.

Me këtë rast mjafton të thuhet se vetë ajeti 5:3 e kundërshton ajetin 2:185. Në rastin e parë kemi të bëjmë me ajetin përmbyllës, „të zbritur” disa ditë para vdekjes së Muhamedit, që do të thotë përmbyllje e procesit 23-vjeçar të sajimit të *Kurani*, ajet pas ajeti, siç thuhet edhe në ajetin 25:32. Prandaj *Kurani* nuk mund „të jetë zbritur“, „shpallur” e „zbuluar” asnjëherë si tërësi, as në Natën e Kadrit.

Kundërthëniet për (mos)kompletimin e *Kuranit*:

... Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca... [6:38]

Në kundërthënie me:

Thuaj: „Sikur të ishte deti ngjyrë për t'i shkruar fjalët e Zotit tim, deti do të shterej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, edhe sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti)”. [18:109]

Ajeti 6:38 bie ndesh me ajetin 18:109. Në të parin thuhet se çdo gjë është evidentuar, ndërsa në tjetrin thuhet, figurativisht, se nuk do të mjaftonte as uji i deteve, po të kishte ngjyrë, për të përmbledhur të gjitha ato që do të mund të thoshte Allahu.

Kundërthënia - Allahu u ka folur drejtpërdrejt njerëzve?

Ne i thamë: „O Adem, ti dhe bashkëshortja jote banoni në xhenet dhe hani lirisht nga frutat e tij, por mos iu afroni asaj peme e të bëheni zullumqarë“. [2:35]

Në kundërthënie me:

Nuk ka asnjë njeri që t'i ketë folur Allahu ndryshe, vetëm se me anë të frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t'i dërgojë të dërguar, e ai t'i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai. [42:51]

Në ajetin 2:35 rezulton se Allahu i paskësh folur Adamit drejtpërdrejt, kurse në ajetin 42:5 del se Allahu nuk i është drejtuar askujt drejtpërdrejt, por përmes frymëzimeve, engjëjve dhe duke vendosur në mes një „perde“ (hixhab). Pra, përmbajtjet e këtyre ajeteve janë kundërshtuese!

Kundërthëniet për numrin e engjëjve:

Përkujto kur engjëjt i thanë: „Oj Mejreme, Allahu të dalloj ty dhe të lartësoi mbi gratë e botës“. [3:42]

Në kundërthënie me:

Ajo vuri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. [19:17]

Në ajetin 3:42 janë shumë engjëj, kurse në ajetin 19:17 është vetëm një, Xhibrili. Sërish kundërthënie!

Kundërthëniet për myslimanët e parë:

Ajeti 39:12, i cili përmban urdhrin e Allahut që i ka dhënë „Të Dërguarit” (Muhamedit), qartësisht e përcakton Muhamedin si mysliman të parë. Dhe është e logjikshme që sajuesi i kësaj feje, Muhamedi, të ishte myslimani i parë. Por në ajetet e tjera kontestohet se Muhamedi është mysliman i parë. Këto kundërthënie duhet të kenë ndodhur për shkak të manovrimeve të Muhamedit, herë për të qenë i pari në fenë e tij, herë për të mashtruar të tjerët, sikur islami daton qysh nga „njeriu i parë” (Adami), pastaj qysh nga Abrahami etj. Pra, varësisht nga nevojat e tij taktiko-propagandistike, në kohë dhe në hapësirë.

Që të mos adhuroni tjetër përveç Allahut, unë jam dërguar nga Ai, qortues e përgëzues për ju. [11:2 / përktheu Sherif Ahmeti].

Adhuroni vetëm Perëndinë, unë jam për ju nga Ai, paralajmërues dhe sihariques.[11:2 / përktheu. Hasan Efendi Nahi]

Që të mos adhuroni tjetër, përveç Allahut - unë jam dërguar nga ana e Tij qortues dhe përgëzues. [11:2 / përktheu Feti Mehdiu].

I afishova tri variantet e shqipërimit, për shkak të domethënies së këtij ajeti, i cili vërteton se personazhi Allah nuk është autor i *Kuranit!* Njëherazi, këtu është përcaktimi se Muhamedi ishte myslimani i parë, siç edhe duhet të ketë qenë, si sajues i dogmës së tij që ishte. Por, siç do të shohim në vazhdim, edhe ndaj këtij ajeti ka kundërthënie:

Thuaj: (...) „dhe më është urdhëruar që të bëhem myslimani i parë”. [39:12]

Në kundërthënie me:

E Ademi prej Zotit të vet pranoi disa fjalë, prandaj Ai ia fali, Ai është Mëshirues dhe pranues i pendimit. [2:37]

Kur Zoti i vet atij i tha: „Dorëzohu!” Ai tha: „I jam dorëzuar Zotit të gjithësisë!” [2:131]

E Ibrahim i porositi bijtë e tij dhe Jakubin: „O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë! [2:132]

Kur Musai erdhi (...) në vete, tha: „Qofsh i lavdëruar Ti, kthehem te Ti dhe unë jam i pari i besimtarëve! [7:143]

... e faraoni ... tha: „Besova se nuk ka Zot tjetër pos Atij që i besuan izraelitët, edhe unë jam nga myslimanët! [39:12]

Meqë ne (disa egjiptianë) jemi besimtarët e parë, shpresojmë se Zoti ynë do të na i falë mëkatet tona! [26:51]

Ti nuk hakmerresh ndaj nesh (bijë izraelitë - sqarimi im) vetëm pse besuam në argumentet e Zotit tonë, pasi na erdhën ato. Zoti ynë, na dhuro durim dhe na bëj të vdesim myslimanë! [7:126]

... E vetë Mesihu (Isai) tha: „O bij izraelitë, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës. [5:72]

Kush, në fakt, ishte mysliman i parë? Adami (Ademi), Abrahami (Ibrahimi) me djemtë e tij, Moisiu (Musai), Faraoni, egjiptianët, bijtë izraelitë, Jezusi (Isai) apo Muhamedi?

Përmes këtyre ajeteve Muhamedi njëherazi na (dez)informon se ai vetë është myslimani i parë, pastaj dezinformon se Adami ishte myslimani i parë, edhe Abrahami (i arabizuar në Ibrahim) dhe bijtë e tij ishin myslimanë të parë, edhe Moisiu (i arabizuar në Musa) ishte myslimani i parë, edhe Faraoni dhe egjiptianët ishin myslimanë, edhe bijtë izraelitë ishin myslimanë, edhe Jezusi (i arabizuar në Isa) ishte mysliman, para Muhamedit.

Vetëm në ajetin 39:12 Muhamedi rezulton të ketë qenë i singertë.

Pra, Muhamedit duhet t'i kenë ndodhur gjithë këto kundërthënie, për shkak se nuk ka mbajtur mend çfarë ka formuluar në secilin ajet, veç e veç, që të mund t'i dakordonte përmbajtjet e tyre ose sepse ia ka kërkuar taktika propagandistike. „Profeti” fatkeq nuk kishte as laps, as letër për t'i shkruar e krahasuar ajetet; kompjuter jo që jo, sepse Allahu ka ditur të „krijojë” tokën, shtatë qiej, Adamin, Evën, të gjitha gjallesat, gjithçka, por jo kompjuter, laps, letër...

Vërtet, si nuk i krijoi Allahu edhe këto, që t'ia lehtësonte punën Muhamedit, që ta kishte më të lehtë „krijimin”, ta zëmë të lapsit dhe letrës, sesa krijimin e tokës, qiejve, Adamit, Evës...

Sigurisht, është më tepër sesa irrituese për besimtarët judaistë e kristianë, që profetët e tyre të tjetërsohen në myslimanë, duke ua arabizuar edhe emrat!

Kundërthëniet për fuqinë e Allahut:

Ai është shpikës i qiejve e i tokës e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: „Bëhu!” në atë moment bëhet. [2:117]

Në kundërthënie me:

Vërtet, Zoti juaj, Allahu është Ai, i cili krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh... [7:54]

Vërtet Zoti juaj është Allahu, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh... [10:3]

i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditëve [11:7].

Ai krijoi qiejt e tokën dhe gjithçka që gjendet mes tyre brenda gjashtë ditësh [25:59].

Është ai, që krijoi qiejt dhe tokën, e si do të ketë Ai fëmijë, kur nuk pati bashkëshorte? [6:101]

Pra, në ajetin 6:101, Allahu shtron pyetjen, sikur t’i drejtohej një sozie të tij (kopjeje), dhe si pyetje sugjestive që është, i bie që as Allahu, pa pasur grua, nuk lind dot fëmijë. Pra, nuk qenkësh i vërtetë urdhri „Bëhu!” [2:117]. Ose, edhe toka e qiejt nuk janë bërë, sepse janë urdhëruar „Bëhu!”, por, megjithatë, „krijuesit” i janë dashur gjashtë ditë për t’i bërë.

Siç do të shohim, në *Kuran* flitet për qiej (në shumës), asnjëherë nuk flitet vetëm për një qiell.

Kundërthënia për (mos)dhunën në islam:

Në fe nuk ka detyrim... [2:256]

Dhe ata, të cilët besojnë në atë që t’u shpall ty, dhe në atë që është shpallur para teje, dhe që janë të bindur plotësisht për botën tjetër. [2:4]

Të tillët janë të udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm ata janë të shpëtuarit. [2:5]

*Thuaj: „O ju jobesimtarë! [109:1]
Unë nuk adhuroj atë që e adhuroni ju! [109:2]
As ju nuk jeni adhures të Atij që unë e adhuroj! [109:3]
Dhe unë kurrë nuk do të jem adhures i asaj që ju adhuroni! [109:4]
Por edhe ju nuk do të jeni adhures të Atij që unë e adhuroj! [109:5]
Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time! [109:6]*

Këto ajete shpërdorohen më së shpeshti nga propagandistët e islamit, kur ata duan të mashtrojnë se feja myslimane është fe paqësore. Por janë qindra ajete të tjera, që dëshmojnë se feja myslimane është e dhunshme. Ja disa prej tyre:

*Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër... [9:29]
Dhe luftoni ata kudo që t'i zini, dëboni prej vendit siç ju kanë dëbuar ata juve... [2:191]
Luftoni ata (idhujtarët) derisa të zhduket propagandimi i tyre dhe derisa të aplikohet feja vetëm për Allahun... [2:193]
Juve ju është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni atë. Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është i dëmshëm për ju. Allahu e di (fundin e çdo sendi), ju nuk dini. [2:216]
Luftoni për hir të Allahut, e të dini se Allahu dëgjon, di. [2:244]
Përkujto (o i Dërguar) kur dole nga familja jote që t'ua përcaktosh besimtarëve vendet për luftë, e Allahu është që dëgjon (fjalët) dhe që kupton (qëllimet). [3:121]
Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij (...), nuk është tjetër, vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo është poshtërim për ta në Dynja, në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]
Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloj Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë, prej atyre të cilëve u është dhënë libri, derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur. [9:29]
O ju që besuat, luftoni jobesimtarët që i keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre... [9:123]
Po nëse hipokritët dhe ata që kanë zemra të sëmura, por dhe ata që përhapin gënjeshtër në Medinë e nuk ndalen, Ne do të bëjmë që Ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë fqinjë me ty, vetëm një kohë të shkurtër. [33:60]
Të mallkuar, kudo që të ndeshen, do të kapen dhe do të mbyten. [33:61]*

Bazuar në formulimin gramatikor, nuk rezulton të jetë autor as personazhi Allah. Ndërsa kundërthëniet mes përcaktimeve tolerante e paqësore dhe atyre të dhunshmeve, agresiveve, madje edhe fashistoidëve, janë më të shumta. Por, do të mjaftonte vetëm një ajet me përcaktim fashistoid, për të diskredituar gjithë *Kuranin*.

Duhet të kihet parasysh edhe fakti se ajetet me frymë e përcaktime tolerante e paqësore janë të sajura kryesisht gjatë viteve 610-622, gjatë kohës kur Muhamedi misionarizonte në Medinë, kurse ajetet agresive fashistoidë janë sajuar kryesisht gjatë viteve 623-632, kur Muhamedi sundoi në Medinë. Prandaj studiuesit i kanë ndarë ajetet në: mekase (paqësore) dhe medinase (agresive/shpatore). Dhe tjetra, nëse dy ajete trajtojnë të njëjtën tematikë, atëherë ajeti që është sajuar më vonë e abrogon (shfuqizon) ajetin e sajuar më herët, që do të thotë se ajetet agresive medinase i shfuqizojnë ajetet mekase, tolerante e paqësore.

Kundërthënia për thirrjen e njerëzve në islam:

O njerëz, adhurojeni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve dhe ata që ishin para jush, ashtu që të jeni të devotshëm. [2:21]

Në kundërthënie me:

O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun e Allahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari. [3:15]

Dy thirrje aspak të përputhshme me njëra-tjetrën, të cilat nuk kanë autor personazhin Allah.

Kundërthënie - kë krijoi zoti së pari: tokën apo „shtatë qiejt“?

Është ai, që për ju krijoi gjithçka që ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi shtatë qiej... [2:29]

Në kundërthënie me:

A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit? E Ai e ngriti atë! Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë. Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi. E pastaj tokën e sheshti. [79:27-30]

Sipas ajetit 2:29, Allahu e ka krijuar së pari tokën, pastaj përsosi shtatë qiej. Ndërsa sipas ajetit 79:27, ai fillimisht e ka ngritur qiellin, -tashmë vetëm një, jo shtatë, si në ajetin 2:29, - dhe „pastaj e sheshti tokën”, si në ajetin 79:30.

Aspak serioze! Autori jo vetëm që nuk ka pasur njohuri lidhur me formën e „tokës” dhe të „qiellit” (të cilin ai e mendon si kupolë, sipër tokës), por as nuk ka qenë në gjendje të jetë i vëmendshëm, që të dakordojnë përmbajtjen e ajeteve.

Kundërthënie për (mos)adhurimin:

Që të mos adhuronit tjetër, përveç Allahut! Unë jam dërguar nga Ai, qortues e përgëzues për ju. [11:2]

Dhe ai i ngriti prindërit e vet në fron, dhe ata të gjithë iu përlulën atij. Ai (Jusufi) tha: „O babai im, ky është komentimi i ëndrrës sime të dikurshme. Zoti im e plotësoi atë. Dhe mua më bëri mirësi, kur më nxori nga burgu, e juve u sollti nga shkretëtira, pasi djalli pat futur ngatërresa mes meje dhe vëllezërve të mi. Me të vërtetë, Zoti im u bën lehtësi kujt të dojë... [12:100]

Ajeti 11:2 është dëshmi e fortë se autor i *Kuranit* është Muhamedi, jo personazhi Allah. Në këtë ajet nuk kemi urdhërimin: „Thuaj...””, që do të rezultonte se Muhamedi është porositur të thotë. Ndërsa në ajetin 12:100 rezulton se prindërit dhe vëllezërit e kanë adhuruar Jusufin (Jozefin).

Kundërthënie për përzgjedhje raciste

O bijtë e Izraelit, përkujtojeni dhuntinë Time, të cilën jua dhurova, dhe Unë ju pata dalluar ndaj njerëzve të tjerë. [2:47]

Allahu e zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt tjerë. [3:33]

O bijtë e Izraelit, kujtoni të mirat e Mia që jua dhurova, që ju dallova mbi njerëzit e tjerë. [2:122]

Pse, atëherë, gjithë ai shovinizëm i Muhamedit ndaj izraelitëve, i trashëguar edhe nga muhamedanët aktualë? Zoti i paskësh dalluar izraelitët, kurse Muhamedi ka lënë porosi (akoma më shumë: „amanet“), që të përzihen të gjithë hebrenjtë dhe kristianët nga Gadishulli Arab, meqë sa ishte gjallë nuk ka mundur t'i zhdukte e dëbonte të gjithë, me arsyetim shovinist se ata janë të pistë...

Një kakofoni tipike muhamedane. Edhe Adami, Noahu, Abrahami, Imrami i përkisnin të njëjtit populli, si edhe „bijtë e Izraelit“. Por, pse kishte nevojë të veçonte dhe favorizonte vetëm këtë popull? Në rastin tjetër, do të shohim se kjo është pjesërisht e vërtetë, meqë „Zoti“ i „paskësh dërguar“ secilit popull profetin e tij. Aspak hyjnore! Një argument më shumë, se një Zot i mirëfilltë nuk do të bënte të tilla dallime mes popujve. Pra, vetë sajuesit e këtyre feve i kanë prodhuar këto lloj favorizimesh shoviniste e raciste...

Kundërthëniet - vetëm një ose shumë fe?

Shumë fe (judaiste, kristiane, sabeje):

Vërtet, ata që besuan, që ishin jehudinjtë, të krishterët, sabejtë, kush e besoi prej tyre Allahun, botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as nuk kanë pse të pikëllohen. [2:62]

Një fe - vetëm islami:

E kush kërkon fe tjetër, përveç fesë islame, atij kurrësi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit. [3:85]

S'ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: „Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë“ e mes këtij duam të marrin një rrugë. [4:150]

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët. [4:151]

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij (...) nuk është tjetër, vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo është poshtërim për ta në këtë Dynja. Në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]

Të gjitha ajetet e paraqitura më lart janë në kundërshtim me ajetin 2:62, i cili ishte më liberal ndaj jomuslimanëve. Ndërsa ky i fundit [5:33] është fare ekstrem, fashistoid!

Në ajetet 3:85, 9:29 etj., Muhamedi, decidivisht, përcaktohet vetëm për fenë islame, duke i dënuar të tjerat, edhe pse në ajetin 2:62 i kishte njohur si besimtarë të arsyeshëm edhe hebrenjtë, kristianët dhe sabejtë. Këto kundërthënie dëshmojnë se Muhamedi i ka ndryshuar qëndrimet nga ajeti në ajet edhe për tematika të njëjta, varësisht nga këshilltarët, ose ato janë krijime të autorëve të tjerë!

Kundërthëniet për arsyen e krijimit të njerëzve e xhinëve:

Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra, që me to nuk kuptojnë; ata kanë sy, që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë, që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur. Të tillë janë të marrët. [7: 179]

Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër qëllim, pos që të më adhurojnë. [51:56]

O ju njerëz, ju keni nevojë Allahun e Allahu nuk ka nevojë për ju; Ai është i falënderuari. [35:15]

Ajeti 7:179 përmban një përcaktim pervers, sikur vetë Allahu i paskësh krijuar njerëzit e xhinët për t'i ndëshkuar me ferr. Pra, vetë „të këqijtë” nuk qenkëshin fajtorë, sepse të tillë na i paskësh krijuar Allahu! Nuk do të duhej të ishte në dinjitetin e Allahut, përçmimi kaq i madh për kafshët, apo i paskësh krijuar për t'i përçmuar?!

Ajeti 51:56 gjithashtu përmban një përcaktim egoist pervers të Allahut, i cili i paskësh krijuar njerëzit dhe xhinët vetëm që ata ta adhuronin atë!

Kundërthëniet - njeriun e ruajnë edhe engjëjt apo vetëm Allahu?

... pos Allahut nuk kenë as mbrojtës, as ndihmës tjetër. [2:107]

Në kundërthënie me:

Ai (njeriu) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e Allahut e ruajnë atë... [13:11]

Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, kudo të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkon... [41:31]

Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se çfarë pëshpërit ai në vetvete dhe jemi më afër tij se damari (që rreh) i qafës së tij. [50:16]

Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. [50:17]

Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm. [50:18]

Kurse ndaj jush kanë përcjellësit! [82:10]

Ajeti 2:107 përmban mbrojtjen e njeriut vetëm nga zoti, ndërsa në ajetet e tjera rezulton se paskësh edhe mbrojtës të tjerë. Në fakt, të gjitha së bashku janë broçkulla *alla*-Muhamed, por ajetet duhet të përballen mes tyre, për të përgënjeshtuar gënjeshtren e madhe, se *Kurani* është vepër e përkryer, pa kundërthënie e gabime.

Kundërthëniet për krijim të tokës dhe qiejve:

Krijimi për gjashtë ditë:

Vërtet Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin... [7:54]

Vërtet Zoti juaj është Allahu, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh e pastaj qëndroi mbi Arshin... [10:3]

Ai krijoi qiejt e tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh, e pastaj mbizotëroi Arshin. [25:59]

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

Është ai, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditëve, e Froni i Tij kishte qenë mbi ujë, që t'ju sprovovë, se cili prej jush është më vepër mirë. [11:7]

Skandaloze! Froni i Allahut, para se ai të krijonte qiejt dhe tokën, paskësh qenë mbi ujë, edhe pse paraprakisht, po sipas *Kuranit*, nuk duhet të kishte ekzistuar ujë. Në ajetin 41:11 thuhet se, para krijimit të tokës dhe të qiejve gjithçka ishte tymnajë. Muhamedane, jo shaka!

Mes ajetit 7:54 dhe atij 10:3 nuk ka kundërtënie, por përsëritje.

Krijimi për dy ditë:

Thuaj: „A ju jeni ata që nuk i besoni Atij, që e krijoi tokën për dy ditë dhe Atij i përshkruani shok, e Ai është Zoti i botëve! [41:9]

Dhe ai krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktoi atë që i nevojitej. Qiellin më të afërt ne e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i plotfuqishmit, të dijshtmit. [41:12]

Krijimi i shtatë qiejve:

Ai (Allahu) është ai, që për ju krijoi gjithçka që ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi shtatë qiej. [2:29]

Lartmadhëri të merituar i shprehin Atij shtatë qiejt e toka dhe çfarë ka në to... [17:44]

Thuaj: „Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh?” [23:86]

Dhe ata i krijoi shtatë qiej brenda dy ditësh dhe secilit qiell i caktoi atë që i nevojitej. Qiellin më të afërt Ne e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i plotfuqishmit, të dijshtmit. [41:12]

Është ai që krijoi shtatë qiej, palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontradiktë, ndaj drejto shikimin nëse sheh ndonjë çarje? [67:3]

Krijimi i shtatë palë qiejve:

Ne krijuam mbi ju shtatë palë (qiej) dhe nuk jemi të pakujdesshëm ndaj asaj që krijuam. [23:17]

Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej... [65:12]

A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej (në kate). [71:15]

Qielli tym:

Mandej e mësyu qiellin, e ai ishte tym, e atij dhe tokës i tha: „Qasuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!“ Ata të dy thanë: „Po, i qasemi me dëshirë!“ [41:11]

Kushdo që i lexoi me vëmendje këto ajete (ka edhe shumë të tjera të ngjashme), duhet të ketë vëzhguar se nuk përputhen mes tyre. Thuhet se Allahu e ka krijuar tokën për 2 ditë, pastaj për 6 ditë. Zoti ua mësyu pastaj qiejve, të cilët ishin tym dhe formoi 7 qiej. Sipas disa ajeteve të tjera, zoti formoi 7 palë qiej, palë mbi palë e kat mbi kat, sipër njerëzimit etj.

Spekulohet se të tilla ajete përmbajnë të vërteta shkencore, por lexuesi i vëmendshëm, paksa i arsimuar, sheh se përmbajtja e këtyre ajeteve dhe shkenca janë larg sa toka me „shtatë qiej” ose „shtatë palë qiej”.

Analizimi i formulimit gjuhësor të bind se as personazhi Allah nuk është autor, meqë ai, si i gjithëditur, nuk do të formulonte ajete me përmbajtje kaq kundërtënjëse e primitive. Pra, teksti i *Kuranit* është sajuar nga „analfabeti” Muhamed dhe bashkautorët, të cilët, përkrah dijes, duhet të kenë qenë mediokër, por të shkathët për t’u imponuar si sharlatanë...

Në ajetin 2:17 rezulton se për Allahun mjafton të thotë „Bëhu!” dhe „në atë moment bëhet”, ndërsa në ajetet e tjera, megjithatë, atij iu deshën gjashtë ditë që të krijonte tokën dhe qiejt (sipas ajeteve 7:54, 10:3, 11:7, 25:59). Në ajetin 41:9 flitet për krijimin e tokës për dy ditë, plus katër ditë për të vendosur kodra dhe për t’i krijuar kushtet për jetë. Kjo do të thotë se zoti është marrë gjashtë ditë me krijimin e tokës. „Mandej e mësyu qiellin (jo qiejt si në ajetet e mëparshme) dhe atij e tokës i tha: „Qasuni urdhrit tim, me dëshirë ose me dhunë“, edhe pse në ajetin pararendës (41:10) toka veç ishte krijuar. Pasi ka krijuar tokën për gjatë ditë (41:9-10), zotit iu deshën edhe dy ditë të tjera për

të krijuar shtatë qiej (41:12), që do të thotë gjithsej tetë ditë. Ndërkaq, në shumë ajete ishte thënë se qiejt dhe toka, ose toka dhe qiejt, ishin krijuar për gjashtë ditë. Një kakofoni *alla*-Muhamed!

Interesant është ajeti 41:11, kur Allahu i qenka drejtuar qiellit [vendnisja nga toka], „ai ishte tym”, ndërsa në ajetin 11:7 thuhet: „*Arshi (Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë*”.

Interesant edhe: „*Qiellin më të afërt (tokës), ne e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur*” [41:12]. Nga ky formulim rezulton se qiejt „janë krijuar“ si gjysmëkupa sferike: i pari, i stolisur me yje dekoruese dhe të gjitha kupat e tjera qiellore sipër njëra-tjetrës...

Këta shtatë qiej, disa demagogë myslimanë tani i arsyetojnë me shtresat atmosferike që mbështjellin tokën, por as ekzistojnë kate, shtresa dhe as shtresa e parë është qiell i stolisur me yje...

Broçkulla muhamedane, aspak shkencore!

Kundërthënie në qëndrime ndaj jehudinjeve dhe kristianëve:

Thuaj: „A doni të grindeni me ne për Allahun, e Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj dhe ne kemi veprat tona, e ju keni veprat tuaja...” [2:139]

Në kundërshtim me:

E jehudinjtë thanë: „Uzejri është djali i Allahut“, e të krishterët thanë: „Mesihu është djalë i Allahut“. Ato ishin thënie të tyre me gojët e tyre, që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. Allahu i vraftë, si largohen! [9:30]

O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshehin në gjokset tyre është edhe më e madhe. Ne, pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. [3:118]

Ja, ju jeni që i doni ata, e ata nuk ju duan juve. Madje, ju i besoni librat në tërësi, e kur ju takojnë thonë: „Ne kemi besuar!“ E kur veçohen, ata nga mllefi kundër jush kafshojnë majat e gishtërinjve. Thuaju: „Vdisni me atë mllef tuajin!“ Allahu e di shumë mirë se çka mbajnë (të fshehtat) zemrat e tyre. [3:119]

Ne e morëm zotimin edhe të atyre që thanë: „Ne jemi nesarë“ dhe ata e harruan një pjesë të asaj me të cilën ishin udhëzuar, andaj Ne kemi ndërsyer armiqësinë e

urrejtjen ndërmjet tyre deri në ditën e kiametit. E më vonë Allahu do t'i njoftojë ata me atë që bënë. [5:14]

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush miqësohet me ta, ai është prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata, të cilëve u është dhënë libri para jush, as edhe jobesimtarët, që me fenë tuaj tallen dhe luajnë. Kini frikë Allahun po qe se jeni besimtarë. [5:57]

A e dini për ata që kanë miqësuar një popull, që Allahu ka shprehur mallkim kundër tyre? Ata nuk janë as prej jush as prej atyre dhe me vetëdije betohen rrejshëm. [58:14]

O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull, që Allahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhme, ashtu si nuk kanë shpresë jobesimtarët prej të vdekurve në këtë botë ose në ringjallje. [60:13]

Nesarë (ajeti 5:14) janë emërtuar kristianët. Edhe kundër tyre, njësoj si kundër hebrejve, janë bërë akuza të njëjta, por të paargumentuara.

Në ajetin 2:139 flitet për zot dhe bashkekzistencë të përbashkët paqësore, ndërsa në ajetet e afishuara në vazhdim urdhërohet armiqësimi mes besimtarëve myslimanë dhe atyre jomyslimanë. Këta këshilla e urdhra nuk rezultojnë të jenë aspak profetikë, universalë, hyjnorë, paqësorë. Ata janë reflektim i mendësisë së autorit Muhamed, i cili, deri në vitin 622, ngjante si misionar paqeje, pastaj u tjetërsua në një harbut të dhunshëm, amoral...

Ajeti 9:30 i kategorizon edhe judenjtë dhe kristianët njësoj si paganët, që Muhamedi i quante „jobesimtarë”. Besimtarët judenj dhe kristianë i kanë pikërisht këto përcaktime, që Muhamedi i kategorizon si kriminale. Prandaj i papërmbajtur, jo si profet, por si rrugaç, ai ulëriti: „Allahu i vraftë!” E kjo thirrje përmban në vetvete një rrezik të kobshëm, sepse të gjithë muhamedanët e botës jo vetëm që nuk dyshojnë në vërtetësitë e thënieve dhe të mallkimeve të profetit të tyre, por ndihen të detyruar të vihen në shërbim për të jetësuar porositë e mallkimit e tij, si kjo në këtë ajet.

Sipas islamologëve, rreth 67% e ajeteve mekase dhe rreth 51% e atyre medinase u dedikohen „jobesimtarëve”, gjegjësisht jomyslimanëve. Ndërsa 20% e haditheve, të përmbledhura nga Bukhari, kanë si tematikë vlerësimet e përcaktimet për „jobesimtarë”.

Jo vetëm kaq. Në prag të vdekjes, Muhamedi duhet të ketë lënë porosi (amanet):

Raporton Saïdbin Xhubejr: Ibn Abas ka thënë: „... Në shtratin e vdekjes Profeti dha tre urdhra: „Dëboni jehudinjtë e kristianët nga Gadishulli Arabik, respektoni dhe jepuni dhurata delegacioneve të huaja, siç keni parë se si veproja unë“. E kam harruar urdhrin e tretë.³⁰⁸

Kundërthënie për (mos)përdorim të verës:

Po të të pyesin ty për verën dhe bixhozin, thuaj: „Që të dyja janë mëkat i madh, ka edhe dobi në të për njerëz, por dëmi i tyre është më i madh sesa dobia e tyre...” [2:219].

O besimtarë! Mos bëni namaz kur jeni të dehur, derisa të kthjelloheni e të dini se ç’flisni... [4:43].

Në vitin 625, gjatë betejës në Uhud, disa xhihadistë pinë shumë dhe, të bërë tapë, u nisën në betejë. Gjatë betejës ata u vranë. Në atë moment sajohet ajeti vijues:

O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës janë vepra të ndyra nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre, që të shpëtoni. [5:90]
Shembulli i xhenetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur, ka lumenj me ujë të mirë për të pirë, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pemësh, kanë edhe falje nga Zoti i tyre (a është i njëjtë) a si ai që është përgjithmonë në zjarr dhe u shuhet etja me ujë valë që ua copëton zorrët e tyre?” [47:15]

³⁰⁸ Sahih Al-Buhariu, 4:52:288.

Në fakt, në ajetin 8:219 nuk rezulton ndalesë e prerë e pirjes së verës, por flitet vetëm për një mëkat të madh për ata që pinë. Madje thuhet se ka edhe dobi prej pirjes së verës, duke e përmbyllur këtë zigzage me konstatimin, se dëmi është më i madh sesa dobia.

Derisa vlera e verës madhërohet, duke e bërë atë pije të çmuar të xhenetit, duke e vënë në rang me ujin, qumështin dhe mjaltin, gogoli i frikës, ferri, nuk është i logjikshëm, sepse nuk është e mundur që të vdekurit, që digjet përgjithmonë në zjarr, kur do të kërkojë t'i shuhet etja, do t'i ofrohet ujë i valuar që ia copëton zorrët, pos nëse kemi të bëjmë me zjarr që nuk djeg...

Kundërthënia në qëndrim preferues ndaj profetëve:

Këta janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët, prej tyre pati që Allahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë... [2:253]

E ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe nuk bënë kurrfarë dallimi në asnjë prej tyre... [4:152]

Në ajetin 2:35 flitet për klasifikim të profetëve, kurse në ajetin 4:152 nuk ka dallime ndërmjet tyre.

Pse Muhamedi kishte nevojë të themelonte fe të re, kur ai i madhëronte kaq shumë „profetët” pararendës (qoftë edhe në mënyrë të dallueshme)? Dhe ja absurditeti: kinse zoti paskësh dashur që popujt të mbyten mes tyre. Është tepër cinik e banditesk ky konstatim: „Sikur të dëshironte Allahu, ata nuk do të mbyteshin, por Allahu bën çfarë dëshiron”.

Kundërthënia për (mos)njohje të Torahës dhe Ungjillit:

Ai ta zbrit ty librin me argument, që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. [3:3]

Në kundërthënie me:

ISLAMI, religion agresiv (?!)

Është shkatërrim për ata, që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: „Ky është prej Allahut!“ E për të arritur me të një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë. [2:79]

Dy përcaktime kundërthënëse i irritojnë besimtarët në përzgjedhjen e tyre: cili ajet duhet të zbatohet, ajeti 3:3, që e vlerëson Tevratin dhe Ungjillin, apo ajeti 2:79, i cili i zhvlerëson Tevratin dhe Ungjillin si të falsifikuar?!

Pse kishte nevojë zoti të shpallte tre „libra“? Vetëm për t’i futur në sherr me njëri-tjetrin besimtarët e tyre përkatës?!

Myslimanët nuk kanë asnjë respekt për Testament të Vjetër dhe Ungjill, sepse janë një mori ajetesh që (dez)informojnë, se Tevrati dhe Ungjilli, që tani janë në përdorim, janë të falsifikuar. Çuditërisht, zoti nuk qenkësh përkujdesur që të mos falsifikoheshin dhe ndryshoheshin „librat“ pararendës, siç qenka përkujdesur për *Kuranin!*

Kundërthëniet për (mos)tolerancë fetare:

Tolerohen:

... Nëse e pranuan islamin, atëherë e kanë gjetur të vërtetën, e nëse refuzojnë, ti ke për obligim vetëm t’ua komunikosh; Allahu i di shumë mirë punët e robërve të tij. [3:20]

Ai ta zbrit ty librin me argument, që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. [3:3]

Ti (Muhamed) mos u keqëso për popullin që nuk beson. [5:68]

(Muhamed) Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në tokë, që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? [10:99]

Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu, Ne ia kemi zbukuar çdo popull veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan. [6:108]

Nuk tolerohen:

Feja e pranueshme tek Allahu është Islami, e atyre që u është dhënë libri, pasi mësuan për të vërtetën, vetëm nga zilia mes tyre e kundërshtuan. E kush mohon argumentet e Allahut, le ta dijë se Allahu shpejt do t'i japë llogarinë. [3:19]

E kush kërkon fe tjetër, përveç fesë islame, atij kurrësi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit. [3:85]

Luftoni ata, derisa të mos mbetet idhujtari, e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun. [8:39]

O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që i keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre... [9:123]

Alarmuese! Sipas ajetit 9:123 çdo jomysliman duhet të jetë vigjilent ndaj fqinjët të tij mysliman!

Po fetë pararendëse, për të cilat sa herë flitet lavdërueshëm në *Kuran*, si në ajetin 3:3?

Muhamedi, tashmë, është më konkret. Ai po sajon fenë e tij, sepse në suren e dytë afronte më shumë me Teveratin e Ungjillin. Personazhit të tij, Allahut muhamedan, Muhamedi i ngarkon qëndrimin sikur ai, tashmë, është përcaktuar vetëm për islamin, duke i diskualifikuar besimtarët e „librit” (hebrenjtë). Sigurisht, jomyslimanët do të ndëshkohen me „llogarinë” që do t'u japë Allahu, por në ajetin 3:20 hasim një qëndrim të rezervuar të Allahut ndaj jomyslimanëve. Kompetencë e Muhamedit mbetet vetëm komunikimi i „shpalljeve” për jomyslimanët.

Ky përkufizim i rolit të Muhamedit bie ndesh me shumë ajete, por, me këtë rast, po sjellim vetëm njërin prej tyre:

Luftoni ata, derisa të mos mbetet asnjë politeist, e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun... [8:39]

Tashmë po vetëkuptohej urdhri i prerë për konvertimin me dhunë në islam ose për zhdukjen e politeistëve! Përcaktim fashistoid!

Kundërthëniet për (mos)dallimin mes Muhamedit dhe Allahut:

S'ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: „Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë“ e mes këtij duam të marrin rrugë.” [4:150]

Të tillët lanë jobesimtarë të vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët“. [4:151]

E ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe nuk bënë kurrfarë dallimi mes tyre, të tillëve do t'u jepet shpërblim i merituar. Allahu falë shumë dhe është mëshirues. [4:152]

Ata që mohojnë argumentet e Allahut, mbysin profetët pa farë të drejte, mbysin edhe njerëz që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroji për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues. [3:21]

Besimtarët të mos i miqësojnë mosbesimtarët e t'i lënë anash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej së keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja. [3:28]

Tashmë është kohë për fillimin e ushtrimit të dhunës (viti 623). Kjo do të thotë se po fillonte sajimi i frymëzimit armiqësor kundër jomuslimanëve...

Kundërthënie për materialin krijues të njeriut:

Nga dheu:

Vërtet, çështja e Isait tek Allahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: „Bëhu“! Dhe ai u bë. [3:59]

Nga balta:

*Ne krijuam njeriun nga balta e argjilës së zezë e të prishur. [15:26]
Kur Zoti yt u tha engjëjve: „Unë po krijoj një njeri nga balta...“ [38:71]*

Nga uji:

Allahu krijoi secilën gjallesë nga uji. [24:45]

Nga gjaku i ngjizur:

Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. [96:2]

Me duart e mia:

(Zoti) tha: „O Iblis, ç’ të pengoi ty, që të mos bësh sexhde para atij që e kam krijuar Unë me duart e mia?... [38:75 / përkthim i Hasan Nahit]

O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët e t’i lini anash besimtarët! A doni t’i sillni Allahut argument të qartë kundër vetes! [4:144]

Pra, rezulton se Allahu e paskësh krijuar Ademin herë nga dheu, herë nga balta e zezë, herë nga gjaku, herë nga uji, herë vetëm me duar të tij. Shih tani çudinë perverse: zoti paskësh edhe duar, siç i kanë edhe skulptorët, kur skalitin statujë. Vetëm Muhamedi i merr vesh këto kundërthënie...

Kundërthëniet për Qabenë:

Shtëpia e parë e ndërtuar për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin. [3:96]

Kur Muhamedi e ka sajuar këtë ajet, mund të mos ketë ekzistuar ende emërtimi *xhami*, për foltore. Ai, prandaj, ka përdorur shprehjen „shtëpia” për foltore. Edhe Meka duket se quhej Beka (!)?

Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në të, ai është i sigurt. Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë është obligim për ata që ka mundësi udhëtimi, e kush nuk e beson; Allahu nuk është i nevojshëm për njerëzit. [3:97]

Interesant! Ku gjendet ky vend me emrin Baka (Beka)? Do të thotë nuk qenka Qabeja?! Ndonjë gabim tipografik ndoshta?

Kurse në ajetin 3:97 është konstatimi për të fuqizuar falsifikimin, se gjoja faltoren e parë në Mekë, Qabenë, e paskësh ndërtuar Ibrahim, i

me djalin e tij, Ismailin. Ndërsa thënia: „Allahu nuk është i nevojshëm për njerëzit”, është një marrëzi e radhës!

Kundërthënia për shifër 5'000 dhe 1'000 engjëj:

Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t'ju vijnë tash në këtë moment, Zoti juaj jua jep juve ndihmën me pesë mijë prej engjëjve të ushtruar (për luftë) ose të shënuar. [3:125]

Në kundërthënie me:

Kur ti u thoshe besimtarëve: „A nuk është mjaft për ju, që Zoti juaj t'ju vazhdojë ndihmën me tre mijë engjëjt e zbritur?” [3:124]

Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj e Ai ju është përgjigjur: „Unë do t'ju ndihmoj me një mijë engjëj që vijnë një pas një”. [8:9]

Nuk do të dinim se në ajetin 3:125 bëhet fjalë për armiq (meqë mungon në origjinal), nëse përkthyesi nuk do ta kishte bërë sqarimin në kllapa.

Muhamedit i janë ngatërruar shifrat e engjëjve, të angazhuar për ndihmë në betejën në Bedër. Vlen supozimi, se kur dikush gënjen, gjatë përsëritjes i ngatërrohet gënjeshtria.

Duhet pranuar se këto ajete ishin gjetje e mirë për të motivuar e trimëruar xhihadistët për beteja të reja, sepse ata ende ishin pak në numër. Tani e tutje ata duhej të besonin se do t'u vinin në ndihmë aq engjëjt, sa të kishin nevojë për të dalë fitimtarë, të dërguar nga Allahu.

Kundërthënia për jetë-vdekjet e profetëve:

Muhamedi nuk është tjetër, vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit. [3:144]

... madje, për shkak të thënies së tyre: „Ne e kemi mbytur mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut“. Po ata as nuk e mbytën, as nuk e gozhduan,

por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan me të janë në dilemë e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveçse fantazojnë. E ata me siguri nuk e mbytn atë. [4:157]

Nuk i shkon Allahut të spekulojë për jetë-vdekjen e Muhamedit, meqë (keq)kuptohet, sikur ai nuk di nëse do të vdesë ose do të mbytet dhe sa kohë do të rrojë Muhamedi. Edhe formulimet polemizuese, se nuk i bëkan dëme Allahut ata që do të deislamizohen, nuk janë aq fisnike. Gjithsesi, personazhi Allah nuk është autor i tekstit të *Kuranit*.

Spekulimet për moskryqëzim të Jezusit bien ndesh me përcaktimet kristiane. Kështu, ato zvogëlojnë mundësinë për dialog mes besimtarëve të religjioneve të ndryshme.

Kundërthëniet për shpërblim të dëshmorëve (shahitëve):

Kurrsesi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. [3:169]

Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij, dhe atyre që kanë mbetur ende pa u bashkuar radhëve të tyre, u marrin myzhde, se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen. [3:170]

Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha Allahu, e s'ka dyshim se Allahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve. [3:171]

Shpërblime tejet motivuese, edhe pse mashtruese. Për Muhamedin rëndësi kishte që t'i mashtronte xhihadistët për të qenë gjithmonë gati për sulme të radhës.

Gjatë viteve 623-632, Muhamedi organizoi e komandoi mbi 100 sulme plaçkitëse e luftarake, që i bie mesatarisht rreth dhjetë sulme në vit. Dhe kjo ndodhi falë shkathtësisë së tij për t'i frymëzuar e motivuar xhihadistët, sidomos me femra si plaçkë lufte.

Të tillët e kanë vendin në xhenetin e Adnit, nën të cilin rrjedhin lumenj; e aty stolisen me rrahë të artë dore dhe veshin rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë e të trashë e janë shtrirë aty në shtretër. Sa shpërblim i mrekullishëm është dhe sa vend i bukur është ai. [18:31]

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu i vendos në xhenet, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Aty stolisen ata me rrathë të artë e me xhevahire, e petkat e tyre janë të mëndafshita. [22:23]

Joshje tipike muhamedane: rrathë dore prej ari, rroba të gjelbra prej mëndafshi, të shtrirë në shtretër (me virgjëresha), siç kanë dëshiruar t'i kenë beduinët...

Kundërthëniet për kamata të huas:

O ju, të cilët besuat, mos e hani kamatën që po e shumëfishoni dhe kini frikë Allahun, që të gjeni shpëtim. [3:130]

Ajeti 3:130 ka përcaktim të përcartë, ndërsa në ajetin 2:275 është ndaluar kamata:

Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe, vetëm se si ngrihet ai i çmenduri nga të prekurit e djallit. (Bëjnë) kështu ngase thanë: „Edhe shitblerja nuk është tjetër, por njësoj sikurse edhe kamata?“! E Allahu e ka lejuar shitblerjen, por e ka ndaluar kamatën... [2:275]

Kundërthëniet për masat ndëshkuese ndaj kurvërisë:

Ato nga gratë tuaja që bëjnë imoralitet, kërkoni që kundër tyre të dëshmojnë katër veta prej jush (burra); nëse vërtetohet me dëshmitarë, mbyllni ato në shtëpi, derisa t'i marrë vdekja ose derisa Allahu të përcaktojë ndonjë rrugë për to. [4:15]

Merre me mend, katër burra duhet të dëshmojnë për imoralitet të një gruaje. Këtë numër të lartë të dëshmitarëve, Muhamedi e caktoi për rastin e aferës së Aishes, e cila qe përfolur për kurvëri, në janar të vitit 627, gjatë rrugëtimiti për në Medinë.

Por ajeti tjetër parasheh tjetër ndëshkim:

Laviren dhe lavirin t'i rrihni secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre të dyve, nëse

i besoni Allahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh. [24:2]

Kundërthënie për (mos)shpërblime nga Allahu:

Çfarëdo e mire që të vjen, është nga Allahu, ndërsa të këqijat nga vetvetja. Ne të dërguam ty, Profet, për mbarë botën... [4:79]

Në kundërthënie me:

... E nëse i qëllon ata ndonjë e mirë, thonë: „Kjo është nga Allahu“. E nëse i godet ndonjë e keqe thonë: „Kjo është nga ti (Muhamed)“. Thuaju: „Të gjitha janë nga Allahu!“ Ç’është me këtë popull, që nuk kupton gati asnjë send? [4:78]

Në ajetin 4:79 vetëm të mirat janë nga Allahu. Të këqijat jo. Ndërkaq, në ajetin 4:79, „të gjitha janë nga Allahu“. Në ajetin 4:79, Muhamedi e përcakton vetveten për profet të krejt botës. Fatkeqësisht pretendimi i tij u realizua goxha, sepse rreth 15 % e popullsisë botërore e adhurojnë Muhamedin për profet.

Thirtja habitore e Muhamedit, „ç’është me këtë popull që nuk kupton gati asgjë“, duhet të ketë qenë refleksion i dëshpërimit të radhës.

Kundërthëniet për fëmijët e Adamit/Ademit:

Lexoju atyre ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbane, nga të cilët njërit iu pranua. Ai tha: „Unë do të të mbys ty“. E ai tha: „Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve“. [5:27]

Këtë lloj formulimi as vetë autori Muhamed nuk mund ta marrë vesh. Megjithatë, propaganduesit e *Kuranit* dhe besimtarët thonë se gjuha e tij është gjuhë e qartë letrare e filozofike, edhe pse rezulton të jetë vetëm gjuhë, stil e përmbajtje e gjysmanalfabetëve...

Dhe, nëse ti e zgjat tek unë dorën tënde për të më mbytur, unë nuk e zgjas te ti

dorën time për të të mbytur; unë i frikësohem Allahut, Zotit të botëve! [5:28]

Ky ajet është vazhdim i rrëfimit të ajetit paraprak, i shkëputur e fare i panevojshëm. Rezulton të ketë përcaktim paqësor, edhe pse ngjarja ndodh mes dy vëllezërve (djem të Adomit). Që të kuptohet rrëfimi, gjoja djali i Adomit, Habili, duhet t'i ketë thënë vëllait të tij, Kabilit, këtë që përmban ajeti. Është interesant fakti, pse djemve të „Njeriut të parë”, në *Kuran*, nuk u përmenden emrat, edhe pse u dedikohen ajete. Duket se Muhamedi i kishte harruar rrëfimet e xhaxhait të Hatixhesë, i cili ka qenë misionar kristian.

Teksa jemi te fëmijët e Adomit, duhet thënë se ata kanë bërë seks mes tyre (incest), që të fillojë shtimi i njerëzimit. Ja një perversitet i feve abrahamike, kinse njerëzimi e ka zanafillën e vet në incest (marrëdhënie seksuale mes vëllezërve e motrave). Ata që kanë sajuar legjenda të këtilla, duhet të kenë qenë në shpirtin e tyre pisanjosë, amoralë...

Unë dua që ta bartësh mëkatin tim dhe mëkatin tënd, e të bëhesh nga banorët e zjarrit, e ai është dënimi i zullumqarëve. [5:29]

Atëherë epshi i tij e bindi atë për mbytjen e të vëllait dhe e mbyti atë. Ai mbeti prej më të dëshpëruarve. [5:30]

Ja si përfundon zënka mes vëllezërish, brezit të parë të njerëzimit (të vetëprodhuar, meqë Ademi e Havaja „ishin krijuar“ nga zoti). Këtë banalitet kanë mundur ta sajojnë vetëm priftërinjtë shpirtkatranë hebrenj dhe ta riprodhojë Muhamedi shpirtfashist.

Kundërthëniet për (mos)tolerancën islame:

Ne të frymëzuam ty me shpallje, sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe profetët pas tij; e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismajlin, Isakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin e Davudit i patëm dhënë Zeburin. [4:163]

Për këtë Ne u shpallëm bijve izraelitë se kush mbyti një njeri, pa mbytur ai ndonjë

*tjetër dhe pa bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall, është si t'i kishte ngjallur të gjithë njerëzit... [5:32]
O Pejgamber, thuaju atyre robërve që i keni në duart tuaja, se posa të vërejë Allahu ndonjë të mirë në zemrat tuaja, Ai ju jep edhe më shumë të mira nga ajo çka është marrë nga ju dhe jua fal gabimet... [8:70]*

Këtu rezulton se Muhamedi nuk po sajonte religjion të ri, unik, por një si sekt të religjioneve pararendëse, ngjashëm me fraksionet që krijohen brenda partive politike. Ai i pranoi të gjithë „profetët” e Tevratit, Zuburit dhe Ungjillit, por i refuzoi „librat” e tyre, me arsye-timin se na qenkëshin të falsifikuar. Ai asgjëkund nuk paraqet ndonjë provë konkrete, çfarë në fakt është falsifikuar në ata „libra”. Pra, si kanë qenë në variantin origjinal, „të zbritur” nga zoti, dhe çfarë është falsifikuar. Kontestimi më i madh ishte se Jezusi është djali i zotit, sipas atyre që e kanë sajuar *Biblën* dhe religjionin e krishterë, ndërsa Muhamedi e mohonte pohimin e tyre. Njëra palë sigurisht po gënjente. Për mendimit tim, të dyja palët vetëm kanë trilluar e sajuar dogma përkatëse.

Edhe ky është një ajet, të cilin e citojnë çdoherë propagandistët e islamit, si argumentim për islamin paqësor. Megjithatë, është një shabllonizëm koti dhe me të komprometohet edhe personazhi Allah. Sërish formulimi është i përcartë, prandaj rezulton të jetë nga gjysmanalfabeti Muhamed. Besimtarët besojnë se ai ishte analfabet, sa herë që duan të kundërshtojnë mendimin se Muhamedi ka kopjuar „librat” pararendës.

Por ky ajet, bie ndesh me ajetin:

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij (...) nuk është tjetër, vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Ky është poshtërim për ta në këtë Dynja, në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]

Kështu shumicës së idhujtarëve, idhujt ua hijeshuan mbytyjen e fëmijëve të vet, për t'i shkatërruar dhe për t'ua ngatërruar fenë. Po sikur të donte Allahu, ata nuk do ta bënin atë, ndaj ik nga ata që shpifin. [6:137]

Në Kuran, emërtimi *idhujtarë* përdoret për besimtarët politeistë, paganët. Sigurisht që ata kanë praktikuar marrëzi të ndryshme, deri edhe të sakrifikimi i fëmijëve për idhuj të tyre. Të njëjtën gjë pati vendosur të bënte edhe Abrahami, i cili kishte ëndërruar se duhet të sakrifikonte fëmijën për zotin e tij, që po e sajonte (nëse vërtet ka ekzistuar një Abraham i tillë). Por është absurd pohimi: „Po sikur të donte Allahu, ata nuk do ta bënin atë” (të vrisnin fëmijët), që i bie se Allahu mund ta shmangte, por ja, thjesht nuk paskësh dashur. Nuk duket pervers ky lloj komprometimi që Muhamedi i ka bërë personazhit të tij, Allahut mysliman?!

E ju përgatituni sa të keni mundësi, forcë e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre e me të ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini, e Allahu i di ata. Çfarë do që të shpenzoni për rrugën e Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet e padrejtë. [8:60]

Fragment i platformës luftarake të Muhamedit, formulim i përcartë.

Kundërthëniet ndaj Jezusit / Isait:

O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu, Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij që ia drejtoi Mejremes dhe ishte frymë nga Ai. Besojeni pra Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: „Tre“. Pushoni, se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë... [4:171] Mohuan të vërtetën ata që thanë: „Allah është ai, Mesihu, biri i Merjemes“. E vetë Mesihu, (Isai), tha: „O bij izraelitë, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar xhenetin dhe vendi i tij është zjarri“. Për mizorët nuk ka ndihmës. [5:72]

Muhamedi sajoi një variant të tij për Jezusin, të cilin kristianët e gjejnë si falsifikim të së vërtetës së tyre. Kjo prodhon armiqësi mes besimtarëve të këtyre dy besimeve. Njëri nga këta dy „profetë” duhet të ketë gënjer. Vetëkuptohet, besimtarët përkatës do të qëndrojnë pas

profetëve të tyre, edhe pse, sa për taktikë, Muhamedi e njej Jezusin për profet. Jezusi nuk duhet të ketë përdorur terminologji të arabëve paganë për zotin e tij.

Është ai që krijoi qiejt dhe tokën, e si do të ketë Ai fëmijë, kur nuk pati bashkëshorte? ... [6:101]

Ne vazhduam gjurmët e tyre me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishin më pranë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzimi i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin pranë, që ishte udhëzues e këshillues për të devotshmit. [5:46]

Skandaloze! Zoti, për të cilin është dezinformuar se ka krijuar Adamin dhe Evën, tani duhet të mbrohet nga përcaktimet kristiane me një konstrukt polemik: „Si do të ketë Ai fëmijë, kur nuk pati bashkëshorte?” Pra, zoti nuk mund të kishte fëmijë, sepse nuk kishte grua. Po me Marinë, si e „prodhoi” Jezusin. Pra, vetë Muhamedi ka harruar se ka dezinformuar për Marinë (Mejremen), e cila paskësh lindur Jezusin (Isain) me urdhër të Allahut...

Kundërthënie për qëndrimet ndaj jomuslimanëve

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Në kundërthënie me:

... Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: „Ne jemi nesarë-krishterë”. Këtë ngase prej tyre ka dijetarë dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë. [5:82]

Ajeti 5:51 është një apel për armiqësim mes besimtarëve. Kjo do të thotë se nuk ka të bëjë fare me hyjnoren. Por në ajetin 5:82 ky qëndrim zbutet paksa.

Kundërthënie spekulative ndaj (mos)tolerancës:

Ka prej tyre që ty të dëgjojnë. Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim, dhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa të vijnë te ti e të polemizojnë. Ata që mohuan thonë: Nuk është tjetër ky, vetëm se mit i hershëm. [6:25]

Çfarë duhet bërë me këta jobesimtarë, meqë vetë zoti qenkësh përkujdesur që të mos dëgjojnë e kuptojnë?! Pse atëherë janë sajuar ajete, që përdhunonin jobesimtarët të konvertohen në islam, nëse dëshironin të mos vriteshin?!

Ngjashëm mund të vlerësohet edhe përmbajtja e ajeteve:

Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë, sikur të ngjitej në qiell. Kështu, Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. [6:125]

Atë që Allahu e udhëzon, ai është në rrugë të drejtë, e atë që e humbë, është i dëshpëruar. [7:178]

E ata që i bënë të rreme faktet Tona janë shurdhmemecë të mbetur në errësira. Allahu e humb kë të dojë dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do. [6:39]

Nëse ti (Muhamed) përpiqesh për t'i vënë në rrugë të drejtë ata, (dije se) Allahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur, dhe për ata nuk ka ndihmëtar. [16:37]

A e ke parë ti (Muhamed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin, atë Allahu e ka humbur, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij, i ka vënë perde mbi të parit e tij. Më thuaj, pos Allahut, kush mund ta udhëzojë atë? A nuk merrni mësim? [45:23]

Krejt tjetër qëndrim, tepër të rreptë, përmbajnë ajetet vijuese:

E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën veten e tyre; atë që e shpalli Allahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se Allahu nga mirësia e Tij t'i shpallë atij që dëshiron nga robërit e vet. Ndaj merituan zemërim mbi zemërim (gazep mbi gazep). Mosbesimtarët kanë dënim që i poshtëron. [2:90]

Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi ato ua sqaruar njerëzve të librit, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. [2:159]

S'ka dyshim se ata që nuk besuan do të thirren (do t'u thuhet): „Hidhërimi i Allahut pse u ftuat të besoni e ju nuk besuat (në Dynja), është më i madh se urretja juaj ndaj vetes. [40:10]

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është njëri prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Kundërthënie për tekat e Allahut:

Allahu humb kë të dojë dhe vë në rrugë të drejtë atë që do. [6:39]

nëse do Ai, ju heq atë për çka i luteni... [6:41]

Ne ngritëm në shkallë të lartë atë që duam... [6:83]

Zoti, siç e përfytyrojnë e besojnë besimtarët, do të duhej të dënonte a të shpëtonte në bazë të një drejtësie të përcaktuar, të barabartë për secilin. Pra, jo në bazë të vullnetit dhe tekave të tij. Kjo, në fakt, është mendësia e Muhamedit të shpërfytyruar, i cili ka sunduar sipas këtyre tekave të tij.

Ne atij (Ibrahimit) i falëm Isakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuar. Më parë patëm udhëzuar edhe Nuhun. E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuar Davudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë bamirësit. [6:84]

Edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këta i veçuar mbi njerëzit e tjerë. [6:86]

Edhe disa nga prindërit, nga pasardhësit dhe nga vëllezërit e tyre i zgjedhëm (për profetë) dhe i udhëzuar në rrugë të vërtetë. [6:87]

Ky është udhëzimi i Allahut. Udhëzon me të kë të dojë nga robërit e Tij. E sikur t'i përkrahujnë shok Zotit, kishte për t'iu shkuar huq ajo që kanë vepruar. [6:88]

Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruar në eshtra, dhe eshtrave u veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, më i miri Krijues! [23:14]

Në ajetin 6:83 thuhet sikur zoti i paskësh dhënë argumente Ibrahimit, jo për të ndërgjegjësuar popullin e tij, por kundër popullit. Ndoshta, në vend të argumenteve, është dashur t'i jepte udhëzime,

meqë ai duhet të ketë qenë, sipas trilleve abrahamike, profeti i parë që e ka proklamuar ekzistencën e një zoti të vetëm.

Edhe fjalia pasuese mund të pranohet se ka për autorësi Allahun, por fjalia tjetër përjashton mundësinë që zoti të jetë autor i këtij formulimi. Pra, brenda një ajeti ngatërrohen vetat e foljes.

Nuk është fare hyjnore të thuhet: „*Ne ngritëm në shkallë të lartë atë që duam*”. Kjo shpjegon mendësinë e Muhamedit, autorin e këtij ajeti. E drejtë do të ishte të ngrihet ai që e meriton, jo ai që duam.

Në ajetet pasuese numërohen profetët e radhës, duke vazhduar me bijtë e Abrahamit, Isakun e Jakobin (Jakubin). Por përmendet edhe Noa (Nuhu) si profet, si pararendës i Abrahamit, për të cilin, në ajete të tjera, rrëfëhet se zoti i besoi shpëtimin e njerëzimit dhe të gjallesave të tjera, kur ndodhi „përmbytja e madhe” (botërore) që, në realitet, duhet të ketë ndodhur vetëm në krahinat rreth lumit Euftrat.

Është interesant që, ky farë zoti, i këtyre farë profetëve, nuk u kujtua të përzgjidhte ndonjë profet nga popujt e tjerë, pra jo vetëm nga familja e popujve semitë.

Do të ishte me interes një studim serioz për këto trille: pse profetët janë sajuar vetëm nga semitët dhe si ia arritën ata që trillet e tyre t’ia imponojnë gati gjysmës së njerëzimit botëror?!

Kundërthënie për (mos)ndryshimin e *Kuranit*:

Kurani nuk mund të ndryshohet:

... s’ka kush që ndryshon fjalët e Allahut. [6:34]

Fjalët e Zotit tënd janë plot të vërteta dhe plot të drejta. S’ka kush të ndryshojë fjalët e Tij. Ai është që dëgjon e di. [6:115]

E, kur t’ju lexohen ajetet tona, të qarta, atëherë thonë ata, që nuk shpresojnë se do të dalin para Nesh: “Na sjell ti ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!” Thuaj (o Muhamed): „Është e pamundur ta ndërroj unë atë - nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë i druham, nëse e kundërshtoj Zotin tim, dënimit të Ditës së Madhe”. [10:15]

... Premtimet e Allahut nuk mund të pësojnë ndryshim... [10:64]

Kurani ndryshohet:

Ne nuk abrogojmë asnjë nga argumentet tona apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send? [2:106]

Allahu shlyen çka të dojë dhe e forcon. Vetëm tek Ai është baza e librit. [13:39]

Kur një ajet e zëvendësojmë me një tjetër - e Allahu di më së miri se çka shpall - ata thonë: „Ti je vetëm trillues”. Jo, por shumica e tyre nuk dinë. [16:101]

Në ajetin 6:115, me foddullëk thuhet se fjalët e zotit nuk ka kush t'i ndryshojë, ndërsa në ajetet e tjera [2:106 dhe 16:101] thuhet se, megjithatë, „libra” dhe ajete të ndryshme janë falsifikuar, shfuqizuar dhe zëvendësuar.

Sërish Muhamedi, ose ndonjëri nga bashkautorët e *Kuranit*, nuk ka qenë në gjendje t'i bëjë të pajtueshme përmbajtjet e ajetit 2:79 me ajetet 6:34 dhe 6:115. Në të parin thuhet se librin e shpallur nga Allahu e paskëshin ndryshuar ata që kanë shkruar „librin” (Tevratin dhe Ungjijtë), kurse në ajetet pasuese thuhet se nuk mund t'i ndryshojë askush fjalët e Allahut. Propaganduesit e myslimanizmit nuk lodhen duke e stërpërsëritur, deri në monotoni, se askush nuk ka mundur ta ndryshojë *Kuranin*, meqë atë e mbron vetë Allahu.

Por, atëherë, pse zoti nuk i paskësh mbrojtur edhe Tevratin, edhe Ungjillin?!

Kundërthëniet për (mos)martesa:

Mos u martoni me paganet, derisa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse ju pëlqen juve. Mos i martoni myslimanet për me paganë, përderisa nuk bëhen besimtarë; skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ju pëlqen juve. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Perëndia, me mirësinë e Tij, ju thërret në xhenet e falje dhe ua shpjegon njerëzve argumentet e Veta, që ata të mendojnë. [2:221]

O besimtarë, kur ju vijnë juve besimtarët emigrante, provoni tek ato, e Perëndia më së miri e di besimin e tyre. Nëse bindeni se ato janë besimtare, mos i ktheni te

ISLAMI, religion agresiv (?!)

jobesimtarët: Ato nuk u lejohen atyre, si dhe as ata nuk janë të lejueshëm për to. Jepni shpenzimet e bëra atyre. Nuk ka pengesë që t'i merrni ju ato për bashkëshorte, pasi t'u jepini dhurata martesë. Mos qëndroni në martesë me pagane. Kërkonit atë që keni dhënë, por dhe ato le të kërkojnë atë që kanë dhënë... [60:10]

Kundërthënie për (mos)dënim kolektiv:

Kur Ne duam ta shkatërrojmë një qytet, i nxitim ata që janë mësuar me jetë luksoze, që të jepen pas korrupsionit, e kështu të meritojnë dënimin, dhe pastaj t'i shkatërrojmë ata gjer në themel. [17:16]

Në kundërthënie me:

Kjo është, ngase Zoti yt nuk e shkatërroi asnjë vend, për shkak të zullumit të tyre pa paralajmërimin e banorëve të tyre. [6:131]

Në asnjërin rast kjo përmbajtje nuk i ka hije një zoti, siç e besojnë qindra milionë njerëz besimtarë, se zoti i tyre është vetëm i mirësjellshëm, paqësor, i drejtë, por edhe i ashpër kundër keqbërësve...

Kundërthënie për (mos)lejim të ngrënies së ushqimit:

Ju hani nga ajo që është përmendur emri i Allahut, po qe se jeni të bindur në faktet e Tij. [6:118]

Dhe mos hani nga ajo që nuk është përmendur emri i Allahut, vërtet ajo është mëkat. Djallëzitetë i nxitin miqtë e vet që t'ju polemizojnë juve, e nëse i dëgjoni ata, atëherë jeni si ata. [6:121]

Kush mund të kuptojë çfarë ka dashur të thoshte Muhamedi në këto ajete? Pra, mbetet që besimtarët të dëgjojnë interpretuesit spekulantë, të cilët *Kuranin* e interpretojnë ndryshe-ndryshe dhe asnjëri nuk e pranon interpretimin e tjetrit. Pastaj, secili interpretues, si pjesëtar i ndonjërit nga 73 sektet, interpretimin e bën nga këndvështrimi i sektit

të tij. Ndoshta këtu bëhet fjalë për ngrënie të mishit të kafshëve, me kushtin që të hahet vetëm mishi i kafshës së therur në emër të zotit.

Kundërthënie ndaj Moisiut (Musait):

*Ti nuk hakmerresh ndaj nesh vetëm pse besuam në argumentet e Zotit tonë, pasi që na erdhën ato. Zoti ynë, na dhuro durim dhe na bëj të vdesim myslimanë!
[7:126]*

Ja edhe përfaqësuesit e izraelitëve i paskëshin thënë faraonit, se dëshirojnë të vdesin si myslimanë. Kjo do të thotë se myslimanizmi qenkësh zbuluar para Muhamedit, apo kjo është lajthitja e tij e radhës?!

Për çfarë qëllimi duhet t'i ketë sajuar këto (dez)informata lidhur me të qenit mysliman të të gjithë profetëve, qysh nga Adami, deri tek ai, kur vetë Muhamedi kishte thënë se ai vetë ishte myslimani i parë?!

Mbase për të sajuar një vijimësi islami, qysh kur zoti paskësh krijuar „njeriun e parë”.

Musai tha: „Mos deshët, pos Allahut, të kërkuj për ju Zot tjetër, kurse Ai ju vlerësoi mbi njerëzit e tjerë?” [7:140]

Asgjëkund në „librat” të tjerë nuk është thënë e shkruar, se Moisiu paskësh përmendur Allahun. Ky emërtim arab për zotin është gjetje e Muhamedit, duke e modifikuar kryezotin e hënës, të cilin e adhuronin arabët paganë.

Populli i Musait, pas largimit të tij, mbaroi nga stolitë e tyre një skulpturë viçi që kishte britmë (pallte). A nuk e shihnin ata se ai nuk iu fliste as nuk i udhëzonte në ndonjë rrugë të drejtë?! E morën atë, e ishin të padrejtë ndaj vetes së tyre. [7:148]

Broçkulla muhamedane! Formulim tipik alla-Muhamed. Absurde: viçi, skulpturë prej ari, pëlliste. Kundërthënia në fjalinë pasuese: viçi nuk fliste dhe nuk udhëzonte...

ISLAMI, religion agresiv (?!)

E kur u kthye Musai te populli i vet, shumë i hidhëruar tha: „Sa keq më paskeni zëvendësuar pas shkuarjes sime! A e ngutët urdhrin e Zotit tuaj?“ I hodhi pllakat dhe e zuri për koke vëllanë e vet duke e tërhequr kah vetja. Ai (vëllai Haruni) tha: „O bir i nënës sime, populli më mundi dhe gati më mbyti, mos më konsidero mua me njerëzit mizorë“. [7:150]

Në „librat“ pararendës abrahamikë, kjo ngjarje nuk figuron. Ka gënjyer Muhamedi (ose ndonjë ish-misionar hebraik, i konvertuar në islam)?! Por, për çfarë qëllimi është dashur të zërë vend në *Kuran* një trill i tij e kujt i hynte në punë ai trill?! Mbase ndonjëri nga sajuesit kishte ves të sajonte broçkulla të kota?

Ne edhe Musait i patëm dhënë librin (Torah-Jalalyn), e bashkuam me vëllanë e vet, Harunin, që ta ketë si ndihmës. [25:35]

Në kundërthënie me:

*Nga mëshira Jonë ia dhamë vëllanë e tij, Harunin, peygamber. [19:53]
Do të më shtrëngohet kraharori (shpirti) im dhe nuk do të më lëshohet gjuha ime, ndaj dërgoje Harunin. [26:13]*

Kundërthëniet për (mos)ndëshkim për adhurim të viçit:

Nuk ka dyshim se ata që adhuruan viçin ka për t'i përfshirë përbuzja nga Zoti i tyre dhe nënçmimi në jetën e dynjasë. Kështu i shpërblejmë (me dënim) trilluesit e rrenës. [7:152]

Në kundërthënie me:

Mandej edhe pas asaj (adhurimit të viçit) ua falëm, ashtu që të falënderoni. [2:52]

Muhamedit nuk i shkonte ndër mend, se më bukuri kishte adhurimi i skulpturës së viçit, i shkrirë në ar, sesa guri i zi në Qabe, i cili adhurohet nga myslimanët sipas rritit pagan!

Kush dhe pse shpërblehet? Mbase ai ka dashur të thoshte se do të dënohen adhuruesit e skulpturës së viçit, por nuk ka zotëruar kulturë të nevojshme gjuhësore për të formuluar qartë dhe konkretisht mendimin e tij. Muhamedi ka sajuar Allahun, sipas mendësisë së tij të inkriminuar, që preferon dënimet dhe jo përkujdesjet për të sqaruar njerëzit që të mos bëjnë gabime.

Kundërthënie ndaj konvertimit me dhunë:

E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni politeistët kudo që t'i gjeni, robërojini dhe ngujojini ata; zëruni prita në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatën, atëherë lëshojuni rrugën, se vërtet Allahu është mëshirues. [9:5]

Në kundërthënie me:

Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? [10:99]
Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë (ndryshe), pos me ndihmën e Allahut. E dënimin u jep atyre që nuk mendojnë. [10:100]
Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte të gjithë njerëzit të një feje... [11: 118]

Skandaloze! Sipas ajetit 9:5 jobesimtarët duhet të vriten, pos nëse pranojnë të konvertohen në islam. Tani thuhet „sikur të kishte dashur zoti, do t'i besonin të gjithë”. Dhe në ajetin pasues: „Nuk është e mundur të besojë asnjë njeri, pos me ndihmën e Zotit”.

Cili Muhamed të zbatohet, ai i ajetit 9:5 apo ai i ajeteve 10:99-100 dhe 11:118?!

Përmbajtja e ajetit 10:99 nxit dilemën: kush mund të jetë autori? Allahu nuk është assesit, por rezulton të mos jetë as Muhamedi, pasi ai nuk do të shtronte pyetje cinike: „A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”

Po të ishte „Zoti”, siç e kanë sajuar „profetët” abrahamikë, vërtet ai do të ishte në gjendje ta programonte njeriun sipas përcaktimeve që

do të zgjidhte, ashtu siç ka qenë në gjendje të „krijojë” Adamin. Nga kjo rrjedh se vetë, i njëjti zot, nuk do të duhej t'i ndëshkonte jobesimtarët ose besimtarët e besimeve të ndryshme me fetë abrahamike, meqë ai vetë i „ka krijuar“ të tillë. Rrjedhimisht, as „të dërguarit e Zotit” dhe besimtarët e tyre nuk do të duhej të vrisnin jobesimtarët dhe besimtarët që besojnë ndryshe prej tyre.

Përcaktim tepër fashist ndaj politeistëve. Muhamedi me xhihadistët e tij ishin një pakicë e kriminalizuar. Ata i jepnin të drejtën vetes të vrisnin shumicën e banorëve që ishin politeistë, nëse nuk pranonin të konvertoheshin në islam, ose të paktën të paguanin haraç. Vetëm ata që nuk kanë informacion për këtë ajet dhe besimtarët trutredhur myslimanë mund të mashtrjnë veten dhe të tjerët, se islami është fe paqësore. Duhet të mjaftojë vetëm ky ajet, për ta diskredituar e denoncuar islamin, si doktrinë fashiste, ashtu dhe sajuesin e tij, Muhamedin. Vetëm ata që nuk kanë aspak kulturë e mendësi njerëzore e demokratike mund të arsyetojnë se një person, në rastin konkret Muhamedi, që sajoi një fe të re, bashkë me disa të mashtruar prej tij (xhihadistët), kanë të drejtë t'i përdhunojnë bashkëqytetarët, në rastin konkret shumicën e popullsisë beduine, që të konvertohet në fe, doktrina e së cilës ende nuk ishte qartë.

O ju që besuat, vërtet idhujtarët janë të ndyrë, ndaj pas këtij viti të mos i afrohen më xhamisë së shenjtë... [9:28]

Edhe ky përcaktim i Muhamedit është tamam fashist. Idhujtarë quhen besimtarët politeistë, e që në atë kohë ishte pothuajse e tërë popullsia, me përjashtim të disa fiseve, që jetonin kryesisht në Medinë e rrethina të saj, që i përkisnin besimit hebre. Tashmë Muhamedi ua kishte uzurpuar Qabënë politeistëve, të cilën e menaxhonin xhaxhallarët politeistë të tij.

Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë... [9:29]

Sërish urdhëresë tepër e qartë, e prerë, gjithsesi fashiste! Dhe meqë askush nuk ka të drejtë t'i korrigjojë këto ajete, që janë me qindra, atëherë mbetet që feja islame, e cila është e detyruar të respektojë doktrinën kuranore, me këto ajete me përcaktime fashiste, derisa të zhduket do të mbetet fashiste. Është demagogji mashtruese e mjerane, nëse ndonjë besimtar thotë se u përmbahet vetëm ajeteve me përcaktime paqësore, dhe jo edhe këtyre me përcaktime fashiste. Madje, nga përvoja e debatit në rrjetet sociale, secili besimtar fundamentalist i arsyetonte edhe këto përcaktime, ta zëmë, si vetëmbrojtje e domosdoshme e myslimanëve. Kjo drejtësi nuk ka pasur bazë, sepse Muhamedi po sajonte një fe të re dhe atë po ia impononte me dhunë popullsisë politeiste.

O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudinje dhe e të krishterëve në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e Allahut, lajmëroji për një dënim të dhembshëm. [9:34]

Përcaktim tepër militant, pothuajse komunist, lidhur me konceptin ndaj të pasurve. Muhamedi tani urdhëron besimtarët që të spiunojnë besimtarët hebrenj dhe kristianë, nëse kanë grumbulluar thesare në ar dhe argjend. Ky përcaktim ishte arsyetim dhe legalizim i sulmeve plaçkiste të kryebanditit Muhamed, i cili komandonte, ndërsa banditët e tij xhihadistë i ekzekutonin.

Atë ditë kur ajo (pasuri e grumbulluar) shkrihet në prushin e xhehenemit, me të do të lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t'u thuhet): „Kjo është ajo që e grumbulluat për veten tuaj, pra shijoni tani atë! [9:35]

Ndërsa ky ajet përmban shantazhin frikësues, për të vërtetuar se grumbullimi i pasurisë është krim, i cili do të ndëshkohet në ferr.

O ju që besuat, ç'është me ju, që kur ju thuhet: „Luftoni në rrugën e Allahut!“, ju

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

u rënduat në vend. A mos ishit më të kënaqur me jetën e kësaj bote, sesa me atë të ardhmen? Përjetimi i jetës së kësaj bote ndaj asaj të ardhmes, nuk është asgjë. [9:38]

Nëse nuk dilni (në luftë), Ai do t'ju dënojë me një dënim të rëndë, ju zëvendëson me një popull tjetër dhe Atij nuk i bëhet fare dëm. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë. [9:39]

Edhe këto ajete rezultojnë tepër luftarake, për t'u bërë presion besimtarëve, që të kenë shpirt e gatishmëri sa më luftarake, duke kërcënuar dezertorët me dënime të rënda. Pra, këto janë argumente më shumë, se kjo fe bazohet në një doktrinë tejet agresive.

Në mos e ndihmofshi atë (Pejgamberin), atë e ka ndihmuar Allahu; kur ata që nuk besuan, e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: „Mos u pikëllo (friko), Allahu është me ne!“ E Allahu zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ulëtën, kurse fjala e Allahut (është) më e larta. Allahu është më i fuqishmi, më i urti. [9:40]

Këtu flitet për momentin kur Muhamedi dhe Ebu Bekri u fshehën në një shpellë, në një mal buzë Mekës, meqë xhaxhallarët e Muhamedit kishin marrë vendimi për ta vrarë atë për agresionin ndaj Qabesë dhe për thyerjet e rekuizitave të kultit pagan. Kjo ngjarje ndodhi në shtator të vitit 622. Pra, Muhamedi dhe Ebu Bekri ishin të fshehur në shpellë, kur në një moment dëgjohen kushërinjtë e Muhamedit, para hyrjes së shpellës. Ebu Bekri frikësohet se do t'i vrisnin, por Muhamedi e qetëson (më gjerësisht në kapitullin për biografinë e Muhamedit, shpjegova rastin për të (zh)vlerësuar formulimin e ngatërruar gjuhësor për atë rast).

Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni. [9:41]

Ata që besojnë Allahun dhe botën tjetër, nuk të kërkojnë leje për të luftuar me pasurinë dhe veten e tyre. Allahu i di të sinqertit. [9:44]

Vetëm ata që nuk besojnë Allahun dhe botën tjetër dhe që zemrat e tyre janë të dyshimta, të kërkojnë leje për luftime, pra ata, sillen vërdallë në dyshimin e tyre. [9:45]

Nuk do koment: Muhamedi tashmë kishte krijuar mendësi agresive dhe luftarake. Këta urdhra e përcaktime luftarake Muhamedi duhet t'i ketë sajuar në vitin 624, kur filloi sulmet gjysmëguerile, fillimisht duke sulmuar karvanët që lëvizni mes Mekës dhe Sirisë. Në këtë frymë janë edhe një mori ajetesh pasuese.

Vetëm mashtruesit dhe besimtarët injorantë mund t'i cilësojnë këto ajete paqësore...

Allahu bleu prej besimtarëve jetët dhe pasurinë e tyre me xhenet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Ungjill e Kuran. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzojuni tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukseksi i madh. [9:111]

Skandaloze! Muhamedi shfaqet edhe si mashtrues matrapaz. Tashmë edhe Tevrat dhe Ungjilli, njësoj si *Kurani*, thirren në ndihmë për të nxitur besimtarët për luftime „në rrugë të Allahut”, që do të thotë: imponim të islamit me dhunë luftarake. Gjithë këto ajete luftarake janë udhëzuese dhe detyruese të xhihadistëve, që po bënin krime monstruoze kundër jomyslimanëve sunitë.

O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre. E dijeni se Allahu është me të devotshmit. [9:123]

Alarmuese! Çdo jomysliman duhet të jetë vigjilent ndaj fqinjit mysliman, i cili urdhërohet për të luftuar fqinjin që i përket fesë joislame.

Kundërthënie për tekat spekulative të Allahut:

Allahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre. [10:44]

Kjo ngjan me një proverb njerëzor dhe nuk i shkon „Zotit”, por as profetit. Mund të vlerësohet edhe si zhargon dhe si stil që përdoret nga polemizuesit. Çështja është: pse Allahu i lejuara njerëzit t’i bëjnë padrejtësi vetes së tyre, pse nuk i ndërjegjëson ata për drejtësi? Ky formulim dëshmon se Allahu muhamedan nuk është autor i tij.

Nëse ti e heton tradhtinë e një populli, atëherë edhe ti hidhura atyre në mënyrë të njëjtë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhtojnë. [8:58]

Nuk është aspak hyjnor ky përcaktim i Muhamedit, i cili i ka ngarkuar vetvetes monopolin e së drejtës për të vlerësuar tradhtinë e një populli (është fjala për fiset arabe, që i përkisnin besimit hebre) dhe të drejtën për revanshizmin.

Po të të pyesin ty (Muhamed) për plaçkën (e fituar në luftë), thuaju: „Plaçka, (mënyra e ndarjes) është çështje e Allahut dhe e Të Dërguarit... [8:1]

Ja filozofia pseudohyjnore e *Kuranit*: rregulli përcaktues për ndarje të plaçkës së luftës. Kryebanditi Muhamed, të drejtën për mënyrën e ndarjes së plaçkës e rezervon krejtësisht për veten (sepse Allahu është vetëm një personazh gogol, që ai e ka sajuar për t’i siguruar vetes sundimin absolut e banditesk)!

Ky religjion, në fakt, vetëm paqësor nuk është!

... Ai (Zoti) tha: „Dënimi im është ai me të cilin godas cilin dua... [7:156]

Sërish mendësi muhamedane, për të mos goditur, ta zëmë, atë që bën gabime, faje e krime, por atë që do, ashtu siç t’i teket.

Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në tokë, që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? [10:99]

Cinizëm skandaloz! Pra, vetë zoti nuk paskësh dashur që të bëhen myslimanë të gjithë njerëzit, prandaj udhëzoi Muhamedin që të mos këmbëngulte për t'i islamizuar të gjithë. Megjithatë, Muhamedi jo vetëm që është përcaktuar për islamizim të përgjithshëm, por ka komanduar rreth 100 sulme e beteja gjatë viteve 623-632, për të përdhunuar jomyslimanët e për t'i detyruar që të konvertohen në islam.

Bazuar në stilin e tij, rezulton se ky ajet duhet të jetë formuluar nga ndonjëri prej bashkautorëve të *Kuranit* ose nga komisioni i kalifit Utman, i caktuar „për të redaktuar“ *Kuranin* (në vitin 651), 19 vjet pas vdekjes së Muhamedit.

Bazuar në formulimin gjuhësor të tij, as personazhi Allah nuk është autor i këtij ajeti.

Duke marrë parasysh qindra ajete agresive, për konvertim të detyrueshëm, ky ajet rezulton të jetë përvjedhur. Autorët e tij nuk duhet të kenë qenë të vetëdijshëm se ky ajet kundërshton ajetet që përmbajnë përcaktimet rigoroze për islamizimin e të gjithë njerëzimit.

Nuk kam hasur deri tani, që islamistët fashistoidë (vehabistët, selafistët, lesh-muhamedanët...) ta kenë propaganduar në rrjetet sociale këtë ajet liberal.

Po të kishim dëshiruar, Ne do ta shlyenim nga gjoksi yt atë që ta shpallëm ty, e ti nuk do të gjeje mbrojtës që do të ruante. [17:86]

Qesharake! Çfarë kishte për ta fshirë në gjoks të Muhamedit? Muhamedi duhet të ketë menduar se ato që po i sajonte, po i arkivonte në zemër (gjoks) dhe jo në tru (kokë). Zoti qenkësh komanduar nga dëshira e tij dhe jo nga arsyeja, që t'i shlyente.

Kundërthënie ndaj Jozefit/Jusufit:

Kur Jusufi, babait të vet i tha: „O babai im, unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje dhe diellin e hënën, i pashë duke më bërë mua sexhde!” [12:4]

Ai (Jakubi) tha: „O biri im, mos ua trego ëndërrën tënde vëllezërve tu, se po të

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

bëjnë ndonjë dredhi, s'ka dyshim, djalli për njeriun është armik i hapur". [12:5] Ja, kështu Zoti yt të zgjedh ty, ta mëson interpretimin e ëndrrave, plotëson dhuntinë e Tij ndaj teje dhe familjes së Jakubit, sikurse e pat plotësuar atë më parë ndaj prindërve tu, Ibrahimit dhe Isakut. Vërtet, Zoti yt është më i dijshti, më i urti! [12:6]

Legjendë biblike e rrëfyer me mendësi muhamedane. Jozefi, - ([hebr.](#) יוסף *yōsēf*, i arabizuar në Jusuf يوسف), djali i Jakobit (Jakubit), „profet“ gjithashtu, si të gjithë „profetët“e tjerë semitë, është një personalitet me rëndësi në religjionet abrahamike. *Kurani* ka emërtuar suren (kaptinë) 12 me emrin e tij.

Rrëfimi biblik dhe ai kuranik dallojnë shumë mes tyre. Kjo vërteton se ato nuk i ka rrëfyer i njëjti „Zot“, ashtu siç thuhet se të gjithë „librat“ abrahamikë.

Vetëm Muhamedi mund ta marrë vesh, pse i është dhënë gjithë kjo hapësirë e rëndësi një legjende pseudohistorike izraelite, kur vetë Muhamedi i urrente aq shumë hebrenjtë?! Me gjasë, kjo përrallë duhet të jetë rrëfyer nga një bashkautor, misionar kristian, siç ishte Varaka, xhaxhai i Hatixhesë (bashkëshortes së parë të Muhamedit), ose Bahira, murg nestorian. Pastaj është përfshirë nga komisioni i kalifit Utman (651) në *Kuran*, duke mos ditur të seleksiononin rëndësinë e „shpalljeve“, sepse i kanë besuar mashtrimin të Muhamedit, se të gjitha „librat“ i „kanë zbritur“...

Dhe atypari kaloi një grup udhëtarësh, e dërguan ujëbartësin (për ujë), e ai e lëshoi kovën e vet (në bunar) dhe tha: „Myzhde! Qe një djalosh!“ Ata e fshehën atë si mall tregtie. Po Allahu e dinte shumë mirë se ç'vëpronin ata. [12:19]

Në kundërthënie me:

Dhe e shitën atë (Jusufin) për një çmim të vogël, për disa derhemë (masë argjendi) të numëruar, sepse në mesin e tyre pati asish që nuk lakmuan (për çmim më të lartë). [12:20]

Në tregimet e tyre (të dërguarve dhe të Jusufit me vëllezër) pati mësimë e përvojë për të zotët e mendjes. Ai (Kurani) nuk është bisedë e trilluar, por vërtetues i asaj

që ishte më parë (librave të shenjtë) dhe sqarues i çdo sendi, e edhe udhërrëfyes e mëshirë për një popull që beson. [12:111]

Në kundërthënie me:

Dhe (ta shpallëm) Kurandin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një. [17:106]

E ata që nuk besuan thanë: „Pse të mos i ketë zbritur atij (Muhamedit) Kurani përnjëherë?” Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë), që me të ta forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajeti (dalëngadalë). [25:32]

Kundërthënie për „profetët”:

Çdo popull pati profetët e tij. [13:7]

Vërtet, cilët janë profetët e popujve të tjerë, siç spekulohet në këtë ajet?! Deri tani njerëzimit i është mbushur koka vetëm me „profetë” semitë (izraelitë të gjithë, ndërsa Muhamedi arab).

Edhe me të dërguarit para teje kanë bërë tallje. Porse Unë atyre që nuk besuan u pata dhënë afat, pastaj i ndëshkova, e çfarë ishte dënimi Im! [13:32]

Cinizmi vazhdon: dëshira për të dënuar për gabime, jo masë preventive për të shmangur gabimet. Kjo s'është aspak hyjnore!

Lum si ne, që nuk ka ekzistuar e nuk ekziston Allahu muhamedan!

E ata që besuan Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe nuk bënë kurrfarë dallimi në asnjërin prej tyre, të tillëve do t'u jepet shpërblim i merituar. Allahu fal shumë dhe është mëshirues. [4:152]

Ne ta shpallëm ty, që me urdhrin e Zotit t'i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; në rrugë të Fuqiplotit, të Falënderuarit. [14:1]

Asnjë nga të dërguarit Ne nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t'u shpjegojë atyre. E Allahu e lë të humbur atë që do dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do. Ai është i fuqishmi, i urti. [14:4]

Zoti yt e di më së miri gjendjen e atij që është në qiej e tokë. Ne kemi dalluar disa profetë nga të tjerët, prandaj Davudit i kemi dhënë Zebur [Psalm / Testamenti i vjetër]. [17:55]

Muhamedi dezinformon „në emër” të personazhit të tij, Allahut, se ai u paskësh dërguar popujve profetë, që e flisnin gjuhën e atyre popujve, ndërsa „profetët” e feve abrahamike janë të gjithë semitë, që kanë folur vetëm dialektet hebre dhe, tashmë, u paskësh ardhur radha arabëve ta kenë profetin në gjuhë të tyre, që t’i nxjerrë nga errësira në dritë [14:1], siç ka ndodhur edhe me „profetët” pararendës [14:4].

Kundërthëniet për qëndrimin ndaj prindërve:

Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre ose që të dy i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as „of - oh”, as mos u trego i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira e të buta. [17:23]

Në kundërthënie me:

O ju që besuat, mos u ofroni dashuri prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë. [9:23]

Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mira ndaj prindërve të vet, e nëse ata të dy përpiqen të të shpien ty që të më përshkruash Mua shok (zot tjetër) për çka ti nuk di asgjë, atëherë ti mos i respekto ata. Kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t’ju njoftoj për atë që keni vepruar. [29:8]

Këshillime kundërthënëse dhe jonjerëzore, sidomos për kohën kur janë sajuar këto ajete. Çdokush i konvertuar në islam, i indoktrinuar nga Muhamedi dhe besimtarët e tij ose me dhunë, mund të ketë pasur prindër që kanë këmbëngulur të mbeten në fenë e trashëguar nga prindërit. Sipas porosisë së Muhamedit [9:23 dhe 29:8], ata prindër nuk duhet të respektohen dhe të duhen. Mizor, apo jo?

Kundërthëniet për lindjen e perëndimin e diellit:

Dhe ti e shihje diellin, kur lindte bartej prej shpellës së tyre nga ana e djathtë, e

kur perëndonte largohej nga ata nga ana e majtë, e ata ishin në një vend të gjerë të saj. Kjo ishte një nga argumentet e Allahut... [18:17]

Deri kur arriti në vendperëndimin e diellit, e gjeti se po perëndon në njëfarë burimi me lym të zi dhe aty gjeti një popull. E Ne u thamë: „O Dhulkarnejn, ose do t'i dënosh, ose do t'i marrësh me të mirë e t'i udhëzosh!” [18:86]

Deri kur arriti vendlindjen e diellit, e gjeti se po lind mbi një popull, që nuk i kemi dhënë ndonjë mbulojë prej tij (diellit). [18:90]

Ja edhe hadithet përkatëse, që dëshmojnë sa injorant ishte Muhamedi:

Al-Buhariu, volumi 4, libri 54, numri 421:

„Transmeton Ebu Dhari: Profeti më pyeti mua kur perëndoi dielli: „A e di ku përfundoi dielli?” Unë u përgjigja: „Allahu dhe I Dërguari i Tij e dinë më mirë“. Profeti tha: „Ai shkoi që t'i përkulet nën Fron Allahut dhe të merrte leje që të ngrihet përsëri, dhe kjo i është lejuar dhe më pas ai do të jetë gati për t'i rënë në sexhde, por sexhdja e tij nuk do t'i pranohet, dhe pastaj ai do të kërkojë leje për të shkuar në rrugën e tij, por ajo nuk do të lejohet, ai do të urdhërohet që të kthehet prej nga ka ardhur dhe kështu që do të rritet në perëndim. Kjo është interpretimi i Deklaratës së Allahut: „Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet. Ai është përcaktim i ngadhënjyesit, të dijsmit.” [36:38]

Kundërthënie ndaj njësisë së kohës:

Dita 1. 000 vjet:

Është ai që udhëheq çështjen prej qiellit në tokë, pastaj ajo ngrihet tek Ai në një ditë që, sipas llogarisë suaj, është sa një mijë vjet. [32:5]

Ata kërkojnë prej teje t'jua ngutësh dënimin, por Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet, siç e llogaritni ju. [22:47]

Dita 50. 000 vjet:

Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti në një ditë që zgjat pesëdhjetë mijë vjet. [70:4]

Kundërthënie ndaj Abrahamit/Ibrahimit dhe Qabesë:

Një rast tjetër kemi korrigjimin e orientimit të namazit. Fillimisht, derisa nuk ishte përvetësuar Qabeja, muhamedanët gjatë lutjeve orientoheshin në drejtim të Jerusalemit. Më vonë u ndryshua. Arsyetimet për këtë metamorfozë e përmbajnë ajetet vijuese:

Përkujto (O i dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: „Unë po të bëj ty prijës (imam) të njerëzimit!“ Ai tha: „Edhe nga pasardhësit e mi“! Tha: „Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!“ [2:124]

Dhe kur shtëpinë (Qabenë) e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit, (u thamë): Vendin ku qëndroi Ibrahim pranojeni për vendfaljeje! Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: „Ju të dy pastrojeni shtëpinë Time për vizitorët, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty. ” [2:125]

Dhe kur Ibrahim tha: „Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoi me lloje të ndryshme frutash“! Ai (Allahu) tha: „(E furnizoj) Edhe atij që nuk besoi do t’ia mundësoj shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër, e pastaj do ta shtyj në dënimin e zjarrit, e sa përfundim i shëmtuar është ai“. [2:126]

Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke i ngritur themelet e shtëpisë (Qabesë - luteshin): „Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di“! [2:127]

Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiri i tyre, të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet e Tua, t’u mësojnë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë ata (prej ndyrësisë së idhujtarisë). S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshti. [2:129]

E kush largohet prej fesë së Ibrahimit, përveç atij që e poshtëron vetveten. Ne atë e bëmë të zgjedhur në këtë botë, kurse në botën tjetër ai është njëri prej të lartëve. [2:130]

„Kur Zoti i vet atij i tha: „Dorëzohu“! Ai tha: „I jam dorëzuar Zotit të gjithësisë!“ [2:131]

E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), edhe Jakubi. (u thanë) „O bijtë e mi, Allahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë! [2:132]

Paraqita disa ajete, - më tepër sesa shumë, - që të shihet se sa përcart është formuluar një proces. Patjetër, ato janë reflektim i nivelit mjerues të atyre që i kanë sajuar.

Dallime më të mëdha janë përcaktimet karshi besimtarëve paganë, jehudinj dhe kristianë, sepse gjatë viteve 610-622, Muhamedi kishte qëndrim, të themi, më liberal sesa gjatë viteve 622-632, kur i ashpërsoi qëndrimet e tij.

Përzgjedha gjithë këtë mori ajetesh, duke i krahasuar mes tyre, për të diskualifikuar propagandën e zhurmshme, se *Kurani* është vepër e përkryer. Përmes tyre, çdo myslimanë fundamentalist ka mundësinë të bindet se *Kurani* jo vetëm që nuk është vepër e përkryer, por me shumë përcaktime do ta komprometonte skajshmërisht „Zotin”, po qe se do të ekzistonte.

II. 5. Kurani - (mos)kuptueshmëria

Për ta argumentuar se *Kurani* është vepër e përkryer e Allahut, propaganduesit e *Kuranit* përdorin si argument kuptueshmërinë e tij. Ata gënjejnë se kuptueshmëria e *Kuranit* na qenkësh e përkryer. Këtë gënjeshtër ata e bazojnë kryesisht te vetë ajetet e *Kuranit*. Nga kjo del se autori i bën lavdërimë eksplicite tekstit, që ai vetë e ka sajuar.

Qysh në fillim më duhet të sqaroj se unë, përgjithësisht, e shpërfill përcaktimin vetëmbrojtës të myslimanëve demagogë e fundamentalistë, që thonë se *Kuranin* nuk duhet ta analizojë askush që nuk e njeh gjuhën origjinale të tij. Ky përcaktim duhet të jetë kryesisht si taktikë për të mbrojtur broçkullat që i përmban *Kurani*. Përndryshe, as vetë shumica e klerikëve (qofshin ata edhe arabë dhe arabishtfolës) nuk e njohin gjuhën „origjinale” të *Kuranit*, e cila, në fakt, as që është ruajtur, sepse ajetonit aktual është shumë herë i transkriptuar e „redaktuar” (për herë të fundit në vitin 1924).

Megjithatë, unë do të bazohem në përkthime (tri variante në shqip, shtatë variante në gjermanisht, dy në gjuhën boshnjake).

Në vazhdim po ofroj disa nga ajetet që përmbajnë lavdërimin e tekstit të *Kuranit*:

„E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai...” [2:23]

„Sikur ai të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie”. [4:82]

„Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca”. [6:38]

„Përkundër kësaj, ata thonë se atë e trilloi ai (Muhamedi). Ti thuaj: „Silleni pra ju një kaptinë të ngjashme me këtë, madje thirrni kë të doni në ndihmë, pos Allahut, po qe se jeni të drejtë në atë që thoni”. [10:38]

„Ne e zbritëm Kuranin në arabisht, që ta kuptoni ju”. [12:2]

„Ne duke shpallur këtë Kuran, po të rrëfejmë ty më të bukurin rrëfim, edhe pse para tij ishe nga të painformuarit”. [12:3]

„Kurani nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i shpalljeve para tij, shpjegues i çdo gjëje dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin besimtarë”. [12:111]

„Këto ajete të kësaj kaptine dhe e tërë ajo që t’u shpall ty nga Allahu yt janë realitet, por shumica e njerëzve nuk besojnë”. [13:1]

„Ky është në gjuhën e qartë arabe” . [16:103]

Duke qenë në arabisht, Kurani nuk ka kundërtënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar. [39:28]

*S’ka dyshim se Ne e bëmë atë Kuran arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni. [43:3]
Ne Kurantin e bëmë të lehtë për ta kuptuar... [54:17]*

Autorët, të kapluar nga dëliri i madhësisë ose nga dyshimi se kanë sajuar broçkulla, kanë sajuar shumë ajete që përmbajnë lavdërimin e përmbajtjes së *Kuranit*.

Ndoshta aksidentalisht ose si taktikë për të arsyetuar përmbajtjen tepër të përcartë të pjesës më të madhe të *Kuranit*, kryeautori i tij, Muhamedi, duhet të ketë sajuar këtë ajet:

„Është Ai që ta zbriti librin ty. Në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit. Ka të tjera ajete, që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrëmbëta, gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutit, kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: „Ne u kemi besuar atyre, të gjitha janë nga Allahu ynë”! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes”. [3:7]

Çfarë kuptimi do të kishte që Allahu t’ia diktonte Muhamedit edhe ajetet që askush nuk i kupton?! Jo, këto janë tekste gjysm-analfabëtësh, me prirje të bejtexhinjve. Përmes këtij ajeti është synuar të arsyetohet primitivizmi i formulimeve, por edhe pengimi i kritikëve, duke i paragjykuar ata si të devijuar, nëse do të merrreshin me përzgjedhje dhe kritikë të ajeteve të përcarta?!

Ajo që të bie më së pari në sy në përkthimet e *Kuranit* në variantin zyrtar, janë sqarimet e shpeshta në kllapa dhe teksti i zgjeruar interpretues në formë të shënimeve në fusnota. Po të mënjanonim tekstin sqarues në kllapa, shumë ajete do të mbeteshin tepër të paqarta. Le ta

konkretizojmë ajetin 3:7: *Ai është që ta zbriti librin ty. Ai aludohet në personazhin Allah. Sigurisht që mund të (keq)kuptohet se bëhet fjalë për dikë tjetër, nëse kemi parasysh mashtrimin e madh se Allahu është autor i formulimit të tekstit. Përndryshe do të duhej të ishte Unë ose Ne, nëse do të ishte autor Allahu. Autori, Muhamedi, vazhdon me pasaktësi, se i pakësh „zbritur” Kurani në formë „libri”, kur në fakt nuk i është zbritur asnjëherë në format libri!*

Në vazhdim të formulimit autori nuk duhet ta ketë ditur se zemra nuk është organ që mendon.

Pos Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë!, sërish është formulim që e përjashton personazhin Allah si autor. Ndërsa autori ka vazhduar me mashtrimin spekulues: „dijetarët...” u besojnë edhe ajeteve të paqarta, sepse i paskësh formuluar Allahu.

Analizimi i pothuajse secilit ajet provon se „zoti” jo se jo, por as personazhi Allah nuk është autor i tekstit, përmbajtja e të cilit është e përcartë, primitive, me veta, rasa, përemra të ngatërruar.

Ja edhe një ajet, gjithashtu i përcartë:

Sikur Ne ta bënim Kuranin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: „Pse nuk janë të kuptueshme ajetet e tij?A është ai në gjuhë të huaj, kurse ai është arab?”Thuaj: „Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbërim. Të tillët janë sikurse thirren prej një vendi të largët e nuk dëgjojnë”. [41:44 / shqipëruar nga Sherif Ahmeti]

Po ofroj edhe shqipërimin nga H. E. Nahi:

*Sikur ta kishim shpallur Kuranin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: „Të ishin ajetet e shpallura të kuptueshme?! Vallë, *të jetë në gjuhën joarabe, **të jetë arab!? Thuaj: „Ai, për besimtarët është udhërrëfyes dhe ilaç”. Dhe, ata që nuk besojnë, kanë pengesa në veshë dhe ai për ta është verbëri, thuajse thirrën prej vendeve të largëta.*

* Fjala është për Kuranin.

** Rezulton të jetë Muhamedi, por mungojnë konkretizimet.

Meqë as tani nuk mund të kuptohet kjo kakofoni, po e ofroj shqipërimin edhe nga Feti Mehdiu (meqë Bashkësia Islame e Kosovës e ka botuar para dy vjetësh *Kurani* e shqipëruar prej tij):

Dhe sikur ta bënim Kuranin në gjuhën e huaj, ata me siguri do të thoshin: „Të kishin qenë ajetet e tij të shpjeguar”. A gjuhë e huaj, e ai vetë arab, a?! Thua: „Ai është për besimtarët udhëzim dhe bar”. Kurse ata që nuk besojnë - janë të shurdhër e të verbër, ata sikur thirren nga një vend i largët.

Përmes këtyre tri shqipërimeve dëshmohet se tekstin origjinal i *Kuranit* është aq i përcartë e primitiv, sa në asnjë përkthim nuk i del ndonjë kuptim i qartë e konstruktiv. Demagogët myslimanë spekulojnë, sikur gjuha e *Kuranit* na qenkësh hyjnore, prandaj nuk mund të përkthehet. Dhe zhurmojnë aq zhurmshëm me këso mashtrimesh, saqë hidhërohen kur të tjerët nuk u besojnë, prandaj i diskualifikojnë për islamofobë.

Qysh në fjalinë e parë, po të ishte Allahu autor, do të mund të keqkuptohej se po prezantohet si arab, meqë për gjuhët joarabe shprehet „gjuhë të huaj”. Cilët janë „ata” që do të mund të thoshin: *Pse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme, a është ai në gjuhë të huaj, kurse ai është arab?* Për ajetet e cilit autor është fjala? Ndërsa „ai”, rezulton të jetë *Kurani* dhe „ai” tjetri do të duhej të ishte Muhamedi. Prandaj, që të bëhet paksa më i kuptueshëm, interpretuesit arabë të tekstit „origjinal” dhe përkthyesit kanë ofruar tekst sqarues në kllapa. Ja si do të dukej ajeti me tekstin sqarues në kllapa:

Sikur Ne (Allahu) ta bënim Kuranin në gjuhë të huaj, ata (jomuslimanët) do të thoshin: „Pse nuk janë ajetet e tij (Allahut) të kuptueshme, a është ai (Kurani) në gjuhë të huaj, kurse ai (Muhamedi) është arab?” Thua: „Ai (Kurani) është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë në veshët e tyre kanë shurdhim dhe ai për ta është verbërim. Të tillët janë sikurse thirren prej një vendi të largët e ata nuk dëgjojnë”. [41:44 / shqipërimi i Sherif Ahmetit]

Në përmbyllje të ajetit janë ofruar edhe (pseudo)arsyetime idiotike, pse jomyslimanët nuk i besonin *Kuranit* dhe Muhamedit. Ky ajet i sures, me emër „Ad-duhan”, është sajuar gjatë kohës sa ishte Muhamedi në Mekë (para 16 korrikut 622).

Po ofroj edhe variantin origjinal, për mundësi praktike të krahasimit, për ata që e zotërojnë arabishten e *Kuranit* (meqë nuk mjafton vetëm arabishtja e tanishme e standardizuar):

اعجمي قرآن «أ» حتنفهها «آياته» بينت «فصلت» هلا «قراناً أعجمياً قالوا الولاء» أياذكر «ولو جعلناه»
«قلهوللدينأمنواهدى» ودونه ،استفهامإنكارمنهمبتحقيقالهمزةالثانيةترقلبهاالفأبأشباع «عربي» نبي «و
فلايفهمونه «وهوعليهمعمى»تقلفلايسمعونه «والذنبلايؤمنونفياًذاتهموقر» منالجهل «وشفاء» منالضلالة
(٤٤). أيهمكالمنادمنمكاتبعيدلايسمعوايفهممايناديبه «أولكنينادونمنمكاتبعيد»

Ja edhe tri ajete që i shkojnë tematikës:

Kur ti e lexon Kuranin, mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne vëmë një perde të padukshme. [17:45]

Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi tyre që t'ju lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme. [62:2]

Ndërkaq, në zemrat e tyre vëmë një mbulesë dhe shurdhim të thellë të veshëve të tyre që nuk mund ta kuptojnë atë. E kur ti e përmend në Kuran Allahin tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen. [17:46]

Autori ka ngatërruar leximin me recitimin (deklamimin). Përndryshe, nga këto ajete, aksidentalisht, është diskredituar mashtrimi se Muhamedi paskësh qenë analfabet. Pastaj, çfarë kuptimi ka këtu „perdja e padukshme”, kur Muhamedi, si misionar, duhej t'ua kishte preztuar jomyslimanëve ajetet që po sajonte, që t'i bindte për t'u konvertuar në myslimanë. Pikërisht për këtë qëllim nuk do të duhej të kishte kurrfarë perdeje mes misionarit Muhamed dhe njerëzve që e dëgjonin.

Ndoshta kuptueshmëria është vështirësuar edhe për faktin se *Kurani* nuk duhet të jetë menduar, në radhë të parë, si tekst letrar ose filozofik, por si një lloj kanuni, që do të normonte sjelljet, të drejtat, detyrimet dhe dënimet. Këtë e thotë edhe ajeti vijues:

Ne e shpallëm atë kushtetutë në arabisht e nëse ti, pasi të kanë ardhur argumente të qarta, shkon pas dëshirave të tyre, ti nuk ke prej Allahut as ndihmë, as mbrojtje. [13:37]

Nuk ia vlen të përsëritet diskreditimi i gënjeshtres shumë herë të përsëritur: „Ne e shpallëm atë”, sepse *Kurani* ende nuk ishte kompletuar, kur po sajohej kjo sure (gjithashtu mekase) dhe asnjëherë nuk ishte „shpallur” si tërësi! Ajetin e fundit [“...Sot jua kam përsosur fenë tuaj...”, 5:3] Muhamedi duhet ta ketë sajuar pak ditë para se të vdiste.

Kuptueshmërinë e formulimit të *Kuranit* duhet t’ia kenë ngatërruar edhe bashkautorët jo arabisht folës, të cilët Muhamedi duhet t’i ketë angazhuar si lloj këshilltarësh. Për angazhimin e tyre kanë (dez)informuar edhe islamologët, por edhe ajeti vijues:

Ne dimë shumë mirë se ata thonë: ‘Atë (Muhamedin) është kah e mëson një njeri!’ Mirëpo, gjuha e atij nga i cili anojnë ata nuk është arabe, e kjo është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë. [16:103]

Nga përmbajtja e ajetit rezulton se Muhamedi ishte i informuar që banorët e Mekës po e përfllisnin për këshillim nga një jo-arabisht-folës. Që të kundërshtoheshin përfollësit, duhet të jetë sajuar ky ajet, i cili gjithashtu përmban paqartësi konkretizuese. Ta zëmë, si mund të dihet tani, pas 14 shekujve, se ata ishin banorë të Mekës. Pastaj, çfarë arsytimi mund të ishte që këshilltari nuk dinte arabisht, ndërsa teksti i *Kuranit* ishte në arabisht, dhe atë „në stil të lartë e të qartë”, që do të thotë se po e përdornin gjuhën e poetëve popullorë, e cila nuk duhet të ishte krejtësisht identike me gjuhën që flisnin beduinët e fisit Kurejsh.

Që të përballen klerikët dhe fundamentalistët myslimanë, të cilët në këso rastesh fajn ua vënë përkthimeve, po sjellim mendime të islamologëve për relacionet mes gjuhës aktuale arabe dhe gjuhës së *Kuranit*, për të vërtetuar se pothuajse të njëjtën vështirësi kanë edhe arabët e tanishëm për të kuptuar gjuhën e *Kuranit* (sado që me kalimin e kohës është „redaktuar”, së fundmi në vitin 1924). Në debate, edhe klerikët myslimanë, me kualifikime superiore në universitete arabe, kanë (sh)përdorur demagogjinë, sikur fajet i kanë përkthimet. Por, sa herë që u kërkoja përkthim më të saktë, ata ngecnin, duke u arsyetuar se përkthimi në shqip i prof. Sherif Ahmetit është tejet i saktë.

Sipas islamologut turk, Kerem Adıgüzel: „Nëse sot do të lexonin *Kuranin* arabët e zakonshëm, ata mezi do të kuptonin gjysmën e asaj që është shkruar. Për këtë arsye nuk është çudi që edhe arabët kanë vështirësi gjatë hulumtimeve, sidomos në aspektin teologjik. Mungesa e ballafaqimit kritik me përmbajtjen e *Kuranit* do të thotë se nuk kemi studime objektive.³⁰⁹

Edhe orientalisti i afirmuar Hartmut Bobzin është i mendimit se për arabin e sotëm, me arsimim mesatar, një pjesë e madhe e tekstit të *Kuranit* është e pakuptueshme.³¹⁰

„Sipas bindjes së shumë studiuesve të islamit, një pjesë e konsiderueshme e *Kuranit* - flasim për afro një të katërtën e tekstit - është „e errët”, d. m. th. e pakuptueshme, dhe ju do të vini re vështirësitë e disa përkthyesve“të ndershëm”, që t’i bëjnë të kuptueshme edhe këto pasazhe të pakuptimta. Këtu, ata zakonisht u drejtohen interpretuesve islamikë të *Kuranit*, të cilët shpesh kanë formuluar faqe të tëra të komenteve, qoftë edhe vetëm për një ajet. Ato komente janë bërë kryesisht në shek. 10, edhe pse edhe interpretuesit e atëhershëm kishin të njëjtat vështirësi gjuhësore.

³⁰⁹ <http://www.alrahman.de/wieso-wurde-der-koran-auf-arabisch-offenbart/>.

³¹⁰ Orientalisti Hartmut Bobzin, "Der Koran: Eine Einführung", s. 95,

<http://www.amazon.de/Der-Koran-Einf%C3%BChrung-Hartmut-Bobzin/dp/340643309X>.

„As arabishtfolësit nuk ndihen më mirë sesa përkthyesit, sepse, zakonisht, ata nuk i dinë hollësitë filologjike në „gjuhën e tyre“ më mirë se përkthyesit. Fakti që gjuha e *Kuranit* është „gjuha e tyre“ është një përshtypje mashtruese, sepse ortografia dhe morfologjia e *Kuranit* nuk kanë mundur t’i përshtatet krejtësisht arabishtes moderne.³¹¹

Vështirësia tjetër gjuhësore e arabishtfolësve të sotëm qëndron në faktin se gjuha arabe, aktualisht, mund të grupohet në 6 „gjuhë“. Ja një shembull konkret, për të pasqyruar dallimin e këtyre 6 „gjuhëve“ arabe:

Fjalja „çfarë dëshiron ti tani?“ në këto „gjuhë“ përkthehet:

1. arabishte të ishullit arab (Rijad): vish tabaḍaḥḥīn?
2. arabishte e Mesopotamisë (Bagdad): sh-ītrīdhassa?
3. arabishte e Levantit (Damask): shūbēddakhalla’?
4. arabishte e Egjiptit (Kajro): ‘āvizēhdilva’ ti?
5. arabishte e Afrikës Veriore (Rabat): āshbēt’sdāba?
6. arabishte moderne: māḍāturīdu-l’ ān?³¹²

Dallimet aq të mëdha, sa të mund të konstatohet se nuk përdoruesi i njëjës nga këto „gjuhë“ nuk do të kuptonte pyetjen e tjetrit të „gjuhës“ tjetër.

Shembull tjetër konkretizues mes arabishtes së *Kuranit* dhe arabishtes së tanishme standarde: në *Kuran sajjaratun* përdoret për *udhëtarët*, ndërsa aktualisht përdoret për *automobil*.³¹³

Ndoshta për rritjen e pakuftueshmërisë së tekstit të *Kuranit* mund të ketë ndikuar edhe fakti se në arabishten e shkruar në shek. 7 nuk janë përdorur fare zanoret. Në një debat me hoxhë Drilon I. Gashin u ofrua

³¹¹ Markus Groß, Karl-Heinz Ohlig, Vorwort der Koranübersetzung.

<http://www.inarah.de/cms/bobzin-karimi.html>.

³¹² <http://publikationen.ub.uni-frankfurt.de/frontdoor/index/index/docId/14638>.

³¹³ http://www.chj.de/Koran/Arab_Koran_Hintergr.html.

një shpjegim krahasues, se çfarë keqkuptimesh mund të ketë shkaktuar mospërdorimi i zanoreve.

Ta zëmë, Muhamedi mund të kishte thënë se gjatë një beteje, para portës së murit rrethues të kështjellës:

„Gjatë sulmit theva dorën”.

E shkruar pa zanore: „Gjtslmtthvdrn”. Ata që janë marrë me përshtatjen e tekstit, sipas ortografisë së ndryshuar gjatë shekujve, kanë mundur ta lexojnë atë fjali edhe kështu:

„Gjatë sulmit theva derën”.

Në të shkruarit e kohës së sajimit të *Kuranit*, mes *derës* e *dorës* nuk ka pasur ndryshim, meqë në të dy rastet është shkruar „dr”, por dallimi përmbajtjesor është i madh, pasi vërtet nuk është njësoj sikur Muhamedi të kishte thyer dorën ose të kishte thyer derën.

Islamologu dhe kleriku turk, Beqir Alboga, konstaton: „Për lutjet e përditshme, myslimanët duhet të mësojnë gjuhën arabe - të paktën të mësojnë përmendsh. Për të kuptuar domethënien e vargjeve në arabishten origjinale, mund dhe duhet të përdorin mjete ndihmëse. Arabishtfolësit mund të kenë avantazhe të caktuara, por as ata, gjithashtu, nuk do ta kuptonin *Kuranin* tërësisht, pa sqarime e interpretime shoqëruese, sepse arabishtja në kohën e Profetit ishte e ndryshme nga arabishtja e sotme. Pos kësaj, ajetet e zbitura para 1400 vjetëve janë shpallur „në gjuhë të qartë arabe” (16:104), por për raste e situata të veçanta. Kemi të bëjmë me *Asbaaban-Nuzuul*, që do të thotë se është e nevojshme për të studiuar me kujdes arsyet e zbulësës.³¹⁴

Ndërsa islamologu Sharhaz Zarqanika shfaqur përcaktimin tipik dogmatik: „Sa i përket përkthimit të *Kuranit* (respektivisht transmetimit ekuivalent në një gjuhë tjetër), kjo logjikisht dhe sipas parimeve

³¹⁴ [http://www.swr.de/contra/-/id=5583300/property=download/nid=7612/11f9bhw/Bekir+Alboga,+November+2009+\(Spracher%3A+Andreas+Rupniak\).pdf](http://www.swr.de/contra/-/id=5583300/property=download/nid=7612/11f9bhw/Bekir+Alboga,+November+2009+(Spracher%3A+Andreas+Rupniak).pdf).

islame është e pamundur, rrjedhimisht është e ndaluar që të provoni të përktheni *Kuranin*.³¹⁵

Ndoshta përcaktimi i Az-Zarqanit do të mund të anashkalohej duke u bazuar në ajetin:

Nga argumentet e tij është edhe krijimi i qiejve dhe tokës, llojlojshmëria e gjuhëve tuaja edhe e ngjyrave tuaja; këto janë, njëmend, mësim për ata që dinë. [30:22]

Autori i ajetit njuh praninë e shumëllojshmërive të gjuhëve, prandaj ky përcaktim do të duhej të sfidonte ndalesën për përkthim të *Kuranit*.

Sa i përket përdorimit të gjuhës arabe si gjuhë e shkruar dhe komunikuese në një rreth më të gjerë, duhet pranuar se ajo fillesat i ka goxha të vonshme, diku nga mesi i shek. 4, kur ndodhi përzierja mes fiseve arabe dhe amhariare (etiopiane). Kështu ndodhi avancimi i saj nga gjuhët e tjera semite, meqë përdorimi i saj u shtri më shpejt e më gjerësisht. Rreth shek. 6 edhe shumica e sabsjve kaluan në përdorim të gjuhës arabe. Ky kalim u sforcua qysh kur u sajua dhe u përhap feja islame, meqë lutjet detyrimisht duhej të bëheshin në këtë gjuhë³¹⁶.

Ndoshta niveli i ulët i kuptueshmërisë përmbajtjesore dhe gjuhësore të *Kuranit* duhet të ketë ndodhur edhe për shkak se, në sajimin e tekstit zanafillor duhet të kenë marrë pjesë rreth 29 veta, që islologët i quajnë regjistrues të „shpalljeve”. Më të rëndësishmit ishin katër kalifët: Ebu Bekri, Omeri, Osmani (Utmani) dhe Aliu. Regjistrues të tjerë të shquar ishin: Moavja, Subeir Ibn El Avam, Saied Ibn El Aas, Amr Ibn El Aas, Obaj Ibn Kab dhe Zeid IbnThabet. (...)

Ruajtjen e formulimit zanafillor të *Kuranit* e ka dëmtuar shumë fakti se, pak muaj pas vdekjes së Muhamedit, në betejën *El-Xhama* (tetor 632), janë vrrarë rreth 70 recitues të *Kuranit*. Duke parë se po

³¹⁵ Az-Zarqani, MuhammadAbdul'azim: Manahilal-'Irfanfi 'Ulumal-Quran, Kairo 2006, Dar As-Salam, 2. Auflage, Bd. 2, S.490.

http://www.islam-pedia.de/index.php5?title=Quran%C3%BCbersetzung#cite_note-2.

³¹⁶ https://de.wikibooks.org/wiki/Wikijunior_Sprachen/_Arabisch.

rrezikohej të humbiste formulimi i *Kuranit*, pas asaj beteje kalifi Ebu Bekri, me propozim të Omer Ibn El Khatabit, ngarkoi Zeid Ibn Thabetin për grumbullimin e formulimeve. Zeidi tashmë ishte afirmuar si „sekretar” i Muhamedit, meqë ai i kishte qëndruar më afër atij, për të shënuar formulimet që i komunikonte, por vetëkuptohet, duke mashtruar se po i „zbrisnin” nga Allahu.

Nën sundimin e kalifit Uthmānibn ‘Affān (عثمان بن عفان), i cili ishte kalifi i katërt dhe që sundoi në vitet 644-656, u intensifikua grumbullimi i formulimeve kuranore, duke u përmbyllur me „redaktimin” e 5 ekzemplarëve, dedikuar për kryeqendra kryesore, tashmë në Perandorinë Arabe. Ekipi „redaktues” drejtohej nga Zeid Ibn Thabet. Pasi mbaruan me „redaktimin” e atyre 5 ekzemplarëve, kalifi Utman duhet të ketë urdhëruar që të zhdukeshin të gjitha përmbledhjet e mëhershme, gjithsesi të shkapërderdhura dhe të pasistemuara. Ky „redaktim” është bazuar kryesisht në recitimet e atyre që i dinin përmendsh ajetet.³¹⁷

Por, fatkeqësisht, deri tani nuk është zbuluar asnjë ekzemplar nga këta pesë. Dorëshkrimi më i vjetër është zbuluar në vitin 1972 në Sana të Jemenit. Bëhet fjalë për 40 fletë. Vjetërsia e tyre duhet të jetë rreth vitit 720, që i bie rreth 70 vjet pas ekzemplarëve të kalifit Utman.³¹⁸

Rëndom propagandistët e islamit preferojnë të citojnë lavdërimet që i kanë bërë islamit personalitet joislame. Kësaj radhe po ofrojmë lavdërimin që i ka bërë *Kuranit* orientalisti francez, Edouard Montet:

Të gjithë ata që janë njohur me Kuranin origjinal në arabisht, pajtohen për bukurinë e këtij libri fetar, madhështinë e tij fisnike që është aq e

³¹⁷ <http://www.way-to-allah.com/themen/korankritik.html>.

³¹⁸ <http://www.islamfacts.info/Islamfacts/Handschriften.html>

*jashtëzakonshme, që asnjë përkthim, në ndonjë gjuhë europiane, nuk mund t'i përafrohet origjinalit.*³¹⁹

Rëndom, arabofilë të këtillë, po të mos kishin një simpati të veçantë për islamin, nuk do të merreshin me një punë kaq të vështirë, siç është përkthimi i *Kuranit*. Përndryshe, përkthime më të sakta kanë bërë profesionalistët, që nuk ishin arabofilë dhe as myslimanë, por studiues neutralë.

Ne po informohemi edhe tani, se si personalitete, si presidenti amerikan Obama, ose kancelaria gjermane, Merkel, e lavdërojnë islamin si fe paqësore, në çdo rast që dënojnë aktet terroriste të islamistëve xhihadistë. Sigurisht, edhe ata e dinë se po gënjejnë, por ama, po gënjejnë për arsye politike demagogjike e taktike, sepse duan t'i përçajjnë turmat e islamistëve, që terroristët islamistë të kenë sa më pak mbështetje. Kështu të paktën i (keq)kuptoj unë „lavdërimet“ e tyre që i bëjnë islamit. Përndryshe do të duhej të diskualifikoheshin si stimulues të terrorizmit islamik!

Fatkeqësisht ka përplot të tjerë, të cilët dëshirojnë që turmat të jenë sa më fetare, sepse përfitojnë nga injoranca e tyre...

II. 6. Kurani - (pa)saktësitë historike

Në vitin 2011 myslimanët fundamentalistë në Shkup, ish-shqiptarë, tani vetëm shqipfolës, kërcënuan që do të shpërthenin me dinamit përmendoren e Aleksandrit të Madh, të sapovendosur në qendër të Shkupit. Në kuadër të angazhimeve të mia, që t'i bind ata të mos e bënin atë akt terrorist, një klerik mysliman, me kualifikime të larta teologjike në shtetet arabe, me informoi se *Kurani* e madheron Lekën

³¹⁹ Edouard Montet, Traduction Française du Coran, Paris, 1929, Introduction, S. 53.

e Madh si profet dhe se ai prezantohet me emër simbolik: *Dhulkarne-nji* (shqip: *Dybrirëshi*), në ajetet 83-111, të sures 18 (e emërtuar *El-kehf* / *Shpella*).

Atëherë, por edhe tani më është dukur rrëfim i përçartë, primitiv!
Citoj:

*Të pyesin ty për Dhulkarnejn, thuaju: “Do t’ju rrëfej për punën e tij”. [18:83]
Ne i mundësuam atij forcë në tokë dhe i dhamë mundësi që çdo send të mund ta arrijë. [18:84]*

Ai iu rrek një aso mundësie. [18:85]

Deri kur arriti në vendperëndimin e diellit e gjeti se po perëndon në njëfarë burimi me lym të zi, aty gjeti një popull. E Ne i thamë: “O Dhulkarnejn, ose do t’i dënosh, ose do t’i marrësh me të mirë e t’i udhëzosh!” [18:86]

Ai (Dhulkarnejni) tha: “Ai që vazhdon edhe më tej të jetë zullumqar, atë do ta dënojmë, pastaj i kthehet Zotit të vet e Ai e dënon atë me një dënim të tmerrshëm”. [18:87]

Sa i përket atij që besoi dhe bëri vepra të mira, atij i takon shpërblimi më i mirë dhe atij nga ana jonë do t’i bëjmë lehtësi. [18:89]

Pastaj, ai iu rrek një aso mundësie. [18:90]

Deri kur arriti vendlindjen e diellit e gjeti se po lind mbi një popull, që nuk i kemi dhënë ndonjë mbulojë prej tij. [18:91]

Ashtu, Ne e kemi ditur gjendjen e tij. [18:92]

Mandej, ai iu rrek përsëri një aso mundësie. [18:93]

Deri kur arriti mes dy kodrave, prapa tyre gjeti një popull që thujse nuk kuptonte asnjë gjuhë. [18:94]

Ata thanë: “O Dhulkarnejn, vërtet Jexhuxhi dhe Mexhuxhi janë duke bërë shkatërrime në tokë, a bën që ne të të japim ty një kontribut, e që të bësh një pendë mes nesh dhe mes tyre?” [18:95]

Ai tha: “Atë që mua ma mundësoi Zoti im është shumë më e mirë, po ju më ndihmoni me fuqi punëtore të bëj një pendë të fortë mes jush dhe mes atyre! Më sillni copa të hekurit!” [18:96]

E kur e niveloi ai me dy anët e kodrave, tha: “Ndizni!”, e kur e bëri atë zjarr tha: “Më sillni bakër të shkrirë t’ia hedh atij!” [18:97]

E ata as nuk arritën ta kapërcenin atë e as ta shponin. [18:98]

Ai tha: “Kjo është një e mirë nga Zoti im, e kur të vjen caktimi i Zotit tim, Ai e bën atë rrafsh, e caktimi i Zotit tim është i sigurt”. [18:99]

Ne bëjmë atë ditë që ata të përzihen si valët njëra me tjetrën. Dhe i fryhet Surit e të gjithë ata i tubojmë. [18:100]

Atë ditë ua prezantojmë xhehenemin jobesimtarëve me një prezantim të hapur. [18:101]

Atyre që sytë i kishin të mbuluar ndaj argumenteve të Mia dhe që nuk mund të dëgjonin. [18:102]

A mos menduan ata që nuk besuan se përkundër Meje mund të marrin zota robërit e Mi? Ne kemi përgatitur për jobesimtarët xhehenemin si vend pritjeje. [18:103]

Thuaj: “A t’ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre?” [18:104]

Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se janë kah bëjnë mirë. [18:105]

Të tillë janë ata që nuk besuan argumentet e Zotit të tyre, as takimin e Tij, ndaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e gjykimit atyre nuk do t’u japim kurrfarë vlere. [18:106]

Këtë, ngase shpërblimi i tyre është xhehenemi, për shkak se nuk besuan dhe argumentet e Mia e të të dërguarit tim i morën për tallje. [18:107]

S’ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vendpritje për ta është xhenetit e Firdevsit. [18:108]

Aty do të jenë përgjithmonë e nuk kërkojnë të largohen nga ai. [18:109]

Thuaj: “Sikur të ishte deti ngjyrë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, ai do të shterej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, edhe sikur të sillnim shtesë dhe një det tjetër si ai”. [18:110]

Thuaj: “Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju! Mua më shpallët se vetëm një Zot është Zoti juaj, e kush e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos e përziejë askënd”. [18:111]

Fillimisht po ofroj disa variante të përkthimeve të ajetit 18:83, që të shohim se sa dallojnë mes tyre përkthimet e *Kuranit*:

ويسألونك «أي اليهود» عن ذي القرنين «اسمه الاسكندر ولم يكن نبيا» قل سأتلو «سأقص» عليكم منه «من حاله» ذكرا «خيرا» [18:83]

Dhe nëse të pyesin ty për Dhulkarnejnin, thuaj: “Unë do t’ju tregoj disa lajme për të”. [18:83 / shqipëruar nga H. E. Nahi]

Dhe nëse të pyesin për Dhulkarnejnin, thuaj: “Për këtë do t’ju rrëfej disa lajme”. [18:83 / shqipëruar nga F. Mehdiu]

Dhe nëse të pyesin ty për Dybrirëshin (Zuu l-Karnejni). Thuaj: Unë do t'ju lexoj një histori për të. [Und man fragt dich nach dem mit den zwei Hërnern. Sag: Ich werde euch eine Geschichte von ihm verlesen. (18:83 / gjermanisht nga Rudi Paret.)].

Ata të pyesin ty për atë me dy brirë. Thuaj: "Unë do t'ju rrëfej diçka nga historia e tij. "[Sie fragen dich nach dem mit den zwei Hërnern. Sprich: "Ich werde euch etwas von seiner Geschichte erzählen. " (18:83 / gjermanisht nga al-Az'har)]³²⁰.

Nga këto alternativa të përkthimit mund të shihet se tematika mбет pak a shumë e njëjtë, ndërsa nuancat janë “shije” të përkthyesve. Ndoshta vetë origjinali është problematik për përkthim...

Në fakt, kush duhet të jetë Dybrirëshi (Dhulkarnejni)?!

Në ajetin 18:86 është një formulim tepër naiv. Dybrirëshi paskësh arritur deri te vendi ku perëndon Dielli. Aty, te fundi i tokës, ku puqet me qiellin, na paskësh qenë një “burim me lym të zi”. Ku duhet të jetë ky vend?! Këtë vend sigurisht nuk e di as personazhi Allah, respektivisht autori Muhamed. Po kështu, sipas ajetit 18:91, ai na paskësh shkuar deri te “vendlindja e diellit”. Ku gjendet ai vend?!

I tërë rrëfimi është një broçkull e përçartë, që vetëm ndonjë besimtar fanatik mund ta lexojë me kënaqësi naive. Pra, as si legjendë nuk të shijon ta lexosh.

Edhe W. Montgomery Watt ishte i mendimit se Dhulkarnejni ishte personazh i legjendarizuar sipas legjendave që përfliteshin për Aleksandrin e Madh në Lindjen e Afërt³²¹.

Si kjo “histori” janë të formuluar pothuajse të gjitha “historitë” e tjera në *Kuran*, plagjiatura të shpifura, të sajuara sipas legjendave, gjithashtu pseudohistorike, që i përmban *Toraha* (TV).

Megjithatë, për të argumentuar këtë zhvlerësim kaq vulgar, po ofroj edhe një legjendë tjetër, edhe më të afirmuar.

³²⁰ <http://www.koransuren.de/koran/surenvergleich/sure18.html>.

³²¹ W. Montgomery Watt in: Encyclopaedia of Islam. New Edition, s. v. al-Iskandar.

Përmytja e madhe - gënjeshtër e madhe

Në librat dogmatikë të feve abrahamike përfshihet një legjendë për një katastrofë, e quajtur **përmytja e madhe** (gjithë-botërore).

Kjo legjendë është edhe një argument më shumë, se autorët e këtyre “librave” nuk duhet të kenë qenë të informuar për një përmytje të kufizuar vetëm në luginën e lumit Eufrat (Iraku i sotëm), për të cilët historianët supozojnë se mund të ketë ndodhur, prandaj ate e kanë quajtur përmytje gjithë-botërore. Po të ishte “zoti” i religjioneve abrahamike autor i këtyre “librave”, sigurisht do ta dinte që nuk ka ndodhur përmytja botërore në kohën e Noas (נח), i arabizuar nga Muhamedi në Nuh (نوح), gjithashtu legjendar.

Kryepersonazhi i legjendës është “profeti” Noa, i cili, sipas Torahës (Tevratit / Besëlidhje e Vjetër), duhet të ketë jetuar në mijëvjeçarin e 3-të p.E.s. dhe paskësh jetuar 950 vjet.³²² Por teologu turk, kryesuesi i një ekipi për përkthimin e Kuranit në turqisht, ka ofruar shpjegimin vijues sa i përket kësaj jetëgjatësie:

“Sipas vlerësimeve empirike që janë kryer, kjo jetëgjatësi nuk është e mundur. Pas disa vitesh hulumtime dhe gërmime, antropologët dhe arkeologët kanë ardhur në përfundimin, se viti kalendarik në kohën para përmytjes së madhe ka qenë i barabartë me muajin e tanishëm kalendarik. Kjo do të thotë se, në qoftë se lexojmë që dikush atëherë ka jetuar 950 vjet, kjo do të ishte rreth 80 vjet të tanishme...”³²³

Sipas këtyre të dhënave, përmytja e madhe duhet të ketë ndodhur rreth shek. 29 p.E.s.

Legjenda ka për bazë hidhërimin e Allahut, për shkak të degjenerimit të njerëzve, të cilët nuk po e çmonin Noan për profet. Prandaj

³²² Bibla, Gensis 9:29; Kuran 29:14.

³²³ Yçce Kuran, f. 396, Prof. Cemal Sofuoglu, prof. Abdulkadir Sener & Prof. Mustafa Yıldırım;

cituar sipas: <http://antikezukunft.de/2011/08/05/lebte-noah-a-wirklich-950-jahre/>.

ai merr vendim për zhdukjen e të gjithë njerëzve të botës. Vetëm “profeti” Noa privilegjohet. Ai urdhërohet të ndërtojë një **ark**, siç është quajtur në *Bibël*, që ngjasonte me emërtimin shqip: *arkë*, dhe jo anije, siç figuron në *Kuran*. Zoti e urdhëroi Noan të hipte në atë arkë, bashkë me gruan e tij, tre djemtë (sipas *Kuranit*, djali i katërt jo, sepse atë e kishte dënuar zoti), tri nusët e djemve, një çift nga të gjitha kafshët, të buta dhe të egra; një çift nga të gjithë zvarranikët, një çift nga të gjitha shpezët etj. Përfundimisht, pasi përfundon përmytja, të shpëtuarit fillojnë shumëzimin e njerëzimit, kafshëve, shpezëve. Pra, njerëzimi, - sipas kësaj legjende të shpifur, - edhe një herë do të jetë shumëzuar përmes incestit, siç ka ndodhur me fëmijët e “njeriut të parë”, Adamit [të cilin, sipas *Torahës*, zoti e ka krijuar më 10. 3761 p.E.s. (ndërsa *Kurani* nuk e fikson ditën e krijimit të Ademit.)].

Aspak hyjnore as kjo legjendë, që ka zënë hapësirë goxha të madhe në *Kuran* dhe në *Bibël*, sepse zoti qenkësh hidhëruar dhe, prandaj, ka përmytur gjithë njerëzimin.

Kjo legjendë u ngjason atyre që janë në eposet e *Atrahasis* (shek. 19 p.E.s.) dhe *Gilgameshit*. Por, meqë *Toraha* është shkruar nga misi-onarët hebrej në shekullin e fundit p.E.s. (rreth 1800 vjet pas *Gilgameshit*), nuk kanë informuar se janë ndikuar prej tyre. As autorët e *Kuranit* nuk kanë informuar se për këtë legjendë janë informuar nga *Toraha* ose nga ato epose.

Të interesuarit mund të bëjnë krahasime, si është paraqitur legjenda në *Kuran* dhe si në *Toraha* (Tevrat / Besëlidhja e Vjetër).

Fillimisht ajetet nga *Kurani*:

Po ata e përgënjeshtroan atë (Nuhun), e Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të në anije, ndërsa ata që i përgënjeshtroan faktet tona i fundosëm. Vërtet, ata ishin popull i verbër. [7:64]

Ne e patëm dërguar edhe Nuhun te populli i vet: “Unë ju tërheq vërejtjen haptazi”. [11:25]

“Që të mos adhuronit tjetërkënd pos Allahut, sepse unë kam frikë për dënimin tuaj në Ditën e pikëllueshme”. [11:26]

Ata thanë: “O Nuh, ti polemizove me ne dhe e zgjate polemikën tonë. Urdhëro, e nëse flet të vërtetën, silleni pra, të na godasë ajo me çka na kërcënohesh!” [11:32]
Ai tha: “Atë ua sjell vetëm Allahu, po qe se dëshiron, e ju nuk mund ta pengoni!” [11:33]

Nëse përpiqem t’ju këshilloj, po qe se Allahu do t’ju humbë, këshilla ime nuk bën dobi. Ai është Zoti juaj dhe vetëm tek Ai do të ktheheni. [11:34]

A mos po thonë se ai e trilloi atë? Thuaj: “Nëse unë kam trilluar, atëherë ai është mëkati im, e unë jam larg nga krimet tuaja”. [11:35]

E Nuhut i qe shpallur: “Nuk do të besojë më askush nga populli yt, përveç atyre që kanë besuar, pra mos u brengos për atë që punojnë ata”. [11:36]

E mbaroje anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe me mësimin tonë, e mos m’u drejto Mua për ata që bënë zullum, ata gjithqysh janë të përmbytur. [11:37]

Dhe ai ndërtonte anijen e paria e popullit të tij, sa herë që kalonte pranë tij e përqeshte. Ai u thoshte: “Nëse talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju, ashtu siç po talleni ju!” [11:38]

Dhe më vonë do të kuptoni se cili do ta pësojë dënimin e turpshëm dhe mbi të cilin do të jetë dënimi i përjetshëm. [11:39]

E kur erdhi urdhri ynë dhe gufoi (uji) prej furrës (vend ku piqet buka), Ne i thamë: “Ngarko në të për çdo krijesë nga një çift dhe familjen tënde, përveç për kë është marrë vendim i hershëm kundër tij, e (ngarko) edhe kush ka besuar, po përveç një pakice nuk i kishin besuar atij”. [11:40]

Dhe ai tha: “Hipni në të, e me emrin e Allahut ajo lundron dhe ndalet. Vërtet, Zoti im fal shumë, Ai është mëshirues”. [11:41]

Ajo lundron me ta nëpër valë si kodra, e Nuhu e thirri djalin e vet, që ishte në një vend të ndarë: “O djali im, hip bashkë me ne, e mos u bëj me mohuesit!” [11:42]

Ai (djali) tha: “Unë do të ngjitem në një kodër, që do të më mbrojë nga uji (vërshimi)!” Tha: “Nuk ka sot mbrojtës prej dënimit të Allahut, pos atë që Ai e ka mëshiruar!” Vala hyri mes atyre të dyve, e ai (djali) u mbyt në ujë. [11:43]

I qe thënë: “Oj tokë, përpije ujin tënd dhe, o qiell, ndërprite shiun. Uji u tërhoq, urdhri u zbatua dhe ajo (anija) u ndal në (kodrën) Xhudij, e u tha: “I shkatërruar qoftë populli mizor!” [11:44]

Nuhu e luti Zotin e vet, duke i thënë: “O Zoti im, djali im është i familjes sime, e premtimi Yt është i saktë, ndërsa Ti je më i drejti i të drejtëve!” [11:45]

(Zoti) Tha: “O Nuh, ai nuk ishte nga familja jote, ai ishte punëkeq, e ti mos më kërko Mua atë që nuk di, Unë të këshilloj që të mos bëhesh nga injorantët!” [11:46]

(Nuhu) Tha: “Zoti im, unë mbështetem në mbrojtjen Tënde, që të (mos) kërkoj prej Teje atë për çka nuk kam njohuri, e në qoftë se nuk më fal mua dhe nuk më mëshiron Ti, do të jem i humbur!” [11:47]

I qe thënë: “O Nuh, zbarko! Qofsh i shpëtuar nga ana Jonë, me begati për ty dhe

për një popull që është me ty. E një populli (tjetër) do t'i mundësojmë përjetime, e pastaj do t'i godasë dënimi i dhembshëm nga ana Jonë". [11:48]

Këto janë disa nga rrëfimet e panjohura (për ty), që po t'i shpallim ty, e që para këtij (Kuranit) nuk i ke ditur as ti, as populli yt...[11:49]

Ai (Nuhu) tha: "Zoti im, më ndihmo për atë që më përgënjeshtrojnë". [23:26]

E Ne i shpallëm: "Ndërto anijen nën mbikëqyrjen Tonë dhe sipas urdhrit Tonë, e kur të vijë urdhri Ynë dhe të ashpërsohet gjendja, atëherë ti ngarko në të prej secilit lloj nga një çift (palë) dhe familjen tënde, me përjashtim të atij (djalit tënd), ndaj të cilit ka marrë fund vendimi. Për të, pra, mos kërko (falje) prej Meje për ata që janë mëkatarë, pse ata janë të përmbytur. [23:27]³²⁴

E kur të vendosesh ti dhe kush është me ty në anije, atëherë thuaj: "Falënderuar qoftë Allahu, i cili na shpëtoi prej popullit të prishur!" [23:28]

Dhe thuaj: "Zoti im, më zbarko në një vend të bekuar, e Ti je më i miri i atyre që bëjnë vendosjen!" [23:29]

Nuk ka dyshim se në këto (ngjarje të popujve) ekzistojnë fakte bindëse. Në të vërtetë Ne i vëmë në provë. [23:30]

Mandej pas tyre Ne sollëm popull tjetër. [23:31]

Ne e përmbytëm edhe popullin e Nuhut, meqë ata të dërguarit i quajtën rrenacakë, e për njerëzit, të cilët mendojnë, le të marrin mësim nga ata. E për mizorët Ne kemi përgatitur dënim të rëndë. [25:37]

Edhe populli i Nuhut gënjeu të dërguarit. [26:105]

Unë nuk jam tjetër, por vetëm sa t'u tërheq vërejtjen haptas. [26:115]

Ata i thanë: "O Nuh! Nëse nuk heq dorë, do të gurëzohesh". [26:116]

Ai tha: "O Zoti im, populli im më pandeh gënjeshtar. [26:117]

Pra, Ti me drejtësinë tënde gjyko ndërmjet meje dhe atyre dhe më shpëto mua dhe besimtarët që janë me mua!" [26:118]

Ndaj Ne e shpëtuan atë dhe të gjithë ata që ishin me të në anijen e mbushur plot. [26:119]

Mandej i mbytëm në ujë ata që mbetën pas tyre. [26:120]

Ne e dërguam Nuhun te populli i vet, e ai kaloi ndër ata një mijë pa pesëdhjetë vjet, e ata meqë ishin horra, i përfshiu vërshimi. [29:14]

Ndërsa atë vetë dhe të tjerët që ishin në anije, i shpëtuan dhe Ne atë (ngjarje) e bëmë argument për tërë botën. [29:15]

Për Zotin Neve na pati thirrur në ndihmë Nuhu, Ne jemi përgjegjës të mirë. [37:75]

Dhe Ne e shpëtuan atë dhe familjen e tij prej asaj të keqeje të madhe. [37:76]

³²⁴ Në këtë ajet thuhet se në arkë kanë hipur Noa me gruan, tre djemtë dhe tri nusët. Kurse në ajetin 26:119 flitet që në anije kanë hipur edhe shumë ihtarë të Noas.

E pasardhësit e tij i bëmë ata që vazhduan jetën. [37:77]
Dhe Ne ua lamë atë kujtim për njerëzit e ardhshëm. [37:78]
Selam i qoftë Nuhut në mbarë botën! [37:79]
Ne kështu i shpërblejmë të mirët. [37:80]
Vërtet, ai ishte prej robërve tanë që janë besimtarë. [37:81]
E pastaj i përmbytëm në ujë të tjerët (që nuk besuan). [37:82]
Edhe popullin e Nuhut (e dënuam) që ishte më parë. Ai ishte një popull i prishur. [51:46]
Edhe popullin e Nuhut më herët, vërtet ata ishin edhe më zullumqarë dhe më renegatë. [53:52]
Populli i Nuhut që ishte para tyre përgënjeshtroi dhe robin Tonë (Nuhun) e quajti rrenacak dhe thanë: "I marrë!" dhe u bë kërcënim. [54:9]
E ai iu drejtua Zotit të vet: "Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!" [54:10]
Atëherë Ne me një shi të vrullshëm i hapëm dyert e qiellit. [54:11]
Dhe Ne tokën e zbërthyem në burime uji, kurse uji u bashkua siç ishte caktuar. [54:12]
E atë (Nuhun) e bartëm në anije dërrasash e shtyllash të mbërthyer mes tyre, që lundronte nën mbikëqyrjen Tonë. [54:13]
(I fundosëm) Si ndëshkim për atë (Nuhun) që ishte mohuar (përbuzur). [54:14]
Atë (ngjarje) Ne e lamë për kujtim, po a ka ndokush që merr mësim? [54:15]
Atyre që mohuan, Allahu u sjell shembull gruan e Nuhut dhe gruan e Luitit. Ato të dyja ishin në kurorë të dy robërve të mirë nga robërit tanë, por ato të dyja i tradhtuan (në fë) ata të dy dhe këta të dy nuk mund t'i mbrojnë ato fare tek Allahu, e atyre dyjave u thuhet: "Hyni të dyja në zjarr së bashku me ata që hyjnë!" [66:10]
Ne e dërguam Nuhun te populli i vet (dhe i thamë): "Tërhiqja vërejtjen popullit tënd para se ata t'i godasë dënimi i rëndë!" [71:1]
Për shkak të mëkateve të tyre, ata u përmbytën dhe menjëherë u futën në zjarr dhe ata, përveç Allahut, nuk gjetën ndihmëtarë. [71:25]
E Nuhu tha: "O Zoti im, mos lër mbi tokë asnjë nga jobesimtarët!
Sepse, nëse Ti i lë ata, robërit Tu do t'i humbin dhe prej tyre nuk lind tjetër, vetëm të prishur e jobesimtarë. [71:26]

E njëjta legjendë në Bibël, Zanafilla, kapitulli 6, ajetetet 5-22:

[Përmbytja / Prishja e njerëzimit:]

⁵ Zoti pa se paudhësia e njerëzve përmbi tokë ishte e madhe dhe se çdo mendim i zemrës së tyre nuk synonte tjetër, por që të bëjë vazhdimisht keq.

⁶ Zotit i erdhi keq që krijoi njeriun përmbi tokë. I erdhi keq thellë në zemër

ISLAMI, religion agresiv (?!)

⁷ e tha: “Do ta shuaj prej faqes së dheut njeriun që e krijova: njeriun, bagëtitë, zvarranikët edhe shpendët e qielli, sepse po më vjen keq që i krijova”.

⁸ Porse Noa gjeti hir para Zotit.

⁹ Ja historia e Noas:

Noa ishte i drejtë dhe pa të meta ndër bashkëkohës të vet; ecte udhës së Hyjit.

¹⁰ I lindën tre djem: Semi, Kami dhe Jafeti.

¹¹ Toka ishte prishur para syve të Hyjit dhe ishte mbushur me dhunë.

¹² Hyji e shikoi tokën dhe pa që ishte prishur, sepse sjellja e çdo njeriu përmbi tokë ishte plot ligësi.

¹³ Hyji i tha Noas: “Për mua erdhi dita të shfaros çdo njeri. Toka është mbushur me ligësi, për shkak të njerëzve dhe, ja, unë do t’i shfaros ata nga toka.

¹⁴ Ndërto për vete një arkë nga druri rrëshinor. Ndaje në kthina dhe lyeje përbrenda e përjashta.

¹⁵ Dhe ja si duhet ta punosh: gjatësia e saj le të jetë treqind kute, gjerësia pesëdhjetë kute, kurse lartësia e saj le të jetë tridhjetë kute.

¹⁶ Në arkë bëj një dritare dhe mbaroje një kut nën majën e saj. Në krah lër derën; bëje në të katin e poshtëm, të mesmin e të lartin.

¹⁷ Dhe, ja, unë do të sjell përmbytjen me ujë mbi tokë për të mbytur çdo gjallesë që ka frymën e jetës nën qiell: gjithçka është përmbi tokë do të shfaroset.

¹⁸ Unë do të bëj besëlidhje me ty. E ti hyr në arkë me bijtë e tu, gruan tënde e me tri gratë e bijve të tu.

¹⁹ Prej të gjithë frymorëve, të çdo lloji, shtjeri në arkë nga dy, mashkull e femër, që të shpëtojnë gjallë me ty.

²⁰ Prej shpendëve sipas llojit të tyre; prej bagëtive sipas llojit të tyre; prej zvarranikëve sipas llojit të tyre le të hyjnë nga dy prej të gjithave me ty, që të mund të jetojnë.

²¹ Ti pastaj merr me vete çdolloj ushqimi që mund të hahen dhe ruaj pranë vetes që të jenë ushqim për ty e për ta”.

²² Noa bëri gjithçka si urdhëroi Hyji: pikërisht ashtu.

Zanafilla, kapitulli 7, ajetetet 1-24:

[Noa kishte gjashtëqind vjet kur ujërat e përmbytjes vërshuan mbi sipërfaqen e tokës].

¹ Atëherë Zoti i tha Noas: “Hyr në arkë ti dhe gjithë familja jote, sepse ty të gjeta të drejtë para syve të mi në këtë brezni.

² Prej të gjitha kafshëve të pastra merr nga shtatë e shtatë: mashkull e femër, kurse prej të papastrave dy nga dy: mashkull e femër.

³ Po ashtu edhe prej shpendëve të qiellit shtatë e shtatë: mashkull e femër, që të shpëtojë fara mbi mbarë sipërfaqen e tokës.

⁴ Sepse, edhe shtatë ditë e do të bëj të bjerë shi përmbi tokë për dyzet ditë e dyzet net dhe do të shfaros çdo gjë të gjallë që krijova mbi sipërfaqen e tokës.

⁵ Noa bëri krejt ashtu si i urdhëroi Zoti.

⁶ Noa kishte gjashtëqind vjet kur ujërat e përmbytjes vërshuan mbi sipërfaqen e tokës.

⁷ Noa hyri në arkë me të bijtë e tij, gruan e tij dhe gratë e bijve të tij, për shkak të ujërave të përmbytjes.

⁸ Prej kafshëve të gjalla të pastra e të papastra, prej shpendëve dhe prej çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë,

⁹ Hynë dy e nga dy me Noan në arkë, mashkull e femër, siç kishte urdhëruar Zoti.

¹⁰ Si kaluan shtatë ditë, ujërat e përmbytjes vërshuan mbi tokë.

¹¹ Të gjashtëqindtin vit të jetës së Noas, në muajin e dytë, të shtatëmbëdhjetën ditë të muajit, plasën të gjitha burimet e humnerës së madhe e u hapën pendët e qiellit.

¹² Përmbi tokë ra shi për dyzet ditë e dyzet net.

¹³ Po atë ditë hynë në arkë Noa, Semi, Kami e Jafeti, bijtë e tij, gruaja e tij dhe me ta tri gratë e bijve të tij,

¹⁴ ata dhe çdo frymor, sipas llojit të vet, çdo lloj kafshe, sipas llojit të vet dhe çdo zvarranik që lëviz përmbi tokë, sipas llojit që i përket, e çdo fluturues sipas llojit, të gjithë shpendët dhe të gjitha kafshët që fluturojnë,

¹⁵ hynë me Noa në arkë dy e dy nga çdo qenie në të cilin ishte fryma e jetës.

¹⁶ Ata që hynë, ishin mashkull e femër prej të gjitha qenieve të gjallë, sikurse Hyji e kishte urdhëruar Noa. Zoti ia mbylli derën nga jashtë.

¹⁷ Atëherë u bë përmbytje mbi tokë gjatë dyzet ditëve e ujërat u shumuan dhe e ngritën arkën lart nga toka.

¹⁸ Sepse u rritën shumë dhe mbuluan gjithçka mbi sipërfaqen e tokës, kurse arka notonte përmbi ujë.

¹⁹ Ujërat u bënë gjithnjë e më të furishme mbi tokë, dhe u mbuluan të gjitha malet e larta nën qiell.

²⁰ Uji që më i lartë pesëmbëdhjetë kute përmbi malet që kishte mbuluar.

²¹ Mbaruan të gjithë frymorët që lëvizin përmbi tokë: shpendët, kafshët, egërsirat, si dhe të gjithë zvarranikët që hiqen zvarrë përmbi tokë dhe të gjithë njerëzit;

²² gjithçka në tokë që kishte frymën e jetës u shkatërrua.

²³ Shfarosi çdo gjallesë që ishte përmbi tokë: prej njeriut deri në bagëti, deri në zvarranikë dhe shpendët e ajrit u shuan nga faqja e dheut. Mbetën gjallë vetëm Noa dhe ata që ishin me të në arkë.

²⁴ Ujërat e pushtuan tokën njëqind e pesëdhjetë ditë.

Zanafilla, kapitulli 8, ajetetet 1-22:

[Uji fillon të bjerë:]

¹Hyjit i ra ndër mend për Noan dhe për të gjithë frymorët e bagëtitë që ishin me të në arkë e solli erën përmbi tokë dhe ujërat ranë.

²U mbyllën burimet e humerës e pendët e qiellit dhe u ndaluan shirat nga qielli.

³Ujërat u tërhoqën nga toka pak nga pak. Pas njëqind e pesëdhjetë ditësh ujërat filluan të pakësohen.

⁴Të shtatin muaj, të shtatëmbëdhjetën ditë të muajit u ndal arka mbi malet Ararat.

⁵Por ujërat vazhdimisht shkonin duke u ulur deri në muajin e dhjetë. Të dhjetin muaj, ditën e parë të muajit, u panë majat e maleve.

⁶Pasi kaluan dyzet ditë, Noa e hapi dritaren e arkës që kishte punuar dhe lëshoi pëllumbin.

⁷Ky dilte: shkonte e kthehej, derisa u terën ujërat mbi tokë.

⁸E lëshoi edhe pëllumbin për të parë a është hequr ujët përmbi sipërfaqen e tokës.

⁹Ky, duke mos gjetur ku ta pushojë këmbën e vet, u kthye tek ai në arkë: sepse ujërat ishin mbi mbarë tokën. Noa e shtriu dorën, e kapi dhe e futi në arkë.

¹⁰Pasi priti edhe shtatë ditë të tjera, përsëri e lëshoi pëllumbin prej arke.

¹¹Atëherë pëllumbi erdhi tek ai në mbrëmje dhe solli në sqep të vet një gem ulliri me gjethe të gjelbra. Noa e mori vesh se ujërat ishin tërhequr nga toka.

¹²Megjithatë, priti edhe shtatë ditë të tjera. Atëherë e lëshoi pëllumbeshën; ajo nuk u kthye më.

¹³Ishte viti gjashtëqind e një, muaji i parë, dita e parë e muajit, kur ujërat u thanë përmbi tokë. Noa e hoqi mbulesën e arkës, shikoi dhe, ja, sipërfaqja e tokës ishte tharë.

¹⁴Të dytin muaj, të njëzeteshtatën ditë të muajit, toka u ter.

[Dalja nga arka:]

¹⁵Atëherë Hyji i tha Noas:

¹⁶“Ti e gruaja jote dilni nga arka, e me ty bijtë e tu e gratë e bijve të tu.

¹⁷Qiti me ty edhe të gjitha kafshët e gjalla të çdo lloji që i ke me vete: shpendët, bagëtitë, si dhe të gjithë zvarranikët që zvarriten përmbi tokë, që të shpërndahen e të përhapen përmbi tokë, të rriten e të shtohen e të shumohen mbi tokë”.

¹⁸Doli, pra, Noa e me të bijtë e tij, gruaja e tij e gratë e bijve të tij.

¹⁹Po ashtu nga arka dolën edhe të gjithë gjallesat sipas llojeve të tyre: bagëtitë, shpendët dhe zvarranikët që zvarriten përmbi tokë.

²⁰ Noa ndërtoi në nder të Zotit një lter, mori prej të gjitha kafshëve e shpendëve të pastër dhe i kushtoi fli shkumbimi në lter.

²¹ Zoti i mori erë erës së këndshme dhe tha në zemrën e vet: “Nuk do ta mallkoj më kurrë tokën për shkak të njerëzve, sepse mendimi i zemrës së njeriut është i prirë kah e keqja që prej rinisë së tij; nuk do t’i ndëshkoj më të gjithë frymorët që bëra.

²² Derisa toka të ketë mbjelljet dhe korrrjet, të ftohtët e të nxehtët, vera e dimri, dita e nata kurrë s’do të pushojnë”.

Zanafilla, kapitulli 9, ajetetet 1-29:

[Rendi i ri i botës:]

¹ Hyji e bekoj Noan dhe bijtë e tij e u tha: “Jini të pëlleshëm, shumojuni dhe mbusheni tokën.

² Jini tmerr dhe frikë për të gjitha gjallesat e tokës, për të gjithë shpendët e qiellit dhe për të gjitha kafshët e gjalla që lëvizin përmbi tokë; të gjithë peshqit e detit janë në duart tuaja.

³ Gjithçka që lëviz dhe gjallon do ta keni për ushqim: jua jap të gjitha këto siç ju pata dhënë të gjitha perimet e blerta.

⁴ Vetëm mos e hani mishin me shpirt që është në gjak.

⁵ Unë do të kërkoj llogari për gjakun e jetës suaj. Do të kërkoj llogari prej të gjitha kafshëve; do të kërkoj llogari prej njeriut për jetën e njeriut, prej secilit gjakun e vëllait të vet.

⁶ Kush derdh gjakun e njeriut, gjaku i tij të derdhet prej njeriut, sepse në përfytyrimin e Hyjit, Hyji e krijoi njeriun.

⁷ Jini të pëlleshëm dhe shumojuni, mbusheni tokën dhe sundojeni!”

⁸ Edhe këto i tha Hyji Noas dhe bijve të tij:

⁹ “Ja, unë po e lidh besëlidhjen time me ju dhe me trashëgimtarët tuaj, pas jush
¹⁰ e me çdo genie të gjallë që është me ju, qoftë ai shpend, qoftë bagëti, qoftë egërsirë e tokës që është me ju, me të gjitha gjallesat që dolën prej arkës me ju, me mbarë gjallesat e tokës.

¹¹ Unë po lidh besëlidhjen time me ju: nuk do të shfaroset më asnjë gjallesë me ujërat e përmbytjes dhe nuk do të ketë më përmbytje që shkreton tokën”.

¹² Dhe Hyji tha: “Kjo është shenja e besëlidhjes, që unë po e bëjnë ndërmjet meje e jush dhe me çdo gjallesë që është me ju për të gjitha brezitë e ardhshme;

¹³ Ylberin tim do ta vë në re dhe do të jetë shenja e besëlidhjes ndërmjet meje dhe tokës.

¹⁴ Kur ta mbuloj qiellin me re, atje do të duket ylberi im,

¹⁵ do të më kujtohet besëlidhja ime me ju e me çdo frymë të gjallë që mishit i jep jetë; ujë përmytjeje më s' do të ketë për të zhdukur mbarë frymorët.

¹⁶ Ylberi do të duket në re. Atë unë do ta shikoj dhe do të më kujtohet besëlidhja e përhershme që u lidh mes Hyjit e çdo gjëje të gjallë, të mbarë gjallesave që janë përmbi tokë”.

¹⁷ Hyji i tha Noas: “Kjo do të jetë shenja e besëlidhjes që bëra ndërmjet meje e çdo gjallesë përmbi tokë”.

[Prej përmytjes e deri tek Abrahami / Noa dhe bijtë e tij:]

¹⁸ Bijtë e Noas që dolën nga arka ishin: Semi, Kami e Jafeti.

Kami është trangu i Kananit.

¹⁹ Këta tre janë bijtë e Noas. Prej tyre u përhap tërë gjinia njerëzore mbi mbarë tokën.

²⁰ Noa, që ishte bujk, nisi të mbjellë një vresht.

²¹ Pasi piu verë, u deh dhe u zhvesh në çadrën e vet.

²² Kur Kami, i ati i Kananit, e pa të atin ashtu lakuriq, lajmëroi dy vëllezërit e tij që ishin jashtë.

²³ Atëherë Semi e Jafeti morën mallotën, e vunë në krah, e duke ecur prapazi, mbuluan lakuriqësinë e atit të tyre, duke mos e shikuar babanë lakuriq.

²⁴ Noa, kur i doli pija e, si e mori vesh çka i kishte bërë i biri i vogël ²⁵, tha: “Qoftë mallkuar Kanani: skllav, bir skllavi, qoftë për vëllezërit e vet”!

²⁶ E shtoi: “Qoftë bekuar Zoti, Hyji i Semit! Kanani qoftë skllavi i tij!”

²⁷ Hyji e zgjeroftë Jafetin! Banoftë në tendat e Semit e Kanani qoftë skllavi i tij!”

²⁸ Noa jetoi pas përmytjes edhe treqind e pesëdhjetë vjet.

²⁹ Jetoi gjithsej nëntëqind e pesëdhjetë vjet e atëherë vdiq.

Zanafilla, kapitulli 10, ajetetet 1-32:

[Toka popullohet:]

¹ Këta janë pasardhësit e bijve të Noas: Semi, Kami e Jafeti. Këtyre pas përmytjes u lindën fëmijë.

² Bijtë e Jafetit: Gomeri, Magogu, Madai, Javani, Tubali, Mosoku e Tirasi.

³ Bijtë e Gomerit: Askenezi, Rifati, Togormai.

⁴ Bijtë e Javanit: Elisai, Tarsisi, Cetimi dhe Rodanimi.

⁵ Prej këtyre u ndanë popujt nëpër ujdhesa në krahinat e veta, secili sipas gjuhës së vet dhe sipas barkut të vet, në kombësi të vet.

- ⁶ *Bijtë e Kamit: Kusi, Mesraimi, Futi dhe Kanani.*
- ⁷ *Bijtë e Kusit: Sabai, Hevilai, Sabatai, Regmai e Sabatakai. Bijtë e Regmait: Sabai e Dadani.*
- ⁸ *Kusit i lindi Nemrodi, i cili u bë sundimtari i parë në tokë*
- ⁹ *dhe me vullnetin e Zotit u bë gjuetar i vyeshtëm. Nga kjo doli edhe thënia: "Nemrodi gjuetar si ai para syve të Zotit".*
- ¹⁰ *Mbretëria e tij filloi me Babiloninë, Arakun, Akadin e Kalanën, në dheun e Senaarit.*
- ¹¹ *Nga ky vend kaloi në Asiri e atje ndërtoi Ninivën, Rohobotirin e Kalenë.*
- ¹² *Po ashtu Resenin ndërmyet Ninivës dhe Kalesë. Ky është qytet i madh.*
- ¹³ *Kurse Mesraimit i lindi Ludimi, Anamimi, Laabimi, Neftuimi,*
- ¹⁴ *Fetrusimi, Kasluimi dhe Kaftorimi, prej të cilëve rrjedhin filistinët.*
- ¹⁵ *Kanaanit i lindi Sidoni, djali i parë, e Heteu,*
- ¹⁶ *Jebuseu, Amorreu, Gergezeu,*
- ¹⁷ *Heveu, Araceu, Sineu,*
- ¹⁸ *Aradiumi, Samareu e Emateu. Atëherë u shpërndanë fiset e kananëve.*
- ¹⁹ *Kufijtë e Kananit shkonin prej Sidonit në drejtim të Gerarës deri në Gazë, dhe në drejtim të Sodomës e të Gomorrës, Adamës e të Seboimit deri në Lesë.*
- ²⁰ *Këta janë bijtë e Kamit sipas vëllazërive, gjuhëve, vendeve e kombësisë së tyre.*
- ²¹ *Gjithashtu, i lindën fëmijë edhe Semit, trungut të të gjithë bijve të Heberit, vëllait të madh të Jafetit.*
- ²² *Bijtë e Semit: Elami, Asuri, Arfaksadi, Ludi dhe Arami.*
- ²³ *Bijtë e Aramit: Usi, Huli, Geteri dhe Mesi.*
- ²⁴ *Kurse Arfaksadit i lindi Saleu e prej këtij i lindi Heberi.*
- ²⁵ *Heberit i lindën dy djem: njëri quhej Faleg, sepse në kohën e tij u nda toka, kurse i vëllai u quajt Jektan.*
- ²⁶ *Këtij, Jektanit, i lindi Elmodadi, Salefi, Asarmoti, Jareu,*
- ²⁷ *Adurami, Uzali, Deklai,*
- ²⁸ *Ebali, Abimaeli, Sabai,*
- ²⁹ *Ofiri, Hevilai dhe Jobabi. Të gjithë këta janë bijtë e Jektanit.*
- ³⁰ *Vendbanimi i tyre shtrihet prej Mesës në drejtim të Sefarit, Mali i Lindjes.*
- ³¹ *Këta janë bijtë e Semit sipas vëllazërive të tyre, gjuhëve, vendeve dhe kombësisë.*
- ³² *Këta janë barqet e bijve të Noas sipas breznive të tyre dhe të fiseve.*
- Pas përmbytjes prej tyre u ndanë popujt mbi tokë.*

Nga *Bibla* solla fragmente të zgjeruara, për t'i bezdisur edhe jofetarët, me shpresë që do të kenë mirëkuptim për besimtarët që torturohen me këso dogmash, - në dukje legjenda, në fakt prallisje, - për të parë se në këtë rrëfim, që e përmban *Besëlidhja e Vjetër* (Teurati), duhet të jenë bazuar autorët e *Kuranit*.

Në *Kuran* emri i kryepesonazhit të saj, Nuhu, përmendet 52 herë.

Rrëfimi në *Kuran* ngjan në rrëfimin e atij që e ka dëgjuar ose e ka lexuar dikur atë legjendë, por në rastin e reproduktimit të saj (për të qenë pjesë edhe e *Kuranit*), e ka mbajtur në mend legjendën vetëm pjesërisht dhe përçart, meqë edhe “origjinali” ka qenë i përçartë.

Kryesore është se sajuesit e të dy “librave” kanë gënjyer, sepse nuk ka ndodhur përmbytja e madh, botërore. Ndërkaq, nëngënjeshtat, se gjithë njerëzimi e ka prejardhjen nga tre djemtë e Noas (Nuhut), janë pjellë e “përmbytjes së madhe”...

II. 7. Kurani - (pseudo)shkencor

Rrëfen Ebu Dhari: Profeti më pyeti në perëndim të diellit: 'A e dini ku bie poshtë dielli?' Unë u përgjigja: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë.' Ai tha: 'Ai i përkulet Allahut nën fron dhe merr leje që të ngrihet përsëri, dhe kjo i lejohet. Pastaj ai do të jetë gati për sexhde, por nuk do t'i pranohet, dhe ai do të kërkojë leje për të shkuar në rrugën e tij. Ai do të urdhërohet që të kthehet prej nga ka ardhur dhe, kështu, ai do të rritet në Perëndim. Ky është interpretimi i ajetit të Allahut: „Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet. Ai është përcaktim i ngadhënjyesit, të dijsimit”. [36:38]³²⁵*

* Sexhde përdoret për pozicionin kur myslimnai bie përmbys, me ball për tokë ose dysHEME, gjatë lutjes (namazit).

³²⁵ Al-Buhariu, volumni 4, libri 54, numri 421.

Ja si e komenton „shkencëtari” Muhamed ajetin e sajuar prej tij dhe çfarë shkence ofron ai përmes *Kuranit!* Është për të ardhur keq për të gjithë ata që u besojnë broçkullave të tilla dhe i çmojnë për shkencore. Çfarë mendësie e shpërfytyruar duhet të jetë ajo që, pothuajse përditë, mund të konfrontohet në programe televizive, me paraqitje të planetëve dhe me demonstrime virtuale të lëvizjeve të tyre, por, megjithatë, detyrohet t’u besojë këtyre broçkullave kaq primitive?!

Shpesh më ka rastisur të debatoja me besimtarë myslimanë për propagandën e tyre, e cila *Kuranin* e madhëron edhe si vepër bazë për shkencën. Ndoth kjo, sepse *Kurani* tashmë është diskredituar dhe nuk çmohet më për vlera hyjnore, misionare, teologjike, filozofike, socio-logjike, morale, juridike e letrare. Më së shpeshti debatet përqendrohehin në krijimin e planetit të Tokës dhe qiellit. Dhe, për t’i zënë ngushtë myslimanët fundamentalistë, i pyesja: *Kur e ka krijuar Allahu ‘tokën’ dhe ‘qiellin’?*

Meqë shumica e madhe e besimtarëve myslimanë nuk i lexojnë „librat” pararendës të *Kuranit*, po u ofroj të lexojnë çfarë thuhet në rreshtat e parë të “Besëlidhjes së Vjetër”:

¹ Në fillim Jehovahi krijoi qiellin e tokën.

² Toka ishte e shkretëtë dhe e zbrazët; terri e mbulonte humnerën dhe fryma e Jehovahit* endej përmbi ujëra.

³ Jehovahi tha: ‘le të bëhet drita!’ Dhe drita u bë.

⁴ Jehovahi pa se drita ishte gjë e mirë dhe e ndau dritën nga terri.

⁵ Jehovahi e quajti dritën ‘ditë’, kurse terrin ‘natë’. Dhe u bë mbrëmje e mëngjes - dita e parë.³²⁶

Ja qasja fillestare fundamentale e feve abrahamike për krijimin e qiellit dhe të tokës. Patjetër që të dhimbsen besimtarët injorantë dhe

* Emërtimi hebraisht i “zotit”; por përdoret edhe emërtim alternativ: “Elohim”.

³²⁶ Bibla, Besëlidhja e Vjetër, Zanafilla 1:1-5

fatkeq, të cilët ende vazhdojnë t'u besojnë këtyre broçkullave. Por vetëkuptohet, që sajuesit e këtyre broçkullave, misionarët jahudinj, nuk kanë pasur asnjë koncept të saktë për „qiellin” dhe për „tokën”. Ata e kanë menduar tokën të rrafshët, ndërsa qiellin si një kupolë mbi tokë. As për ndriçimin e tokës nuk kanë pasur ide, sepse rezultoi se tokën na e paskësh krijuar Jhv (Jahve / Jehova) para diellit, prandaj paskësh qenë e errët. Dhe po Jehova paskësh urdhëruar të bëhet drita dhe drita na qenkësh bërë. Këtë „ditë të dytë” të krijimit të tokës sajuesit e *Torahës* e kanë shpallur si „Ditën Një” në kalendarin e tyre. Kjo ditë i bie të ketë ndodhur më 6 tetor 3761 p.E.s.

Për t'u informuar sa të paditur duhet të kenë qenë autorët e këtij „libri”, po sjell edhe disa ajetët pasuese, meqë janë bazë për të gjitha fetë e sektet abrahamike.

⁶ *Jehovai tha edhe: „Le të bëhet ndërmjet ujërave kupa e qiellit dhe le t'i ndajë ajo ujërat prej ujërave”.*

⁷ *Jehovai bëri kupën e qiellit dhe i ndau ujërat që ishin nën kupën e qiellit prej atyre që ishin përmbi kupën e qiellit. Dhe u bë ashtu.*

⁸ *Jehovai e quajti kupën e qiellit „qiell”. Dhe u bë mbrëmje e mëngjes - dita e dytë.*

⁹ *Jehovai tha prapë: „Le të bashkohen ujërat, që janë nën qiell, në një vend të vetëm. E le të duket teriku!”.* Dhe u bë ashtu.

¹⁰ *Jehovai terikun e quajti „tokë”, kurse ujërat e bashkuara i quajti „dete”. Dhe Jehovai pa se ishte gjë e mirë.*

¹¹ *Dhe Jehovai tha: „Le të qesë toka bar të gjelbër e bar që qet farë e lëndë frytdhënëse, që jep fryte sipas llojit të vet që ta ketë farën e vet në vetvete përmbi tokë”!* E ashtu u bë.

¹² *Toka qiti barin e gjelbër, barin që qet farë sipas llojit të vet, dhe lëndën frytdhënëse sipas llojit të vet, që ka me vete farën sipas llojit të vet. Jehovai pa se ishte gjë e mirë.*

¹³ *Dhe u bë mbrëmje e mëngjes - dita e tretë.*

¹⁴ *Jehovai tha: „Le të bëhen ndriçues në kupën e qiellit, që ta ndajnë ditën e natën dhe të shërbejnë si shenja për stinë, ditë dhe vite:*

¹⁵ *që të ndriçojnë në kupën e qiellit dhe të ndrisin tokën”.* Dhe u bë ashtu.

¹⁶ *Jehovai bëri dy dritëdhënës të mëdhenj: dritëdhënësin më të madh që të sundojë ditën, e dritëdhënësin më të vogël që të sundojë natën dhe yjet.*

¹⁷ *Jehovai i vendosi në kupën e qiellit që të ndriçojnë mbi tokë,*

¹⁸ që ta sundojnë ditën dhe natën e ta ndajnë dritën prej errësirës. Jehovai pa se ishte gjë e mirë.

¹⁹ Dhe u bë mbrëmje e mëngjes - dita e katërt.³²⁷

Gjithsesi mund të ketë ndodhur, por vetëm kështu jo! Sajuesit nuk kanë pasur asnjë njohuri të saktë lidhur me „qiellin” (Gjithësinë / Kozmosin*). Ata, prandaj, e kanë emëruar „kupë”, sepse ashtu ua shihte syri dhe perceptohej si kupolë. Pastaj, nuk e dinin as se hëna nuk prodhonte fare dritë, por vetëm e reflektonte dritën e diellit.

²⁶ Jehovai tha: „Le ta bëjmë njeriun në shëmbëlltyrën e në përngjasimin tonë që të jetë zotërues i peshqve të detit, i shpendëve të qiellit, i kafshëve, i mbarë tokës dhe i çdo zvarraniku që zvarritet mbi tokë”!

²⁷ Jehovai krijoi njeriun në përngjasimin me veten; krijoi mashkullin e femrën.

²⁸ Jehovai i bekoj dhe u tha: „Shtohuni e shumojuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë! Bëhuni zotëruesit e peshqve të detit, të shpendëve të qiellit dhe të çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë”!³²⁸

Tora na ka ofruar një konfiguracion të zotit, meqë njeriun e paskësh krijuar që t’i përngjasojë atij. Njëherazi e paskësh mandatuar të jetë një si pronar i të gjithave dhe gjithçkaje.

¹ Kështu u krijuan qielli e toka dhe mbarë ushtria e tyre.

² Të shtatën ditë Jehovai e kreu punën e vet që kishte bërë. Të shtatën ditë pushoi nga çdo punë që kishte bërë.

³ Jehovai e bekoj të shtatën ditë dhe e shenjtëroi, sepse atë ditë kishte pushuar prej çdo pune që Jehovai kishte bërë duke krijuar.

⁴ Kjo është zanafilla e qiellit dhe e tokës, kur u krijuan.

[Zanafilla, 2:1-4]

Solla një fragment goxha të zgjeruar të *Testamentit të Vjetër* (TV), meqë këtu e kanë bazën fetë abrahimike, krishterimi dhe islami dhe

³²⁷ *Bibla, Zanafilla* 1:6-19; <http://www.bibla.net/?cid=1,6>

* Emërtim antik “grek” (gjuha e misionarëve dhe filozofëve antikë pellazgë) κόσμος, që e kishte kuptimin e “rendit botëror”.

³²⁸ *Bibla, Zanafilla*, 1:26-28; <http://www.bibla.net/?cid=1, 9>.

sektet e tyre të shumta. I solla për të parë se me çfarë pasaktësie skandaloze startojnë këto fe monoteiste.

Pra, kur Jehovahi tha të bëhet drita, ishte 6 tetori i vitit 3761 p.E.s. Ajo është dita **Një** për kalendarin hebraik. Sipas kësaj rezulton se zoti hebre, Jehovahi, e paskësh krijuar tokën para 5776 vjetësh*. Pse të mos e vlerësojmë këtë rrëfim dogmatik thjesht si gënjeshtër, e sajuar nga njerëzit me vetëdije të atëhershme primitive! Tashmë edhe besimtarët e këtyre feve duhet të jenë të bindur se Planeti ynë, Toka, është krijuar para miliarda vjetësh, por nuk e pranojnë, meqë do të duhej të kundërshtonin TV dhe librat e tjerë pasues(*Testamentin e Ri* dhe *Kuranin*).

Versët pasuese nuk të nxitin as t'i interpretosh e komentosh, meqë janë tepër naive. Megjithatë, të shohim çfarë bëri zoti „ditën e gjashtë“:

Jehovai tha: „Le ta bëjmë njeriun në shëmbëlltyrën e në përngjasimin tonë... [Zanafilla, 1:26]

Dhe Jehovahi krijoi njeriun në përngjasimin e vet...; krijoi mashkullin e femrën. [Zanafilla, 1:27].

Me kë paskësh folur Jehovahi?! Pra, zoti izraelit e krijoi Adamin dhe Evën (të arabizuar nga Muhamedi në Adem dhe Hava). Adami duhet të jetë babai i të gjithë njerëzve të planetit Tokë (vetëm nuk e dimë se si ata i kanë dërguar stërnipërit e tyre në kontinentet e tjera, përtej oqeanëve...).

Interesante është marrëzia, se Zoti e paskësh krijuar njeriun në ngjashmëri me veten e tij. Kjo marrëzi nuk është sajuar kot. Kjo duhet të ketë qenë e motivuar nga egoja e „njeriut“ për ta bërë veten e tij zotërues dhe sundues të gjithçka je mbi e nën tokë.

„Jehovai i bekoi dhe u tha: „Shtohuni e shumojuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë! Bëhuni zotëruesit e peshqve të detit, të shpendëve të qiellit dhe të çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë“! [Zanafilla, 1:28]

* Tani, kur po përfundoi se shkruari këtë libër, është viti 2016.

Ja, Jehovahi e bekoji Adamin dhe Evën që të lindin fëmijë, por pasoi incesti, meqë fëmijët, vëllezër e motra, duhej të bënin seks mes tyre që të ngjiznin fëmijë, sepse ashtu i kishte bekuar Jehovahi. Pra, sipas këtij rrëfimi, rezulton se njerëzit e të gjithë globit zanafillën e tyre e paskëshin në incest mes fëmijëve të Adamit e Evës...

Pak është t'u thuhet këtyre sajime, meqë janë marrëzi perverse!

Tani t'i rikthehemi karakterit 'shkencor' të *Kuranit*, i cili po trumbetohet aq shumë nga propagandistët e tij. Po përqendrohemi në krijimin e planetëve dhe të kozmosit.

Hulumtova *Kuranin*, për të përzgjedhur ajetët që përmbajnë këtë tematikë dhe tani po i paraqes në vijim, me interpretime e komente telegrafike.

Ai, i cili bëri tokën shtrat e qiellin kulm për ju, e prej qiellit ju lëshoi shi... [2:22]

Ai që duhet ta ketë formuluar këtë ajet, sigurisht që nuk mund të sajoni mendime shkencore. „Ai”, në këtë rast, është Allahu, prandaj nuk rezulton që ky ajet të jetë formulim i tij, siç këmbëngulin besimtarët myslimanë. Dhe, për njohuritë e autorit, toka ishte „shtrat”, që do të thotë e rrafshët, dhe qiellin „kulm”, që do të thotë nuk ishte Gjithësi, por kupolë mbuluese e tokës së rrafshët. Nuk e dinte Allahu çfarë kishte formuar, ç'formë u kishte dhënë, ose nuk ka ditur ta formulon, për të na e përcjell ne rrëfimin për „krijimet” e tij?!

Është ai, që krijoi për ju gjithçka që ka në tokë, pastaj vullnetin e vet ia drejtoi qiellit dhe i përsosi ata shtatë qiej. Ai është i Gjithëdijshmi për çdo gjë. [2:29]

Merre me mend, „ai” (Allahu muhamedan), së pari, paskësh krijuar tokën dhe „gjithçka” në tokë. Pastaj, pas gjatë ditëve i qenka drejtuar „qiellit”, nga i cili paskësh sajuar „shtatë qiej”. Ku janë ata „shtatë

qiej” që i paskësh krijuar Allahu?! Muhamedi ose komisioni „redak-tues” i kalifit Utman³²⁹ e kanë përdorur shpesh shprehjen „shtatë qiej”, por edhe „shatë palë qiej”, në sajimet e tyre. Vetëm me këtë pasaktësi kaq primitive, mjafton që *Kurani* të diskualifikohet si „libër” që përmban broçkulla kaq sharlatane. Autori që ka sajuar këto të pavërteta nuk ka qenë në gjendje të sajojë asnjë konstatim shkencor!

As Allahu muhamedan nuk është autor i këtij formulimi, sepse rrëfimi është në vetën e tretë njëjës. Përndryshe do të kishim dy zota: njërin që ka sajuar këtë tekst dhe tjetrin („Ai”), për të cilin flitet se ka sajuar „shtatë qiej”.

Ai është shpikës i qiejve e i tokës e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: „Bëhu!”, në atë moment bëhet.” [2:117]

Në këtë ajet Allahu paskësh „shpikur” qiejt dhe tokën, nuk i paskësh „krijuar”. Sërish qielli është në shumës, meqë Muhamedi ishte i mendimit se ekzistojnë „shtatë qiej” (ose „shtatë palë qiej”, që do të thotë na qenkëshin katërmbëdhjetë qiej). Urdhrin e Allahut „Bëhu!” Muhamedi e ka të kopjuar nga *Testamenti i Vjetër* dhe e ka përsëritur shumë herë gjatë sajimit të ajetëve (ajeteve), shpesh të ngjashme mes tyre.

Po të pyesin ty për hënën e re, thuaj: „Ato janë përcaktime të kohës për njerëz dhe për haxh”. [2:189]

Këtu rezulton sikur Allahu e pakësh krijuar hënën vetëm për të matur kohën dhe për t’i orientuar pelegrinët myslimanë se kur duhet të shkojnë në haxh. As në këtë ajetet s’ka asgjë shkencore!

³²⁹ Ka mendime, që edhe në kohë e pasuesit të Muhamedit, kalifit Ebu Bekër (632-634), para kalifit Utman, u përmblohdhën ajetet e suret që po ruheshin në copa lëkure, pergamene, rrasa guri dhe në mbamendje në një si kodeks, të quajtur arabisht *muşhaf* (مصحف). Por kalifi Utman in Afan (644-656) krijoi një lloj ekipi, që të përmbledhë në formë libri të gjitha ajetet e suret, sepse tani po zgjerohej ekspansioni islam dhe për këtë u duhej edhe doktrina e shkruar.

Vetëm e Allahut është gjithë çfarë ka në qiej e në tokë, Ai fal atë që do dhe dënon atë që do. Allahu është mëkatfalës, mëshirues. [3:129]

Vetëm Allahut i takon sundimi i qiejve e i tokës dhe Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo send. [3:189]

Vetëm të Allahut janë çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë. Allahu ka përfshirë çdo send. [4:126]

Vetëm e Allahut është çfarë ka në qiej e çfarë ka në tokë. (...). [4:131]

Të Allahut janë gjithë çfarë ka në qiej e çfarë ka në tokë... [4:132]

(...)çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur. [4:171]

Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe çfarë ka mes tyre. Ai krijon çdo gjë që dëshiron. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë. [5:17]

...Sundimi i qiejve, i tokës dhe i gjithçka ka mes tyre është vetëm i Allahut dhe vetëm tek Ai është e ardhmja. [5:18]

A nuk di se Allahu është Ai që sundimi i qiejve dhe i tokës është vetëm i Tij, ndaj Ai dënon atë që do dhe fal atë që do... [5:40]

Vetëm i Allahut është sundimi ndaj qiejve e tokës dhe çfarë ka në ta. Ai është i plotfuqishëm për çdo send. [5:120]

Vetëm i Allahut është i tërë sundimi i qiejve e i tokës dhe vetëm tek Ai është e ardhmja. [24:42]

Është sajuar kjo pronësi e Allahut, që të përvetësohet si pronësi vetëm e „Të Dërguarit” dhe besimtarëve të tij. Prandaj muhamedanët kanë këtë koncept për pronën, e kudo që shkojnë, mendojnë se u takon gjithçka atyre. Kurse fjalia pasuese në 3:129 vetëm drejtësi hyjnore nuk përmban, meqë zoti dënuaka dhe falka si t’i teket. Ajetet pasuese janë disa përsëritje primitive, që e diskualifikojnë tekstin e Kuranit si tekst i sajuar nga gjysmanalfabetë *a la*Muhamed...

Këto formulime e përjashtojnë edhe Allahun muhamedan si autor!

Këto konstatime, të ngjashme mes tyre, Muhamedi (ose komisioni i kalifit Utmar) i ka përsëritur deri në monotoni, sipas motos: përsërit gënjeshtren se diç mbetet.

Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. [3:190]

Ky është mendim spekulativ, sepse imponohet si i vërtetë, me kushtëzimin: „Ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt”. Soji im, që nuk gjej asgjë shkencore në *Kuran*, rezulton të jetë i paarsyeshëm dhe i paintelekt, ndërsa besimtarët që i besojnë këto mashtrime, rezultojnë të jenë të arsyeshëm dhe me intelekt!

Çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, atë nuk e di kush pos Tij. Ai e di çfarë ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë që nuk është në librin e qartë. [6:59]

Konstatim spekulativ, aspak shkencor, tipik muhamedan! Meqë qenkëshin të regjistruar në „librin e qartë”, qenkëshin të vërteta. Marrëzi e radhës!

E është Ai që krijoi qiejt dhe tokën me qëllim të caktuar, e ditën kur thotë: „Bëhu”! Ajo bëhet. Fjala e Tij është e njëmendtë dhe Atij i takon sundimi ditën kur i fryhet „Surit”. Ai e di të fshehtën dhe konkretën, është më i urti që di për çdo gjë në hollësi. [6:73]

As vetë Muhamedi ose komisioni i kalifit Utman nuk duhet të kenë qenë të qartë çfarë kanë dashur të thonë. Natyrisht, nuk ka ndonjë gjë shkencore as në këtë ajet.

Kur e pa hënën të porsalindur tha: „Ky është Zoti im!” Kur perëndoi ajo, tha: „Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur!” [6:77]

Ishin arabët paganë, ata që e dinin zotin e hënës si kryezot të tyre, si paraardhësit tanë që e dinin Zeusin për Kryezot. Në flamujt e popujve „islamik” prandaj hëna është simboli i tyre hyjnor. Muhamedi duhet ta ketë admiruar aq shumë atë zot pagan, sa ta ketë shndërruar në kryezot, të cilin e përmban edhe thirrja, tashmë frikësuese: *Allahu akbar* (zoti është më i madhi), *më i madhi nga të gjithë zotat e tjerë*.

As në këtë ajet nuk ka gjë shkencore!

Ai është krijues i dritës së mëngjesit. Natën e bëri kohë pushimi, e diellin dhe hënën për llogaritje të kohës. Ky është caktim i të plotfuqishmit, i gjithëdijshmit. [6:96]

Ky mendim i Muhamedit (natën për pushim) mund të vlerësohet paksa logjik (në kohë e hapësirë), por jo edhe në shkencë. Por „krijimi” i diellit dhe e hënës, me qëllim të llogaritjes së kohës nga njerëzit, është një broçkull ekskluzive muhamedane, aspak shkencore.

Është ai që krijoi yjet për ju, që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det. Vërtet Ne i shpjeguam argumentet tona për një popull që di të mendojë”. [6:97]

Të bën të tallesh kjo broçkull e Muhamedit (ose i komisionit „redaktues” të kalifit Utman), se zoti i paskësh krijuar edhe yjet për t’i orientuar njerëzit në errësirë. Aspak shkencor as ky mendim, i cili ka qenë shekuj përpara i njohur, që kur njerëzit kanë filluar të lundrojnë në det të hapur.

Është ai, që krijoi qiejt dhe tokën, e si do të ketë Ai fëmijë, kur nuk pati grua? Çdo send e krijoi Ai, dhe është më i dijshti për të gjitha sendet e krijuara”. [6:101]

Mendim i stërpërsëritur për krijimin e qiejve dhe të tokës, por sikur është ca cinik ndaj Allahut, kur tallet: “Si do të ketë Ai fëmijë, kur nuk pati grua.” Pra, Allahu që paskësh qenë në gjendje të krijonte tokë e qiej, Adam e Evë, gjithçka që ka në gjithësi, nuk paskësh qenë në gjendje të krijojë edhe fëmijë, sepse nuk kishte grua?!

Patjetër që ndien keqardhje për bashkëqytetarët, të cilët u besojnë edhe të tilla broçkullave muhamedane...

Nuk ka dyshim se ata që përgënjeshtroan argumentet Tona dhe nga mendjemadhësia u larguan prej tyre, atyre nuk u hapen dyert e qiellit dhe nuk do të hyjnë në xhenet deri të përbirojnë deveja nëpër vrimën e gjilpërës. Ja, kështu i shpërblejmë kriminelët.” [7:40]

Qesharake! Ku janë „dyert e qiellit”?! Muhamedi (ose komisioni i kalifit Utman) sikur mendojnë se „kulmi i tokës”, qielli, ka dyer dhe shkallë për t’u ngjitur (përmenden në ajetin 6:35; 70:3-4). Madje në ajetin 70:3 lexojmë një mendim të hamendësuar kuturu:

*Ai dënim vjen nga Allahu, pronari i shkallëve të larta (deri në qiej) [70:3].
Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh,
pastaj qëndroi mbi Arshin. Ai e mbulon ditën me natën, që me të shpejtë e kërkon
atë, edhe dielli, hëna dhe yjet i janë nënshtruar sundimit të Tij. Ja, vetëm Atij i
takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar është Allahu, Zoti i botëve. [7:54]*

Në fakt, Muhamedi nuk duhet t’i ketë mbajtur mend saktësisht sajesat e hebrenjve, me që në *Testamentin e Vjetër* thuhet se ditën e parë zoti krijoi qiellin dhe tokën, pastaj krijoi gjërat e tjera, ditë pas dite, kurse ditën e gjashtë krijoi „Adamin” dhe „Evën”. Ditën e shtatë, nga lodhja, ka pushuar. Të tjera mendime të këtij ajeteti vetëm të vërtetë shkencore nuk e përmbajnë! Nuk kanë shije as si lekturë letrare!

Ai e bëri diellin shndritës, e hënë dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk e krijoi këtë jo për tjetër, pos me qëllim të caktuar. Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton. [10:5]

As në këtë ajet nuk ka asgjë shkencore. Këto janë thjesht hamendësime injorante të sharlatanit Muhamed, i cili nuk kishte idenë për planetët, por ka broçkullitur sikur ata i paskësh krijuar Allahu për t’u shërbyer njerëzve...

(...) Zotit tënd nuk mund t’i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt. [10:61]

Ky sajim i Muhamedit shpërdorohet nga myslimanët spekulantë, sikur *Kurani* informon shkencërisht për atomin, duke u bazuar në „*as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe*”, ndërsa sajuesi i tekstit duhet të ketë menduar edhe gjërat më të vockla.

Ja një spekulim i një islamisti:“*Kurani* e përshkruan në këtë mënyrë, të ekzistuarit e grimcave (atomeve) në një pjesë të ajetit kuranor „...*as sa grimca e as ma e vogël se ajo...*”, qëllimi apo objekti i kësaj pjese të ajetit kuranor është që të jepet përgjigje mbi atomin dhe, njëkohësisht, të tregojë funksionalitetin apo strukturën e tij”.³³⁰ Ja deri në cilin interpretim mashtrues arrihet, kur synohet, gjithsesi, afirmimi i *Kuranit*, edhe si kryevepër shkencore!

Është ai, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditëve, e Arshi (Froni) i Tij kishte qenë (më parë) mbi ujë, që t'ju sprovovë se cili prej jush është më vepërmirë... [11:7]

Edhe ky mendim po përsëritet, por siç sqarova, në ajetin 41:9 thotë se ai i ka krijuar për dy ditë, qiejt dhe tokën. Merre me mend, Muhamedi (ose komisioni i kalifit Utman) është i mendimit se Allahu paskësh pasur „arshin (fronin)”, ku tjetër, pos „mbi ujë”, edhe pse në një ajetet tjetër thuhet se gjetja përpara se Allahu ta krijonte tokën e shtatë qiej ishte e „tymtë”. Sikur Muhamedi është tallur edhe me Allahun e tij, duke sajuar edhe këso broçkullash! Po vetëkuptohet, aspak shkencore, por as hyjnore e mkisionare!

Allahu është Ai, që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë... [13:2]

Këtu Muhamedi përshfaq gjithë injorancën e tij „shkencore”, kinse qielli është çatia (kulmi / kupola) e tokës dhe mrekullia qenkësh se gjithë ajo kupolë qëndron sipër tokës pa ndonjë shtyllë mbajtëse. Nuk do mend të thuhet se Muhamedi nuk e kishte fare idenë që toka është një planet sferik nga miliarda të tjerë, që „noton” në Gjithësi.

³³⁰ <http://www.elbuhari.at/html1/kurani-dhe-shkenca/346-atomi>.

Dhe ne kemi bërë në qiell sisteme jvesh dhe kemi zbuluar për shikuesit.[15:16 / shq. Feti Mehdiu]

Shqipëruesi Mehdiu përdor „sistem jvesh”, ndërsa shqipëruesi Nahi përdor shprehjen „hyllësi”, që „qenkëshin krijuar“ për dekor. Në gjermanisht kemi krejtësisht shprehje të tjera. Këtu s’ka gjë profetike, edhe nëse është autor „profeti” Muhamed. I bie sikur Allahu i tij i paskësh sajuar yje vetëm për ta zbuluar qiellin, që ta kënaqte syrin e njeriut...

Dhe atë (qiellin) e kemi ruajtur prej çdo djalli të mallkuar. [15:17]

No comment! - siç thonë anglishtfolësit në raste të ngjashme.

Ky formulim i Muhamedit duhet të jetë i motivuar nga mendësia e tij, se qielli si „kupolë”, pa shtylla, e ka ruajtur Allahu për të mos e shembur ndonjë *djall* i mallkuar.

Mjeruese! Vetëm besimtarët injorantë mund të besojnë se Allahu na qenkësh autor i këtyre broçkullave „shkencore”!

Dhe Ai vuri kodra (të forta) në tokë, ashtu që ajo të mos lëkundet me ju, (bëri) edhe lumenj e rrugë që të mund të orientoheni.” [16:15]

Mendim tejet „shkencor” i Muhamedit (edhe pse tërmetet, fatkeqësisht, po përsëriten së tepërmi.)! Deri tani na mungonte informimi, se Allahu paskësh ndërtuar edhe rrugë, jo për rrugëtim të njerëzve, por për orientim (edhe pse nuk ka asnjë dëshmi konkrete se Allahu ka hapur e ndërtuar ndonjë rrugë). Formulim primitiv, qesharak!

Deri kur arriti në vendpërdimin e diellit, e gjeti se po perëndon në njëfarë burimi me lym të zi dhe aty e gjeti një popull. E Ne i thamë: „O Dhulkarnejn, ose do t’i dënosh, ose do t’i marrish me të mirë e t’i udhëzosh!” [18:86]

Interpretimi i kësaj përmbajtjeje çon në përfundimin se kupa e qiellit, në „skaj”, puqet ose peshon mbi tokën...

Shumë islamologë janë të mendimit se „Dhulkarnejn” (Dybrirëshi) është Aleksandri i Madh, të cilin egjiptianët e kanë madhëruar e legjendarizuar shumë, meqë ai i ka çliruar nga pushtimi pers, u ka dhënë vetëqeverisje demokratike (sipas udhëzimeve të mësuesit të tij, Aristotelit) dhe kryeqytet të botës ka caktuar Aleksandrinë. Por, zbrëthimi i fragmentit që ka të bëjë me „Dhulkarnejnin”, dëshmon se Muhamedi e ka rrëfyer historinë përçart, sipas gojëdhënave, meqë nuk duhet të ketë pasur njohuri të mirëfilltë as për ngjarjet historike të përmasave botërore.

*A nuk e dinë ata (mohues), të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?
[21:30]*

Ndonjë interpretues spekulant, në rastin konkret islamologu Edip Yuksel³³¹, thotë se ky ajet dëshmon teorinë e „big-bangut”, meqë e paraqet tokën të bashkuar me „qiej”, si univers nga „masa e dendur kozmike”, e cila „plasi” para 10-15 miliardë vjetësh dhe krijohen galaktikat.

Rëndom, formulimet e përçarta të Muhamedit u japin mundësi besimtarëve të spekulojnë se *Kurani* është bazë për shkencë, si në rastin e ajetit të sipërcituar, edhe pse në ajet tekstualisht shkruhet se „*qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja*”. Për Muhamedin ekzistonin „qiej” të bashkuar me „tokën” dhe Allahu na i paskësh ndarë në „tokë” dhe në „shtatë palë qiej” ose „shtatë qiej”, të cilët janë të vendosur si „kulm” mbi tokë. Kurse në ajet precizohet vetëm ndarja e dy „gjërave”: qiejve (që sistemohen si një njësi) dhe tokës. Vetëm

³³¹ <http://www.alrahman.de/wissenschaftliche-wunder-im-koran/>.

Kjo web-faqe është e një OJQ-je islamike, e regjistruar në Roschach të Zvicrës; përgjegjës për përmbajtje, sipas § 55 Abs. 2 RStV, Zafer Adigçzel.

propaganduesit spekulantë e mashtrues të *Kuranit* nga ky ajetet mund të sajojnë „big-bang” dhe shkencë. Viktima të mjera!

Qiellin ua kemi bërë kulm të sigurt, por ata zmbropsën prej atyre argumenteve.[21:32]

Tashmë edhe më troç: Muhamedi mendon se qielli është tamam një kulm mbi tokë, pra një si kupolë, që puqet me tokën në „vendperëndimin” e diellit (ajeti18:86), rrjedhimisht edhe në „vendlindjen” e tij. Kur *Kurani* ka të tillë ajet, dhe plot si ky, si mund t’i jepet atij epiteti shkencor?! Megjithatë islamologu Edip Yuksel, përmes spekulimeve, gjithsesi do t’i sigurojë *Kuranit* edhe përmbaje shkencore.

Ne lëshuam me masë ujë nga qielli dhe atë e përqendrojmë në tokë. Po Ne kemi mundësi edhe ta humbim atë (ujin).[23:18]

Përsëritje tashmë monotone për atë që merret me analizë kritike të *Kuranit*, kurse për myslimanin, kjo përsëritje është ekzaltuese. Shihet se Muhamedi nuk e ka e kuptuar as procesin e avullimit të ujit dhe rikthimin e tij në ujë. Ai mendon se zoti „e humb” (ujin) kur të dëshirojë. Nuk e kishte as idenë se diku tjetër shiu është i tepërt dhe i mërzitshëm, kurse në shkretëtira mungonte, që do të thotë as në veri të Planetit dhe as në Ekuator nuk lëshonte ujë me masë...

A nuk e sheh se si Zoti yt e zgjati hijen, e sikur të kishte dashur do ta linte në një vend, pastaj diellin e bëmë rrëfyes të saj. [25:45]

Merre me mend, ai nuk e kishte idenë as si krijohet hija e trupave në tokë dhe si „ka lëvizur” ajo. Pra, nuk e ka ditur se toka ka lëvizur rreth „boshtit” të saj dhe ajo lëvizje e ka prodhuar „lëvizjen” e hijes, që do të thotë dielli nuk ishte rrëfyes i hijes. Vërtet pseudoshkencor!

Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe si frikë, edhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shi e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë

ka argumente për një popull që di të mendojë. [30:24]

Muhamedi nuk duhet ta ketë njohur as procesin e rrufesë. Ai prandaj nuk ka mundur të sajojë ndonjë mendim shkencor as për vetëtimën.

Ai i krijoi qiejt pa shtylla... [31:10]

Sërish përsëritje, se kupolat e qiejve që rrinë sipër tokës, pa shtylla, dëshmojnë se sa injorant duhet të ketë qenë Muhamedi.

Allahu ju krijoi prej dheu, mandej prej një pike uji, e pastaj ju bëri çift. E asnjë femër nuk bart e as nuk lind ndryshe, vetëm se me dijen e Tij, dhe nuk i jepet kujt të jetojë gjatë ose t'i shkurtohet jeta e tij, vetëm sa ajo është e shënuar në Libër (Levhi Mahfudh), e kjo për Allahun është e lehtë. [35:11]

Edhe nga ky ajet islamologu Edip Yuksel sajton përmbajtje shkencore: „Gjatësia e jetës sonë biologjike është e përcaktuar në gjenet tona”.³³² Këtë sajësë të këtij dietari islam nuk e përmban ky ajet. Aty po thuhet se jetëgjatësia e njerëzve është fiksuar në „Libër” (Levhi Mahfudh)”.³³³ Pra, kjo është çështje (mos)besimi. Përndryshe, i bie që njerëzit më kot mjekohen për të mos vdekur „para kohe”, sepse jetëgjatësia na qenkësh e paracaktuar nga Allahu. Ose, më kot prodhohen barna kundër shtatzënisë, sepse (mos)lindjet ndodhin vetëm me dijeni e Allahut dhe jo si shkak i tundimeve të epsheve seksuale të çiftve...

Edhe dielli udhëton për në kufirin e vet. Ai është përcaktim i ngadhënjyësit, të

³³² <http://www.alrahman.de/wissenschaftliche-wunder-im-koran/>.

³³³ Për “Libër (Levhi Mahfudh)” (dez)informohet në hadithen vijuese:

Hafidh Ebul Kasim Et-Taberani transmeton nga Ibn Abasi (radio Allahu ‘anhu), se I Dërguari i Allahut Sal-Allahu ‘alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Me të vërtetë Allahu e ka krijuar Pllakën të ruajtur me kujdes (Levhi-Mahfudh) nga perla të bardha, faqet e saj janë nga rubini i kuq, kalemi i tij është dritë (nur), shënimet e tij janë dritë, Allahu për çdo ditë ka treqind e gjashtëdhjetë momente, në të cilat krijon dhe jep fuqizim, merr jetë dhe jep jetë, është Ai që rrezon dhe që ngre e bën atë që Ai do.”

Këtë hadithe e gjeni në:

<http://xhamiambret.com/levhi-mahfudh-pllaka-nga-perla-te-bardha.bismillah>.

dijshmit. [36:38]

Ky ajet dëshmon mungesën e njohurive të Muhamedit, në rastin konkret, për diellin. Ai kishte mendim „shkencor” të „udhëtimit” të diellit „për në kufirin” e tij, që do të thotë se dielli „qenkësh ngritur” nga „lindja”, ku janë puqur toka e rrafshët me kupën e qiellit dhe „ka udhëtuar” deri në „perëndim”, në vend-puqjen e tokës me qiellin. Ndërsa orientimin veri dhe jug, *Kurani* nuk e përmban. Ka mundësi që beduinët nuk i kanë njohur fare. Edhe hatithja në fillim të këtij kapitulli sqaron se Muhamedi vërtet ka qenë tepër i paditur për njohuritë rreth Gjithësisë.

Vërtet, Ne kemi stolisur qiellin më të afërt me bukurinë e yjeve. 37:6

Tashmë, sipas formuluesit të këtij ajeteti, Allahu vetë paska thënë se i ka formuar yjet vetëm sa për ta stolisur qiellin (këtë të parin, nga të shtatë, që e „mbulon” tokën). Në një rast tjetër, Muhamedi thotë se yjet janë formuar për t’i ndihmuar njerëzit që të orientohen. Këto përmbajtje të bindin se autorët e *Kuranit* nuk duhet të kenë pas asnjë njohuri të saktë shkencore.

Mandej ia mësyu qiellit, e ai ishte tym, e atij dhe tokës u tha: „Qasuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!” Ata të dy thanë: „Po, i qasemi me dëshirë!” [41:11]

Bëhen spekulime, sikur „yjet dhe galaktikat janë krijuar nga tymi”, siç e interpreton këtë ajet islamologu Edip Yuksel³³⁴. Vetëm besimtari pasionant e gjen që, nga ky qiell „tymnajë” na qenkëshin formuar yjet dhe galaktikat. Ndoshta po vetëkuptohet se „tokën” tashmë e kishte krijuar Allahu para se t’ia ketë „mësy qiellit”, i cili paskësh qenë tym, ndërsa toka **nuk** paskësh qenë pjesë e atij tymi. Në një ajet tjetër të

³³⁴ <http://www.alrahman.de/wissenschaftliche-wunder-im-koran/>

cituar më lart thuhet se, para krijimit të qiejve e tokës, Allahu qëndronte mbi ujë.

Në ajet është edhe një mendim naiv, si ky: Allahu ia „mësy qiellit”. Ku ishte ai? Jashtë „qiellit”? Populli do të thoshte, për raste të ngjashme: *mos u përpiq të shtrydhësh pleshtin për të nxjerrë dhjamë, që do të thotë: kot përpiqet myslimani Yuksel të zbulojë në këtë ajet mendimin shkencor se „yjet dhe galaktikat janë krijuar nga tymi”*. Ky, me gjasë, nuk di të bëjë as dallimin mes tymit dhe gazrave, prandaj e përdor termin *tym*, vetëm se e ka përdorur Muhamedi në ajetetin e cituar.

Meqë është ajetet „shkencor” dhe meqë po më brengos shqipërimi nga Sherif Ahmeti, po sjell në fusnotë në variantin tjetër, shqipërimin nga Hasan Efendi Nahi, dhe përkthimin që po e bëj nga gjermanishtja. Krahasimet japin dallime serioze mes këtyre tri varianteve.³³⁵

Dhe ai i krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktoi atë që i nevojitej. Qiellin më të afërt (të Dynjasë) Ne e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i plotfuqishmit, të dijshtmit.” [41:12]³³⁶

Tani Muhamedi përcaktohet për krijimin e shtatë qiejve brenda dy ditëve, edhe pse në një mori ajetesh është thënë se janë formuar brenda gjashtë ditëve. Me cilën shkencë mund të arsyetohet formimi i shtatë qiejve? Ku janë ata shtatë qiej? I lejohet „zotit” „të gjithëditur” të jetë kaq i paditur?!

³³⁵ “Pastaj, vendosi (të rregullojë) qiellin, e ai ishte në gjendje mjegullore, e i tha atij (qiellit) dhe Tokës: “Dukuni (ejani të përlulur) me dashje ose me dhunë!” e ata u përgjigjën:

“Erhëm vullnetarisht!” [41:11 / shqipërim nga H. E. Nahi]

Shqipërimi nga Kurani në gjermanisht:

“Atëherë ai iu drejtua qiellit, i cili ende ishte mjegull, dhe i foli atij dhe tokës: “Ejani ju të dy, me dëshirë ose pa dëshirë”. Ata folën: “Po vijmë me dëshirë”.

³³⁶ Sërish shqipërimi nga Hasan Nahi:

“Dhe Ai krijoi (të jenë) shtatë qiej në dy ditë (periudha kohore), dhe çdo qiell i caktoi detyrat e tij. E, qiellin më të afërm e kemi zbuluar me yje të shkëlqyera dhe i ruajmë ato. Kjo është dispozita e të Plotfuqishmit dhe të Gjithëditshmit.” [41:12]

Ne krijuam qiejt e tokën dhe gjithçka ka ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh dhe Ne nuk ndiem lodhje. [50:38]

Stërpërsëritje monotone, formulime tepër primitive! Edhe këtu rezultojnë sharlatanizmi i Muhamedit, meqë tani e përsërit atë që duhet ta ketë ditur nga *Testamenti i Vjetër*. Atje shkruhet vetëm për një qiell, ndërsa Muhamedi këtu sajton shtatë qiej. Edhe atje shkruhet se Jehovahi i ka krijuar të gjitha brenda gjashtë ditëve, edhe Muhamedi i përmbahet gjashtëditëshit. Ndonjëherë, me pasaktësi, shprehet për krijim e çdo gjëje brenda dy ditëve (si në ajetin 41:12). Sërish cinizmi ndaj Allahut: „*Ne nuk ndiem lodhje*”.

Por problematik është fakti, se myslimanët e angazhuar nuk pajtohen me doktrinën e jehudinëve dhe kalendarin e tyre, sepse janë të kompleksuar pse Muhamedi ka kopjuar aq shumë nga Tora. Ta zëmë, toka, qielli, gjallesat, bimët etj., dhe „njeriu i parë”, sipas Torës dhe kalendarit judaist janë krijuar për gjashtë ditë, tamam më 4-10 tetor 3761, p. e. s. Edhe Muhamedi orientohet njësoj, por me disa „devijime”, si pasojë e përshtjellimeve autentike dhe pretendimit, gjithsesi, për t’u imponuar origjinal. Ta zëmë, Muhamedi gjatësinë e ditës e relativizon. Herë e paraqet të gjatë një mijë vjet, herë pesëdhjetë mijë. Edhe sikur të pranoheshin si të vërteta të dy këto variante, sërish nuk do të ishte shkencore të pranohet se toka, e krijuar për dy ose gjashtë ditë, qenka krijuar para dhjetë ose treqind mijë vjetësh (nëse ditët i shumëzohjmë me pesëdhjetë mijë), respektivisht me shumën që do të rezultonte sikur ditën ta llogarisnim një mijë vjet.

Islamologu Edip Yuksel, gjithsesi, edhe këtij ajeti do t’i japë karakter shkencor, prandaj e interpreton si vijon: „Universi është krijuar në gjashtë faza, kurse jeta në planetin tokë është mundësuar në katër fazat e fundit”.³³⁷ Pra, sipas këtij islamologu, dita që përmban ky ajet nuk është ditë, por është fazë, që zgjat njëmijë ose pesëdhjetëmijë vjet, siç përkufizohet në ajetet 70:4; 22:47; 32:5.

³³⁷ Po aty.

Tani shtrohet dilema: duhet të bazohemi në përmbajtjen tekstuale të *Kuranit* apo në interpretimet spekuluese të besimtarëve të tij? Unë po bazohem në tekstin e *Kuranit*, kurse interpretimet e komentet e myslimanëve po i sjell vetëm për ilustrim, për të dëshmuar se çfarë është në gjendje të mendojë besimtari, i cili është i privuar nga mendimi autonom kritik.

*Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë, [51:47]
edhe tokën Ne e kemi shtruar, sa shtrues të mirë jemi.” [51:48]*

Islamologu Edip Yuksel sërish e interpreton spekulueshëm ajetin 51:47, sikur ai ajet përmban kuptimin: „Galaktikat në universin tonë ekspandojnë”.³³⁸

Konsultova këtë ajet, të përkthyer në gjuhën gjermane, meqë ky islamolog, me emër tipik turk, është i angazhuar në Zvicër dhe propagandon islamin në gjuhën gjermane (si islamistët imigrantë shqiptarë atje). Po e sjell këtë ajet në gjermanisht dhe të shqipëruar nga gjermanishtja: „*Und den Himmel haben Wirerbaut mit (Unseren) Kräften, und Unsere Kräfte sind wirklich gewaltig*”. „*Dhe ne e ndërtoam qiellin me forca (tona), dhe forcat tona janë jashtëzakonisht të fuqishme*”.

Dallimet e përkthimit në gjermanisht, me shqipërimin e Sherif Ahmetit janë aq të mëdha, sikur të mos bëhet fjalë për të njëjtin ajetet.

Tani po sjell edhe shqipërimin e Hasan E.Nahit: „*Ne e kemi ndërtoar qiellin me pushtetin Tonë, e Ne, me të vërtetë, jemi të pushtetshëm edhe më tepër.*” Përkthimi i Hasan Nahit i për afrohet më shumë përkthimit në gjermanisht, sesa përkthimi i Sherif Ahmetit. Por, në asnjërin variant të përkthimeve nuk rezulton interpretimi i Yukselit: „galaktikat në unin tonë ekspandojnë (zgjerohen)”. Nuk besoj se në gjuhën arabe të shekullit 7 kanë ekzistuar emërtimet „galaktika” dhe

³³⁸ Po aty.

„univers”, siç spekulon ky islamolog. E si do të mund të sajonte „analfabeti” Muhamed një mendim kaq shkencor, siç interpreton Yukseli, kur në fjalinë pasuese shprehet: „*edhe tokën Ne e kemi shtruar, sa shtrues të mirë jemi*”. Pra, Muhamedi nuk e kishte idenë se toka, në të cilën rronte dhe ecte përditë, është sferike, e shtypur paksa në „pole”, por e paraqet të shtruar/rrafshët, duke u tallur me Allahun e tij, kur ia vesh mendimin „sa shtrues të mirë jemi”.

Pasha kulmin e ngritur! [52:5]

Edhe sikur ta shihnin që u bie nga qielli ndonjë copë, ata do të thoshin: „Është re e dendur!” [52:44]

Formulime tepër primitive. Metaforat e përdorura nuk përmbajnë ndonjë shije të veçantë letrare. Dhe do të ishte befasuese, sikur „analfabeti” Muhamed, gjithashtu edhe analfabetët ose gjysmanalfabetët e tjerë, pjesëtarë të komisionit të kalifit Utman (edhe vetë Utmani ishte analfabet), të ishin në gjendje të prodhonin formulime letrare. Pra, në ajetin 52:5, Muhamedi betohet në „kulm të ngritur”, sepse vërtet mendonte se ai ishte kulm (çati, kupolë), që e mbulonte tokën e rrafshët. Kurse në ajetin 52:44 ai tallet me „jobesimtarët”, siç i quante arabët paganë. Populli ynë ka një proverb, që ndoshta i shkon kësaj ironie të Muhamedit: „I talluri të tall”.

Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë. [55:5]

Edhe yjet, edhe bimët i bëjnë përrulje. [55:6]

Muhamedi duhet ta ketë thënë shumë herë, se dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë (po u bazuam në shqipërimin e Sherif Ahmetit). Sipas përkthimit të Hasan Nahit, ky „udhëtim i saktë” nuk rezulton. Ja shqipërimi i Hasanit: „*Dielli dhe Hëna sipas llogarisë së caktuar, edhe bimët dhe drunjtë i përrulen*”. Pra, në shqipërimin e Hasanit, Muhamedi nuk përmend lëvizjen dhe as udhëtimin e diellit dhe të hënës.

... Ne e kemi zbritur edhe hekurin që në të ka forcë të fortë dhe dobi për njerëz, e edhe për t'u ditur tek Allahu se kush ndihmon Atë dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës... [57:25]

Në këtë fjali të këtij ajeti, islamologu Yuksel identifikon mendimin „shkencor”: „Numri rendor, masa atomike dhe numrin e neutroneve të izotopeve të elementit hekur bëhen të ditur³³⁹. Marrëzi spekuluese koti! Aty thuhet se hekuri është dërguar, por pa ndonjë të dhënë tjetër, që e sajton ky spekulant mysliman. Muhamedi duhet të jetë bazuar në mendimin e kohës, se hekuri zbret nga qielli, meqë në kohë të vjetra ai është përfituar nga copa të meteorëve, të përplasur në tokë.

Allahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej dhe prej tokës aq sa ata... [65:12]

Këto shtatë palë qiej e shtatë palë tokë nuk dihet pse dhe si i janë fiksuar Muhamedit injorant!? Shkenca nuk ka njohuri për „shtatë palë qiej” e as për „shtatë palë tokë”. Megjithatë, islamologu Edip Yuksel bën një shpërdorim pikant, për t'i dhënë karakter shkencor edhe këtij ajeti: „Atomët e elementeve, të cilat përbëjnë tokën, kanë maksimalisht shtatë rathë energjike”. Vetëm besimtarit i lejohet një kësi spekulimi, por përmbajtja tekstuale e ajetit nuk përmban asgjë shkencore.

Ne qiellin më të afërt e kemi zburuar me kandila dhe ata i kemi bërë gjuajtës kundër djajve, të cilëve u kemi përgatitur dënim me zjarr shumë të madh. [67:5]

Muhamedi duhet të ketë qenë në gjendje të mirë humori, kur ka formuluar këtë ajetet aspak shkencor.

E qielli çahet, pse Ai atë ditë është i rraskapitur. [69:16]

³³⁹ <http://www.alrahman.de/wissenschaftliche-wunder-im-koran/>

Muhamedi ditka të formulojë edhe humor të zi. Pra, „qielli çahet, sepse atë ditë” Allahu i tij „është i rraskapitur”. Aspak serioze dhe aspak shkencore!

Të shohim shqipërimet e tjera të këtij ajeti, ndoshta kanë ndonjë kuptim. Sipas Hasan Nahit: “*Dhe do të çahet qielli, e atë ditë do të jetë i thyeshëm*”. Ndërsa sipas Feti Mehdiut: “*Edhe qielli do të çahet. Atëherë ai do të jetë i thyeshëm*”. Secila nga variantet e shqipëruara rezulton të jetë primitive.

Ata kërkojnë prej teje t’ua ngutësh dënimin, po Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt është sa një mijë vjet, si llogaritimi ju. [22:47]

Është ai që udhëheq çështjen prej qiellit në tokë, pastaj ajo ngrihet tek Ai në një ditë që, sipas llogarisë suaj, është sa një mijë vjet. [32:5]

Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) në një ditë që zgjat pesëdhjetë mijë vjet [70:4].

Në këto tri ajete me përmbajtje të përcarta dhe kundërthënëse, islamologu EdipYuksel gjen mendimin shkencor, se „koha është relative”.³⁴⁰ Nuk jam i informuar nëse ndonjë islamolog e ka diskredituar Albert Einstein (Ajnshtajnin) si kopjues të Teorisë së Relativitetit nga *Kurani*?! Por tashmë nuk po kuptoj cilat ditë duhet të kishte parasysh „analfabeti” Muhamed, kur i ka sajuar këto ajete, të cilat, për hir të imponimit, ia mvësh autorësinë Allahut të tij?! Në dy ajetet, *dita zgjat nga një mijë vjet*, kurse në ajetin tjetër: *dita zgjat pesëdhjetë mijë vjet*, ka dallime të mëdha. E se ku ngjiten engjëjt dhe shpirti, kur ai përdor vendin „atje”, vetëm Muhamedi e merr vesh!

Në ajetin pararendës 70:3, Muhamedi ka sajuar edhe ca shkallë: „*Ai dënim vjen nga Allahu, pronari i shkallëve të larta*”. Këto „shkallë” i hasim disa herë në *Kuran*, sepse Muhamedi është i mendimit, se në skajin/ cepin e tokës së rrafshët, ky qiell si kupolë takohet me tokën, janë shkallët për t’u ngritur në „shtatë qiejt” (muhamedanë). Këto sajime jo vetëm që nuk janë shkencore, por janë aq naive, sa të bëjnë vërtet të ndiesh keqardhje për ata që u besojnë.

³⁴⁰ <http://www.alrahman.de/wissenschaftliche-wunder-im-koran/>.

Po të tilla „ditë”, një mijë dhe pesëdhjetë mijë vjeçarë, i shpërdorjnë disa myslimanë të angazhuar, kur duan të korrigjojnë *Torën*, e cila thotë se në „ditën e parë” (të 4 tetorit 3761, p. e. s., përkatësish në Ditën Një, sipas kalendarit judaist), zoti e ka formuar tokën. „Dita” e „krijimit” të tokës, sipas këtyre myslimanëve, zgjat pesëdhjetë mijë vjet. Edhe „dita e gjashtë”, kur zoti ka krijuar „njeriun e parë” (Adamin), duhet të ketë zgjatur pesëdhjetë mijë vjet, myslimanët belbëzojnë kur u thuhet se nuk është e mundur që Adamin e tyre ta ketë krijuar Allahu islam, vetëm para 5775 vjetësh.

Dita kur qielli të bëhet si kallaji i shkrirë. [70:8]

Profeci muhamedane, që nuk meriton të injorohet.

A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej (në kate).[71:16]

Allahu juve ua bëri tokën të sheshtë. [71:19]

Që të ecni nëpër rrugë të gjera. [71:20]

Përmbajtje e stërpërsëritur. Këtu kemi edhe një herë „shtatë palë qiej (në kate)”. Në një ajetet tjetër vetëm „shtatë qiej”. Dallimi dhe kundërthënia janë goxha skandaloze. Për të kursyer bezdisjen e lexuesve, nuk po sjell variante të tjera të shqipërimeve, për të bërë krahasime.

Se sa shkencor ka qenë Allahu i Muhamedit, gjegjësisht vetë Muhamedi, e shohim në mendimin: „*Allahu juve ua bëri tokën të sheshtë*”. Edhe sot e kësaj dite ka mendimtarë, që besojnë se toka është e sheshtë. Madje para ca kohësh një klerik (i shpifur), tepër autoritativ, në Arabinë Saudite (ministër për Fenë), qe prononcuar se, ata që thonë se toka është e rrumbullakët, duhet të ndëshkohen. Kur zoti muhamedan, gjegjësisht Muhamedi, konstaton se toka është e sheshtë, atëherë nuk kemi pse të kërkojmë mendime shkencore në *Kuran*, sepse do t'u ngjasojmë myslimanëve injorantë...

Dhe vërtet, ne kemi hulumtuar ta arrijmë qiellin, po atë e gjetëm përplot me roje

të forta dhe me shkëndija. [72:8]

Në këtë përmbajtje nuk kuptohet kush është „ne”. Ndërsa qiellin (cilin?) me roja mund ta prodhojë vetëm fantazia primitive e Muhamedit primitiv. Kur kemi edhe kësi ajetësh që përmbajnë këso broçkullash, ku qielli ruhet nga „roja”, nuk mund të pritret shkencë në *Kuran*, pos injorancë dogmatike. Pastaj, është tepër absurd teksti, që Allahun nuk e paskëshin lejuar „rojat” të ngjitet në qiell...

Atë ditë qielli do të çahet dhe premtimi i Tij do të realizohet. [73:18]

E të zihet hëna (errësohet). [75:8]

Dhe të bashkohen dielli e hëna. [75:9]

Atë ditë njeriu do të thotë: „Nga të iket!“ [75:10]

Jo, nuk ka strehim! [75:11]

Atë ditë vetëm te Zoti yt është caku! [75:12]

Dhe qielli hapet e bëhet dyer-dyer. [78:19]

Profeci ogurzeza të Muhamedit, të sajuara për t’i mbajtur të frikësuar e të nënshtruar besimtarët, përmes kërcënimesh të tilla. Muhamedi nuk e ka as idenë si „zihet” hëna, e as për çfarë „bashkimesh” në mes të diellit dhe hënës bëhet fjalë, kur hëna gjendet e pozicionuar në mes të diellit dhe tokës. Ndërsa hapja e diellit dhe bërja e tij dyer-dyer jo vetëm që nuk është shkencor, por është një formulim kaq primitiv, sa vërtet nuk i ka hije profetit!

E pastaj e rrafshoi Tokën. [79:30]

Sërish këtë ajet (në përkthimin gjermanisht: „*Ndërkohë, tokën e zgjeroi*”), disa myslimanë spekulantë e përshtatin: „*E pastaj tokën e vezoi / sferoi*”. Pra, spekulimi përqendrohet të folja *sheshoi / zgjeroi*, të cilat mund të ishin: *vezoi / sferoi*. Citojmë: „Në ajetin e mësipërm, fjala *daha* përdoret në arabishten origjinale. Ajo, e përkthyer si *sheshoi*, rrjedh nga fjala *dahv*, që do të thotë edhe *zgjeroj*. Edhe pse fjala *dahvdo* të thotë gjithashtu *për të mbështjellë* apo *për të përcaktuar*,

domethënia e foljes është më shumë se vetëm një prozaik përcaktues, pasi ai përshkruan përcaktimin në një rreth. Koncepti i formës qarkore është gjithashtu i pranishëm në fjalët e tjera që rrjedhin nga *dahv*.³⁴¹ Është e njëjta logjikë e përpjekjes për tjetërsim të këtij ajeteti deri në atë trajtë, sa tokën e sheshtë, siç është në origjinal, e tjetërsojnë në *tokë vezore / sferike*, që e gjejmë në shumë portale të tjera, në gjuhë të ndryshme. Por siç pamë, ajeteti 18:86 dhe ajetetet e tjera e paraqisnin tokën të sheshtë, të mbuluar me kupolë (qielli), që Allahu e mban pezull, pa shtylla, por që takohet me tokën në skajet e saj.

Të shohim tani çfarë ofron libri i një mjeku francez, dr. med. Maurice Bucaille³⁴², me titull: „*Bibla, Kurani dhe shkenca*”, meqë këtë libër e propagandojnë shumë aktivistët myslimanë. Ky libër është botuar në Francë në vitin 1976 dhe tashmë është përkthyer edhe në shqip.

Këtë libër e kam shfletuar në Shkup, por tani e gjeta edhe variantin elektronik³⁴³. Qysh atëherë krijova mendimin se mjeku francez Bucaille (1920-1998) ishte një njeri ekzotik, i cili qe shndërruar në propagandist i angazhuar i islamit. Më rezultoi se kjo duhet të ketë ndodhur për përfitime financiare dhe afirmim. Ai ishte mjek personal i Mbretit të Arabisë Saudite, Fajsal. Këtë dyshim ma forcon edhe prononcimi i tij vijues:

Në asnjë rast nuk ekziston as më i vogli kundërshtim mes tekstit kuranor dhe njohurive shkencore bashkëkohore mbi krijimin e gjithësisë. Unë e përsëris vlerësimin tim, se qëndrimet shkencore të Kuranit janë dëshmi,

³⁴¹ <http://www.elbuhari.at/html1/kurani-dhe-shkenca/414-forma-sferike-e-tokes>.

³⁴² Në vitin 1973 mjeku Bucaille u punësua si mjek personal i Mbretit të Arabisë Saudite Fajsal. Më gjerësisht në:

<http://coran-bible.over-blog.com/article-maurice-bucaille-biographie-113361879.html>

³⁴³ [http://www.bibladhekurani.com/libraria_b_k/Bibla,Kurani dhe shkenca.pdf](http://www.bibladhekurani.com/libraria_b_k/Bibla,Kurani_dhe_shkenca.pdf).

*në tekstin e tij nuk është futur dora e njeriut, por ai tekst është Shpallje Hyjnore, për të cilin s'ka dyshim.*³⁴⁴

Asnjë përfitim financiar nuk e arsyeton mjekun Bucaille të gënjejë kaq trashë. Në tekstin e *Kuranit* jo vetëm që është futur dora e njeriut, por i tëri është i sajuar nga „profeti” Muhamed dhe nga bashkëveprimtarët e tij, nga ekipi i kalifit Ebu Bekri, nga komisioni enkas për sajimin e *Kuranit* të kalifit Utman dhe „redaktorëve” të mëvonshëm, deri te varianti aktual zyrtar, „i redaktuar” nga Uniteti Islam „Al-Azhar“ i Kajros, në vitin 1924 (me urdhër të mbretit të atëhershëm egjiptian). Pra, asnjë gërmë e tij nuk është pjesë e tekstit, të një shpalljeje hyjnore të formuluar nga Allahu. Ndërsa sa i përket përmbajtjes (pseudo)shkencore, dëshmojnë ajetetet që i prezantova, interpretova e komentova. Në *Kuran* vetëm mendime shkencore nuk mund të gjenden, edhe sikur të kërkonim me llupë.

Ja si përballet ky mjek me një nobelist (të cilit ndoshta qëllimisht nuk ia ka konkretizuar emrin):

*Sot në Perëndim, të flasësh për Zotin do të thotë të të konsiderojnë për të çuditshëm. Ky qëndrim i sulmon të gjithë të rinjtë që mësojnë në universitetet tona, duke përfshirë këtu edhe myslimanët. Si mos të jetë kështu, kur dihet se çfarë pikëpamjeje ekstreme kanë pasur shkencëtarët tanë më të njohur. Një fitues i çmimit „Nobel“ për mjekësi ka provuar vitet e fundit, që në një libër, të cilën ia ka kushtuar publikut të gjerë, të imponojë idenë se, në saje të rastit, materia e gjallë është krijuar vetvetiu nga disa përbërës elementarë dhe se nga kjo materie e gjallë primitive, nën ndikimin e rrethanave të jashtme të shumëllojshme, janë formuar qenie të gjalla të organizuara për të arritur deri te kompleksi i çuditshëm siç është njeriu.*³⁴⁵

³⁴⁴Po aty, f. 3.

³⁴⁵Po aty, f. 81.

Po ky mjek „shkencëtar” shtron një pyetje, që e diskrediton seriozitetin e tij prej shkencëtari:

Çfarë force shpirtërore duhet t'i kundërvëmë kësaj ndotjeje të mendimit nga shumë shkencëtarë bashkëkohorë?

Këto janë prononcime irrituese të këtij (pseudo)islamologu, ndosh-ta mercenar. Edhe sipas tij, shkencëtarët bashkëkohorë i injorojnë doktrinën dogmatike të religjioneve abrahamike. Ai shpreh një shqetësim që përmban të vërtetën për rrjedhën e defetarizimit në shoqëritë sekulariste në Perëndim, dikur i dominuar nga krishterimi:

Para baticës së materializmit dhe pushtimit të Perëndimit nga ateizmi, edhe krishterimi dhe hebraizmi tregojnë paaftësi për t'u mbrojtur. Ata janë tërësisht të shushatur dhe, nga dhjetëvjeçari në dhjetëvjeçar, dobësohet rezistenca ndaj rrymës që kanoset të marrë gjithçka me vete.³⁴⁶

Edhe „shkencëtari” Maurice Bucaille, njësoj si islamologu Edip Yuksel, identifikon në *Kuran* „të dhëna të sakta shkencore” lidhur me krijimin e tokës. Ja çfarë konstaton ky mjek:

Gjashtë periudhat kohore të krijimit të qiejve dhe të Tokës sipas Kuranit, mbulojnë formimin e trupave qiellorë, formimin e Tokës dhe zhvillimin e këtyre të fundit, kur ende nuk ishte bërë (me „ushqimin” e saj) e banueshme për njeriun. Për këtë të fundit, ngjarjet sipas tregimit kuranor janë zhvilluar në katër periudha kohore. A duhet në këtë paraqitje të vërejmë epokat teologjike të cilat i përshkruan shkenca bashkëkohore, kurse njeriu, siç është e njohur, është paraqitur në çerekun (periudha e katërt e formimit të Tokës). Kjo është hipoteza e rëndomtë, sepse askush nuk mund të përgjigjet në këtë pyetje. Por duhet kuptuar se për formimin e trupave qiellorë dhe për formimin e Tokës ishin të nevojshme dy faza, sikurse shpjegohet në ajetet 9 gjer në 12, të sures 41. Shkenca na mëson

³⁴⁶ Po aty.

se, nëse merret si shembull (dhe i vetmi shembull i mundshëm) formimi i Diellit dhe nënprodukti i tij -Tokës, procesi është zhvilluar me kondensimin e mjegullnajës së parë dhe copëtimin të saj. Pikërisht këtë e shpreh Kurani në mënyrë krejt eksplicite duke përmendur proceset, të cilat, duke u nisur nga „avulli” qiellor, prodhuan bashkimin e pastaj copëtimin. Këtu vërejmë njëjtësinë e përkryer të të dhënave kuranore me ato shkencore...”.³⁴⁷

Po sjell këto ajetet, që lexuesi të ketë mundësi për të ballafaquar spekulimet e „shkencëtarit” Bucaille dhe përmbajtjes tekstuale të këtyre ajeteve (verseti 41:11 e kam shqyrtuar edhe më herët):

Thuaj: „A ju jeni ata që nuk i besoni Atij që e krijoi tokën për dy ditë dhe Atij i përshkruani shok, e Ai është Zoti i botëve!” [41:9]

Ai që në të vuri kodra të forta, ia shtoi të mirat asaj dhe brenda katër ditëve të plota caktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të. [41:10]

Mandej e mësyu qiellin e ai ishte tym dhe atij dhe të tokës i tha: „Qasuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!” Ata të dy thanë: „Po i qasemi me dëshirë!” [41:11]

Dhe ne krijuam shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktuam atë që i nevojitej. Qiellin më të afërt Ne e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i plotfuqishmit, të dijshmit. [41:12]

„Gjashtë periudhat kohore të krijimit të qiejve dhe të Tokës”, Bucaille i sajoi nga vetja e tij, meqë në ajetin 41:9 thuhet se Zoti „krijoi tokën për dy ditë”, ndërsa në katër ditët pasuese ai krijoi kodra të forta dhe kushte për jetesë [41:10], pastaj ia „mësyu qiellit, e ai ishte tym”. Pra, në këto ajete nuk rezultojnë fare gjashtë periudha kohore të krijimit të qiejve dhe të tokës, por dy plus katër ditë, për krijim të tokës dhe pastaj zoti „ia ka mësy qiellit”, i cili ishte „tym”. Po të vazhdojmë më tutje interpretimet, Muhamedi duhet të ketë menduar se toka ishte krijesa e parë e Allahut, prej aty ai, për hir të njeriut, ua ka mësy shtatë qiejve...

³⁴⁷ Po aty.

Gjithsesi, është për të ardhur keq që mercenarizmi pjell kësi „shkencëtari” sharlatan, që të irriton, meqë „lexon” në ajete përmbajtje nuk që ekzistojnë fare në to!

Në vazhdim, mjeku Buaillé fillon një kapitull tjetër, të titulluar „*Kurani dhe astronomia*”. Ai shkruan:

Kurani përmban shumë meditime mbi qiejt. Në kapitullin e sipërm kushtuar krijimit, kemi vërejtur se janë përmendur shumë qiejt dhe Toka, si dhe ekzistimi i asaj që Kurani e përkufizon si ndërkrijim, përkatësisht meskrijim „mes qiejve dhe Tokës“, si realitet, të cilën e ka dëshmuar shkenca bashkëkohore. Ajetet që kanë të bëjnë me krijimin, në njëfarë mënyre, e kanë dhënë kuptimin e përgjithshëm mbi përmbajtjen e qiejve, d.m.th., për tërë atë që është jashtë Tokës sonë”.³⁴⁸

Është për të të ardhur keq, që ai duhet t’ia ketë mbushur mendjen vetes, se gjoja në kapitullin pararendës paska shqyrtuar shkencërisht tematikën e krijimit të tokës dhe të qiejve në „gjashtë periudha” dhe i ka rezultuar se ajetet e sipërcituara janë shkencore. Tani, ky mjek i identifikon në *Kurane* dhe „ndërkrijimet” dhe „meskrijimet” mes tokës dhe qiejve, „si realitet, të cilën shkenca bashkëkohore e ka dëshmuar”. Spekulum, i cili mund të (keq)kuptohet si i porositur, por nëse e ka bërë duke shkërdhyer përgatitjen e tij intelektuale prej mjeku, vërtet nuk është logjike të arsyetohet.

Ai vazhdon të nënçmojë lexuesit e tij të mundshëm, duke mos konkretizuar përmbajtjen e ndonjë ajeti, por vetëm duke bërë paralelizime sharlatane si ky në vijim:

Përveç ajeteve, të cilat në mënyrë të veçantë përshkruajnë krijimin, 40 ajete të tjera ofrojnë të dhëna të sakta astronomike, të cilat janë plotësuese të këtyre të dhënave.

³⁴⁸ Po aty, f. 88.

Vetëm lexuesit injorantë, që rëndom janë besimtarët përkatës, do të besojnë se plot 40 ajete ofruakan „të dhëna të sakta astronomike”. Kurse unë kam përzgjedhur shumë ajete kuranore, që kanë të bëjnë me këtë tematikë, dhe nuk më ka rezultuar se ndonjëri prej tyre përmban të dhëna të sakta astronomike.

Destruktiviteti i mjekut Bucaille bëhet akoma më brutal:

Ajetet e para, të cilat i kemi cituar këtu, nuk motivojnë aspak për meditim shkencor: qëllimi i tyre është thjesht të tërheqin vëmendjen në gjithëfuqinë e Zotit. Megjithatë, duhet t'i përmendim, që të krijohet përfytyrimi real mbi mënyrën në të cilën teksti kuranor, para gati 14 shekujsh, e ka paraqitur organizimin e gjithësisë.³⁴⁹

Tashmë vetë ai, pas ndonjë fragmenti jo të gjatë, i degradon ajetet e sipërcituara si jo shkencore, edhe pse „periudhat e krijimit të tokës dhe të qiejve” i quante të vërtetuara nga shkenca moderne.

Mjeku Bucaille bëhet akoma më skandaloz, kur përshfaq vulgarisht tifozerinë prej mercenari:

As Ungjijtë, as Besëlidhja e Vjetër (...) nuk merren me organizimin e botës. Kurani e shqyrton hollësisht këtë temë³⁵⁰.

Për këtë konstatim ai sjell ajetet:

A nuk shikojnë ata me vëmendje kah qielli se si mbi ta kemi ndërtuar atë, e kemi zbuluar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti? [50:6]

Ai krijoi qiejt pa shtylla, sikurse po i shihni ... [31:10]

Allahu është Ai që ngriti qiejt pa ndonjë shtyllë. Ju i shihni ata. Ai mbizotëroi Arshin dhe nënshtroi diellin dhe hënën ... [13:2]

Ai e ngriti qiellin dhe vuri drejtësinë. [55:7]

Ai mban qiellin të mos bjerë në tokë, pos nëse dëshiron Ai.[22:65]

³⁴⁹ Po aty.

³⁵⁰ Po aty, f. 89.

Këto ajete kirurgu Bucaille i pason me interpretimin vijues:

„Dihet se largësia e masave qiellore në distanca të mëdha, proporcionale me madhësitë e vetë masave paraqet bazën e ekuilibrit të tyre. Sa më të largëta të jenë masat, aq më të dobëta do të jenë forcat tërheqëse midis tyre. Sa më të afërta të jenë ato, aq më shumë ndikojnë njëra mbi tjetrën. P.sh., rasti i Hënës, e afërt me Tokën, e cila sipas ligjit të tërheqjes ndikon në ujin e detit, nga ky ndikim lind fenomeni i baticës. Nëse dy trupa qiellorë do të afroreshin jashtë mase, atëherë përplasja e tyre do të ishte e pashmangshme. Nënshtrimi ndaj një rendi është „conditiosine qua non“ i mungesës së çrregullimit.³⁵¹

Ndoshta vetëm ndonjë besimtar mysliman (i cili krenohen me lavdëruesin e islamit, mjekun Bucaille, sidomos për faktin pse nuk është mysliman), mund të besojë se ky interpretim u përket këtyre ajeteve. Megjithatë, në një interpretim të bërë më vonë, ai thotë:

E pamë se me shtatë qiej duhet kuptuar shumësi e jo një numër i caktuar.

Tashmë seriozitetin e tij ai e diskreditoi krejtësisht, meqë, sipas tij, nuk u dashka kuptuar atë çfarë shkruan, por çfarë dëshirojmë të jetë e shkruar. Nuk është serioze të merremi me këso talljesh të këtij mjeku. Të shohim nëse ka diçka më serioze në kapitujt e tjerë.

Demagogu Bucaille, i vetëdijshëm se lexuesit kritikë do të hetojnë që interpretimet e tij dhe përmbajtja e ajeteve kuranore nuk përputhet, ka gjetur një arsytim:

Me të vërtetë, në epokën tonë ende janë të përhapura përkthimet dhe komentimet e disa fragmenteve, të cilat, me rastin e leximit, mund t'u

³⁵¹ Po aty.

*krijojnë shkencëtarëve një pasqyrë krejt të shtrembër të Shpalljes Kuranore...*³⁵²

Fetva për rrotullimin e Diellit:

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, ish-ministri për Çështjet Islame dhe ish-kryemyftiu i Arabisë Saudite, Azizb. 'Abdullahb. Baz (عبد العزيز بن عبد الله بن باز) ka shkruar në një nga librat e tij, në vitin 1982:

„Klerikët e shquar paraardhës myslimanë, si Shejh Ibn Tejmijes, Ibn Kethirit dhe Ibnel-Kajjim, pajtohen se ai, i cili pretendon se toka rrotullohet rreth diellit, është mëkatar që shkel ligjin islamik. Kushdo që pretendon se toka rrotullohet, është jobesimtar dhe mashtrues. Atij duhet t'i ofrohet kohë për të reflektuar. Nëse ai pendohet dhe përsëri bëhet i arsyeshëm, duhet falur. Nëse ai nuk e ndryshon mendimin e tij, do të ekzekutohet si jobesimtar. Prona e tij do të konfiskohet nga shteti mysliman”.

Për këtë, Ibn Baz ka deklaruar se ai vetë e ka parë se si dielli rrotullohet rreth tokës. Këtë ai e ka përjetuar para humbjes së shikimit. Edhe shumë bashkëkohës të tij gjithashtu e kishin vërejtur.

Për formën e diellit, Shejh Ibn Baz ka thënë:

„Dielli nuk është sferik, por kupolë. Kjo është një kupolë që qëndron mbi shtylla. Ai mbahet nga engjëjt”. Dhe: „Nëse dielli do të ishte i palëvizshëm, nuk do të kishim katër stinë të dallueshme. Edhe ora do të ishte e njëjtë në të gjithë botën”.

Për deklaratat e shkencëtarëve në lidhje me moslëvizjen e diellit, Ibn Baz ka deklaruar si vijon:

„Shumë mësues të gjeografisë pretendojnë se dielli nuk rrotullohet. Kjo është një gënjeshtër dhe mashtrim. Këta njerëzi gënjejnë njerëzit dhe shkelin Kuranin dhe deklaratat e dijetarëve paraardhës myslimanë. (...) Nëse toka vërtet lëviz, kjo do të thotë që ne kurrë nuk do të arrinim në

³⁵² Po aty, f.130.

destinacion. Ata që mësojnë nxënësit e tyre kështu, edukojnë njerëz ateistë”.

Ibn 'Uthejmin ka konfirmuar të njëjtin mendim. Ai ka cituar vargje nga *Kurani*, që thonë se toka është e fiksuar me kolona. Kjo bie në kundërshtim me pohimin se toka rrotullohet. Për më tepër, Ibn 'Uthejmin ka konfirmuar: „*Kurani dhe tradita dëshmojnë se dielli lëviz. Kjo çon në krijimin e ditës dhe të natës...*”. Ibn 'Uthejmin ka cituar katër ajete të *Kuranit*. Të gjithë thonë se tok rrotullohet. Edhe përmes haditheve Muhamedi ka thënë: „Kur dielli perëndoi, Profeti i Allahut, Muhamedi, pyet Ebu Tharin: „A e dini ku është zhdukur dielli?“ Ebu Thari është përgjigjur: „Allahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë këtë“. Muhamedi ka thënë: „Dielli lëviz, shkon dhe përkulet para fronit të Allahut dhe i kërkon leje për të shkuar. Atij i lejohet, por i thotë kthehu mbrapa atje nga ke ardhur. Kështu ai vjen përsëri”³⁵³.

II. 8. Kurani - ajete skandaloze

Për të parë çfarë përcaktimesh skandaloze përmban *Kurani*, identifikova dhjetëra vërse (ajete), të cilat as që meritojnë të komentohen. Megjithatë, po i citoj dhe komentojë, për të diskualifikuar mitin mashtrues, se Kurani është vepër e përkryer, pa kundërthënie.

Me të vërtetë, për ata që janë në mohim, është njësoj si i paralajmërove ti apo nuk i paralajmërove - ata nuk besojnë. [2:6]

Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të parin e tyre ka një perde, e ata kanë një dënim të madh. [2:7]

Tejet irrituese! Pse ua mbylli Allahu zemrat, veshët, sytë?! Atëherë vetë Allahu qenka fajtor, pse jomuslimanët nuk ndërgjegjësohen për

³⁵³ <http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M52e3d50a0ad.0.html>.

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

t'i besuar atij e Muhamedit. Jo, në këtë rast kemi Muhamedin e desh-përuar, me energji negative...

Në zemrat e tyre ka sëmundje, e Allahu u shton sëmundje edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtruan, pësojnë dënim të dhembshëm. [2:10]

Muhamed shpirtkazmë! Armiqësia e tij kundër besimtarëve politeistë nuk ka të sosur dhe nuk njeh kufi! Kështu ai komprometon edhe personazhin e tij: Allahun!

E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën veten e tyre; atë që e shpalli Allahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se Allahu nga mirësia e Tij i shpall atij që dëshiron nga robërit e vet. Ndaj merituan zemërim mbi zemërim. Mosbesimtarët kanë dënim që i poshtëron. [2:90]

Sërish përcaktime tejet të neveritshme! Edhe nga formulimi gjuhësor rezulton se personazhi Allah nuk është autor, meqë gjysmanalfabetët nuk kanë ditur të jenë konsekuentë në këtë formulim, që të besojnë se Allahu ishte autor i tij.

*Thuaj: „Nëse bota tjetër (xheneti) tek Allahu është vetëm për ju, e jo edhe për njerëzit e tjerë, nëse jeni të sigurtë, kërkojeni vdekjen. ” [2:94]**

Çfarë talljeje cinike! Vërtet, pse nuk nguten të vdesin myslimanët...?!

Ata thanë: ‘Kurrësi nuk ka për të hyrë kush në xhenet, përveç atij që është jehudi ose i krishterë! Ato janë fantazi të tyre!’ Thuaju: ‘Sillni argumentin tuaj, po qe se jeni të drejtë’. [2:111]

Ngjan si një zënkë rrugaçësh ose fëmijësh të llastuar. Muhamedi duhet të ketë qenë i vetëdijshëm çfarë e pse po e sajonte, prandaj u ka kërkuar argumente jahudinjve, vetëm t'u imponuar.

* Shqipërimi i Hasan E. Nahit:

“Thuaju (O Muhamedi): “Nëse vetëm për ju te Perëndia u është siguruar xheneti, e jo për njerëzit e tjerë, atëherë, nëse flisni të vërtetën, kërkon vdekjen”. [Kurani, 2:94]

Të Allahut janë edhe lindja, edhe perëndimi, dhe ngado që të ktheheni, aty është anë e Allahut...[2:115]

Atëherë, pse myslimanët kur luten, i drejtohen vetëm Qabesë pagane?! Ndoshta, sepse *guri i zi* ka më shumë vlerë (idhujtarie) sesa Allahu. *Gurin e zi* ata e puthin dhe i përkulen si në paganizëm, edhe pse do të duhej t'i përkuleshin vetëm Allahut. A nuk është gjykuar idhullimi i skulpturës së *viçit të artë* si idhujtari pagane? Pse atëherë *guri i zi* duhet të idhullohet? *Viçi i artë* ishte më i bukur se *guri i zi*...

*Këta janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët. Prej tyre pati që Allahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë. Isait, birit të Merjemes i dhamë argumente dhe e përforcuam me shpirtin e shenjtë. E sikur të donte Allahu, nuk do të mbyteshin ndërmjet tyre ata që ishin pas tyre, pasi atyre u patën zbritur argumentet, por ata, megjithatë, u përçanë. E pati prej tyre që besuan dhe pati të tillë që nuk besuan, e sikur të dëshironte Allahu, ata nuk do të mbyteshin, por Allahu punon çka dëshiron. [2:253]**

Sërish mendësi tipike muhamedane: bëhet përzgjedhje preferenciale edhe mes „profetëve”. Vrasjet e pjesëtarëve të popullit, që i përkisnin „profetit”, paskëshin ndodhur, sepse ashtu paskësh dëshiruar Allahu. Për ata që besojnë në të njëjtin „Allah”, këto shpifje do të duheshin diskualifikuar si blasfemike! Aspak hyjnore e profetike!

*Profeti beson në atë që i është shpallur (Kurani) nga Allahu i tij, dhe besimtarët; - të gjithë ata besojnë Perëndinë, engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe profetëve të Tij: „Ne nuk e dallojmë asnjërin nga profetëve e Tij”. Ata thonë: „Ne dëgjuam dhe përulemi, - falna ne o Allahu ynë dhe te Ti do të kthehemi! [2:285 / shq. H. E. Nahi]**

* Shqipërim nga Feti Mehdiu:

“Mes profetëve kemi bërë dallime. Me disa prej tyre ka folur Allahu e disa i ka ngritur për disa shkallë. Dhe Isait, birit të Merjemes, i kemi dhënë argumente të qarta dhe e kemi ndihmuar me Xhebrailin. Sikur të donte Allahu, ata nuk do të vriteshin ndërmjet tyre, pasi u erdhën argumente të qarta, por ata u konfrontuan; disa prej tyre besuan e disa mohuan. Por sikur të donte Allahu ata nuk do të vriteshin, por Allahu punon çka dëshiron vetë”. [Kurani, 2:253]

* Shqipërim i Sherif Ahmetit:

Derisa në ajetin 2:253 bëhet dallimi - „Këta janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam nga të tjerët...” - në ajetin 285 thuhet në mënyrë eksplicite: „Ne nuk e dallojmë asnjërin nga profetët e Tij”. Kur dy ose më shumë ajete dallojnë mes tyre, që trajtojnë të njëjtën çështje, duhet zbatuar ajeti „i zbritur“ më vonë. Në rastin konkret, të dy ajetet i përkasin së njëjtës kaptinë (sure) dhe ndoshta duhet marrë për bazë vetëm renditja numerike, që do të thotë se duhet zbatuar ajeti 285 dhe jo ai 253. Edhe renditja e ajeteve në *Kuran* nuk do të duhej të merret fare për bazë, sepse, ta zëmë, ajeti *ikra* (shqip: recito / lexo), të cilin Muhamedit duhet t’ia ketë prezantuar engjëlli Xhibril për herë të parë, siç besojnë myslimanët, ajeti i parë nuk „është redaktuar” në *Kuran* në kaptinën e parë, por në kaptinën 96:1. Përgjithësisht, renditja e ajeteve në *Kuran* është një pështjellim i llojit të vet, duke ia dëmtuar rëndë rrjedhshmërinë e ngjarjeve, pasi Muhamedi i ka sajuar ajetet në bazë të nevojave në terren.

Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi ato ua sqaruum njerëzve të librit, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë.
[2:159]

Si paskan pasur mundësi jomyslimanët t’i fshehin shpalljet e Allahut, kur Allahu është i gjithësurvejueshmi?! Tallje ordinere!

Mos u martoni me pagane, përderisa të mos bëhen myslimane. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse ju pëlqen. Mos i martoni myslimanet për paganë, përderisa nuk bëhen myslimanë; skllavi mysliman është më i mirë se pagani, edhe nëse u pëlqen juve. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Perëndia, me mirësinë e Tij, ju thërret në xhenet e falje dhe jua shpjegon njerëzve argumentet e Veta, që të mendojnë ata. [2:221 / shqip. Hasan E. Nahi]

I dërguari (Muhamedi) i besoi asaj që iu shpall prej Allahit të Tij, si edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut dhe melekëve të Tij dhe të dërguarve të Tij. “Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij”, dhe thanë: “Dëgjuam dhe respektoam. Kërkojmë faljen tënde, o Allahi ynë, te Ti është ardhmëria (jonë).” [Kurani, 2:285]

Edhe këtu, përcaktimi i Muhamedit është tepër shovinist!

Është Ai që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe që janë bazë e librit, e ka të tjera që nuk janë krejtësisht të qarta (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutë, e kinse kërkojnë komentën e tyre. Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: „Ne i kemi besuar atij, të gjitha janë nga Allahu ynë”! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të Allahët e mendjes”. [3:7]

Demagogji tipike muhamedane, për të arsyetuar edhe broçkullat e përcarta që duhet t'i ketë sajuar. Ose ndoshta i ka sajuar ndonjë bashkautor tjetër (?!). Gjithsesi, aspak hyjnore e profetike!

E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrësi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit. [3:85]

Ky ajet përmban përcaktim diskriminues kundër besimtarëve të të gjitha feve të tjera. Respektivisht në këtë ajet përsëritet përcaktimi: asnjë fe tjetër, pos fesë islame, nuk pranohet nga Allahu! Por, mu në *Kuran* ekzistojnë edhe ajete që i njohin fetë e tjera abrahamike. Pikërisht ky është perversiteti i mendësisë së Muhamedit, i cili nuk ka parim, saktësi, por sipas rasteve, ka miratuar ajete, që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Prandaj besimtarët myslimanë, kur duan të bëjnë demagogji, thirren në ajete tolerante, ndërsa kur e kanë gjendjen e epërsisë, besojnë e zbatojnë veset barbare. Në fakt, myslimanët fundamentalistë janë të informuar se, kur është fjala për (mos)njohe të feve të tjera, meqë ata e dinë se ajeti i miratuar më vonë është i plotfuqishëm ngaqë shfuqizon ajetin e mëhershëm. Këtë ajete Muhamedi e ka sajuar në Medinë, prandaj është i plotfuqishëm, ndërsa ajetet tolerante, të sajuara më herët në Mekë, janë të pavlefshme. Por, pse këto ajetet vazhdojnë të qëndrojnë në *Kuran*, këtë nuk është kompetent askush që ta sqarojë. Ndoshta meqë Muhamedi vdiq pa

arritur t'i sistemojë ajetet që kishte shfuqizuar, duke sajuar ajete të tjera.

Shtëpia³⁵⁴ e parë e ndërtuar për njerëzit është ajo në Bekë (Mekë), e dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin. [3:96 / shq. Sh. Ahmeti]

Formulim i përcartë muhamedan! Kemi të bëjmë me një falsifikim flagrant të Muhamedit, për qëllime ekspansioniste, për t'i përvetësuar „profetët” izraelitë dhe historinë e atij populli. Qabeja, e cila përpara quhej *Beka*, ishte objekt kulti pagan, në pronësi të fisit Kurejsh, të cilit i përkiste edhe Muhamedi. Grindjet e para mes Muhamedit dhe xhaxhallarëve e kushërinjve të tij zunë fill qysh në momentin kur Muhamedi shfaqi pretendimin për Qabenë, me (pseudo)arsyetimin se ajo ishte myslimane qysh nga koha e Adamit, e „rindërtuar” nga Abrahami dhe Ismaili, që gjoja na paskëshin qenë myslimanë edhe paraardhës familjarë të tij.³⁵⁵

Për shqiptarët, ky lloj pretendimi mund të kuptohet, kur të krahasohen pretendimet e nacionalistëve serbë ndaj Kosovës, duke u thirrur në objektet fetare mesjetare, gjoja serbe...

Allahu nuk është i nevojshëm për njerëzit. [3:97]

Formulim pa shije! Mirë do të kishte qenë, sikur njerëzit të mos kishin nevojë, sidomos për një Allah, siç është prezantuar në *Kuran*, por, fatkeqësisht, rezulton sikur injorantët, megjithatë, kanë nevojë për një gogol, siç është Allahu!

Siç rezulton, formulimi mund të (keq)kuptohet edhe se Allahut nuk i duhen njerëzit; asnjë Allah nuk do të duhej të binte në këtë nivel, për të thënë se nuk kishte nevojë për njerëz...

³⁵⁴ H. E. Nahi e ka shqipëruar faktore. F. Mehdiu ka përdor emërtimin *tempull*. Gjermanisht (Bubenheim & Elyas) është përkthyer gjithashtu si *shtëpi*.

³⁵⁵ Sipas Ibn Isak; shih paraqitjen grafike të trungut familjar, me 51 paraardhës, në: <http://www.derletztetephoet.info/der-stammbaum-der-propheten-bis-mohammed-sav>

Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni tek Allahu. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Allahit. [3:110 / shq. Sh. Ahmeti]

Ju jeni populli më i mirë se të gjithë të tjerët që janë paraqitur ndonjëherë. Kërkonin të bëhen vepra të mira dhe pengoni të këqijat dhe i besoni Allahut. Dhe sikur ithtarët e Librit të besonin drejt, do të ishte më mirë për at. Ka prej tyre edhe besimtarë, por shumica janë mbrapshtanë. [3:110 / shq. FetiMehdiu]

Të dy variantet kanë ngjashmëri. Uroj që besimtarët myslimanë të mos ankohen, sepse shpesh ankohen për përkthimet. Shumë prej tyre besojnë në islamin e tyre të idealizuar, prandaj ndodh që, kur nuk u pëlqejnë përmbajtjet e ndonjë ajeti, fajësojnë përkthimin. Kjo ndodh sidomos kur ajetet nuk janë të përputhshme me islamin e tyre të idealizuar.

Në të dy këto shqipërime rezulton se Muhamedi përcakton popullin e tij arab si popullin më të mirë. E vetëkuptueshme: ai ka synuar ta konsolidojë popullin e tij, prandaj për këto arsye ka mashtruar, sikur e paskësh përzgjedhur Allahu. Asnjë „Allah” nuk do të duhej të përzgjidhte një popull si më të mirin. Por ja që ka ndodhur, por jo nga asnjë „Allah”, por nga „të dërguarit” (Abrahami, Moisiu, Jezusi dhe Muhamedi).

Siç vetëkuptohet, Muhamedi e autorizon popullin e tij të vendosë për vlera të mira dhe të këqija, për lejime dhe ndalesa, që duhet të vlejnjë për gjithë njerëzimin. Ndërsa spekulimi për besimtarët judenj, se pak veta janë të devotshëm, kurse shumica jo, është një demagogji shoviniste e Muhamedit për të nxitur urrejtjen e myslimanëve kundër tyre, madje si tërësi, meqë ata nuk janë në gjendje të identifikojnë pakicën e devotshme.

O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojët e tyre, por ajo që fshihin në gjokset tyre është edhe

ISLAMI, religjion agresiv (!)

më e madhe. Ne, pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. [3:118]

Fatkeqësisht Kurani është përplot me këso thirrjesh fashistoide, si në ajetet 4:144, 5:51etj.

Çdo gjallesë vdes vetëm me vendimin e Perëndisë, në kohë të caktuar. Kush dëshiron mirësitë e kësaj bote, Ne ia japim; e kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër ne ia japim, dhe me siguri i shpërblejmë falënderuesit. [3:145]

Broçkull tipike muhamedane, që duhet të shërbejnë si demagogji për t'i mbajtur nën kontroll turmat e varfra, me arsyetim se ata do të shpërblehen me xhenet, kurse të pasurit vetëm me mirësitë e kësaj bote...

O ju që u është dhënë libri (Testamenti i Vjetër, - sqarim imi), besojeni atë që e zbritëm (Kuranin) e që është vërtetues i atij që keni, para se të shlyejmë fytyrat dhe t'i rrotullojmë ose t'i mallkojmë ata, si i mallkuam ata të së shtunës. Urdhri i Allahut është i kryer. [4:47]

Muhamedi sikur ka harruar se ka sajuar ajetet, të cilat përmbajnë për-caktime që nuk i njohin religjionet e tjera. Pra, kjo është dëshmi se ai ka sajuar ajete në bazë të ballafaqimeve polemizuese me jomyslimanë.

Ju do të hasni në të tjerë, që duan të sigurohen te ju dhe të sigurohen te populli i vet. E, sa herë që thirren, i përgjigjen thirrjes. Në qoftë se nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapeni dhe mbytni kudo që takoni. Kundër tyre u kemi dhënë fakte të qarta. [4:91]

Në këtë rast mendohet ajo pjesë e njerëzve, të cilët, për të mbijetuar, simulonin të qenit besimtar i fesë që ua kërkonte më i forti.

„Faktet” për të cilat flet Muhamedi janë spekulime demagogjike, për t'i bindur xhihadistët e tij, se vërtet atyre u janë ofruar fakte, por nuk i kanë marrë parasysh, prandaj duhen mbytur.

Ngjashëm duhet të ketë ndodhur edhe me shqiptarët, në fazën e parë të konvertimit të tyre në islam. Fillimisht, gjatë kohës duhet të

kenë nxitur simulimin në myslimanë, pastaj kanë mbetur brenda dhe, nga roli i simulimit (aktrimit) janë shndërruar në shqiptarë hibridë myslimanë...

Juve ju është shpallur në librin që, kur të dëgjoni se po mohohet Kurani i Allahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ta derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. Allahu do t'i tubojë të gjithë tradhtarët dhe jobesimtarët në xhehenem. [4:140]

Një porosi tepër idioteske. Vërtet, si do të ftohen të tjerët për t'u konvertuar në islam, nëse nuk tolerohen polemika e debati?! Dhe Muhamedi nuk duhet të ketë qenë aq analfabet, siç e prezantojnë ithtarët e tij. Ai është frikësuar se besimtarët mund të ndikohen nga kritikrat dhe talljet e kundërshtarëve, prandaj duhet ta ketë sajuar këtë ajet, si masë mbrojtëse.

Ata që nuk besuan dhe bënë zullum, Allahu as nuk ka për t'i falur as nuk ka për t'i drejtuar në rrugë (të drejtë). [4:168]

Mendësi tipike muhamedane, hakmarrëse. Improvizon personazhin Allah, sikur ai nuk do të donte fare t'i udhëzonte jobesimtarët, që të përmirësohen kur gabojnë.

E para, ky nuk është përcaktim i Allahut, si personazh i sajuar nga Muhamedi. E dyta, është tmerruese se çfarë atributesh barbare i ka mveshur Muhamedi personazhit të tij! Çfarë Allahi është ai që përcaktohet për të mos i ndërgjegjësuar asnjëherë njerëzit që kanë bërë gabime, por kënaqet duke i ndëshkuar ata. Kjo dëshmon se sa shpirtkaltër ka qenë Muhamedi!

...Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka (...) vetëm vëlla dhe motër, atëherë mashkullit i takon hise dyfish më shumë se femrës. (...) [4:176]

E para, gjuhësisht nuk është përcaktim i personazhit Allah, por përcaktim muhamedan. E dyta, është përcaktim i padrejtë i Muhamedit,

që vëllai të trashëgojë dyfishin. Gjithandej, Muhamedi maço femrën e zhvlerëson sa gjysmën e mashkullit qoftë në trashëgimi, qoftë në dëshmi...

Kjo quhet drejtësi muhamedane dhe praktikohet në shoqërinë muhamedane. Nuk di nga janë ndikuar shqiptarët e besimit islam, që vajza nuk trashëgon fare pronë nga babai, nëse ai ka lënë djalë, pas vdekjes. Me ligje demokratike, trashëgimia është e barabartë, prandaj besimtarët myslimanë që jetojnë në shtete demokratike nuk mund ta praktikojnë këtë padrejtësi.

O ju që besuat! Zbatoni premtimet. U janë (lejuar t'i hani) kafshët shtëpiake, me përjashtim të atyre që po ju lexohen dhe përveç gjuetisë, që nuk është e lejuar derisa jeni në haxhillëk. Vërtet, Allahu vendos atë që dëshiron. [5:1]

Formulim i përcartë (sidomos kur hiqen sqarimet në kllapa, të cilat nuk i përmban origjinali). Për çfarë premtimesh bëhet fjalë? Ku dhe kujt po i lexohen? Pra, ky formulim, si shumë të tjerë, dëshmon se çfarë niveli intelektual ka pasur Muhamedi dhe stafi i tij; ai, tashmë, kishte krijuar staf, sepse kishte krijuar kalifatin e tij minor në Medinë dhe rrethina.

Meqë Allahu vendos siç dëshiron, pse atëherë duhen gjithë këto ajete, gjithë këto udhëzime?! Kjo dëshmon se Muhamedi ka sajuar një Allah sipas mendësisë së tij, meqë vetëvepronte siç po i tekej, dhe jo siç do të duhej, rrjedhimisht jo siç i takon sundimtarit paksa racional...

Lexoju (Muhamed) atyre ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbane, nga të cilët njërit iu pranua. Ai tha: „Unë do të të mbys ty!“ E ai tha: „Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve“ [5:27]

Nëse shqipërime është i saktë, rezulton të jetë demaskim i mashtrimin të mitizuar, se Muhamedi ishte analfabet. Këtë lloj formulimi as vetë autori Muhamed nuk e merr vesh. Megjithatë, propaganduesit e *Kuranit* dhe besimtarët thonë se gjuha e *Kuranit* është gjuhë e qartë

letrare e filozofike, edhe pse rezulton të jetë vetëm gjuhë, stil e përmbajtje e gjysmanalfabetëve...

O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është njëri prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Thirrje fashistoide! Do të mjaftonte ky ajet si argument për të ndaluar *Kuranin* si „Mein Kampf” të Hitlerit!

O ju që besuat! Mos i merrni për miq ata të cilëve u është dhënë libri para jush, as jobesimtarët që me fenë tuaj tallen dhe luajnë. Kini drojë Allahun po qe se jeni besimtarë. [5:57]

Edhe ky ajet është fashistoid, si thirrjet në ajetin pararendëse!

Ti, gjithsesi, do të vëshesh, se armiqtë më të ashpër për besimtarët janë hebrenjtë dhe paganët. E, gjithsesi, do të vëshesh, se miqtë më të afërt të besimtarëve janë ata që thonë: „Ne jemi të krishterë”. Kjo rrjedh, ngase ndër ta ka dijetarë dhe murgë dhe ata me të vërtetë nuk madhësohen (në pranimin e së vërtetës). [5:82]

Sërish mendësi tipike shoviniste muhamedane! Këtë ajet Muhamedi e ka sajuar në Medinë. Atje nuk duhet të ketë pasur pak besimtarë të krishterë, prandaj nuk kishte nevojë t’u shpallte armiqtë të barabartë me hebrenjtë e paganët. Pastaj, ai ende duhet të ketë qenë i ndikuar nga autoriteti që kishte misionari kristian, Ibn Varaka, i cili ishte xhaxhai i Hatixhesë, gruas së parë të Muhamedit, gjithashtu kushërirë e Muhamedit.

Thuaj: „A t’ju lajmëroj për një të keqe më të dëmshme si dënim nga Allahu? Mallkimi i atij që e mallkoi Allahu dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e në derra, e i bëri adhurues të djallit. Të tillët janë në pozitë më të keqe dhe më të humburit prej rrugës së drejtë”. [5:160]

Mendësi tipike muhamedane, e formuluar primitivisht! Të paragjyko-heshin majmunët e derrat, kjo ka qenë në natyrën e njerëzve të kohës, por kjo nuk do të duhej të ishte karakteristikë e një profeti. Pastaj, si ka mundësi që ata, të cilët na qenkëshin shndërruar në majmunë e derra, na qenkëshin bërë edhe adhurues të djallit?! Prapë, sa herë që Muhamedi përmend shndërrimin e njerëzve në majmunë e derra, i mendon kryesisht izraelitët, ndonjëherë edhe paganët.

Ka prej tyre që ty të dëgjojnë. Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim dhe, edhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa kur vijnë te ti e të polemizojnë, ata që mohuan thonë: „Nuk është tjetër ky vetëm se mit i hershëm. ” [6:25]

Idioteske! Kush janë ata dhe kë e dëgjojnë?! Thjesht, tamam e ngatërruar si lesh-arapi, siç shprehet populli ynë. Ç'logjikë ka që jomuslimanëve t'u mbulohen zemrat. „Analfabeti” Muhamed vazhdon të besojë se qenka zemra ajo që mendon. Pastaj, pse duhen shurdhuar ata, në vend që t'u mundësohet të dëgjojnë sa më mirë?! Tepër irrituese!

Pra, me këta jobesimtarë çfarë duhet bërë, meqë vetë Allahu qenka përkujdesur që të mos dëgjojnë e kuptojnë?! Pse atëherë janë sajuar ajete, që detyronin me dhunë jobesimtarët të konvertohen në islam, nëse dëshironin të mos vriteshin?!

E ata që i bënë të rreme faktet Tona janë shurdhmemecë të mbetur në errësi. Allahu e humb kë të dojë dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do. [6:39]

Sa barbar ky farë Allahu muhamedan, qoftë edhe vetëm si personazh!

Ai është që krijoi yjet për ju, që me ta të orientoheni në errësi kur jeni në tokë ose në det...[6:97]

Ja cila paskësh qenë arsyeja e Allahut për të krijuar yjet! Ky për-caktim përmban paditurinë injorante të Muhamedit, të cilin mund ta çmojnë vetëm besimtarët e tij, gjithashtu injorantë.

Vallë, a barazohet ai që qe i vdekur, kurse Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë, me të cilën ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësirë dhe nuk mund të shpëtojë nga ajo? Ja, kështu iu duket mirë mohuesve ajo që bëjnë. [6:122]

Një formulim i përçartë, spekulativ, pasi në asnjë rast nuk janë ofruar të dhëna konkrete se kush ishte i vdekur, që është ngjallur. S'ka ndonjë dëshmitar ose ndonjë të dhënë burimore. Pra, vetëm është thënë, sa për t'u thënë, në shërbim të garimit me kundërshtarë. Edhe në këtë ajet sikur garohet me besimtarë hebrenj, që këtu quhen „mohues”. Por nuk po kuptohet pse quhen mohues, meqë nuk rezulton kë e çfarë mohojnë ata.

Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë, sikur të ngjitej në qiell. Kështu, Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. [6:125]

Pse, pra, propagandojnë kot klerikët dhe besimtarët, kur nuk u varka fare nga propagandimi i tyre, por nga dëshira bastarde e Allahut?!

Po ashtu, Ne i bëjmë sundues disa mizorë mbi mizorët e tjerë, për shkak të asaj që vepruan. [6:129 / shq. Sh. Ahmeti]

Që, kështu, Ne u japim pushtet disa zullumqarëve mbi të tjerët, për atë që kanë fituar ata. [6:129 / shq. H. E. Nahi]

Dhe ashtu, Ne u japim pushtet disa mizorëve kundër të tjerëve, ashtu siç e meritojnë. [6:129 / shq. F. Mehdiu]

وكذلك «كمامتًا غصاة الإنسانو الجنبعضهمببعض «نولي «منالولاية «بعضالظالمينبعضا «أيعلبعض بماكانوايكتبون «منالمعاصي»

ISLAMI, religion agresiv (?!)

Asnjëri nga përkthimet nuk ka ndonjë kuptim konstruktiv, pos destruktive tipike muhamedane.

Kjo është, ngase Allahu yt nuk e shkatërron asnjë vend për shkak të zullumit të tyre pa paralajmërimin e banorëve të tyre. [6:131]

Sërish formulim i përçartë, tipik muhamedan! Kush duhet të jenë zullumqarët?! Sigurisht jomuslimanët, por cilët?!

...Ai (Allahi) tha: „Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua...” [7:156]

Sërish mendësi muhamedane, për të mos goditur atë që bën gabime, ta zëmë, por atë që do e si t'i teket Muhamedit.

Vërtet, Allahu duhet të jetë autor i formulimit: „Ai tha”.

E kur ata tejkaluan me arrogancë të hapur nga ajo që ishin të ndaluar, Ne i shndërruam në majmunë të përbuzur. [7:166]

Sërish i njëjti paragjykim urrejtës muhamedan, sikur majmunët nuk i paskësh krijuar Allahu!

Atë që Allahu e udhëzon, ai është në rrugë të drejtë; e atë që e humbë, është i dëshpëruar. [7:178]

Pse nuk i udhëzon të gjithë në rrugë të drejtë?! Mendësi muhamedane!

Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë; ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë, që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur, të tillë janë të marrët. [7:179]

Edhe këtë gënjeshtër perverse Muhamedi e ka përsëritur disa herë. Ç'kuptim ka që Allahu të krijojë xhinë dhe njerëz ekstra për xhehenem

(ferr)?! As për mendësinë perverse e fashistoide muhamedane nuk do të ishte me interes që Allahu të krijonte xhinë dhe njerëz të tillë.

Meqë vetë Allahu i paskësh krijuar njerëzit për xhehenem, pse atëherë kërkohet prej tyre të bëhen besimtarë myslimanë dhe pse fyhen kafshët pa qenë fare nevoja, duke bërë këtë lloj krahasimi kaq banal?!

Të pyesin ty (Muhamed) për plaçkën (e fituar në luftë), thuaju: „Plaçka, është çështje e Allahut dhe të Dërguarit...” [8:1]

Ja drejtësia pseudohjnore e *Kuranit*: rregulli përcaktues për ndarje të plaçkës së luftës. Kryebanditi Muhamed, për të qenë i tillë, të drejtën për mënyrën e ndarjes së plaçkës e rezervon komplet për vete (sepse Allahu është vetëm një personazh gogol, që e ka sajuar për t’i siguruar vetes sundimin absolut e banditesk).

Këtij vetëm religjion paqësor nuk mund t’i thuash, por barbari alla-Muhamed!

Përkujtoni kur Allahu ua premtoi njërin prej dy grupeve se është i juaji, e ju dëshironit t’ju takonte ai i paarmatosur, ndërsa Allahu dëshiroi që me premtimet e Tij ta vendoste të vërtetën e ta zhdukte me themel mbeturinën e mohuesve. [8:7] Të forconte të vërtetën e ta çrrënjoste të kotën, edhe pse këtë e urrejnë kriminelët. [8:8]

Meqë formulimi gjuhësor i këtyre ajeteve është i përçartë, po sjellim edhe përkthimin e Hasan E. Nahit, që të bëhen krahasime, me mendimin se mund të kuptohet çfarë ka dashur të thotë „analfabeti” Muhamed.

(Kujtoje) kur Perëndia ju premtoi njëri prej dy grupeve, që me të vërtetë ai të jetë i juaji. E ju dëshiruat që ai i paarmatosuri të jetë i juaji; e Perëndia dëshiron ta forcojë të vërtetën me fjalë të Tij dhe mohuesve t’u zhdukë rrënjët, [8:7] për ta forcuar të Vërtetën (Islamizmin) dhe ta zhdukë gënjeshtren, edhe sikur madje ta urrenin mëkatarët. [8:8]

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

As ky variant nuk të ndihmon për të kuptuar çfarë është dashur të formulohet. Mundet që ndonjë besimtar, nga ata të llojit të interpretuesve mashtrues, të fantazojë diçka.

Nëse ti e heton tradhtinë e një populli, atëherë edhe ti hidhuan atyre në mënyrë të njëjtë, sepse Allahu nuk i do ata që tradhtojnë. [8:58]

Aspak hyjnor ky përcaktim i Muhamedit, i cili i ka caktuar vetes monopolin e së drejtës për të vlerësuar tradhtinë e një populli (është fjala për fiset arabe, që i përkisnin besimit hebre) dhe për revanshizëm.

O ju që besuat (myslimanë), mos u ofroni dashuri prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesim (jo islamit) kundër besimit (islamit). E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë. [9:23]

Marrëzi barbare, prindërit e vëllazëria nuk duhet të duhen, nëse nuk janë konvertuar në myslimanë, respektivisht nuk janë myslimanë! Tipike muhamedane!

Është ai që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse ngjall urrejtjen e idhujtarëve. [9:33]

هو الذيار سلسر سوله «محمد اصلنا لله عليه وسلم» بالهدودينا الحقلظهره «يعليه» عندالدينكله «جميعا لأديانا المخالفاته
ولوكر هالمشركون «ذلك»

Edhe ky ajet përmban përcaktim pothuajse të njëjtë me ajetin 3:85, 61:9etj., që do të thotë se feja islame nuk i njej fetë pagane, judaiste, kristiane, ndërsa për ato të Lindjes së Largët Muhamedi as që duhet të ketë ditur se ekzistojnë.

E, kur të shpallet ndonjë sure, disa prej tyre thonë: „Kujt prej jush kjo do t’ia shtojë besimin?!” Sa u përket besimtarëve, atyre ua shton besimin, dhe ata do të gëzohen, [9:124] e sa u përket atyre, zemrat e të cilëve janë të sëmura, atyre ua shton mohimin në mohimin që kanë dhe ata vdesin si mohues. [9:125]

Vallë, a nuk shohin ata se çdo vit, një herë ose dy herë vihen në sprovë, e megjithatë, përsëri, as nuk pendohen, as nuk këshillohen. [9:126]

Tri ajetet, njëri pas tjetrit, nuk kanë ndonjë përmbajtje që të mrekullon. Në cilin rast myslimanët dhe jomyslimanët do të dinin kur u „shpall” një kaptinë (sure), meqë vetë Muhamedi ende nuk duhet t’i kishte të sistemuara. Pse paragjykohe si zemërsëmurë ata që nuk besojnë në ato që po sajonte Muhamedi. Allahi, siç e mendojnë besimtarët, nuk do të duhej të kishte këso paragjykimesh. Sigurisht që mund të keqkuptohet sikur zemërsëmurët lindin të tillë dhe kot që u ofrohet një dogmë e re fetare...

Allahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre. [10:44]

Ngjan me një proverb njerëzor, që nuk i shkon profetit. Mund të vlerësohet edhe si zhargon dhe stil që përdoret nga polemizuesit. Çështja është: *pse Allahu i lejuaka njerëzit t’i bëjnë padrejtësi vetes së tyre e pse nuk i ndërgjegjëson për drejtësi?*

Formulimi dëshmon se nuk është i formuluar as nga Allahu muhamedan.

Secili popull kishte të dërguarin e vet...[10:47]

Ne dërguam në çdo popull të dërguar...[16:36]

...nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar. [35:24]

Ky është një mashtrim demagogjik, që Muhamedi duhet ta ketë sajuar gjatë polemikave me jomyslimanë. Asgjëkund s’ka asnjë konkretizim për ndonjë „të dërguar”, pos Dhulkarnejnit, për të cilin disa islamologë të universitetit islam *Az’har* (Kajro) mendojnë se ishte Aleksandri i

Madh³⁵⁶. Për këtë është ndier i detyruar edhe përkthyesi Sherif Ahmeti, që të japë sqarime në fusnotë në *Kuran*³⁵⁷.

Që të mos adhuroni tjetër përveç Allahut, unë jam dërguar nga Ai, qortues e përgëzues për ju. [11:2/ përkth. Sherif Ahmeti]

Ky ajet dëshmon kaq konkretisht autorësinë e Muhamedit, sa nuk lë aspak hapësirë për ndonjë hamendësim!

Sikur të ishte ndonjë Kuran, që me të do të ecnin malet, që me të do të plasej toka, që me të do të flisnin të vdekurit? Jo, se e tërë çështja i takon vetëm Allahut. A nuk e kanë të qartë ata që besuan se sikur të donte Allahu, do t'i drejtonte në rrugë të drejtë të gjithë njerëzit, por ata që nuk besuan e për shkak të asaj që bënë, do t'i godasë vazhdimisht fatkeqësia e kohës ose do ta rrënojë vendin e tyre, derisa të vijë urdhri i Allahut. Allahu nuk e thyen premtimin. [13:31]

Formulim tepër i përcartë. Nuk ia vlen të komentohen këto broçku-lla kaq barbare. Formulimi „sikur të donte Allahu, do t'i drejtonte në rrugë të drejtë të gjithë njerëzit, por ata që nuk besuan e për shkak të asaj që bënë, do t'i godasë vazhdimisht fatkeqësia e kohës ose do ta rrënojë vendin e tyre”, është reflektim i mendësisë destruktive të Muhamedit, assesi e asnjë Allahi, fikSION ose sajese abrahamike.

Shembulli i xhenetit që u është premtuar të devotshmëve është: që në të rrjedhin lumenj, që ushqimi dhe hija në të është e përhershme...[13:35]

Premtim mashtrues, tepër joshës për beduinët e përcëlluar nga dielli në shkretëtira, të cilët kanë vuajtur për të gjetur hije, për t'u strehuar dhe ujë për të shuar etjen. Patjetër, i zgjuar për të mashtruar me premtime joshëse, sepse burrat beduinë vuanin për gra dhe për hije...

³⁵⁶ Po të të pyesin ty për Dhulkarnejnin, thuaju: “Do t’ju rrëfej për punën e tij me Kuranim (me shpallje)”. [Kurani, surja El-Khaf (shpella), 18:83]

³⁵⁷ Kurani, bot. në shqip nga mbreti saudit Fehd ibn Abdulaziz Al-Saud, fusnotë në f. 350, përkthyer e komentuar nga prof. Sherif Ahmeti.

*Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kuranin dhe Ne, gjithsesi, jemi mbrojtës të tij.
[15:9]*

Përcaktimet të ngjashme si ky e bëjnë të pamundur korrekturën e *Kuranit*, ta zëmë të largohen ajetet e *abroguara*, të përsëritura. Të redaktohet në gjuhë standarde arabe, që të mund të kuptohet tani nga arabët dhe që të mund të përkthehet pa spekulime e vështirësi. Pra, myslimanët duhet të kuptojnë se Muhamedi nuk duhet ta ketë menduar konservimin e ortografisë dhe formulimin gjuhësor, pos atij përmbajtjesor.

Nëse ti përpiqesh për t'i vënë në rrugë të drejtë ata, Allahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur, dhe për ata nuk ka ndihmëtar. [16:37]

Merre me mend, edhe Muhamedi qenkësh angazhuar kot! Këtë përcaktim kaq destruktiv duhet ta ketë sajuar ndonjë bashkëveprimtar i Muhamedit. Përndryshe, Muhamedi paskësh qenë një debil ordiner, i cili ka sajuar ajete edhe kundër vetes së tij...

S'ka dyshim se ata që nuk besojnë ajetet e Allahut, ata nuk i drejton Allahu në rrugën e drejtë dhe ata kanë një dënim të dhembshëm. [16:104]

Edhe kjo është broçkull stereotipike muhamedane! Ç'kuptim ka që Allahu të mos i drejtojë edhe ata që nuk besojnë, duke i bindur se duhet të besojnë?!

O grumbull i xhinëve dhe i njerëzve! A nuk ju erdhën nga mesi juaj të dërguar t'ju rrëfejnë argumentet e Mia dhe t'ju tërheqin vërejtjen për takimin tuaj në këtë ditë? Ata thonë: „Dëshmojmë kundër vetvetes“. Ata i pat mashtruar jeta e kësaj bote dhe ashtu dëshmuar kundër vetvetes, se me të vërtetë e refuzonin. [16:130]

Sërish broçkull tipike muhamedane, pa ndonjë përmbajtje logjike, hyjnore, profetike!

Kush udhëzohet në rrugën e drejtë, ai është udhëzuar, e ai që bredhur, ka bredhur në dëm të vet dhe askush nuk e merr të keqen e tjetërkujt. Ne nuk dënojmë para se të dërgojmë pejgamberë! [17:15]

Sërish përcaktim i pakuptimtë, aspak hyjnor e profetik! „Profetë” semitë janë të sajuar qysh nga 10 tetori 3761, p. e. s., kur „Allahi” (Jhv hebre) duhet të ketë krijuar Adamin. Po para tij, çfarë ka ndodhur me njerëzit, meqë duhet të kenë ekzistuar qysh para qindra milionë vjetësh?! Po për të gjithë popujt e tjerë të botës, pos atyre semitë, çfarë duhet të ketë ndodhur, meqë nuk dimë të kenë pasur profetë?!

Kur Ne duam ta shkatërrojmë një qytet, i nxitim ata që janë mësuar me jetë luksoze, që të jepen pas korrupsionit, e kështu të meritojnë dënimin, dhe pastaj i shkatërrojmë ata gjer në themel. [17:16]

Mendësi kriminale, për të mos e kualifikuar si mendësi fashistoide, tipike muhamedane! Sipas këtij ajeti, ata që bëjnë korrupsion (japin e marrin), nuk qenkan vetja e tyre, por qenkëshin të nxitur nga Allahu! Edhe ky farë Allahu, qoftë edhe vetëm si personazh i shpifur nga Muhamedi, do të duhej të turpërohej për këso formulimesh kaq barbare!

Po të kishim dëshiruar, Ne do ta shlyenim nga gjoksi yt atë që ta shpallëm ty, e ti nuk do të gjeje mbrojtës që do të ruante. [17:86]

Qesharake! Çfarë kishte në gjoks të Muhamedit për ta fshirë. Duhet të ketë sajuar kështu, mashtrueshëm, meqë duhet të ketë menduar se ato që po sajonte, po i arkivonte në zemër (gjoks) dhe jo në tru (kokë). Allahu qenkësh komanduar nga dëshira e tij dhe jo nga arsyeja...

Në *Kuran* kemi edhe ajete që përmbajnë deklarinimin kategorik të Allahut, aspak hyjnore e misionare, si në këtë ajet skandaloz, që po e sjell këtu:

Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka Allah tjetër pos Meje, pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua. [20:14]

Po kaq skandaloz është edhe deklarimi i Allahut, duke anashkaluar komunikimin përmes Muhamedit:

Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe, kurse Unë jam Allahu juaj, pra më adhuroni vetëm Mua! [21:92]

Mbase është e qartë se po bëhet fjalë për qëndrim kategorik, se vetëm islami është e vetmja fe e vërtetë e Allahut, sepse ka ajete që përmbajnë përcaktimin e tolerimit edhe të feve pararendëse abrahamike (hebraizmi dhe kristianizmi).

...për ta është xheneti i Ademit (ndoshta kopshti Eden, sipas Biblës), nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Aty ata do të stolisen me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra, nga mëndafshi i hollë dhe i trashë, duke ndenjur të mbështetur në kanape. Shpërblim i mrekullueshëm është ky! Dhe, sa vendbanim i bukur që është ky! [18:31]

Me të vërtetë, Perëndia i shpie ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira në kopshtije, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të stolisen me byzylykë të artë dhe inxhi, e rrobat e tyre në të (xhenet)do të jenë prej mëndafshi. [22:23]

Xhenetet e Ademit në të cilin hyjnë ata, duke u veshur me byzylykë ari dhe margaritarë, veshja e tyre, në to, është prej mëndafshi. [35:33]

Joshje mashtruese e Muhamedit për t'i përvetësuar lakmitarët krimogjenë! Gjithsesi, joshje degjeneruese! Dhe, fatkeqësisht, joshje që ka gjetur mjaft viktime...

E veprat e atyre që nuk besojnë janë si valët në një rrafshinë, ku i etshmi mendon se është ujë, derisa kur t'i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje. [24:39]

Sërish një formulim, kinse me metaforë të fuqishme, por asgjë mrekulluese, sepse kur jobesimtarët do të ecin në shkretëtira të pafundme

dhe do të vazhdojnë të mos i mbarojnë ato valë, për sa kohë nuk është arritur fundi i shkretëtirës. Dhe secili prej atyre jobesimtarëve e kishte provuar sa herë, se në ato shkretëtira asgjëkund nuk e ka gjetur Allahun, prej të cilit i qenkësh dhënë ndonjë llogari, rrjedhimisht ndonjë dënim. Ndërsa formulimi „Allahu është i shpejtë në llogaritje”, do të duhej të diskualifikuar si blasfemi, sikur të ekzistonte Allahu.

Ai mban qiellin të mos bjerë në tokë, pos nëse dëshiron Ai. [22:65]

Ja mendësia „shkencore“ muhamedane, që mendon se qielli është gjysmëkupolë (kulm) i vendosur mbi tokën e rrafshët dhe Allahu muhamedan e mbajtka që të mos bjerë në tokë. Sa shumë myslimanë mashtrues propagandojnë Kuranin si vepër edhe shkencore, i cili ka paraparë zbulimet më të rëndësishme...

Mjerë myslimanëbtë tillë, sidomos kur besojnë në të tilla broçkulla!

E vallë, a është ai që u kanë zbukuruar veprat e tij të këqija dhe ato i duken të mira? Me të vërtetë, Perëndia e shpie në humbje kë të dojë, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. E, mos u shkatërro për humbjen e tyre! Perëndia, me të vërtetë, është i Gjithëdijshëm për atë që punojnë ata. [35:8]

Tipike muhamedane! Aspak hyjnore e profetike!

O ju njerëz, ju keni nevojë për Allahun e Allahu nuk ka nevojë për ju...[35:15]

Aspak profetike e as hyjnore. Po vetëkuptohet, formulimi gjuhësor e përjashton Allahun për autor!

Prandaj, Ne të shpallëm ty Kuran arabisht, që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe ata përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për ditën e tubimit (kiametit), për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në Xhenet, kurse një grup për në zjarr. [42:7]

Vërtet, është fatkeqësi e madhe për njerëzimin, që kjo dogmë ka mundur të përhapet kaq shumë dhe nuk është përkufizuar vetëm në

„kryefshatin” e quajtur Mekë, siç e ka menduar Muhamedi pesimist. Sa për sqarim, gjatë 13 vjetëve misionarizëm (9610-622), Muhamedi duhet të ketë konvertuar vetëm rreth 140 veta, duke llogaritur edhe fëmijë, siç ishte adoleshenti 14-vjeçar Ali ibn-Talib, i cili duhet të ketë qenë myslimani i tretë (Muhamedi i pari, Hatixheja e dyta). Gjithashtu vlen të ofrohet edhe informimi, se një pjesë e madhe e të konvertuarve ishin skllavër, që i blinin Hatixheja dhe Muhamedi për punë skllavëruese.

A e ke parë atë, që kënaqësinë e vet e ka marrë për Allah dhe Perëndia e ka lënë në humbje duke e ditur (të keqen e tij), ia ka vulosur të dëgjuarit e tij dhe zemrën e tij, e para syve të tij ka vënë perde? Kush do ta udhëzojë atë, pos Perëndisë? A nuk po kuptoni?[45:23 / shqip H. E. Nahi]

Nuk meriton as koment!

Shembulli i xhenetit, i cili u është premtuar atyre që janë ruajtur, ka lumenj me ujë të mirë për të pirë, lumenj nga qumështi me shije të paprishur, lumenj nga vera e shijshme për njerëz, lumenj nga mjalti i kulluar, ata kanë aty edhe gjithfarë lloj pemësh, kanë edhe falje nga Allahu i tyre, jo si ai që është përgjithmonë në zjarr dhe u shuhet etja me ujë të valë, që ua copëton zorrët e tyre? [47:15]

Joshje mashtruese për beduinët e përmalluar për lumenj me ujë, për qumësht, për verë, për mjaltë, për pemë. Kësaj joshjeje ia ka shtuar edhe kërcënimin me ferr, duke përdorur figuracion të fuqishëm, sikur ata, që përjetësisht do të digjen (asnjëherë nuk do të harxhohen), sa herë që kërkojnë ujë për të shuar etjen, u jepet ujë i nxehtë. Mendësi tipike muhamedane, e zyrtë, e kriminalizuar, barbare. Ç’logjikë ka që njeriu, përjetësisht në zjarr, të mund të kërkojë edhe ujë për të shuar etjen?! Të tilla broçkullave perversiteteve u besojnë vetëm injorantët dhe viktimat e indoktrinimit muhamedan!

E në anën tjetër, për t’i ndëshkuar hipokritët dhe idhujtarët, mendimi i të cilëve ndaj Allahut ishte mendim i keq. Atyre u raftë e keqja! Allahu shprehu urrejtje kundër tyre dhe i mallkoi e xhehenemin e përgatiti për ta, që është vendbanim i

keq. [48:6]

Gjithashtu përmbajtje barbare! Tipike muhamedane!

Ata që, duke mos pasur kurrfarë fakti pranë vetes, kundërshtojnë argumentet e Allahut, do e pësojnë nga urrejtja e madhe e Allahut dhe e besimtarëve. Allahu vulos çdo zemër të arrogantis dhe zullumqarit. [40:35]

Përcaktim gjithashtu barbar: nxitje e myslimanëve për të urreyer jomyslimanët!

S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe keni frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Allahu). [49:10]

Muhamedi duhet të ketë synuar krijimin e një populli homogjen në gjithë botën, mundësisht të gjithë nën sundimin e tij, meqë nga kushërirri Varaka, misionar kristian, duhet të ketë dëgjuar gënjeshtër se profetët e hershëm kanë jetuar deri edhe 1000 vjet...

Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër gjë, pos që të më adhurojnë mua. [51:56]

Është pak të thuhet se Allahu i paskësh krijuar njerëzit vetëm që ta adhurojnë atë! Në fakt, kjo është mendësi perverse e Muhamedit, i cili ka menduar se njerëzit duhet të ekzistojnë vetëm për ta adhuroar atë...

O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull që Allahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu si nuk kanë shpresë jobsimtarët prej të vdekurve në këtë botë, ose në ringjallje. [60:13]

Sërish apel fashistoid, i cili nga myslimanët zbatohet si urdhër nga Allahu i tyre. Nga formulimi rezulton të jetë për popujt e besimit judaist.

Është Ai (Allahu) që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë,

për ta bërë mbiAllahërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnjë. [61:9]

هو الذيار سلسر سولهبالهدودينا الحقايطهره «يعليه» «علادينكله» «جميعاالأديانالمخالفةلوهولوكر هالمشركونذلك

Ky ajet është pothuajse identik me ajetin 9:33. Dallimi është vetëm në „elasticitetin” e përkthyesit. Pse duhet të përsëriten ajete me përmbajtje të njëjtë?! Unë do të thosha mungesë e kapaciteteve të „redaktuesve”, për të hequr njërin ajet dhe, tashmë, asnjë besimtar mysliman nuk guxon t’i korrigjojë ndonjë gërmë *Kuranit*, meqë besojnë se Allahu ua ruan të konservuar...

Mbase janë të mjaftueshme këto vërse, për t’u bindur se lavdërimet që i bëhen *Kuranit* janë vetëm propagandë mashtruese!

II. 9. Kurani - abrogimi i ajeteve paqësore me shpatare

Tematikë tejet problematike e *Kuranit* është i ashtuquajtur i abrogimi i ajeteve (ajeteve) të caktuara, që do të thotë shfuqizimi dhe zëvendësimi i tyre me ajete të mëvonshme. Abrogim në arabisht: nas’*h* /ناسخ/ ndërsa forma aktive: nasih /ناسخ/.

Trajtimi i tematikës së abrogimit të ajeteve ka nxitur përçarje mes interpretuesve myslimanë (tefsirologëve), meqë ka qenë problematik identifikimi konkret i ajeteve të abroguara. Do të ishte logjike që ajetet e abroguara të mos figuronin fare në *Kuran*, meqë masat e gjera të besimtarëve, por as klerikët dhe teologët nuk mund t’i identifikojnë.

Abrogimet janë legalizuar edhe përmes përcaktimeve të Muhamedit, të sanksionuara në *Kuran*. Ja ajetet përkatëse:

Ne nuk i mohojmë ajetet e as nuk i lëmë që të harrohen ato. Ne sjellim ndonjë tjetër më të mirë ose të ngjashëm me të. Ti e di se Perëndia është e plotfuqishme. [2:106]

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Kur një ajet e zëvendësojmë me një ajet tjetër - e Allahu di më së miri se çka shpall - ata thonë: „Ti (Muhamed) je vetëm trillues!“ Jo, por shumica e tyre nuk dinë. [16:101]

Formulime tejet të përcarta! Por ajete të këtilla mund të bien ndesh me ajete që ndalojnë ndryshimet, rrjedhimisht edhe abrogimet. Citoj:

...askush nuk mund t'i ndryshojë fjalët e Perëndisë... [6:34]

Thuaj: „Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që është shpallë. Unë druaj - nëse e kundërshtoj Zotit tim - dënimin e Ditës së Madhe“. [10:15]

S'ka ndryshim në fjalët e Perëndisë. [10:64]

Pra, ajetet pro e kundër abrogimeve dëshmojnë se sa kundërthënës ishte Muhamedi, rrjedhimisht *Kurani*. Kjo është njerëzore, meqë si mund të mbante mend Muhamedi ajetin e sajuar 20 vjet më parë, që nuk ishte i shkruar, që të mund të rishikonte, për të mos sajuar ajet të ri, që bie ndesh me atë të mëhershmin! Edhe në kohën moderne formohen komisione me profesionalistë për hartimin e projektkushtutave dhe ligjeve. I kanë të gjitha mjetet teknike (lapsa, letër, kompjuterë...) dhe, megjithëkëtë, ndodh të formulojnë nene kundërthënëse. Pastaj, përvoja praktike bëri që Muhamedi të ndryshonte mendësinë e tij me 180 gradë: nga misionari paqësor i viteve 610-620, në misionar agresiv të viteve 621-632. Dhe vetëm nëse kemi parasysh rrjedhën e ngjarjeve, do të mund të kuptonim pse ajetet me përcaktime paqësore u abroguan me ajete të shpatës, siç i quajnë klerikët myslimanë ajetet me përcaktime të dhunshme.

Sikur Muhamedit të mos vdiste fare papritur në moshën 62-vjeçare, ndoshta do t'i kishte përmbledhur të gjitha ajetet në një libër, duke i shartuar ajetet që kishte abroguar, meqë duhet të ketë pasur synim për t'u lënë besimtarëve një dogmë pa kundërthënie kontroverse e konfuze.

Në parim, kur për të njëjtën tematikë e ngjarje kemi ajete kundërthënëse, atëherë ajetet e sajuara më vonë i abrogojnë ajetet e

mëhershme. Rrjedhimisht, ajetet e sajuara në Medinë (622-632) janë më të vonshme se ajetet e sajuara në Mekë (610-622) dhe, prandaj, janë të plotfuqishme dhe i abrogojnë ajetet mekase.

Nga abrogimi janë shënjestruar kryesisht ajetet me përcaktime paqësore, të cilat Muhamedi duhet t'i ketë sajuar gjatë misionarizimit të tij në Mekë (610-622), me ajete që i ka sajuar gjatë ushtrimit të sundimit të tij në Medinë (623-632). Shumë nga këto ajete, që i kanë abroguar ajetet paqësore, dijetarët islamë i kanë quajtur ajete të shpatës (arabisht: السيفالآية / *ajat as-saif*), ndërsa „të abroguarat me abrogime” arabisht i kanë quajtur: „*an-Nasihwa-l-mansuh*”.

Dijetari më i hershëm që është marrë me këtë tematikë është Kata-da in Diama as-Sadusi, Abu'l-Kattab / قتادة بن دعامة السدوسي، أبو / (që vdiq më 736), në librin e titulluar: „*Kitab an-Nasih va-l-mansuh*” (*Libri i abrogimeve*).

Për abrogimin e ajeteve paqësore nga ajetet e shpatës ka shkruar edhe filologu dhe interpretuesi i afirmuar i *Kuranit*, Abu Jafar An-Nahhas / أبو جعفر النحاس (vdiq në vitin 949)³⁵⁸. Ai ka identifikuar 113 ajete të abroguara nga ajetet e shpatës, në kapitullin me titull: „Shqyrtime të abrogimeve në *Kuran* nga ajete e shpatës” / بيان المنسوخ في القرآن / *Bajanal-mansuhfi'l-Kurani-ajat as-saif*.

Interpretuesi tjetër mysliman, Hibatallah ibn Salama ibn Nasr (vdiq më 1019), ka identifikuar 124 ajete të shpatës, që duhet t'i kenë shfuqizuar ajetet „paqësore“.

Interpretuesi i *Kuranit*, andaluziani Al-Kurṭubi / القرطبي (1214 - 1272) ka cituar interpretuesit e shek. 7-8, duke përmendur abrogimin e ajetit 88:22.

*Ti këshillo - se ti je vetëm këshillues, [88:21]
ti nuk je mbi ta imponues! [88:22]*

³⁵⁸ Carl Brockelmann: *Geschichteder arabischen Litteratur*. Zweiteden Supplement bändenange passte Auflage. Brill. Leiden 1943. Band 1. S. 138

Pra, kur Muhamedi nga misionari paqësor (mekas) ka eskaluar në sundimtar luftarak (medinas), ka sajuar ajete shpatarake, duke abroguar ajetet paqësore, si ky që e ndalonte imponimin ndaj të tjerëve.

Dijetari tjetër mysliman, Muhammad ibn 'Alīasch-Schaukānī / محمد بن علي الشوكاني (1760-1834) ka konkretizuar abrogimin e ajetit 10:108.

...E, unë nuk jam mbikëqyrësi juaj. [10:108]

Abrogimin e ka ndërmarrë Muhamedi, meqë në Mekë ai nuk imponohej dot si sundimtar, por vetëm si misionar. Ai ende nuk kishte potencial fizik (për 12 vjet angazhim, ai ia kishte dalë të konvertonte në islam vetëm rreth 140 veta). Ndërsa në Medinë bëhet sundimtar tiranik.

Interpretuesi klasik i *Kuranit*, Abu Xhafar Muhamed ibn Xharir at-Tabari / الطبري جرير بن محمد جعفر أبو (839 - 923), interpreton gjerësisht dhe saktë suren e shpatës 9:5, duke e lavdëruar Muhamedin për rolin e tij meritot të konvertimit me dhunë. Dhe kjo ndodhte, për shkak se dijetarët e shek. 7-9 nuk praktikonin taktikë demagogjike, si të mëvonshmit, që mundoheshin të kamuflonin përcaktimet luftarake të ajeteve shpatare.

Edhe ajetet 29:46 dhe 8:61, sipas Katada ibn Diama, janë abroguar nga ajete shpatare (9:5 dhe 29).

Dhe, polemizoni me ithtarët e Librit në mënyrën më të bukur, por jo me zullum-qarët e tyre. Dhe thojuni atyre: „Ne besojmë në atë që na është shpallur neve dhe në atë që ju është shpallur juve. Edhe Zoti ynë edhe Zoti juaj është një dhe ne Atij i përulemi“. [29:46]

Nëse ata tregojnë prirje për paqe, trego edhe ti prirje për të dhe mbështetu te Perëndia! Se Ai, me të vërtetë, i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë. [8:61]

Është interesante se pikërisht në këto ajete të abroguara, thuhet nga klerikët demagogë sa herë që duan të mashtrojnë për islamin si fe paqësore, edhe pse ajetet me këtë përmbajtje të ngjashme janë të abroguara (shfuqizuar me ajete zëvendësuese).

Shembull tipik për abrogimet shkallë-shkallë të ajeteve kemi të ashtuquajturat ajete të verës, që eskalojnë deri në ndalimin e plotë të saj. Sipas ajetit 16:67, vera është e lejuar. Ndalimi i pjesshëm i saj pason në ajetin 4:43, ndërsa ndalimi i plotë i verës bëhet në ajetin 5:90. Ose abrogimet që kanë të bëjnë me orientimet në namaz: fillimisht nuk kishte orientim të namazit (ajeti 2:115). Përcaktimi i orientimit në drejtim të Mekës bëhet më vonë (ajeti 2:144).

Sipas ajetit 2:240, gratë e veja, pas vdekjes së burrit, duhej të mbaheshin nga familja e burrit, por ky ajet u abrogua me ajetin 2:234, duke e shkurtuar kohëmbajtjen e gruas nga familja e burrit, në 4 muaj e 10 ditë.³⁵⁹

Numri i ajeteve të abroguara është i madh, edhe më i madh duhet të jenë numri i ajeteve abroguese. Të gjitha ajetet me përcaktime agresive mund të trajtohen si ajete abroguese. Ato nuk po i evidentoj këtu, meqë ajetet shpatare (luftarake) do të shqyrtohen në një kapitull të veçantë.

Ja një listë³⁶⁰ me ajete të abroguara dhe ajete abroguese:

2:109 -/- 9:5	4:43 -/- 5:90	6:106 -/- 9:5	16:125 -/- 9:5	53:29 -/- 9:5
2:115 -/- 2:144	4:63 -/- 9:5	6:141 -/- 9:60	24:3 -/- 24:32	58:12 -/- 58:13
2:180 -/- 4:7	4:81 -/- 9:5	8:1 -/- 8:41	32:30 -/- 9:5	60:10 -/- 9:5
2:184 -/- 2:185	4:90, 91 -/- 9:5	8:61 -/- 9:5	33:52 -/- 33:50	73:1-3 -/- 73:20
2:191 -/- 2:193	4:92 -/- 9:5	8:65 -/- 8:66	39:41 -/- 9:5	73:10 -/- 9:5
2:217 -/- 9:5	5:2 -/- 9:5	8:72 -/- 8:75	43:89 -/- 9:5	
2:240 -/- 2:234	5:42 -/- 5:49	9:41 -/- 9:122	45:14 -/- 9:5	
2:284 -/- 2:286	5:106 -/- 65:2	15:85 -/- 9:5	50:45 -/- 9:5	
3:102 -/- 64:16	6:68 -/- 9:5	15:94 -/- 9:5	51:54 -/- 9:5	

Dijetarët islamë vlerësojnë në mënyra të ndryshme numrin e ajeteve të abroguara. Disa mendojnë se vetëm 5 ajete janë abroguar,

³⁵⁹ Burton: *The sources of Islamic law*. 1990, S. 57.

<http://www.amazon.de/The-Sources-Islamic-Law-Abrogation/dp/0748601082>.

³⁶⁰ <http://www.ahlu-sunnah.com/threads/18862-abrogierte-verse...>

disa të tjerë 260. Edhe kjo tematikë është e ngatërruar, sikur të ketë për autor Muhamedin „analfabet”.

Problematika e ajeteve të abroguara është edhe një argument më shumë për të reformuar *Kuranin*, sepse nuk është aspak logjike që ajetet e abroguara të vazhdojnë të qëndrojnë në *Kuran*. E nëse ato largohen, atëherë *Kurani* mbetet pa ajete me përcaktime paqësore. Duke qëndruar në *Kuran*, ajetet e abroguara (të shfuqizuara) po shpërdorohen nga klerikët demagogë.

Gjatë analizimit të *Kuranit*, deri tani kam identifikuar disa ajete, që janë të ngjashme dhe qëndrojnë pa arsye në *Kuran*. Ndoshta edhe prania në *Kuran* e këtyre ajeteve të njëjta, është dëshmi se *Kurani* nuk është gjithaq perfekt, siç e propagandojnë propagandistit e tij.

Fatkeqësi është pamundësia e redaktimit të *Kuranit*, i cili ka nevojë për redaktimin e përsëritjeve dhe të metat e tjera të tij.

Është ai, që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fe, e mjafton Allahu dëshmitar. [48:28]

Përsëritet:

Është ai, që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. [61:9]

Luftoni ata, derisa të mos mbetet idhujtari (besim i kotë), e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun. Po nëse ata ndalen (i japin fund mosbesimit), Allahu është mbikëqyrës për ata që veprojnë. [8:39]

Përsëritet:

Luftoni ata (idhujtarët), derisa të zhduket propagandimi i idhujtarëve dhe derisa të aplikohet feja vetëm për Allahun. E në qoftë se ndalen, atëherë lëreni armiqësinë, përveç atyre që janë zullumqarë. [2:193]

Ai (Zekiriai) tha: „Zoti im, më jep një shenjë!” Shenja e jote, - tha Ai, - është që tri ditë nuk do të mund t’u flasësh njerëzve, pos me gjeste (mimikë), e ti përmende shumë Zotin tënd dhe madhëroje mbrëmje e mëngjes!” [3:41]

Përsëritet:

Ai (Zekiriai) tha: Zoti im, më jep mua një shenjë (që të di!)” Ai (Allahu) tha: „Shenja jote është se (duke qenë shëndoshë e mirë), nuk do të mund t’u flasësh njerëzve tri net (e tri ditë)”. [19:10]

Ai (Allahu) është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë, për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. [61:9]

Përsëritet:

Ai (Allahu) është që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejnë idhujtarët. [9:33]

Vetëm e Allahut është gjithë çfarë ka në qiej e në tokë ...” [3:129]

Përsëritet:

Vetëm të Allahut janë çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë...[4:126]

Vetëm e Allahut është çfarë ka në qiej e çfarë ka në tokë. (...). [4:131]

Përsëritet:

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Të Allahut janë gjithë çfarë ka në qiej e çfarë ka në tokë...[4:132]

Përsëritet:

(...) Çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë është vetëm e Tij. [4:171]

Ai ishte një popull që kaloi, atij i takoi ajo që fitoi, e juve ju takon ajo që fituat, prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që vepruan ata. [2:134]

Përsëritet:

Ai ishte një popull që shkoi, të cilit i takoi ajo që fitoi, e juve ju takon ajo që fituat, prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që ata vepruan. [2:141]

Është ai, që e dërgoi të dërguarin e Vet me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fe, e mjafton Allahu dëshmitar. [48:28]

Përsëritet:

Është ai, që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fe të vërtetë, për ta bërë mbizotërues mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. [61:9]

Vërtet, Zoti juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin ...[7:54]

Përsëritet:

Vërtet Zoti juaj është Allahu, i cili krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh e pastaj qëndroi mbi Arshin ...[10:3]

Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:15 /shq. H. E. Nahi]

Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:19/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:24/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:28/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:34/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:37/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:40/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:45/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:47/shq. H. E. Nahi]
Mjerë ajo ditë për përgënjeshtarët! [77:49/shq. H. E. Nahi]

Hoxhë Drilon I. Gashi, i cili ka bërë master në teologjinë islame, në Jordani, më dërgoi një punim të tij për 22 ajetet e abroguara dhe zëvendësimet e tyre, bashkë me arsyetimet përkatëse islamike. Pyetjes sime, pse ato duhet të qëndrojnë në *Kuran* edhe më tutje, përgjigjja e hoxhës ishte goxha e përçartë. Por, meqë ishte komunikim privat, nuk po e citoj.

Punimin e tij për ajetet e abroguara, hoxhë Drilon Gashi e ka publikuar tashmë.

II. 10. Kurani - përkthimi dhe interpretimi

Tejet intriguese janë edhe zhurmimet e zhurmshme, deri në shurdhim, të propagandistëve myslimanë rreth interpretimit dhe përkthimit të *Kuranit*. Kjo ndodh kryesisht, për arsye se teksti i *Kuranit* ka përmbajtje dhe formulim tepër primitiv, tepër diskriminues, amoral, poligamist, shovinist, pedofil, agresiv, imperialist, fashistoid... Prandaj, duke u fshehur pas interpretimit dhe përkthimit, bëhen përpjekje për ta kamufluar, arsyetuar, mbrojtur e madhëruar këtë kanun e dogmë reaksionare, së cilës mund t'i konkurrojnë ndoshta vetëm *Besëlidhja e Vjetër* dhe *Mein Kampf!*

Klerikët myslimanë ia kanë dalë ta katapultojnë interpretimin e *Kuranit* si një lloj shkence (islame) më vete, duke e quajtur në arabisht *tefsir* [تفسير], që e shqipëruar do t'i shkonte më së miri: *interpretim*. Kjo praktikë ndoshta është kopjuar nga kleri kristian, i cili ka përvetësuar shprehjen e greqishtes *eksegesis* [ἐξήγησις], që e shqipëruar gjithashtu i bie: *interpretim*.

Kushdo që është konfrontuar me klerikë, teologë e myslimanë fundamentalistë gjatë diskutimeve e debateve, sa herë që u është cituar ndonjë ajet (ajet) nga *Kurani*, me përmbajtje edhe fashistoide, janë alarmuar me mbrojtje të zhurmshe e emocionale, se domosdoshmërisht duhet bazuar në interpretim (tefsir) të dijetarëve islamë, për të kuptuar përmbajtjen dhe mesazhin e vërtetë, i cili dallon nga përmbajtja konkrete e tekstit, gjegjësisht nga kuptimi logjik i tij. Ata nuk skuqen e nuk turpërohen edhe kur iu citon ajete nga *Kurani* që përmbajnë përcaktim eksplicit, se gjuha e *Kuranit* është e qartë, meqë është formulim nga Allahu.

Ta zëmë, ajetet në vijim përjashtojnë domosdoshmërinë e interpretimit, si kusht që teksti i *Kuranit* të mund të kuptohet, madje të kuptohet edhe nga analfabetët bashkëkohës të Muhamedit:

...Në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit. Ka të tjera ajete, që nuk janë krejtësisht të qarta (...), që pos Allahut, askush nuk e di domethënien e tyre të saktë...[3:7]

Ne e zbritëm atë Kuran arabisht, ashtu që ta kuptoni. [12:2]

Ky (Kurani) është në gjuhën e qartë arabe. [16:103 / shqip. nga H. E. Nahi]

S'ka dyshim se Ne e bëmë atë Kuran arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni. [43:3]

Ne Kuranin e bëmë të lehtë për ta kuptuar...[54:17]

Propaganduesit myslimanë e përdorin trukun për domosdoshmërinë e interpretimit nga „dijetarët“ edhe të këtyre ajeteve, si të të gjithë *Kuranit*, që të mund të kuptohet përmbajtja e tyre e vërtetë.

Ndoshta i pari dijetar islam, që ka sajuar domosdoshmërinë e interpretimit (tefsir), duhet të ketë qenë persiani At-Tabari [Abu

Xhafar Muhammad ibn Xharir at-Tabarī / [ابو جعفر محمد بن جرير الطبري], i lindur në Tabaristan në vitin 839, dhe vdiq në Bagdad në vitin 923.

Pos veprave historike dhe teologjike, At-Tabari ka merita që ka cituar fragmente të gjata nga biografia e parë për Muhamedin, e shkruar nga Ibn Isaku, sepse origjinali nuk është gjetur. Veprat e tij për interpretim të *Kuranit* janë botuar në Egjipt, të përmbledhura në 30 vëllime. Karakteristikë kryesore e interpretimit të tij është koncepti dialektik i krahasimeve, që dallonte me karakterin propagandistik të interpreteve pararendës.

Interpreti (tefsiristi) tjetër klasik është Ibn Kathiri (1300-1373).³⁶¹ Një përmbledhje të interpretimeve të Tabarit dhe të Ibn Kathirit në gjermanisht e ka bërë Samir Muradi. Deri tani janë publikuar 6 vëllime. Me këtë rast, sa për konkretizim të „shkencës“ së interpretimit (tefsir), po sjell fragmente si është interpretuar surja e parë e *Kuranit* nga ky interpret famëmadh. Fillimisht, teksti i sures „Al-Fatiha“ (Hyrja / hapja):

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:1]

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! [1:2]

Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:3]

Sunduesit të ditës së Gjykimit! [1:4]

Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë! [1:5]

Udhëzona në rrugën e drejtë! [1:6]

Në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur! [1:7 / shq. nga Sherif Ahmeti]

Ibn Kathir fillon interpretim (sipas ajetionit të shqipëruar nga Avni Tahir Xhemaili, por vetëm disa kaptina)³⁶²:

Kjo kaptinë quhet El-Fatiha (në shqip: Hapja e Librit), është kaptina me të cilën fillojnë lutjet-namazi. Nga shumica e dijetarëve është quajtur

³⁶¹ http://www.way-to-allah.com/dokument/Tafsir_Band1.pdf

³⁶² <https://de.scribd.com/collections/3919822/Tefsiri-i-Ibn-Kethirit>

Umm Al-Kitab (Nëna e Librit). Në hadith autentik të transmetuar nga Tirmidhiu, i cili e ngritine shkallën sahih, Ebu Hurejra transmeton e thotë se i Dërguari i Allahut, Muhamedi salallahu alejhi we selem ka thënë:

“Elhamdulilahi-Rabbil-‘Alemin është Nëna e Kur’anit, Nëna e Librit dhe shtatë ajetet e Ku’ranit të lavdishëm që përsëriten (shtatë ajetet e kësaj sureje përsëriten në çdo rekat gjatë namazit)”.

Gjithashtu, është quajtur edhe El-Hamd dhe Es-Salah, sepse Profeti salallahu alejhi weselem ka thënë se Allahu ka thënë:

“E kam ndarë namazin ndërmjet Meje dhe robit Tim në dy gjysma”. Kur robithotë: ‘Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të Gjithësisë!’ Allahu thotë: “Robi im mëlavdëroi”.

El-Fatiha është quajtur edhe Salah, sepse të recituarit e saj është kusht për vlefshmërinë e namazit. Është quajtur edhe Esh-Shifa’ (Shërimi). Gjithashtu, quhet edhe Er-Rukjeh (shërim, mjet shërimi), sepse në Sahih ekziston rrëfimi i Ebu Seidit ku tregon historinë e Sahabiut i cili i këndoi El-Fatihën udhëheqësit të një fisi i cili ishte i helmuar.

Ibn Kat’hir ofron një rrëfim (hadithe):

Transmeton Imam Ahmed Ibn Hambeli në Musnedin e tij se Ebu Seid bin Mua’lla kathënë: “Isha duke u falur, kur më thirri Profeti, kështu që nuk iu përgjigja, derisa embarova namazin. Më pas, iu afrova atij dhe ai më tha: ‘Ç’ të pengoi ty të vije? A nuk kathënë Allahu:

“O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut (duke iu bindur Atij) dhe të Dërguarit të Tijkur ai u thërret tek ajo që u jep jetë”. [8:24]

Pastaj tha:

“Para se të largohesh nga kjo xhami, unë do të të mësoj suren më të vlefshme në Kuran”. Ai më mbante dorën dhe, kur po bëhej gati të largohesh nga xhamia, i thash: “O I Dërguar i Allahut, ju thatë se do të më mësoni suren më të madhe nga Kurani”. “Po”, tha ai.

“Ajo është shtatëshja që përsëritet dhe Kurani i Lavdishëm që më është dhënë mua.”³⁶³

Në vazhdim Ibn Kathiri citon edhe bashkëveprimtarin e Muhamedit, Ebu Huraira:

I Dërguari i Allahut ka thënë: „Kur imami të reciton: „Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!“ [1:2], atëherë ju përgjigjuni: Amin!“, meqë nëse kjo lutje përputhet me deklaratën e engjëllit, do t’u falën gjynahet“.³⁶⁴

Sërish Ibn Kathiri citon edhe një hadithe të Buharit, ku thuhet se Muhamedi paskësh thënë: nëse nuk përsëritet në çdo lutje kjo sure, atëherë lutja nuk është bërë e plotë. Me këtë rast Muhamedi i paskësh recituar të shtatë ajetet e kësaj sureje.

Interpreti Ibn Kathiri shtron pyetjen për çfarë njerëzish bëhet fjalë në ajetin nr. 7 të këtij kapitulli (sureje), duke iu përgjigjur përmes hadithes (rrëfimit) të hadithologut At-Tirmidhi. Hadithja përmbillet me njoftimin se Muhamedi paskësh thënë: „Ndaj jehudinëve ka ndodhur zemërimi i Allahut, ndërsa të krishterët janë të mashtruar“.

Fatkeqësisht, po t’u besonim këtyre broçkullave, na rezulton se *Kurani* filluaka me një sure, që aksentin kryesor e ka zemërimin e Allahut kundër jehudinëve dhe zhvlerësimin e kristianëve si të

³⁶³ <https://de.scribd.com/document/110331512/Tefsiri-i-sures-Fatiha-1>

³⁶⁴ Citimet në vazhdim janë nga ajetioni gjermanisht, prandaj nuk po e përsërisë shënimin në fusnotë se është sipas portalit:

http://www.way-to-allah.com/dokument/Tafsir_Band1.pdf

devijuar. Për të vërtetuar këtë diskualifikim të Muhamedit ndaj jehudinëve dhe kristianëve citohet edhe një hadithe tjetër pasuese, po nga hadithologu Tirmidhi.

Në vazhdim Ibn Kathiri (dez)informon për karakterin shërues të kësaj sureje, duke u bazuar në hadithen nga përmbledhja e Buharit. Meqë është rrëfim i gjatë, por e perifrazoj variantin e shkurtuar.

Disa medinas na paskëshin qenë në rrugëtim. Janë lodhur dhe kanë kërkuar strehim te ca beduinë. Ata i kanë refuzuar. Në ato çaste njërin e paskësh kafshuar një gjarpër helmues. Beduinët i kanë pyetur medinasit, nëse di ndonjëri të shërojë nga kafshimi helmues i gjarpërit. Rrugëtarët qenkëshin përgjigjur që shërojnë, por me pagesë. Beduinët u kanë ofruar dele. Pastaj njëri nga ata ka filluar me recitim të kësaj sureje, derisa ka grumbulluar pështymë që ta pështyjë mbi plagë. Me këtë rast i helmuari është shëruar. Por në fund ata i kanë refuzuar delet, me shpjegimin se do ta pyesin profetin nëse u lejoheshin. Medinasit e kanë pyetur Muhamedin. Ai u është përgjigjur:

Nga e dije ti se Al-Fatiha [1:1-7] kishte efekt shërues? Po, merrini delet dhe më jepni mua një pjesë!

Pak a shumë ky është interpretimi i Ibn Kathirit për suren e parë të *Kuranit* (e publikuar në këtë përmbledhje në faqet 12-19, në arabisht dhe gjermanisht).

Nga ky konkretizim mund të konstatohet se interpretimi i *Kuranit* vetëm shkencë nuk mund të quhet. Përgjithësisht, interpretimet ngjajnë të jenë tejet subjektive!

Megjithatë, do të ishte e mangët kjo tematikë, nëse nuk do të sillnim edhe interpretimin e ndonjë ajeti agresiv, ta zëmë ajetit 5:33:

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë nuk është vetëm të mbyten ose të gozhdohen, t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, por edhe të dëbohen

nga vendi. Ky është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33 / shq. nga Sherif Ahmeti]

Ibn Kathiri:

Moharebeh (të bësh luftë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij) do të thotë „të kundërshtosh“. Kjo klasifikohet si kufër (në qoftë se kemi të bëjmë me luftim aktiv), si dhe grabitje dhe përhapje frike. Kështu kualifikohet edhe shkatërrimi në tokë...“

Në vazhdim citohet hadithja vijuese, për të konkretizuar si dënohen ata që kundërshtojnë Allahun dhe Muhamedin:

Aishja transmeton se i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë: „Nuk është e lejuar të vrarësh një mysliman, përveç nëse ai ka bërë njërin nga këto tri krime:

- ai ka kurvëruar: duhet vrarë me gurë;
- nëse ka vrarë një mysliman me qëllim;
- dhe nëse del nga islami dhe pastaj kundërshton Allahun dhe të Dërguari i Tij: ai duhet të mbytet, të gozhdohet ose të dëbohet nga vendi.

Ebu Hanife dënimin „dëbuar nga Toka“ e përcakton edhe si mundësi për ta burgosur, (që i bie, në përshtatje me rrethanat kur ka jetuar Ebu Hanife).

Në vazhdim citohet hadithja:

Abu Kilaba ka raportuar se Enesi (Bin Malik) ka thënë: „Një grup prej tetë njerëzish të ‘Ukl erdhën tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe i dha betimin për besnikëri në islam (konvertim). Atyre nuk iu përshtat klima dhe prandaj u sëmurën. Ata u ankuan tek i Dërguari i Allahut (s.a.s.). Ai ju tha: „A po shkon me barinj të tanë që po ruajnë devetë dhe të pini urinë dhe qumësht devesh?“ Ata u përgjigjën: „Po, jemi gati.“ Ata shkuan dhe pinë qumësht dhe urinë deveje. Pas kësaj, ata u shëruan. Pastaj ata vranë barinj të dhe i grabitën devetë. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) u informua dhe dha urdhër të ndiqen. Ata u kapën dhe u sollën para të Dërguarit të Allahut. Pastaj ai urdhëroi që duart dhe këmbët e tyre t’u pritëshin dhe

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

sytë e tyre t'u nxirreshin, çka edhe ndodhi. Pastaj ata u hodhën në diell, derisa i mbyti etja.

Në vazhdim citohen edhe hadithe të tjera, që ndërlidhen me ngjarjen.

Mbaj mend të kemi debatuar gjatë në rrjetin social FB për disa ajete (ajete) agresive me hoxhë Drilon Gashin, në mesin e të cilëve ishte edhe ajeti 5:33. Gjatë debatit ai ka cituar hadithen e sipërcituar, për ta arsyetuar këtë ajet kaq barbar. Në pyetjen time se pse duhet të jetë në *Kuran* një ajet që lidhet me një krim konkret, hoxha është përgjigjur se ato që i ka sanksionuar Allahu në *Kuran*, nuk mund t'i largojë askush, meqë vetë Allahu është roje e *Kuranit* (perifrazim i lirë). Pastaj e kam pyetur, se pse kishte të drejtë Muhamedi t'i urdhëronte njerëzit për t'i kapur e mbytur kriminelët, duke konkretizuar urdhrin me prerje të gjymtyrëve, nxjerrje të syve, hedhje në diell në atë gjendje, pa qenë fare gjyqtar, hoxha u përgjigj se ai ishte më kompetent se çdo gjyqtar, meqë Allahu e kishte graduar atë për profet dhe, për rastin konkret, i „kishte zbritur“ ajetin në fjalë. Gjithashtu e kam pyetur hoxhën, nëse mund të praktikohet i njëjti ajet edhe kundër rreth 6 miliardë njerëzve, që nuk e njohin Allahun muhamedan për zot, as Muhamedin për profet. Si përgjigje ai citoi ajete me përcaktime tolerante ndaj jomuslimanëve, duke menduar se unë nuk kisha informacione që, kur dy a më shumë ajete kanë të bëjnë me të njëjtën çështje, atëherë duhet zbatuar ajeti që „ka zbritur“ më vonë; përgjithësisht ajetet tolerante Muhamedi i ka sajuar gjatë misionarizimit të tij në Mekë (610-622), kurse ajetet e dhunshme, të cilat dijetarët myslimanë i quajnë ajete të shpatës, Muhamedi dhe bashkëveprimtarët i kanë sajuar kryesisht gjatë sundimit barbar në Medinë (623-632).

Tani shtrohet pyetja: si do ta ndihmonin myslimanin interpretimet „shkencore“ të *Kuranit*, që ai ta kuptonte dhe praktikonte këtë ajet, ose

edhe suren fillestare që trajtuam? Në interpretim nuk kishte ndonjë këshillë, që myslimanët të përmbahen nga keqkuptimi i zemërimit të Allahut ndaj jehudinëve, ose për devijimin e kristianëve nga rruga e Allahut [1:7], dhe nuk kishte as edhe ndonjë këshillë që të përmbahen për të mos masakruar të gjithë ata „që kundërshtojnë Allahun dhe Muhamedin dhe bëjnë shkatërrim në tokë“ [5:33]. Përkundrazi, udhëzohen edhe për dy dënime barbare shtojcë, që nuk e përmban ajeti: nxjerrjen e syve dhe trupin e sakatosur ta hedhin në diell përcëllues. Përndryshe, myslimani mbetet të (zh)vlerësojë vetë se cilët janë kundërshtarë të Allahut e Muhamedit dhe cilët shkatërrues në tokë duhet të masakrohen, siç urdhëron ajeti 5:33. Teksti është tepër i qartë e konkret. Fatkeqësisht, besimi e pengon myslimanin „e rëndomtë“ të kuptojë, qoftë vetëm duke u bazuar në formulimin gjuhësor, se Allahu nuk është autor i tekstit, por Muhamedi, për çka ofrohen dëshmi edhe nga hadithet përkatëse. Po të ishte autor Allahu, nuk do të fillonte ajetin me formulimin: „Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij“, sepse këtu po rezulton si personazh pasiv, i ranguar njësoj me Muhamedin. Allahu do të duhej ta formulonte: „Dënimi i atyre që më kundërshtojnë mua (Allahun) dhe të dërguarin tim...“. Por ja që myslimanët janë të penguar nga mashtrimi i madh, i mitizuar dhe i hyjnizuar, se Allahu na qenkësh autor i *Kuranit*, dhe kush nuk i përmbahet, mund të diskualifikohet si dezertor e kundërshtar i Allahut dhe Muhamedit.

Tipizim interesant i terrorizmit aktual islamik, që bazohet në urdhëresat e këtij ajeti [3:55], është se asnjë ndëshkim ndaj jomyslimanëve ose ndaj myslimanëve dezertorë (apostazistë) nuk ndodhi se ata kundërshtojnë e mohojnë Allahun, por të gjitha krimet terroriste myslimane kanë për motiv hakmarrjen ndëshkuese vetëm për kritika ndaj Muhamedit (qoftë ato edhe në formë karikature), për mohimin e Muhamedit si profet, për informimet se Muhamedi ka praktikuar pedofili, nekrofil, dhunime seksuale ndaj vajzave e grave të zëna robëresha gjatë sulmeve e betejave „xhihadiste“ etj.

Po sjell edhe një fragment interpretimi nga ideologët e rinj islamë, sepse ata mesjetarë duhet të jenë bazuar kryesisht në legjenda, të përcjella përmes haditheve.

Njëri prej ideologëve e frymëzuesve islamikë më me ndikim në shekullin e kaluar, ideologu kryesor i organizatës famoze „Vëllazëria Myslimane“, është egjiptiani Sajid Qutb (1906-1966). Ai, në veprën e tij me ndikim të madh *Ma'alimfial Tariq*³⁶⁵ (Orientime rrugore), ka interpretuar edhe vargun e thirrjes së ezanit, si vijon:

La ilaheill allah nuk e ka kuptimin: Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut! „La ilaheill allah“ do të thotë të heqësh dorë nga zakonet, traditat, dëshirat, mënyra e jetesës, fesë, ideologjisë dhe besimit dhe vetëm islamin ta pranosh si identitet dhe Allahun si ligjvënës. Por kjo është shumë e vështirë për t'u pranuar dhe, për këtë arsye, Profeti dhe sahabët [komunitetin e parë muhamedan në Mekë dhe Medinë] qenë luftuar.

Vepra tjetër e tij është Tafsir Fi Zilalil Quran (Interpretim nën hijen e Kuranit).³⁶⁶

Meqë ky është frymëzues i madh edhe i terrorizmit islamik, po ofroj fragmente të interpretimit të tij, që i ka bërë sures së parë:

Çdo mysliman këtë sure të shkurtër, me shtatë ajete, e reciton të paktën shtatëmbëdhjetë herë në ditë. Një hadithe autentike përmban përcaktimin e Profetit Muhamed: „Lutja që nuk përmban recitimin e Fatihës është e pavlefshme!“

Kjo sure e shkurtër përmban një pjesë të madhe të ideve qendrore themelore të islamit, besimin dhe konceptet e tij. Ajo përshkruan perceptimet dhe qëndrimet e tij thelbësore. E gjithë kjo e bën të qartë pse është zgjedhur për recitime të shpeshta dhe pse ajo është e domosdoshme për vlefshmërinë e lutjes.

³⁶⁵ http://www.atheisten-info.at/infos/zeichen-auf-dem-weg_qutb.pdf

³⁶⁶ <https://tafsirzilal.wordpress.com/2012/06/05/english-language/>

Edhe përkthimi i *Kuranit* shpërdorohet si truk arsyetues, sa herë që klerikëve, teologëve dhe myslimanëve fundamentalistë u citohet ndonjë ajet problematik, por i përkthyer në ndonjërin nga gjuhët botërore. Mbrojtja dhe arsyetimi i parë i tyre është se në origjinal nuk e ka tamam atë përmbajtje, se origjinali është i formuluar nga Allahu në arabishten hyjnore, prandaj edhe nuk mund të përkthehet saktësisht etj. Ky truk përdoret për të mbrojtur edhe nivelin primitiv të formulimit gjuhësor, gramatikor, letrar, filozofik, të tekstit të *Kuranit*. Pra, duke qenë tepër primitiv formulimi i tij gjuhësor, bëhet e pamundur përkthimi i saktë dhe jo teksti origjinal në arabishten hyjnore.

Po ofroj pak informacion historik për përkthime të *Kuranit*.

Rëndom, përkthimi i tij, njësoj siç ka ndodhur edhe me *Biblën*, ka qenë i ndaluar. Motivi i pathënë zëshëm ka qenë që masat popullore të mos e kuptojnë përmbajtjen, por të jenë të varura vetëm nga propaganda e klerikëve. Në rastin e *Kuranit* duhet të ketë pasur një përjashtim simbolik, siç kanë spekuluar mbledhësit e legjendave: në kohën e Muhamedit qenkëshin përkthyer në persisht ca ajete, për t'ia ofruar njëfarë mbreti persishtfolës. Por vetëm në shekullin e kaluar është toleruar përkthimi i *Kuranit*, madje është sponsorizuar nga kryeqendrat propaganduese të islamit.

Deri tani dihet se për herë të parë *Kurani* është përkthyer në latinisht, në vitin 1143, nga prifti Petrus Venerabilis. Njëkohësisht duhet ta kenë përkthyer edhe anglezi Robert von Keton dhe hebreu i shuguruar (kristianizuar) Petrus Alfonsi. Përkthimin e Alfonsit e kanë përpunuar e letrarizuar prifti Herman von Karinthia dhe saraqeni Mohamet në Spanjë. E përgatiti për shtyp Peter von Poitiers dhe u botua për herë të parë në vitin 1543 në Bazel (Zvicër). Kaq sa i përket

aspektit historik të përkthimeve të para, për të mos e zgjatur me historikun e përkthimeve të tjera, në gjuhë të tjera.

Vetë *Kurani* origjinal (në arabisht), për herë të parë është shtypur në vitin 1694, në Hamburg (Gjermani).

Historiku i përkthimit të *Kuranit*, më saktësisht i shqipërimit, është i vonshëm.

Studiuesi Lidian Cikalleshi është i mendimit se shqipërimin e parë të *Kuranit* e ka bërë Naim Frashëri jo në tërësi, por fragmentarisht, në librin e tij me titull *Thelbi i Kuranit*, botuar në vitin 1894 në Bukuresht (nga diaspora e atyshme shqiptare). Pastaj disa fragmente i ka përkthyer Ilo M. Qafëzezi në vitin 1921, por përkthim nga anglishtja. Ndërsa shqipërimi i parë i plotë është bërë nga teologu dhe kleriku Feti Mehdiu në vitin 1984 dhe është botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) në vitin 1985 (878 faqe). Në vitin 1987 e kanë shqipëruar edhe Hasan Efendi Nahi dhe Sherif Ahmeti. Shqipërimin e Sherif Ahmetit e ka botuar BIK në vitin 1988 dhe është pothuajse varianti kryesor në Kosovë.

Ta shohim tani, me shembuj konkretë, si dallojnë mes tyre tri shqipërimet e *Kuranit*:

Surja e parë [Al-Fatiha / Hyrje]:

<u>Feti Mehdiu:</u>	<u>Sherif Ahmeti:</u>	<u>Hasan Efendi Nahi:</u>
<i>Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmi, Mëshirëplotit! [1:1]</i>	<i>Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:1]</i>	<i>Me emër të Allahut, Mëshirues dhe Përdëllimtar i Madh. [1:1]</i>

<p>Lavdërimi është për Allahun, Zot i botëve, [1:2]</p> <p>Të Gjithëmëshirshmin, Mëshirëplotin, [1:3]</p> <p>Sunduesin e ditës së gjykimit [1:4]</p> <p>Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojmë. [1:5]</p> <p>Drejtona në rrugën e drejtë! [1:6]</p> <p>Në rrugën e atyre, të cilët i bekove, jo të atyre që kanë merituar hidhërimin, e as të atyre që kanë humbur! [1:7]</p>	<p>Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! [1:2]</p> <p>Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! [1:3]</p> <p>Sunduesit të ditës së Gjykimit! [1:4]</p> <p>Ty të adhurojmë dhe prej Teje ndihmë kërkojmë! [1:5]</p> <p>Udhëzона në rrugën e drejtë! [1:6]</p> <p>Në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar dhe që kanë humbur! [1:7]</p>	<p>Çdo lavdërim i përket Perëndisë, Zotit të Gjithësisë [1:2]</p> <p>Mëshirues dhe Përdëllimtar i Madh. [1:3]</p> <p>Sunduesit të ditës së gjykimit. [1:4]</p> <p>Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë! [1. 5]</p> <p>Udhëzона në rrugë të drejtë! [1:6]</p> <p>Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi. E jo në të atyre që kanë shkaktuar pezmin, as në rrugën e atyre që janë të humbur! [1:7]</p>
---	--	---

Po ofroj edhe variantet „origjinale“ të përkthimit profesional nga gjermani Rudi Paret dhe të përkthimit (jo shqipërim) nga unë:

„Origjinali“:	Rudi Paret:	Përkthimi:
<p>بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ [1:1]</p> <p>« الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ » [1:2]</p> <p>« الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ » [1:3]</p> <p>« مُلِكِ يَوْمِ الدِّينِ » [1:4]</p> <p>إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ [1:5]</p>	<p>1. Im Namendes barmherzigen und gnädigen Gottes</p> <p>2. Lob sei Gott, dem Herrnder Welten,</p> <p>3. dem Barmherzigen und Gnädigen,</p> <p>4. deram Tagdes Gerichtsregiert!</p>	<p>Në emër të Perëndisë mëshiruesit dhe zemërmirit [1:1]</p> <p>Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve! [1:2]</p> <p>Të mëshirshmit dhe zemërmirit, [1:3]</p> <p>që sundon në ditën e gjykimit! [1:4]</p>

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

<p>« أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ » [1:6] « صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ » [1:7]</p>	<p>5. Dirdienenwir, und Dichbittenwirum Hilfe. 6. FühreunsdengeradenWeg 7. den Wegderer, denen Du Gnadeerwiesenhast, nicht (den Weg) derer, die D(ein)em Zornverfallensind und irregehen!</p>	<p>Ty të shërbejmë dhe Ty të lutemi për ndihmë. [1:5] Na udhëzo në rrugën e drejtë! [1:6] Në rrugën e atyre, të cilët i ke bekuar, e jo të atyre që shkaktuan zemërimin dhe të devjueuarin! [1:7]</p>
--	---	---

Kaptina (surja) e pestë [Al-Ma'ida], ajeti 33:

<u>Feti Mehdiu:</u>	<u>Sherif Ahmeti:</u>	<u>Hasan Efendi Nahi:</u>
<p>Shpërblimi i atyre të cilët bëjnë luftë kundër Allahut dhe Profetit të tij dhe që bëjnë çrregullime në tokë, është: të vriten ose të gozhdohen, ose t'u pritën duart dhe këmbët tërthorazi, ose të përzihen prej andej. Ky është poshtërim në këtë botë, kurse në botën tjetër i pret dënim i madh. [5:33]</p>	<p>Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen) t'u pritën duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Ky (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]</p>	<p>Ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Perëndisë dhe të dërguarit të Tij dhe të cilët bëjnë ngatërresa në tokë është të vriten ose të varen, ose t'u këputen duart dhe këmbët e tyre nga anët e ndryshme (djathtas e majtas), ose të dëbohen nga vendi. Ky ndëshkim për ta është poshtërim në këtë jetë, e në jetën tjetër ka mundim të madh për ta. [5:33]</p>

Çdokush që ka përgatitjen e nevojshme gjuhësore, do t'i vërejë dallimet në këto tri shqipërime të *Kuranit*. Dallime do të ketë edhe në shqipërimet e reja, sepse secili shqipëruar ka shijet individuale.

Por pyetja shtrohet: dallime kaq të mëdha në shqipërime vijnë si pasojë e tekstit në „original“ (faktikisht teksti origjinal i Kuranit nuk ekziston, sepse shumë herë duhet të „jetë transkriptuar“ gjatë këtyre 1400 viteve, për herë të fundit në vitin 1924, nga universiteti islam „Al-Azhar“ në Kajro...), apo të përkushtimit fetar të atyre që e kanë shqipëruar?

Fatkeqësisht, deri tani nuk kemi përkthim profesional të *Kuranit*, nga ndonjë orientalist jomysliman. Në gjuhë të tjera ekzistojnë përkthime profesionale, që i kanë bërë orientalistë që nuk i përkasin religjionit islam.

Sidoqoftë, as këto shqipërime nuk mund të shpërdorohen për të arsyetuar formulimin dhe përmbajtjen primitive e inkriminuese të *Kuranit*, sepse si në suren e parë, ashtu si dhe në suren e pestë (ajeti 33), kuptohen mesazhet inkriminuese kundër jomyslimanëve!

Përndryshe, vetë gjuha „origjinale“ e *Kuranit* duhet të jetë shkaktarja kryesore e vështirësive gjatë përkthimit në cilëndo qoftë gjuhë. Ja çfarë vlerësimi huazova nga një portal mysliman:

Arabishtja e Kuranit vlerësohet si arabishtja klasike arabe dhe ndryshon shumë nga arabishtja që flitet sot. (...) Sot arabishtja standarde (MSA - Modern Standard Arabic) është forma e modernizuar dhe e reformuar e arabishtes klasike, që u ngrit nga nevoja për të lëvizur nga ajo arabishte „e sofistikuar“, për të zhvilluar një arabishte më moderne. „Në vazhdimi ofrohet edhe një shembull që e ka prezantuar studiuesi gjerman Hartmund Bodzim: emërtimi „sajaratun“ [Kuran, 12:19] atëherë është përdor për një grup udhëtarësh, ndërsa në arabishten e sotme përdoret për automobilin. Në shqipërimin e tij, Sherif Ahmeti përdor „grup udhëtarësh“; Feti Mehdiu „karvan“, Hasan Nahi gjithashtu „karvan“. Por, poenta është te evoluimi i arabishtes, nga emërtimi për „grup udhëtarësh“, në emërimin për „automobil“.

Për ta kuptuar çështjen që ka të bëjë me vështirësitë e përkthimit, po marr si shembull konkretizues „Mesharin“ e priftit shqiptar kristian shqiptar Gjon Buzuku, i shkruar në vitin 1555. Në vitin 1968 albanologu Eqrem Çabej bëri transkriptimin, transliterimin dhe interpretimin e kësaj vepre, që të mund ta lexonin e kuptonin shqipfolësit e sotëm.

Edhe në gjuhën gjermane, si në pothuajse të gjitha gjuhët „e gjalla“ („të vdekura“ quhen greqishtja dhe latinishtja), ka pësuar evoluimin e saj. Gjuha e vjetër gjermane (Althochdeutsch) është folur deri rreth vitit 1050.

Po ofroj disa shprehje krahasuese të gjermanishtes së tanishme dhe gjermanishtes së vjetër:

Gjermanishtja aktuale:	Gjermanishtja e vjetër:	Përkthimi në shqip:
mutter	muoter	nënë
bruder	bruoder	vëlla
suhn	sunu	djalë
herz	herza	zemër
knie	knio	guni (gjuri)
elch	elaho, eliho	kaprolli
schwein	swin	thi (derr)
wasser	wazzar	ujë
fener (lexohet: fojer)	fiur	zjarr
essen	ezan	ha
tragen	beran	mbart

Më pas ka pasuar gjermanishtja „e mesme“, përafërsisht e viteve 1050-1500. Duke marrë për bazë përkthimin e *Biblës* që ka bërë Martin Luteri (Luther) në vitin 1522, ka zënë fill gjermanishtja e njësuar, kryesisht si gjuhë e elitës intelektuale. Luteri ka përdorur gjuhën e folur në rrethinat e Hanoverit.

Nga kjo paraqitje telegrafike e evoluimit të gjermanishtes rezulton se gjuhët e gjalla „zhvillohen“ përditë. Atëherë, pse duhet të bëjë përjashtim arabishtja, siç gënjejnë arabët dhe joarabët muhamedanë?!

Pra, vetëm arabët nacionalistë dhe myslimanët fundamentalistë, naivisht, këmbëngulin se gjuha „origjinale“ (zanafillore) e *Kuranit* nuk ka ndryshuar fare dhe ajo praktikohet edhe tani. Ata belbëzojnë kur u thuhet se *Kuranin* para vitit 1924, para se të transkriptohej me urdhër të mbretit të Egjiptit, nuk e kuptojnë fare arabishtfolësit e tanishëm. Hasin vështirësi për të kuptuar edhe variantin e transkriptuar e „të redaktuar“ të vitit 1924.

Për t’ua bërë të kuptueshëm atyre që e lexojnë variantin „zyrtar“ të *Kuranit* aktual, në arabishten e vitit 1924, janë bërë sqarime në kllapa e fusnota. Edhe në përkthime, sqarimet konkretizuese janë në kllapa. Varianti zanafillor nuk përmbante tekst sqarues në kllapa.

Jomyslimanët arabë dhe të tjerë nuk e lexojnë dot *Kuranin* në arabisht dhe të përkthyer, as si letërsi, as si histori, as si legjendë, as si përrallë, as si filozofi..., sepse është tekst me përmbajtje e formulim tepër primitiv. Kurse myslimanët të krijojnë ndjesi keqardhjeje, se besojnë edhe në shekullin 21, ta zëmë, se toka është e rrafshët, e palëvizshme, e mbuluar me shtatë qiej në formë kupolash, ku qielli i parë i stolitur me yje i orienton udhëtarët natën; me diell që sillet rreth tokës etj. Dhe prandaj myslimanët, sidomos fundamentalistët, që besojnë se Allahu është autori i *Kuranit* dhe që praktikojnë përmbajtjen e tij, janë rrezik potencial dhe të përhershëm për krime terroriste...

III. 1. Islami - debate polarizuese

Kurani ka ajete me përmbajtje tepër konfuze e kundërthënëse. Skandaloze janë përcaktimet, ta zëmë, ndaj kafirëve, siç i (dis)kualifikonte dhe i përçmonte Muhamedi “jobesimtarët”, që do të thotë të gjithë jomyslimanët (besimtarët paganë, jehudin, kristianë dhe të tjerë). Kundërthëniet dhe konfuziteti shtrihen nga përcaktimet tejet tolerante e paqësore, deri tek ato agresive e fashiste.

Më gjysmë zëri, Muhamedi dhe muhamedanët i akceptonin për “besimtarë të vërtetë” të “librave” (*Teurati, Zeburi dhe Ungjilli*) disa besimtarë fiktivë, por jo ata që besonin se Jezusi është bir i zotit, ose ata që besonin në “librat e falsifikuar” të Abrahamit dhe Moisiut (Musait). Kështu ishte në kohë të islamit zanafillor dhe kështu është edhe tani, meqë dogma islamike nuk qenkësh e reformueshme. Ajo është fikse, e konservuar, e balsamosur, ashtu siç e ka sajuar Muhamedi dhe ashtu siç “janë redaktuar” në format “Kurani” nga komisioni “redaktues” i kalifit Utman (651) dhe “komisionet” e tjera pasuese...

Megjithatë, besimtarët myslimanë nuk janë aq homogjenë, edhe pse kryeministri i Turqisë, Erdogan, pati zhurmuar me pompozitet:

“Nuk ka islam dhe islamizëm, por ka vetëm një islam!”

Pra, sipas tij, ka “vetëm një islam”, që qenkësh ashtu siç e kupton dhe e shpërdoron ai vetë për ekspansion nacionalist turko-osman.

Për të bërë vlerësimin, përcaktimin dhe gjykimin, se cilët janë islami dhe islamistët e vërtetë, Muhamedi ka autorizuar vetëm popullin mysliman arab përmes ajetit:

Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaheni nga veprat e këqija dhe të besoni tek Allahu. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit. [3: 110]

Për shkak të përmbajtjes tepër përcaktuese të këtij ajeti, po ofrojmë në fusnotë (referencë) edhe shqipërimin e Feti Mehdiut.³⁶⁷

Të dy variantet kanë ngjashmëri. Uroj që besimtarët myslimanë të mos ankohen për përkthimet.

Shumë prej tyre besojnë në islamin e idealizuar, sipas dëshirave e fantazive vetjake, prandaj ndodh që atyre nuk u pëlqen përmbajtja e ndonjë ajeti, i cili nuk përputhet me islamin e tyre të idealizuar dhe, rrjedhimisht, i kundërshtojnë përkthimet. Në të dy këto shqipërime rezulton se Muhamedi e cilëson popullin e tij arab si populli më i mirë. Është e vetëkuptueshme që Muhamedi ka synuar të konsolidojë popullin e tij, për të qenë më i miri dhe, për ta motivuar, e ka lavdëruar. As zoti, të cilin e kanë sajuar fetë abrahamike, nuk do të duhej të përzgjidhte një popull të caktuar si populli më i mirë. Këtë përzgjedhje e ka bërë jo ndonjë zot abrahamik, por “të dërguarit e tij” (Abrahami, Moisiu, Jezuesi, Muhamedi e "profetë" të tjerë), që kanë mashtruar se zoti ka zgjedhur popullin e tyre përkatës, si populli më i mirë.

Siç vetëkuptohet, Muhamedi e autorizon popullin e tij të vendosë për vlera të mira dhe të këqija, për lejime dhe ndalesa. Ndërsa spekulimi për besimtarët jehudinj, se pak veta janë të devotshëm, kurse shumica jo, është një demagogji e Muhamedit për të nxitur urrejtjen e islamistëve kundër tyre, madje kundër tyre si tërësi.

Taip Erdogani nuk është pjesëtar i popullit arab. Ai, prandaj, nuk është i autorizuar të përcaktojë se cili është islami i vërtetë. Islami që e shpërdoron ai për qëllime nacionaliste turko-osmane nuk ka ngjashmëri me islamin “e vërtetë”. Sikur ta njihje ai islamin e vërtetë, do ta dinte se kompetencën për vlerësime e kanë ekskluzivisht vetëm islamistët arabë, dhe jo ata turq, malazias, indonezianë, amerikanë, shqiptarë etj.

³⁶⁷ *Ju jeni populli më i mirë se të gjithë të tjerët që janë paraqitur ndonjëherë. Kërkonti të bëhen vepra të mira dhe pengoni nga të pamirat dhe i besoni Allahut. Dhe sikur ihtarët e Librit të besonin drejt, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre edhe besimtarë, por shumica janë mbrapshtanë. [3: 110]*

Këtu po sjell ajete që përmbajnë përcaktime konfuze e kundërthënëse, dedikuar jobesimtarëve, për të parë se sa e vështirë është të vlerësohet cili është islami i vërtetë. Janë qindra ajete, që i dedikohen kësaj tematike. Ja disa prej tyre:

E jehudinjtë thanë: "Uzejri është djali i Allahut". Të krishterët thanë: "Mesihu është djalë i Allahut". Ato ishin thënie të tyre, me gojët e tyre, që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. Allahu i vraftë, si largohen! [9: 30]

Ky ajet i kategorizon edhe jehudinjtë, edhe kristianët njësoj si paganët, të cilët Muhamedi i quante "jobesimtarë". Ai, prandaj, papërmbajtshtëm, jo si profet, por si barbar, ulërinte: "Allahu i vraftë!" E kjo thirrje përmban në vetvete një rrezik të kobshëm, sepse të gjithë muhamedanët e botës jo vetëm që nuk dyshojnë në vërtetësinë e asaj që thotë e mallkon profeti i tyre, por ndihen të detyruar të vihen në shërbim, për të jetësuar porositë e mallkimet e tij, si kjo në këtë ajet.

Sipas islamologëve, rreth 67% e ajeteve mekase dhe rreth 51% e atyre medinase u dedikohen "jobesimtarëve". Ndërkaq, 20% e haditheve të përmbledhura nga Bukhariau trajtojnë si tematikë (zh)vlerësimin e "jobesimtarëve".

Jo vetëm kaq. Në prag të vdekjes, Muhamedi duhet të ketë lënë porosi:

Raporton Said bint Xhubejr:

Ibn Abasi ka thënë: "...Në shtratin e vdekjes Profeti i dha tre urdhra: "Dëboni jehudinjtë dhe kristianët nga Gadishulli Arabik, respektoni dhe jepuni dhurata delegacioneve të huaja, siç keni parë se si veproja unë". E kam harruar urdhrin e tretë³⁶⁸.

Pra, në këtë (dez)informim që përmban kjo hadithe, rezulton se Muhamedi ka urdhëruar që të luftohen me ngulm jehudinjtë e

³⁶⁸ Bukhari/Buhariu, 4: 52: 288.

kristianët dhe të dëbohen jashtë Gadishullit Arabik. Sipas interpretimit që i bëjnë muhamedanët këtij urdhri të profetit të tyre, “jofetarët” duhet të dëbohen nga të gjitha hapësirat, ku myslimanët janë shumicë dhe të fortë.

“Jofetari” i Muhamedit nuk është thjesht jobesimtar, por është *kafir*, që për të do të thotë se duhet të vritet, të dhunohet, të skllavërohet, të urrehet, të plaçkitet, të tatimohet ekstra, të shpronësohet...

Jobesimtarët, pra politeistët, janë jashtë marrëdhënies me zotin. Ata nuk konsiderohen njerëz, por si ulokë shpirtërorë e emocionalë. "Në zemrat e tyre është sëmundja"; ata janë "të shurdhër, memecë dhe të verbër". Këto dobësi i thekson shumë herë *Kurani* dhe, sipas tij, këto dobësi janë të pashërueshme³⁶⁹. Islamologu Bürgel është bazuar në ajetin vijues, kur ka shprehur këto vlerësimë:

E sa u përket atyre që kanë sëmundje në zemrat e tyre, ajo ndyrësisë së tyre u shton ndyrësi dhe ata vdesin si jobesimtarë. [9: 125]

Ja edhe dy ajete, që reflektojnë mendësinë perverse të Muhamedit (e cila është ngulitur edhe në trurin e tredhur të ekspertit ligjor juridik e fetar arab, si më lart):

E veprat e atyre që nuk besojnë janë si valët në një rrafshinë, ku i etshmi mendon se është ujë, ndërsa kur i afrohet atij nuk gjen asgjë, por aty gjen Allahun dhe Ai do t'i japë llogari atij. Allahu është i shpejtë në llogaritje. [24: 39]

Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë, të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën, saqë ai nuk mund ta shohë as dorën e vet. Atij të cilit Allahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë. [24: 40]

³⁶⁹ Islamologu Johann Christoph Bürgel, "Allmacht und Mächtigkeit", München, Verlag C. H. Beck, 1991, Seite 35; mik i admiruarshumëngaislamistët:
<http://www.freunde-islamischer-kunst.de/archiv/mitglieder-und-interessen/johann-christoph-buergel/>.

Jo vetëm kaq. Muhamedi ka përcaktuar edhe rastet kur duhet të vriten jobesimtarët:

E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni idhujtarët kudo që t'i gjeni, robërojini dhe ngujojini ata, vritini në pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë lëshojuni rrugën, se vërtet Allahu fal dhe është mëshirues. [9: 5]

“Idhujtarët” në këtë ajet (ndoshta është përzgjedhje sinonimesh nga shqipëruesi), janë “jomyslimanët”. Muhamedi udhëzon të vriten ata, nëse nuk pranojnë të konvertohen në myslimanë. Pra, islami nuk ka si të çmohet paqësor, sikur *Kurani* të përmbante edhe vetëm këtë ajet.

Tani të shohim ca ajete që përmbajnë kundërthënie me ajetin 9:5:

Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? [10: 99]

Nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë (ndryshe), pos me ndihmën e Allahut. E dënimin u jep atyre që nuk mendojnë. [10: 100]

Sikur të dëshironte Zoti yt, do t'i bënte të gjithë njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse)...” [11. 118]

Skandaloze! Në ajetin 9: 5 thuhet se jomyslimanët duhet të vriten, pos nëse pranojnë të konvertohen në islam. Tani thuhet “*sikur të kishte dashur Zoti, do t'i besonin të gjithë të një feje*”. Dhe në ajetin pasues: “*nuk është e mundur për asnjë njeri të besojë, pos me ndihmën e Zotit*”. Cili Muhamed të zbatohet, ai i ajetit 9: 5 apo i ajeteve 10: 99-100 dhe 11: 118?!

Po të ishte “zoti” ashtu siç e kanë sajuar profetët abrahamikë, vërtet ai do të ishte në gjendje ta programonte njeriun sipas përcaktimeve të tij, ashtu siç ka qenë në gjendje të “krijonte” Adamin. Nga kjo rrjedh se vetë, i njëjti zot, nuk do të duhej t'i ndëshkonte jomyslimanët, meqë ai vetë i “ka krijuar” të tillë. Rrjedhimisht, as “I Dërguari i Zotit” (Muhamedi) dhe myslimanët nuk do të duhej të vrisnin jomyslimanët.

Ka prej tyre që të dëgjojnë ty. Por Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë dhe në veshët e tyre sajuam shurdhim dhe, edhe sikur t'i shohin të gjitha faktet, ata nuk besojnë, derisa kur vijnë te ti e të polemizojnë, ata që mohuan thonë: "Nuk është tjetër ky (Kurani) vetëm se mit i hershëm." [6: 25]

Nuk ia vlen të shpreh pakënaqësinë ndaj këtij formulimi të përçartë (ose shqipërimit).

Jomyslimanë nuk do të duhej të dënohen e të vriten, meqë vetë zoti qenkësh përkujdesur që ata të mos dëgjojnë e të mos kuptojnë! Pse atëherë janë sajuar ajete, që i detyronin jobesimtarët të konvertoheshin në islam?!

Ngjashëm mund të vlerësohet edhe përmbajtja e ajeteve:

A e ke parë ti (Muhamed) atë që, duke e ditur dëshirën e vet, e respekton si Zot të vetin, atë Allahu e ka humbur, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij; i ka vënë perde mbi të parit e tij. Më thuaj, pos Allahut, kush mund ta udhëzojë atë? A nuk merrni mësim? [45:23]

Atë që Allahu e udhëzon, ai është në rrugë të drejtë; e atë që e humb, është i dëshpëruar. [7:178] E ata që i bënë të rreme faktet Tona janë shurdhmemecë të mbetur në errësi. Allahu humb kë të dojë dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do. [6:39]

Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, ia bën zemrën e tij shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu, Allahu lëshon dënimin mbi ata që nuk besojnë. [6:125]

Nëse ti (Muhamed) përpiqesh për t'i vënë në rrugë të drejtë ata, (dije se) Allahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur dhe për ata nuk ka ndihmëtar. [16:37]

Krejt tjetër qëndrim, tepër të rreptë, përmbajnë ajetet vijuese:

E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën veten e tyre; atë që e shpalli Allahu të mos e besojnë nga zilia, për shkak se Allahu nga mirësia e Tij i shpall atij që dëshiron nga robërit e vet. Ndaj merituan zemërim mbi zemërim (gazep mbi gazep). Mosbesimtarët kanë dënim që i poshtëron. [2:90]

Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi ato ua sqaruar njerëzve të librit, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. [2:159]

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

S'ka dyshim se ata që nuk besuan do të thirren (do t'u thuhet): "Hidhërimi i Allahut pse u ftuat të besoni e ju nuk besuat (në Dynja), është më i madh se urrejtja juaj ndaj vetes." [40:10]

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë, as të krishterët. Ata janë miq të njërit-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është njëri prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Muhamedi dhe bashkëhartuesit e tjerë të këtyre ajeteve tashmë ia mveshin zotit mallkimin dhe ndëshkimin e jobesimtarëve (paganët, judenjtë, kristianët).

O ju që ju është dhënë libri, besojeni atë që e zbritëm (Kuranin) e që është vërtetues i atij që keni (Tevratit), para se të shlyejmë fytyrat (t'ua fshijmë shqisat) dhe t'i rrotullojmë ose t'i mallkojmë ata siç i mallkuam ata të së shtunës. Urdhri i Allahut është i kryer. [4:47]

Ata që, duke mos pasur kurrfarë fakti pranë vetes, kundërshtojnë argumentet e Allahut, do e pësojnë nga urrejtja e madhe e Allahut dhe e besimtarëve (myslimanëve). Allahu vulos çdo zemër të arrogantit dhe zullumqarit. [40:35]

Ju e keni shembullin më të mirë tek Ibrahim i dhe tek ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni; pos Allahut, nuk besojmë tuajt, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapur armiqësia e urrejtja, derisa ta besoni vetëm Allahun..." [60:4]

E , në anën tjetër, për t'i ndëshkuar hipokritët dhe idhujtarët, mendimi i të cilëve ndaj Allahut ishte mendim i keq, atyre u raftë e keqja! Allahu shprehu urrejtje kundër tyre dhe i mallkoi e përgatiti për ta xhehenemin, që është vendbanim i keq. [48:6]

Në ajetin 4:47 kërcënohen besimtarët e *Teuratit* (Torës/Besëlidhja e Vjetër). Në ajetin 40:35 kërcënohen të gjithë ata që nuk e besojnë Allahun muhamedan, ndërsa në ajetin 60:4 nxitet armiqësia përbrenda izraelitëve, sepse vetëm një pakicë e tyre i shkoi prapa Abrahamit. Në ajetin 48:6, Muhamedi i kërcënon hipokritët dhe paganët, me mallkimin dhe urrejtjen e Allahut mysliiman, duke ua përgatitur edhe xhehenemin e përhershëm si ndëshkim.

Pothuajse nga të gjitha formulimet rezulton se Allahu nuk është autor i *Kuranit*, meqë gjithandej është prezent në vetën e tretë, njëjës.

Muhamedi ose bashkëhartues tjerë të *Kuranit* i kërcënojnë besimtarët myslimanë që do të miqësohen me jobesimtarë, në ajetet vijuese:

Besimtarët të mos miqësohen me jobesimtarët e t'i lënë anash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e Allahut nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja. [3:28]

O ju që besuat, mos i bëni miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj. Ata nuk pushojnë së vepruari në dënim tuajin, e ju dëshirojnë çka ju mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojë e tyre, por ajo që fshehin në gjoks in e tyre është edhe më e madhe. Ne, pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. [3:118]

Ata dëshirojnë që edhe ju të mos besoni, sikurse nuk besuan vetë dhe bëheni të njëjtë. Mos zini miq prej tyre, derisa ata të shpërngulen (si ju) për hir të Allahut, e nëse refuzojnë, atëherë kudo që t'i gjeni, kapini dhe mbytini dhe prej tyre mos zini as mik, as ndihmës. [4:89]

O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët (jomyslimanët) e t'i lini anash besimtarët (myslimanët)! A doni t'i sillni Allahut argument të qartë kundër vetes! [4:144]

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

O ju që besuat! Mos i merrni për miq, ata të cilëve u është dhënë libri para jush, as jobesimtarët që tallen dhe luajnë me fenë tuaj. Kini drojë Allahun, po qe se jeni besimtarë. [5:57]

Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhamed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm tek Allahu. Ai do t'i njohë me atë që punuan. [6:159]

O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull që Allahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu si nuk kanë shpresë jobesimtarët prej të vdekurve (që do të ngjallen) në këtë botë, ose në ringjallje (në botën tjetër). [60:13]

Vetëkuptohet qartë që këto ajete, me përcaktime urdhëruese e kërcënuese, nuk janë aspak njerëzore e hyjnore. Sikur të mos mjaftonte me kaq, Muhamedi ashpërsion kërcënimin e tij në ajetin vijues:

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

E ju përgatituni sa të keni mundësi force (mjete luftarake) e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre (që tradhtojnë) e me të (me përgatitje) ta frikësoni armikun e Allahut, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini (se kush janë), e Allahu i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugë të Allahut, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet e padrejtë. [8:60]

S'ka dyshim se ata, të cilët nuk besuan nga ithtarët e librit dhe nga idhujtarët, do të jenë në zjarrin e xhehenemit përgjithmonë. Të tillët janë krijesa të dëmshme. [98:6]

Muhamedi i denigron hebrenjtë:

Ju tanimë e keni të njohur çështjen e atyre nga mesi juaj që nuk respektuan (urdhrin) në të shtunën, e Ne u thamë: "Shndërrohuni në majmunë të përbuzur!" [2:65]

Thuaj: "A t'ju lajmëroj për një të keqe (të zezë) më të dëmshme si dënim nga Allahu?" Mallkimi i atij që e mallkoi Allahu dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e derra, e i bëri adhurues të djallit. Të tillët janë në pozitë më të keqe dhe më të humburit prej rrugës së drejtë. [5:160]

E kur ata tejkaluan me arrogancë të hapur nga ajo që ishte e ndaluar, Ne i shndërruam në majmunë të përbuzur. [7:166]

Ne krijuam shumë nga xhinët e njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra, që me to nuk kuptojnë; ata kanë sy, që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë, që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, madje edhe më të humbur. Të tillë janë ata, të marrët. [7:179]

Shembulli i atyre që nuk besuan është sikurse i atij që u lëshon britmë atyre që nuk dëgjojnë tjetër, vetëm se britmë e zë. Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër; ata nuk kuptojnë. [2:171]

Duke u bazuar në të tilla ajete, Institucioni për *Fetva* (ekspertizë ligjore) pranë Ministrisë për Fenë, i Emiratit të Katarit, lëshon ekspertizën vijuese:

Fetva nr: 156.641, më 12. 08. 2011

Pyetje: Disa kohë më parë kam mallkuar hebrenjtë. Por kur kam menduar se ata janë një racë me ne, unë nuk i kam mallkuar hebrenjtë që janë konvertuar në myslimanë. Më vonë njoha gabimin: hebrenjtë janë një bashkësi fetare dhe jo një

popull. Natyrisht, të gjithë hebrenjtë janë jobesimtarë. A kam mëkatuar në këtë mënyrë?

Përgjigje: Duke vepruar ashtu, nuk keni bërë asgjë të keqe, ngaqë hebrenjtë nuk e kanë besuar mesazhin e Muhamedit (Paqja, mëshira dhe lavdia qofshin mbi të!), nuk e besojnë islamin, prandaj janë jobesimtarë të urryer, që u takon xhehenemi i zjarrit. Në të kundërt, ata që besojnë Muhamedin (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) nuk janë hebrenjtë, por janë bërë myslimanë. Se hebrenjtë janë një rasë, ky është një pohim i rremë. Ata kanë prejardhje nga rasa të ndryshme, siç e kemi paraqitur në ekspertizën juridike nr. 49.581.

Rëndom, myslimanët "e moderuar", kur u paraqiten të tilla argumente, për qëndrimet fashiste të institucioneve të mbretërive islamike, kundërshtojnë me pseudoarsyetimin, se ata nuk i përmbahen islamit burimor. Demantime mbrojtëse të myslimanëve "të moderuar" po lexoj përditë në medie, që distancohen nga kalifati ISIS (kalifati islamik në Irak e Siri). Mua më rezulton se prononcimet e udhëheqësve të "kalifatit ISIS" janë në përputhje identike me përcaktimet e "profetit" Muhamed (në *Kuran* e në hadithe), ndërsa myslimanët "e moderuar" vetëm taktizojnë, siç parashihet me *Kuran*, sepse e dinë se nuk janë aq të fortë për të mundur gjithë njerëzimin joislam.

Muhamedi urdhëron luftime kundër jomyslimanëve:

Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni. [9:41]

*Dilni në luftë kundër jobesimtarëve, qofshi të dobët a të fortë, dhe luftoni për hir të Allahut me mish e me shpirt! ...[9:41]**

Vetëm ajeti 9:41 do të mjaftonte për ta kualifikuar gjithë *Kuranin* si doktrinë agresive dhe luftarake, edhe pse ky "libër" përmban një paletë përcaktimesh të shumëllojshme, nga ato paqësore deri tek ato agresive, luftarake e fashistoide.

* Shqipëruar nga Feti Mehdiu.

Çështja bëhet tepër serioze, kur sanksionohet konservimi i doktrinës së *Kuranit*, duke privuar çdo instancë të kësaj feje, që do të mund të ndërmernte qoftë edhe ndonjë reformë të vockël. Këtë sanksionim e kemi në ajetet vijuese:

Janë përgënjeshtruar të dërguar para teje, duruan atë gënjeshtër dhe u torturuan derisa u erdhi ndihma Jonë, prandaj s'ka kush e ndryshon fjalët e Allahut. E ti je i njohur me disa nga ngjarjet e të dërguarve. [6:34]

Meqë është ajet me përcaktim tepër të rëndësishëm, po sjellim edhe një variant tjetër të shqipërimin të tij, atë nga Hasan Nahi:

Edhe para teje (o Muhamed!), shumë pejgamberë janë përgënjeshtruar, por ata kanë duruar për atë që janë konsideruar. Dhe kanë vuajtur, derisa nuk ka ardhur ndihma Jonë, - e askush nuk mund t'i ndryshojë fjalët e Perëndisë, - dhe, padyshim, te ti kanë arritur disa lajme për pejgamberë. [6:34]

Por, po në *Kuran* flitet edhe për ndryshime të përcaktimeve gjatë sajimit të tij:

Ne nuk abrogojmë asnjë nga argumentet tona e nuk i hedhim në harresë, që të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të...[2:106]

Pra, vetëm sajuesit e *Kuranit* kanë pasur mundësi të bëjnë “plotësime” gjatë procesit të sajimit ose gjatë “redaktimeve” të tij.

Akoma më “skandaloze” rezulton të jetë ndërhyrja e djallit për të imponuar përcaktime të djallëzuara:

Ne nuk dërguam para teje asnjë të dërguar dhe asnjë pejgamber e që, kur ai dëshiroi diçka, të mos ndërhyjë në dëshirën e tij djalli, e Allahu asgjëson atë që e hedh djalli e fuqizon argumentet e Veta. Allahu është shumë i dijshtëm dhe i rregullon çështjet me urtësi të madhe. [22:52]

Por “Zoti” është përkujdesur t’ia tërheqë vërejtjen Muhamedit:

Ne do ta mësojmë ty, e ti nuk do ta harrosh, [87:6] përveç asaj që do Zoti. Ai me të vërtetë di çdo gjë që shprehni haptazi dhe atë që fshihni... [87:7]

Tani të shohim përmbajtjen e ajetit vijues, ku rezulton se duhet të ketë pasur diskutime mes sajuesve të *Kuranit*. Ndoshta diskutimet duhet të jenë bërë gjatë “redaktimit”, në komisionin që pat formuar kalifati Utman, “për të kompletuar” një *Kuran* në format libri. Për “përshtatjet” e bëra gjatë “redaktimit” (dez)informon edhe Sahihal-Bukari, përmes hadithes përkatëse (vëll. 6, nr.510).

E, kur t’ju lexohen ajetet Tona të qarta, atëherë thonë ata, që nuk shpresojnë se do të dalin para Nesh: "Na sjell ti ndonjë Kuran tjetër ose ndërroje atë!" Thuaj: "Është e pamundur ta ndërroj unë atë nga ana ime. Unë shkoj vetëm pas asaj që më është shpallur. Unë druham, nëse e kundërshtoj Zotit tim, ndaj dënimit të Ditës së Madhe". [10:15]

Interpretuesit klasikë të *Kuranit* kanë vlerësime të ndryshme se cilat ajete dhe sa prej tyre "janë korrigjuar" përmes ajeteve të mëvonshme. Numri i ajeteve "të përmirësuara" duhet të jetë mes 5 dhe 260.

Të shohin një rast konkret se çfarë “përmirësimesh” ka pësuar qëndrimi ndaj (mos)pirjes së verës:

Po të të pyesin ty për verë dhe bixhoz, thuaju: "Ata u sjellin dëme të mëdha (mëkate), por edhe dobi për njerëzit, mirëpo dëmi është më i madh se dobia..." [2:219]

Përmes këtij ajeti, i sajuar para vitit 622, vera tolerohet, edhe pse nuk preferohet. Edhe në ajetin vijues vazhdon tolerimi i pijeve alkoolike.

O besimtarë! Mos bëni namaz kur jeni të dehur, përderisa të kthjelloheni e të dini se ç’flisni...[4:43]

Në vitin 625, gjatë betejës në Uhud, disa xhihadistë pinë shumë dhe, të bërë tapë, u nisën në betejë. Gjatë betejës ata u vranë. Në atë moment sajohet ajeti vijues:

O besimtarë! Me të vërtetë, vera, bixhozi, statujat dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyra nga punët e djallit. Largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar! [5:90]

Në një rast tjetër bëhet korrigjimi i drejtimit të namazit. Fillimisht, derisa nuk ishte përvetësuar Qabeja, gjatë lutjeve fetare (namazit) muhamedanët drejtoheshin kah Jerusalemit. Më vonë bëhet ndryshimi. Arsyetimet për këtë metamorfozë përmbahen në ajetet vijuese:

As jehudinjtë e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa ta pasosh fenë e tyre. Thuaju: "Udhëzimi i Allahut është udhëzimi i drejtë. E nëse pasi të ka ardhur ty e vërteta, shkon pas mendimeve të tyre; nuk ka kush të të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu. " [2:120]

Atyre, të cilëve ua dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejt ashtu si është, ata e besojnë atë (Kuranin). E ata që e mohojnë atë, janë ata që do të dështojnë. [2:121]
O bijtë e israilit, kujtoni të mirat e Mia që ju dhurova, që ju dallova mbi njerëzit e tjerë. [2:122]

Dhe ruajuni një ditë, kur askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asnjë send, nuk pranohet prej askujt kompensim, nuk do t'i bëjë dobi askujt ndonjë ndërmjetësim dhe as që do të ndihmohen. [2:123]

Përkujto kur Zoti i vet e provoi Ibrahimin me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: "Unë po të bëj ty prijës të njerëzimit!" Ai tha: "Edhe nga pasardhësit e mi!" Tha (Zoti): "Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!" [2:124]

Dhe kur shtëpinë e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit, tha: "Vendin ku qëndroi Ibrahim i pranoheni për vendfaljeje! Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrojini shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty." [2:125]

Dhe kur Ibrahim i tha: "Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoji me lloje të ndryshme frutash!" Ai tha: "Edhe atij që nuk besoi, do t'ia mundësojë shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër, e pastaj do ta shtyjë në dënimin e zjarrit, e sa përfundim i shëmtuar është ai." [2:126]

*Edhe kur Ibrahim dhe Ismaili, duke ngritur themelet e shtëpisë: "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!" [2:127]
Këto ajete i kanë sajuar Muhamedi dhe bashkautorë të tjerë të Kuranit, në shërbim të falsifikimit historik dhe të pronësisë së Qabesë.*

Dallimet më të mëdha duken në përcaktimet karshi besimtarëve paganë, jehudinjtë dhe kristianët. Gjatë viteve 610-622, Muhamedi kishte qëndrim, të themi, më liberal ndaj tyre, sesa gjatë viteve 622-632, kur i ashpërsoi qëndrimet e tij ndaj “jobesimtarëve”. Këtyre qëndrimeve do t’u ngjajnë, shumë më vonë, qëndrimet e nazizmit hitlerian.

Ja një shembull tipik:

Në fe nuk ka detyrim. [2:256]

Ky përcaktim ashpërsohet deri në tërbim barbar në ajetet:

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose të gjymtohen, t’u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, por edhe të dëbohen nga vendi. Ky (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]

Kur të kalojnë muajt e mëdhenj, atëherë mbytini idhujtarët kudo që t’i takoni, zërin robër, rrethojini dhe ngrijuni pusi kudo! E, nëse pendohen e bëjnë namaz dhe japin zeqatin, atëherë lërin të qetë. Se, Perëndia, me të vërtetë, është falës dhe mëshirues. [9:5]

Luftojini ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi Allahu dhe I Dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë... [9:29]

Nuk meritojnë as të komentohen! Të vjen keq që myslimanët fundamentalistë i arsyetojnë, duke u bazuar në interpretimet e “dijetarëve” myslimanë, sikur na qenkëshin ajete të sajuara për rrethana të caktuara. Por belbëzojnë kur i pyet: pse janë dhe si duhet të zbatohen aktualisht, meqë janë përcaktime të sanksionuara në *Kuran*?

III. 2. Islami: Pozicioni dhe roli i femrës

Gratë tuaja janë arat tuaja. Afrojuni arave tuaja si të doni...[2:223 / shq. H. E. Nahi]

Në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakeve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë; me dy, me tri apo me katër. E nëse i frikësoheni padrejtësisë, atëherë martohuni vetëm me një ose me ato që i keni nën pushtetin tuaj (robërreshat). Ky (përkufizim) është më afër, që të mos gaboni. [4:3 / Shqipëruar nga Sherif Ahmeti]

Dr. Younes Shaikh citon: „Para shpalljes së islamit, gratë pagane arabe, në përgjithësi, gëzonin një status të respektuar në shoqëri. Shumë prej tyre, duke përfshirë Hatixhenë, gruan e parë të Profetit të islamit, kishin të drejtën për të pasur biznesin e tyre dhe për të zgjedhur burrat e tyre, sipas mendësisë matriarkale. Ato merrnin pjesë në luftë, në paqe dhe në aktivitetet publike, duke përfshirë edhe praktikimin publik të besimit fetar. Në paganizmin femëror arab, përendesha kishte status të veçantë. Perëndesha Al-Uza në Mekë, perëndesha Al-Lat në Taifa dhe perëndesha Manat në Medinë, ishin më hyjnorete dhe statujat e tyre ishin më të nderuarat. Ndërkaq, statuja e Al-Ilahut të ashpër (zotit të hënës), ishte lënë pothuajse krejtësisht pas dore.

Poezia pagane arabe i përkushtojë kryesisht bukurisë dhe fisnikërisë së grave dhe lavdisë së vlerave të tyre fisnore në paqe dhe luftë. Ishte vetëm një fis grabitqar i Mekës, në të cilën mbizotëronte zakoni i keq: varrosja e ndonjë vajze të gjallë, e porsalindur, një lloj therorizimi ky. Ishte krejtësisht e pazakontë për një burrë në shoqërinë paraislamike arabe, që të kishte më shumë se një grua në shtëpinë e tij. Me mjaft siguri mund të pohohet se poligamia u praktikua dhe u inkurajua nga profeti, pas shpalljes së islamit. Nga kjo kohë, gratë duhej „të prodhonin“, sa më shumë që të jetë e mundur, myslimanë. Kjo e degradoi statusin e gruas së martuar në shoqërinë islame. Ndërsa zakonet tradicionale pagane lejonin marrëdhënie të çliruara martesore, që përmbanin edhe lirinë dhe dinjitetin e gruas, si qenie e barabartë

njerëzore, rregullat artificiale të *nikahut* islam (rituali i martesës fetare islame) e ka reduktuar martesën krejtësisht në skllavëri seksuale dhe sociale.”³⁷⁰

Kjo është një paraqitje e pozitës së gruas në botën mesjetare para-islame arabe, nga myslimani iluminist pakistanez Younes Shaikh. Ndërsa „profeti“ Muhamed, në komplotin me personazhin e tij të quajtur Allah, e degraduan dhe e shpërftyruan femrën arabe, rrjedhimisht myslimane, me përcaktimin juridik si në ajetin vijuese:

Meshkujt udhëheqin gratë, meqë Perëndia i ka graduar ata me disa cilësi mbi ato, - dhe, meqë ata shpenzojnë pasurinë e tyre për to. Gra të mira janë ato që përulën, ruajnë fshehtësitë që ua ka besuar Perëndia. E, për ato gra që i druhen kundërshtimit të tyre, këshillojini ato, bojkotojini në shtrat dhe rrihini. E, nëse ato ju binden, atëherë mos ndërmerrni kundër tyre kurrfarë veprimi. Se Perëndia, me të vërtetë, është e lartësuar dhe e madhëruar! [4:34 / Shqipëruar nga H. E. Nahi]

Muhamedi pagan duhet të ketë qenë tejet i emancipuar. Ai u martua me një grua, dy herë vejushë, më e moshuar se ai rreth 15-20 vjet, biznesmene dhe me një status të lartë shoqëror në Mekë. Meqë gruaja e Muhamedit, Hatixheja, kishte xhaxha Varakën³⁷¹, i konvertuar në misionar kristian, spekulohet se edhe Hatixheja duhet të ketë qenë e indoktrinuara në dogmën kristiane nga ai, ndoshta edhe një si besimtare, por kriptokristiane (e kamufluar). Nëse këto të dhëna do të ishin të vërteta, patjetër që edhe Muhamedi duhet të jenë ndikuar nga kushëriri i tij, Varaka, dhe nga guraja e tij, Hatixheja.

Edhe si pagan, Muhamedi duhet të ketë qenë kundër viktimizimit, përmes varrosjes së vajzave të gjalla, lindjen e së cilave nuk e mirëpriste familja, por edhe kundër keqtrajtimit të skllavëve. Deri në moshën 40-vjeçare Muhamedi praktikoi paganizmin tradicional të fisit të tij Kurejsh, i cili kishte në „pronësi“ edhe Kabenë (Qabenë) pagane, që frekuentohej nga pelegrinët e një hapësire të gjerë arabe, meqë ishte e

³⁷⁰ Dr. Younes Shaikh në: <http://www.frei-denken.ch/de/2004/02/islam-und-die-frauen/>

³⁷¹ Waraqa (Varaka) in Naufal ibn Asadibn ‘Abdal-‘Uzzā ibn al-Qusaiy Qurashī (ورقه بن نوفل (بن أسد بن عبد العزى بن قصي القرشي).

afirmuar për shenjtërinë e saj pagane. Edhe pas „transformimit“ të tij në „profet“ (01. 02. 610), në dukje aksidental, Muhamedi vazhdoi të ishte tejet paqësor, sepse ishte nën „mbikëqyrjen“ e Hatixhesë kriptokristiane, dhe xhaxhait pagan, Ebu Talib, si kryeplak i Mekës dhe i Qabesë. Vdekja e Hatixhesë dhe e Ebu Talibit në vitin 619 (ose 620), duhet të kenë qenë goditje e rëndë shpirtërore për Muhamedin. Që në këtë kohë e më pas, ai zuri të bëhej agresiv dhe të shpërfytyrohej edhe moralisht.

Nuk është rastësi gjetja e librit të islamologes, sociologes, ligjërueses universitare dhe shkrimtares arabe, **Fatima Mernisi**³⁷², por rrjedhje e angazhimeve të mia për të gjetur literaturë sa më informuese e analitike për religjionet abrahimike/ibrahimike. Studimi i saj, i përkthyer edhe në gjuhën gjermane, mban titullin: „Haremi politik / Muhamedi dhe gratë“ (Derpolitische Harem / Muhammed und die Frauen).³⁷³

Qysh në fillim duhet të bëj të ditur (zh)vlerësimet e mia për autoren, të cilat nuk mund të gjenden në biografitë „zyrtare“ për të. Ajo është më shumë nacionaliste arabe, sesa myslimane e mirëfilltë. Si nacionaliste arabe, ajo është tifoze dhe ithtarë e ngazëllyer e

³⁷² Fatima Mernisi (e lindur në vitin 1940) është sociologe marokene, islamologe dhe shkrimtare. Ka studiuar në universitetin “Mohammed V” në Rabat, pastaj në Sorbonë / Paris. Në vitin 1973 mori gradën PhD (Doktor) në sociologji nga Universiteti i Brandeis, SHBA. Pas kthimit në Marok, ajo u angazhua Departamentin e Sociologjisë, në universitetin “Mohammed V”.

Librat e saj janë përkthyer në shumë gjuhë, duke përfshirë anglishten, gjermanishten, holandishten, gjuhën japoneze etj. Ajo ka mbikëqyrur botimin e një seri librash për statusin ligjor të grave në Marok, Algjeri dhe Tunizi. Mernisi hulumton kryesisht statusin e gruas në islam.

Më gjerësisht për biografinë e Fatima Mernisi në:

<http://www.oxfordislamicstudies.com/article/opr/t236/e0527>

³⁷³ Fatima Mernisi, “Derpolitische Harem / Muhammed und die Frauen (Haremi politik / Muhamedi dhe gratë)”. Herder, Freiburg/KNO VA; Botimi i 4-rt, 2002; <http://www.amazon.de/Der-politische-Harem-Mohammed-Frauen/dp/3451052806>

Muhamedit, meqë ai duhet ta ketë faktorizuar popullin arab, siç mendon edhe studiuesja Fatima Mernisi.

Në këtë studim, ajo ka si tematikë kryesore pozicionin e gruas në islamin zanafillor. Autorja madhëron Muhamedin për profet dhe të dërguar të zotit me një fanatizëm nationalist arab. Ajo vlerëson njëanshmërisht, sidomos angazhimin e tij, që femra myslimane të barazohet në shoqërinë islame. Për këtë arsye, ajo evidenton ajetet (versët) kuranore që përmbajnë të drejtat e gruas, duke i çmuar ato revolucionare, në krahasim me padrejtësitë ndaj grave në shoqërinë e deriatëhershme arabe.

Kur informon për diskriminimin e gruas në islamin zanafillor, autorja përpiqet ta arsyetojë Muhamedin, se ai nuk mundi të bënte më shumë, meqë reaksioni patriarkal edhe te besimtarët e parë muhamedanë ishte shumë i madh. Autorja shkon aq larg, sa ajetet që e degradojnë gruan në skllave të burrit, i arsyeton si më kompromiset e zotit dhe Muhamedit, që të mos dështojë misioni i tyre para reaksionit patriarkal, të cilin autorja e vlerëson se ishte tepër i madh, i papërballueshëm për Muhamedin dhe për „zotin mysliman“ (siç e karakterizon deri në monotoni autorja zotin e feve abrahamike). Përmes këtij (zh)vlerësimi, autorja, pavetëdijshtë, vërteton se Muhamedi ishte një njeri tokësor, si gjithë të tjerët, por me dhunti të veçanta, ndërsa zotin e tij e kishte vetëm „mjet“ për të realizuar qëllimet e tij.

Gjithsesi, kemi të bëjmë me një studiuese të indoktrinuuar nga muhamedanizmi (si shumë intelektualë myslimanë), sepse edhe studiuese shkencore, edhe besimtare fetare është e pamundur të jesh.

Ajo që më surprizoi në studimin e saj, ishte çmitizimi i Muhamedit dhe i zotit që u bën autorja Mernisi në analizën e vet, si dhe kohës dhe mënyrës së „shfaqjes“ ose „zbritjes nga qielli“ të ajeteve kuranore që u dedikohen grave. Ajo, mbase, nuk është e vetëdijshtë për diskreditimin që i ka bërë Muhamedit me këtë mënyrë shtjellimi.

Titullin „Haremi politik“, autorja e arsyeve me martesat e Muhamedit, sipas saj, me 13 gra, si taktikë e rritjes së islamit, duke lidhur kështu familjet e mëdha dhe fiset, por gjatë konkretizimit të këtyre martesave, sipas saj, rezulton se Muhamedi duhet të ketë qenë „viktimitë“ e epsheve të tij vulgare seksuale. Rrjedhimisht, ai duhet të ketë qenë maniak seksual. Për shkak të frikës nga islamistët fashistoidë, çmitizimin e diskreditimit të Muhamedit autorja e ka kamufluar përmes lavdërimit dhe arsyesimit të çdo veprimi të tij.

Në vazhdim po përzgjedh fragmente të shkurtra nga libri i autores Mernisi.

Rreshtat fillestarë të librit:

„Mundet një grua t'i udhëheqë myslimanët?“ - e pyeta shitësin e gjërave ushqimore, i cili, si shumë shitës të tjerë në Maroko, është „barometër“ i opinionit publik.

„Allahu me qëndroftë pranë“, - thirri ai i habitur, pavarësisht miqësisë që na lidhte. Nga zemërimi, atij i ranë nga dora në tokë vezët që doja të blija. (...)

Një blerës i dytë, të cilin edhe atë e njihja, kur dëgjoi bisedën tonë, foli duke cituar një hadithe të Muhamedit: „Kurrë populli nuk do të arrijë mirëqenie, nëse udhëheqja e tij i besohet një gruaje“. Menjëherë mbizotëroi heshtja. Unë e humba lojën. Në teokracinë myslimane hadithja nuk është ndonjë vogëlsi. Përmbledhja e haditheve janë dokumente, të cilat përmbajnë deri në detaje sjelljet dhe fjalët e Profetit...³⁷⁴*

Qysh në fillim autorja e paralajmëron tematikën kryesore të librit dhe mënyrën si do ta trajtojë atë.

* Shprehjen "zotëroj" duhet ta kemi nga besimi në Zot, i cili sundon mbi gjithçka, prandaj duhet të jetë sajuar kjo shprehje. Sinonim kemi edhe shprehjen "mbretëroj", që duhet të ketë origjinën nga sundimi i mbretërve.

³⁷⁴ Po aty, f. 7.

Kohët e fundit është botuar libri „Të drejtat e grave në islam“, autor i së cilës është Muhamed Arafa. Ai thekson se gruaja në historinë politike të islamit jo vetëm që nuk kishte të drejta, por edhe më keq, ajo ishte inekzistente. Atëherë, pse ky autor hesht për rolin e Aishes, gruas së Profetit, që udhëhoqi opozitën e armatosur kundër kalifit të atëhershëm sundues. Meqë ai bazohet në dhjetëvjeçarët e parë të islamit, ai nuk mundet ta injorojë Aishen, po dëshiroj të mos e humb besueshmërinë. Profeti vdiq më 8 qershor, ditë e hënë, të vitit 632. Gruaja e tij, Aishja, atëherë 18 vjeçe,³⁷⁵ në moshën 42-vjeçare ishte në krye të ushtrisë në betejë, për të kundërshtuar legjitimitetin e kalifit të katërt, Ali. Kjo betejë ndodhi në Basra më 4 dhjetor 656...³⁷⁶

Autorja Mernisi vazhdon me informime e komente të gjata, se si krerët patriarkalë të islamit e kanë marrë si shkak udhëheqjen e kësaj beteje nga Aishja, për të arsyetuar se çfarë fatkeqësie i ka sjellë gruaja islamit, meqë nga ajo betejë e deri tani në islam nuk kanë pushuar betejat sektare për pushtet.

...Dy pjesët e shpjegimeve të Xhaberit ofrojnë dëshmi të shumëllojshme historike. Ato vërtetojnë se politikanët në islam shumë shpejt janë bërë të vetëdijshëm, se gjendjen e kanë nën kontroll vetëm nëse të kaluarën e shpallin të shenjtë. (...) Ky përcaktim zuri fill në shtetin Abasid, ku u praktikua kontrolli institucional. (...) Kulmoi nën sundimin e kalifit abasid Mansur gjatë viteve 136-158 (sipas kalendarit islam).³⁷⁷

Këtë përcaktim, - shenjtërimin e fesë së tyre, - besimtarët myslimanë e kanë përvetësuar si të ishin të urdhëruar nga zoti, ndërsa këtu bëhet sqarimi konkret, kur është vendosur të shpallet „e kaluara“, - islami zanafillor, - i shenjtë. Ky vendim, ndërkohë, është natyralizuar

³⁷⁵ Meqë Aishja kur vdiq Muhamedi paskësh qenë 18-vjeçare, siç pohon autorja Fatima Mernisi, atëherë na rezulton se ajo qenë martuar me Muhamedin në moshë 6-vjeçare, në vitin 620, siç rrëfëhet edhe në hadithet përkatëse.

³⁷⁶ Po aty, f. 11-12. [Sipas kalendarit të tanishëm botëror (gregorian) i bie në vitet 758-780.]

³⁷⁷ Po aty, f. 23.

si traditë si përcaktim i zotit. Pra, është fjala për një proces që e ka fillin e tij: së pari Muhamedi si sajues i doktrinës së islamit; paralelisht, i njëjti Muhamed si praktikues, duke krijuar formën e sundimit përkatës, të cilën e ka sanksionuar në kanunin e tij të emërtuar *Kuran*. Ndërkohë, këto u injektohen besimtarëve si vullnet dhe përcaktim i zotit. Gjithsesi, janë njerëzit konkretë, Muhamedi, bashkëveprimtarët dhe pasuesit, që e kanë sajuar dhe kanalizuar islamin, që të duket sikur është „prodhimtari“ e zotit, e realizuar përmes „të dërguarit“ dhe kalifëve, që gjithashtu janë „përfaqësues“ të sundimit të zotit në tokë.

Edhe pse në dukje jashtë tematikës së këtij kapitulli, megjithatë, po sjell një shpjegim që e ofron studiuësja Mernisi:

Është momenti ta përcaktoj çfarë kuptoj unë kur shprehem „ne myslimanët“. „Ne“ nuk bazohet në islam si zgjedhje individuale, si vendim personal. Unë përcaktoj faktin se, „të jesh mysliman“, është e barabartë me përkatësinë shtetërore në një shtet teokratik. Ajo çfarë individit mendon luan rol dytësor. (...) Të jesh mysliman është status i së drejtës civile të gjendjes personale, është letërnjoftim, një pasaportë, një e drejtë familjare... Këto janë të drejtat bazë. Konfuzioni mes islamit si besim personal, në njërën anë, dhe islamit si ligj dhe religjion shtetëror në anën tjetër, ka ndikuar në dështimet e shumta të rrymave marksiste dhe, përgjithësisht, lëvizjeve majtiste brenda shteteve islame.³⁷⁸

Këtë sqarim e kam trajtuar më gjerësisht në kapitullin „Islami - doktrinë nacionaliste arabe“. Por e solla edhe këtu, sepse këtë përcaktim nationalist panarab, duke shpërdoruar fenë islame, duhet ta diskreditojmë, kritikojmë e kundërshtojmë më shumë se një herë.

Kthimi në të kaluarën dhe në traditë, siç kërkohet nga burrat, është një mjet, që gjërat të rikthehen sërish në „rregullin“ e vjetër, një rregull që nuk u përshtatet të gjithëve, sidomos grave, të cilat asnjëherë nuk e kanë akceptuar. Përmes „kthimit“ të ferexheja gratë lirojnë terrenin që kanë

³⁷⁸ Po aty, f. 28-29.

pushtuar. Dhe vendi që provohet t'u imponohet grave, sigurisht është një nivel përçmues, i kamufluar si rikthim në islam in e pastër të Profetit Muhamed, i cili, përkundrazi, në vitin 610 predikonte një gjuhë aq revolucionare, saqë aristokratët e përzunë atë në ekzil.³⁷⁹

Për këtë sqarim kaq të sinqertë të studiueses Mernisi, ajo duhet të falënderohet, edhe pse e ka identifikuar veten se është ithtare e unifikimit të identitetit fetar mysliman dhe identiteteve etnike, të atyre që besojnë në islam, duke krijuar kështu një popull islam, që përfshin të gjithë besimtarët.

Autorja Mernisi misionarizmin e Muhamedit të viteve 610-622 e çmon për revolucionar. Mendoj që autorja nuk është objektive në këtë vlerësim. Muhamedin e kanë përzënë burrat e fisit të tij (Kurejsh), sepse ai donte të përvetësonte Qabenë, e cila ishte pagane dhe objekt i shenjtë kulti për banorët e Mekës dhe rrethinave, ku besimtarët paganë zhvillonin pelegrinazhin e tyre. Nga kjo del se Muhamedi nuk kishte të drejtë në këmbënguljen për të përvetësuar Qabenë, e cila u përkiste besimtarëve të saj paganë, kurse fisi i Muhamedit kishte të drejtë ta mbronte atë objekt të tij të kultit. Dëbimi i përdhunshëm i Muhamedit ndodhi vetëm atëherë kur ai zuri të praktikonte dhunë fizike për të uzurpuar Qabenë.

„Islami është historia e një njeriu të lumtur, i cili në rininë e tij ëndërronte për një botë tjetër dhe të gjithë ëndrrat e tij i realizoi në moshën e pjekurisë dhe pleqërisë me plot gjallëri, duke pasur sukses me gratë dhe duke korrur fitore ushtarake³⁸⁰ „.

E vërteta është se Muhamedi kishte sukses me gratë në martesë, por jo gjithaq në bashkëjetesë. Ndërsa për suksesin e tij ushtarake nuk mund të lavdërohet, meqë ai nuk kishte ushtri, por bandë piratësh e

³⁷⁹ Po aty, f. 33.

³⁸⁰ Po aty, f. 34.

dhunuesish ordinerë. Edhe po të ishte siç pohon ajo, nuk është në ndërin e një ligjërueseje universitare të lavdërojë këto dy suksese të tij. Sidomos i pari, suksesi me gratë, është aq skandaloz e pervers, sa që ndihesh keq edhe si burrë kur e shtjellon. Autores Mernisi, e afirmuar për të drejta të grave në hapësirën „arabe“, nuk i ka hije të arsyetojë poligaminë, kurvërinë, përdhunimet, pedofilinë, nekrofilinë etj., të praktikuar nga Muhamedi! Edhe suksesi i tij ushtarak nuk do të duhej të lavdërohej, sepse nuk ka pasur karakter çlirimtar, as për drejtësi e mirëqenie, por si plaçkitës dhe imponues me dhunë në konvertimin fetar!

Tashmë kemi përshfaqjen e një patriotizmi më të sforcuar.

Në rini Muhamedi u bë shërbëtor i një menaxhereje, Hatixhe bint Khuvailid, vejushë, e cila i takon të njëjtit fis Kurejsh dhe nga ish-burri kishte trashëguar shumë pasuri. (...) Pas kthimit nga udhëtimi tregtar nga Siria, për shkak të suksesit, Hatixheja i ofroi atij martesë. Ai ishte 25-vjeçar, kurse ajo mbi 40 vjeçe. Për Profetin ishte martesa e parë, kurse ajo ka pasur edhe burra të tjerë. Ajo i dhuroi atij katër vajza dhe tre djem. Djemtë i vdiqën që në moshë të vogël. (...) I pakënaqur nga traditat..., vit për vit shkonte për të medituuar në shpellën e malit Hira. (...) Megjithatë, misionin e tij si profet e mori më vonë. „Kur Muhamedi mbushi 40 vjet, zoti i dërgoi Xhibrilin, që t'i përcillte porosinë.“³⁸¹

Autorja paraqet një fragment interesant të biografisë së Muhamedit, duke ofruar edhe burimet historike. Për këtë duhet t'i jemi mirënjohës, sepse u mundëson lexuesve të librit të saj informimin nga burime të vjetra historike autentike.

Mbase Muhamedi nuk duhet të ketë qenë gjithaq i pakënaqur nga tradita, sa duhet të ketë vuajtur bashkëshortësinë e pabarabartë me Hatixhenë, padrone dhe, të paktën, 15 vjet më e madhe. Nga leximi i vë-

³⁸¹ Po aty, f. 38-39; autorja sjell burime për këto dhëna.

mendshëm i këtij studimi dhe i librave të tjerë, më rezultoi se përcëmi-
met e Hatixhesë duhet ta kenë detyruar Muhamedin të gjejë ngu-
shëllim në shpellën e malit Hira, ku shkonin edhe banorë të tjerë pa-
ganë të Mekës. Por këtu mund të shtrohet pyetja: pse zoti nuk e
përzgjodhi Muhamedin më herët për „të dërguar të tij“, por priti kaq
shumë vite të Muhamedit të përvuajtur dhe „analfabet“?!

Besimtarët myslimanë arsyetohen se zoti e ka testuar përkushtimin
dhe durimin e Muhamedit. Pse të mos bëhet edhe pyetja: në cilin besim
medittoi Muhamedi deri më 01.02.610?

Nga studimet më rezultoi se ai deri atëherë ka praktikuar besimin
pagan, si shumica e banorëve të atyre anëve. Tjetra ishte edhe trendi i
asaj kohe, që individët e popullsisë sunite të prezantoheshin si profetë.
Autorja sjell shembull konkret të një „profeti“ tjetër, por të
pasuksesshëm. Ajo e ka sjellë atë rast, për të argumentuar suksesin e
Muhamedit edhe përmes krahasimit. Por autorja hesht në lidhje me
faktin se Muhamedit ia solli suksesin dhuna e organizuar, meqë gjatë
viteve 610-622, kur nuk ushtronte dhunë të organizuar, përfitoi vetëm
disa dhjetëra besimtarë muhamedanë.

Edhe shpella, si vend i errësirës dhe i egërsisë, e përzgjedhur nga
zoti që të dërgonte aty Xhibrilin për të gjetur Muhamedin e dëshpëruar
dhe të përvuajtur, nuk duket gjithaq hyjnore...

*Zbulimi i parë, të cilën zoti ia dërgoi Muhamedit përmes Xhibrilin, ishte
ajeti i parë i sures 96 „Ikra“ (lexo)³⁸². Pra, islami filloi me kërkesën për
të lexuar, për t’u informuar. Kjo ndodhi në vitin 610. Zbulimi i parë e
frikësoi Muhamedin. I frikësuar nga zërat që kishte dëgjuar, i rrëfeu Hati-
xhesë. Ai dyshoi në veten e tij: „O Hatixhe, frikësohem se po humbas
vetëdijen“. Ajo e qetësoi atë. (...) Hatixhja e festoi ngjarjen, duke u*

³⁸² Në fakt surja (kapitulli) nr. 96 emërtohet “Al-Alak”, ndërsa ajeti i parë i kësaj sureje fillon me urdhrin: “Recito” (të cilin përkthyesit e japin si “lexo”, meqë përkthimi i saktë u del i pakuptimtë; dhe arabisht ndërkohë “Ikra” i kanë dhënë kuptimin “lexo”, sepse edhe klerikëve arabë nuk u përshtatej kuptimi “recito” për rrethanat ku duhet të ketë ndodhur ngjarja.

konvertuar në religjionin e ri të burrit të saj. Ajo ishte e para vartëse e islamit.³⁸³

Pothuajse të gjithë propagandistët e islamit spekulojnë me ëndrrën e Muhamedit, ku atij duhet t'i jetë paraqitur (krye)engjëlli Xhibril, dhe duhet ta ketë urdhëruar: „Lexo!“ (në fakt shqipërimi më i saktë nga arabishtja mesjetare do të ishte: recito). Pra, të tillë propagandistë duan të bindin besimtarët, se zoti paskësh urdhëruar muhamedanët që të arsimohen, por, ata harrojnë të thonë se, vetë Muhamedi informon se kishte ëndërruar dhe ëndërrimi, ashtu si ëndërrimet, nuk mund të vlerësohet si „zbulim“ i dërguar nga zoti.

[Bashkautorët myslimane, Leila Azam dhe Aisha Gouvernuer, në librin e tyre „Biografia e Profetit Muhamed“³⁸⁴ rrëfejnë më në detaje si ka ndodhur zbulimi i ajetit të parë, por kjo tematikë do të trajtohet në një kapitull më vete.]

Prof. dr. Fatima Mernisi harron që për tematikë të studimit ka pozicionin e gruas në islamin zanafillor. Atë e tërheq më shumë biografia e Muhamedit dhe historia e islamit zanafillor, meqë tashmë ishte faktorizuar populli arab, me gjithë ato pushtime aq të shpejta dhe të bujshme.

Ajo i rikthehet sërish tematikës së librit dhe, për pozitën diskriminuese të gruas, shkruan:

Sipas Bukharit,³⁸⁵ Ebu Bekri duhet të ketë qenë ai, i cili duhet të ketë dëgjuar Profetin të ketë thënë: „Kurrë një popull nuk do të arrijë mirëqenie, nëse gruas do t'i besohet udhëheqja e tij“. Meqë kjo hadithe është përfshirë te përmbledhja nga Sahihal-Bukhari, atëherë vlerësohet si i vërtetë,

³⁸³ Po aty, f. 39

³⁸⁴ http://www.way-to-allah.com/alb/documents/JETA_E_PROFETIT_MUHAMED.pdf; f. 25.

³⁸⁵ Dijetar i shquar arab. Ka jetuar në vitet 818-870. Emri i tij i plotë: Muhammad in Ismā'īl ibn Ibrāhīmibn al-Mughāraal-Buchārīal-Dschufī (arabisht: محمد بن إسماعيل بن إبراهيم بن المغيرة البخاري).

meqë Bukhari ka qenë studiues i saktë (...) Mua nuk më pengon asgjë, si grua myslimane, që të bëj hulumtime historike dhe metodologjike për këtë hadithe dhe formuluesin e saj dhe, para së gjithash, të hulumtoj rrethanat kur është përdorur ajo për herë të parë: kush e tha këtë hadithe, ku, kur, pse dhe kujt ia tha?³⁸⁶

Nuk po sjell këtu paraqitjet e gjata të hulumtimeve që ka bërë autorja për këtë hadithe. Mjafton të theksoj se autorja provon t'i bindë lexuesit, se kjo hadithe diskriminuese për gratë nuk ka dalë nga goja e Muhamedit, por nga goja e Ebu Bekrit, i cili, për të qenë më imponues, thotë se e ka dëgjuar nga Profeti. Pra, sipas autores, kjo hadithe u bë publike pas vdekjes së Muhamedit, kur kalifi Ali ripushtoi Basrën, meqë fitoi kundër Aishes (e veja e Muhamedit) në të ashtuquajturën *Beteja e Deveve*.

Autorja Fatima Mernisi tashmë sjell hadithe, që kanë në përmbajtjen e tyre diskriminimin dhe poshtërimin e grave, përgjithësisht femrave. Ja hadithja e radhës:

Muhamedi ka thënë: „Qeni, gomari dhe gruaja prishin namazin, nëse ecin para besimtarit, sepse ata do të gjenden mes tij dhe kiblës. „³⁸⁷

Ajo e nis kapitullin e radhës, si vijon:

Gjatë kohës kur Profeti po përmbushte misionin e tij, qoftë në Mekë (610-622) ose në Medinë(622-632), ai u kushtojë grave rol të rëndësishëm në jetën publike. Ishte 40 vjeç (për disa kronika 43), kur i ndodhi zbulimi i parë, në vitin 610. (...) Ekzistojnë shumë përshkrime për frikën dhe ankthin që përfshiu Profetin me rastin e zbulimit të parë. Gjithandej informohet se ai gjeti energjinë e duhur nga jeta bashkëshortore: „Muhamedi po zbriste nga bregu. (...) Atij po i dridheshin gjithë pjesët e trupit

³⁸⁶ Fatima Merinissi, vep. e cit. , f. 67-68

³⁸⁷ Po aty, f. 88; autorja jep si burim: Bukhari, “Sahih”, vepra, vëll. 1, f. 99.

një frika e ankthi, që i kishte shkaktuar Xhibrili (...) Ai iu përgjërua Hatixhes: „Më mbulo! Më mbulo!“ Hatixheja e mbuloi me një mantel dhe atë e zuri gjumi. Hatixheja kishte lexuar shkrimet e vjetra dhe prandaj njihje historitë e profetëve, dinte edhe për Xhibrilin (...).³⁸⁸

Autorja Mernisi do që të madhërojë rolin e gruas Hatixhe, në katalpultimin e Muhamedit në profet. Mbase e ka gjetur këtë taktikë për të diskredituar Muhamedin si „I Dërguar i Allahut“. Ajo mjaftohet me Muhamedin si kryehero kombëtar arab. Por autorja nuk është e vetëdijshme se lexuesit mund të pyesin se pse është frikësuar Muhamedi, sepse vërtet ka ëndërruar një ëndërr të llahtarshme dhe e ka vuajtur ngufatjen nga Xhibrili, ose sepse e ka takuar Xhibrilin papritur?!

Meqë *Kurani* është normativi bazë i fesë islame, do të përzgjedh disa ajete (sipas radhës në *Kuran*) që përmbajnë përcaktime për gratë, për të parë nëse ato e privilegjojnë ose e diskriminojnë gruan.

Gratë tuaja janë arat tuaja. Afrojuni arave tuaja si të doni e paraqitni diçka për shpirtin tuaj. Dhe druhuni ndaj Perëndisë dhe dini se do të takoheni me Të. Sihariqo besimtarët. [2:223 / shq. H. E. Nahi]

Po e ofroj edhe në origjinal:

يَسْأَلُكُمْ خَزَنَاتُكُمْ فَاَنْتُمْ اَحْرُزٌ فَكَمَا تَنْشِئْتُمْ قَدِّمُوا الْاَنْفُسَ كُمْ وَاتَّقُوا اللّٰهَ اَعْلَمُوْا اَنَّكُمْ مَّالِقُوْهُ هُوَ يَشِيْرُ الْمُؤْمِنِيْنَ

Meqë është ajet me përmbajtje tepër irrituese, po e ofroj edhe shqipërimin e prof. Sh. Ahmetit:

³⁸⁸ Po aty, f. 135-136. Autorja citon sipas Tabari; Tarikh, vëll. 2, f. 209; ibn Hisham, Sira, vëll. 1, f. 249.

Gratë tuaja janë vendmbjellje juaja. Afrohuni vendmbjelljes suaj si të dëshironi, por përgatituni për veten tuaj dhe kini frikë Allahun, e ta dini se fundi juaj është tek Ai, e besimtarëve jepuni myzhde. [2:223]

Edhe përkthimet në gjermanisht kanë po këtë përmbajtje, me emërtime „arë“ dhe „vendmbjellje“, që në parim kanë pothuajse të njëjtën përmbajtje.

Debat i nxehtë për këtë përcaktim ka nxitur ligjërata që ka mbajtur kleriku i afirmuar egjiptian, Abdel Moez al-Eila, në një xhami në Berlin. Ai ka interpretuar ajetin 2:223 saktësisht, por myslimanët që nuk e njohin *Kuranin* ose besojnë në një islam të dëshiruar, janë revoltuar kundër interpretimit të tij. Madje, një federatë e shoqatave turke e ka denoncuar këtë klerik.

Edhe teologu kristian, Holger Lahayne, është marrë me atë ligjëratë, duke ofruar informacion burimor islam, për të argumentuar se është dogma islame, që e diskriminon gruan dhe jo kleriku që e ka prezantuar.³⁸⁹ Ndërsa mua më duket logjike dhe e drejtë që të denoncohet *Kurani*, që përmban ajeti 2:223 dhe ajete të ngjashme dhe jo kleriku që ka prezantuar saktësisht *Kuranin*.

Rëndom, klerikët e teologët myslimanë zhurmojnë se janë të domosdoshme interpretimet e dijetarëve islamë (studiuësit jomyslimanë nuk qenkëshin kompetentë), dhe prandaj konsultova edhe një studim të islamologut Samir Mourad, që ka bërë një përmbledhje në gjermanisht, duke u bazuar në hadithe dhe tek interpretuesi Ibn Kathir dhe Taberi. Me këtë rast është cituar edhe hadithja:

Xhabiri ka rrëfyer: „Çifutët rëndom thonë: „Në qoftë se marrëdhënia seksuale me një grua zhvillohet nga prapa, fëmija lind me sy çatall!“ Për këtë arsye është zbuluar ky ajet (ajeti) i Kuranit. ³⁹⁰

³⁸⁹ <http://www.freiewelt.net/blog/eure-frauen-sind-euch-ein-saatfeld-10054573/>.

³⁹⁰ Buhari 4528; cituar sipas Samir Mourad, “Erläuterungdes Koran (Tafsīr)”, f. 292-293; varianti elektronik i studimit: http://www.way-to-allah.com/dokument/Tafsir_Band1.pdf

I njëjti studiues citon edhe Ibn Kathirin, që paskësh thënë se burri ka të drejtë të praktikojë seks me gruan e tij si të dëshirojë dhe gruaja nuk duhet të kundërshtojë.

Në vazhdim citohet edhe Ibn Abasi, që ka thënë:

Versi 2:223 është zbritur, për shkak se ca çifutë të fisit Ansar e kanë pyet të Dërguarin (Muhamedin s. a. s.) nëse lejohet me seksi me grua nga mbrapa, e ai u është përgjigjur: „Ju mund të bëni seks si të doni, e rëndësishme është ta futni në birë.“³⁹¹

Mjaft me citime të marrëzive të interpretuesve klasikë, meqë sa më shumë që të citohen, aq më shumë rritet neveria ndaj këtij ajeti dhe autorit të tij, Muhamedit (shihet se ishte një përgjigje e shpejtë e një pyetjeje konkrete, pasi ai nuk pati lidhje satelitore me Allahun ta pyeste dhe ai „t’ia zbriste“ këtë ajet).

Gjithsesi, ky formulim është më tepër sesa fyes për gratë!

Juve u lejohet që gjatë netëve të agjërimit t’u afroheni bashkëshorteve tuaja. Ato janë petku juaj, e ju jeni petku i tyre. Perëndia e di mirë se ju nuk mund të duroni e kenë tradhtuar veten, e Perëndia e ka pranuar pendimin tuaj dhe jua ka falur gabimin... [2:187]

Mendësi muhamedane, për rolin aktiv të burrit dhe rolin pasiv të gruas si objekt.

Mos u martoni me paganet, derisa ato të mos bëhen besimtare (myslimane). Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse ju pëlqen juve. Mos i martoni myslimanet për paganë, derisa nuk bëhen besimtarë;

³⁹¹ Po aty.

skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ju pëlqen juve...[2:221]

Mendësi shoviniste e diskriminuese, pse jo edhe fashistoide ndaj grave jomuslimane dhe ndaj jomuslimanëve në përgjithësi!

Po të të pyesin ty për ciklin mujor të femrave, thuaju: „Ajo është e neveritshme! „Prandaj gjatë kësaj kohe largohuni prej tyre dhe mos iu afrohuni derisa të pastrohen. E pasi të pastrohen, atëherë afrohuni tek ato ashtu siç ju ka urdhëruar Perëndia... [2:222]

Maço diskriminues! Bastard!

Perëndia ju urdhëron juve në çështjen e trashëgimit për fëmijët tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave; nëse trashëgimtarë janë femrat - dy e më tepër, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia... [4:11]

Diskriminim në të drejtën e trashëgimisë!

Për ato gra tuaja që bëjnë kurvëri, kërkoni që të dëshmojnë për këtë gjë katër veta prej jush; nëse dëshmojnë ata për këtë gjë, mbajini ato në shtëpi derisa t'u vijë vdekja ose derisa Perëndia të bëjë rrugëdalje për to. [4:15]

Muhamedi e ka sajuar këtë ajet për të mbrojtur viktimën e tij pedofile, Aishen, nga përfoljet që i janë bërë për një aferë seksuale. Duhet të ketë vendosur për numrin katër, që të mos mund të koordinohen aq shumë dëshmitarë kundër Aishes...

ISLAMI, religion agresiv (?!)

Cilido nga ju, që nuk mund të martohet me gra të lira besimtare, për shkaqe të vështira materiale, le të martohet me një vajzë besimtare që gjendet nën pushtetin tuaj (robëresha)...[4:25]

Përcënim aspak profetik e hyjnor ndaj femrave që ishin skllave...

Ju nuk jeni në gjendje, madje edhe sikur të dëshironi, të silleni drejt në mes të grave. Ndaj, mos anoni krejtësisht vetëm nga njëra e ta lini tjetrën si të varur... [4:129]

Muhamedi në shërbim të mendësisë së tij poligamiste, bazuar në përjetimet vetjake...

Laviren dhe lavirin [duhet] t'i rrihni, secilit prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre të dyve, nëse besoni tek Allahu dhe bota tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh. [24:2]

Aspak njerëzore rrahja dhe poshtërimi publik...

Bazuar në formulimin gjuhësor, sërish edhe ky ajet, si qindra të tjerë, dëshmon se Allahu nuk është autor!

Laviri nuk do të duhej të martohej me tjetërkënd, pos me ndonjë lavire ose idhujtare, e lavirja nuk do të duhet të martohet me dikë tjetër, pos ndonjë lavir idhujtar. Ajo është e ndaluar për besimtarët. [24:3]

Kryelaviri Muhamed me kë është martuar?!

Edhe ata, të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, duhen rrahur me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoi dëshminë asnjëherë. Të tillët janë të pabesueshëm. [24:3-4]

Në shërbim të ajetit 4:15, për të frikësuar që të mos paraqiten katër dëshmitarë burra...

Ndërsa ata, të cilët shpifin për gratë e veta dhe nuk kanë dëshmitarë të tjerë përveç vetes, atëherë dëshmia e tyre është: të betohen katër herë tek Allahu se ai e thotë të vërtetën. [24:6]

Dëshmi e mendësi e shpifur muhamedane, tejet diskriminuese!

Dhe thuaju besimtareve, që t'i shmangin shikimet e tyre dhe le t'i ruajnë organet e veta gjenitale; dhe le të mos tregojnë nga stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme. Dhe le të lëshojnë pelerinën e vet në anët e tyre dhe le të u mos tregojnë stolitë e tyre, përpos: bashkëshortëve të tyre, ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve të tyre, ose djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave të tyre ose mikeshave të tyre, ose atyre që i kanë nën pushtet (si skllave), ose atyre që u shkojnë pas e që nuk kanë pretendime të tjera ndaj femrave. E këta janë meshkujt apo fëmijët që nuk i dinë ngacmimet e femrave. Dhe mos t'i përplasnin këmbët e tyre që të hetohen stolitë e tyre të fshehta. Të gjithë ju, o besimtarë, pendohuni te Perëndia, që të arrini shpëtimin! [24:31]

Përcaktim përçmues e denigrues i Muhamedit ndaj grave të veta...

O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish e kjo për Allahun është shumë e lehtë. [33:30]

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Muhamedi kërcënon gratë e veta, si masë preventive që t'i ketë nën kontroll. Por, pse duhet të jetë ky përcaktim në Kuran, kur dihet se nuk do të ketë më „profet“?!

O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse keni kujdes e ruheni, ndaj mos u llastoni në të folur që t'ju lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, por thoni fjalë të matura. [33:32]

Mendësi e shpifur muhamedane...

Dhe rrini në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj siç shfaqej në injorancën e hershme, falni namazin, jepni zeqatën dhe respektoni Allahun dhe Të dërguarin e Tij. Allahu ka për qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë (së Pejgamberit), të largojë ndyrësinë e mëkateve dhe t'ju pastrojë deri në skaj. [33:33]

Mendësi e shpifur muhamedane...

Kur i the atij që Allahu e kishte shpërblyer dhe ti i pate bërë mirë: „Mbaje bashkëshorten tënde dhe ki frikë nga Allahu!“, e ti e mbaje të fshehtë në veten tënde atë që Allahu do ta zbulojë dhe frikësoju njerëzve, por më e drejtë është që t'i frikësohesh Allahut. E pasi Zejdi e kishte vendosur atë që kishte menduar ndaj saj, Ne ta kurorëzojmë ty atë, e për të mos pasur besimtarët vështirësi në martesë me gratë e të adoptuarve të tyre, kur ata heqin dorë prej tyre. E vendimi i Allahut është kryer. [33:37]

Sajesë e Muhamedit për të arsyetuar martesën e tij me vajzën e hallës, Zejneben, që e kishte edhe nuse të djalit të tij të birësuar, sepse populli po e përfliste për amoralist ndaj traditës - martesës me renë e vet, dhe jo për shkak që po martohej me vajzën e hallës, meqë atëherë

dhe tani është traditë shtazarake e arabëve që të martohen me vajza halle, xhaxhai, tezeje e daje...

O ti Pejgamber, Ne të kemi lejuar gratë, të cilave u ke dhënë shpërblimin e kurorës, dhe ato që me ndihmën e Allahut hyjnë në posedimin tënd dhe bijat e axhës tënd, bijat e hallave të tua, të dajës tënd, bijat e tezeve të tua, të cilat kanë migruar si ti, dhe një grua besimtare nëse ajo ia falë veten Pejgamberit dhe nëse Pejgamberi dëshiron të martohet me të duke qenë kjo vetëm për ty e jo edhe për besimtarët...[33:50]

Sajesë e Muhamedit për të arsyetuar poligaminë amorale me kushërira të tij...

Ti je i lirë të lëshosh atë që do prej tyre dhe të mbash pranë vetes atë që do, dhe të kërkosh afrimin e asaj nga e cila ke qenë larguar dhe nuk ke mëkat... [33:51]

Sërish sajesë e Muhamedit për të arsyetuar amoralitetin e tij.

O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe, vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie e duke mos pritur përgatitjen e saj, por kur të thirreni, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin, vërtet këto e mundojnë Pejgamberin, por ai turpërohet prej jush; Allahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkoni prej tyre (grave) ndonjë send, atë kërkoheni pas perdes, kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e Allahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij, pas (vdekjes së) tij. Këto janë tek Allahu mëkat i madh. [33:53]

Këtë ajet Muhamedi duhet ta ketë sajuar në momentin kur donte të hynte në dhomë ditën e dasmës së tij me vajzën e hallës, Zejneben, por

dasmorët vazhdonin të qëndronin në kasollen e Muhamedit. Atij duhet t'i ketë humbur durimi, meqë tundimin e epshit duhet ta ketë pasur tepër vulgar (siç propagandonte ai për veten e tij, e kishte potencën seksuale sa të 30 meshkujve...). Interpretuesit e *Kuranit* këtë e quajnë ajeti i „perdes“ (hixhabit)...

O Pejgamber, thuaju grave të tua, vajzave të tua dhe grave të myslimanëve, që ta veshin pelerinën e vet. Kështu është më e lehtë që të njihen ato, për të mos u ngacmuar...[33:59]

Ky është një ajet që përcakton mënyrën e mbulimit të myslimanëve, por përmasat dhe forma e pelerinës nuk është përcaktuar.

O ti pejgamber, kur t'i lëshoni gratë, lëshojini ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre dhe kohën e pritjes mbani mend mirë e kini frikë Allahun, zotin tuaj, dhe mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre, e as ato të mos dalin ndryshe, vetëm nëse bëjnë ndonjë vepër të keqe të vërtetuar... [65:1]

Formulim i përçartë muhamedan, gjithsesi, paragjykues ndaj grave...

Përkujto kur Pejgamberi ndonjëherë prej grave të veta i kumtoi fshehurazi një lajm, e kur ajo e tregoi atë e Allahu i zbuloi atij për të, ai ia bëri me dije një pjesë të tregimit, kurse për pjesën tjetër heshti. E kur ai e informoi atë, ajo tha: „E kush ta tregoi ty këtë?“ Ai tha: „Më tregoi i Gjithëdijshmi, njohësi i të fshehtave!“ [66:3]
Nëse ju të dyja pendoheni tek Allahu, sepse zemrat tuaja tanimë kanë rrëshqitur, e nëse bashkëveproni kundër tij, ta dini se Allahu është Ai, mbrojtës i tij, si dhe Xhibrili dhe besimtarët e ndershëm; e kur është kështu, edhe engjëjt i dalin në ndihmë. [66:4]

Këto ajete duhet t'i ketë sajuar Muhamedi në rastin kur ai ia besoi sekretin gruas së tij, Hafsës, vajzës së Omerit, për përcaktimin e tij që të bënte trashëgimtar Aliun, që e kishte djalë xhaxhai dhe dhëndër. Hafsaja atë sekret ia rrëfeu Aishes, e cila pastaj ia rrëfeu babait të saj, Ebu Bekrit. Ebu Bekri dhe Omeri duhet të kenë kurditur komplotin për të helmuar Muhamedin, për të shmangur faktin që Aliu të mos e trashëgonte sundimin e tij. [Më gjerësisht për këto spekulime rreth helmimit të Muhamedit mund të lexoni në kapitullin përkatës.].

Nëse ai u ka lëshuar juve, është detyrë e zotit të tij t'i zëvendësojë me gra edhe më të mira se ju; myslimane, besimtarë, respektuese, penduese, adhurese, emigruese, që kanë qenë të martuara ose virgjëresha. [66:5]

Ky është kërcënimi shantazhues i Muhamedit ndaj Aishes dhe Hafsasë, për dekonspirim të sekretit.

Myslimanet dhe myslimanët janë viktima të indoktrinimit të trashëguar dhe, prandaj, i arsyetojnë edhe këto ajete diskriminuese, denigruese, fashistoide kundër tyre, duke u ngjarë skllëvërve që u kullon goja jargë duke folur mirë për padronët e tyre...

Se cilën mendësi poshtëruese e shoviniste kishte Muhamedi ndaj grave, na (dez)informojnë edhe rrëfimet që na janë përcjellë përmes të ashtuquajturave hadithe. Citoj:

Është thënë nga i Dërguari (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) se gratë do të përbëjnë shumicën e banorëve të ferrit. Është transmetuar nga Imran ibn Huseinit se Profeti (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: „Kam shikuar në xhenet dhe kam parë se shumica e

*banorëve të tij ishin të varfrit. Dhe kam shikuar në xhehenem dhe kam parë se shumica e banorëve të tij ishin gra”.*³⁹²

*Është transmetuar nga Abdullah ibn Abasi: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: „Më është treguar xhehenemi dhe kurrë nuk kam parë gjë më të tmerrshme se ai. Dhe pashë se shumica e banorëve të tij ishin gra“. Ata pyetën: „Pse, o i Dërguari i Allahut?!“ Ai u përgjigj: „Për shkak të mosmirënjohjes së tyre (kufar)!“ Ai u pyet: “A janë ato mosmirënjohëse ndaj Allahut?” Ai u përgjigj: „Ato janë mosmirënjohëse ndaj burrave të tyre dhe janë mosmirënjohëse për trajtimin e tyre të mirë nga ana e burrave. Edhe po të jesh gjithë jetën i mirësjellshëm ndaj gruas, në momentin që ajo sheh diçka të padëshirueshme te burrit, menjëherë do të thotë: „Unë kurrë nuk kam përjetuar diçka të mirë nga ti“.*³⁹³

*Ebu Seid el-Hudri ka rrëfyer: „I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ka thanë: „(...) Unë nuk kam parë askënd që është më injorant dhe më me pak përkushtim fetar sesa gratë“. Gratë e pyetën: „O I Dërguari i Allahut, përse jemi injorante dhe të papërkushtuara nga ana fetare?! Ai u përgjigj: „Jeni të informuara, që dëshmia e dy grave është e barabartë me dëshminë e një burri?“ Ato u përgjigjën: „Po“. Ai tha: „Ajo është rrjedhojë e injorancës suaj. A nuk është e vërtetë se gruaja gjatë periudhës të saj (menstruacionit) as nuk mund të lutet dhe as të agjërojë?“ Gratë u përgjigjën: „Po“. Ai tha: „Kjo është mungesa e angazhimit fetar.“*³⁹⁴

³⁹² Sahih al-Bukhāri, hadithe nr. 3241; Muslim, hadithe nr. 2737 *cituat sipas:)

<https://arrayana.wordpress.com/2010/11/16/warum-werden-in-der-holle-mehr-frauen-als-manner-sein/>.

³⁹³ Po aty, Al-Bukhāri, nr. 1052.

³⁹⁴ Po aty, Al-Bukhariu nr. 304.

Është raportuar se Xhabir ibn Abdullah ka thënë: „Kam marrë pjesë në lutjet e Bajramit me Të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) pjesë. (...) Pastaj ai shkoi te gratë dhe u predikoi e u kujtoi atyre. „Jepni lëmoshë, edhe pse ju jeni lënda kryesore djegëse e xhehenemit“. Një grua ezmere e pyeti: „Pse është kështu, o I Dërguari i Allahut?“ Ai u përgjigj: „Sepse ju ankoheni shumë dhe jeni mosmirënjohëse ndaj bashkëshortëve tuaj“. Atëherë ato filluan t'i dhurojnë bizhuteritë e tyre dhe duke hedhur vathët dhe unaza e tyre në mantelin e Bilalit.³⁹⁵

Sigurisht, nuk ia vlen as të komentohen e interpretohen këto hadithe, sepse Muhamedi i ka formuluar këto denigrime pa ndonjë vetëcensurë mirësjelljeje!

Mjerë ato gra injorante që e adhurojnë Muhamedin për profet, kur ai ka qenë kaq denigrues, diskriminues e poshtërues ndaj grave!

³⁹⁵ Po aty, Muslim nr. 885.

III. 3. Islami – shamia, hixhabi, burka, khimari

Pas tematikës shqetësuese të xhihadit (“luftës së shenjtë” islame), “shamitë” kanë qenë dhe janë shkak për debate e zënka të shpeshta: në xhami, rrugë, institucione shtetërore e publike, në pothuajse të gjitha shtetet ku jetojnë besimtarë myslimanë, përpos në shtetet islamike, ku është e ndaluar liria e mendimit. Për lirinë e mbajtjes së “shamisë” (uniformës muhamedane për femrat) në institucionet publike shtetërore e laike, u organizuan demonstrata edhe në Kosovë. Por, meqë Kosova është shtet sekular, laik, mbajtja e “shamive” në institucione shtetërore e publike deri tani nuk është lejuar.

“Shamitë” (hixhabi, ferexheja, burka, khimari...) duhen dalluar nga shamitë e rëndomta, që i kanë mbajtur gratë në të kaluarën, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare, por edhe nga shamitë “tradicionale” që kanë mbajtur gratë (jo vajzat) shqiptare të besimit islam.

Myslmanët fundamentalistë po përpiqen t’i imponojë “shamitë” si një soj uniforme identifikuese islamike. Duket se ata nuk e kanë hallin kryesor të mbulimi i grave, sesa tek imponimi i “shamisë” si uniformë islame. Megjithatë, ata nuk janë unikë për përmasat e mbulimit të grave dhe të vajzave.

Në shtetet islamike (Irani, Arabia Saudite...) është detyrim ligjor mbulimi i grave kudo, edhe në shtëpi. Kurse në Turqi, ta zëmë, edhe pse shumica e popullsisë i përket besimit islam, në institucionet shtetërore dhe publike **nuk** lejohet “shamia”. Në shtete laike, ku shumica e popullsisë i përket besimit islam, kanë filluar të praktikohen “shami” të ndryshme. Ato diku lejohen e diku jo.

“Shamia” mund të trajtohet nga aspekte të ndryshme, si: fetar, politik, sociologjik etj. Rëndom, pyetja më e shpeshtë që ngrihet është: çfarë shkruhet në *Kuran* për shamitë (!), sepse *Kurani* përmban dogmën dhe normat bazë të fesë islame.

Qysh në fillim duhet thënë se në *Kuran* nuk përmenden fare shamitë. Vetëm përmes traditës islame “mbulesa” në islam është imponuar si lloj mbulimi i detyruar për vajzat dhe gratë.

Kemi disa ajete (ajete), në të cilat bëhet fjalë për veshje e mbulesa. Njëri prej tyre më konkretisht është ajeti i *hixhabit* (perdes), kaptina (surja) 33 [në vazhdim vetëm me numra 33:55]. Pastaj kemi ajetet 33:33, 24:31 etj., të cilat sugjerojnë veshjen dhe mbulimin, por askund nuk bëhet fjalë për “shami” dhe nuk thuhet se duhet mbuluar koka dhe fytyra.

Në ajetin 53, kaptina 33, flitet për një si perde (*hixhab*), që ndan hapësira të caktuara.

O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e Pejgamberit ndryshe, vetëm nëse u lejohet për ndonjë ngrënie (...), por kur të thirrreni, atëherë hyni, e kur të mbaroni ngrënien, atëherë shpërndahuni, duke mos hyrë në bisedë me njëri-tjetrin. Vërtet këto e mundojnë Profetit, por ai turpërohet prej jush; Allahu nuk i turpërohet realitetit. E kur kërkoni prej grave të Profetit ndonjë send, atë kërkoni pas perdes. Kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre. Juve nuk u takon ta mundoni të dërguarin e Allahut, e as të martoheni kurrë me gratë e tij. Këto janë tek Allahu mëkat i madh. [33:53]

Fillimisht dëshiroj të shpreh mendimin, se ky ajet nuk përmban asgjë profetike, hyjnore, misionare! Vërtet, zoti duhet t’ia ketë “shpallur” Muhamedit këtë ajet?! Sipas formulimit gjuhësor, ky ajet nuk rezulton të jetë i formuluar nga Allahu. Sikur të ishte shpallur nga ai, në fjalinë e dytë nuk do të thuhej: “Allahu nuk i turpërohet realitetit”. Sikur ai të ishte autori, do ta kishte formuluar në vetën e parë njëjës: *Unë nuk turpërohem nga realiteti*, ose në vetën e parë shumës (po të dominohej nga mendësia fodulle): *Ne...*

Rezultoni të jetë qesharake, se si denigrohet Allahu. Muhamedi mbase qenkësh turpëruar t’u thoshte vetë njerëzve që ta lënë të qetë, atëherë Allahu, që nuk paskësh qenë në gjendje t’ia hiqte turpin Muhamedit ose t’ia largonte njerëzit, merr rolin e shërbëtorit të tij, madje në një situatë goxha banale...

Ja si e shpjegon “shpalljen” e këtij ajeti sociologia dhe islamologia arabe, Fatima Mernisi:

Ky ajet i hixhabit (perdes) ka zbritur nga qielli në vitin 627, në dhomën e çiftit që po martohej, për të mbrojtur hapësirën private dhe për të penguar një person, në rastin konkret Anas ibn Malikun, njërin nga nxënësit e Profetit. (...) Profeti po bënte dasmën e martesës. Atij po i humbiste durimi duke pritur për të hyrë dhëndër te kushërira e tij, Zejneb, meqë një grup dasmorësh të patakhtë nuk po largoheshin, pasi kishin mbaruar së ngrëni. Hixhabi duhet të jetë përgjigjja e Allahut për njerëz pa ndjesi, që tashmë po e lëndonin Profetin, të cilin po i vinte keq të reagonte. Ky është të paktën interpretimi nga Tabari.³⁹⁶

Vërtet është më tepër se skandaloze t’i mvishet edhe Allahut muhamedan autorësia e këtij ajet. Siç shihet edhe nga shpjegimi i autores, Muhamedi ishte përfolur për martesën me Zejneben³⁹⁷, të cilën e kishte vajzë halle dhe, njëherazi, ishte edhe gruaja e djalit të tij të birësuar, Zejd ibn Harithit.

Në fillim të librit, islamologia Mernisi i arsyeton martesat e Muhamedit me shumë gra si gjest social dhe politik (për aleanca politike e ushtarake mes fiseve). Siç do të shohim, ajo jep edhe sqarime që bien ndesh me përcaktimet e saj.

Kjo martesë ishte përfolur shumë, jo sepse Muhamedi po martohej me vajzën e hallës (meqë të tilla martesë ishin dhe janë përditshmëri në traditën arabe), por sepse po martohej me gruan e djalit të tij (gjë që është e ndaluar edhe me *Kuran*). Për t’i korrptuar qytetarët që të mos e përfllisnin për këtë martesë, Muhamedi shtron drekë për të përzgjedhurit e fiseve. Dasmori Anas ibn Maliku dhe një dasmor tjetër

³⁹⁶ Fatima Mernisi, “Derpolitische Harem / Mohammed und die Frauen”, Herder Verla, ISBN 3451052806, Freiburg 1992, f. 114; at-Tabari [Abū Dscha‘far Muhammad ibn Dscha‘fir at-Tabarī / أبو جعفر محمد بن جرير الطبري (839-923)], islamolog dhe historian klasik i islamit.

³⁹⁷ Zajnaab bint Jahsh (زينب بنت جحش), jetoi në vitet 590-641), gruaja e 7-të e Muhamedit, martuar në mars 627 [Sipas biografëve klasik të Muhamedit: Ibn Isak (f. 215, 495), Ibn Hisham (note 918), Al-Tabari (vol., p. 134), Ibn Sad 8:72-81, etj.]

kishin vazhduar të qëndronin më gjatë se të tjerët pas ngrënies. Muhamedit nuk po i pritej që t'i vardisej Zejnebes për seks. Mu në këtë moment, atij duhet “t'i ketë zbritur” nga Allahu ky ajet, të cilin e reciton me zë dhe e tërheq perden (hixhabin), që ta pengonte Anas ibn Malikun të shihte çfarë do të ndodhte pas perdes...

Skandali i kësaj ngjarjeje dhe i përmbajtjes së këtij ajeti nuk mbaron me kaq. Krerët e islamit e bëjnë tërkuazë interpretimin e tij, duke u thirrur në shumëkuptimësinë e emrit *hixhab*.

Autorja Mernisi u kushton një hapësirë goxha të madhe rrethanave që kushtëzuan ajetin *hixhab*. Por, për shkak të simpatisë së madhe që ka për profetin e saj, ajo shkruan gjerësisht edhe për luftërat e tij, të cilat i trajton si çlirimtare, patriotike, madje edhe të shenjta, për përhapje të islamit dhe për formimin dhe fuqizimin e Arabisë. Citoj:

Islami zuri fill në krahët e një gruaje të dashuruar. Pas vdekjes së Hati-xhesë, Profeti zuri të kërkonte dashurinë te gratë e tjera. (...) Para arratisë në Medinë (622), ai u martua Savdën, një grua në moshë mesatare. Dashuria e madhe e jetës së tij ishte Aishja, vajza e nxënësit të tij, Ebu Bekri. U fejuar me të pak para se të nisej për në Medinë. (...) Megjithatë, ai u martua edhe me gra të tjera, ndaj të cilave Aishja shfaqte xhelozë, madje ndaj ndonjëres sajonte edhe intriga. Për shembull, shfaqti xhelozë kundër koptës (egjiptiane) Maria, një grua e bukur me flokë kaçurrelë, e cila i dhuroi Profetit një djalë me emrin Ibrahim. (...) Disa nga martesat e Muhamedit kishin të bënin me interesat ushtarake: rrjeti i aleancave me fise të konvertuara rishtas duhej të rritej. Por në të shumtën e rasteve ndikonte bukuria trupore e grave. Kështu ai u martua Xhuvairija bin al Harith, pasi mundi në betejë fisin e saj (viti 6 s. H.). U martua me Zejneb bin Jah, kushërirën e tij (gjatë dasmës i zbriti ajeti i mbulesës/hixhabi), duke mos pasur ndonjë arsye ushtarake, edhe pse ajo ishte gruaje e djalit të tij të birësuar, Zejd, kur Profeti u dashurua me të.³⁹⁸

³⁹⁸ Fatima Mernisi, vep. cit., f. 136-137.

Gjithsesi, Fatima Mernisi është kundër mbulimit të femrave myslimane dhe, për këtë qëllim, imponimin e mbulimit të grave ajo ia mvesh bashkëluftëtarëve dhe pasuesve të profetit të saj të dashur, duke e shfajësuar krejtësisht Muhamedin. Kjo mund të ketë qenë një taktikë e kësaj studiueseje, që të mos konfrontohet me fundamentalistët myslimanë.

Kthimi në të kaluarën dhe në traditë, - shkruan Fatima Mernisi, - siç kërkohet nga burrat, është një mjet që gjërat të rikthehen sërish në "rregullin" e vjetër, një rregull që nuk u përshtatet të gjithëve, sidomos grave, të cilat asnjëherë nuk e kanë pranuar. Përmes "kthimit" te ferexheja gratë lirojnë terrenin e tanishëm që kanë pushtuar. Dhe vendi që provohet t'u imponohet grave, sigurisht është një nivel përçmues, i kamufluar si rikthim në islamin e pastër të Profetit Muhamed, i cili, përkundrazi, në vitin 610 predikonte një gjuhë aq revolucionare, saqë aristokratët e përzunë atë në ekzil.³⁹⁹

Pos ajetit të *hixhabit*, për veshjen e mbulimit të grave, flitet edhe në ajete të tjera. Citoj:

O bijtë e Ademit, Ne krijuam për ju petk, që ju mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues... [7:26]

Rëndom, në traditën çifute e kristiane, Adami dhe Eva janë portretizuar të mbuluar me gjethe pemësh. Edhe në këtë ajet flitet për mbulim vetëm të organeve gjinitale. Ndërsa për petkun zbukurues vetëm mund të spekulohet, meqë duhet të jetë produkt i fantazisë

³⁹⁹ Fatima Mernisi, po aty, f. 33.

dashamirëse të autorëve të *Kuranit*, kur dihet se veshja me stof është zbuluar e praktikuar vonë.

Kur ti (Muhamed) e lexon Kuranin, mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne vëmë një perde të padukshme.” [17:45]

Edhe në këtë ajet përmendet perdja (hixhabi), por kjo duhet të jetë vetëm një perde virtuale, simbolike, metaforike.

Kësaj radhe është harruar gënjeshtria taktike se Muhamedi ishte analfabet, meqë këtu po thuhet “Kur ti e lexoje *Kuranin*”. Vërtet Allahu i gjithëditur nuk ka qenë në gjendje të jetë konsistent gjatë formulimit të *Kuranit*?!

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme! Le të vënë mbulesë mbi kraharorin e tyre... [24:31]

Në këtë ajet bëhet fjalë për një lloj **mbulesë**, e cila duhet të mbulojë kraharorin dhe gjoksin, por jo kokën. Po t’i besohet këtij ajeti, gratë e beduinëve ende nuk e kishin mbështjellë kokën. Muhamedi duhet të ketë qenë i mbikëqyrur nga Hatixheja, biznesmene, për të qenë i emancipuar në marrëdhënie me gratë, rrjedhimisht, për të mos kundërshtuar gratë e angazhuara në biznese e në punë. Ndërkaq, këtë ajet Muhamedi duhet ta sajuar rreth vitit 628, kur i bëhen shumë gra, të cilat ai tashmë nuk duhet t’i ketë pasur nën kontroll e komandë të plotë. Ato po përfliteshin për flirte të fshehta. Prandaj ai duhet t’i ketë urdhëruar që t’i mbulonin pjesët e trupit, sidomos gjinjatë, që rëndom i tundojnë meshkujt (si Muhamedi).

Muhamed Asad, në studimin e tij *Mesazhi i Kuranit*⁴⁰⁰, e komenton fjalën “mbulesë” të këtij ajeti si vijon: “Fjala *khimar* (shumësi *khumur*) është përdorur për një si shami, që e kanë mbajtur gratë arabe

⁴⁰⁰ <http://tavhid.de/?p=1416>

para dhe pas islamit, si një lloj stolie, e cila nuk iu mbulonte fytyrën dhe gjoksin”.

Teologu turk, İlhami Güler, komenton këtë ajet:

*Do të ishte perverse nëse flokët do të konsideroheshin tundim seksual. Kushdo që tundohet e nxitet nga flokët e një gruaje, do të mund të tundohet e nxitet edhe nga flokët dhe mjekra e një burri.*⁴⁰¹

Edhe komentuesi klasik dhe babai i shkollës hanefi, Al Xhasas (vdekur më 980), thotë se bëhet fjalë për mbulim të gjoksit dhe jo për mbulim të flokëve, dhe shton se mbulimi i kokës nuk është e detyrueshëm, por i sugjeruar (*makruh*).⁴⁰²

Edhe Al-Buhari na e sjell mbulesën përmes hadithes vijuese:

*Aishe r.a. ka thënë: “Perëndia do të jetë i mëshirshëm ndaj grave të emigrimit të parë, me shpalljen e këtyre fjalëve: “Ato të vendosin vellot e tyre mbi kraharor” për të mbuluar gjinjtë e tyre”.*⁴⁰³

Edhe prof. dr. Hüseyin Hatem, në librin e tij *İlahi Hikmettekin* (f. 220-245), informon se mbulimi i flokëve në atë kohë ka qenë simbolikë sociale, për të dalluar gratë e zëna (të martuara) nga të pamar-tuarat. Gjithashtu, ai thotë se shprehja *khimar* nuk duhet të përkthehet si *shami koke*, por vetëm si *mbulesë kraharori*.

Kalifi Omar ibn al Khatap ka rrahur një skllave vetëm se i ka mbuluar flokët (Serahsi, në *El-Mebcut* 2/108).

Në të njëjtën kohë dhe për të njëjtin shqetësim, Muhamedi duhet të ketë sajuar edhe ajetin:

⁴⁰¹ İlhami Güler, “Direnisteolojisi”, f. 123; <http://www.idefix.com/kitap/direnis-teolojisi-ilhami-guler/tanim.asp?sid=BP8622TEJTITVIQ1MJEJ>

⁴⁰² Al Dschassass, Ahkamul Kuran - Band 3/ S. 461; <http://tavhid.de/?p=1416>

⁴⁰³ Al-Buhariu, 3/65/12

Thuaju besimtareve të ndalin shikimet, t'i mbulojnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, se kjo është më e pastër për to... [24:30]

Ndërsa ajetet 11-20, kaptina 24, Muhamedi duhet t'i ketë sajuar në kulmin e një shqetësimi të tij, kur ishte në dilemë për t'u divorcuar me Aishen⁴⁰⁴, meqë ajo ishte përfolur për një aferë seksuale në janar 627, sapo xhihadistët muhamedanë kishin përfunduar masakrën ndaj fisit hebre Banual-Mustalik. Sipas biografit më të hershëm dhe më autentik të Muhamedit, Ibn Isak⁴⁰⁵ (i cili është bazuar kryesisht në rrëfimet e Aishes), Muhamedi kishte përdhunuar nusen e këtij fisi, Safijën, ditën kur ai kishte komanduar t'i vritej babai i saj, në prani të së bijës, dhe pasi xhihadistët ia kishin vrarë edhe burrin dhe gjithë farefisën mashkullor. Ky përdhunim kishte ndodhur në shator (qadër/tend), pothuajse në prani të Aishes. Ajo, nga hidhërimi, largohet nga shatori, takon të riun Safvan ibn al-Muatal, bën një plan me të për t'u takuar fshehurazi gjatë natës, gjatë rrugëtimit për në Medinë. Kur po errësohej, meqë karvani ndalet për të pushuar, Aishja largohet, duke bërë sikur po kryente nevojat fiziologjike. Ajo shtiret me atë rast sikur i kishte humbur zinxhiri i qafës, të cilin po e kërkonte. Karvani nis rrugëtimin, ndërsa kujdestari Safvan ibn al-Muatal ndalet për ta pritur Aishen. Ata e kalojnë pjesën më të madhe të natës aty. Në mëngjes, pjesëtarët e karvanit fillojnë të përflasin. Por, meqë Aishja ishte vajza e Ebu Bekrit, Muhamedi sajon ajetet, në të cilët përcakton katër dëshmitarë për të dëshmuar marrëdhëniet seksuale jashtëmartesore. Kështu Muhamedi shpëton Aishen nga mbytja me gurë dhe, njëherazi, shpëton edhe miqësinë me Ebu Bekrin, kalifin e parë pas vdekjes së Muhamedit (632-634).

Ky shqetësim i Muhamedit me gratë e tij do të duhej vlerësuar si tepër subjektiv dhe nuk do të duhej të imponohej si doktrinë e përhershme në *Kuran*.

⁴⁰⁴ Āisha bint Ebu Bakr [عائشة بنت أبي بكر, (614-678)], e "fejuar" nga Muhamedi në maj 620 (6-vjeçare), marrëdhënie seksuale prill 623 (9-vjeçare).

⁴⁰⁵ Muhammad ibn Isak (محمد بن إسحاق) (lindur në Medina 704; vdes më 767 në Bagdad).

Ja thirrjet dëshpëruese e moralizuese të Muhamedit, drejtuar kopesë së tij me gra:

O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish... [33:30]

O gratë e Pejgamberit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, ndaj mos u llastoni në të folur... [33:32]

*O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve që t'i vënë **mbulesat** e veta mbi trupin e tyre, se kështu ato do të njihen e nuk do të ofendohen... [33:59]*

Në këto ajete bëhet fjalë për mbulim të trupit, jo edhe të kokës. Rezulton alogjike se, duke u mbuluar, ato do të njihen më mirë apo ndoshta është menduar që të dallohen nga gratë e besimeve të tjera. Gjithashtu, nuk duket e logjikshme se gratë që mbulohen, ofendohen më pak nga meshkujt.

Meqë në *Kuran* nuk ekziston përcaktim konkret për mbështjellje të kokës dhe fytyrës, me “shami”, me ferexhe, burka, hixhab, atëherë na mbetet të shohim çfarë na thonë fetvatë (ekspertizat islamike).

Fetva për mbulimin e fytyrës për grate

[Nga eksperti zyrtar ligjor i shtetit të Egjiptit, dr. Ali Juma]

Pyetje: A është e detyruar myslimania ta mbulojë fytyrën e saj?

Përgjigje: Detyrimi për të mbuluar fytyrën për gratë është konfirmuar nga imam Ahmedi, imam Esh-Shafi dhe imam Ahmed Ibn Hanbel [themeluesit e tri prej katër shkollave ligjore të islamit sunit]. Vetëm imam

Maliku [themelues i shkollës së katërt ligjore të islamit sunit] nuk e konsideron detyrim mbulesën e fytyrës... Kjo tregon se ishte e zakonshme për gratë të dalin nga shtëpitë e tyre të mbuluara me shami ose ferexhe.

Ai pretendon se mbulimi i fytyrës nuk është detyrim në bazë të ligjit islam, por ishte një traditë, sepse fytyrat i kanë mbuluar edhe gratë e Profetit, madje edhe në poezitë paraislamike arabe kanë qenë evidente fytyrat e mbuluara të femrave. (...)⁴⁰⁶

Ky mashtrim nuk e bazon asgjëkund në *Kuran* ose hadithe dogmën bazë të islamit, por te “dijetarë” të mëvonshëm të islamit. Më lart ofrova të gjitha ajetet kuranore dhe hadithen përkatëse, kur nuk dilte obligimi eksplicit për mbulimin e flokëve dhe të fytyrës. Gjithashtu, ofrova edhe studimet e teologëve myslimanë, nga të cilat dilte se asgjëkund nuk janë mbuluar flokët e fytyra në kohën e Muhamedit dhe ai nuk duhet të kishte dhënë urdhër për mbulim të kokës e fytyrës.

Fetva për detyrim të mbështjelljes së kokës për gratë myslimane

[Nga eksperti ligjor islam, dr. Jusufel-Kardavi, kryetar i Unionit Ndërkombëtar të Dijetarëve Myslimanë. / IUMS]

Pyetje: Si e vlerëson islami të ashtuquajturin "hixhab" [perde] për mbulimin e kokës së myslimanes?

Përgjigje: Islami e konsideron mbajtjen e ferexhesë si detyrim. Allahu ka urdhëruar në librin e tij [Kuranin], në suren e dritës [24:31].⁴⁰⁷ (...) Prandaj

⁴⁰⁶ www.youtube.com/watch?v=zYGEo92Dta0&feature=related

<http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M51fa161273c.0.html>

⁴⁰⁷ “Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre. të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet...”
[Kurani 24:31 / shqip. Sherif Ahmeti]

*ferexheja e kokës është një detyrim dhe një shtyllë në islam! Por nuk është detyrim i barabartë me detyrimin si ai për namaz. (...)*⁴⁰⁸

Ky karagjoz mashtrues gënjen, kur e bazon fetvanë në ajetin 24:31. Për ta demaskuar gënjeshtërën e tij të shpifur, po citoj ajetin në fjalë:

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet ose djemve të vëllezërve të vet apo djemve të motrave të veta..."[24:31 / shqip. Sherif Ahmeti]

Në ajet thuhet: “Le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre”, por nuk figuron të jetë thënë të mbulojnë kokën (dhe fytyrën).

Fetva për ferexhenë - detyrim për gratë myslimane

Ekspertizë ligjore nr. 47, nga eksperti ligjor Shejh Abdul-Aziz bin Baz, ish-eksperti ligjor i Arabisë Saudite, ministri për Fe dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

Pyetje: Ju lutem, na tregoni dëshmitë për detyrimin e grave që të mbulojnë fytyrën. Allahu ju bekoftë!

Përgjigje: Fytyra e një gruaje duhet të jetë mbuluar përpara një burri të huaj. (...) Burrë i huaj është nipi, kushëriri, fqinji apo një burrë tjetër. Allahu u ka drejtuar myslimanëve në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) si vijon: "...E kur kërkon prej tyre (grave të Profetit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes, kjo është më e pastër për zemrat tuaja dhe të tyre..." [33:53]. Kjo vlen për gratë e Profetit (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) dhe për gratë myslimane në përgjithësi, siç mund të shihet nga porosia e

⁴⁰⁸ www.youtube.com/watch?v=VQj-DiEsMOU

<http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M543d7417f15.0.html>

Allahut: “O ti Profet, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve që t’i vënë shamitë e veta (mbulohen) mbi trupin e tyre, pse kjo është më afër që ato të njihen (se nuk janë rrugaçe) e të mos ofendohen...” [33:59]. “Mbulesa” [arab. “hixhab”, e cila është përmendur në ajetin e mësipërm], do të thotë që të veshin diçka mbi kokë dhe trup, më shumë sesa veshja. Mbulesa duhet të mbulojë kokën, fytyrën dhe të gjithë trupin. Kurse mbulesa vetëm për kokë quhet “khimar” (shami).

(...) Allahu ka bërë edhe porosinë tjetër:

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, le të vënë mbulesë mbi kraharorin e tyre...” [24:31].⁴⁰⁹

Edhe ky shpifarak vehabist i keqinterpretonte të njëjtat ajete, në të cilat askund nuk thuhet në mënyrë eksplicite që të mbulohen koka dhe fytyra, por vetëm pjesët e turpshme, kraharori.

Në përmbyllje të këtij kapitulli duhet konstatuar se mbulimi i kokës dhe i fytyrës së vajzave e grave nuk rezulton të jetë detyrim që përcaktohet me *Kuran*, as detyrim nga tradita e islamit zanafillor. “Shamitë” (khimari, ferexhetë, burkat, hixhabët) duhet t’i kenë imponuar më vonë burrat fundamentalistë e shovinistë. Ndërsa në Kosovë, në vitet e fundit, na i solli agresioni i islamit të politizuar, i quajtur *vehabistë* e *salafistë*. As islamistët fundamentalistë turq, Erdogan, Gylen dhe soji i tyre, nuk ua kanë imponuar grave të tyre mbulimin e fytyrave...

Sa u përket fetvave, ato janë kryesisht nga “ekspertët ligjorë islamë”, të islamit vehabist e salafist, prandaj nuk janë obliguese. Këto fetva i ofrova, që të dimë se ku bazohen islamistët vehabistë e selafistë në Kosovë dhe gjetiu, kur propagandojnë “shamitë”.

⁴⁰⁹ www.al-eman.com/fatwa/fatwa-display.htm?parent=button.search&id=47
<http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M57b00801fd0.html>

Shamitë janë praktikuar edhe në islamin tradicional të shqiptareve, por jo si “shamia” e parlamentares së Kuvendit të Kosovës, Labinote Demi, ose si të vajzave dhe grave të indoktrinuara me islam vehabist e selafist.

III. 4. Islami - platformë e imperializmit arab

Tematikë tejet problematike është shqyrtimi i *Kuranit* si një platformë politike e imperializmit arab, për të formësuar e aftësuar këtë popull që të bëhet fuqi imperialiste botërore. Do të mjaftonte realizimi i këtij qëllimi, qoftë vetëm përmes gjuhës, meqë lutjet (namazi) në islam, detyrimisht, duhet të bëheshin vetëm në gjuhën “kuranore” arabe.

Pyetje tepër domethënëse është, nëse Muhamedi me vetëdije e ka sajuar fenë islame si mjet për të krijuar një perandori të fuqishme arabe, apo e ka sajuar që të realizonte vetëm veten e tij, si një egoist tepër vulgar në aspektin e pasurimit të pandershëm, të seksomanisë perverse, të sundimitarit të inkriminuar etj.? Edhe po të kenë qenë motivet kryesore këto të fundit, prapëseprapë rezulton se islami ka qenë doktrinë e suksesshme për ekspansionin agresiv arab.

Për të vërtetuar këtë mendim është goxha punë e vështirë, sepse studiuesit, sidomos ata muhamedanë, janë përmbajtur, që të mos informojnë për përkushtimin “nacional” arab të Muhamedit. Pretendimi i tyre kryesor ka qenë dhe është: Muhamedi është “i dërguari i Allahut”, “profeti i fundit” për gjithë njerëzimin. Rrjedhimisht, njerëzimi përgjithësisht dhe gjithësi duhet të islamizohet, pra të arabizohet. Kurse studiuesit joislamikë u janë përmbajtur studimeve të “dijetarëve” myslimanë, sepse e dinin që besimtarët muhamedanë do t’i diskualifikojnë si antiislamistë, islamofobë, ateistë, nëse do të mbanin qëndrim objektiv e kritik. Ose ndoshta ka

studime të shumta, por meqë deri tani nuk më ka interesuar studimi i feve monoteiste, nuk jam i informuar.

Islamologu i afirmuar, Muhamad Anvar Shaikh, ka dalë nga rreshti i muhamedanëve fundamentalistë. Disa nga konstatimet e tij janë:

“Edhe pse islami i ka shkaktuar dinjitetit kombëtar të myslimanëve joarabë më tepër dëme se çdo fatkeqësi tjetër që mund t’u ketë rënë atyre, përsëri ata besojnë se ky religjion është ambasadori i:

1- barazisë dhe

2- dashurisë njerëzore.

1a. Kjo është një fantazi, e paraqitur me një mjeshtëri të pashembullt. Në të vërtetë, Profeti Muhamed e ndau njerëzimin në dy pjesë: në arabë dhe joarabë. Sipas këtij kategorizimi, duke përdorur kartën e Imperializmit Kulturor Arab, arabët janë sunduesit dhe joarabët janë të sunduarit. Islami është mënyra për të realizuar këtë ëndërr, sepse bazat e tij e ngre në qiell superioritetin e Arabisë, duke u shkaktuar pasuesve joarabë të tij një lloj inferioriteti në dinjitetin e tyre kombëtar. Nga këndvështrimi arab, kjo skemë duket e jashhtëzakonshme, e mrekullueshme dhe e mister-shme, por është shkatërruese, tallëse dhe destruktive për myslimanët joarabë. Sidoqoftë, nën efektin psikologjik të saj, ata i gëzohen deri në vetëdegradim, duke shpresuar që të shpërblehen nga Profeti me luksin e parajsës.

2b. Dashuria islamike për njerëzimin është një mit, madje i përmasave të mëdha. Urrejtja ndaj jomyslimanëve është boshti i ekzistencës islame. Ai jo vetëm që i deklaroi jomyslimanët si banorë të ferrit, por gjithashtu kërkon të ndezë një zjarr të përhershëm tensionesh mes myslimanëve dhe jomyslimanëve; kjo është shumë më vdekjeprurëse sesa ideja e Karl Marksit mbi konfliktin social, të cilën ai e indoktrinoi për të mbajtur gjallë teorinë e tij. Duke pasur parasysh tendencën e thellë për glorifikimin e arabëve, islami nuk cilësohet si një besim, por si një Lëvizje Kombëtare Arabe. Suksesi i tij qëndron në shndërrimin total të pikëpamjeve të besimtarëve të saj joarabë, të cilët heqin dorë nga rrënjët e tyre kombëtare, për të adhuruar shenjtërinë, superioritetin dhe epërsinë arabe. Pranvera e tij është fuqia ndërmjetësuese mitike e Profetit Muhamed. Kjo paralizë psikologjike shkaktoi rënien e kombeve të mëdha

aziatike, të tilla si India, Egjipti dhe Irani, të cilat dikur përbënin "prurësit" më të mëdhenj të qytetërimit, por tani renditen si anëtarë të "Botës së Tretë", për shkak të humbjes së identitetit të tyre kombëtar dhe gjallërisë (vrullit) nën ndikimin e islamit (...)"⁴¹⁰

Është e vërtetë tragjike se, tashmë, shumë popuj në Afrikën Veriore dhe në Azi janë arabizuar, kurse shumë popuj të mbizotëruar nga besimi islam, siç janë turqit, iranianët, indonezianët, boshnjakët etj., madje edhe shqiptarët myslimanë (ku "zyrtarisht" më llogaritin edhe mua), janë shndërruar në popuj hibridë, që vetëmashtroshëm pretendojnë se janë popuj me identitet etnik autonom kombëtar, por gjithsesi, mendësia e tyre fetare, morale, juridike, politike mbisundohet nga mendësia arabo-muhamedane.

Profeti Muhamed (...), sa herë që vlerësohet objektivisht, pa dyshim rezulton hero i madh arab, më i madh se çdo hero që kanë prodhuar kurdoherë popujt e tjerë. Madhështia e tij qëndron në mjeshtërinë e shfrytëzimit të konceptit të të qenit "profet", i cili, duke qenë një praktikë tradicionale dhe integrale e kulturës së Lindjes së Mesme, është më pak shpirtërore dhe më shumë politike.⁴¹¹

Tradita integrale e Lindjes së Mesme shkon deri në Babiloni, ku ishte sajuar kryezoti Marduk. Kjo ndodhi, pasi Hamurabi I (1792 - 1750, p. e. s.) mundi qytet-shtetet përreth Babilonisë dhe krijoi perandorinë e tij. Ai sajoi kryezotin e panteonit babilonez, Marduk, dhe u vetëshpall përfaqësues, sundimtar i tij.

Atij kryezoti iu sajua edhe himni:

*Kush mund të shpëtojë para fuqisë sate?
Vullneti yt është një mister i përjetshëm!
E ke shtrirë në qiell dhe në tokë.*

⁴¹⁰ <http://www.islam-watch.org/AnwarSheikh/Islam-Arab-Imperialism6.htm>

⁴¹¹ <http://www.islam-watch.org/AnwarSheikh/Islam-Arab-Imperialism2.htm>

*Komandon detin dhe deti të bindet.
Urdhëron stuhinë dhe ajo qetësohet.
Urdhëron rrjedhën gjarpëruese të Euftratit
dhe vullneti i Merdukut ndalon përmytjet.
Zot, Ti je i shenjtë!
Kush barazohet me ty?
Marduk, Ti je i nderuar si kryeperëndi
midis perëndive që mbajnë një emër.⁴¹²*

Këtë traditë e vazhdoi edhe “profeti” Moisi (hebraisht: מֹשֶׁה / *Mo-sheh*; arabisht: مُوسَى *Mūsā*), i cili sajoi zotin Jhv (Jahva ose Jehova), zot i tij dhe i popullit izraelit. Në islam, ky është profeti i 14-të. Muhamedi e ka kopjuar Moisiun në sajim të zotit: Moisiu sajoi Jehovahin hebre, Muhamedi sajoi Allahun islam. Mashtrimi i madh ishte: që të dy zotat i kanë mandatuar Moisiun dhe Muhamedin që të bëhen sundues. Urdhrat përkatës u qenkëshin komunikuar përmes engjëjve, saktësisht përmes ëndërrimeve...

Studiuesi Hamed Abdel-Samed⁴¹³ shtjellon përkushtimin panarab të Muhamedit si vijon:

Muhamedi, si tregtar i ri, në udhëtimet e tij të shumta në Damask, ka kontaktuar shumë çifutë e kristianë dhe ka dëgjuar prej tyre histori nga Bibla. Rrëfimet për Abrahamin i qenë ngulitur si më kryesore për doktrinën e tij, të cilën ai e emërtoi Islam. Edhe djalin e tij të vetëm Muhamedi e quan Ibrahim, varianti arab për Abraham. Që ta bëjë doktrinën e tij*

⁴¹² <http://islamreview.org/anwarshaikh/arabnationalism/Chapter1.html>
[Shqipërimi nga anglishtja me ndihmë të google.]

⁴¹³ Politologu dhe islamologu egjiptiano-arab Hamed Abdel-Samad është ligjërues në universitetin e Erfurtit dhe Munihut (München), anëtar i Konferencës Islamike Gjermane, i angazhuar në UNESCO për studime të islamit.

* *Bibla* përfshin *Besëlidhjen e Vjetër* të judenjëve (Tora / Teurat) dhe *Besëlidhjen e Re* të kristianëve (Ungjillin).

interesante edhe për arabët çifutë dhe kristianë, ai u mbështet tek Abrahami si Baba Burimor. Por bëri një ndryshim mjeshtëror mashtrues. Muhamedi u informua për rrëfimin biblik mbi djalin e Abrahamit, Ismailin, të cilit në Bibël nuk i jepet rëndësi e madhe. Për djalin e skllaves egjiptiane Haxhara në Bibël rrëfëhet se Abrahami e ka lënë atë dhe nënën e tij në shkretëtirë, meqë gruaja e tij, Sara, qe bërë xheloze ndaj Haxharës dhe djalit të saj. Kurse Muhamedi shton se Abrahami ka dashur të viktimizojë Ismailin për kurban dhe jo Isakun. Kështu, trashëgimia abrahimike u ka takuar edhe pasardhësve të Ismailit, pasardhës i të cilit prezantohen Muhamedi dhe fisi i tij. Për kompletim të këtij përcaktimi në Kuran rrëfëhet se Abrahami dhe djali i tij kanë ndërtuar Qabenë, që të funksionojnë si objekt kulti për të gjithë pelegrinët pasardhës. Një taktikë e zgjuar, përmes së cilës Muhamedi do të përfitonte edhe pjesëtarët e fisit për lëvizjen e tij të re, sepse ata e respektonin pelegrinazhin në Qabe si ritin më domethënës të paganizmit të tyre.

Qabeja e Mekës njihet atëherë si qendër religjioze e Arabisë. Qyteti ishte i vendosur në rrugën kryesore tregtare Damask-Jemen. Para islamit secili fis mund të ekspozonte zotat e tij në Qabe, kështu që ishte qendër politeiste. Edhe kristianëve u ishte lejuar të ekspozonin fotografi të Jezusit dhe Marisë brenda në Qabe. Ky ishte një përcaktim pragmatik, i nevojshëm për kohën, meqë Qabeja ishte pikëtakimi për të gjithë tregtarët e hapësirës arabe. Kjo ishte tolerancë e këtij qyteti, e cila përfundoi pas invadimit fitimtar të muhamedanëve.

Kur Muhamedi zuri të predikonte fenë e tij të re në Mekë, mekasit e lejuan atë të lutej para Qabesë. Ai pat vlerësuar këtë tolerancë: “Juve feja juaj, mua feja ime”. Vetëm kur ai deshi të hiqte nga Qabeja rekuizitat e kultit pagan, ndodhi konflikti mes tij dhe pjesëtarëve të fiseve mekase, meqë ata preferonin mbarëvajtjen e veprimtarisë tregtare.

Koha paraislamike karakterizohej me zënka dhe luftime mes fiseve arabe. Këto i nxitnin mjeshtërisht dy superfuqitë botërore, të cilat ishin të kufizuara me Arabinë: perandoritë bizantine dhe persiano-sasanide. Të dyja angazhonin fise arabe për bërë luftime për interesa të tyre në siujdhesën arabike.

Përkundër kësaj, Muhamedi ëndërronte për një perandori të madhe arabe, me kryeqendër religjioze Qabenë. Kështu, ai iu përgjigj traditës

familjare. Edhe stërgjyshi i tij, Kusai Ibn Kilab ishte përpjekur të bashkonte fiset grindavece arabe, duke synuar bashkimin edhe me medinasit. Por ai vdiq para se të realizonte qëllimin e tij. Nipi i tij, Muhamedi, do të përfitonte nga aleancat e stërgjyshit me fiset e Medinës, e cila në atë kohë quhej **Jatirb**.

Muhamedi predikoi në Mekë trembëdhjetë vite pa ndonjë sukses që t'ia vlejë të madhërohet. Vetëm pak dhjetëra veta u konvertuan pas tij, shumica e të cilëve ishin skllevër. Vetëm kur u shpërngul në Medinë me ithtarët e tij, ai përfjetoi shpërthimin. Ai ndërmjetësoi për të fashitur armiqësinë mes fiseve të mëdha Aos dhe Khasraxh, duke u zgjedhur si udhëheqës i Medinës.

Në Medinë, Muhamedi iu përafhua fillimisht arabëve çifutë, ritualet e të cilëve i pëlqeu: ai fuqizoi lejime dhe ndalesa çifute, siç ishin ritualet e pastrimit, lutjet, agjërimi dhe ndalesën e ngrënies së mishit të dërrit. Madje, ai përcaktoi Jerusalemin si orientues për lutjet myslimanëve. Lejimet dhe ndalesat i quajti "Sharia", një përkthim tekstual i emërtimit çifut "Halaha"; në hebraisht dhe arabisht do të thotë "rruga".

Muhamedi ngarkoi formulimin e një marrëveshjeje për bashkëjetesë paqësore mes fiseve arabe, që u përkisnin kryesisht feve pagane e çifute, e më pak kristiane dhe myslimane. Ajo kishte 52 nene dhe garantonte lirinë e besimit, por cenonte neutralitetin çifut në disa fusha. Kështu, çifutët u obliguan të përkrahnin Muhamedin ushtarakisht dhe të mos bënë më tregti me mekasit paganë. Ai shpresonte se çifutët dhe kristianët do të pranonin fenë e tij, meqë thirrej në Abrahamin dhe historitë e profetëve të Biblës i integroi në Kuran. Por shumica e fetarëve e ruajtën distancën. Para së gjithash, çifutët e Medinës nuk donin të rrezikonin neutralitetin dhe fleksibilitetin me fiset e tjera arabe pagane. Madje, disa prej tyre kooperuan me mekas, të cilët gjendeshin në konflikt kundër Muhamedit. Si hakmarrje, Muhamedi dënoi fisin çifut Khejbar me zhdukje të tërësishme. Deri tani islamistët në të gjithë botën thërrasin në demonstrata: "Khejbar, Khejbar, ju çifutë, ushtria e Muhamedit do të rikthehet!".

Pastaj Profeti bëri kthesën. Ai që nuk u bindej fjalëve për t'u konvertuar në mysliman, duhej të nënshtrohej me dhunë në rrugën e drejtë. Kur Muhamedi pushtoi Mekën e tij të lindjes, ai nuk tha më "Juve feja juaj, mua feja ime". Si dikur Abrahami, ai shkatërroi të gjitha

rekuizitat pagane në Qabe. Kushdo që kundërshtonte sundimin e tij, urdhëronte që të vritej. Edhe një burrë të paarmatosur, i cili kërkonte strehim në Qabe, ai urdhëronte që të vritej. Kjo ishte shkelje e një tabuje, meqë Qabeja ishte zonë ku nuk guxonin të ndodhnin luftime.

Ai urdhëroi që të pastrohet tërësisht qyteti i Medinës nga çifutët dhe kristianët. Për këtë qëllim ai formoi një bandë, e cila u urdhërua t'u bëjë atentate kundërshtarëve të Muhamedit. (...) Brutale ishte sidomos vrasja e një plake, e cila Muhamedin e paraqiste si gënjeshtar dhe prandaj motivi dyzet nipër e stërnipër të saj që të luftonin kundër tij. Muhamedi dërgoi njësitin e tij special, që komandohej nga djali i tij i birësuar, Zejdi, që të hakmerrej ndaj plakës. Zejdi vrau të gjithë nipërit e stërnipërit e saj, vetëm një grua të bukur jo, të cilën e zuri robinjë dhe ia dërgoi Muhamedit. Zejdi urdhëroi ta lidhin plakën mes dy deveve, të cilat i detyruan të ecnin në drejtime të kundërta, duke e ndarë plakën në dy pjesë.

Përmes dhunës Muhamedi u shkaktoi kundërshtarëve frikë dhe tmerr, duke mbjellë kështu farën e jotolerancës në zemër të islamit. Kjo farë ka mbirë, është rritur dhe ende po bën fruta. Falë Muhamedit, një qendër multireligjioze u shndërrua në monoteiste. Falë tij Allahu i u bë paparashikueshëm, një zot i egërsuar (...)

Pothuajse gjysma e betejave të Muhamedit në siujdhesën arabe u bënë kundër fiseve çifute, të cilat po rezistonin t'i nënshtroheshin. Papritmas gjuha e Kuranit u shndërrua në gjuhë tejet polemike dhe armiqësore. Fillimisht ata quheshin "njerëz besimtarë të librit", tashmë quheshin "falsifikues të librit". Armiqësia eskaloi deri atje, sa Kurani i quante çifutët "majmunë" dhe "derra". Tri fise çifute u dëbuan nga Medina, i katërti u akuzua për tradhti të lartë. Me urdhër të Muhamedit të gjithë burrat e atij fisi u vranë, fëmijët dhe gratë u shitën si skllëvër. Medina u pastrua nga çifutët, drejtimi i lutjeve myslimane u spostua nga Jerusalemi drejt Mekës. Në Kuran është sanksionuar armiqësia e përhershme kundër judenjve në suren 8, ku ata përshkruhen si kafshë, të cilët janë të mallkuar për tradhti:

"Krijesat më të dëmshme tek Allahu janë ata që mohuan, nuk pritet që ata të besojnë. [8:55]

Këta janë ata prej të cilëve ti pate marrë premtimin (se nuk do të ndihmojnë idhujtarët) e të cilin ata nuk e ruajtën, por si çdoherë e thejnë premtimin e tyre. [8:56]

*Po nëse i ndesh (i zë) ata në luftë, atëherë ti (me shkatërrimin e tyre) shpartalloji ata që janë pas tyre, në mënyrë që të marrin mësim. [8:57]**

Kështu nisi angazhimi për “pastrimin e Arabisë”. Në siujdhesë nuk duhej të rronin më jomyslimanët, sepse ajo duhej të shërbente si bazë për perandorinë islame, e cila do të duhej të invadonte në gjithë botën. Kjo ishte ora e lindjes së fashizmit zanafillor islam.⁴¹⁴

Solla fragmente më të zgjeruara, për të ofruar më shumë informacion se si studiuesi Hamed Abdel-Samad e shtjellon panarabizmin e Muhamedit dhe, njëherazi, e vlerëson si doktrinë dhe praktikë fashiste.

Një tjetër studiues i hapësirës arabe, pa pretendim për të qenë historian e as islamolog, ka shkruar librin me titull intrigues: *Të marrët e Allahut, si po e pushton botën islamizmi*⁴¹⁵. Fjala është për shkrimtarin algjerian, tashmë goxha të afirmuar, Boualem Sansal, i cili ka gradë shkencore "Doktor në ekonomi" dhe është funksionar shtetëror në Algjeri.

* Meqë shqipërimi nga Sherif Ahmeti nuk përputhet me përkthimin në gjermanisht, po e shqipëroj nga gjermanishtja, për të bërë krahasimin se sa shumë dallojnë përkthimet mes tyre: *“Megjithatë, para Allahut më të këqij se kafshët janë jobsimtarët dhe ata që nuk besojnë. Janë ata, me të cilët Ti kishe krijuar një lidhje, pastaj ata e shkelnin çdo herë këtë lidhje dhe nuk i frikësohen Zotit. Prandaj, kur Ti i zë në luftë, futua tmerrin me brutalitetin Tënd, që të frikësohen edhe ata që qëndrojnë prapa tyre.” [8:55-57].*

Këtë variant që e shqipërova nga gjermanishtja, është sipas islamologut Hamed Abdel-Samad (f. 67), edhe ky dallon nga *Kurani* në gjermanisht, i publikuar në internet.

⁴¹⁴ Vep. cit. , f. 61-67.

⁴¹⁵ Boualem Sansal, “Allahs Narren” (Të marrët e Allahut), Merlin Verlag 2013 (botim në gjuhë gjermane).

http://merlin-verlag.com/shop/article_978-3-87536-309-8/Boualem-Sansal---ALLAHS-NARREN.html?shop_param=cid%3D24%26aid%3D978-3-87536-309-8%26

Në këtë libër ky autor shtjellon lindjen e islamit, fragmentarizmin e tij në sekte qysh në lindje, luftën e përgjakshme mes tyre dhe rrezikun që ato luftime t'i imponohen botës. Por mendoj se, duke jetuar në rrethana konfliktuale mes sekteve islame në Algjeri, ky autor e ekzagjeron rrezikun e ekspansionit të islamit konfliktual në gjithë botën.

Informuese janë analizat e tij për mënyrën e lindjes së islamit. Sipas tij, islami është kryesisht platformë ekspansioniste arabe, me pretendim këmbëngulës për të arabizuar mundësisht gjithë botën. Doktrinën islame nuk e çmon si doktrinë universale fetare. Ai, edhe përmes dëshmimeve autentike, informon lexuesit se si ka ndodhur ekspansioni arab, i kamufluar si ekspansion islamik, duke pushtuar e asimiluar përdhunshëm popuj të ndryshëm, që flisnin gjuhë të ndryshme, e që tani emërtohen si popuj e shtete arabe. Ai vajton konkretisht rastin e Algjerisë së tij, e cila, sapo u çlirua nga kolonializmi francez, ra nën kolonializmin panarab, i kamufluar si islamizim. Ky islamizim solli me vete luftërat mes sekteve islamike, duke i gjakosur e arabizuar popujt e Algjerisë.

Ja vlerësimi i autorit për arabizimin e popujve të pushtuar në hapësirën, tashmë, arabe:

*Popujt, që tashmë përbëjnë "botën arabe", në fakt janë ata popuj që u pushtuan nga hordhitë arabe në kuadër të përhapjes së islamit dhe ndërkohë hynë tërësisht në lëkurën e pushtuesve të tyre. Fillimisht atyre iu imponua feja islame (pjesërisht ia dolën të ruajnë judaizmin, kristianizmin dhe paganizmin e tyre), gjuhën (fillimisht vetëm si gjuhë liturgjike dhe administrative), pos këtyre edhe ca adete e rite, pastaj, për një kohë rekord e përvetësuan historinë e tyre, duke e përdorur si burim për identitetin e tyre. Dhe kështu, siç ndodh me hedhjen e rrobave të vjetra në mbeturina, ata hodhën në mbeturina identitetet e tyre etnike, gjuhët dhe traditat e tyre, historitë e tyre mijëvjeçare. Me plot krenari kanë veshur rrobat e reja shkëlqyese: **identitetin arab**. Ishte epoka, kur bota e re arabe me plot fodullëk rrihte gjoksin e Muhamedit, që ta kishte nga*

*gjiri i vet profetin, të cilin Allahu e përzgjedhi që t'ia proklamonte njerëzimit Kuranin - privilegj ky hyjnor.*⁴¹⁶

Përkufizim paksa letrar, por që përmban realitetin e hidhur historik.

Kam takuar plot pjesëtarë të popujve "arabë", që dinin se paraardhësit e tyre, para pushtimeve arabe, nuk ishin arabë e as myslimanë. Por tashmë ndiheshin krenarë që, pas pushtimit, janë shndërruar në arabë myslimanë. Madje edhe disa ish-bashkatdhetarë shqiptarë në Kosovë, Shqipëri, Makedoni, Serbi, si dhe emigrantë shqiptarë në Perëndim, të cilët vitet e fundit u tjetërsuan në islamistë selafistë (zanafillorë), tashmë e ndiejnë veten krenarë që i përkasin *umetit** islam. Qindra prej tyre kanë shkuar vullnetarë, si xhihadistë muhamedanë, në Siri dhe Irak, për të realizuar kalifatin, sipas porosive dhe angazhimeve të Muhamedit, të sanksionuara në *Kuran*...

Autori Boualem Sansal polemizon me ata që e karakterizojnë dhe e propagandojnë islamin si fe paqësore. Për të argumentuar se nuk është e tillë, ai sjell ajetin 73 të sures 9:

O Pejgamber, lufto jobsimtarët dhe hipokritët dhe sillu rreptë ndaj tyre! Vendi i tyre është xhehenemi, që është përfundimi më i keq. [9:73]

Bazuar në këtë përcaktim kuranor, qysh në fillim është legjitimuar "lufta e shenjtë" (xhihadi) për t'i islamizuar përdhunshëm të mundurit në beteja. Nëse ata nuk pranonin të konvertoheshin në myslimanë, atëherë xhihadistët muhamedanë i zhduknin. Këtë autori e konkretizon me një shembull të komandimit të Muhamedit për të zhdukur fisin Banu Kuraiza, popullsi e njëjtë si vetë fisi i Muhamedit, por që i përkiste fesë hebraike (ihtarë të Moisiut / Musait).

⁴¹⁶ Po aty, f. 105-106.

* Arabisht: uma / أمة, e përshtatur në shqip si umet, që është shprehje për bashkësi myslimane të ngjashme me popull dhe komb.

Meqë as vetë shumica e myslimanëve nuk janë mjaftueshëm të informuar për fenë e tyre se sa është e fragmentarizuar ajo, po sjellim shpjegimet që ka bërë ky autor (duke filluar nga faqja 35 e librit).

Islami është i fragmentarizuar në katër sekte kryesore: sunitë, shiite, sufiste dhe karidshiste. Islamit sunit i përkasin rreth 85 % e besimtarëve myslimanë. Por edhe islami sunit është i fragmentarizuar në katër shkolla juridike: malikiste, hanifiste, shafiisiste dhe hanabaliste. Secila prej tyre ka koncept autentik për islamin. Kjo ka shkaktuar armiqësi të madhe edhe mes ithtarëve të këtyre shkollave. Sërish, edhe brenda secilës shkollë ka fragmentarizime.

Këto fragmentarizime kanë filluar bashkë me lindjen dhe ekspansionin e islamit, si rezultat i luftimeve për sundim në hapësirat e islamizuara. Luftimet sektariste kanë eskaluar, sidomos pasi vendet “arabe” u çliruan nga kolonializmi i pushtuesve perëndimorë.

Islami shiit është sekti i dytë, me 10-15 % të besimtarëve myslimanë. Dallimi kryesor me islamin sunit është se shiitët mendojnë që *Kurani* është krijuar, kurse sunitët mendojnë se *Kurani* i është shfaqur Muhamedit. Islami shiit identifikohet me të parin e saj, Aliun, kushëririn e Muhamedit. Në prag të vdekjes Muhamedi përcakton Aliun si kalif pasues, por besimtarët e tjerë (të udhëhequr nga e veja e Muhamedit, Aishja) nuk e pranojnë Aliun për kalif dhe, ende pa u varrosur Muhamedi, fillojnë luftimet për pasues (gati sa nuk harrojnë për ta varrosur Muhamedin. Pas tri ditësh, Muhamedin e varrosin tetë të vejat e tjera të tij, me disa fqinjë).

Në Iran dhe në Irak është mbizotërues islami shiit, por shiitë ka edhe në Siri dhe në veriun e Arabisë Saudite. Edhe islami shiit është i fragmentarizuar në nënsekte: xaferit, zejdit, ismailit dhe gëhulait.

Islami sufist bazohet në spiritualizmin ezoterik. Në kërkim të adhurimeve dhe dashurisë së zotit, pjesëtarët e këtij sekti praktikojnë askevizëm të mënyrave ekstreme të ekzazave. Këtij sekti i përket një numër i vogël besimtarësh myslimanë.

Sekti i katër minor i islamit janë karixhitenët, që i karakterizon kundërshtia ndaj sunitëve e shiitëve dhe përcaktimi paqësor, por janë asketikë ndaj punës (është i pranishëm në Sulltanatin e Omanit).

Autori ankohet se në shoqëritë islame mungon angazhimi i intelektualëve iluministë, që u kundërvihen rrymave konservatore e radikale. Kjo ndodh për shkak të konformizmit dhe frikës për konfrontim...

Revista elektronike “Orientdienst. de”, në shkrimin “Islami dhe nacionalizmi”, konstaton:

Islami dhe nacionalizmi janë shfaqur në të kaluarën historike, shfaqen edhe sot, më së shpeshti së bashku. Fjalët “nacionalizmi islamik”, “panarabizëm”, “panislamizëm” janë vetëm sinonime.

Gjatë shqyrtimit të lindjes së shtetit të parë islam bie në sy se Muhamedi, si themeluesi i bashkësisë së parë islame, ishte njëkohësisht udhëheqës fetar dhe shtetëror. Muhamedi ndërtoi një shtet islamo-arab në Gadishullin Arabik, duke luftuar për bashkim të fiseve rivale nomade dhe popujve të fragmentuar të Gadishullit Arabik në një njësi të vetme shtetërore, nën flamurin e islamit. Sipas modelit të tij, më vonë u angazhuan shumë ideologë islamikë për të realizuar atë ideal: një shtet të vetëm islam botëror (...) Meqë Muhamedi ishte arab dhe katër pasardhësit e tij të parë (gjatë viteve 632-661) ishin gjithashtu nga fisi arab Kurejsh i Mekës, kështu qe imponuar epërsia e arabizmit në islam. Perandoritë e mëdha islame pasuan trashëgiminë e Muhamedit, të cilat u dominuan nga dinastitë: Kalifati i Umajadëve (661-750), i Abasidëve (750-1258), Sulltanatet e Fatimidëve dhe kalifët në Afrikën e Veriut (930-1171), sulltanët selxhukë në Konia dhe Bagdad (1055-1307) dhe, në fund, Dinastia e Osmanëve (1288-1922). Këto pushtete, herë më shumë e herë më pak fetare, bashkuan pushtetin fetar dhe pushtetin perandorak në një

institucion të vetëm, duke përfshirë tërë umetit islamik. Në vitin 1924 u rrëzua nga Ataturku kalifi i fundit islam dhe e zhbë Kalifati.”⁴¹⁷

Studiuesja marokene Fatima Mernisi ka ofruar disa vlerësime për rolin dhe meritat e Muhamedit, për konsolidimin dhe faktorizimin e popullit arab. Citoj:

Është momenti ta përcaktoj se çfarë kuptoj unë kur shprehem “ne myslimanët”. “Ne” nuk bazohet në islam si zgjedhje individuale, si vendim personal. Unë definoj faktin se, të jesh mysliman është e barabartë me përkatësinë shtetërore në një shtet teokratik. Çfarë mendon individi, kjo luan rol dytësor. (...) Të jesh mysliman është status i së drejtës civile, është letërnjoftim, një pasaportë, një e drejtë familjare; këto janë të drejtat bazë...⁴¹⁸

Sipas Fatima Mernisit, “ne myslimanët” do të thotë hiç më pak se një popull, një fe, një kalifat arab. Kjo është e vetëkuptueshme për muhamedanët fundamentalistë. Edhe besimtarët myslimanë fundamentalistë shqipfolës përfshihen në përcaktimin: *ne myslimanët*. Vetëkuptimi rezulton nga përcaktimi i Muhamedit, që të sajohet një Allah muhamedan islam, i cili e paskësh zgjedhur Muhamedin për “profet”, “të dërguar” (sundimtar i autorizuar nga Allahu) dhe gjuhën arabe, si “gjuhë perëndie”, rrjedhimisht si gjuhë “hyjnore” e islamit.

Duhet falënderuar autorja për këtë sinqeritet. Jo vetëm kjo, por të gjithë nacionalistët panarabistë e praktikojnë përcaktimin “ne myslimanët”, me të cilin vetëkuptojnë “ne arabët”. Këtë përcaktim ata ua kanë imponuar dhe po ua imponojnë popujve të tjerë. Kështu janë asimiluar / arabizuar shumë popuj në hapësirën “arabe”, por po vazhdon

⁴¹⁷ <http://www.orientdienst.de/muslime/minikurs/nationalismus/>.

⁴¹⁸ Prof. dr. Fatima Mernissi, “Derpolitische Harem: Mohammad und die Frauen” (“Haremi politik: Muhamedi dhe gratë”), botim në gjermanisht, Herder-Verlag 1998, f. 29. <http://www.amazon.de/Der-politische-Harem-Mohammed-Frauen/dp/3451052806>

ekspansioni për të arabizuar edhe popuj të tjerë. Ta zëmë, populli i besimit mysliman në Bosnjë nuk do të dijë çfarë etnie kombëtare kishte dhe ka. Udhëheqja komuniste e Jugosllavisë i kanalizoi boshnjakët myslimanë që të formonin popull/kombin "islam" përmes reformave kushtetuese të vitit 1974 dhe që atëherë, ata e përcaktojnë veten si popull/komb mysliman. Tani vonë, intelektualët iluministë kanë zënë të deklarohen si boshnjakë.

Kjo praktikë, si shumë të tjera, duhet të jetë plagjiaturë nga lëvizja nacionaliste izraelite, e cila të gjithë besimtarët e Torës i përcakton si popull kompakt, unik në kuptimin e përkatësisë etnike. Pra, është shpërdoruar besimi religjioz për qëllime nacionaliste. Tashmë kemi njerëz që u përkasin racave të ndryshme dhe deklarohen izraelitë, vetëm sepse rastësisht i përkasin besimit hebre. Ky shembull dëshmon se popujt/kombet nuk krijohen vetëm se kanë prejardhje të njëjtë etnike, gjuhësore, kulturore, por edhe për shkak të përkatësisë së njëjtë fetare, të cilën e dëshirojnë dhe e përvetësojnë si kriter të mjaftueshëm për t'u ndier e për të funksionuar si popull kompakt, homogjen. Kjo ka bërë që semitët dhe zezakët afrikanë, bashkë me gjermanët, rusët, francezët, anglezët etj., të parët e të cilëve janë konvertuar në besimin hebre, tani të ndihen popull/komb kompakt izraelit/hebre...

Pothuajse të njëjtat përcaktime e praktika i kanë dëshiruar, sajuar dhe zbatuar edhe Muhamedi e muhamedanët pasues: ata kanë sajuar popullin islam/arab, me synim që të gjithë njerëzit, që i përkasin besimit islam ose që i kishin paraardhësit islamë (si rasti im), "të shkrihen" në një popull të vetëm islam/arab. Dhe jo vetëm kaq. Përcaktimi i tyre ishte dhe është islamizimi i të gjithë njerëzimin, paqësisht ose me dhunë, që globi i tokës të jetë i tëri i përfshirë në një kalifat islam/arab...

Meqë këto dy doktrina, përcaktime, synime janë sajuar për sundim, ekspansion e hegjemoni, ato patjetër konfrontoheshin mes tyre, meqë

kanë lindur në të njëjtën hapësirë dhe nga i njëjti popull (semit). Historia, fatkeqësisht, është plot e përplot me konfrontime mes këtyre dy përcaktimeve qysh nga koha e islamit zanafillor...

Autorja Fatima Mernisi, e mbizotëruar nga mendësia panarabe, është më konkrete në vlerësimin e saj për meritat e Muhamedit si arab:

Islami ideal (...), që bazohet në rrugën e pabesueshme jetësore të një të riu të Mekës, i cili në moshën 40-vjeçare njohu thirrjen e tij si profet dhe para vdekjes së tij, gjatë 22 viteve të shfaqjeve, i përfshirë pa ndërprerë në marshimet luftarake ushtarake, realizoi ëndrrat, të cilat për bashkëkohësit ishin të parealizueshme: bashkimin e arabëve përmes fesë (...) dhe shfaqjen e tyre në historinë botërore si forcë botërore.⁴¹⁹

Skandalozë! Kjo studiuese muhamedanizmin vulgar (salafizmin) e çmon "islam ideal". Këtë mendësi nuk e ka vetëm ajo, por e kanë pothuajse të gjithë besimtarët myslimanë, edhe ata që janë kualifikuar për të qenë studiues të avancuar. Dhe, me krenari, kjo studiuese myslimane i bën vlerësim pompoz Muhamedit si luftëtar i përkushtuar: "Gjatë 22 viteve të shfaqjeve, i përfshirë pa ndërprerë në marshimet luftarake ushtarake". Që të dy së bashku, "islami ideal" dhe Muhamedi "i përfshirë pa ndërprerë në marshimet luftarake ushtarake", kanë realizuar "bashkimin e arabëve dhe shfaqjen e tyre në historinë botërore si forcë botërore".

Për këtë singëritet kjo studiuese duhet falënderuar, përndryshe ndonjë tjetër do t'i kishte kamufluar e modifikuar paksa të tilla vlerësime, të cilat, në të vërtetë, e diskreditojnë Muhamedin si profet e "të dërguar të Allahut", duke e paraqitur si njëri tokësor - personalitet heroik e historik arab!

Në vazhdë të krenarisë së saj panarabe, ndonjëherë me krenari fodulle studiuesja Mernisi shkruan:

Në vitin 628, në moshën 60-vjeçare, Muhamedi u shkruan letër perandorëve të Bizantit (Herakliusit) dhe të Persisë, të cilëve u kërkonte të konvertoheshin në islam. Perandori i Persisë u egërsua aq shumë me këtë

⁴¹⁹ Po aty, f. 36.

letër, prandaj i shkroi guvernatorit të tij në Jemen: "Ky arab, që na doli nga hiçgjë, na ka dërguar një letër denigruese. Dërgoju dy burra të zgjuar, që të ma sjellin të prangosur, pastaj do të mendoj çfarë duhet të bëj me të. Nëse ai kundërshton urdhrin tim, atëherë dërgo një ushtri të më sjellin kokën e tij". Gjashtëmbëdhjetë vite më vonë Persia u pushtua nga arabët myslimanë dhe u islamizua përgjithnjë.⁴²⁰

Është formulim tepër konkret dhe nuk ka nevojë për komentime se sa meritë kishte Muhamedi për pushtimin e Persisë dhe për islamizimin e saj.

Ndoshta është vendi dhe rendi për një digresion: Persia vërtet është islamizuar, por nga islami shiit, i cili Aliun e ka flamurtar të tij, dhe prandaj prej 1400 vjetësh atje luftohet për dominim sektar. Qysh nga *Beteja e Devesë*, më 9 ose 25 dhjetor 656, në Basra, në mes të ushtrisë së kalifit të 4-rt Ali dhe kryengritësve rebelë, të udhëhequr nga e veja e Muhamedit, Aishja fatkeqe, kanë zënë fill armiqësitë mes sekteve kryesore që u përvijuan pas asaj beteje!

Të shohim se si duket vlerësimi, paksa i kamufluar, nga kjo panarabe:

Religjioni i ri do ta dridhte Mekën politeiste me mbi 300 zotucë. (...) Mekasit e vlerësonin paraqitjen e një zoti të vetëm si absurde, që tashmë po e bënte hapur Muhamedi, pas tri vitesh të predikimit të tij në fshehtësi. Atij i duhej të luftonte, që shërbimin ndaj Allahut ta bënte në një vend, të cilin ai e çmonte të shenjtë: Kabaja e shenjtë, e njohur cep më cep të Arabisë, ku një herë në vit bëhej haxh për të nderuar 300 zotucët e tyre, aty e tutje do të fillohej t'i ndërrohej karakteri, për t'u përvetësuar nga islami.⁴²¹

Tashmë autorja informon me krenari për konfrontimet e muhamedanizmit fitimtar (që "dridhi Mekën") ndaj paganizmit, duke

⁴²⁰ Po aty, f. 35-36.

⁴²¹ Po aty, f. 39.

i cilësuar zotat paganë si “zotucë”. Ajo këtu “islamizmin ideal” të saj e quan vetëm religjion të ri, meqë doktrina muhamedane ende nuk ishte kompletuar. Por Mernisi arsyeton insistimin e Muhamedit për të përvetësuar Qabenë, e cila deri atëherë ishte objekt kulti për arabët paganë. Mbase autorja nuk e ka kuptuar motivin kryesor të Muhamedit për të përvetësuar Qabenë: ishte interesi për përfitime financiare, sepse aty vinin pelegrinë paganë nga të gjitha anët “arabe” (atëherë hapësirat që u pushtuan dhe u arabizuan më vonë nuk ishin arabe). Muhamedi tashmë duhet ta ketë ditur, nga përjetimet e tij bashkëshortore me gruan e pasur, se çfarë pushteti ushtron pasuria, sepse duhet ta ketë vuajtur atë pushtet të ushtruar ndaj tij nga padronia (dhe gruaja) Hatixhe.

Më duket se tani është vendi dhe rendi të bëj edhe një pyetje: *pse pikërisht ato praktika pagane të pelegrinëve, në një objekt të kultit pagan, Muhamedi i integroi në doktrinën e tij (islame)?!* Nga kjo autore myslimane dhe nga besimtarë të ngjashëm nuk mund të pritet përgjigje sqaruese e shteruese. Më së shumti, ata do të arsyetonin me të drejtën e bazuar në falsifikimet e Muhamedit, sikur gjoja Abrahami (i arabizuar në Ibrahim), bashkë me djalin e tij, Ismailin, ishin myslimanë dhe ata e kishin ngritur Qabenë. Madje, në falsifikimet e tij historike, që i duheshin për të zgjeruar pushtetin, Muhamedi e deklaronte origjinën e arabëve nga Ismaili (djali i Abrahamit) dhe veten e tij, jo më pak se pasardhës familjar i Ismailit.

Sihariqi tjetër i kësaj studiueseje panarabe:

*Pas befasisë nga ajeti i parë, Muhamedi u ambientua me ritmin e paparashikuar dhe misterioz të zbritjeve. Njëzet e dy vite ai priste këto shfaqje privilegjuese... Po ndodhte mrekullia, **Zoti po i fliste Muhamedit në gjuhën e tij amtare: arabisht.** Vetëm jehudinjtë dhe kristianët e kishin pasur përpara të tillë nder e privilegj. Muhamedi pranoi zbulësën e fundit nëntë ditë para vdekjes.⁴²²*

⁴²² Po aty, f. 40.

Nuk është aspak serioze që një studiuese, me CV akademike, të pranojë për të vërtetë thënien, se Muhamedit i paskëshin ndodhur *zbritjet, zbulosat*. Gjithashtu, nuk është serioze të thuhet: *Po ndodhte mrekullia: “Zoti po i fliste Muhamedit në gjuhën e tij amtare: arabisht.* (nënvizimi im). Pra, vetëm pse zoti po i fliste Muhamedit në gjuhë amtare, arabe, ishte mrekullia! Kjo është e drejtë e saj, por e drejta ime është ta diskreditoj si besimtare myslimane, nacionaliste panarabe dhe studiuese e indoktrinuara nga mashtrimet dhe veprimtaria e Muhamedit.

Kurse sa u përket kristianëve, autorja duket sikur nuk është e informuar. Nëse është kështu, është për të ardhur keq për studimet e saj superiore në Francë e Amerikë, sepse informimet për fe të tjera do ta kompletinin më shumë edhe për studime të tematikave islamike.

Bibla zanafillore është shkruar në greqisht dhe jo në gjuhë çifute dhe as në gjuhë “kristiane”, që do të thotë se zoti i kësaj studiueseje, gjithsesi, nuk ka mundur të flasë në gjuhën “kristiane”, meqë ajo gjuhë nuk ekzistonte. Themeluesi i kristianizmit, Sauli / Pauli (Saulus/Paulus), letrat e tij i shkroi në greqisht. Greqishtja nuk ishte gjuhë amtare e asnjë populli, ishte gjuhë e sajuar nga priftërinjtë e misionarët pellazgë, që predikonin fetë e tyre në gjuhë që nuk duhej ta kuptonte popullata: “greqishtja e vjetër” [Në fakt, nuk ekzistojnë greqishte e vjetër dhe e re, por “pellazgjishtja” (“greqishtja”) dhe helenishtja!]. Dilema është e vetëkuptueshme: zoti nuk i ka privilegjuar këto tri gjuhë (hebraisht, greqisht e arabisht), por “profetët” e misionarët përkatës. Këta sajuan fetë e tyre, prandaj i impononin gjuhët e tyre, - si në rastin izraelit hebraishten dhe në rastin arab arabishten, - si gjuhë të privileguara nga zoti. Gjithsesi, fetë janë shfrytëzuar e keqpërdorur për ekspansion të gjuhëve përkatëse, si “gjuhë të privileguara nga zoti”, duke iu bashkuar këtyre gjuhëve edhe gjuha latinishte, si gjuhë liturgjike kristiane.

Të shohim se çfarë shkruan studiuesja Mernisi për fillesat e luftimeve mes besimtarëve islamë në islamin zanafillor:

Për të sqaruar se me çfarë intensiteti është zhvilluar lufta për pushtet mes myslimanëve të parë, është e nevojshme të përshkruhen rrethanat e varrimit të Profetit, i cili ishte përfaqësues i Zotit dhe prandaj edhe ishte i padyshuar. Profeti vdiq ditën e hënë. Kufoma e tij u harrua në dhomën e Aishes dhe u varros në natën e së mërkurës. “Trupi i Profetit, i mbuluar me një mantel, pushonte në shtëpinë e tij. Meqë të gjithë merreshin me zgjedhjen e pasuesit të tij, askujt nuk i binte ndër mend ta lante dhe ta varroste”.⁴²³ Lufta për pushtet politik në islam, që tashmë kishte filluar, nuk pushoi asnjëherë.⁴²⁴

Shihet se zonja Mernisi ka bërë këtë konstatim subjektiv, meqë ajo do të parapëlqente një botë tërësisht të arabizuar. Megjithatë, me këto sqarime ajo të bind se besimtarët e parë, ashtu si edhe Muhamedi, motiv kryesor kishin pushtetin dhe pasurimin, gratë dhe seksin, përmes plaçkitjeve në luftëra pushtuese dhe jo ndonjë mision hyjnor ose ndonjë parim për liri, drejtësi e mirëqenie. Doktrina që sajoi Muhamedi dhe bashkëhartuesit e *Kuranit*, që motivim i fortë për muhamedanët, që të shndërrohen në pushtues tepër agresivë (si edhe pushtuesit e tjerë të kohës), duke e zgjeruar sundimin dhe ndikimin e tyre nga India deri në Kinë, Persi, Karpate e Spanjë.

Dy vjet pas vdekjes së Profetit vdes kalifi i parë Ebu Bekr. Atë e pason kalifi Umar ibn al-Khattabs. (...) Ebu Bekr ishte i vetmi kalif besnik, që vdiq natyrshëm.⁴²⁵

⁴²³ Autorja Mernisi citon historianin e afirmuar të islamit Abu Ja'far Muhammad ibn Jariral-Tabari (arabisht: أبو جعفر محمد بن جرير بن يزيد الطبري) Ka jetuar në vitet 839-923.

⁴²⁴ Fatima Mernisi, vep. cit., f. 51.

⁴²⁵ Po aty, f. 55.

Kjo dëshmi diskrediton islamin si fe të dhunshme, aspak paqësore e hyjnore (siç nuk ishin as edhe fetë pararendëse abrahimike).

Sundimi i Kalifit Umar zgjati dhjetë vjet. Nën sundimin e tij myslimanët pushtuan Egjiptin dhe Iranin. Ai krijoi edhe mekanizmat për financim të ushtrisë. Ai u ther nga një besimtar mysliman në xhami, kur po falte namazin. (...) Kalifi Umar ua pat ndaluar jetesën joarabëve në Medinë.

426

Ky ekspansion i rrufeshëm pushtues i myslimanëve zanafillorë dëshmon se sa e dhunshme ishte (dhe është) dogma islame, gjegjësisht sa të dhunshëm ishin sajuesit e kësaj platforme, Muhamedi dhe ithtarët e bashkëluftëtarët e tij të parë. Qysh në betejat që komandonte Muhamedi ishin ndërmarrë pastrime “etnike” fetare (në fakt, arabët e besimit hebre ishin dëbuar, por tashmë për të gjithë besimtarët hebre flitej si për një popull-komb), ndërsa kalifi Umar e realizoi plotësisht pastrimin fetar të Medinës dhe rrethinave të saj.

Kalifi Umar, - shkruan Mernisi, - i shtrirë në krevatin e vdekjes, mori vendim, i cili më vonë u quajt "shura" (koncil). Ai caktoi një grup prej gjashtë personalitetesh dhe i urdhëroi që të zgjedhin për kalif njërin prej tyre. Pas vdekjes së Umarit, bisedimet e këtij grupi zgjatën tri ditë. U zgjodh Ut'hman ibn Afan (viti 644) për kalif të 3-të. Edhe ky ishte mekana i fisit të Kurejshëve (si edhe pararendësit), por i përkiste klanit që kishte rivalizuar Profetin. Ky ishte dhëndër i Profetit, i martuar me vajzën e tij, Rykaja, prandaj ishte edhe besnik i tij.(...) Kalifati i tij përfundoi në mënyrë tragjike. Njëmbëdhjetë vjet pas zgjedhjes së tij si kalif, ndodh rebelimi i një grupi kryengritësish (viti 655), të bindur se ai nuk po e udhëhiqte vendin me drejtësi. Ai u vra nga ata kryengritës. Ata e sulmuan shtëpinë e tij kur ai ishte duke lexuar ajete kuranore. Ky ishte fillimi i parë luftimeve për pushtet, të cilat eskaluan edhe pas zgjedhjes së Aliut për kalif të 4-rt.

⁴²⁶ Po aty.

⁴²⁷ Po aty, f. 55-56.

Rrjedhë aspak paqësore, assesi vizionare e hyjnore. Kjo ishte pjesë e dinamikës së agresionit beduino-muhamedan, për të pushtuar territore, për të plaçkitur, për të vrarë burrat që nuk pranonin të konvertoheshin në myslimanë, për të përdhunuar gratë e zëna robinja, për të përhapur islamit me dhunë...

Edhe me ardhjen e kalifit Ali vazhdon zbatimi i doktrinës muhamedane. Studiuesja Mernisi shkruan:

*Aliu u zgjodh për kalif në vitin 656 (ose 35 sipas kalendarit islamik). Më njëherë shumë myslimanë u ngritën në betejë kundër tij. Udhëheqëse e tyre ishte Aishja (e veja e Muhamedit), meqë ajo ishte kundër zgjedhjes së Aliut si kalif. Një vit më vonë Aliu iu kundërvu asaj me ushtri në Basra, në betejën e njohur si Beteja e Deveve. Aty, kryengritësit e udhëhequr nga Aishja, u mundën. Pas kësaj beteje është sajuar hadithja, sipas së cilës të gjithë ata që udhëhiqen nga gratë i pret humbja. (...) Pas kësaj beteje ndodhi beteja e tmerrshme mes ushtrisë së Muavijës, guvernatorit të Sirisë, që përbëhej nga 85 mijë pjesëtarë, dhe ushtrisë së kalifit Ali, me 90 mijë pjesëtarë. Beteja u zhvillua në Sifin, ku u shkaktuan 70 mijë viktima. Nuk fitoi asnjëra ushtri. Për të vendosur përfundimin u caktua një ekip pleqërues, i cili në shkurt të vitit 658 vendosi që Muavijën ta caktojë për kalif. Por as ky vendim nuk e paqësoi gjendjen. Aty e tutje myslimanët u fraksionuan definitivisht në sunitë dhe shiitë. (...) Në vitin 40 të Haxhrit u formua një grup rebelësh, të quajtur **karixhit**. (...) më 17 ose më 21 të muajit ramadan (28 janar 661) ata vranë Aliun në mëngjesin e hershëm, kur po udhëhiqte namazin e mëngjesit. Aty e tutje filloi dinastia familjare edhe në islam, meqë kalifi Muavija caktoi djalin e tij, Jasid, për kalif pasues...”⁴²⁸*

Histori tragjike që nuk i shkon zanafillës së një religjioni paqësor!
Të gjithë këta që udhëhiqnin dhe që vritnin, që bënin beteja e luftëra

⁴²⁸ Po aty, f. 57-58

për pushtet, ishin ihtarët dhe pasuesit e parë të Muhamedit, gjegjësisht bashkëlufëtaret e tij për përhapje të përdhunshme të islamit.

Meqë më duket histori interesante, në vijim po sjell fragmente paksa të zgjeruara:

Islami i kishte sjellë atij (Ebu Bekrit) fatin e dëshiruar. Para se të konvertohej, Ebu Bekri bënte një jetë të rëndë prej skllavi në qytetin Taif, ku vetëm aristokratët kishin të drejta e nderoheshin. Në vitin 630 Profeti kishte gjykuar se ishte koha për ta pushtuar Taifën. Ai tashmë e kishte pushtuar Mekën dhe atje kishte shënjuar një hyrje triumfale dhe prandaj ndihej mjaftueshëm i fortë për t'i nënshtruar banorët e Taifës, të cilën po vazhdonin t'i rezistonin islamit. Por ata po mbroheshin trimërisht. Profeti rrethoi kështjellën dhe e mbajti 18 ditë të rrethuar. Kot. (...) Vendosi të tërhiqej. Paraprakisht dërgoi korrierë të përhapin thirrjen e Profetit; skllëverit që do të dalin nga kalaja dhe do t'i bashkohen Profetit, duke pranuar islamin, do të jenë njerëz të lirë. Një mori skllëverish iu përgjigjën thirrjes së Profetit, ndër ata edhe Ebu Bekri. Profeti i shpalli ata të lirë, përkundër protestave të pronarëve të tyre. Pas konvertimit në islam ata u bënë vëllezër. Kështu e njohu Ebu Bekri islamin dhe lirinë.⁴²⁹

Informativ dhe domethënës duket citimi i dijetarit islam, Fath ul-Bari Sahihal-Bukhari (arabisht: فتح الباري), i cili ka jetuar në vitet 1372-1449:

Ju, arabët, ishit në një gjendje të papërshkruar të shkatërrimit, të pazotësisë dhe të zhbërjes. Islami i Allahut dhe i Muhamedit ju ka shpëtuar dhe ju ka përparuar në gjendjen ku jeni tani.⁴³⁰

Kjo përzgjedhje të krijon mendimin se autorja mbisundohet nga krenaria, që dikur Arabia islamike ishte perandori botërore, por tani është komprometuar. Vetë autorja, kur shprehet "ne myslimanët", ka shpjeguar se për të mysliman do të thotë status civil i të qenit arab dhe

⁴²⁹ Po aty, f. 69-70

⁴³⁰ Po aty, f. 71.

qytetar i shtetit islamik (arabik). Edhe kjo autore duket të jetë e ndikuar nga madhështia e dikurshme e perandorisë arabe (siç janë nacionalistët turq, helenë, serbë, bullgarë etj.).

Autorja sërish i rikthehet Aishes, të cilën e madhëron për heroinë:

*Aishja jo vetëm që zbatoi besnikërisht metodat e Muhamedit, por ajo kishte edhe një arsye më të fortë: për herë të parë që kur kishte vdekur Profeti, myslimanët u pozicionuan armiqësisht mes tyre. U krijua një gjendje, të cilën profeti e pat parashikuar si më të keqen për islam: **lufta qytetare** (fitna), ku armët e myslimanëve drejtoheshin kundër njëri-tjetrit, në vend që, siç e dëshironte Allahu, t'i drejtonin kundër të tjerëve, që të pushtonin e të sundonin botën. (...)*

*Për disa ihtarë të Profetit gjendja e popullit islam (në origjinal është **Nation**) përballej me rrezikun jo pse sundohej nga një kalif i padrejtë, por me luftën qytetare. Të mos harrojmë, fjala "**islam**" do të thotë "**nënshtrim**". Prandaj, nëse kundërshtohet kalifi, atëherë parimi bazë i islamit ishte i rrezikuar. Të tjerët mendonin se padrejtësia e kalifit është më e keqe sesa lufta qytetare.⁴³¹*

Gjithsesi, një libër i tërë, edhe pse ka për tematikë kryesore pozicionin dhe padrejtësitë ndaj gruas në islam zanafillor (në Kuran e hadithe), patjetër që do të përmbajë, herë pas here, edhe mendësinë e thekur të vetë autores arabe e muhamedane, e cila vajton se myslimanët po përçaheshin, në vend që të zbatonin *dëshirën e Allahut për të pushtuar e sunduar botën*. Meqë këtë synim kryesor e kishte Muhamedi, pikërisht për këtë arsye kjo autore e madhëron atë deri në hyznizimin e tij.

Interesant është edhe shpjegimi i fjalës *islam* (nënshtrim) nga autorja. Pra, ashtu si edhe në fetë e tjera abrahamike (monoteiste), edhe në dogmën e Muhamedit besimtarët myslimanë duhej t'i nënshtroheshin kalifit (sundimtarit, përfaqësues të zotit në tokë) dhe

⁴³¹

Po aty, f. 74-76

kushdo që e kundërshtonte kalifin, sipas kësaj doktrine (kuranore), kundërshtonte vetë zotin. “Profetin” Muhamed nuk e kishte zgjedhur njeri për të qenë udhëheqës, por atë, sipas kësaj doktrine, e kishte përzgjedhur dhe emëruar vetë Allahu. Ustai i vërtetë, Muhamedi, sajoi një dogmë, - edhe pse në përmasa të mëdha plagjiat i dogmave pararendëse, - ku dominonte përzgjedhja e tij, si i dërguar nga Allahu arab.

Në ato kohë shumë individë i përfshinte deliri i madhësisë, me dhunti të veçanta. Prandaj ata e shpallnin veten profetë, të përzgjedhur nga zoti. (Edhe tani kemi raste të ngjashme, por sot ata mund të krijojnë vetëm ca sekte të vockla mjerane...). Vetëm ata “profetë” që bëheshin të zotë për të ushtruar dhunë, për ta imponuar veten e tyre dhe doktrinën që sajnin, u imponuan për “profet”.

Shembull pararendës kemi edhe Lekën e Madh. Atë e bindi nëna e tij, Olimpia iliro-epiriote, se ishte Bir i Zotit Amon. Olimpia ishte kategorike se me atë “zot” e kishte ngjizur djalin e saj (jo me Filipin II, me të cilin pikërisht për këtë marrëzi u konfliktua dhe e organizoi vrasjen e burrit të saj, Filipit II, për ta bërë djalin e saj 18-vjeçar perandor dhe profet). Dhe ky Lekë (Aleksandër) i Madh, i indoktrinuar, ndërmoi marshime të gjata, gjigantomane, pushtuese dhe çliruese (varësisht nga këndvështrimi). Dy ishin motivet kryesore të tij: të mundte persët në vendin e tyre, që të liheshin të qetë popujt në Europën Juglindore (Pellazgji / Iliri), dhe të përhapte qytetërimin “grek” dhe fenë e Zotit Amon...

Ky Lekë ishte mitizuar si çlirimtar më së shumti nga egjiptianët dhe popujt arabë. Madje, aq shumë ishte i mitizuar e legjendarizuar, sa që edhe në *Kuran* madhërohet si i dërguar i Allahut (edhe pse, si për inat, disa myslimanë shqipfolës me kryeneçësi naive e kundërshtojnë). Shihni për këtë suren 18, ajetet 83-111. Vetë ky fragment kuranor, si edhe shumë rrëfime të tjera, dëshmojnë se cilin nivel injorant duhet ta kenë pasur ata që e kanë formuluar *Kuranin*...

Në qytetërimin antik "grek" kishte demokraci goxha të zhvilluar, ku qytetarët vetëqeveriseshin përmes zgjedhjeve të udhëheqësve, ndërsa fetë abrahimike sundimin ia deleguan "zotit", i cili përzgjidhte përfaqësuesit (profetët) e vet, gjegjësisht sundimtarët (perandorët, mbretërit, kalifët). Kjo e fundit ishte synimi kryesor i "profetëve". U vetëshpallën mijëra "profetë", por, çuditërisht, vetëm dhjetëra prej tyre ia dolën të imponohen si profetë, dhe këta profetë janë pjesëtarë vetëm të popujve semitë (izraelitë e arabë).

Autorja sërish i rikthehet rrëfimit historik:

Qabeja nuk ka qenë gjithnjë orientim i shenjtë për myslimanët. Disa muaj besimtarët, me kërkesë të Profetit, janë orientuar drejt një vendi të shenjtë, Jerusalemit, të cilin e çmonin të huaj. Në kohën e fëmijërisë së Muhamedit, Qabeja ishte qendër e kulteve pagane. Por, sapo Profetit iu paraqit Xhibrili dhe i dhuroi zbulesën e parë, bashkë me gruan e tij, Hatixhenë, shkuan në Qabe, që të deklamojë për herë të parë në lutje të çuditshme. Meqë Meka shfaqti armiqësi kundër lutjes së tij, duke këmbëngulur në kultet tradicionale, Muhamedi u mendua të gjente vend tjetër të shenjtë për orientim. Pasi arabët vazhdonin t'u luteshin zotave të tyre paganë, ai u orientua drejt Jerusalemit. Kur erdhi Muhamedi në Medinë, gjashtëmbëdhjetë muaj u drejtua nga Jerusalemi gjatë namazit. Pastaj, një ditë, njëri nga ata të grupit të ansarëve, që luteshin bashkë me Profetin, tha: "Dëshmoj se kam parë Muhamedin t'i drejtohet Qabesë gjatë namazit, prandaj ndryshojeni drejtimin".⁴³²

Mbase rezulton se gjithçka kishte rrjedhë tokësore, sipas rrethana-ve. Asgjë hyjnore dhe profetike. Meqë banorët arabë të Mekës ia bënë të pamundur Muhamedit të bënte lutjet e tij në Qabe, ai vendosi t'i drejtohet Jerusalemit, si vend i shenjtë, për të cilin autorja thotë se e çmonin për të huaj. Për këtë ajo bazohet tek imam Nisai. Nëse kjo do të ishte e vërtetë, se Jerusalemi ishte i huaj, atëherë a janë legjitime

⁴³² Autorja citon imam Nisain, "as-Sunan", vëll. I, f. 242; Fatima Mernisi, vep. cit. f. 90.

pretendimet muhamedane (arabe) për Jerusalemin?! Por, pretendimet arsyetohen me prejardhjen e arabëve nga “babai” Abraham dhe djalit të tij, Ismaili (edhe hebrenjtë e çmojnë për “baba” të popullit të tyre të njëjtin Abraham, me gjasë vetë personazh legjendar).

Autorja shtron pyetjet:

Pse këto ndryshime? (...) Në cilin drejtim duhej të orientohej Muhamedi, i cili po formonte diçka të re, diçka specifike arabe? Qabeja ishte drejtimi i arabëve paganë. Në vitin 622 ata e përzunë Profetin nga Meka. Të orientohej nga Jerusalemi? Kjo do të thoshte që t'u nënshtrohej hebrenjve dhe kristianëve. Armiqësia e mekasve, arabë paganë, ishte aq e madhe, sa që Profeti i çmonte jehudinjtë dhe kristianët, njerëzit e Librit (Ahl l-kitab) më të afërt, partnerë ideologjikë. Përderisa krishterimi, i koncentruar në personin legjendar Nagahi i Etiopisë, strehoi myslimanin e parë të përndjekur nga Meka, hebrenjtë e pasur në Medinë iu vardisën Profetit për ta përzënë...⁴³³

Ja edhe një informim e interpretim historik për lindjen e islamit si proces tokësor, konkret, pra, johyjnor dhe joprofetik. Muhamedi parapëlqen krishterimin, sepse një i krishterë i ofron strehim një besimtar i mysliman, kurse me hebrenjtë ishte më i armiqësuar, sepse ata e përzi-nin. Madje autorja bën edhe arsyetimin vijues:

Se pse Muhamedit jehudinjtë i duken më të rrezikshëm sesa kristianët, kishte të bënte pjesërisht me afërsinë gjeografike dhe konfliktin e interesit, i cili rezultonte si vijon: Në Medinë komuniteti judenj dhe dy fiset politeiste arabe, Aus dhe Kasradsh, ndanin pushtetin mes tyre. Këto dy fise arabe i ofruan Profetit strehim.⁴³⁴

Shihni, pra, përballjet e përvojat konkrete të Muhamedit ndaj jude-njve (arabë) në Medinë do të bëhen më vonë busull urrejtëse e

⁴³³ Po aty, f. 90-91.

⁴³⁴ Po aty, f. 92.

muslimanëve kundër tyre. Çifutët kishin të drejtë të mbronin besimin e tyre nga kërcënimi muhamedan, i cili përveçse u rrezikonte identitetin fetar, njëherazi u rrezikonte edhe ekzistencën materiale dhe fizike! Nëse përdorim mendësinë e sotme, duhet pranuar se çifutët kishin të drejtë të vetëmbroheshin; sa herë që tani muslimanët qortohen për cenim të lirisë së bashkëqytetarëve jomuslimanë, ata reagojnë emocionalisht dhe vulgarisht: “E kemi të garantuar lirinë fetare”, thonë ata. Zhurmimi me megafona në minare nuk ka të bëjë fare me islamin zanafillor, por me (sh)përdorim të teknologjisë së prodhuar nga “kaurët” (kufarët). Ndërsa për kërcënimin e atëhershëm muhamedan ndaj besimeve përkatëse të arabëve (paganë, çifutë e kristianë), muslimanët e sotëm nuk gjejnë mbi bazën e “të drejtës për liri fetare”, që duhet të kishin ata...

Autorja vazhdon:

Meqë pushteti i komunitetit hebre bazohej, pos të tjerash, në kontrollin e dijes së deriatëhershme hebrejo-kristiane, për Muhamedin, i cili përfaqësonte interesat e një ideologjie nacionaliste arabe, kishte vetëm dy mundësi për përforcimin e pozicionit të tij: ose me përkrahje të komunitetit hebre ose luftë kundër tij. (...) Profeti vendosi për “nacionalizmin” dhe “arabizimin” e trashëgimisë judo-kristiane.(...) Hebrejtë e “vuajtën” Muhamedin si mashtrues ordiner, i cili u vodhi atyre profetët dhe i arabizmi ata për nevoja të veta.⁴³⁵

Sigurisht, këto konstatime mundësojnë vlerësimin e autores, si studiuese objektive do të thosha, pavarësisht se ajo është një tifoze pasionante e Muhamedit dhe e arabizmit muhamedan, i paketuar si islami-zëm. Pra, tashmë, vetë autorja e pranon se Muhamedi ka arabizuar “profetët” pararendës, që të përvetësonte “të drejtën historike” për interesa të nacionalizmit arab.

Konstatimi tjetër i autores:

⁴³⁵ Po aty, f. 92-93

Megjithatë, nuk duhet harruar se Profeti mundi të përmbushë misionin e tij, meqë bota arabe ishte e pjekur për një transformim ideologjik: Arabia po përjetonte një krizë të thellë ideologjike, që solli një krizë të madhe ekonomike dhe shoqërore. Si e tillë, ajo po rrezikohet të judizohej ose kristianizohej.(...) Për këtë arsye, në Kuran shpesh theksohet fakti se libri i zbulesave është në gjuhën arabe...⁴³⁶

Autorja, siç rezulton, e çmon Muhamedin si një shpëtimtar të popullit arab, si konsolidues e faktorizues të tij, duke shfrytëzuar favorin që i mundësoi zoti, që zgjodhi Muhamedin për profet dhe “zbriti” *Kuranin* në gjuhën arabe. Kjo doktrinë e taktikë e Muhamedit për ekspansion arab, u praktikua e po praktikohet edhe tani. Por tani, ekspansioni i dëshiruar dhe i synuar rezulton i pamundur, meqë mes besimtarëve myslimanë dominojnë luftërat sektare, me zanafillë qysh në islamin zanafillor: *Beteja e Devesë* në Basra...

Ne dimë shumë mirë se ata thonë: “Ai (Muhamedin) është kah e mëson një njeri!” Mirëpo, gjuha e tij, nga i cili anojnë ata, është joarabe (e paqartë), e kjo (e Kuranit) është gjuhë arabe e stilit të lartë dhe e qartë. [16:103]

Nga formulimi rezulton se qytetarët e Mekës paskëshin përfolur, se Muhamedin “e mëson një njeri” dhe ai “njeri” na qenkësh joarabishtfolës. Dhe kur banorët e një qyteti përflasin, duhet të kenë pasur ndonjë shkas, por fakti që përfoljet janë përfshirë e trajtuar në *Kuran*, i cili pretendon të jetë doktrinë universale, hyjnore, vetëm se i shton dilemat. Këto përfolje kundërshtohen me një ajet enkas, me argumentimin se *Kurani* është në “gjuhën arabe, të stilit të lartë e të qartë”, prandaj nuk ka për autor “njeriun” joarabishtfolës. Nuk paskësh qenë e mundur që “njeriu” joarabishtfolës ta këshillonte Muhamedin, i cili pastaj i ka sajuar ajetet në dialektin e arabishtes së fisit të tij Kurejsh, që, si të gjitha gjuhët dhe dialektet e kohës

⁴³⁶ Po aty, f. 93.

(përrjashto krijesat artificiale greqisht dhe latinisht, që vdiqën vetëm pse ishin krijesa artificiale), nuk kishte stil të lartë dhe të qartë. Këtë e dëshmojnë edhe vështirësitë që kanë pasur përkthyesit e *Kuranit* në gjithë botën. Këtë mund ta dëshmojnë edhe arabologët, të cilët kanë vështirësi për ta kuptuar tekstin zanafillor të *Kuranit* (siç më ka informuar një shqiptar, teolog i fesë islame, që ka kryer studimet e larta në universitete arabe).

Qesharak është edhe vlerësimi selektiv, meqë gjuha e “njeriut” paskësh qenë joarabe, domosdo paskësh qenë edhe e paqartë. Kurani, sigurisht, nuk duhet të ketë qenë formulim i zotit, i cili nga fetë abrahimike madhërohet edhe deri “sipër qiellit”!

Të shohim çfarë përmban një informim burimor:

Hatixheja e mbuloi me një mantel dhe atë e zuri gjumi. Hatixheja kishte lexuar shkrimet e vjetra dhe prandaj njihnte historitë e profetëve, dinte edhe për emrin e Xhibrilit. (...)⁴³⁷

Rezulton se Hatixheja nuk ishte një amvisë injorante arabe, por grua autoritare, e pasur, menaxhere, intelektualisht e kultivuar, meqë xhaxhai, nga i cili ajo vazhdimisht merrte këshilla, e ka furnizuar me literaturë fetare (kristiane). Sikur Muhamedi të kishte mësuese vetëm Hatixhenë, do t’i mjaftonte për t’u bërë misionar. Për më tepër, Muhamedi nuk e kishte vetëm grua e mësuese Hatixhenë, por edhe padrone e komanduese.

Për xhaxhanë e Hatixhesë informon edhe Fatima Mernisi:

⁴³⁷ Tabari, Tarikh, vell. 2, f. 209; ibn Hisham, Sira, vëll. 1, f. 249; cituar sipas: Prof. Dr. Fatima Mernisi, “Derpolitische Harem: Mohammad und die Frauen” (“Harem politik: Mohamedi dhe gratë”), botim në gjermanisht, Herder-Verlag 1998, f. 136.

Hatixheja kishte një xhaxha me emrin Varaka ibn Naufal, i konvertuar në kristian. Ai u angazhua me përkushtim që ta bindte Muhamedin se nuk është i çmendur dhe as poet, por profet i një religjioni të ri.”⁴³⁸

Për këtë këshillë Hatixheja kishte pyetur xhaxhanë e saj, në prani të Muhamedit, pas ëndërrimit të sures së parë në vitin 610. Ajo ëndërr duhet ta ketë trazuar e trembur Muhamedin, por duhet të ketë qenë edhe kthesë e madhe në jetën e tij.

Është e habitshme se përse duhej t’i kushtohet një ajet një detaji të tillë, meqë ajetet do të duhej të ishin pjesë e një doktrine fetare universale, hyjnore? Pse duhej një ajet për të marrë në mbrojtje Muhamedin, “të dërguarin e Allahut”, nga një thashethem, të themi ordiner. E që mbrojtja të ishte më e suksesshme, zoti Muhamed, i cili ka gjetur kohë të merret edhe me këso cikërrimash, ka përzgjedhur argumentin: “*Gjuha e atij, nga i cili anojnë ata, është joarabe, e kjo (e Kuranit) është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë.*”

Pra, kjo mbrojtje në vetvete përmban një si paragjykim për gjuhën joarabe, duke e madhëruar gjuhën arabe.

A duhet të ketë qenë zoti kaq arabofil e shovinist ndaj gjuhës joarabe?

Dhe jo vetëm kaq! Tashmë Muhamedi po e madhëronte arabishten edhe si gjuhë perëndie, meqë zoti kishte përzgjedhur një profet që fliste këtë gjuhë, madje e kishte zgjedhur për të qenë “profeti i fundit”!

Broçkulla muhamedane!

Si ia doli Muhamedi të bëhej i suksesshëm? Kjo është një tematikë interesante për t'u shtjelluar. Në vend të përpjekjeve për vlerësime ori-

⁴³⁸ Prof. dr. Fatima Memisi, “Derpolitische Harem: Mohammad und dieFrauen” (“Haremi politik: Muhamedi dhe gratë”), botim në gjermanisht, Herder-Verlag 1998, f. 136.

gjinalë, më e lehtë dhe më praktike është të gjesh studiues më kompetent e më autorativ. Njëri nga këta është jo më pak se Ibn Khadun⁴³⁹, historian islam, oborrtar dhe politikan autoritativ i shekullit të 13-të. Kryevepra e tij monumentale shkencore titullohet *Al Mukaddima*⁴⁴⁰. Në vazhdim po sjell ca fragmente të kësaj kryevepre, të përkthyer në gjermanisht, nga orientalisti Matias Paetcold (Mathias Pätzold):

Arabët janë në gjendje për të fituar epërsi vetëm në tokë të sheshtë. Kjo, sepse arabët, për shkak të natyrës së tyre të egër dhe të pavarur, kanë dhuntinë njerëzore të grabitqarëve, që të grabisin çdo gjë që mund ta marrin pa luftë dhe pa e ekspozuar veten ndaj rrezikut për t'u tërhequr pastaj në shkretëtirë (...).

*Nga ana tjetër, tokat e rrafshëta, që ata i sulmojnë, nëse u mungojnë forcat mbrojtëse dhe pushteti përkatës shtetëror është i dobët, janë për ta një pre e lehtë, si një kafshatë që e gëlltisnin kollaj. Përsëritshëm ata ndërmarrin sulme, plaçkitje dhe kur ato u duket të lehta dhe të parrezikshme, derisa më në fund të nënshtrijnë popullsitë e tokave të sheshta. (...)*⁴⁴¹

“Vendet që janë pushtuar nga arabët i ka goditur menjëherë prapambetja dhe shkatërrimi. Arsyeja për këtë është fakti se arabët janë një popull me tipare të egra, të pavarur, te të cilët doket dhe zakonet e kësaj mënyre të jetesës janë rrënjësor thellë. Ajo është bërë për arabët mendësi dhe natyra e dytë e tyre. Ata e shohin këtë si shumë të volitshme, ngaqë në këtë mënyrë i ikin shtypjes nga sundimi dhe nuk kanë nevojë t'i nënshtrihen autoritetit politik. Ky përcaktim është e kundërta e jetës së qytetëruar. Ndërrimi i shpeshtë i vendbanimit për të bredhur gjithandej, është qëllimi i preferuar i jetës së tyre të përditshme. Kjo është e kundërta e vendbanimit të përhershëm, përmes të cilit lind qytetërimi. (...)

⁴³⁹ Ibn Khaldūn (arabisht: ابن خلدون, emri i plotë: ولي الدين عبد الرحمن ابن محمد بن محمد بن أبي بكر محمد بن الحसन بن Walfād-Dīn 'Abd ar-Raḥmān ibn Muḥammad ibn Muḥammad ibn Abī Bakr Muḥammad ibn Al-Ḥasan, i lindur më maj 1332 në Tunis; vdekur në mars 1406 in Kajro) ishte historian islamik dhe politikan.

⁴⁴⁰ Kjo vepër është ribotuar e përmbledhur në një botim që ka 1475 faqe, nga universiteti i Kajros, në vitin 1967.

⁴⁴¹ Fragment nga kapitulli 25 i veprës “Al-Mukaddima”; cituar sipas: Boualem Sansal, “Allah Narren”, vep. cit., f. 153-154.

Po kështu, është në natyrën e arabëve për t'i privuar të tjerët në pronësi të tyre. Rrojtjen e tyre ata e furnizojnë me ndihmë të shigjetave të tyre. Kur është çështja që njerëzve t'u grabitet pasuria, për ta nuk ka asnjë pengesë, para së cilës do të ndalonin. Përkundrazi, ata grabisin çfarë u sheh syri, para, mallra dhe pajisje. Në qoftë se ata kanë fituar pushtetin dhe mbretërimin, me këtë rast për të grabitur do të kenë më shumë mundësi, dhe çdo politikë që mbron pronën e njerëzve është e parespektueshme. Kështu zhduket qytetërimi. (...)

Për më tepër, arabët rivalizojnë njëri-tjetrin për sundim. Vështirë se ndonjëri ia lë pushtetin një tjetri, qoftë edhe babai, vëllai ose një njeriu të rëndësishëm të fisit, dhe nëse ndodh të akceptohet, kjo ndodh rrallë dhe vetëm me gjysmë zemre. Tek arabët ka shumë emirë dhe komandantë të tjerë. Për të nënshtruarit ndërrohen vetëm duart që marrin taksat dhe shkruajnë ligjet. Kështu, qytetërimi sfilitet dhe zhduket. (...)

(...) Shikoni vendet e botës, të cilat arabët i pushtuan dhe i sundojnë. Qytetërimi i tyre është shkatërruar. Ato janë shpopulluar dhe se toka është bërë tokë e askujt! Në Jemen fshatrat janë të shkretuara, përveç disa qyteteve. Po kështu, qytetërimi i Irakut arab, të cilin e kishin zhvilluar persianët, është shkatërruar. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Sirinë e sotme. Në fillim të shekullit të 11-të, kur Benu Sulejm Ifrikija dhe Bany Hilal pushtuan Mahhirbin dhe qëndruan atje plot 350 vjet duke luftuar njëri-tjetrin, toka e sheshtë u rrënuar krejtësisht. Përpara, e gjithë zona midis Sudanit dhe Mesdheut ishte e banuar. Për këtë dëshmojnë gjurmët e qytetërimit vendor, siç janë rrënojat e ndërtimeve të fshatrave dhe vendbanimeve të dikurshme.⁴⁴²

Arabët mund të formojnë sundim të mirëfilltë mbretëror, vetëm kur t'i përfshijë euforia fetare, qoftë përmes profetizimit, shenjtërimeve apo të ndonjë ndikimi tjetër mrekullues fetar.

Arabët janë më pak të përgatitur, për shkak të temperamentit të tyre të egër dhe të vrullshëm, që dallon nga të gjithë popujt. Ata nuk janë në gjendje të rreshtohen njëri pas tjetrit, për shkak se janë krenarë dhe

⁴⁴² Po aty, fragment nga kap. 26 i veprës *Al-Mukaddima*; sipas: B. Sansal, vep. cit., f. 154-157. Në fusnota janë dhënë shpjegimet për dinastitë e Benu Sulejm Ifrikija dhe Bany Hilal, të cilat fillimisht, si banda plaçkitëse, përbëheshin nga cuba të fiseve nomade arabe.

*ambiciozë, prandaj rivalizojnë njëri-tjetrin për pozita udhëheqëse. Ata rrallë bien dakord në dëshirat e tyre. (...)*⁴⁴³

Sigurisht, Ibn Khadun duhet të ketë bërë vlerësime për (mos)sukseset e arabëve gjatë shek. VII, kur Muhamedi sajoi dhe praktikoi islamin zanafillor, tejet agresiv e imperialist, dhe pushtimet e sundimet e kalifateve pasuese. Shkrimtari algerian Sansal nuk sjell më shumë fragmente në librin e tij, e origjinalin e Ibn Khadun nuk mund ta studioj, sepse nuk e zotëroj gjuhën arabe. Karakteristikat që u ka bërë arabëve ky dijetar i madh, të japin mundësi të konkludosh se ishin euforia dhe motivimi që prodhoi doktrina muhamedane, e pakeluar si fe islame dhe akoma më shumë, dhe vetë Muhamedi si udhëheqës, që ndikuan në sukseset e arabëve. Ai njihte mendësinë e fiseve arabe në Mekë e Medinë, njihte përçarjet e dëshirat ndërmjet tyre, prandaj e sajoi plisin që i binte tamam kokës së tyre.

Tani të shohim nëse vetë *Kurani* është doktrinë që i shërbeu lëvizjes arabe për konsolidim popullor (kombëtar) dhe perandorak. Vlerësimet e studiuesve, shkrimtarëve, publicistëve etj., edhe mund të çmohen si subjektive e islamofobe nga besimtarët myslimanë, por para vlerësimeve kuranore, besimtarët myslimanë ndihen të detyruar të mos kundërshtojnë. Madje, edhe kur citohen ajetet kuranore, nëse rezulton se nuk i përgjigjen bindjes së tyre të shabllonizuar, ata kundërshtojnë me arsyetimin se përkthimet nuk bëjnë, se origjinali është i pagabueshëm, i pakritikueshëm dhe i pareformueshëm.

Për shtjellim kam përzgjedhur disa ajete të *Kuranit*, të cilat, në një mënyrë ose në një tjetër, u dedikohen arabëve, gjuhës, traditave dhe të ardhmes së tyre.

Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, që urdhëroni për

⁴⁴³ Po aty, fragment nga kap. 27 i *Al-Mukaddima*; cituar sipas: B. Sansal, vep. cit., f. 157.

mirë, që ndaloni veprat e këqija dhe të besoni tek Allahu. Sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit. [3:110]⁴⁴⁴

Ky ajet madhëron arabët, si populli *më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, që urdhërojnë për mirë...*

Vetëm ky ajet do të mjaftonte për ta kategorizuar *Kuranin* si doktrinë nacionaliste arabe. Po të ekzistonte zoti, - me karakteristikat madhëruese që i kanë sajuar besimtarët për të, - sigurisht se nuk do ta përzgjidhte dhe klasifikonte në mënyrë kaq eksplicite një popull, duke i shpallur të gjithë popujt e tjerë si të dorës së dytë. Këtë lloj nacionalizmi nuk e zbuloi Muhamedi. Ai e kopjoi nga një doktrinë tjetër, pararendëse nacional dogmatike: judaizmi i sanksionuar në *Besëlidhja e Vjetër*. Edhe atëherë, para shumë shekujsh, gjoja i njëjti zot kishte përzgjedhur popullin izraelit si më të mirin. Pra, njësoj kishte mashtruar edhe “profeti” Abraham, e akoma më vulgarisht kishte mashtruar Moisiu (i arabizuar nga Muhamedi në Musa), sikur zoti judaist, Jahve, i kishte përzgjedhur ata për “të dërguar” të tij dhe i kishte autorizuar për sundimtarë. Edhe ata kishin kopjuar sundimtarin e Babilonisë. Por Abrahami dhe Moisiu nuk qenë të suksesshëm si Muhamedi. Ata nuk e bënë dot popullin izraelit popull perandorak.

Përmes këtij ajeti rezulton se gjoja zoti autorizon arabët që të udhëzojnë popujt e tjerë për vepra të mira, që do të thotë se populli arab autorizohet të sundojë gjithë popujt e botës “në rrugë të Allahut”. Në fjalinë pasuese “e sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më mirë për ta”, u dedikohet izraelitëve, pavarësisht se formulimi është i përcartë, alla-Muhamed. Atyre sikur u ishte dhënë njëherë e një kohë ky mandat, por meqë “ithtarët e librit” (*Besëlidhja*

⁴⁴⁴ Po ofroj edhe variantin e shqipëruar nga Hasan E. Nahi, për ta krahasuar me shqipërimin e Sherif Ahmetit:

“Ju jeni njerëzit më të mirë nga i gjithë populli, që janë paraqitur ndonjëherë: dhe besoni Perëndinë, kërkoni që të bëhen vepra të mira e të shmangen nga të këqijat. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ta; ka edhe prej atyre besimtarëve të vërtetë, por shumica e tyre janë të këqij. [3:110]

Vjetër, Teuratit) nuk besuan drejt, zoti, tashmë i hidhëruar, po ua merrte mandatin dhe po ua jepte arabëve të Muhamedit.

Pra, kjo praktikë po përsëritej e zbatohet tashmë të paktën për të tretën herë, në të njëjtën hapësirë, nga popuj që i përkisnin së njëjtës etni.

Po të ekzistonte me të vërtetë zoti, siç e karakterizojnë *Toraha* e *Kurani*, sigurisht që do të rebelohesha, pikërisht për këto përzgjedhje të tij selektive, shoviniste e raciste, ashtu siç është edhe përzgjedhja e profetëve (vetëm semitë).

Ai (Allahu) është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrenin idhujtarët.” [9:33]

Sërisht Muhamedi nuk është përmbajtur për të sforcuar arabizmin vulgar duke mashtruar, sikur Allahu mysliman ka përzgjedhur enkas arabin Muhamed “me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë”, duke përzgjedhur këtë fe “që të dominojë mbi të gjitha fetë”. Skandaloze! Vetëm besimtarët trushpërlarë fundamentalistë mund të besojnë se këto janë përcaktime të zotit. Në fakt, formulimi përjashton zotin si autor edhe të këtij ajeti, pasi nëse do të ishte ai sikur të ishte ai autor, ajeti nuk do të fillonte me “Ai”, por do ta fillonte me “Unë” ose “Ne”.

Përmes këtij përcaktimi, Muhamedi ose bashkautorë të tjerë kanë yshtur besimtarët muhamedanë që t’i luftojnë, deri në zhdukjen fizike, besimtarët e feve të tjera, nëse ata rezistojnë për të mos pranuar sundimin e vetëm të islamit.

Ky ajet ka qasje seleksionuese, sikur Muhamedi është më i mirë e më i vërtetë se profetët pararendës “myslimanë” (nga Adam/Adem deri te Jezus/Isa).

Këto përcaktime nxitin xhelozë, urrejtje, rivalizim, agresivitet...

Ai është ai që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë mbizotëruar mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë. [61:9]

Skandaloze! Përmbajtja e këtij ajeti është identike me ajetin e mësipërm [9:33]. Është e vetëkuptueshme se ithtarët injorantë të Muhamedit kanë mundur të bëhen edhe kalifë (përmes luftimeve), por nuk kanë pasur intelekt të bollshëm për të shmangur përsëritjen e ajeteve në *Kuran*. Pra, as pjesëtarët e komisionit, të formuar me urdhër të kalifit Utman e nën drejtim të tij, nuk kanë qenë në gjendje të shmangin përsëritjen gjatë “redaktimit” të *Kuranit*. Përsëritja ka ndodhur, sepse duhet të ketë mbisunduar entuziazmi ekzaltues i nacionalizmit arab.

Që pranojnë të dërguarin, Pejgamberin arab, të cilin e gjejnë të cilësuar tek ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, u heq barrën e rëndë dhe prangat që kishin në duar. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, këta janë të shpëtuarit. [7:157]

Meqë përmbajtja më duket goxha e ngatërruar, po ofroj në fusnotë shqipërimin nga Hasan E. Nahi*. Te shqipërimi i Nahit nuk figuron cilësimi i Muhamedit si arab. Kush e ka shtuar ose e ka hequr?! Ai që ka bërë një devijim kaq të madh nga origjinali, duhet akuzuar se e ka bërë me qëllim. Kurse fakti se Muhamedi nuk di shkrim e lexim është një mashtrim taktik. Padronia dhe gruaja e tij, Hatixheja, gjithsesi duhet ta ketë detyruar Muhamedin gjatë rreth 25 viteve martesë dhe disa viteve paraprake si shërbëtor, të mësojë shkrim e lexim, meqë ajo ka qenë grua goxha intelektuale dhe autoritare, e cila duket se e ka mbikëqyrur Muhamedin deri në denigrim të “burrërisë” fodulle arabe. Ky mashtrim ka si qëllim të përballojë dyshimin e njerëzve se Muhamedi po kopjon nga *Besëlidhja e Vjetër, Besëlidhja e Re* dhe

* “Ata që ndjekin rrugën e Pejgamberit, lajmëtarit të fesë, i cili nuk di shkrim e lexim (Muhamedi), të cilin ata e gjejnë të shënuar në Teurat dhe Inxhil, i urdhëron të bëjnë vepra të mira dhe i ndalon nga të këqijat, ua lejon të mirat, e ua ndalon të këqijat, i liron nga barrët e rënda dhe vështirësitë që i kanë pasur. Prandaj, ata që do të besojnë atë (Muhamedin), që do ta përkrahin dhe ndihmojnë, e do të ndjekin dritën që i është shpallur atij - vetëm ata janë të lumtur. ” [7:157]

doktrina të tjera dogmatike, si dhe nga poetë e dijetarë arabë, besimtarë paganë dhe hebrenj...

Disa nga arabët beduinë që kërkuan falje, erdhën për t'iu dhënë leje (të mos shkonin në luftë), e ata të tjerët që kishin gënjer (me besim) Allahun dhe të dërguarin e Tij ishin ndalur (pa leje). Ata që prej tyre nuk besuan, do t'i godasë dënim i ashpër. [9:90]

Kjo përmbajtje dëshmon se Muhamedi po sajonte platformë konkrete, për një lëvizje arabe, duke imponuar edhe përkufizimin e emërimit etnik arab, i cili deri atëherë ishte fluid për fiset nomade të hapësirës “arabe” dhe, duke unifikuar gjuhën arabe, mbi bazën e imponimit të dialektit të fisit të tij Kurejsh të Mekës dhe rrethinës. Karakterin luftarak të këtij ajeti dhe të qindra të tjerëve e kam shtjelluar në një kapitull tjetër.

Arabët beduinë janë të pajisur me mohim e hipokrizi më të fortë dhe janë më të përshtatshëm për të mos i njohur dispozitat që ia zbriti të dërguarit të Tij Allahu. Allahu i di çështjet, Ai është i urtë. [9:97]

Sërisht për arabë, tashmë konkretisht për fise nomade të shkretëtirave, që i quanin beduinë. Si mund të ketë karakter të një doktrine religjioze universale e hyjnore ky karakterizim i përkufizuar për të qenë gjithëpërfshirës për të gjithë njerëzit e botës?!

Ne e zbritëm Kuranin në arabisht, që ju ta kuptoni. [12:2]

Patjetër! Në çfarë gjuhe tjetër do të duhej ta sajonte doktrinën e tij Muhamedi, nëse jo në gjuhën e tij, që ia ka mësuar nëna dhe fisi?! Është praktike e pragmatike që Muhamedi të sajonte *Kuranin* në arabisht, përndryshe nuk do ta kuptonin bashkëbanorët vendorë. Edhe ashtu, edhe kështu, nuk kanë ditur gjuhë tjetër as Muhamedi, por as personazhi i tij, Allahu muhamedan. Por, atëherë, si mund të jetë *Kurani* gjithëpërfshirës dhe për të gjithë njerëzit e botës, kur ai qenka

shkruar ekskluzivisht në arabisht, që ta kuptojnë arabët?! Kjo do të thotë se *Kurani* nuk u është dedikuar joarabëve, sepse ata nuk flasin arabisht.

Ajeti nuk duhet të jetë formuluar nga zoti, sepse ai, të paktën, duhet ta dinte që nuk ka zbritur asnjëherë *Kuran*, as si format libri, as si recital i kompletuar. Ta zëmë, suren e parë nr. 96 Muhamedi e ka ëndërruar në shpellën e malit Hira në vitin 610, me ç'rast i ishte shfaqur "kryeengjëlli" Xhibril, kurse ajetet dhe suret e tjera në raste e në forma të ndryshme, kohë pas kohe, sipas rastit e nevojës, gjatë 22 vjetëve (ajetin e fundit e ka sajuar 9 ditë para se të vdiste).

Po sjell hadithen nga *Sahihal-Bukhari*, e cila informon se si Muhamedi i "ka pranuar" ajetet:

Na ka treguar Abdullah b. Jusufi, ky nga Maliku, ky nga Hisham b. Urve, ky nga babai i tij, ky nga Aisha hr. a., e cila transmeton se Harith b. Hishami r.a. e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.: "O Resulullah, si të vjen ty Shpallja (Vahji)?

Pejgamberi s.a.v.s. i qe përgjigjur: "Herë-herë më vjen si tingujt e ziles. Kjo për mua është mënyra më e vështirë e shpalljes, e më ndërpritet pasi ta kem mbajtur në mend atë që më është thënë. Dhe herë-herë meleku (Xhibril) më paraqitet në formë njeriu. Ai më flet dhe unë e mbaj në mend atë që më thotë".

Aisha hr. a. është shprehur kështu: "E kam parë atë (Pejgamberin s.a.v.s.) duke iu zbritur Shpallja në ditë shumë të ftohta dhe kur i ndërpritej (Shpallja), vërtet e kishte ballin ende qull në djersë."⁴⁴⁵

Nga kjo hadithe rezulton se Muhamedi ose ka gënjyer kur e ka sajuar ajetin [12:2], ose ka gënjyer kur i është përgjigjur Harith bin Hishamit. Ndërkaq, edhe përgjigjja e Muhamedit, sipas kësaj haditheje, është më tepër sesa naive e qesharake dhe asaj mund t'i besojnë vetëm besimtarët trushpërlarë.

⁴⁴⁵ Sahih Buhari libri i parë nr. 2.

ISLAMI, religion agresiv (?!)

Dhe ashtu, Ne e shpallën atë (Kuranin) kushtetutë në arabishte. E nëse ti, pasi të kanë ardhur argumente të qarta shkon pas dëshirave të tyre, ti nuk ke prej Allahut as ndihmë, as mbrojtje. [13:37]

Meqë në këtë ajet figuron “kushtetuta”, po ofroj edhe shqipërimin alternativ të Hasan E. Nahit:

Ja, kështu, Ne e kemi zbritur Kuranin - ligj në gjuhën arabe. E, nëse ti ndjek dëshirat e tyre, pas njohurisë që të ka ardhur, ti nuk do të kesh as ndihmës, as mbrojtje prej (dënimit të) Zotit. [13:37]

Në shqipërimin e Sherif Ahmetit bëhet fjalë për “ligj”, në vend të “kushtetutës”, Por në të dy rastet kemi njoftimin se *Kurani* “është shpallur” ose “është zbritur” në gjuhën arabe. Tani, meqë figuron përcaktimi “kushtetutë” ose “ligj”, rezulton se Muhamedi dhe “këshilltarët” e tij e kanë sajuar një lloj kanuni për beduinët, ngjashëm siç e kishin shqiptarët Kanunin e Lekës. Meqë kanuni është sajuar për beduinët, ndoshta kishte vlera për emancipimin dhe formësimin e tyre. Si i tillë, pse duhet të vlejë për popuj të tjerë, në hapësira e kohë të ndryshme, të cilët nuk kishin dhe nuk kanë ngjashmëri me beduinët?

Kështu, Ne e shpallëm këtë Kuran arabisht dhe përsëritëm në të vërejtjet, në mënyrë që ata të ruhen ose ai (Kurani) t’u sjellë atyre përvojë mësimi. [20:113]

Formulim i përçartë, ose i variantit zanafillor, ose shqipërim kuturu*. Por sërish potencohet se *Kurani* është shpallur në arabisht...

Edhe ai (Kurani) është shpallje e Zotit të botëve. [26:192]

Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). [26:193]

(E solli) Në zemrën tënde, për të qenë ti (Muhamed) prej atyre që tërheqin vërejtjen. [26:194]

* Po sjell edhe shqipërimin nga Hasan E. Nahi:

“Dhe kështu Ne, e kemi zbritur Kuranin në gjuhën arabe dhe në të kemi përsëritur vërejtjet, që ata të ruhen nga mëkatet, ose që t’i orientojë ata në këshillim.” [20:113]

(E shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe. [26:195]

Dhe se ai (Muhamedi) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm. [26:196]

Nuk ia hoqa sqarimet në kllapa, meqë ta zëmë, në fjalinë e parë nuk do të kuptohej se bëhet fjalë për *Kuranin*, kurse në fjalinë e dytë nuk do të dihej cili ishte ai shpirt besnik (Xhibrili) etj. Fjalja e katërt “Në gjuhën arabe” do të ishte tepër e cunguar, sepse nuk do të dihej çfarë është në gjuhën arabe. Në fjalinë përmbyllëse “ai” do të ishte i pakonkretizuar e nuk do të dihej se është fjala për Muhamedin. Nuk besoj se shqipërimi është tepër ndryshe nga origjinali. Madje jam i mendimit se Sherif Ahmeti, duke e përkthyer në mënyrë sa më korrekte, ka ofruar një tekst më të qartë sesa “origjinali”.

Sërish ripotencohet tashmë, “me gjuhë të kulluar arabe”, duke u bërë bezdisëse për lexuesin kritik (ndërsa ngazëlluese për panarabistët dhe panarabistofilët).

A nuk ishte për ata argument, se atë e dinin dijetarët e beniizreilëve? E sikur t'ia shpallnim atë ndonjë joarabi, e ai t'ua lexonte atyre, ata nuk do t'i besonin atij. Dhe kështu, Ne ua futëm atë në zemrat kriminelëve, e ata nuk i besojnë atij, derisa ta shohin dënimin e dhembshëm... [26:197-201]

Kjo përmbajtje dëshmon për përcaktimin shovinist të Muhamedit kundër izraelitëve dhe joarabëve, duke i cilësuar ata edhe si kriminelë. Blasfemike! - do të shpreheshin fetarët. Gjithsesi, formulim i përçartë, i bërë nga autorët gjysmanalfabetë dhe jo nga ndonjë lloj “zoti”.

Dhe po ashtu, Ne ta zbritëm ty librin. E ata, të cilëve Ne u kemi dhënë librin, i besojnë këtij; ka edhe nga ata që i besojnë këtij, kurse argumentet tona nuk i refuzon askush, përpos jobsimtarëve”. [29:47]

Sërish formulim i përçartë, që të nevrikos. Është gënjeshtër skandaloze të thuhet se ndonjëherë zoti ka zbritur një libër, cilindo qoftë ai. Ata janë sajuar nga tokësorët, edhe pse besimtarët besojnë se "janë zbritur" (sipas mendësisë së tyre injorante, zoti është “lart”...),

“zbuluar”, “shpallur” dhe, pas kompletimit, dhjetëra vjet më vonë janë përmbledhur e “redaktuar” në formate të ngjashme me librin.

Bizantinët u mundën në tokën më afër, por pas disfatës së tyre ata do të ngadhënjëjnë, brenda pak vitesh. [30:2-3]

Sa ishte gjallë Muhamedi dhe komandonte luftërat e tij plaçkitëse e pushtuese, asnjëherë bandat e tij nuk janë përballur me ushtrinë bizantine. Kjo dëshmon se edhe këto dy ajete janë sajuar nga komisioni “redaktues” i kalifit Utman, të paktën 20 vjet pas vdekjes së Muhamedit, kur duhet të kenë ndodhur përballjet me Bizantin. Nuk kemi pse spekulojmë për përmbajtje hyjnore dhe universale, meqë ato (ajetet) janë e kundërta e hyjnores dhe e universales.

Ata mendonin se grupet aleate ende nuk kishin shkuar, dhe nëse aleatët kthehen edhe një herë, ata do të dëshironin të kishin qenë beduinë diku me arabët dhe prej atje të pyesin për çështjen tuaj, por edhe sikur të ishin në mesin tuaj, ata do të luftonin shumë pak. [33:20]

Sërish formulim i përcartë, neveritës. Nga e gjejnë stilin letrar ata që mashtrojnë se *Kurani* ka stil të lartë letrar, pos në besimin e tyre naiv?! Domosdo, detyrohem të sjell edhe variantin e shqipëruar nga Hasan Nahi:

Ata mendonin se ende nuk ka shkuar ushtria, e nëse do të vinte ushtria e aleatëve, ata do të dëshironin të jenë në mesin e beduinëve dhe të pyesin për ju; e, edhe sikur të mbeteshin me ju, pak do të luftonin. [33:20]

Ky variant është goxha ndryshe. Në shqipërimin e Hasan Nahit nuk përmenden fare arabët, por vetëm beduinët, sepse ky shqipëruar duhet të ketë qenë i mendimit se beduinët janë vetëm arabë. Edhe ky variant nuk ka qartësi të bollshme, për ta kuptuar ngjarjen. Megjithatë, shihet se kemi të bëjmë me ushtri, me përballje të tyre, për t'i zgjeruar pushtimet muhamedane. Kjo përmbajtje dhe të tjera të ngjashme

dëshmojnë se *Kurani* përmban platformë për luftëra ekspansioniste arabe.

Duke qenë Kurani arabisht që nuk ka kundërthënie, me qëllim që të ruhen prej rrugës së gabuar. [39:28]

Kështu, kundërthëniet u shmangkan vetëm në arabisht dhe jo në gjuhë të tjera! Vetëm arabishtja e mbrojtka *Kuranin* nga devijimet. Ndërsa e vërteta është se *Kurani* përmban shumë kundërthënie, por ato do të trajtohen në një kapitull tjetër. Ndërsa këtu më mbetet vetëm të thërras: aferim panarabit nacionalist Muhamed!

Libër ku ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kuran arabisht për një popull që di ta kuptojë. [41:3]

Tamam, i sajuar vetëm për arabishtfolësit. Të tjerët kot që e çmojnë si *Kuran* të tyre, sepse ata nuk dinë arabisht dhe nuk janë në gjendje ta kuptojnë. E nga ajetet që kam shqyrtuar, jam bindur se ato janë kaotike, kontraverse, kundërthënëse, injorante...

Sikur Ne ta bënim Kuranin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Pse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme? A është ai në gjuhë të huaj, kurse ai është arab?" Thuaj: "Ai është për besimtarët udhëzues e shërues. E ata që nuk besojnë, në veshët e tyre kanë shurdhim, dhe ai për ta është verbërim. Të tillët janë sikurse thirren prej një vendi të largët e nuk dëgjojnë." [41:44]

Vërtet: *No comment!*

Prandaj, Ne ta shpallëm ty Kuranin arabisht, që ta këshillosh kryefshatin (Mekën) dhe zonat përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për ditën e tubimit, për të cilën nuk ka dyshim. Një grup për në xhenet, kurse një grup për në zjarr. [42:7]

Përmbajtja e këtij ajeti ka karakter përkufizues të *Kuranit* vetëm për arabishtfolësit, madje akoma më pak, vetëm për banorët e Mekës e rrethinave. Duhet të jetë sajuar që në fillim, nga një Muhamed akoma

skeptik se mund të kishte suksese të mëdha, prandaj i mjaftonin vetëm banorët e Mekës e rrethinave. Kurse formulimi është alla-Muhamed...

S'ka dyshim se Ne e bëmë atë Kuran arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni. [43:3]

Edhe në këtë ajet, si në atë më sipër, sajuesi (Muhamedi) është kufizuar vetëm tek arabishtfolësit. Ai ende nuk e dinte se ai *Kuran* do t'u imponohej me dhunë qindra milionë joarabëve (ashtu siç kjo fatkeqësi u ka ndodhur edhe shqiptarëve...).

E para tij (Kuranit) ishte libri i Musait, prijës dhe mëshirues, e edhe ky është libër që vërteton (librin e Musait), është në gjuhën arabe për t'u tërhequr vërejtjen atyre që nuk besuan, kurse s'hariq për besimtarët. [46:12]

Rezulton se *Kurani* është vazhdim i *Torahës* së Moisiut dhe vërteton se *Toraha* është libër hyjnor, por, megjithatë, është në gjuhë arabe, prandaj edhe rivalizues. Pse “zoti” i përbashkët i këtyre dy religjioneve të ngjashme, me profetë themelues pothuajse të ngjashëm, paskësh përzgjedhur mënyrën më të keqe për të përçarë këta dy popuj, për të cilët thuhet se kishin për “baba” të tyre njëfetar e etnik, Abrahamin/Ibrahimin?! Absurde! Janë vetë këta profetë, që kanë sajuar doktrina për të imponuar veten e tyre si sundimtarë, fillimisht të popujve të tyre, pastaj edhe të të gjithë botës.

*Është ai, që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre, që t'u lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme. [62:2]**

* Shqipërimi nga Hasan E. Nahi:

“Perëndia është Ai, që ju ka dërguar të paarsimuarve një Profet nga mesi i tyre, që ua ka lexuar ajetet e Kuranit dhe i ka pastruar, ua ka mësuar Librin dhe urtinë, meqë ata më parë, në të vërtetë, kanë qenë në humbje të plotë...”

Shqipërimi i Fetii Mehdiut: “Është ai, i cili u dërgoi analfabetëve një Profet nga mesi i tyre, t'ua lexojë ajetet e tij, t'i pastrojë dhe t'ua mësojë librin dhe urtësinë, edhe pse më herët kanë qenë në humbje të hapët...”

Në fusnotë po ofroj edhe dy variante shqipërimesh, të Hasan Nahit dhe të Feti Mehdiut, për të pasur mirëkuptimin e lexuesit, se sa problematike është të interpretosh e komentosh ajete, kur nuk e di dialektin kurejsh të *Kuranit*. Por sajuesit të këtij ajeti i është përvjedhur një gabim: nuk ka logjikë të përzgjedhësh profet analfabet, “nga mesi i analfabetëve”, “që t’ua lexojë ajetet”, meqë vetëkuptohet se profeti analfabet nuk di të lexojë. A nuk (dez)informohet kur thuhet se Xhibrili i kishte thënë Muhamedit të lexonte me rastin e “shfaqjes” së ajetit të parë, dhe Muhamedi i ishte përgjigjur se nuk dinte të lexonte (ajeti 96:1)?! Ja edhe një kundërthënie flagrante! Pastaj, rezulton se *Kurani* është sajuar vetëm për analfabetë të një hapësire të kufizuar gjuhësore dhe etnike. Ai nuk është menduar të ketë karakter universal dhe hyjnor.

Secili popull kishte të dërguarin e vet, e kur u vinte i dërguari i tyre bëhej gjykimi i drejtë mes tyre; atyre nuk u bëhet padrejtësi.” [10:47]

Informimi që përmban ky ajet më është dukur kurdoherë intrigues. Atëherë e tani, kush e ka ditur dhe kush e di se cilin profet kishin popujt, ta zëmë hindutë, kinezët, anglezët, gjermanët, deri edhe shqiptarët? Ky është një konstatim kuturu i Muhamedit ose sajuesve të tjerë të këtij ajeti.

Deri tani, në fetë abrahamike flitet vetëm për “profetë” të përkatësisë semite (izraelite-arabe), rrjedhimisht ata që i kishte përcaktuar fillimisht Moisiu (Musai), duke u shtuar edhe themeluesin e krishterimit, Paulus (Palin) Jezusin (Isain) dhe duke shtuar Muhamedi edhe veten e tij për besimtarët myslimanë. Çifutët nuk e pranojnë Jezusin e Muhamedin për profet. Kristianët nuk e pranojnë Muhamedin për profet. Është e vetëkuptueshme se, edhe dogmat e tyre (*Bibla* janë fikse e nuk mund të ndryshohen, prandaj nuk kanë mundësi të njohin profetë pasardhës.

Ky kapitull mund të përmbillet, pa mëdyshje, me konstatimin se “Kurani” ishte një lloj kanuni i beduinëve arabishtfolës, fise që në atë kohë popullonin Mekën dhe Medinën. Sajuesit e tij, Muhamedi bashkë me veprimtarë të tjerë, u bënë shkaktarë të luftërave të përhershme, fillimisht ndërmjet besimtarëve fetarë, pastaj edhe të luftërave pushtuese e për sundim. Së këndejmi, atëherë dhe tani, *Kurani* dhe hadithet rezultojnë të jenë një si platformë panarabe, e cila ka arabizuar shumë popuj dhe vazhdon të ketë atë synim...

III. 5. *Kurani* - kundër çifutëve dhe kristianëve

Kurani përmban shumë vërse (ajete), që u dedikohen besimtarëve çifutë e kristianë. Vlerësimet e përcaktimet kuranore ndaj tyre janë tejet konfuze, kontroverse, kundërthënëse; ka prej tyre që janë tepër tolerante e mirëdashëse, deri tek ajetet shoviniste, armiqësore e fashiste.

Kjo tematikë meriton të trajtohet kryesisht për faktin se shumica e luftërave të mëdha, gjatë 1400 viteve të fundit, janë motivuar nga doktrina armiqësore e *Kuranit* ndaj dy feve pararendëse: kristianizmit dhe judaizmit. E kundërta nuk mund të ndodhte, sepse “librat” pararendës, nuk kanë mundur të përmbajnë armiqësi kundër religjion islam, meqë ai ende nuk ishte sajuar. Megjithatë, kleri i atyre feve ka prodhuar urrejtje më tepricë kundër Muhamedit dhe fesë së tij. Dhe jo vetëm ka prodhuar urrejtje, por edhe ka nxitur e organizuar luftëra kundër besimtarëve myslimanë, më saktësisht, kundër perandorive ekspansioniste e pushtuese islame.

Po shqyrtoj, telegrafikisht, disa ajete që i kam përzgjedhur, - sipas radhës se nprezantuar në Kuran, - të cilat u dedikohen çifutëve dhe kristianëve.

Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudinj, krishterë, sabej, kush besoi prej tyre Allahun, botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë, as nuk kanë pse të pikëllohen. [2:62]

Kaptina (surja) nr. 2 titullohet *El-bekare*, e përkthyer në shqip: *Mështjerra* (viçi femër i lopës). Është një sure e sajuar pas dëbimit të Muhamedit nga vendlindja, Meka, dhe strehimi i tij në Jah'tribë (Medinë). Pra, kjo sure është e sajuar pas vitit 622. Muhamedi medinas duhet të jetë shquar si luftëtar e komandant energjik për përhapje të dogmës së tij: Islamit. Nuk kam gjetur informacione se kush i ka emërtuar suret, por emërtimi i kësaj sureje, *Mështjerra*, rezulton të jetë i pakuptimtë. Përcaktimi në 2:62 është dashamirës, por po flitet për *zot të tyre*, pra, jo për zot të përbashkët.

A shpresoni se ata do t'ju besojnë juve, kur dihet se një grup prej tyre dëgjuan fjalët e Allahut, edhe pse i kishin kuptuar, e duke qenë të vetëdijshëm, i ndryshuan ato. [2:75]

Tashmë çifutët fajësohen nga Muhamedi, se i kanë ndryshuar me qëllim fjalët e zotit, të zbritura përmes “librave” (*Toraha, Ungjilli*).

A thua nuk e dinë ata se Allahu e di atë çka fshehin dhe atë çka publikojnë? [2:77]

Sërisht i (dis)kualifikon çifutët si komplotistë kundër Allahut.

(Çifutët) thonë: "Zemrat tona janë në këllëf!" Jo, por për shkak të mosbesimit të tyre Allahu i ka mallkuar, ndaj pak janë ata që besojnë. [2:88]

Formulim i përcartë, sidomos po të mos ishte sqarimi në kllapa, i cili nuk është në tekstin zanafillor. Megjithatë, duket se Muhamedi shpreh mallkimin e tij, sepse çifutët nuk i besojnë atij dhe nuk konvertohen.

Është e sigurt se njerëzit më lakmues për të jetuar, ti ke për të gjetur ata (çifutët), madje edhe më lakmues se idhujtarët. Ndonjëri prej tyre dëshiron të jetojë një

mijë vjet, por edhe sikur të jetojë, kjo nuk do ta shpëtojë atë prej dënimit. Allahu sheh çka veprojnë ata.” [2:96]

Diskualifikim ndaj çifutëve, më i ashpër sesa ndaj paganëve. Është interesant se, në dëshirën për jetëgjatësi fshihet edhe dilema e autorit, se ndoshta edhe mund të jetojnë një mijë vjet. Përndryshe, zoti i ka të paracaktuara jetëgjatësitë, e kjo përsëritet shpesh në *Kuran*.

Shumë ithtarë të librit edhe pasi iu është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale dëshiruan që, pas besimit tuaj, t’iu kthejnë në mosbesimtarë, pra ju lërin dhe largohuni prej tyre, derisa Allahu ta sjellë urdhrin e vet. Allahu ka mundësi për çdo send.” [2:109]

Muhamedi i diskualifikon çifutët edhe si kundërshtarë të tij, por ata duhet të përballen, kurdo që të jenë të gatshme forcat xhihadiste.

Ata thanë: “Kurrsesi nuk ka për të hyrë kush në xhenet, përveç atij që është jehudi ose i krishterë!” Këto janë fantazi të tyre! Thuaju: “Sillni argumentin tuaj po qe se jeni të drejtë!” [2:111]

Çifutët thanë se të krishterët nuk janë të mbështetur në asgjë. Edhe të krishterët thanë se çifutët nuk janë të mbështetur në asgjë, duke qenë se të dyja palët e lexojnë librin. Po kështu, si thënie të tyre, thanë edhe ata që nuk dinin. Në ditën e gjykimit për atë që ata nuk pajtoheshin, Allahu gjykon ndërmjet tyre. [2:113]

As çifutët e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty, derisa të mos ndjekësh fenë e tyre. Thuaju: “Udhëzimi i Allahut është udhëzimi i drejtë. E nëse ti, pasi të ka ardhur e vërteta, shkon pas mendimeve të tyre, nuk ka kush të të ndihmojë e as të mbrojë nga Allahu”. [2:120]

Përmbajtje polemizuese, që nuk do të duhej të gjente hapësirë në *Kuran* (me pretendimin për të qenë vepër e zotit). Nga përmbajtja rezulton se në pyetje është vetëm gara, që islami të shtrihet në përmasa dominuese. Por Muhamedi ka gjykuar se çifutët janë komunitet më i vogël, pa mbrojtje ushtarake, prandaj u është vardinur më shumë, kurse kristianët, të cilët ishin superfuqi botërore (Bizanti), nuk trazoheshin shumë.

Atyre, të cilëve ua dhamë librin dhe të cilët e lexojnë drejt ashtu siç është, ata e besojnë atë. E ata që e mohojnë atë, janë ata që dështuan. [2:121]

Përmbajtje e përçartë, sepse fillimisht flitet për “libër” (*Toraha*), pastaj bëhet ngatërrimi duke aluduar për *Kuranin*. Nuk është realiste të pritej formulime me koncize nga injorantët e sojit të Muhamedit, të komanduar nga “analfabeti” Muhamed.

O bij israilitë, kujtoni të mirat e Mia ju dhurova, që ju dallova mbi njerëzit e tjerë. [2:122]

Formuluesi i këtij ajeti ka qenë i (dez)informuar për marrëzinë, sikur zoti i paskësh përzgjedhur izraelitët si popullin më të mirë hyjnor. Por tashmë Muhamedi angazhohet t’i diskualifikojë ata si të tillë, sepse do që arabët të jenë të parët. Për këtë përcaktim të tij sajón dogmë privilegjuese, që gjoja tashmë zoti i ka përzgjedhur arabët.

Dhe kur shtëpinë e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit: vendin ku qëndroi Ibrahim pranojeni si vendfaljeje! Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrojeni shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty. ” [2:125]

Sërisht një formulim i ngatërruar. Tashmë Muhamedit i duhet të sajojë argumente për të uzurpuar Qabenë, sepse përmes saj do të kishte përfitime materiale dhe konvertime më të shumta. Për këtë qëllim ai sajón sikur Qabenë ekzistuese e “paskëshin pastruar” Abrahami me djalin e tij, Ismailin. Pra, rezulton se ajo “shtëpi” paskësh ekzistuar edhe para Abrahamit, por tashmë ai urdhërohet nga zoti vetëm për ta pastruar. Kjo do të thotë se Qabeja, megjithatë paskësh qenë politeiste, nëse vërtet ka ekzistuar, meqë para Abrahamit nuk ekzistonte besim monoteist.

Dhe kur Ibrahim tha: "Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun, furnizoi me lloje frutash!" Ai tha: "Edhe atij që nuk besoi do t'ia

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

mundësoj shfrytëzimin e frutave për një kohë të shkurtër, e pastaj do ta shtyj në dënimin e zjarrit, e sa përfundim i shëmtuar është ai. [2:126]

Sikur të mos ishte ajet i *Kuranit*, që i besojnë qindra milionë myslimanë trutredhur, do të mjaftonte të injorohej një kësi formulimi vetëm me një përcëim!

Edhe kur Ibrahim i dhe Ismaili, duke ngritur themelet e shtëpisë: "Zoti ynë, pranoje prej nesh, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe di!" [2:127]

Në ajetin 2:125 kishim urdhrin e zotit, që Abrahami dhe Ismaili ta pastronin, kurse tashmë ata po vënë themelet. Muhamedit i janë përzier sajusat e tij, prandaj i kanë ndodhur edhe këso kundërthëniesh, meqë rëndom gënjeshttrat është shumë e vështirë të përsëriten.

E kush largohet prej fesë së Ibrahimit, përveç atij që poshtëron vetveten. Ne atë e bëjmë të zgjedhur në këtë botë, kurse në botën tjetër ai është njëri prej të lartëve. [2:130]

E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë, edhe Jakubin: "O bijtë e mi, Allahu jua zgjodhi juve fenë, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë myslimanë!" [2:132]

Këto ajete janë në vazhde të falsifikimeve historike për të argumentuar përvetësimin e Qabesë, duke u bazuar në "të drejtën historike". Edhe vjetërsinë e fesë islame Muhamedi e katapulton deri te Abrahami, duke e tjetërsuar atë dhe pasardhësit e tij në myslimanë. Por, megjithatë, i ka shpëtuar një lajthitje *a la* Muhamed, sepse ai e ka shpallur veten myslimanin e parë (39:12), siç edhe ishte. Irrituese për besimtarët çifutë dhe kristianë ishte tjetërsimi kaq flagrant i Abrahamit të "tyre"...

A ishit ju dëshmitarë kur Jakubi i u afrua vdekja, e ai u tha bijve të vet: "Çfarë do të adhuronit pas meje?" Ata u përgjigjën: "Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Isakut, një të vetmin Zot, dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar!" [2:133]

Truk demagogjik i Muhamedit për t'i islamizuar “profetët” para-
rendës dhe “paraardhës” të tij familjarë.

*Ai ishte një popull që kaloi, atij i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat,
prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që vepruan ata. [2:134]*

Përsëritje:

*Ai ishte një popull që shkoi, të cilit i takoi ajo që fitoi, e juve u takon ajo që fituat,
prandaj ju nuk jeni përgjegjës për atë që vepruan ata. [2:141]*

Këto dy ajete kanë përmbajtje identike. Përsëritje koti! Megjithatë,
askush nuk guxon të ndërmarë largimin e njërit, meqë prishet miti
gënjeshtar: *Kuranin* nuk mund ta ndryshojë askush, pasi atë e mbron
zoti. Por edhe përmbajtja është e përçartë e aspak hyjnore!

Sikur rezulton një taktikë për të bindur çifutë e kristianë që të
konvertohen në myslimanë. Një praktikë të tillë besimtarët myslimanë
e kanë shndërruar në traditë. Edhe sot e gjithë ditën zhurmojnë kur
ndodh ndonjë konvertim ekzibicionist ose spektakolar (shpesh
mercenarist). Praktikën e konvertimit e nxisin edhe klerikët kristianë,
por janë më të heshtur sesa islamistët e zhurmshëm.

Profetët e këtyre dy popujve, izraelitë dhe arabë, edhe pse këmbë-
ngulin se të dy kanë “baba” Abrahamin, vazhdojnë të jenë popujt më
të armiqësuar në botë, dhe detyrohen të jenë të armiqësuar përjetësisht,
derisa të ketë besimtarë muhamedanë. Pse? Fajtoje nuk mund të jetë
doktrina që përmban *Toraha*, meqë nuk përmban përcaktime ekspli-
cite armiqësore ndaj arabëve. Në kohën kur është sajuar ajo fe, arabët
pothuajse nuk kanë ekzistuar fare si popull, aq më pak të ishin
faktorizuar dhe konkurrues. Sipas fantazive të Muhamedit, arabët
ekzistojnë vetëm si pasardhës të Ismailit, djalit të Abrahamit. Ndërsa
Kurani është përplot me përcaktime armiqësore ndaj çifutëve, njësoj
armiqësore ishin angazhimet luftarake të Muhamedit dhe xhihadistëve

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

të tij kundër tyre. Rezulton se vetëm lufta për territore e dominim ka motivuar edhe klerikët përkatës që t'i yshtin besimtarët.

Ata thanë: "Bëhuni jehudinjtë ose të krishterë, e gjeni rrugën e drejtë!" Thuaj: "Jo, por fenë e drejtë të Ibrahimit, që ai nuk ishte nga idhujtarët." [2:135]

Sërish Muhamedi me metodat e tij polemizuese, duke e përvetësuar Abrahamin si karrem mashtrues sidomos ndaj çifutëve dhe kristianëve, duke ia mveshur atij të qenit mysliman.

Ju thoni: "Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakubit dhe pasardhësve, atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve; ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur." [2:136]

Muhamedi këshillon besimtarët e tij, se duhet të propagandojnë për t'i bindur çifutë e kristianë që të konvertohen. Praktika dëshmon se të gjithë "profetët" pararendës nuk janë respektuar njësoj nga myslimanët. Pra, myslimanët janë përqendruar në adhurim vetëm të Muhamedit, i cili ka prodhuar më tepër se urrejtje kundër çifutëve dhe kristianëve.

Në qoftë se ata besuan ashtu siç besuat ju, ata vërtet kanë gjetur rrugën e drejtë, e nëse refuzojnë, atëherë ata janë kundërshtarë, po ty kundër tyre do të mjaftojë Allahu. Ai është dëgjuesi, i dijshtmi. [2:137]

Por Muhamedit nuk i ka mjaftuar vetëm Allahu i tij që t'u kundërvihet, por ka sajuar doktrinë monstruoze dhe ka mobilizuar edhe xhihadistë agresivë kundër tyre.

Thuaj: "A doni të grindeni me ne për Allahun? Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj dhe ne kemi vepra tona, e ju keni veprat tuaja. Por ne jemi të sinqertë ndaj Tij. [2:139]

Përmbajtje polemizuese dhe garuese ndaj çifutëve. Nga përmbajtja rezulton se çifutët nuk qenkëshin të sinqertë ndaj zotit, ndërsa besimtarët myslimanë po.

Aspak profetike dhe hyjnore ky lloj përcaktimi seleksionues e preferues.

A pretendoni se Ibrahim, Ismaili, Isaku, Jakubi dhe pasardhësit kanë qenë jehudinjtë ose të krishterët? Thuaj: "A e dini ju më mirë apo Allahu? Kush është më mizor se ai, që e ka dëshminë e Allahut pranë vetes dhe e fsheh. Allahu nuk është i panjoftuar për veprimet tuaja." [2:140]

Sërish garë banale për përvetësim të "profetëve". Se për çfarë dëshmie bëhet fjalë, këtë e di vetëm Muhamedi. Sigurisht, ky ka qenë një lloj agresiviteti kundër besimtarëve çifutë e kristianë, meqë profetët tashmë i tjetërsojnë në myslimanë dhe ua arabizojnë edhe emrat.

Disa nga njerëzit mendjelehtë do të thonë: "Çka i ktheu ata prej kibles në të cilin ishin?" Thuaj: "Të Allahut janë lindja dhe perëndimi, Ai vë në rrugën e drejtë atë që do." [2:142]

Rezulton se manovrimet janë për t'u orientuar gjatë lutjeve (namazit) nga Qabeja ose nga Jerusalemi, meqë ka rreth 17 muaj (623-624) që Muhamedi është orientuar nga Jerusalemi.

Po edhe sikur ti t'u sillje çdolloj argumenti atyre që u është dhënë libri, ata nuk pasojnë kiblen tënde, e as ti nuk do të pasosh kiblen e tyre, po asnjëra palë nuk do ta pasojë kiblen e tjetrës. E pas dijes, e cila të ka ardhur, po e zëmë se ishe vënë pas dëshirave të tyre, atëherë ti do të ishe mizor. [2:145]

Një formulim kakofonik *a la* Muhamed. Thjesht broçkulla! Qëllimi duhet të ketë qenë për të prodhuar sa më shumë demagogji garuese.

Atyre që ua kemi dhënë librin, ata e njohin atë siç i njohin bijtë e vet, e një grup prej tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke e fshehur të vërtetën. [2:146]

Sa herë që përmendet “libri”, është fjala për *Torahën* e çifutëve. Sërish taktikë për të bërë presion ndaj tyre që të konvertohen.

Secili (popull) ka një anë, së cilës ai i kthehet. Ju shpejtoni kah punët e mbara, e Allahu kudo që të jeni ka për t'ju tubuar të gjithëve...[2:148]

Këtë ajet e dinë fare pak besimtarë myslimanë joarabë, përndryshe do të irritoreshin me këtë përcaktim. Por, meqë në origjinal nuk duhet të ekzistojë shprehja "popull", nuk është dashur që shqipëruesi ta ofrojë edhe në kllapa. Pos izraelitëve dhe arabëve, popujt e tjerë nuk dinë për këto “anë” që ka trilluar Muhamedi.

Ata të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi ato ua sqaruar njerëzve në libër, të tillët i mallkon Allahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. ” [2:159]

Stërpërsëritje bajate, duke kërcënuar çifutët me mallkime të Allahut mysliman, por edhe “ata që mallkojnë”. Se cilët janë këta, vetëm Muhamedi merr vesh! Muhamedi shpif se çifutët e kanë falsifikuar *Torahën* dhe kjo është një akuzë e rëndë për ata besimtarë. Askund nuk është ofruar qoftë vetëm një dëshmi, se cili ishte varianti origjinal i *Torahës*.

Në fe nuk ka detyrim. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Allahut, ai është kapur te lidhja më e fortë, e cila nuk këputet. Allahu është dëgjues i dijshtëm. [2:256]

Vërtet Muhamedi duhet ta ketë formuluar: “Në fe nuk ka detyrim”?! E pabesueshme! Në çfarë momenti duhet të ketë qenë ai, që i është përvjedhur ky formulim paqësor?! Me qindra ajete janë tepër luftarake, fashistoide (janë paraqitur e shqyrtuar në kapitull më vete), kurse tani kemi një prononcim paqësor. Vërtet doktrinë konfuze, kontroverse, që përmban ajete me përcaktime tepër kundërthënëse.

Këtë ajet e citojnë më së shpeshti propagandistët myslimanë, kur debatojnë kundër atyre që fajësojnë islamin për fe të dhunshme, duke heshtur për qindra ajete që i detyrojnë muhamedanët të jenë më tepër sesa të dhunshëm. Madje ata nuk ngurrojnë t'ia ndryshojnë paksa përmbajtjen, duke paraqitur formulimin “Në fe nuk ka dhunë”, që dallon shumë me origjinalin: “Në fe nuk ka detyrim”.

Pastaj, propagandistët myslimanë harrojnë se ky përcaktim duhet të jetë abroguar (shfuqizuar) me ajete “shpatare”, sepse, megjithatë, në religjionin islam ka dhunë me tepri, deri edhe dhunë barbare, duke ua prerë kokat edhe vetë Muhamedi, kur nuk pranoin të konvertoheshin.

Ai ta zbret ty librin, me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin. [3:3]

Sigurisht, shumica e myslimanëve nuk e dinë këtë ajet. Megjithatë, problematike bëhet kur nuk dihet për cilin variant të *Tevratit* dhe *Ungjillit* e ka fjalën, meqë në ndonjë ajet flitet për falsifikime të tyre.

Besimtarët të mos i miqësojnë jobesimtarët, e t'i lënë anash besimtarët. E kush e bën atë, ai nuk ka asgjë nga feja e Allahut, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej së keqes së tyre. Allahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek Allahu është e ardhmja. ” [3:28]

Thirrje që vetëm fesë, e cila pretendon të jetë hyjnore, nuk i shkon! Sa banale tingëllon taktika, kur arsyetohet miqësimi vetëm në raste kur jobesimtarët janë më të fortë. Ky lloj përcaktimi i lejon myslimanët të përdorin dhunë, sapo të konstatojnë se dalin fitimtarë.

E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim, tha: "Kush janë ndihmësit e mi për në rrugën e Allahut?" Havarijunët thanë: "Ne jemi ndihmësit e fesë së Allahut, ne i besuam Allahut, e ti dëshmo për ne se jemi myslimanë!" [3:52]

Një shaka e hidhur, që nxit kristianët për të mbrojtur kryeprofetin e tyre, Jezusin, të cilin e ka paraqitur mashtrueshëm Paulusi (Pali), i cili e sajoi kristianizmin si fe më vete.

E, ata i kurdisën një dredhi. Allahu iu kundërvu dredhisë së tyre. Allahu është asgjësuesi më i fuqishëm kundër atyre që bëjnë dredhi. [3:54]

Kujt t'i besohet? Pastaj, a duhet që ai krim ordiner ndaj Jezusit (nëse vërtet ka ndodhur), të shpërdorohen në përmasa kaq botërore, për të armiqësuar besimtarë të feve përkatëse përgjatë kaq shumë shekujve. Ai krim është shpërdoruar tmerrësisht për të armiqësuar çifutët e kristianët. Tashmë edhe Muhamedi tallet me atë fatkeqësi, duke e kapitalizuar për muhamedanizmin e tij.

O ithtarë të librit, pse po polemizoni me ne rreth Ibrahimit? E, nuk janë shpallur as Tevratit as Inxhilit, vetëm se pas tij?! A nuk e kuptoni? [3:65]

Uroj të ketë ndonjë lexues që di ta konkretizojë këtë formulim ka-kofonik *a la* Muhamed! Polemikë fare e përçartë! Dëshmohej se synim kryesor ka qenë të thuhet sa më shumë kundër çifutëve!

Në të vërtetë, një grup prej tyre janë ata që pëshjellojnë gjuhët e tyre kur lexojnë librin, ashtu që ju të mendoni se ajo është nga libri, po ajo nuk është nga libri, madje thonë: "Kjo është nga Allahu!" Po ajo nuk është nga Allahu. Ata duke ditur thonë gënjeshtër për Allahun. [3:78]

Edhe një (dis)kualifikim polemizues *a la* Muhamed, në shërbim të nxitjes së armiqësisë së myslimanëve kundër çifutëve.

A mos kërkojnë ata fe, pos fesë së shpallur nga Allahu? E Atij i është dorëzuar gjithçka ka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje dhe tek Ai kthehen. [3:83]

Pra, çifutët nuk duhet ta besojnë zotin e tyre, as doktrinën që përmban *Toraha* e tyre, por ato që "ka zbritur" vetëm Allahu mysliman.

Ndoshta mund të keqkuptohet fjalia “Atij i është dorëzuar gjithçka ka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje”, se kanë ekzistuar para Allahut, por ja që i janë dorëzuar! Pra, sikur rezulton se nuk i ka krijuar zoti, por vetëm i ka detyruar t’i dorëzohen.

Thuaj: "Ne i kemi besuar Allahut, edhe asaj që na u zbrit, edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Isakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që u është zbritur të gjithë pejgamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar." [3:84]

Sa për të qeshur! E kush e thotë se? Muhamedi, i cili me qindra herë ka thënë të kundërtën. Si nuk qenkësh lodhur zoti "duke zbritur" ato dogma!

Një palë nga çifutët është që ndryshojnë fjalët. Ata thonë: "Dëgjuam dhe kundërshtuam". Ju përgjigjuni: "Dëgjo, mos dëgjofsh: "Raina" duke përdredhur gjuhët e tyre dhe duke atakuar fenë. E sikur të thoshin ata: "Dëgjuam, respekto, dëgjo dhe na vështro", do të ishte më mirë për ta dhe më e drejtë, por për shkak të refuzimit të tyre, Allahu i mallkoi, prandaj besojnë vetëm pak. [4:46]

Tepër e ngatërruar për të qenë profetike, hyjnore e universale. Armiqësimi kundër çifutëve e ka shtyrë Muhamedin për të prodhuar formulime edhe kaq të përcarta, pasi është mbizotëruar nga urrejtja.

O ju që besuat, mos i zini miq jobesimtarët e t'i lini anash besimtarët! A doni t'i sillni Allahut argument të qartë kundër vetes! [4:144]*

Thirrje e stërpërsëritur, që nuk meriton as të komentohet, por të urohet: u harroftë sa më shpejt kjo thirrje irracionale!

*O ju që besuat, besoni vazhdimisht Allahut, të dërguarit të Tij, librit që gradua-
lisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pati zbritur më parë. Kush nuk i*

* Jobesimtarë kategorizoheshin të gjithë jo-muslimanët, meqë atëherë nuk duhet të kishte jobesimtarë, gjegjësisht jo-fetarë, në kuptimin eksplicit të fjalës. Ndërsa besimtarë, në gjithë Kuranin, karakterizoheshin vetë muslimanët.

ISLAMI, religion agresiv (?!)

beson Allahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg. [4:136]

Një dëshmi se *Kurani* "është shpallu" gradualisht dhe jo si tërësi, siç thuhet në shumë ajete. Por, kur Muhamedi ose dikush tjetër e ka sajuar këtë ajet, nuk kishte përfunduar "shpallja" e ajeteve (i fundit, siç dezinformohet, "është shpallur" nëntë ditë para vdekjes së Muhamedit), prandaj ende nuk mund të flitej për "libër". Mbase e kanë formuluar ata të komisionit të kalifit Utman (rreth 20 vjet pas vdekjes së Muhamedit). Nuk rezulton serioz përcaktimi për të respektuar "libra" të tjerë, meqë vërtetësia e tyre kontestohet, besimtarët e tyre diskualifikohen, denigrohen e luftohen.

Të tillë janë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët. [4:151]

Kërcënim inkriminues kundër "jobesimtarëve" (jomyslimanëve, që e diskrediton Muhamedin si njeri me mendësi edhe fashistoide!

Ihtarët e librit kërkojnë prej teje t'u sjellësh një libër nga qielli. Po ata patën kërkuar prej Musait edhe më tepër e i patën thënë: "Na dëfto Zotin sheshas e për shkak të mizorisë së tyre i kapi rrufeja. Mandej edhe pasi atyre iu shfaqën mrekulli të qarta, ata adhuruan viçin. Ne ua patëm falur atë faj, e Musait i dhamë argumente të forta." [4:153]

Nga ky ajet vetëkuptohet se Muhamedi, i vetëdijshëm që po mashtron me sajimet që bën me përkrahësit e tij, sajon kësi ajeti polemizuese për të kamufluar mashtrimin e tij. Për izraelitët paganë, që nuk iu besuan sajësive të Abrahamit dhe Mozës, Muhamedi ironizon se ata kanë besuar viçin, por ndoshta Muhamedi nuk e di se surja e dytë është emërtuar "Mëshjtjerë" (motra e viçit), se emërtimet e sureve duhet t'i kenë bërë "redaktorët" e mëvonshëm...

Ne ngritëm mbi ta Turin se ishin zotuar. U patëm thënë: "Hyni në derë të përulur",

dhe u patëm thënë: "Mos e thyeni të shtunën". Ashtu Ne patëm marrë prej tyre besë të fortë. [4:154]

Dhe për shkak të thyerjes së besës së dhënë, të mohimit të ajeteve të Allahut, të mbytjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejte dhe thënies së tyre: "Zemrat tona janë të mbuluara". Jo, por për shkak të mohimit të tyre Allahu ua vulosi ato, e nuk besojnë prej tyre vetëm pakkush. [4:155]

Edhe për shkak të mosbesimit dhe të thënies së tyre shpifëse kundër Merjemes; [4:156]

Madje për shkak të thënies së tyre: "Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut". Por ata as nuk e mbytën, as nuk e kryqëzuan në gozhdë, por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth tij, janë në dilemë për të e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveçse krijojnë iluzione. E ata me siguri nuk e mbytën atë. [4:157]

Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i plotfuqishëm, i dijshtëm. [4:158]

Vazhdohet me broçkullat polemizuese kundër çifutëve, deri edhe të kontestimi se Jezusi nuk është kryqëzuar. Sigurisht, kristianët duhet të ndihen tepër keq nga këto trille blasfemike të Muhamedit! Vetëm një mendësi bastarde mund të shpifte kaq barbarisht!

Madje, për shkak të zullumit që bënë hebrenjtë, Ne ua ndaluar atyre disa ushqime të shijshme, të cilat ishin të lejueshme për ta dhe për shkak se i zmbrafsen shumë njerëz nga udha e Perëndisë. [4:160]

Merre me mend arsyen pse ua paskëshin ndaluar atyre mishin e dërrit: hakmarrje për zullumin që paskëshin bërë dhe pse kanë rezistuar ndaj monotoizmit. Ky formulim nuk ngjan me ca të tjerë, për të cilët mund të thuhet se janë të “analfabetit” Muhamed.

Edhe për shkak të marrjes së kamatës, edhe pse e kishin të ndaluar atë, dhe ngrënies së pasurisë së njerëzve në mënyrë të padrejtë. Ne kemi përgatitur dënim të mundimshëm për ata që nuk besuan prej tyre. [4:161]

Tani Muhamedi sikur ndihet epror edhe i çifutëve dhe do t'i rreshtojë edhe ata, siç i rreshtoi muhamedanët e tij. Madje edhe moralizon

dhe duke filluar nga viti 623 organizon bandat e tij për të plaçkitur karvanët që udhëtonin nga Damasku për në Mekë dhe anasjelltas; organizon sulme për të plaçkitur fiset arabe të besimeve pagane e hebre; rrëmben gra e fëmijë, i përdhunojnë e i shesin si skllevër...

Sa fatkeq janë besimtarët e doktrinave mashtruese e inkriminuese abrahamike!

Ne të frymëzuar ty (Muhamed) me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe pejgamberët pas tij; e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismajlin, Isakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin e Davudit i patëm dhënë Zeburin. [4:163]

Përmbajtje (dez)informuese dhe e stërpërsëritur. Duhet të kihet mirëkuptim për përsëritjet e stërpërsëritura, meqë me këto formulime janë marrë individë analfabetë e gjysmanalfabet, të cilët nuk kishin kushte teknike për t'i shkruar e sistemuar formulimet e tyre.

O ithtarët e librit, mos e teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesih Isai, biri i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjala e Tij që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë nga Ai. Besojeni pra Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: "Tre". Pushoni, se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Çfarë ka në qiej dhe çfarë ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur. [4:171]

Muhamedi sikur nuk është i vetëdijshëm se edhe kristianët kanë një *Ungjill* të pareformueshëm, prandaj për t'ua mbushur mendjen besimtarëve të tij, i këshillon e qorton ata kot së koti. Sigurisht, kjo është tepër irrituese për besimtarët kristianë dhe prandaj duhet t'u ketë shërbyer klerikëve për të nxitur armiqësi kundër islamit. Ndërsa mbarsja e Marisë (Mejremes) me urdhër të zotit, "bëhu!", është një shaka, që i besojnë vetëm besimtarët trutredhur.

O ithtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Ynë, që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk ju jep sqarime. Juve ju erdhi nga Allahu dritë

dhe libër i qartë. [5:15]

Sërish presion ndaj çifutëve, sërish përmbajtje e përcartë.

*E mohuan të vërtetën ata që thanë se: "Zot është ai, Mesihu, biri i Merjemes".
Thuaju: "Nëse dëshiron Allahu ta shkatërrojë Mesihun, birin e Merjemes, nënën
e tij dhe gjithçka në tokë, kush mund ta pengojë atë? "...[5:17]*

Sërish ironizime polemizuese kundër fesë kristiane...

*Çifutët dhe të krishterët thanë: "Ne jemi bijtë e Allahut dhe të dashurit e Tij".
Thuaju: "E pse pra Ai ju dënon për mëkatet tuaja?"... [5:18]*

Muhamedi sikur nuk e ka kuptuar kur bëhet i bezdisshëm me përsëritje të stërpërsëritshme, duke e ngarkuar doktrinën me urrejtje kundër feve pararendëse!

O ihtarë të librit, ju erdhi i dërguari Ynë, ju sqaron pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi as i dërguar që të na përgëzojë, e as që të na tërheqë vërejtjen". Pra, ja, ju erdhi përgëzuesi dhe kërcënuesi. Allahu është fuqplotë për çdo send. [5:19]

Sërish çifutëve iu bëhet presion, madje tashmë paralajmërohen për Muhamedin "përgëzues" dhe "kërcënues". Ekspliciti Muhamed duhet ta ketë sajuar këtë ajet në prag të vendimmarrjes për t'i sulmuar me banda xhihadiste fiset e çifutëve.

Përkujto kur Musai i tha popullit të vet: "O popull im, përkujtojeni dhuratën e Allahut ndaj jush, kur në mesin tuaj dërgoi pejgamberë, e ju mundësoi të jeni sundues dhe ju dha çka nuk i dha askujt nga popujt". [5:20]

Moisiu duhet të ketë qenë modeli kryesor për Muhamedin, i cili izraelitët i shpalli popull i përzgjedhur nga zoti i tij Jhv (Jehova), për të sunduar botën. Edhe Muhamedi shpalli gjuhën dhe popullin arab të

përzgjedhur nga Allahu i tij, për të sunduar botën. Patjetër, konfrontimi i përhershëm mes këtyre dy popujve, pasi secili prej tyre është përzgjedhur për të sunduar krejt botën.

Dy burra, prej atyre që Allahu i kishte pajisur me bindje dhe kishin frikën e Tij, thanë: "Futuni atyre nga dera, e kur të hyni nga ajo, atëherë ju jeni ngadhënjyes. Dhe vetëm tek Allahu mbështetuni, nëse jeni besimtarë të sigurtë". [5:23]

Ata thanë: "O Musa, ne kurrë nuk hymë në të derisa ata janë aty, shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu!" [5:24]

Tha: "Zoti im! Unë nuk kam në dorë pos vetes sime dhe as vëllai im; na ndaj neve prej popullit të fëlliqtë." [5:25]

Broçkulla që argëtojnë vetëm besimtarët trutredhur! Merre me mend çfarë i mvësh formuluesi i ajetit 5:25 Mozës, sikur populli izraelit është popull i fëlliqtë. Pak është të thuhet e padinjitetshme për *Kuranin* të përmbajë të tillë ofendim kolektiv!

Tha: "Ajo është e ndaluar për ta dzyzet vjet. Do të sillen nëpër tokë. Ti mos u shqetëso për popullin e shfrenuar." [5:26]

No comment! Një spekulim shovinist a la Muhamed!

Lexoju (Muhamed) atyre ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan kurbane, nga të cilët njërit iu pranua. Ai tha: "Unë do të të mbys ty" (Kabili i tha Habilit). E ai tha: "Allahu pranon vetëm prej të sigurtëve" [5:27]

Legjendë aspak argëtuese! Kur Allahu nuk paskësh pasur mundësi, kohë ose dëshirë për të drejtuar vetëm një vëllazëri (fëmijët e Adamit e të Evës), pse atëherë qenkësh angazhuar pastaj, duke ngarkuar aq shumë "profetë", që secili në mënyrën e tij të udhëheqë njerëzimin?! Pastaj, kishte harruar zoti se Muhamedi i ishte përgjigjur Xhibrililit se nuk dinte të lexonte, kur ai i kishte ofruar ajetin e parë "Ikra" (surja nr. 96) që ta lexonte?! Broçkulla muhamedane!

Atëherë epshi i tij e bindi atë për mbytjen e të vëllait dhe e mbyti atë. Ai mbeti prej

më të dëshpëruarve...[5:30]

Allahu dërgoi një sorrë, e cila hapte gropën dhe për t'i treguar atij se si ta mbulonte trupin e vëllait. E ai i tha: "I mjeri unë, a nuk qeshë i aftë të bëhem si kjo sorrë e ta mbuloja trupin e vëllait tim?" Ashtu mbeti i penduar. [5:31]

E tmerrshme çfarë fillese dëshpëruese i kanë ofruar dogmat fetare abrahamike njerëzimit! Duke pas një glob të tërë në dispozicion, pa asnjë konkurrencë e kërcënim nga njerëz të tjerë, fëmijët e Adamit dhe Evës vriten mes tyre. Nuk paskësh ditur as ta varrosë vëllanë, por e mësoi sorra! Fatkeq dhe të mjerë janë ata që u besojnë këtyre dogmave ogurzeza edhe në shekullin 21!

Për këtë Ne u shpallëm bijve izraelitë, se kush mbyti një njeri, nëse ai nuk ka mbytur ndonjë tjetër dhe pa bërë ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall, është si t'i kishte ngjallur të gjithë njerëzit. Atyre u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij shumë prej tyre e teprojnë në këtë tokë. [5:32]

Përcaktime kuturu *a la* Muhamed, ose të ndonjë misionari çifut akristian, që e këshillonte Muhamedin (sepse për diçka të tillë përflitej në Mekë).

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është tjetër vetëm se të mbyten, të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, por edhe të dëbohen nga vendi. Kjo është poshtërim për ta në Dynja dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh. [5:33]

Muhamedi duhet të ketë qenë në vllugun e luftimeve kundër jomyslimanëve, prandaj e ka ashpërsuar kaq shumë përcaktimin e tij. Tashmë ai duhet të ketë vendosur të bëhet sundimtar dhe të përhapë islamin gjithsesi, qoftë edhe me krime kaq monstruoze që ua përcakton xhihadistëve të tij si praktikë veprimi. Ai dhe pakica e individëve që e ndiqte prapa nuk kishin asnjë lloj legjitimiteti të mbështetur në ndonjë arsye racionale ose drejtësi njerëzore. Askush

nuk e luftonte dhe e kundërshtonte as Allahun muhamedan, sepse ai (si personazh virtual) nuk mund të luftohej konkretisht, meqë i krijuari nuk mund të luftojë krijuesin (sipas mendësisë abrahamike). Dhe jo vetëm kaq! Askush nuk e luftonte as Muhamedin. Vetë Muhamedi ishte ai që i kishte provokuar të tjerët, besimtarët me shumicë pagane dhe besimtarët me pakicë çifute dhe kristiane, fillimisht me predikim provokues të një feje të re, pastaj me pretendimet për uzurpim të Qabesë pagane e, akoma më konkretisht, me sulme plaçkitëse ndaj karvanëve dhe sulme luftarake ndaj fiseve jomyslimane. E shumta, të sulmuarit mbroheshin nga agresioni muhamedan. Kushdo që mashtron se islami është fe paqësore, mund të kundërshtohet edhe me përcaktimet kaq kriminale të këtij ajeti.

Përveç atyre që janë penduar para se t'i kapni. E dijeni, pra, se Allahu bën falje të madhe, është mëshirues. [5:34]

Patjetër, sikur Muhamedi të shfaqte zemërgjerësi njerëzore, por është fjala vetëm për ata që shprehin gatishmërinë për konvertim në islam, nga frika se do të zhduken fizikisht, do të dëbohen e do të plaçkiten, do të zihen robër e do t'u dhunohen gratë e vajzat...

Atyre që mohuan, edhe sikur të ishte e tyre e gjithë ajo që është në tokë, edhe një herë aq për të dhënë shpagim nga dënimi i ditës së kiametit, nuk u pranohet. Ata kanë dënim të dhembshëm. [5:36]

Ata përpiqen të dalin nga zjarri, por nuk dalin dot nga ai, ata kanë dënim të përhershëm. [5:37]

Kërcënim i Muhamedit kundër jomyslimanëve, të cilët i rezistonin konvertimin në islam.

Ne e zbritëm Tevratin (Besëlidhjen e Vjetër), në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij, gjykuan ndaj atyre që ishin jehudinj, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij. Prandaj mos u frikësoni nga njerëzit, vetëm Mua të më frikësoheni dhe mos i ndërroni argumentet e Mia për

pak sende. E kush nuk gjykon me atë që e zbriti Allahu, ata janë mohues. [5:44]

Një demagogji *a la* Muhamed, për periudhë të shkurtër kohore, e formuluar përqart. Për cilin *Tevrat (Toraha)* e kishte fjalën Muhamedi, për një *Torahë* fiktive, që na "ishte zbritur" dikur, por që qenkësh humbur. Ndërsa ajo që po e praktikonin çifutët në kohë e hapësirë qenkësh e falsifikuar, thoshte Muhamedi atëherë e thonë edhe tani klerikët muhamedanë. Përndryshe pse e kishte të nevojshme Muhamedi të lodhej duke sajuar një doktrinë të re, ose të lodhej duke pritur "zbritjet" gjatë 22 viteve?! Atij do t'i mjaftonte të gjente *Torahën* origjinale, në të cilën ishte "udhëzimi i drejtë dhe drita", ose t'ia kërkonte Allahut një kopje, nëse nuk mund ta gjente. Vetëm me besimtarët trushpërlarë mund të tallej Muhamedi (po tallet edhe tani) me të tillë demagogji, e sajuar si metodikë efektive për mashtrim.

Ne edhe ty ta zbritëm librin e vërtetë, që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre. Gjyko pra, mes tyre me atë që Allahu e zbriti, e mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program. Sikur të donte Allahu, do t'ju bënte një popull, por deshi t'ju sprovovë në atë që ua dha juve, ndaj përpiquni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu, e Ai do t'ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit. [5:48]

Sërish më duhet të bëj një sqarim. Është naive të përsëritet gënjeshtër: "ta zbritëm librin", sepse në kohën e sajimit të këtij ajeti nuk kishte ndodhur kompletimi i *Kuranit*, e lëre më të kishte format të përmbledhur të "librit". Është demagogjike të thuhet se ky "libër i vërtetë" (*Kurani*) po vërtetonte "librat" pararendës, sepse, siç kam sqaruar dhe do të sqaroj herë pas here, sa herë që më duhet të shqyrtoj të tilla mashtrime, sipas mashtruesit Muhamed, "librat" origjinale kishin humbur, kurse ata që po praktikoheshin nga besimtarët e tyre ishin të falsifikuar e të tjetërsuar, siç shpifte Muhamedi.

Që edhe ti të gjykos me atë që të zbriti Allahu, mos ndiq dëshirat e tyre dhe ruaju

ISLAMI, religion agresiv (?!)

nga rreziku i tyre, që të mos të shmangin nga një pjesë e asaj që ta zbriti Allahu. Nëse ata refuzojnë, dije se Allahu ka për qëllim t'i ndëshkojë për disa mëkate të tyre. Në të vërtetë, një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës. [5:49]

Ajo që komentova për ajetin pararendës po vërtetohet me përmbajtjen e këtij ajeti. Pra, tashmë, zoti gjoja i tërheq vërejtjen Muhamedit që të ketë kujdes, që të mos e mashtrojë çifutët dhe kristianët, të cilët u besonin “librave” të tyre të falsifikuar. Në fjalinë e fundit Muhamedi bën konstatimin dëshpërues: “*Në të vërtetë, një shumicë e njerëzve janë jashtë rrugës*”. Por, për cilën shumicë është fjala? Deri në momentin kur po e sajonte këtë ajet, “një shumicë” ishte pothuajse e gjithë popullsia e Mekës dhe e Medinës me rrethinat, ndërsa muhamedanë ishin vetëm disa qindra veta.

O ju që besuat! Mos zini miq as çifutët e as të krishterët. Ata janë miq të njëritjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është njëri prej tyre. Vërtet Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Thirrje tipike muhamedane, aspak njerëzore, as profetike e hyjnore. Kjo thirrje kundërshton përcaktimet në ajetet e mëhershme, për ekzistencën e besimtarëve të mirë të “librave” (*Tevratit, Ungjillit* etj.), sepse këtu i (dis)kualifikon si bashkësi gjithëpërfshirëse, me pjesëtarët e të cilave myslimanët nuk guxojnë të miqësohen, përndryshe do të (dis)kualifikoheshin njësoj. Madje, tashmë populli izraelit i besimit jehudi (dis)kualifikohet si “popull zullumqar”, i cili, sipas porosisë (në fakt amanetit, që ka më shumë fuqi se porosia) që la Muhamedi pak para vdekjes: “Të gjithë hebrenjtë duhet të dëbohen nga Gadishulli Arab”.

O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën, atëherë nuk e ke kryer detyrën. Allahu të garanton mbrojtjen prej armiqve. Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon. [5:67]

Sërish një pasaktësi *a la* Muhamed lidhur me “zbritjen”. Muhamedi duket se ka hetuar se muhamedanët e tij po ngurrnin të propagandonin doktrinën e udhëheqësit të tyre, meqë kundërshtitë e banorëve vendas ishin të mëdha, prandaj duhej t’i motivonte e kërcënonte përmes këtij ajeti. Duket se çifutët po kundërshtonin në mënyrë aktive, prandaj përsëritet edhe një herë (dhe shumë herë) diskualifikimi kërcënues kolektiv si “popull”.

Thuaj: "O ithtarë të librit, ju nuk jeni asgjë derisa të mos zbatoni Tëvratin, Inxhilin dhe atë që ju zbriti Zoti juaj. E kjo që t’u zbrit ty nga Zoti yt, do të shtojë te shumica prej tyre rezistencë e mohim. Po ti mos u keqëso me popullin që nuk beson". [5:68]

Sërish demagogji kontroverse, ndoshta i zënë ngushtë gjatë debateve me besimtarë çifutë e kristianë. Në një ajet që shqyrtoam më herët ishte thirrja eksplicite, që myslimanët të mos miqësoheshin me çifutë e kristianë. Kurse tani taktizon sikur ata paskëshin *Tëvrat* e *Inxhil* të vërtetë, por nuk po e zbatojnë. Ndërsa “rezistenca e mohimit” është konfuze, sepse pse do të duhej që ata besimtarë të besonin në “librin” e ri, kur kishin “librat” e tyre (*Tëvratin* dhe *Inxhilin*), "të zbritur" nga i njëjti zot abrahamik. Edhe porosia, “*ti mos u keqëso me popullin që nuk beson*”, duhet të jetë menduar vetëm si e përkohshme, derisa të forcoheshin bandat muhamedane të organizuara. Pra, është fjala për besimtarë çifutë, të cilët sërish (dis)kualifikohet kolektivisht si “popull që nuk beson”. As edhe një zot abrahamik, të cilit i atribuohen gjithë ato mirësi, nuk i shkon të bëjë porosi kaq diskriminuese e shoviniste!

S’ka dyshim se kush e beson Allahun, e beson ditën e gjykimit dhe bën vepra të mira, qoftë prej atyre që besuan, prej çifutëve, prej sabinëve, prej të krishterëve, për ta nuk do të ketë frikë e pikëllim.” [5:69]

Sërish përcaktim më tolerant. Siç do të trajtohet në një kapitull më vete, nuk është vetëm Muhamedi që ka formuluar ajete. As nga këto që u dedikohen qëndrimeve ndaj çifutëve, kristianëve e sabinëve. Ja, pra, çfarë taktike pragmatike: krejt lufta që ndodhte, në kohë dhe

hapësirë të jetës së Muhamedit, bëhej vetëm që të imponohej Muhamedi si “i dërguar”.

Ne patëm marrë besë prej izraelitëve, atyre u dërguam pejgamberë, por sa herë që u erdhi atyre ndonjë pejgamber që nuk u pëlqeu epsheve të tyre, disa prej tyre i përgënjeshtruan, kurse disa të tjerë i mbytën. [5:70]

Edhe pse është ajet i radhës (sigurisht, sipas atyre që e kanë redaktuar), nuk ka asnjë vazhdimësi në tematikë me ajetin pararendës. Për cilën besë është fjala, vetëm Muhamedi e merr vesh. Mos ndoshta është fjala për besimtarë çifutë të Medinës, të cilët kishin bërë marrëveshje (623) me fise pagane dhe me bashkësinë e vockël muhamedane, për bashkëjetesë paqësore në Medinë e rrethinat e saj. Tashmë izraelitët po diskualifikohen si njerëz që mbisundohen nga epsheet dhe jo nga arsyeja për t’u shkuar mbrapa “profetëve”. Madje, Muhamedi (ose ndonjë formulues tjetër), fajëson kolektivisht izraelitët, se kanë mbytur profetët e tyre.

Ata menduan se nuk do të kenë telashe, mirëpo ashtu u verbuan dhe u shurdhuan. Pastaj Allahu ua pranoi pendimin. Mirëpo më vonë, shumë prej tyre mbetën të verbër e të shurdhër. Allahu di për atë që punuan. [5:71]

Sado përmbajtje e dhimbshme, të bën të qeshësh me mënyrën naive të formulimit. Po rezulton sikur zoti i paskësh verbuar të gjithë izraelitët se i paskëshin mbytur profetët e tyre! Nuk kam informacion se cilin profet të tyre kanë mbytur izraelitët, por nëse kanë qenë “profetë” si Muhamedi, e kanë merituar! Megjithatë, Muhamedi ose formuluesi i ajetit nuk e ka merakun se ata kanë mbytur “profetët”, hallin e kanë të propaganda “argumentuese”, që të bëhet sa më ndikuese dhe të paralajmërohen muhamedanët e rinj për verbimin që do t’u ndodhte po e mbytën “profetin” e tyre Muhamed...

Mohuan të vërtetën ata që thanë: "Allah është ai, Mesihu, biri i Merjemes". E vetë Mesihu (Isai), tha: "O beniisrailë, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj,

sepse ai që i sajon Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri". Për mizorët nuk ka ndihmës. [5:72]

Gjithashtu, janë mosbesues ata që thanë: "Allahu është i treti i të treve". S'ka në gjithësi tjetër pos një Allahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë, ata që nuk besuan prej tyre do t'i kapë dënim i dhembshëm [5:73]

Sërish polemikë me kristianë, lidhur me përcaktimet e tyre fetare, dhe sërish trille, sikur sajuesi i ajetit 5:72 ka dëgjuar Jezusin duke iu bërë thirrje izraelitëve për t'i besuar "Allahut". Sërish aludimi se kristianët, që e vlerësojnë për zot "birin e Mejremes", janë mizorë që nuk kanë ndihmës. Edhe në ajetin pasues fajësohen kristianët. Por interesante kësaj radhe është mendësia e Muhamedit, se zoti rri në gjithësi dhe atje është i vetëm, pra nuk ka koncept për hapësirë kozmike, ndërsa zoti sikur konkretizohet si konstrukt (trup) konkret.

Mesihu, biri i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë. Që të dy ata ishin që ushqeheshin. Ja si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si ia kthejnë shpinën të vërtetës! [5:75]

Muhamedi ose sajuesit e ajeteve të tilla, pa u lodhur, kanë sajuar ajete që ngjajnë me njëri-tjetrin, rrjedhimisht që janë në konfuzion dhe në kontradiktë mes tyre. Kanë ngjashmëri, sepse janë shumë ajete që trajtojnë këtë tematikë, pothuajse njësoj, kurse konfuzë dhe kontradiktore, sepse herë ashpërsohen e herë zbuten (zh)vlerësimet e (dis)kualifikimet edhe ndaj besimtarëve kristianë, por diçka më butë sesa ndaj besimtarëve çifutë dhe paganë. Për këtë mund të ketë ndikuar xhaxhai i Hatixhesë, gruas së Muhamedit, Varaka, i cili ishte misionar kristian, që kishte ndikim të madh frymëzues te Muhamedi. Madje, ai ia ka mbushur mendjen Muhamedit se është "i dërguar" i zotit, kur është pyetur për të komentuar ëndërrimin e Muhamedit në shpellën e malit Hira (ky Xhibrili duhet t'i ketë komunikuar ajetin e parë "Ikra").

Thuaju: "O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë së vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar

humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë". [5:77]

Kjo thirrje e Muhamedit (ose e hartuesit të këtij ajeti) sërish iu drejtohet besimtarëve kristianë, por tani është goxha i zbutur, meqë luten të mos e teprojnë dhe të mos shkojnë pas popullit izraelit, i cili paskësh humbur "rrugën e drejtë". Por, ama, çfarë pasojash kanë lënë këto përcaktime, që besimtarët myslimanë e kristianë qysh atëherë janë në armiqësi mes tyre.

Ata që mohuan të vërtetën nga beniisrailët, u mallkuan prej gjuhës së Davudit dhe Isait, të birit të Merjemes. Kështu ndodhi, sepse kundërshtuan dhe e tepruan." [5:78]

(Dez)informata koti, të stërpërsëritura, aspak profetike, hyjnore e universale. Duhet kuptuar si prodhim për propagandë të përditshme, për të përvetësuar kristianët që të konvertohen në islam. Mbase më produktive do të kishte qenë që të mos spekulohet me ato çfarë u kanë thënë Davidi dhe Jezusi besimtarëve dhe bashkëbanorëve të tyre. Në logjikën e besimtarëve myslimanë është legjitime që profeti i tyre të diskreditojë e denigrojë besimet e të tjerëve, ndërsa ndonjë kritikë ndaj Muhamedit dhe muhamedanëve nuk duhet ta bëjë askush.

Ishin ata, që nuk ndalonin njëri-tjetrin nga e keqja që punonin. E ajo që bënin ishte e shëmtuar. [5:79]

Sërish diskualifikim i çifutëve dhe izraelitëve, që i ekzalton vetëm besimtarët myslimanë, sepse ata parapëlqejnë këso përsëritjesh kundër jomyslimanëve.

I sheh shumë prej tyre që i miqësojnë ata që mohuan. E keqe është ajo që i përgatitën vetes së tyre, ngase Allahu është i hidhëruar kundër tyre dhe ata përjetësisht janë të dënuar. [5:80]

Formulim goxha i përçartë, por kuptohet, sërish diskualifikohen besimtarët çifutë.

Sikur të ishin ata, që vërtet e besojnë Allahun, pejgamberin dhe atë që i zbriti atij, nuk do t'i zinin për miq ata, por shumica prej tyre janë mëkatarë. [5:81]

Mbase rezulton se sërish diskualifikohen besimtarët e “librave” (çifutët dhe kristianë) për miqësim me arabët paganë.

Gjithçka që ti do të vëresh, se çifutët dhe ata që i përshkruan Zotit shok janë njerëzit me armiqësi të fortë kundër besimtarëve (myslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: "Ne jemi nesara-krishterë". Këtë, ngase prej tyre ka dijetarë dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë. [5:82]

Një kakofoni muhamedane. Sërish përcaktim që duhet të prodhojë qëndrime armiqësore mes besimtarëve, në rastin konkret të myslimanëve kundër hebrenjve dhe kristianëve. Konstatimi tjetër se "nesara-kristianët" na qenkëshin paksa më miq, pa përcaktuar krahasimin se kush janë ata, që janë edhe më pak miq.

Dhe i frymëzova havarijunët: "Të më besoni Mua dhe të dërguarin Tim!" E ata thanë: "Ne besuam, e ti dëshmo se ne jemi myslimanë". [5:111]

Muhamedi e merr vesh për kë bëhet fjalë! Mund të bëhet fjalë për besimtarë “të vërtetë” kristianë e çifutë, të cilët kanë thënë për veten e tyre se janë myslimanë, meqë Muhamedi do ta shtrijë doktrinën e tij fetare deri tek Adami. Në këtë përcaktim ndonjëherë ka dalë qesharak, meqë një herë e ka shpallur veten si myslimanë të parë, herëve të tjera ka shpallur Moisiun, pastaj Abrahamin, por edhe Adamin.

Vërtet, ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm tek Allahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan. [6:159]

Tamam, a thua ka qenë i informuar Muhamedi se ekziston edhe një kësi ajeti dhe prandaj nuk do të duhet t'i bezdiste muhamedanët me (zh)vlerësime e (dis)kualifikime të stërpërsëritura deri në monotoni ndaj çifutëve dhe kristianëve. Pra, meqë Muhamedi nuk ishte përgjegjës për ato që u kishin ndodhur më herët çifutëve dhe kristianëve, nuk kishte pse të merakosej për t'i ndrequr; mbase edhe ai ka qenë i prirë për të drejtuar lesh-arapët...

Po, nëse ata pendohen, e falin namazin dhe e japin zeqatën, atëherë i keni vëllezër në fe. Ne i sqarojmë argumentet për ata njerëz që kuptojnë. [9:11]

Ja, gjithë dërdëllitjet e deritanishme kishin këtë qëllim: të binden, me hir e me pahir, që të konvertohen të gjithë në myslimanë! Çfarë injorance! Nuk e kanë ditur se sa të vështirë e ka njeriu, sidomos i asaj kohe, që të ndërrojë fetë siç ndërron ndërresat e trupit. Megjithatë, i ka rezultuar e suksesshme taktika, sidomos që kur ka filluar të ushtrojë dhunë fashiste për të kushtëzuar jomyslimanët: o konvertim në islam, o zhdukje fizike!

Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë... [9:29]

Thirrje aspak paqësore e njerëzore, sidomos jo të një feje që të kishte dhe ka pretendime që të jetë hyjnore, vizionare, universale. Por, siç do të shihet, praktika e Muhamedit ka qenë akoma më ekstreme e më fashiste se kjo thirrje e tij (ose e ndonjë bashkëveprimtari të tij).

E çifutët thanë: "Uzejri është djali i Allahut", e të krishterët thanë: "Mesihu është djali i Allahut. Ato ishin thënie të tyre me gojët e tyre, që imitojnë thëniet e jobesimtarëve të mëhershëm. Allahu i vraftë nëse largohen! [9:30]

Sërish diskreditim e diskualifikim ndaj çifutëve dhe kristianëve për mendimet e besimet e tyre, duke i mallkuar për bindjen e sajuesit, me

ashpërsinë më të madhe të mundshme. Tashmë duket se Muhamedi i kishte obsesion ata.

Allahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhenet. Luftojnë në rrugën e Allahut, mbysin dhe mbyten. Premtim të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kuran. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se Allahu? Pra, gëzoju tregtisë që e bëtë me Të. Ky është suksezi i madh. [9:111]

Duke mos e kuptuar përmbajtjen, mendova se faji mund të jetë i shqipëruetit Sherif Ahmeti, meqë kam lexuar lavdërime pompoze që i bëhet gjuhës dhe stilit të tekstit zanafillor të *Kuranit* arab. Prandaj po sjell edhe shqipërimin nga Hasan E. Nahi:

Perëndia, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e vet trupin dhe pasurinë e tyre, për t'iu dhuruar xhenetin atyre. Ata luftojnë në rrugën e Perëndisë, vrasin dhe vriten. Premtimi i tij i vërtetë në Teurat, Inxhil dhe Kuran. E kush është më i plotë se Perëndia në premtim? Ndaj, gëzojuni kësaj shitjeje, që e keni kontraktuar me Të, dhe kjo është fitore e madhe.” [9:111]

Sërish rezulton e pakuptueshme, se Allahu, gjegjësisht zoti, duhet të ketë blerë nga besimtarët trupin dhe pasurinë e tyre. Pra, po rezulton një soj tregtie mes zotit dhe njerëzve, rrjedhimisht edhe njëfarë barazimi, sepse në momentin që bëjnë tregti, shitësi dhe blerësi barazohen. Pra, zoti po shet xhenetin, ndërsa njerëzit trupin dhe pasurinë e tyre (për të cilat në ajete të tjera thuhet se janë rob dhe pasuri e zotit). Edhe formulimi i mëtejshëm rezulton të jetë i përçartë, ose unë nuk jam i kualifikuar për të kuptuar “filozofinë” e “analfabetit” Muhamed.

Vetëm zoti nuk është autor i këtyre pështjellimeve e pazareve, siç rezulton edhe nga formulimi.

Pse nuk pati vendbanim, që të ketë besuar e besimi i tij të ketë ndihmuar, pos popullit të Junusit, që pasi besoi, Ne larguam prej tyre dënimin shëmtues në jetën e kësaj bote dhe i lejuam të jetojnë deri në një afat të caktuar. [10:98]

Sërish formulim i përçartë. Sigurisht, duhet t'i jetë dedikuar popullit të ndonjë profeti, prandaj duhet të jetë populli izraelit, sepse të gjithë profetët e sajuar, nga Adami deri te Jezusi, i përkasin asaj popullsie, nëse nuk përfillim falsifikimet që ka sajuar Muhamedi dhe bashkëveprimtarët e tij.

E ai që është në argument nga Zoti i tij dhe atë e përforcon dëshmia nga Ai, e para tij ishte libri i Musait, që ishte udhërrëfyes e mëshirë - Të tillët e besojnë. E kush prej atyre grupeve e refuzuan atë, vendi i tij është zjarri. E ti mos ki dyshim në të: ai është e vërtetë nga Zoti yt, në të s'ka dyshim, por shumica e njerëzve nuk e besojnë." [11:17]

Uroj të ketë lexues që të kuptojë përmbajtjen e përçartë të këtij ajeti. Kjo gjuhë dhe ky stil janë mrekullia vetë, dërdëllisin besimtarët. Megjithatë, sikur vetëkuptohet se flitet për zotin Jehova të Moisiut dhe për zotin Allah të Muhamedit, të cilëve secili profet përkatës u ka dhënë attribute të veçanta, sipas mendësive vetjake që zotëronin "profetët" sajues.

Interesant do të jetë shqyrtimi i sures 12-të, e cila mban titullin "Jusuf", njëri nga profetët kryesorë të besimtarëve hebre, por që e kanë përvetësuar edhe kristianët dhe myslimanët. Fillon me ajetet:

Elif, Lam, Ra. Këto janë ajetet e librit të qartë. Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju. [12:1-2]

A përputhet me realitetin informimi: "Ne e zbritëm këtë Kuran në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju"? Nuk përputhet, sepse kjo është sure mekase e të paktën treçerek të sureve "janë zbritur" gjatë viteve 622-632, prandaj në kohën e sajimit të kësaj sureje nuk ka ekzistuar *Kurani* i kompletuar, në asnjërën nga format e mundshme. Nga kjo rrjedh se autor i kësaj sureje mund të jetë edhe komisioni i kalifit Utman, i formuar "për të redaktuar" *Kuranin*.

Për tematikë kryesore kjo sure (kaptinë) ka legjendën e çifutëve për Jozefin. Po përzgjedh disa nga ajetet, që rrisin dilemat se Muhamedi nuk ka sajuar religjion origjinal, unikat, por një si plagjiaturë të *Besëlidhjes së Vjetër dhe të Re*.

*Ne ty do t'i rrëfejme ngjarjet më të bukura përmes shpalljes së këtij Kurani; e ti, me të vërtetë, këto nuk i ke ditur më parë... [12:3]**

Sikur rezulton se vetëm Muhamedi nuk do të duhej të jetë autor i kësaj sureje. Por nuk përjashtohet mundësia të jetë pikërisht ai, meqë është dëshmuar si mjeshtër i mashtrimeve dhe i imponimeve. Informimi se Muhamedi vërtet nuk i ka ditur më parë këto rrëfime, të nxit dyshimin se është truk i Muhamedit, për të përballuar përfolet e banorëve mekas. Ata tashmë përfllisnin se Muhamedin e mësonte një njeri joarabishtëfolës (pos priftit kristian, Varaka, xhaxha i Hatixhesë).

Legjenda fillon me ajetin:

Kur Jusufi i tha babait të vet: "O babai im! Unë kam ëndërruar njëmbëdhjetë yje, edhe Diellin e Hënë! I pashë se si ato më bënin sexhde (më përulëshin)". [12:4]

Rëndom, vendimmarrjet e mëdha të "profetëve" janë mbështetur në ëndrra. I fundit ka qenë Muhamedi, që ka mundur të imponohet si profet i përmasave botërore, duke e startuar sajësën e fesë së tij mbi ëndërrimin e tij në shpellën e malit Hira, nga e cila rezulton ajeti i parë "Ikra" (lexo / recito), në *Kuranin* "e redaktuar" në suren e 96-të.

Tha: "O biri im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve të tu, që mos të bëjnë ndonjë dredhi. Se, me të vërtetë, djalli është armik i hapur i njeriut. [12:5]

Skandaloze! Vetëm këshillë të tillë nuk do të duhej t'i jepte babai djalit. Nuk është prindërore e njerëzore që babai nxitë njërin nga

* Kësaj radhe po sjell ajete nga shqipërimi që ka bërë Hasan Nahi, sepse më duken si më të qarta.

djemtë, se vëllezërit mund t'i bëjnë dredhi. Mbase sajuesit e kanë filluar legjendën me një dramalizim të tillë, që t'i bëjnë kureshtarë njerëzit që do ta dëgjojnë. Fjalia pasuese është tipike për mendësinë e Muhamedit, për ta gogolizuar sa më shumë djallin, gjithashtu “të prodhuar” nga sajuesit e feve abrahamike.

Dhe kështu, Zoti yt të ka zgjedhur ty dhe të mëson në shpjegimin e ngjarjeve dhe e plotëson dhuntinë e Vet ndaj teje dhe familjes së Jakubit, ashtu siç e ka plotësuar më parë ndaj të parëve të tu, Ibrahimit dhe Isakut... [12:6]

Ja, pra, përmes një ëndrrë lindi edhe një profet (Jozefi). Atij iu sajua edhe prejardhja familjare, meqë të gjithë profetët (semitë), nga Adami deri te Muhamedi, i përkasin së njëjtës familje. Kjo nuk përputhet me legjendat që përmban *Toraha*. Mirë ata që kanë bërë sajime për nevojat dhe interesat e tyre, në kohën dhe hapësirën e tyre, por pse duhet t'u besojnë njerëzit edhe në shekullin 21?!

Në legjendë rrëfëhet përçart dhe pështjellueshëm (*a la* Muhamed), se vërtet vëllezërit e Jozefit u bënë xhelozë e bënë plan si ta mënjanojnë atë. Merre me mend, vëllezërit komplotojnë, duke e mashtruar babanë. E hedhin Jozefin në pus, ku rastësisht e gjen një karvan. Ai e shet atë për pak para. Rastësisht e blen një çift nga Misiri (Egjipti)...

Legjendë e hidhur, e rrëfyer ngatërrueshëm përmes 95 ajeteve (rreth 4500 fjalëve), fare e panevojshme për t'u përfshirë në *Kuran*, për të cilin gënjejhet se është formulim i Allahut muhamedan. Kjo legjendë përfundon me ajetet:

Këto janë lajmet e ngjarjeve të padukshme, të cilat Ne po t'i shpallim ty, e ti nuk ke qenë me ata kur vendosën për punën e tyre, e ata bënë dredhi. E, shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë. [12:102-103]

Ajeti 12:103 sikur reflekton Muhamedin realist, tejet i dëshpëruar, në konstatimet: “*Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë*

besimtarë” dhe “Shumica e tyre nuk e besojnë Perëndinë, por i bëjnë shok Atij” [12:106].

E si të mos ishte i dëshpëruar, kur në Mekë ishte bërë një si *kloshar**, me të cilin talleshin të gjithë banorët (paganë) të qytetit. Gjendjen e tij dëshpëruese ai e paraqet edhe në ajetin:

Dhe kur pejgamberët gati e humbën shpresën dhe menduan se do të shpallen për gënjeshtarë...”[12:110]

Kjo sure përmbillet me ajetin:

Në tregimet e tyre ka këshilla për ata që janë mendarë. Kurani nuk është tregim i trilluar, por ai është vërtetues i atyre që janë shpallur para tij dhe shpjegues i çdo gjëje, dhe udhërrëfyes e mëshirë për popullin besimtar. [12:111]

Nuk meriton komentim, sepse në legjendën që përmban kjo sure nuk mund të gjesh ndonjë këshillë të vyer. Ndoshta vetë konstatimi “*Kurani nuk është tregim i trilluar*”, dëshmon se ai, në fakt, është primitivisht i trilluar. Nëse Muhamedi i vërteton librat pararendës, pse atëherë herëve të tjera i diskualifikon si të falsifikuar?! Madje, më shpesh i denigron dhe u shpallë luftë besimtarëve jehudinj e kristianë, të cilët në më të shpeshtën e herëve i quan jobesimtarë.

Të gjitha fetë abrahamike kanë në bazën e tyre dogmatike edhe trillet e shndërruara në legjenda, se si vëllezërit kanë xhelozuar njëri-tjetrin, janë grindur, kanë komplotuar e vrarë njëri-tjetrin. Të tilla trille nisin qysh me fëmijët e çiftit të parë njerëzor, Adamit e Evës: Kainit, Abelit dhe Setit. E, përderisa vëllezërit nuk mund të kenë mirëkuptim e bashkëjetesë paqësore, atëherë sikur rezulton e vetëkuptueshme se njerëzimi nuk mund të ketë mirëkuptim e bashkëjetesë paqësore, meqë djalli e pamundëson këtë gjë. Dhe kanë të drejtë! Vërtet njerëzimi nuk

* Zhargon në gjuhë franceze, i përhapur në disa gjuhë të botës, për devijantët psikikë, që flenë në trotuare, rrugëve, nën strehë të shtëpive, në shpella...

do të paqësohet, derisa të ketë njerëz me mendësi të fekonduar me këto doktrina kaq armiqësore dhe tepër të dhunshme...

Dhe ashtu, Ne e shpallën atë kushtetutë në arabisht. E nëse ti, pasi të kanë ardhur argumente të qarta shkon pas dëshirave të tyre, nuk ke prej Allahut as ndihmë, as mbrojtje. ” [13:37]

Për shkak se më provokoi karakterizimi i *Kuranit* si kushtetutë, po sjell edhe shqipërimin e Hasan Nahit, nëse edhe ai e ka karakterizuar njësoj.

Ja, kështu, Ne e kemi zbritur Kuranin - ligj në gjuhën arabe. E, nëse ti ndjek dëshirat e tyre, pas njohurisë që të ka ardhur, ti nuk do të kesh as ndihmës, as mbrojtës prej Zotit. ” [13:37]

Për dallimet e mëdha të shqipërimeve kam dhënë alarmin shpeshherë. Do të ishte mirë të kishte interes dikush që është në gjendje të shqyrtonte këtë tematikë, me shpresë që të ndodhë një shqipërim ose përkthim më i saktë. Po sjell edhe një shqipërim nga Feti Mehdiu:

Dhe ne ashtu e kemi shpallur atë urtësi në gjuhën arabe. Por nëse ti pason dëshirat e tyre, pasi të të ketë ardhur dijenia, nuk do të kesh mbrojtës e as ndihmës nga Allahu. ”

Meqë ekziston edhe një shqipërim i katërt, i bërë nga një ekip i angazhuar nga institucioni *Darsalam*, po e sjell për krahasim:

Kështu, Ne e kemi zbritur atë për të qenë gjykues autoritar në arabisht. Sikur të ishte ti që të ndiqje dëshirat e tyre të kota pas dijes që të ka arritur ty, atëherë ti nuk do të kesh as ndonjë mbrojtës dhe as ruajtës a përkrahës kundër Allahut.

Vetë lexuesit le t'i krahasojnë këto katër shqipërime. Sherif Ahmeti e quan kushtetutë, Hasa Nahi e quan ligj, Feti Mehdiu e quan urtësi, ndërsa ekipi e quan gjykues.

Unë disa herë kam shprehur mendimin se *Kurani* është një si kanun beduin muhamedan, siç i kanë quajtur popujt e ndryshëm kanunet e tyre zakonore. Dhe ky kanun i quajtur *Kuran*, i dedikohet kryesisht gjendjes dhe marrëdhënieve në Mekë e Medinë me rrethinat e tyre në shek. VII, si dhe krijimit të një identiteti të ri politik arab.

Pavarësisht ndryshimeve në përkthime, Muhamedi duhet të ketë dëshiruar të formulojë kanun në arabisht, ekskluzivisht për arabët, që duhet të mëvetësohen në një perandori të tyre të fuqishme, gjithësun-duese, kurse ata arabë që vazhdojnë të jenë paganë, çifutë, kristianë, nuk do të jenë arabë të mirë, myslimanë.

Ne dimë shumë mirë se ata thonë: "Ai është kah e mëson një njeri!" Mirëpo gjuha e atij, nga i cili supozojnë ata se është joarabe (e paqartë), e kjo është gjuhë arabe e stilit të lartë e të qartë. [16:103]

Ky ajet dekonspiron kompleksin e Muhamedit, i cili ishte dekonspiruar se po e mësojnë të tjerët, mbase edhe po e shpërdoronin. Pra, edhe vetë ajeti (dez)informon se banorët e Mekës e përfllisnin Muhamedin si të manipuluar. Ndërsa ky, për t'u mbrojtur, sajon ajetin që duhej të përmbante argumentimin kundërshtues. Por ky argumentim rezulton të mos jetë bindës, sepse vetëm fakti se ai që e ka mësuar është joarabishtfolës nuk mjafton, meqë është e mundur që tregtari Muhamed dhe tregtarët e tjerë t'i kenë ditur gjuhët e njëri-tjetrit (edhe pse në atë hapësirë "arabe" vështirë të ketë pasur persona madhorë aktivë, ta zëmë tregtar ose misionar, i cili nuk ka ditur të flasë gjuhën vendase: arabishten. Ndërsa sa i përket përmbajtjes diskriminuese dhe shoviniste ndaj gjuhës joarabe, kjo është njëra nga shtyllat vertebrale të mendësisë nacionaliste të Muhamedit, i cili madhëron vetëm dialektin arab të fisit të tij Kurejsh.

Ai (Isai) tha: "Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë librin dhe më ka bërë Pejgamber. [19:30]

Sërish Muhamedi nuk është përmbajtur pa dërdëllitur për Jezusin. Duket se xhaxhai i Hatixhes, njëherazi edhe kushëri i tij, misionari kristian Varaka Ibn Naufal, duhet t'i ketë folur shumë për fenë kristiane, prandaj ka edhe kaq shumë ajete që përmbajnë qëndrime konfuze, nga ato tolerante deri tek ato fashiste ndaj krishterimit.

Dhe ata që nuk besuan, thanë: "Kjo nuk është gjë tjetër, vetëm se një gënjeshtër që e trilloi ai, të cilit i ndihmuar edhe njerëz të tjerë". Pra, ata bënë shtrembërime e shpifje. [25:4]

Ky ajet përmban pothuajse të gjithë të vërtetën. Dihet truket taktike të mashtruesit kronik. Ai rëndom thotë: "Po më akuzojnë për mashtrues...". Pra, mashtruesi kronik dyshon se secili është, duke e ditur që ai është mashtrues. Sipas kësaj motoje, këtë ajet duhet ta ketë formuluar vetë Muhamedi, meqë është edhe brenda stilit të (dis)kualifikimit të tij ndaj paganëve dhe besimtarëve monoteistë jo-muslimanë.

Edhe thanë: "Janë legjenda të të parëve, që ai kërkoi t'i shkruhen e t'i lexohen atij në mëngjes e mbrëmje. ' [25:5]

Ajo duhet t'i ketë ndodhur gjatë rreth 19 viteve martesë me Hatixhenë, ndoshta edhe më herët, meqë edhe para martesë ishte shërbëtor te Hatixheja. Ajo duhet të jetë furnizuar me literaturë kristiane e çifute nga misionari Varaka dhe duhet ta ketë detyruar Muhamedin e përvuajtur që t'i lexojë ose, nëse vërtet ishte analfabet, ia ka lexuar ajo dhe xhaxhai i saj. Mjedisi i atëhershëm në Mekë, si kryeqendër pelegrinimi për arabët paganë, duhet të ketë qenë i infektuar nga viruset fetare, si preokupim kryesor i njerëzve.

*E ata thanë: "Ç'është me këtë të dërguar, i cili ha ushqim dhe ecën nëpër tregje? Pse të mos i jetë dërguar një engjell së bashku me të, e të jetë qortues?"[25:7]
Ose atij t'i jepet ndonjë thesar apo të ketë ndonjë kopsht, nga i cili do të ushqehet?
Horrat madje thonë: "Ju vetëm jeni duke e ndjekur një njeri që e ka zënë magjia!"*

[25:4]

Shih se çfarë shembujsh të sjellin, ndaj ata janë të humbur dhe nuk mund ta gjejnë rrugën e drejtë. [25:4]

Është i madhëruar Ai, i cili po të dëshirojë, mund të të japë ty edhe më mirë se ç'thonë ata, kopshte në të cilat rrjedhin lumenj, ku ka edhe pallate. [25:4]

Polemikë koti, *a la* Muhamed, e një të përvuajturit nga trajtimi që duhet t'i ketë bërë padronia Hatixhe dhe kushërinjtë e irrituar; Muhamedi nuk duhet të ketë ditur të menaxhojë çlirimin që duhet t'i ketë ndodhur me vdekjen e Hatixhesë (619). Ai zuri t'u vardisej edhe fëmijëve 6-vjeçarë (siç ishte rasti me Aishen, gruas së tij të tretë), madje edhe më të vegjël, pastaj bridhte i pistë nëpër tregje, ku i dhuroheshin ushqime...

A nuk ishte për ata argument, se atë e dinin dijetarët e beniizrailëve? [26:197]

Ky term, “beniizrailëve”, është përzgjedhje e shqipëruesit apo ka qenë tipike për Muhamedin t'i quante izraelitët “bijë të izraelëve”?

Ty mos të të brengosë mosbesimi i atij që nuk beson, kthimi i tyre është vetëm te Ne, e për atë që vepruan, Ne do t'u tregojmë. Allahu vërtet është i dijshtëm për atë që mbajnë në zemra. [31:23]

Sa mirë do të kishte qenë sikur Muhamed t'i përmbahej këtij ajeti! Kjo është një dëshmi e fortë se në *Kuran* ka disa autorësi. Allahu, kup-tohet, nuk është autor! Kurse Muhamedi nuk duhet të ketë qenë i vetmi formulues, përndryshe do të duhej të akuzohej për moral të dyfishtë, për të mos thënë të shumëfishtë.

Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përcani në të. Për idhujtarët është e rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. Allahu veçon për të atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij.” [42:13]

Janë spekulime të karakterit polemik, prandaj edhe nuk mund të dëshmohet. Mbeten vetëm përplasjet mes besimtarëve të religjioneve përkatëse abrahamike, të cilët, edhe pse thirren pothuajse në të njëjtit “zot”, garojnë mes tyre. Sikur nuk i mjaftonin njerëzimit të kësaj hapësire grindjet mes fetarëve jehudinj dhe kristianë, por atyre iu shtuan edhe grindjet e armiqësitë e myslimanëve kundër fetarëve të atyre dy religjioneve (por edhe armiqësitë sektare).

Po ata, vetëm pasi që u erdhi e vërteta, nuk u përçanë për tjetër, por nga zilia mes tyre. E sikur të mos ishte fjala e hershme nga Zoti yt deri në një afat të caktuar, do të kryhej me ta. Nuk ka dyshim se ata që e trashëguan librin prej tyre (prej të parëve) janë në dyshim të thellë ndaj tij (ndaj librave Tevrat e Inxhil). [42:14]

Sërisht (zh)vlerësime e (dis)kualifikime *a la* Muhamed, të cilat vetëm besimtarëve injorantë nuk iu duken të bezdisshme.

E për këtë shkak, ti thirr dhe përqendrohu ashtu si të është urdhëruar dhe mos shko pas dëshirave të tyre dhe thuaj: "Unë kam besuar në librat që i shpalli Allahu, jam urdhëruar të mbaj drejtësi mes jush, Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj. Ne kemi përgjegjësinë e veprave tona e ju të veprave tuaja, nuk ka polemikë mes nesh e jush..." [42:15]

As për këtë ajet nuk duhet të ketë qenë i informuar Muhamedi, përndryshe nuk do të polemizonte me besimtarë jomyslimanë, akoma më shumë nuk do t'i terrorizonte që të konvertoheshin në islam. Po të kishin qenë punë të zotit, të zotit siç e prezantojnë fetë abrahamike, do t'i kishte programuar “krijesat” e tij ose, të paktën, do t'i linte të qetë të jetojnë si munden e dinë, dhe jo t'u dërgonte “libra”, duke futur në garë e armiqësi mes tyre besimtarët e tij.

Ju keni shembullin më të mirë tek Ibrahimimi dhe tek ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuron, pos Allahut; nuk besojnë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapur armiqësia e urrejtja, derisa ta besoni vetëm Një: Allahun!" Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit thënë babait të vet: "Unë do të kërkoj falje për ty, por unë nuk kam në dorë

asgjë për ty tek Allahu!" Zoti ynë, vetëm tek Ti jemi mbështetur, vetëm nga Ti jemi kthyer dhe vetëm te Ti është e ardhmja! [60:4]

Dokrra dogmatike, që kënaqin vetëm besimtarët trushpërlarë. Vërtet nuk mund të quhet hyjnor përcaktimi për armiqtë, derisa të homogjenizohen për të besuar vetëm një zot: o zotin Jehova, o Allahun! Njerëzimi ka qenë fatkeq me sajime të këtyre feve abrahamike, që kanë shkaktuar aq shumë luftëra e tragjedi fetare, aq shumë urrejtje shoviniste e armiqtë.

Gjithë këto ajete që shtjellova në këtë kapitull janë vetëm disa nga 6214 ajete⁴⁴⁶, sa ka gjithsej *Kurani*, që iu dedikohen feve çifute e kristiane, respektivisht besimtarëve çifutë e kristianë. Mbase pak a shumë ia dola të jem i qartë, për të bindur lexuesit se ato përmbajnë qëndrime, zhvlerësime dhe (dis)kualifikime kontroverse, konfuze, kontradiktore, armiqësore, fashistoide. Shpesh ato i karakterizon një formulim i përçartë, i ngatërruar, ndoshta vetëm për shkak të shqipërimeve, por në konfidencë më është sqaruar nga shumë islamologë, se vetë arabologët nuk e kuptojnë tekstin zanafillor të *Kuranit*, pos atyre që janë specializuar për arabishten mesjetare.

Vërtet, ndiej keqardhje pse këto doktrina abrahamike po ia dalin të armiqësojnë besimtarët edhe në shekullin 21. Madje po i armiqësojnë në ato përmasa, sa ato armiqtë po prodhojnë dhunë e terror barbar.

Sot jemi të pafuqishëm për t'i ndërgjegjësuar të armiqësuarit se janë të manipuluar nga doktrinën e tyre dogmatike. Dhe pikërisht pse nuk dis-kreditohen doktrinën fetare abrahamike, por flasim vetëm për ca "ekstremistë" e "fanatikë", po dëshmojmë mjerimin tonë, po dëshmojmë se shumëkujt i duhen të çmohen mashtrueshëm këto dogma si paqësore,

⁴⁴⁶ Numërimi i parë medinas përbëhej nga 6217 ajete; numërimi i dytë medinas nga 6214 apo 6210 ajete. Numërimi mekas: 6220 ajete. Numërimi i Basrës: 6204 ose 6219 ajete dhe numërimi sirian: 6226; varianti i tanishëm kairjot (i vitit 1924): 6214. Më shumë për numërimet pas vdekjes së Muhamedit në Enciklopedinë (digjitale) islame: http://www.eslam.de/begriffe/z/zahl_der_verse.htm.

hyjnore, edhe pse nuk dinë të dallojnë se cili religjion është më barbar se tjetri; secili fetar akuzon fenë tjetër, duke madhëruar të vetën.

Po sjell një dokumentim autoritar për këtë tematikë:

Fetva (ekspertizë) në pyetjen se si Islami i çmon jobesimtarët

Nga eksperti i shquar për ekspertizë juridiko-ligjore dhe predikues i islamit, Muhamed Salih el-Munaxhid,

Instituti i Studimeve Islame, nr. 13. 759, më 31. 08. 2010

Pyetje: Si i vlerëson Islami jobesimtarët?

Përgjigje: ...Islami na ka urdhëruar të jemi të mëshirshëm mes nesh. Ndaj ne duhet të jemi mospërfillës dhe të rreptë ndaj jobesimtarëve. Allahu i përshkruan shokët e Profetit (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!): "Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër kundër jobesimtarëve, megjithatë të mëshirshëm me njëri-tjetrin." [48:29]

Islami na lejon të martohemi me gratë e çifutëve dhe të krishterëve. Megjithatë, ata nuk guxojnë të martohen me gratë tona, meqë hebrejntë dhe të krishterët janë inferiorë për ne e gratë tona janë superiore ndaj tyre. Inferiori nuk duhet të jetë sipër superiorit. Islami është fe superiore. Asgjë nuk mund të jetë mbi islamit. Ne besojmë te profetët e tyre, por ata nuk besojnë te profeti ynë.

Profeti na ka urdhëruar për të dëbuar hebrejntë dhe të krishterët nga Gadishulli Arabik. Ata nuk guxojnë të qëndrojnë këtu, sepse Gadishulli Arabik është vendi i mesazhit. Prandaj ne nuk duhet të lejojmë të ndotim vendin me hebrej e kristianë të fëlliqur. Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) ka thënë: "Dëbojini idhujtarët nga Gadishulli Arabik"⁴⁴⁷.

Islami na e ndalon të hamë nga enët e hebrejve dhe të krishterëve, nëse nuk jemi të detyruar për ta bërë këtë. Në këtë rast, ne duhet t'i lajmë enët me përkushtim. Kur Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) u pyet në lidhje me ushqimin në enët e hebrejve dhe të krishterëve, ai u përgjigj: "Në qoftë se ju gjeni enë të tjera, përdorini ato. Nëse ju nuk mund të gjeni enë të tjera, atëherë hani në to, por lajini paraprakisht me përkushtim".⁴⁴⁸

⁴⁴⁷ Sahih el Buhari 2932 dhe Sahih Muslim 3089.

⁴⁴⁸ El-Buhari 5056 dhe Muslimi 3567.

Islami na e ka ndaluar të vishemi si jobesimtarët apo të hamë e të pimë si ata, sepse ne jemi superiorë, jobesimtarët janë inferiorë. Superiori nuk imiton inferiorin. Profeti i Allahut (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) ua ka premtuar ferrin atyre që imitojnë jobesimtarët: “Kush imiton një popull, ai bëhet si ai.”

Kjo është transmetuar nga Ebu Davudi [3412].

Al-Albani e ka klasifikuar këtë traditë si autentike. Profeti ynë na ka urdhëruar të luftojmë kundër jobesimtarëve, nëse jemi në gjendje për të pushtuar vendet e tyre dhe për t'i vënë ata para zgjedhjeve, para se ne të pushtojmë vendet e tyre: konvertojuni në islam! Nëse konvertohen, ata do të konsiderohen si ne, kanë të drejtat tona; në këtë rast, neve na takojnë pronat, gratë, fëmijët dhe tokat e tyre. Ata myslimanët i çmojnë si pre e luftës...”⁴⁴⁹

Mjerë muhamedanët e kësaj sërë fashiste! Vetëkuptohet se çfarë shteti fashist është shteti që ka këtë kriminel për funksionar të lartë juridik e fetar!

⁴⁴⁹ <http://derprophet.info/inhalt/das-bild-unglaeubigen.htm/>

III. 6. Islami zanafillor - agresiv dhe fashistoid

Urrejtja dhe dhuna ndaj jomyslimanëve janë të sanksionuara në suret e sajuara gjatë viteve të fundit të rrojtjes së Muhamedit dhe janë rrënjësor thellë në kulturën islame. Me zhurmim taktik mashtrues potencohen pjesët paqësore të islamit, por ato janë të shfuqizuara dhe të pavlefshme. Duke mbivlerësuar suret medinase, ky religjion është shpërftyruar përfundimisht në një ideologji terroriste.⁴⁵⁰

Tim W. Thornau

Sa herë që kritikohet terrorizmi i xhihadistëve muhamedanë, myslimanët e politizuar e fundamentalistë vetëmbrohen me thënien: „Islami është fe paqësore...”. Edhe disa personalitete jomyslimane i fajësojnë vetëm myslimanët „ekstremistë”, „fundamentalistë” për terrorizëm, ndërsa për fenë myslimane edhe ata mashtrojnë opinionin: „Islami është fe paqësore”.

I shqetësuar për ofensivën e islamit fashistoid në vendin tonë, por edhe në mesin e emigrantëve shqiptarë (në Zvicër, Gjermani, SHBA...), vitet e fundit u mora me studimin e islamit. Më interesonte të gjeja përgjigjen e pyetjes: „Pse kjo dogmë aktualisht po ia del të indoktrinojë të rinjtë tanë, duke u angazhuar në vepra kriminale e terroriste, si xhihadistë muhamedanë, në luftimet mes sekteve islame, në Siri e Irak, por edhe në aksione të veçuara terroriste në SHBA, Gjermani, Shqipëri, Makedoni, Kosovë?!”

Tashmë jam bindur se vetë dogma fundamentale e fesë islame është tejet joshëse, nxitëse dhe urdhëruese për dhunë agresive e fashistoide, në shërbim të Allahut dhe Muhamedit. Synimi final i dogmës së islamit është myslimanizimi i domosdoshëm i të gjithë njerëzimit!

⁴⁵⁰ Tim W. Thornau: *Gott & Co*, equbli, Berlin, 2013, Seite 196 und 197; http://de.pluspedia.org/wiki/Hass_und_Gewalt_im_Koran#cite_note-25.

Këtë konstatim nuk e kam të bazuar në sulmet terroriste, as në luftimet e tanishme në Siri e Irak, as nga ndonjë paragjykim subjektiv e islamofob, por e kam të bazuar në analizën e doktrinës zanafillore të fesë islame, e sanksionuar në *Kuran*. Edhe hadithet dhe biografia e Muhamedit i përforcojnë përcaktimet për dhunë dhe agresivitet, që përmban dogma fundamentale: *Kurani*.

Pas një kërkimi (elektronik) rezultoi se në tekstin e *Kuranit* fjala „luftë” është përdorur 184 herë (në trajta të ndryshme). I mora me radhë ajetet (*ajetet*) me përmbajtje „luftarake”, dhe tani po paraqes disa prej tyre, duke i shoqëruar me sqarime, interpretime e komente telegrafike.

Për ata që mund të kenë harruar, gjatë shqyrtimit kam përdorur *Kuranin* e shqipëruar nga Sherif Ahmeti, duke e krahasuar ndonjëherë edhe me dy shqipërime të tjera, por edhe me përkthime në gjermanisht e bosniakisht.

Në zemrat e tyre ka sëmundje, pra Zoti ua shton sëmundjen, dhe pësojnë dënim të dhembshëm, për shkak se përgënjeshtronin [surja 2: ajeti 10 / në shënimin vijues vetëm shifra suresh dhe ajetesh]⁴⁵¹

Rëndom, Muhamedi dhe bashkautorët e tjerë kanë sajuar formule të përçarta gjuhësore. Ata duhet të ketë qenë një grupim gjysm-analfabetësh dhe sharlatanësh, të cilët mes injorantëve janë shquar si poetë popullorë.

Qysh në fillim vërehet paqartësia e shprehjes *Në zemrat e tyre ka sëmundje*. Kush ishin ata me *zemra të sëmura*? Në rastin konkret, fjala është për besimtarë politeistë, të cilët, në hapësirat mes Mekës e Medinës ishin shumicë. Bashkësi tjetër fetare ishin arabët e besimit hebre. Kristianë duhet të kenë qenë një numër fare i vogël. Por një kushëri i Muhamedit ishte misionar kristian dhe ndikimi i tij duhet të

⁴⁵¹Cituar sipas *Kuranit* digjital: <http://tanzil.net/#trans/sq.ahmeti/2:10>.

ketë qenë i madh. Ai ishte xhaxhai i Hatixhesë (padrones dhe gruas së parë të Muhamedit). E quanin Vereka ibn Naufal ibn Asad ibn ‘Abd al-‘Uzza ibn al-Kusajj Kureshī (ورقه بن نوفل بن أسد بن عبد العزى بن قصي (القرشي).

Disa islamologë (dez)informojnë se ai e kishte indoktrinu Hatixhenë me kristianizëm, por për shkak të reagimit të fisit, ajo duhet të ketë qenë kriptokristiane. Ata kanë (dez)informuar se Vereka ibn Naufal e furnizonte Hatixhenë me literaturë kristiane dhe filozofi antike. Kjo do të thotë se edhe Muhamedi duhet të jetë frymëzuar nga ajo literaturë, meqë ai nuk ishte thjesht vetëm burri i Hatixhesë, por kishte raporte edhe të skllavit ndaj padrones, edhe të djalit ndaj nënës, sepse ajo ishte rreth 20 vjet më e moshuar.

Muhamedi, si autor i këtij ajeti, përshfaq mendësinë e tij të tjetërsuar në mendësi prej devijanti psikik, prandaj duhet të ketë formuluar atë që ua ka dëshiruar besimtarëve politeistë: zoti t’ua shtojë sëmurdjen e zemrës jo në kuptim fizik, por shpirtëror.

Muhamedi, gjithashtu, i paragjykonte ata kolektivisht si gënjeshtarë, pavarësisht se bëhet fjalë kryesisht për xhaxhallarë e kushërinj, meqë fisi i tij Kurejsh i përkiste besimit pagan, politeist.

E shëmtuar është ajo për çka ata e shitën veten e tyre; atë që e shpalli Zoti të mos e besojnë nga zilia, për shkak se Zoti nga mirësia e Tij t’i shpallë atij që dëshiron nga robërit e vet. Ndaj merituan zemërim mbi zemërim. Jobsimtarët kanë dënim që i poshtëron. [2:90]

Kemi të bëjmë me sajësë mashtruese të Muhamedit, se gjoja zoti e paskësh zgjedhur atë si profet, dhe njerëzit e asaj hapësire nuk e mirëpritën. Surja e dytë është sajuar pas vitit 623, kur Muhamedi kishte filluar ta sundonte Medinën, por banorët e saj ende i rezistonin konvertimin në islamin, që po sajonte Muhamedi.

Përmbajtja duket se shpreh mendësinë e Muhamedit, i cili duhet të ketë qenë i hidhëruar, pse besimtarët politeistë **nuk** e mirëprisnin islamin që po sajonte ai. Duket se njëra nga arsytet e refuzimit ishte

vetë Muhamedi, të cilin nuk e qasnin as xhaxhallarët dhe kushërinjtë e tij. Por kësaj radhe, ai është mjaftuar vetëm me një lloj mallkimi, „zemërim mbi zemërim“, që përmbillet me një përcaktim abstrakt: „Jobesimtarët kanë dënim që i poshtëron“. Pra, nuk dihet kush do t’i dënojë dhe kush do ta ekzekutojë dënimin.

Përrjashtohet fare hyjnorja, kurse formulimi gjuhësor përjashton autorësinë e zotit (edhe si emër fiktiv, por edhe si personazh Allah).

*O besimtarë! Mos thoni: „Ráiná“, por thoni: „Undhurná“, - na shikoni neve dhe dëgjoni! E, për mohuesit ka dënim pikëllues. [2:104]**

Përkthimi në gjermanisht (nga Abu Rida, në *Kuranin* elektronik që ofron portali *tanzil*, i menaxhuar nga instituti islam Azhar në Kajro):

O ihr, die ihr glaubt, sagt nicht: „Achte auf uns!“ sondern sagt: „Schau auf uns!“ und hört. Den Ungläubigen wird eine schmerzliche Strafe zuteil sein. [2:104].

Shprehjet *Raina* dhe *Undhurná* në variantin shqip, në gjermanisht janë përkthyer: *Kujdes ndaj nesh* dhe *na shikoni neve*.

Ky formulim ofron mundësinë e (keq)kuptimit, sikur ata që hezitonin të përfshiheshin në sulmime, shfaqnin merakosje për luftëtarët e përfshirë në betejë, ndërsa Muhamedi i thërriste që të mos merakosen, por të marrin shembull për t’u angazhuar në luftime. Kjo përmbajtje nuk do të dukej krejtësisht muhamedane, po të mos e kishte edhe kërcënimin për jobesimtarë.

O besimtarë! Është porosi për ju ndëshkimi për vrasje: I liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën; e atij që ia fal farefisi i të vvarit, duhet të silllet njerëzishëm dhe le të zbatohet dëmshpërblimi... [2:178]

* Ajetet që shënjohen me * janë cituar nga shqipërimi i Hasan Efendi Nahit.

Një përcaktim që dëshmon karakterin kanunor të *Kuranit*, i përshtatur për fiset beduine. Muhamedi ka përcaktuar normat për hakmarrje.

*Luftoni në rrugën e Zotit - kundër atyre që luftojnë kundër jush, por mos tejkaloni kufirin! - Se Perëndia nuk i do ata që e kalojnë kufirin. [2:190]**

Porosi luftarake, por në fakt, cila është „rruga e zotit“?! Kush e jep këtë urdhër? Allahu apo Muhamedi? Po të urdhëronte zoti, do të duhej të kishim formulimin: *Luftoni në rrugën time...* Pra, rezulton se zoti nuk është as urdhëruesi dhe as autori i këtij ajeti. Autor duhet të jetë Muhamedi ose ndonjëri nga bashkautorët, madje edhe ndonjëri nga ata që e kanë përgatitur *Kuranin* si format libri. Kalifi Utman ibn Afan (644-656), i treti pas Muhamedit, formoi një komision që t'i përmbledhonte ajetet në format libri. Kjo duhet të ketë ndodhur në vitin 651, 19 vjet pas vdekjes së Muhamedit.

Ky ajet është i hershëm, ende pa u kompletuar doktrina islame. Atëherë, besimtarët e parë myslimanë nuk e dinin se cila është „rruga e Allahut“? Kurse *sulmues* janë cilësuar banorët e Mekës, kryesisht arabë paganë, por edhe arabë të besimit hebre e kristian. Ata ndiheshin të rrezikuar nga agresiviteti i Muhamedit dhe i xhihadistëve të tij, sepse Muhamedi kishte vendosur ta uzurponte Qabenë. „Sulmuesit“ ishin kryesisht pjesëtarë të fisit që i përkiste edhe Muhamedi. Ata e kishin Qabenë objekt kulti shekullor të trashëguar. Ata vetëm e mbronin Qabenë e tyre (ku pos arabëve paganë, skulpturat, ikonat, afresket e tyre i kishin vendosur edhe arabët hebrej dhe kristianë). Muhamedi i cilësonte „sulmues“ besimtarët që e kishin pronësi legjitime Qabenë. Kështu ai arsyetonte pretendimet dhe agresionin e tij për të uzurpuar e përvetësuar Qabenë.

Bëhet fjalë për islamin zanafillor që po sajonte Muhamedi dhe, tashmë, vetë ai po angazhohej që ta përhapte, duke praktikuar edhe agresionin, sepse po të mos rezultonte i suksesshëm, nuk do të kishim

fe islame botërore. Një fe merr primat feje vetëm nëse ka mjaftueshëm njerëz që e besojnë. E islami, fatkeqësisht, ia ka dalë të ketë qindra milionë besimtarë.

Ky lloj urdhri për luftim, në këtë ajet, gjithsesi nuk është paqësor e as hyjnor. Besimtarët myslimanë besojnë se Muhamedi kishte të drejtë, meqë Qabeja paskësh qenë myslimane edhe para sajimit të kësaj feje.

*Vritni ata kudo që t'i gjeni dhe dëboni prej vendeve ashtu siç ju dëbuan juve. Se keqpërdorimi është më i rëndë se vrasja. Mos luftoni me ta pranë Mesxhid Haramit! Derisa ata të vriten me ju aty! E, nëse ata luftojnë me ju, atëherë ju vritni ata! I këtu duhet të jetë ndëshkimi për jobesimtarët (politeistët). [2:191]**

Këtë ajet duhet ta ketë sajuar Muhamedi, për të urdhëruar muhamedanët e parë, tashmë të organizuar si xhihadistë (falangë paramilitare). Ata urdhëroheshin ta sulmonin Mekën, për ta uzurpuar Qabenë dhe për t'u hakmarrë për „dëbimin“ e Muhamedit. Në Mekë kishte edhe disa fise arabe, që i besonin doktrinës së Torahës, dhe më pak arabë të besimit kristian (siç ishte Vereka, xhaxhai i Hatixhesë). Përmes këtij ajeti, muhamedanët urdhëroheshin të vrisnin këdo që do ta zinin/hasnin; urdhëroheshin që t'i dëbonin ata, që gjoja e kishin dëbuar Muhamedin dhe besimtarët e tij; urdhëroheshin tashmë të hakmerreshin. Në të vërtetë, Muhamedi dhe besimtarët e tij e kishin dëbuar veten e tyre, me këmbënguljen për të uzurpuar dhe islamizuar Qabenë. Pra, xhihadistët po urdhëroheshin të vrisnin mbrojtësit paganë të Qabesë së tyre pagane.

Siç bëhet e ditur edhe nga rrëfimet e vetë Muhamedit, ai ka ëndërruar për herë të parë ajetin *Ikra* (lexo ose recito), në vitin 610. Ky ajet është radhitur në suren e emërtuar *Al-Alek* dhe është renditur në Kuran nga komisioni „redaktues“ i kalifit Utman me numrin 96. Nga ai moment, ai kishte filluar të sajonte doktrinën dhe praktikën islame. Fillimisht zuri të praktikonte lutjet fetare, i shoqëruar vetëm nga gruaja

e tij, Hatixheja. Besimtarët paganë, të udhëhequr nga xhaxhai i Muhamedit, Ebu Talib, e lejuan të lutej pranë Qabesë.

Pas vdekjes së Hatixhesë, në vitin 619 (ose 620), por më intensivisht në vitet 621-622, Muhamedi kërkoi që të largoheshin skulpturat, afresket dhe ikonat e zotave paganë, për të besuar vetëm në zotin islam. Ata e kundërshtuan dhe filluan ta përndiqnin.

Për dymbëdhjetë vjet me radhë predikim në Mekë, Muhamedi mezi kishte indoktrinuar rreth 140 veta. Fillimisht u konvertuan bashkëshortja e tij, Hatixheja; i dyti ishte Ali ibn Ebu Talib (djali i xhaxhait në moshë 14-vjeçare) dhe i treti, Ebu Bekri.

Meqë i kishte vdekur edhe xhaxhai, Ebu Talib, të cilin Muhamedi e kishte mbrojtësin kryesor, nuk i mbeti rrugëdalje tjetër, pos të arratisëj nga Meka. Dhe mezi ia doli të arratisëj. Më 22 shtator 622, strehohet në Jatriba (ish-emri i Medinës), rreth 440 km larg Mekës. Krejt e pakuptimtë, kjo arratisje e tij është caktuar si viti Një i kalendarit islam (*Hixhra*), edhe pse Muhamedi mashtrioi se zoti e kishte shpallur „të dërguar“ dhe kishte filluar të predikonte fenë e tij qysh në vitin 610.

Në Medinë, Muhamedi ndërhyri në pleqërimin e armiqësive mes të fiseve të atjeshme dhe, kështu, iu rrit autoriteti për të marrë rolin e udhëheqësit. Me atë rast, ai miratoi një marrëveshje mes fiseve, e njohur si Rregullorja e Medinës (viti 623), që karakterizohej për barazinë e fiseve, rrjedhimisht edhe të besimeve të tyre fetare, duke përfshirë si „palë kontraktuese“ edhe muhaxhirët myslimanë, të arratisur nga Meka dhe të strehuar në Medinë. Muhamedi u kritikua nga disa besimtarë të tij për këtë marrëveshje, që përmbante barazinë e besimeve. Ai, prandaj, duhet të jetë detyruar të sajohë ajete, të cilat, si herët e tjera, do të prezantoheshin mashtrueshëm si të „zbritura“ nga Allahu. Këto ajete duhej të arsyetonin barazinë e besimeve fetare:

Thuaj: 'O ju jobesimtarë! [109:1]

Unë nuk adhuroj atë që e adhuron ju! [109:2]

As ju nuk jeni adhurues të Atij që adhuroj unë! [109:3]

Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! [109:4]

Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj! [109:5]

Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time!' [109:6]

Në marrëveshje dhe në këto ajete, Muhamedi shfaqet më tolerant. Ai tashmë respekton edhe besimin pagan të fiseve arabe të Medinës me rrethina, por edhe besimin e arabëve hebrej. Madje për 17 muaj ai caktoi Jerusalemin si epiqendër të shenjtë, kah duhej të drejtoheshin myslimanët gjatë kryerjes së lutjeve fetare (namazit). Kësaj çështjeje i dedikohen ajetet 2:125, 2:142-145 etj.

Disa muaj më vonë, Muhamedi filloi t'u zinte pritë karvanëve tregtarë, sepse ai dhe refugjatët e tjerë myslimanë (muhaxhirë), nuk kishin me se të jetonin. Ato sulme plaçkitëse Muhamedi i arsyetonte si hakmarrje për dëbimin që ua kishin bërë mekasit.

Afirmimi si udhëheqës në Medinë duhet ta ketë motivuar Muhamedin që t'i përkushtohet, konkretisht, një përcaktimi ndaj paraardhësve të tij, që rëndom quhet qëndrim patriotik e nacional. Një stërgjysh i tij i largët, Kusaj ibn Kilab ibn Murrah (arab.: قصي بن كلاب; بين مرة / i viteve 400 – 480)⁴⁵², ishte angazhuar për krijimin e një shteti arab, por ai kishte mundur të shtinte nën sundim vetëm Mekën.

Muhamedi u bë fillimisht komandant i bandave të ithtarëve të tij, të cilat i urdhëronte të sulmonin besimtarët paganë, hebrej dhe kristianë, për të plaçkitur gjësende e kafshë shtëpiake dhe për të zënë robër për kënaqësi seksuale dhe për t'i shitur si skllevër në treg. Robërit pastaj i kushtëzonin të konvertoheshin në islam ose do të vriteshin. Dhe kështu filloi të rritej islami zanafillor.

Ajetin paraprak (2:191) Muhamedi duhet ta ketë sajuar në prag të sulmit për të marrë Qabenë. Ai nuk thoshte se po i sajonte vetë ajetet, por se po ia citonte Xhibrili, po i ëndërronte (si në rastin e sures 96) dhe po i zbritnin nga qielli etj. Pra, përmes këtij ajeti, Muhamedi

⁴⁵² Ibn Hisham. The Life of the Prophet Muhammad1. p. 181.

urdhëronte xhihadistët e tij, vetëkuptohet gjithnjë „në emër të zotit“ të tij, që të uzurponin Qabenë, për ta shndërruar aty e tutje në objekt të kultit islam.

Për të arsyetuar uzurpimin e Qabesë, Muhamedi sajoi legjenda për Abrahamin, i cili duhet të ketë jetuar rreth shek. 18, p. e. s. Ai cilësohej e nderohej nga *Toraha* si profeti i parë që ka themeluar fe monoteiste. Edhe Muhamedi u përcaktua për Abrahamin se ishte „babai“ i fesë monoteiste, por tashmë i fesë islame. Dhe jo vetëm kaq. Muhamedi ia arabizoi emrin nga Abraham në Ibrahim, e shpalli si gjyshin e popullit arab, meqë djalin e tij, Ismailin, e shpalli „baba“ të arabëve dhe paraardhës të drejtpërdrejtë familjarë të tij (kurse vëllanë e Ismailit, profetin Isak, e shpalli „baba“ të popullit izraelit).

Gjithsesi, për të kompletuar të „drejtën e Zotit“ dhe „të drejtën historike“ për uzurpim të Qabesë, Muhamedi e shpalli Ibrahimin mysliman (Madje edhe Adamin, „njeriun e parë“, të cilit gjithashtu ia arabizoi emrin në Adem). Në vazhden e këtyre sajimeve, sipas Muhamedit, Qabeja ishte ngritur nga „profeti“ Adem, pastruar nga „profeti“ Ibrahim dhe djali i tij, „profeti“ Ismail. Prandaj ajo duhej të çlirohej nga arabët paganë dhe të shndërrohej në objekt kryesor kulti për fenë islame.

Vërtet ishin këto ëndërrime të Muhamedit apo një platformë e zgjuar për të realizuar një perandori të madhe arabe?

Nga njohuritë e mia për islamin, më rezulton se Muhamedi e donte Qabenë, kryesisht për përfitime ekonomike, meqë ajo vizitohej nga shumë pelegrinë paganë. Tashmë, si bashkëshort e shërbëtor i së kamurës plakushe Hatixhe, ai ia dinte vlerën, rolin dhe influencën pasurisë. Por besimtarëve myslimanë u është mbushur mendja se Muhamedi ishte vetëm „i dërguar i Allahut“.

Pra, siç kuptohet, kemi të bëjmë me urdhër, që Muhamedi duhet t’ua ketë komunikuar ithtarëve të tij xhihadistë, tashmë të organizuar në falanga kusarësh. Të sulmuarit janë banorë të Mekës, të fisit Kurejsh, të cilët ishin pjesëtarë të karvanit tregtar, por tashmë, i kishte

sulmuar falanga muhamedane për t'i plaçkitur. Dhe sulmimi arsyetohet si hakmarrje. Por, mekasit nuk e kishin dëbuar pa arsye Muhamedin dhe rreth 140 ithtarë të tij. Ata ishin toleruar 12 vjet, aq sa ishin paqësorë. Kur u bënë agresivë, me sulme ndaj Qabesë politeiste dhe ndaj skulpturave të idhujtarëve të tyre, ata ndërmorën masa mbrojtëse. Madje ato vendime i morën në kuvend të hapur, të mbajtur para Qabesë, ku ishte i pranishëm edhe Muhamedi me muhamedanë të tij. Vetëmbrojtja e banorëve të Mekës ka qenë legjitime, sepse agresioni i muhamedanëve ishte agresion harbutërisht e plëngprishësve, që e luftonin fizikisht besimin shumëshekullor politeist, i praktikuar tashmë edhe si traditë.

Arsyetimet e Muhamedit për agresion ishin vërtet absurde. Papritmas, si vetëtima në qiell pa re, ai gënjeu se Qabeja ishte myslimane, e ndërtuar nga „myslimani“ Adam dhe „e pastruar“ nga „myslimani“ Abraham...

Këtë gënjeshtër të Muhamedit e diskrediton edhe ajeti 39:12, i cili përmban përcaktimin: *Thuaj: Dhe më është urdhëruar që të bëhem myslimani i parë!* Vetë ky ajet përjashton mundësinë të ketë qenë ndokush para Muhamedit mysliman, ose të kishte pas fe e objekte myslimane! Prandaj, në këtë rast, kemi sulm plaçkitës dhe jo hakmarrje, siç e arsyetojnë agresionin e tij besimtarët fundamentalistë myslimanë.

Ky fragment, si dhe shumë të tjerë, do të duhej të arkivohej si rrëfim legjendar, për një ngjarje në një kohë e në një hapësirë të caktuar, me karakterin e një platforme kanunore dhe nuk do të duhej të zinte vend në një dogmë bazë fetare...

ISLAMI, religion agresiv (?!)

*Vritni ata derisa të zhduket shpifja dhe të aplikohet feja vetëm për Zotin. E në qoftë se ndalen, atëherë lëreni luftimin, përveç atyre që janë zullumqarë. [2:193 / shq. Sherif Ahmeti]**

Në fusnotë jepen edhe dy variante të tjera të shqipërimit.

Urdhër tipik fashistoid muhamedan! Duhej t'i vrisnin të gjithë jomyslimanët, derisa të konvertoheshin të gjithë në fe të Allahut. Urdhri është konkret dhe kategorik. Demagogët myslihanë, kur ballafaqohen me opinion dominues paqësor, belbëzojnë, duke u thirrur në fjalinë pasuese, e cila duhet të kishte kuptim vetëm derisa të dorëzoheshin jomyslihanët kundërshtues.

As ky ajet nuk ka përmbajtje paqësore e hyjnore, por të dhunshme, agresive, luftarake, që aty e tutje, në atë hapësirë, të praktikohej vetëm feja islame.

Ky ajet përmban përcaktimin të prerë, për vetëm një fe legjitime (islamin). Të tjerat nuk njihen!

Formulimi gjuhësor i fjalisë së parë e përjashton Allahun si autor! Autor është Muhamedi me ndonjë bashkautor.

Muaji i madh për muaj të madh; respektimet janë reciproke. Pra, kushdo që ju sulmon duke tejkalluar kufirin, edhe ju sulmohet, ashtu siç ju sulmuan ata juve! Druajuni Perëndisë dhe dijëni se, me të vërtetë, Perëndia është me ata që ruhen nga të këqijat. [2:194]

Për njohësit e interpretuesit kritikë të legjendave islamike të kohës së Muhamedit, - meqë histori e mirëfilltë nuk ekziston, - nuk ka pasur ndonjë agresion të fiseve të tjera ndaj një grushti muhamedanësh, tashmë që të gjithë burra të shpërfytyruar në xhihadistë falangistë. As

*“Luftoni ata derisa të zhduken ngatërresat dhe derisa të bëhet besimi vetëm për Perëndinë! E në qoftë se ata heqin dorë (prej ngatërresave), atëherë s’ka armiqësi, përveç atyre që kanë tejkalluar kufirin.” [2:193 / shq. Hasan E. Nahi]

“Ata t’i luftoni derisa të zhduket shpifja dhe të mbesë feja e Allahut. E nëse përmbahen, atëherë nuk ka armiqësi, përveç kundër kriminelëve.” [2:193 /shq. Feti Mehdiu]

organizimi i pjesëtarëve të fisit Kurejsh për të mbrojtur karvanët e tyre gjatë kalimit transit buzë Medinës, nuk duhet (dis)kualifikuar si agresion, por si vetëmbrojtje, meqë ai rrugëtim ishte tradicional dhe kusarët muhamedanë nuk kishin legjitimitet për t'i sulmuar karvanët për kusari.

Meqë më rezulton përmbajte e përçartë, po e sjell edhe shqipërimin e Hasan E. Nahit:

Muaji i madh për muaj të madh; respektimet janë reciproke. Pra, kushdo që ju sulmon duke tejkalar kufirin, edhe ju sulmohet, ashtu siç ju sulmuan ata juve! Druajuni Perëndisë dhe dijeni se, me të vërtetë, Perëndia është me ata që ruhen nga të këqijat. [2:194 / përkthyes Hasan Nahi]

Edhe në këtë variant rezulton se vetë Muhamedi me bashkautorë ishin të përçartë në përgatitjen e tyre intelektuale dhe në mendësi. Nuk bën të denigrohet „zoti“ duke ia mveshur atij, mashtrueshëm, autorësinë e tekstit të *Kuranit*.

Siç do të shohim, Muhamedi dhe bashkautorët gjatë gjithë kohës janë përkujdesur që të imponojnë përcaktimin, sikur myslimanët kanë luftuar vetëm sepse ishin të detyruar, pra për vetëmbrojtje, por e vërteta është se vetë Muhamedi me ithtarët e tij ishin nismëtarë të dhunës. Pra, ishte Muhamedi që donte ta uzurponte Qabenë, e cila, gjatë shekujve, kishte qenë objekt kulti i besimtarëve paganë dhe ajo po menaxhohej nga xhaxhallarët e tij. Derisa nuk ishte bërë ende provokues fizik dhe agresor, Muhamedi u tolerua në Mekë si misionar i dogmës se tij.

Në Mekë duhet të ketë mbretëruar fryma e tolerancës së tri religjioneve të deriatëhershëm: politeistë, hebrej e kristianë. E kur Muhamedi në vitin 622 tentoi t'i thyente rekuizitat e kultit në Qabe, atëherë xhaxhallarët e kushërinjtë e tij morën vendim që ta vrisnin, si hakmarrje për herezinë që kishte bërë.

Edhe kur u arratis në Medinë, i shoqëruar nga Ebu Bekri, në vitin 623, Muhamedi zuri të praktikonte kusari ndaj karvanëve tregtarë të

Mekës, duke e arsyetuar kusarinë si hakmarrje për dëbimin që u kishte ndodhur. Pra, këto ishin nismat konkrete të dhunës, ndërsa në vazhdim Muhamedi organizoi bandat e tij, për të sulmuar fiset në Medinë, në mënyrë që myslimanët e parë të jetonin me plaçkitjet e atyre sulmeve.

Edhe përmbajta e këtij ajeti rezulton të mos jetë paqësore, as hyjnore, por muhamedane, luftarake.

Juve ju është urdhëruar lufta e ju e urreni. Mund ta urreni një gjë, por ajo është e mirë për ju; e mund të doni një gjë, por ajo është e dëmshme për ju. Perëndia e di e ju nuk e dini. [2:216 / shqip nga H. E. Nahi]

Fragment i platformës luftarake të Muhamedit, tashmë agresive.

„Juve“, në rastin konkret, janë xhihadistët muhamedanë. Ai duhet ta ketë ditur se njeriu, për nga natyra (procesi i evoluimit të tij deri te arsyeja), nuk e do luftën. Ai, prandaj, përdorte taktikë për t'i bindur xhihadistët, se lufta për misionin e tij është shumë e dobishme. Duhet të jetë përcaktuar për këtë formë demagogjike, dhe jo për urdhër, meqë ishte fazë e islamit zanafillor dhe ithtarët e tij të parë ende nuk ishin thellësisht të indoktrinuar dhe, prandaj, nuk ishin gjithaq të dëgjueshëm për t'u komanduar.

Me konstatimin „Zoti e di, ju nuk dini“, Muhamedi duhet të ketë synuar depersonalizimin e besimtarëve të tij. Ata, tashmë, nuk mund të dinë dhe, rrjedhimisht, nuk duhet të mendojnë, por vetëm të besojnë. Gjithëdituria është atribut vetëm i zotit. Vetëkuptohet se qëllimi ishte që, përmes zotit, Muhamedi të impononte veten e tij si i gjithëditur e sundimtar.

Edhe në këtë ajet, zoti nuk është autor, meqë nuk do të thuhet përçart në vetën e tretë njëjës: „Zoti e di, ju nuk dini.“

Nëse të pyesin për luftën në muajin e shenjtë, thuaj: „Lufta në të është e madhe (mëkat i madh), por pengimi nga rruga e Zotit, mosbesimi ndaj Tij, pengimi nga

xhamia e shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo janë mëkate edhe më të mëdha te Zoti. E provokimi është edhe më i madh se mbytja. Ata do t'ju luftojnë juve vazhdimisht, për t'ju zbrapsur nga feja juaj, nëse munden. E kush zbrapset prej jush nga feja e tij dhe vdes si jobesimtar, do t'i zhduken veprat në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm. [2:217]

Përmbajtja e këtij ajeti, porosinë, stimulimet, kushtëzimet, kërcënimet janë formuluar goxha përçart. Sajuesi i këtij ajeti (me gjasë pjesëtar i komisionit të kalifit Utman) thotë se „*Lufta në të është e madhe*“, kurse në kllapa vlerësohet „*mëkat i madh*“. Se cilin variant, kaq kundërthënës, duhet të përzgjedhim, kjo mbetet ta vendosin vetë besimtarët.

Edhe ky ajet u dedikohet rrethanave konkrete, parapërgatitjes për ta sulmuar Mekën. Në fund bëhet kërcënimi: ata që nuk luftojnë për të mbrojtur islamit do të jenë „*banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm.*“ Autori i këtij formulimi sikur nuk e di se nuk mund të jesh përjetësisht banor i zjarrit, meqë digjesh shpejt. Ose, ndoshta, zjarri i xhehenemit nuk djeg, pasi është vetëm virtual, siç mund të keqkuptohet ky ajet.

Edhe ky ajet nuk e ka autor zotin, meqë autori edhe këtu shfaqet në veten e tretë njëjës.

Vetëm besimtari naiv mund të këmbëngulë se edhe ky ajet është paqësor, misionar, hyjnor, me karakter universal (edhe pse i dedikohet ngjarjes konkrete, në kohë dhe në hapësirë).

Ata të cilët besuan, ata që u shpërngulën dhe luftuan në rrugën e Zotit, ata meritojnë të shpërsojnë në mëshirën e Tij. Zoti fal shumë dhe është mëshirues. [2:218]

Ky ajet ofron shpërblimin për ata që luftuan, pra, nuk rezulton të jetë paqësor. Të shpërngulurit janë Muhamedi dhe ithtarët e tij, të cilët, në shtator të vitit 622, u dëbuan nga Meka dhe u strehuan në Medinë.

Zoti nuk është autor as i këtij ajeti, i cili nuk rezulton të ketë përmbajtje paqësore, meqë madhërohen Muhamedi dhe xhihadistët e tij për luftime „në rrugë të zotit“.

Luftoni për hir të Allahut, e të dini se Ai dëgjon, di. [2:244]

Mund të (keq)kuptohet si lutje e Muhamedit, por edhe si urdhër, drejtuar xhihadistëve, sepse sërish autori është paraqitur në vetën e tretë njëjës. Konstatimi se zoti *dëgjon dhe di* është përçmim i zotit, të cilit i atribuohet „gjithëfuqia“, „gjithëpushteti“, „gjithëdituria“... Ndërsa në këtë rast, zoti paraqitet paksa më i vockël, meqë është e natyrshme për të gjitha gjallesat të dëgjojnë, ndërsa për njeriun, pak a shumë, edhe të dijë.

As ky ajet, përmes të cilit urdhërohet luftimi, nuk është paqësor e as hyjnor, por tepër i dhunshëm dhe agresiv. Besimtarëve mund të mos iu duket i tillë (sepse ata janë të privuar nga mendimi...). Ndërsa të tjerët, që thonë se islami është fe paqësore, e bëjnë për demagogji e taktikë konjunkturale.

A nuk ke marrë vesh për parinë e bijve të Izraelit pas Musait? Kur i patën thënë një të dërguari të tyre (Shem'unit): „Cakto për ne një sundues e të luftojmë në rrugën e Zotit!“ Ai tha: „A mund të ndodhë që, nëse lufta u bëhet obligim, ju të mos luftoni?!“ Ata thanë: ‘,E ç’kemi ne që të mos luftojmë në rrugën e Zotit, kur dihet se ne jemi dëbuar nga atdheu dhe bijtë tanë?!“ E kur u obliguan me luftë, përveç një pakicë prej tyre, ata u zbrapsën. Zoti është i njohur për punët e zullumqarëve. [2:246]

Sërish fragment për motivim luftarak dhe arsyetim të sulmeve fashistoide. Rëndom, propagandistët e islamit e minimizojnë „pakicën“ me numër të vogël të të vrarëve, duke anashkaluar faktin se shkretëtirat mes Mekës e Medinës nuk duhet të kishin më shumë se 20 mijë banorë, në një hapësirë gjeografike me diametër prej rreth 450 km. Pastaj, në atë kohë armatimi ishte në nivel primitiv. Arma më e

sofistikuar duhet të ketë qenë shpata, të cilën nuk ishte e mundur ta kishte gjithsecili. As fiset që sulmoheshin nuk u rezistonin atyre harbutëve të shpërfytyruar në barbarë. Në më të shumtën e rasteve, të sulmuarit dorëzoheshin shpejt dhe simulonin pranimin e konvertimit në islam.

Ky ajet i kushtohet një ngjarjeje të largët historike dhe, si çdo trajtim tjetër historik në *Kuran*, edhe ky është tepër i përcartë, më shumë nebuloz sesa informues, i sajuar nga autori që nuk ka qenë i informuar për ato ngjarje, por që ka qenë i ndikuar nga mitet e legjendat.

Këtu shohim se që të tria fetë abrahimike udhëheqjen dhe sundimin ia kanë deleguar zotit, i cili duhet të emërojë përfaqësuesin e tij (mbretin, perandorin, kalifin). Për rrjedhojë, për sundimtar do të imponohet patjetër ai që mund të imponohet, duke u thirrur edhe „në emër të zotit“. Ky përcaktim i padrejtë iu kundërvu qytetërimit tonë antik (në Europën Juglindore), ku vetë njerëzit i zgjidhnin udhëheqësit e tyre (demokracia zanafillore).

Bazuar në trajta të rrëfimit, zoti nuk është autor as i këtij ajeti. Po të ishte autor, ai do ta formulonte më qartë dhe më saktë edhe këtë ajet, meqë ai është „i gjithëditur“.

E kur doli (prej qytetit) Taluti me ushtrinë, tha: „Allahu do t'ju sprovtojë me një lumë, e ai që pi prej tij, ai nuk është me mua, e kush nuk e shijon atë, ai është me mua, përveç atij që me dorën e vet e pi një grusht!“ Mirëpo, me përjashtim të një pakice prej tyre, të tjerët pinë nga ai. E kur e kaloi ai (Taluti) së bashku me të edhe ata që ishin besimtarë thanë: „Ne sot nuk kemi fuqi kundër Xhalutit dhe ushtrisë së tij!“ Po ata që ishin të bindur se do ta takonin Allahun thanë: „Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e Allahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha!“ Allahu është me durimtarët. [2:249]

Taluti është Saluti hebre, mbret i izraelitëve. Duhet të ketë jetuar në vitet 1082-1010, p. e. s. Ndërsa Xhaluti është Goliati. Varianti i paraqitur në *Torah* ndryshon krejtësisht nga ky në *Kuran*. Dhe nuk dihen arsyet pse Muhamedi ka paraqitur në *Kuran* vetëm histori të

popullit izraelit-jahudi-hebre dhe pothuajse asnjë histori të popullit arab!

Edhe ky trill historik duhet të jetë sajuar për të frymëzuar xhihadistët muhamedanë, që të brumosnin shpirtin e tyre luftarak. Pikërisht pse ishin pak xhihadistë muhamedanë, trille të tilla historike duhej të brumosnin shpirtin luftarak të tyre, për të besuar se kanë ndihmës edhe „zotin“.

As ky trill nuk i shkon religjionit paqësor e hyjnor!

Në fe nuk ka detyrim. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat e i beson Zotit, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje...[2:256]

Këtë ajet e shpërdorojnë edhe myslimanët me mendësi tepër të dhunshme, për të kamufluar angazhimet e tyre, nëse ua kërkon taktika që të simulojnë besimtarin paqësor. Megjithatë, përcaktimi „në fe nuk ka detyrim“, nuk do të thotë se në fe nuk ka dhunë, siç përshtatet ky ajet, kur citohet nga propagandistët islamë.

Mund të thuhet se Muhamedi nuk ishte i dhunshëm gjatë viteve 610-620, kur zuri të sajonte e predikonte islamin e tij. Ai zuri të bëhej agresiv dhe i dhunshëm pas vitit 620, pas vdekjes së Hatixhesë, gruaja e tij e parë, me të cilën ishte martuar në vitin 594 dhe pas vdekjes së xhaxhait të tij, Ebu Talib, gjithashtu në vitin 619 (ose 620).

Përcaktimi në fjalinë e parë nuk rezulton të jetë në harmoni logjike me fjalinë pasuese. Formulimi gjuhësor dëshmon se zoti nuk është autor.

Është e vërtetë se atyre që nuk besuan nuk do t'u vlejë asgjë para Allahut, as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata vetë janë lëndë e zjarrit. [3:10]

Mendësi harbute e autorit Muhamed, i cili kërcënon jomyslimanët, duke i ngarkuar me faj dhe dënim edhe fëmijët e tyre, për „fajin“ e prindërve që nuk pranojnë të konvertohen. Dhe mendësia fashistoide

muhamedane i kërcënon ata me shndërrim të tyre në „lëndë djegëse“ në zjarrin e ferrit muhamedan, i cili asnjëherë nuk fiket dhe kufomat asnjëherë nuk digjen përfundimisht...

Ata që mohojnë argumentet e Zotit mbysin profetët pa farë të drejte, mbysin edhe njerëz që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhembshëm e pikëllues. [3:21]

Përmbajtje koti! Kur është sajuar ky ajet, nuk kishte profetë, pos Muhamedit. I fundit ishte Jezusi i legjendarizuar, që duhet të kishte vdekur rreth 600 vjet më herët. Por poenta duhet të ketë qenë tërheqja e vërejtjes për të mos i vrarë propagandistët e islamit. Nuk rezulton kush duhet të jetë ai që vendos për ndëshkim dhe për ekzekutorët e tij.

Ky ajet duhet të jetë sajuar në fazën kur Muhamedi duhet të ketë qenë në formësim të mendësisë së tij luftarake.

Besimtarët të mos i miqësojnë jobesimtarët, e t'i lënë anash besimtarët. E kush bën atë, ai nga feja e Zotit nuk ka asgjë, përveç nëse është për qëllim ruajtja prej së keqes së tyre. Zoti ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm te Zoti është e ardhmja. [3:28]

Një urdhër tipik fashistoid! Mendësi tipike muhamedane, nxitje dhe segregacion armiqësor, shovinist, fashistoid! Vetëkuptohet, aspak hyjnor e paqësor! Në atë kohë nuk duhet të ketë pasur jobesimtarë. Muhamedi dhe bashkëveprimtarët e tij i (zh)vlerësonin politeistët si jobesimtarë, shpeshherë edhe hebrenjtë e kristianët. Rrjedhimisht të gjithë jomyslimanët.

Për sa u përket atyre që nuk besuan, Unë do t'i ndëshkoj me një ndëshkim të ashpër në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ata nuk do të kenë ndihmëtarë. [3:56]

Muhamedi me mendësi, tashmë të kriminalizuar, sajton gogolin e shpifur Allah, për të frikësuar jomyslimanët, por edhe për t'i disiplinuar muhamedanët që t'i zbatonin urdhrat e tij.

O ju që besuat, mos i zini për miq të ngushtë të tjerët jashtë mesit tuaj, ata nuk pushojnë së vepruari në dëm tuajin, u dëshirojnë çka u mundon juve. Urrejtja kundër jush duket nga gojë e tyre, por ajo që fshehin në gjokset e tyre është edhe më e madhe. Ne pra, ua kemi sqaruar faktet nëse ju i kuptoni. [3:118]

Sërish mendësi tipike muhamedane, nxitje e urrejtje dhe armiqësisë mes besimtarëve, për të brumosur një shpirt shovinist, agresiv, fashistoid mysliman!

Përkujto (Muhamed) kur dole nga familja jote që t'ua përcaktosh besimtarëve vendet për luftë, e Zoti është që dëgjon. [3:121]

Duket sikur Muhamedi duhet të ketë pasur dilema ndaj vendimmarrjes së tij në të kaluarën, por ai tashmë dekonspiron përcaktimin e tij të vërtetë, për luftëra e jo për misionarizëm paqësor. Pra, rezulton se qysh në fillim Muhamedi ishte përcaktuar për t'u bërë komandant sundimtar (kalif) dhe i pasur, përmes dhunës dhe luftërave pushtuese. Sulmet plaçkitëse, betejat dhe luftërat për imponim të përdhunshëm të islamit, besimtarët myslimanë i vlerësojnë si angazhime paqësore misionare dhe si luftëra të shenjta e çlirimtare. Por, si mund të vlerësohet „hyrja“ e tij në Mekë me forca të armatosura, si betejë çlirimtare, kur Meka nuk ishte e pushtuar?! Gjithashtu, a mund të quhet çlirim grabitja e Qabesë dhe shndërrimi i saj në objekt kulti islam (duke i demoluar të gjitha skulpturat e ikonat pagane të saj)?!

Rezulton se as këtë ajet nuk duhet ta ketë formuluar zoti, siç nuk rezulton të jetë as paqësor e hyjnor.

Zoti ju ndihmoi juve (në luftë) në Bedër kur ju ishit pak në numër, e për të qenë

mirënjohës, kini frikë nga Zoti. [3:123]

Bëhet fjalë për betejën në Bedër (17.03.624 / 17 Ramadan 2, sipas kalendarit islamik). Në këtë betejë Muhamedi mundi fisin e tij Kurejsh. Pra, atij nuk i kishte mbetur mundësi tjetër komunikimi me fisin e tij, pos me gjuhën e shpatës. Vetë Muhamedi duhet ta ketë formuluar këtë ajet për t'i motivuar e manipuluar xhihadistët e tij për beteja të tjera, meqë ata ishin ende të paktë në numër. Pra, ata do të duhej të besonin se zoti do t'i ndihmonte edhe në beteja të tjera, që Muhamedi kishte ndër mend të komandonte.

Duhet pranuar se Muhamedi dëshmohej se ishte usta i mashtrimeve të suksesshme motivuese dhe i psikologjisë për imponim të frikës te besimtarët e sapokonvertuar nga ai si „profet“, por të kamufluar si frikë nga zoti.

As këtë ajet, i cili nuk ka përmbajtje paqësore, por të dhunshme dhe luftënxitëse, nuk e ka formuluar Allahu muhamedan.

Kur ti u thoshe besimtarëve: „A nuk është mjaft për ju, që Zoti juaj të vazhdojë t'ju ndihmojë me tre mijë engjëjt e zbritur“? [3:124]

Fantazia e Muhamedit shpif edhe për engjëjt si bashkëluftëtarë të tij, për të motivuar xhihadistët për beteja të reja. Në kapitullin, ku trajtohen ajetet kundërthënëse, janë të ballafaquara ajetet, që këtë shifër e paraqesin herë *një mijë*, herë *pesë mijë*. Këtë radhë *tre mijë*. Për Muhamedin nuk prishin punë kundërthëniet në shifra, meqë ai ishte i vetëdijshëm se po gënjente. Me rëndësi ishte ndikimi motivues.

Po, nëse jeni të qëndrueshëm e të matur, e ata (armiqtë) t'ju vijnë tash në këtë moment, Zoti juaj vazhdon t'ju ndihmojë me pesë mijë engjëj të ushtruar (për luftë) ose të shënuar. [3:125]

Tashmë Muhamedit i duken pak tre mijë. Ai e fryn mashtrimin e tij në pesë mijë. Marrëzi e radhës: edhe engjëjt të ushtruar për luftë! Tipike muhamedane! Edhe të tilla mashtrime ishin pjesë e platformës

luftarake, për moralizim luftarak të xhihadistëve. Rrjedhimisht, nuk kemi të bëjmë me fe paqësore e hyjnore!

A mos menduat ju se do të hyni në xhenet pa e ditur Zoti se cilët prej jush kanë luftuar dhe pa e ditur se cilët prej jush ishin të durueshëm. [3:142]

Muhamedi sërish dëshmohet usta i mendësisë dhe i përkushtimit të tij, në përhapje të islamit me dhunë, duke i mbajtur ushtarët nën survejim dhe presion, përmes shpërdorimit të zotit. Pra, ai po sajonte një zot që kontrollonte besimtarët. Ata, prandaj, nuk e mashtrojnë dot as „profetin“ Muhamed si përfaqësues të zotit. Kjo metodë i hynte shumë në punë Muhamedit, meqë ai nuk ishte në gjendje t’i kishte tërësisht nën disiplinë e komandë ish-paganët e sapokonvertuar.

As këtë ajet nuk e ka formuluar zoti, as ky ajet nuk është aspak paqësor!

Muhamedi nuk është tjetër, vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar. E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën aspak dëm Zotit, kurse Zoti do t’i shpërblejë mirënjohësit. [3:144]

Meqë rezulton se Muhamedi nuk është autor i këtij ajeti (zoti jo e jo!), atëherë kush është autor i tij? Mbetet mundësia që këtë ajet ta ketë formuluar komisioni i kalifit Utman.

Pyetja „E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa?“, nuk rezulton gjithaq profetike, meqë në vetvete përmban këtë paqartësi dilematike. Zoti, për të cilin besimtarët thonë se di për vdekjen e secilit (kur, ku, si), si nuk e paskësh ditur si dhe kur do të vdiste profeti „më i dashur“ i tij, i dërguari Muhamed, dhe çfarë do të ndodhte pas vdekjes se tij?! Kjo pyetje mund të (keq)kuptohet se Muhamedi nuk duhet të ketë qenë i sigurt, nëse islami do të vazhdojë të ekzistojë edhe pas vdekjes së tij. Ka edhe interpretues, që këtë paqartësi e lidhin me paralajmërimin se Muhamedit do t’i bëhej atentat (siç mund të lexoni në kapitullin për helmimin e Muhamedit).

Sërish kushtëzim i besimtarëve me dënim, nëse nuk e vazhdojnë doktrinën e Muhamedit dhe, kuptohet, me shpërblim për të devotshmit, të cilët do të vazhdojnë fenë dhe luftërat për përhapjen e islamit. Ky kushtëzim është shoqëruar me trukun mashtrues „Zotit nuk i bëjnë dëme ata që devijojnë“, por vetëm vetvetes.

Cinik edhe ndaj zotit!

Zoti nuk është autor, përmbajtja nuk është paqësore e hyjnore.

Askush nuk vdes pa vullnetin dhe lejen e Zotit. Ai është shënim i afatit të caktuar. E kush e dëshiron shpërblimin e kësaj bote, Ne ia japim atij; e kush e dëshiron shpërblimin e botës tjetër, edhe atij do t'ia japim atë, kurse mirënjohësit Ne do t'i shpërblejmë. [3:145]

Ky ajet duhet të jetë sajuar për t'i motivuar xhihadistët, se ata nuk do të vdesin në beteja, nëse kjo nuk është vullneti dhe përcaktimi i zotit. Dhe, vetëkuptohet, zoti nuk ka vullnet për t'i vdekur xhihadistët, sepse ata i duhen për të luftuar prore në rrugën e tij.

Marrëzi, të cilave u besojnë vetëm besimtarët!

Pjesa tjetër e ajetit është një llafomani koti. Se kush është „ne“ në këtë rast, që mund të shpërblejë secilin sipas dëshirës, mbetet për të spekuluar (ndoshta është folur në emër të duetit zot-Muhamed).

Edhe ky ajet rezulton të mos e ketë për autor zotin, por, me gjasë, as Muhamedin.

E sa profetë pati, që së bashku me ta luftuan turma të mëdha besimtarësh dhe për atë që i goditi në rrugën e Zotit, ata nuk u dobësuan dhe as nuk u përulën... [3:146]

Duke e arsyetuar dhunën e tij luftarake me shtrirjen e saj gjatë gjithë historisë së „profetëve“, Muhamedi do që të jetë vazhdimësia e atyre luftërave. Niveli i formulimit është paksa i ngatërruar, aspak historik e letrar.

Edhe ky ajet përmban frymën e dhunës dhe të luftës, sikur ato të jenë shfaqur qysh në kohën kur kanë jetuar profetët pararendës. Si

rrjedhim, dhuna dhe luftërat nuk ndodhën vetëm në kohën e Muhamedit. Këso trukesh arsyetuese duhet t'i ketë prodhuar Muhamedi „në emër të zotit“, për të përvetësuar besimtarët, që të përmbushte veten e tij.

Sërish zoti nuk rezulton të jetë autor as i këtij ajeti, ashtu siç nuk është fare as paqësor, as hyjnor ky ajet.

Fjala e tyre nuk ishte tjetër, pos vetëm të thoshin: „Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe lëshimet në punët tona dhe na forco në vendet tona (luftë)! Ndhimona kundër popullit jobesimtar!“ [3:147]

Bëhet fjalë për një popull tjetër, edhe ai „i përzgjedhur“ nga zoti: populli izraelit. Edhe besimtarët e Moisiut zoti i paskësh ndihmuar për të luftuar kundër popullit jobesimtar.

Mbase mund të ngrihet pyetja: nuk kishte mundësi e fuqi zoti që t'i bënte njerëzit e popujt të besonin në doktrinat që ai po ua „zbriste“ profetëve, pos përmes dhunës dhe luftës?! Akoma më praktike do të kishte qenë që zoti „të zbriste“ vetëm një dogmë fetare dhe jo kaq shumë sish, sepse kështu i ka futur besimtarët e tij në luftë të përhershme mes tyre...!

Edhe ky ajet rezulton të ketë përmbajtje të dhunshme, agresive, luftarake.

Ne do të mbjellim frikën në zemrat e atyre që nuk besuan, sepse ata Zotit i trillojnë zota të tjerë, duke mos pasur për këtë kurrfarë fakti, ndaj vendbanimi i tyre do të jetë xhehenemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve. [3:151]

Mbase s'ka nevojë të përsëris në komentim të çdo ajeti, se formulimi gjuhësor e përjashton edhe Allahun muhamedan si autor. Frika më efektive mbillet me sulme barbare, „në emër të Allahut“, siç po bëjnë tani xhihadistët muhamedanë në Siri e Irak, të cilët ngjasojnë tamam me xhihadistë zanafillorë muhamedanë...

Zoti përmbushi premtimin e vet ndaj jush, ngase me vullnetin e Tij i korrët ata (me shpata)... [3:152]

Demagogji *a la* Muhamed! Zoti i paska ndihmuar xhihadistët muhamedanë t'i „korrin“ kundërshtarët e tyre. Sa çnjerëzore, jo profetike, jo hyjnore, jo misionare rezulton të jetë „të korrurit“; jo grurë me drapër, por njerëz me shpatë! Dhe kë „kanë korrur“ xhihadistët e Muhamedit? Bashkëvendësit e tyre, madje edhe pjesëtarët e të njëjtit fis, vetëm për „fajin“ që nuk pranonin të konvertoheshin në islamin e Muhamedit. Të mjerët „e korrur“! As ata vetë nuk ishin fajtorë pse ishin paganë. Paganizmin e kishin trashëguar nga prindërit e tyre, edhe ata besonin në zotat e tyre!

Muhamedi e ka hallin edhe se si mund t'i mbajë nën kontroll xhihadistët, pas „të korrave“, sepse ata dalldiseshin nga fitorja dhe bëheshin vandalë. Grabitnin gra e vajzave, të cilat i përdhunonin barbarisht, edhe në prani të burrave dhe prindërve të tyre. Populli ynë ka një proverb, që i shkon kësaj teme: „siç është hoxha, është xhemati“. Xhihadistët kishin për komandant kalifin seksoman e pervers, Muhamedin. Nga ai ishin dresuar të dominoheshin nga epshi seksual shtazarak, si mjet kryesor për frymëzim të tyre, që të jenë sa më të motivuar për luftë e sa më luftarakë në beteja. Por ngatërresa mes xhihadistëve gjatë ndarjes së presë, pas përfundimit të betejave, i shkaktonin Muhamedit kokëçarje serioze. Për t'i disiplinuar ata, duhet të ketë sajuar këtë ajet, duke mashtruar, si herëve të tjera, se i „zbriti nga qielli“ (meqë ai qiellin e dinte si një lloj tavani sipër tokës, i cili rrinte pezull, pa shtylla, siç thuhet në një ajet përkatës).

Ajetin e përmbylli me konstatimin taktik: „*Zoti ju fali juve*“ (xhihadistët keqbërës kriminelë), sepse ai frikësohej se mos i kundërviheshin fizikisht, ose nuk do të angazhoheshin në beteja të tjera.

As ky ajet nuk e ka për autor Allahun. Përmbajtja zanafillore (pa sqarimet plotësuese brenda kllapave) është vështirë të kuptohet. Gjithashtu rezulton se përmbajtja nuk është aspak paqësore e hyjnore!

Një kësi ajeti pse duhet të zërë vend në *Kuran*?! Ky ajet do të duhej të arkivohej në muze, ose të rrëfehej si legjendë për ngjarje të caktuara. Por jo. Ky ajet mbase u duhet tani xhihadistëve në „isis“.

Dhe kur largoheshit e nuk përfillnit as njëri-tjetrin, ndërsa i dërguari ju thërriste mbrapa. Atëherë i goditi me dëshpërim për dëshpërim, që të mos pikëlloheni për atë që ju shpëtoi (preja e luftës) e as për atë që ju goditi... [3:153]

Ky ajet pasues është vazhdim i ajetit pararendës.

Kishte xhihadistë që, sapo grabisnin plaçkën e tyre (më së shumti preferonin femra sa më të reja), largoheshin nga mejdani, sepse nuk i rezistonin tundimit të epshit seksual. Ky tundim i bënte ata që të mos dëgjonin as thirrjet e „profetit“. Domosdo, prandaj duhet të ndodhte dënimi nga zoti, por vetëm si dënim verbal, mashtrues, që „profeti“ i tyre të mund t’i disiplinonte e komandonte xhihadistët e shpërfytyruar.

Sërish Allahu nuk është autor i këtyre përcaktimeve. Sërish formulimi është i përçartë, sërish përmbajtja nuk rezulton të jetë paqësore e hyjnore.

Përgjithësisht, sajimi i ajeteve 140-160 të sures 3 janë të lidhura me Betejën e Uhudit (kodër buzë Medinës, e ndodhur në mars 625), ku forcat mekase të fisit Kurejsh mundën forcat e Muhamedit, por ato nuk hynë fare në Medinë. Ato u kthyen në Mekë, meqë qëllimi i tyre kishte qenë hakmarrje për Betejën në Bedër dhe për t’i treguar Muhamedit se ishte mashtrim ndihma e zotit dhënë xhihadistëve. Kjo që goditje e rëndë për forcat luftarake të Muhamedit. Në betejë u vra xhaxhai i Muhamedit, Hamzai, por edhe Muhamedi që plaçar.

Asnjë profeti nuk i takoi të bëjë hile dhe kush bën hile (në ndarjen e plaçkës së luftës), ai në ditën e kiametit vjen i ngarkuar me atë që ka bërë, pastaj secilit njeri i jepet ajo që ka fituar, duke mos iu bërë e padrejtë. [3:161]

Siç shihet, ajeti përmban përcaktimin për ndarjen e plaçkës së luftës, duke e shtrirë këtë përcaktim edhe për „profetët“ pararendës,

nga se edhe ata kanë bërë luftime për të imponuar fetë e tyre, gjithherë „në emër të zotit“ dhe për t’u pasuruar me plaçkë të luftërave.

Dhe ata që nuk luftuan dhe atyre të vetëve u thanë: „Sikur të na dëgjoni neve, nuk do të mbyteshim!“ Thuaju: „Largojeni pra vdekjen prej vetes suaj, nëse jeni të sigurt çka thoni?“ [3:168]

Ajet spekulativ, aspak profetik e hyjnor. Rrjedhimisht, aspak paqësor. Siç vetëkuptohet, synohet çimentimi i frymës së dhunës e agresionit, për të përhapur përdhunshëm „rrugën e Zotit“.

Kundërvënie goxha naive ndaj atyre që nuk kanë marrë pjesë në luftë dhe që përpiqeshin të mos i linin as të tjerët të merrnin pjesë në luftë. Fakti se të gjithë njerëzit vdesin shpërdorohet naivisht për të bindur ata, se nuk do të mund ta shmangin vdekjen, as nëse nuk merrnin pjesë në luftë (ku mund të vdisnin). Mendësi paqësore, jo që jo!

Kurrsesi mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Zotit. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. [3:169]

Kulmi i motivimit për luftë, për të imponuar „rrugën e Zotit“. Dëshmorët (sheitët) që vriten në këso luftërash nuk vdesin, „përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre“. Nuk ia vlen të thuhet gjë për këtë joshje. Kjo është thjesht çështje (mos)besimi. Qysh atëherë e deri në ditët e sotme, xhihadistët ndihen të lumtur nëse vriten në luftëra „të shenjta“, sepse përfundojnë në të ushqyerit nga zoti mysliman, siç thuhet në këtë ajet, ndërsa në ajete të tjera, thuhet se shpërblehen me nga 73 hyri (virgjëresha). Atyre u jepet jetë e përhershme në moshë të fiksuar 30-vjeçare dhe potencial seksual të barabartë me të 30 burrave (aq sa zoti i kishte dhënë Muhamedit, siç spekulohet).

Interesant do të ishte të zbrërthehej mendësia e xhihadisëve, që joshen me këso premtimesh dhe, prandaj, e dëshirojnë vdekjen në luftë „të shenjtë“, për përhapjen e islamit „paqësor“.

Përmbyllja e premtimit dëshmon se as ky ajet nuk është formulim i Allahut dhe nuk është aspak paqësor.

Me të vërtetë, ata që ndërrojnë besimin e vërtetë me mohim, nuk mund t'i bëjnë kurrfarë dëmi Perëndisë; e për ta ka ndëshkim të madh. [3:177 / Shqipëruar nga H. E. Nahi]

Tashmë duhet të ketë ndodhur që ndonjë muhamedan, i sapokonvertuar, të ishte penduar dhe, prandaj, duhet të „ketë dezertuar“ nga islami. Për këtë „dezertim“ Muhamedi ka sajuar këtë ajet, në dukje tejet liberal, por do të evidentojmë edhe ajete të tjera, që parashihnin dënim kapital për „dezertuesit“, me prerje koke.

Të mos mendojnë ata që nuk besuan se afatin që u dhamë Ne atyre të jetojnë, është në dobi të tyre. Ne i lamë të jetojnë vetëm që të shtojnë edhe më shumë mëkate, se ata i pret një dënim nënçmues. [3:178]

Mendësi tipike muhamedane. Vetëm Allahu, personazhi i sajuar nga Muhamedi, mund të jetë kaq destruktiv, sa t'ua zgjatë jetën atyre që nuk e pranojnë islamin, vetëm që t'i shtojnë gabimet e tyre, në vend që të angazhohej për t'i ndërgjegjësuar për të mirë.

...Ata që u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe emigruan, u munduan vetëm pse ishin në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, atyre patjetër do t'ua shlyej mëkatet e tyre dhe do t'i çoj në xhenete, në të cilët burojnë lumenj. Ai është shpërblim nga ana e Zotit, se më i miri i shpërblimeve është te Zoti. [3:195]

Edhe ky ajet është vazhdim i ajetit paraprak, por tani, pos „ushqimit me zotin“, zoti do t'ua falë fajet e deriatëhershme (patjetër, gjithsecili e dinte se ka bërë faje gjatë jetës së tij), do t'i vendosë në xhenet, ku rrjedhin lumenj (diku tjetër thuhet lumenj me verë, mjaltë e qumësht...).

Mbase përkthyesi mund t'i ketë ngatërruar vetat gjatë shqipërimit, sepse fjalia e parë rezulton të jetë nga Allahu, kurse të tjerat nga dikush tjetër, rrëfen se çfarë është zoti dhe kë e si e shpërblen ai.

Të diskutohet nëse këto janë të vërteta, si dhe në rastin tjetër, nuk ia vlen. Është thjeshtë çështje e (mos)besimit. Vetëm mendësi paqesore e hyjnore nuk është, sepse janë sajuar për të frymëzuar shpirtin luftarak të xhihadistëve.

*E sikur Ne t'i urdhëronim ata: „Vritni veten!“ ose „Shpërnguluni nga atdheu juaj!“, pak prej tyre do ta bënin këtë. E sikur të punonin ata siç këshilloheshin, kjo për ata do të ishte më mirë dhe do të ishin më të fortë në besim. [4:66]**

Formulim polemik i Muhamedit, të cilin bashkëveprimtarët e tij duhet ta kenë regjistruar si ajet, që i „kishte zbritur“ nga Allahu. Edhe ky ajet duhet diskredituar si fragment në kuadër të platformës shoviniste kundër jomyslimanëve.

O ju që besuat, rritni të përgatitur (të armatosur) dhe dilni (për në luftë) grup pas grupi apo të gjithë së bashku. [4:71]

Vetëm thirrje për paqe nuk është kjo! Muhamedi jep udhëzime të formohen banda të armatosura dhe të sulmojnë pa ndërprerje, derisa të mundin besimtarët paganë dhe ata të besimeve të tjera, duke pranuar kushtin: o konvertim „në rrugë të Zotit“, o zhdukje fizike.

Ka disa prej jush që zvarriten (nuk dalin në luftë). E nëse juve ju godet ndonjë e papritur, thoni: „Zoti më favorizoi që nuk isha i pranishëm bashkë me ta.“ [4:72]

Sërisht ajet në shërbim të luftës e aspak paqësor.

Le të luftojnë në rrugën e Allahut ata që e japin jetën e kësaj bote për botën tjetër. Kush lufton në rrugën e Zotit e mbytet ose triumfon, Ne do t'i japim atij shpërblim të madh. [4:74]

Shpërblimet motivuese për dëshmorët që viktimizohet për „rrugë të Zotit“ po rriten. Tashmë ofrohet një „shpërblim i madh“. E kush janë „ne“, vetëm Allahu e di, do të thoshin besimtarët. Ky nuk është ajet që përhap frymë paqësore e hyjnore. Sërish Allahu nuk është autor as i këtij ajeti.

Ç'keni që nuk luftoni për Zotin dhe për të paafitit: nga burrat, nga gratë e nga fëmijët, të cilët luten: „Zoti ynë, na nxirr nga ky fshat (Meka), banorët e të cilit janë mizorë. Na jep nga ana jote shpëtim e ndihmë! [4:75]

Përmbajtja e këtij ajeti ngjan shumë me taktikën e Sllobodan Millosheviqit (presidentit të Serbisë), i cili nxiste nacionalizmin serb dhe shpirtin luftarak të çetnikëve (xhihadistëve) serbë, me gënjeshtren se pakica serbe në Kosovë po keqtrajtohet nga shumica shqiptare. Njësoj përhapeshin thirrjet alarmuese të plakave serbe, të cilat thërrisnin Millosheviqin dhe çetnikët e tij për të shpëtuar gratë e fëmijët që keqtrajtoheshin në Kosovën „serbe“. Dallimi kryesor është se, në atë kohë, nuk kishte konflikt mes të dy popujve, si në Kosovë, por mes arabëve që u takonin feve të ndryshme.

Edhe ky ajet është sajuar për të nxitur luftën mes popullsisë, që i rezistonte konvertimin në islam, dhe falangave të tij, që motivoheshin e komandoheshin për të përhapur islamin me dhunë luftarake.

I vetëdijshëm se mund të jenë të bezdisshme përsëritjet, nuk mund të kalohet pa konstatuar se përmbajtja e këtij ajeti, kaq luftënxitës, e përjashton mundësinë që Allahu të jetë autor i tij.

Ata që besuan, luftojnë në rrugë të Zotit, e ata që nuk besuan, luftojnë në rrugë të djallëzuar. Luftoni, pra, miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e djallit është e dobët. [4:76]

Sërish luftime mes myslimanëve dhe të tjerëve. Të parët patjetër janë në „rrugë të Zotit“, kurse të tjerët tashmë në „rrugë të djallëzuar“. Sajues i këtij ajeti nuk mund të jetë personazhi Allah, por Muhamedi

ose komisioni „redaktues“ i kalifit Utman. Ndërsa përmbajtja rezulton të jetë tejet luftarake, aspak paqësore.

A nuk i vure re ata të cilëve iu pate thënë: „Ndalni duart tuaja prej luftës, e faleni namazin dhe jepeni zeqatin!“ E kur atyre iu bë obligim lufta, që një grup prej tyre u frikësoheshin njerëzve siç është frika ndaj Zotit, edhe më fort, thoshin: „Zoti ynë, pse na e bërë obligim luftën? Sikur të na e kishe shtyrë deri në një afat të afërt!“ Thuaju: „Përjetimi i kësaj bote është pak, e për atë që është i devotshëm, bota tjetër është shumë më e dobishme. Nuk do t’ju bëhet padrejtësi as sa fija. [4:77]

Duhet të jetë sajuar kur të dëbuarit nga Mekë, të strehuar në Medinë, donin konfrontime luftarake me përndjekësit e tyre mekas. Teksti origjinal ose përkthimi nuk janë gjithaq të qartë, megjithatë vetëkuptohet se është fragment i taktikës luftarake të Muhamedit.

Lufto në rrugën e Zotit! Nuk obligohet kush pos teje. Nxiti besimtarët (për luftë), Zoti do të zbrapsë fuqinë e të pafeve. Zoti është më fuqiforti, më ndëshkuesi. [4:84]

Nuk ka nevojë për koment e interpretim, sepse është tepër konkret. Besimtarët detyrohen për të luftuar dhe për nxitur edhe të tjerët për të luftuar.

Sa naiv e banal është premtimi mashtrues, se „*Allahu do të zbrapsë fuqinë e të pabesëve!*“ Nëse është kështu, atëherë pse Allahu të mos e shmangte luftën dhe të detyronte të gjithë njerëzit të besonin, meqë „është më fuqiforti, më ndëshkuesi“ (por nuk po rezulton më i fuqishmi dhe më i ndëshkueshmi).

... Mos i zini për miq prej tyre, derisa ata të shpërngulen (si ju) për hir të Allahut, e nëse refuzojnë, atëherë kudo që t’i gjeni, kapni dhe mbytni dhe prej tyre mos zini as mik, as ndihmës.[4:89]

Urdhër fashistoid muhamedan!

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

Ju do të hasni në të tjerë, që duan të sigurohen te ju dhe të sigurohen te populli i vet. E, sa herë që thirren, i përgjigjen thirrjes. Në qoftë se nuk largohen prej jush, nuk ju ofrojnë paqe dhe nuk heqin dorë nga lufta kundër jush, atëherë kapeni dhe mbytni kudo që t'i takoni. [4:91]

Thirrje muhamedane për të rritur armiqësinë dhe për frymëzim e për veprime luftarake, njësoj siç po veprojnë tani xhihaditët muhamedanë. Edhe një argument më shumë se islami nuk është fe paqësore e hyjnore, por më shumë nacional-shovinizëm arab, i kamufluar me religjion.

Nuk janë të barabartë prej besimtarëve ata që ndenjën dhe ata që me pasurinë dhe me jetën e tyre luftuan në rrugën e Zotit, me përjashtim të atyre që ishin të penguar pa vullnetin e tyre. Ata që luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre, Zoti i gradoi në një shkallë më lart mbi ata që ndenjën... [4:95]

Platforma luftarake e Muhamedit, për ta imponuar islamin e tij me dhunë, sa vjen e kompletohet, duke shpallur edhe shpërblime të graduara, varësisht nga (mos)angazhimi luftarak. Vetëm besimtarët injorantë nuk mund të kuptojnë se ky është fragment i platformës luftarake të Muhamedit, për sundim e pasurim (edhe për të pasur më shumë gra...).

Edhe ky ajet nuk rezulton të jetë aspak paqësor e hyjnor. Përkundrazi. Ai është i dhunshëm e luftarak.

Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam dhe zemrat e tyre i bëmë të forta. Ata i ndryshojnë fjalët nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përpos një pakice nga ata. Pra, fali dhe injoroi. [5:13]

Muhamedi ua dedikon këtë ajet hebrenjve të Medinës, që duhet të kenë përkrahur kurejshët e Mekës, në përballjen me bandat xhihadiste të Muhamedit. Por, duket jashtë rrjedhës porosia: *Pra, fali dhe injoroi.*

Ne morëm zotimin edhe të atyre që thanë: „Ne jemi nesara“ dhe ata e harruan një pjesë të asaj me të cilën ishin udhëzuar, ndaj Ne kemi ndërsyer armiqësinë e urrejtjen ndërmjet tyre deri në ditën e kiametit. E më vonë Zoti do t'i njoftojë ata për atë që bënë. [5:14]

Sërish fragment i platformës së dhunshme e luftarake muhamedane!

Për këtë Ne u shpallëm bijve izraelitë se kush mbyt një njeri, pa mbytur ai ndonjë tjetër më parë dhe pa bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall, është si t'i kishte ngjallur të gjithë njerëzit...“ [5:32]

Broçkulla të pakuptimta! Si mund të barazohet krimi i mbytjes së një njeriu baras me mbytjen e gjithë njerëzimit?! Po ngjallja e njeriut, a nuk është mundësi që i është rezervuar vetëm „zotit“? Apo ndoshta Muhamedi ka harruar se çfarë personazhi ka sajuar.

Dënimi i atyre që kundërshtojnë Zotin dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërri-me në tokë nuk është tjetër, vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, por edhe të dëbohen nga vendi. Ky është poshtërim për ta në këtë dynja, në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh.“ [5:33]

Përcaktim kriminal, fashistoid! Kjo përmbajtje reflekton agravimin e mendësisë së Muhamedit në harbutëri barbare! Janë mbi 6 miliardë njerëz që nuk e njohin Allahun për zot, as Muhamedin për profet. Si mund ta zbatojnë myslimanët fanatikë këtë urdhër?!

Vjedhësve dhe hajdutëve prituani duart, si shpagim i veprës që bëjnë. Kjo masë është dënim nga Allahu. Ai është i fuqishëm, ligjdhënës i urtë. [5:38]

Solla edhe këtë ajet për të paraqitur mendësinë e Muhamedit edhe për këtë problematikë, sepse veprimi është shabllonizuar. Duhet t'u priten duart edhe atyre që do të vjedhin një pemë në bahçe të dikujt, të

shtyrë nga etja dhe uria ose edhe vetëm nga tundimi. Meqë nuk është përcaktuar moshë, edhe fëmijëve duhet t'u priten duart, nëse do vjedhin diçka, për të cilën kanë nevojë ose që i tundon?!

Tjetra, pamundësia që të zbatohet ky „nën“ (ajet) i kanunit beduin muhamedan (Kuran) është terrorizuese për myslimanët që jetojnë në shtetet ligjore.

Kush tjetër, pos myslimanëve fundamentalistë, mund të këmbëngulë se edhe ky përcaktim është i drejtë, meqë e paskësh sajuar Allahu.

O ti i dërguar! Mos u brengos nga vrapimi në mosbesim i tyre që me gojët e tyre thanë: „Ne kemi besuar“, e zemrat e tyre nuk kanë besuar, e as e atyre që janë jahudinjtë, të cilët shumë i përgjigjen gënjeshtëris dhe më shumë dëgjojnë një popull që nuk vjen te ti. Ata i mënjanojnë fjalët pas vënies së tyre në vendin e vet e thonë: „Nëse u jepet kjo, pranohuni, e nëse nuk u jepet, atëherë refuzojini“. Po atë që Zoti do ta humbë, ti nuk mund të bësh asgjë për të. Janë ata, të cilëve Zoti nuk desh t'ua pastrojë zemrat. Janë ata, që në këtë jetë kanë poshtërim, kurse në botën tjetër dënim...[5:41]

Është formulim i ngatërruar, polemik, muhamedan, që i dedikohet një rrjedhe konkrete, në kohë e hapësirë. Edhe ky fragment legjendar do të duhej të ishte arkivuar, që të mos zinte vend në këtë kanun beduin, sepse nuk është përcaktim që mund të zbatohet në kohën e tanishme.

Ne u caktuam atyre në të (në Tevrat) kundërmasat ndëshkuese: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e fal atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush vendos sipas asaj që zbriti Allahu, ata janë mizorë (të padrejtë). [5:45]

Formulim tipik muhamedan, tejet i pasaktë. Ta zëmë, kush duhet të jenë „atyre“? Në bazë të legjendave, duhet të jetë fjala për izraelitët dhe për dogmën që përmban *Besëlidhja e Vjetër*. Megjithatë, po

(keq)kuptohet se vazhdon përvijimi i qëndrimit armiqësor kundër jomyslimanëve, në këtë rast kundër besimtarëve të BV.

O ju që besuat! Mos zini miq as jehudinjtë e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet Zoti nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar. [5:51]

Vazhdon konsolidimi i mendësisë harbute të Muhamedit! Fatkeqësisht! Pothuajse njësoj si ajeti 4:144.

I sheh ti ata, zemrat e të cilëve lëngojnë, se si vrapojnë për të lidhur miqësi me ta duke thënë: „Druajmë se mos po na godit ndonjë fatkeqësi“. E, Perëndia do t'i sjellë fitoren ose diçka tjetër nga ana e Tij, e prandaj, për atë që kanë fshehur në veten e tyre do të pendohen. [5:52]

Sërish formulim i përcartë, meqë bëhet fjalë për „ata“ dhe „me ta“. Ndoshta për shkak të armiqësisë vulgare që e ka mbizotëruar mendësinë e Muhamedit, ai është nxituar të sajojë edhe këso formulimesh, të cilat i kanë shënuar „sekretarët“ e tij, me mendim se çfarëdo që llomotiste Muhamedi, i „vinin“ nga Allahu.

Nuk e besoj që edhe propaganduesit më virtuozë të *Kuranit* do të jenë në gjendje të mbrojnë këtë fragment, si krijimtari e përkryer letrare ose hyjnore. Sigurisht, në raste të tilla ata do të thonë se fajet i ka përkthimi. Jam i bindur se origjinali duhet të jetë edhe më i përcartë, sepse përkthyesit janë sflitur për të përkthyer kështu siç është, që të paktën të mund të kuptohet...

O ju që besuat! Kini frikë Zotin dhe kërkonit afrim tek Ai, luftoni në rrugën e Tij që të gjeni shpëtim. [5:53]

Sërish thirrje luftënxitëse, që të imponohet me dhunë luftarake „rruga e Zotit“. Sërish Allahu nuk është autor as i kësaj thirrjeje. Sërish vetëm besimtarët myslimanë mund të thonë se nuk është thirrje për luftë, ose se është thirrje për luftë të drejtë, „të shenjtë“, se islami është

përhapur e masivizuar paqësisht. Ata patjetër që kështu do të arsyetojnë, përndryshe nuk do të ishin myslimanë, të detyruar t'u përmbahen edhe këtyre porosive të „profetit“ (të cilin ata e adhurojnë më shumë se çdo „profet“ tjetër dhe më shumë edhe se Allahun).

A e vërejtën ata sa gjenerata para tyre i shkatërruam, që Ne u patëm mundësuar atyre në tokë çfarë juve nuk ju mundësuar; u patëm lëshuar nga qielli shi me bollëk dhe u patëm bërë që të rrjedhin lumenj ndër ta, e për shkak të mëkateve të tyre i shkatërruam dhe pas tyre sollëm (breza) të tjerë.[6:6]

Legjenda të shpifura, që nuk përkojnë me asnjë ngjarje historike! Atyre vërtet nuk u takon vendi në një libër „të shenjtë“, që myslimanët fundamentalistë e paraqesin rrejshëm: paqësor!

Sa fshatra kemi shkatërruar (me fajin e tyre) e dënimi Ynë u erdhi natën a (ditën) kur ishin duke pushuar (duke fjetur).[7:4]

Duket që Muhamedi e ka sajuar personazhin Allah si kopje të mendësisë së tij, sipas mendimit të thënë edhe nga filozofët antikë, se po të dinte kau të vizatonte, ai do ta vizatonte zotin si vetja e tij...

Po të të pyesin ty për plaçkën (e fituar në luftë), thuaju: „Plaçka është çështje e Zotit dhe të dërguarit, prandaj kini frikë Zotin, përmirësoni gjendjen e unitetit tuaj dhe nëse jeni besimtarë, respektojeni Zotin dhe të dërguarin e Tij“. [8:1]

Edhe një fragment për kompletim të platformës luftarake. Kësaj radhe shprehet përcaktimi për mënyrën e ndarjes së plaçkës së luftës. Ustai Muhamed përdor trukun, sikur është çështje e zotit mënyra e ndarjes së plaçkës së luftës, që do të thotë se ai e uzurpon për vete të drejtën për të vendosur e për ta bërë ndarjen.

As ky ajet nuk ka përmbajtje paqësore, as është formulim i zotit.

Përkujtoni kur kërkuat ndihmë prej Zotit tuaj, e Ai u është përgjigjur: „Unë do t'ju ndihmoj me një mijë engjëj që vijnë njëri pas tjetrit (grup pas grupi). [8:9]

Karrem mashtrues për të trimëruar xhihadistët e paktë në numër dhe jo gjithaq të motivuar për luftime të përhershme. Por Muhamedi ka harruar se në ajetin 3:124 ka premtuar tre mijë, ndërsa në një tjetër [3:125] pesë mijë engjëj.

Edhe kur Zoti yt u kumtoi engjëjve: „Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan, e ju goditni në qafë e lart, mëshojuni atyre në çdo gjymtyrë“. [8:12]

Karrem motivues, i sajuar nga Muhamedi, për t'i bërë sa më luftarakë xhihadistët e tij. Ndërsa goditjet, në qafë e lart, tashmë po i shohim të tmerruar në kalifatit muhamedan, të vetëquajtur me akronimin „isis“ ...

Sigurisht, edhe nga formulimi gjuhësor rezulton se ky ajet nuk ka për autor Allahun muhamedan.

Këtë (ndëshkim për ta) ngase kundërshtuan Allahun dhe të dërguarin e Tij, e kush kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij nuk ka dyshim se Allahu është ndëshkimfortë. [8:13]

Ky ajet ngjason me ajetin 5:33, që përcakton ndëshkime të ashpra ndaj atyre që kundërshtojnë Muhamedin (meqë „perëndinë“ inekzistente nuk e kundërshtojnë dot). Aktualisht, janë rreth 6 miliardë njerëz që nuk e njohin Muhamedin për profet. Ata, vetëkuptohet, janë kundër imponimit të tij si profet. Pastaj, është lënë në mendësinë personale të secilit mysliman, për të (zh)vlerësuar se kush dhe si është kundër Muhamedit dhe si duhet të dënohet.

O ju që besuat! Kur të ndesheni me turmën e atyre që mohuan, mos ua ktheni shpinën! [8:15]

Kush ua kthen atyre shpinën, në atë moment veç atij që kthehet për të luftuar ose për t'iu bashkëngjitur një grupi tjetër, ai ka tërhequr kundër vetes hidhërimin e Allahut dhe vendi i tij është Xhehenemi. E ai është përfundim i keq. [8:16]

Urdhër për falangat muhamedane kundër jomuslimanëve!

Kërcënim për ata që mund të arratisen nga frika ose dëshira për të jetuar, kur binden se janë në pozicion të disfavorshëm për të fituar kundër luftëtarit kundërshtar.

Ju nuk i mbytët ata, por Allahu (me ndihmën që u dha) i mbyti. Dhe ti nuk i gjuajte ata, por Allahu i gjuajti, dhe e bëri këtë për t'i shpërblyer besimtarët me një dhunti të mirë nga ana e Tij. Allahu dëgjon dhe di gjithçka. [8:17]

Ajetet 8:12-17 mund të ndërlidhen edhe me ajetin 5:33, i cili është njësoj fashistoid si këta. Është fat i madh për njerëzimin e atëhershëm, që Muhamedi nuk kishte në dispozicion armë të zhdukjes në masë, se do t'i kishte vënë në zbatim. Për këtë të bindën më së miri mendësia kaq kriminale e fashistoide, që e ka paraqitur ai në kaq shumë ajete...!

Luftoni ata derisa të mos mbetet idhujtari, e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për Allahun. Po nëse ata ndalen, Zoti është mbikëqyrës për atë që veprojnë. [8:39]

Ky ajet përmban urdhrin „në emër“ të zotit, për të luftuar derisa të mos mbeten më idhujtarë, konkretisht, derisa të zhduken besimtarët paganë. Vetëm nëse ata konvertohen në islam, lufta kundër tyre mund të ndërpritej.

Vetëm besimtarët myslimanë mund të provojnë t'i mashtrojnë ata që nuk janë të informuar, se islami është fe paqësore, e mirëkuptimit, e tolerancës; se *Kurani* është doktrinë bazike, obligative, përjetësisht e pareformueshme. Këto ajete dëshmojnë se islami është fe e ngritur mbi dhunë tepër barbare.

As ky ajet nuk ka për autor Allahun muhamedan!

Ju ta dini se një e pesta e asaj që e fituat nga ndonjë send i takon Zotit, të dërguarit të Tij, të afërmve të tij, jetimëve, nevojtarëve dhe atyre në mërgim, nëse keni besuar Zotin, dhe atë që ia zbritëm robit Tonë ditën e furkanit, ditën e konfrontimit të dy grupeve... [8:41]

Tashmë përcaktohet konkretisht se sa plaçkë e luftës i takon sundimitarit, komandantit Muhamed, por ashtu si edhe herëve të tjera, e kamufluar si hise që u takon Zotit dhe jetimëve... Në bazë të këtij përcaktimi ndaheshin edhe gratë e vajzat, të zëna robinja. Por as Allahu dhe as jetimët e të varfrit nuk merrnin ndonjërin nga ato gra e vajza. Muhamedi i mbante për vete të bukurat, atraktivet. Ato që nuk i pëlqenin i nxirrte në tregun e skllaveve ose ua dhuronte xhihadistëve të tjerë, si skllave seksi, kështu siç veprojnë edhe aktualisht muhamedanët e „isisit“ në Siri dhe në Irak...

Në shumë raste kam mënjanuar tekstin sqarues brenda kllapave gjatë citimit të ajeteve dhe, ndoshta, shumëçka nuk do të kuptohet. Këtë mënjanim e kam bërë, me qëllim që të kemi tekst sa më autentik të *Kuranit* zanafillor. Ta zëmë, te shqipëruesi Ahmeti teksti përmyllës të këtij ajeti është: „...atë (*Kuranin*) që ia zbritëm robit Tonë (*Muhamedit*) ditën e furkanit (ditën e Bedrit, kur u dallua e vërteta nga e shtrembra), ditën e konfrontimit të dy grupeve. Zoti është i fuqishëm për çdo gjë.“

Ndonjë *Kuran*, si tërësi, derisa ishte gjallë Muhamedi (8.06.632) nuk i ka zbritur (as në ditën e furkanit), por herë pas here, sipas nevojës së tij, i „kanë zbritur“ vetëm ajetet. Më saktësisht, Muhamedi e ka sajuar doktrinën e tij gjatë 22 viteve. Meqë tashmë përmendet diçka që ngjan me *Kuranin* si format libri, rezulton se komisioni „redaktues“ i kalifit Utman duhet „ta ketë kompletuar“ formulimin e *Kuranit*, meqë ishte urdhëruar për ta kompletuar atë në format libri.

As përmbajtja e këtij ajeti nuk rezulton të jetë paqësore.

Përkujtoni kur u takuat, e Ai bëri që ata në sytë tuaj të duken pak, e po ashtu edhe ju të dukeni në sytë e tyre shumë; Zoti e bëri këtë, për të zbatuar një çështje që ishte e vendosur. Vetëm te Zoti është përfundimi i çështjeve. [8:44]

Sërish një mashtrim *a la* Muhamed për të motivuar xhihadistët për të marrë pjesë në luftëra. Atyre u premtohej rrejshëm përkrahja e zotit, edhe kur janë pak në numër dhe më të dobët se kundërshtari.

Rezultton se as ky ajet nuk është paqësor dhe nuk është formuluar nga zoti.

Dhe respektojeni Zotin e të dërguarin e Tij, e mos u përçani mes jush, e të dobësoheni e ta humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm, se Zoti është me të durueshmit. [8:46]

Sërish fragment për kompletim të platformës për luftëra fitimtare. Është një thirrje e Muhamedit, si gjithnjë „në emër të zotit“, e kamufluar sikur i „ka zbritur nga qielli“, drejtuar xhihadistëve që të respektonin profetin dhe të zbatonin urdhrat e komandantin të tyre. Ka mundësi që ky ajet i „ka zbritur“ Muhamedit në momentin kur po ballafaqohej me përçarje mes xhihadistëve gjatë grabitjes dhe ndarjes së plaçkës së luftës.

As ky ajet nuk mund të vlerësohet si paqësor, as i formuluar nga zoti.

Sikur t'i kishë parë engjëjt kur ua marrin shpirtin atyre që mohuan (do të shihje tmerr), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre (para, prapa): „Shijoni dënimin e djegies!“ [8:50]

Gjepura fashistoide muhamedane, tepër groteske!

Po nëse i ndesh ata në luftë, atëherë ti shpartalloji ata që të marrin mësim. [8:57]

Urdhër ushtarak, aspak paqësor!

*Posa të vëresh që ndonjë fis e thyen besën, edhe ti theyeje, në të njëjtën mënyrë prishe marrëveshjen, se Perëndia, me të vërtetë, nuk i do ata që tradhtojnë. [8:58]
/ shqipëruar nga H. E. Nahi]*

Këtë ajet Muhamedi duhet ta ketë sajuar për të arsyetuar pabesinë e tij ndaj fiseve jomyslimane, me të cilat duhet të ketë bërë ndonjëherë marrëveshje.

Le të mos mendojnë kurrsesi ata që nuk besojnë, se do t'i shpëtojmë, sepse ata nuk mund ta dobësojnë fuqinë e Perëndisë. [8:59 / shqipëruar nga H. E. Nahi]

Shfryrje muhamedane kundër jomyslimanëve, të cilët i sulmonin tashmë pa ndërprerje dhe pa shkas falangat xhihadiste të Muhamedit.

E ju përgatituni sa të keni mundësi e forcë, kuaj të caktuar për betejë kundër atyre e me të frikësojeni armikun e Zotit, armikun tuaj dhe të tjerët, të cilët ju nuk i dini, e Zoti i di ata. Çfarëdo që shpenzoni për rrugë të Zotit, ajo do t'ju kompensohet dhe nuk do t'ju bëhet padrejtësi. [8:60]

Sërish ajet për kompletim të platformës luftarake, për përhapjen e shpejtë dhe të përdhunshme të islamit muhamedan. Pra, është një si këshillë, thirrje, por më shumë si urdhër, që myslimanët xhihadistë të përgatiten për luftë. Jepet edhe premtimi se atë „që shpenzon për rrugën e zotit“ do të kompensohet. Por nuk është përcaktuar kur dhe nga kush do të kompensohet. Këtë e „ka harruar“ formuluesi Muhamed, sepse, nëse ndonjë xhihadist do t'i kërkonte kompensim, Muhamedi do të thoshte se kompensimi bëhet në botën tjetër (me hyria, që i kishin dhe i kanë aq shumë qejf besimtarët myslimanë, dhe me lumenj vere, mjalti e qumështi).

Përmbajtja nuk rezulton të jetë paqësore e as të ketë për autor Allahun.

O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, trima të fuqishëm, do t'i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundni një mijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë. [8:65]

Thirrje tejet luftarake. Mbase edhe kjo thirrje do t'u duket paqësore myslimanëve të angazhuar.

Janë interesante këto mashtrimet motivuese të Muhamedit, meqë në atë kohë ende nuk kishte shumë xhihadistë të thekur për luftime,

ndërkohë që priteshin luftëra kundër jobesimtarëve, siç i quante Muhamedi besimtarët paganë, të cilët duhej të konvertoheshin në myslimanë ose të vriteshin. Këto truke mashtruese përdorte Muhamedi, meqë fryma euforike luftarake te besimtarët e tij po rritej me shpejtësi. Sigurisht, kësaj i gëzoheshin dhe i gëzohen edhe sot myslimanët e devotshëm, edhe pse imponimi i islamit të tyre po ndodhte tashmë me dhunë ushtarake.

Rezulton sikur zoti e ka bërë këtë thirrje, por kjo është mjeshtri e ustait Muhamed, që t'i mashtrojë e t'i përvetësojë besimtarët e tij (në emër të zotit). Dhe, edhe sot, pas gati 14 shekujsh, vazhdojnë t'i besojnë qindra milionë besimtarë, sepse indoktrinimi dhe besimi fetar e përjashtojnë të menduarit racional.

Aspak paqësor nuk rezulton të jetë përmbajtja as e këtij ajeti.

Asnjë pejgamber s'ka të drejtë të ketë rob për vete, derisa të mos arrijë fitore të plotë në Tokë; ju i dëshironi të mirat e kalueshme të kësaj bote, kurse Perëndia dëshiron botën tjetër. Perëndia është i Ploftuqishëm dhe i Gjithëdijshëm. [8:67 / shqipëruar nga H. E. Nahi]

Çfarë përcaktimi është ky, përveçse idiotesk?! Cili „profet“ mund të arrijë fitore të plotë në tokë?! Për cilët „profetë“ ishte fjala?! Nga Jezusi deri tek Adami (24 profetë, sipas dogmës islame), që janë të emërtuar nga sajuesit e judaizmit dhe kristianizmit, dhe 214.000 të tjerë, që nuk iu dihen as emrat, tashmë ishin të vdekur. Vetëm „profeti“ Muhamed ishte i gjallë. E ai e kishte shpallur veten të fundit dhe „vulë“. Pra, ai kishte për veten këtë lloj ëndërrimi! Vërtet optimist injorant!

Islamologu „dezertor“ Ibn Warraq, në studimin e tij „Pse nuk jam mysliman“, (dez)informon se, sa ishte gjallë Muhamedi, me hatër dhe me zor, mundi të konvertojë në islam vetëm rreth një mijë veta.

Të thuash se Perëndia dashuron vetëm „botën tjetër“, ngjan si blasfemi. Dhe kjo i shpifet atij në „veprën“ autoriale të tij (*Kuran*), edhe pse edhe formulimi gjuhësor e diskrediton autorësinë e Allahut...

Pra, hani atë që e fituat me luftë, si të lejuar dhe të mirë, përmbajuni dispozitave të Zotit, se Zoti është Ai që fal dhe që mëshiron. [8:69]

Sërish për prenë e luftës, sepse Muhamedi, duke u nisur nga vetvetja, e dinte se ai është motivimi kryesor për të pasur sa më shumë xhihadistë.

Është e vërtetë se ata që besuan, u shpërngulën dhe luftuan me pasurinë e shpirtin e tyre në rrugën e Zotit, dhe ata që strehuan dhe u ndihmuan, ata janë miq të njëritjetrit. Ata që besuan, por nuk u shpërngulën (...) nëse kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'i ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që të keni marrëveshje me të. Zoti e mbikëqyr atë që ju bëni. [8:72]

Ajeti i kushtohet fazës pas arratisjes së Muhamedit me besimtarët e tij nga Meka në Medinë, ku Muhamedi vetëlavdërohej dhe udhëzonte besimtarët se çfarë qëndrimi duhej të mbanin ndaj mekasve myslimanë, të cilët nuk ishin arratisur. Duket se kjo ka karakter propagandistik, meqë dihet se Muhamedi, me të gjithë besimtarët e tij, qenë arratisur nga Meka, ku nuk mbeti ndonjë besimtar mysliman. Kjo përmbajtje nuk është në shërbim të një feje paqësore e hyjnore. Ky është fragment i platformës luftarake të Muhamedit, i cili duhet të jetë edhe autor i tij.

E kur të kalojnë muajt e shenjtë, luftoni paganët kudo që t'i gjeni, robërojini dhe ngujojini ata, zëruni pritë në çdo shteg. Në qoftë se pendohen, falin namazin dhe e japin zeqatin, atëherë lëshojuni rrugën, se vërtet Zoti falë është mëshirues. [9:5]

Urdhër tepër i qartë luftarak: si duhet të luftojnë dhe çfarë duhet të bëjnë me robërit e luftës. Pavarësisht nga kjo, sërish ka besimtarë myslimanë që këmbëngulin se islami ishte dhe është fe paqësore, e përhapur paqësisht.

Ky tekst nuk rezulton të jetë formulim i Allahut. (Zoti, të cilit i atribuohen të gjitha madhësitë, formulonte edhe të tillë tekst, kaq të përdhunshëm, për të dëshmuar se nuk është në gjendje t'i brumosë njerëzit paqësisht, me udhëzime të tij, pos me dhunë, përmes xhihadistëve që i ngarkon...).

Pse të mos e luftoni një popull që thyen zotimet e veta dhe tentoi ta dëbojë të dërguarin? Në të vërtetë ata e filluan të parët luftën. A u frikësoheni atyre? Më e drejtë është t'i frikësoheni Zotit, nëse jeni besimtarë. [9:13]

Pyetje interesante. Një grusht besimtarësh, të sapokonvertuar në islam, gjykojnë se kanë të drejtë ta luftojnë „një popull“ (është fjala për banorët e Mekës), sepse e dëbuan Muhamedin. Nuk është e vërtetë që banorët e Mekës e filluan të parët luftën. Ata vetëm nuk e lejuan Muhamedin dhe Hatixhenë (bashkëshorten e parë të Muhamedit, dhe myslimanen e dytë, meqë i pari ishte Muhamedi) të bënin lutje në Qabenë e tyre pagane, sipas riteve që po sajonte Muhamedi. Pra, Muhamedi po insistonte në përvetësimin e Qabesë, kurse besimtarët e saj po e mbronin.

Të tilla gënjeshtër nuk kanë si të jenë profetike, hyjnore, paqësore dhe as formulime të asnjë lloji zoti.

Luftojini ata! Zoti i dënon dhe i mposht ata nëpërmjet jush, e juve ju ndihmon kundër tyre dhe shëron zemrat e njerëzve besimtarë. [9:14]

Urdhëresë tepër demagogjike, dogmatike e mashtruese. Zoti nuk qenka në gjendje t'i mposhtë vetë „ata“, por iu dashka lufta e Muhamedit dhe xhihadistëve të tij?! Po të ishte në gjendje zoti për t'i ndihmuar, do ta bënte vetë luftën - do të thoshte arsyeja rationale. Ndërsa myslimani i devotshëm e ha edhe këtë karrem, sepse besimi ia privon mundësinë e të menduarit.

As kjo urdhëresë nuk rezulton të jetë paqësore.

Ata të cilët besuan, migruan dhe luftuan me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e Zotit, ata kanë pozitë më të lartë te Zoti dhe vetëm ata janë fatlumë. [9:20]

Besoni, po deshët, në këto premtime joshëse për t'u bërë xhihadistë! Besimtari u beson, jobesimtari i çmon për mashtrime që nxitin krimin.

Rezultoni të mos jetë i formuluar nga zoti dhe aspak paqësor.

Nuk ka dyshim se Zoti ju ka ndihmuar në shumë beteja, edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë, dhe me gjerësinë e saj që kishte toka u ngushtua për ju, pastaj ju u zbrapsët. [9:25]

Ky ajet u dedikohet betejave në Al-Hunain, në fund të vitit 630. Sërish një mashtrim motivues, për të nxitur gatishmërinë për të bërë beteja e lufta, për të përhapur përdhunshëm „rrugën e Zotit“. Kush duhet të jetë autori i këtij teksti, meqë thotë: „*Nuk ka dyshim se Zoti ju ka ndihmuar në shumë beteja?* Muhamedi apo Komisioni i Utmanit?

Vetëm paqësore nuk është përmbajtja as e këtij ajeti.

Luftoni ata që nuk besojnë Zotin e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar atë që e ndaloi Zoti dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë... [9:29]

Urdhër për luftë kundër të gjithë atyre që nuk janë myslimanë. Ky ajet i është dedikuar betejës në Tabuk, të armatës prej 30 mijë ushtarësh të komanduar nga Muhamedi, kundër ushtrisë bizantine (tetor-dhjetor 630). Dhe këto luftime vërtet vazhduan gjatë 14 shekujve e vazhdojnë edhe tani, por për momentin janë përqendruar kryesisht në luftime mes sekteve islamike. Merita kryesore për këto luftime gjithsesi i takon Muhamedit, sepse ai sajoi një doktrinë dhe praktikë tejet joshëse (bazuar kryesisht në vesin e tij: eposhin seksual; shumë gra në „këtë botë“, kryesisht robëresha lufte, 73 hyria në „botën tjetër të përhershme dhe potencë të madhe seksuale për t'u kënaqur me ato 73 „virgjëresha“ etj.).

Kush, pos besimtarëve, mund të vlerësojë se ky ajet nuk ka përmbajtje pro dhunës e luftës për të imponuar islamin?! Prandaj (vetë)-mashtrimet se islami është fe paqësore, tashmë janë bërë edhe bajate.

O ju që besuat, vërtet një shumicë e parisë fetare e jehudinje dhe e të krishterëve, në mënyrë të paligjshme e hanë pasurinë e njerëzve dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Ata të cilët e ruajnë arin e argjendin e nuk e japin për rrugën e Allahut, lajmëroji për një dënim të dhembshëm. [9:34]

Atë ditë kur ajo (pasuri e deponuar) fërgohet në prushin e Xhehenemit, e me të (ashtu zharavë) lyhen ballët, anët dhe shpinat e tyre (do t'u thuhet): „Kjo është ajo që e përvetësuar për veten tuaj, pra shijoni atë që zotëroni!“ [9:35]

Sa qesharake! Ndoshta ky është formulimi më i saktë i Muhamedit për priftërinj e murgj, por kërcënimi është një *blof* që ata i bën për të qeshur, meqë ata e dinë, pothuajse më së miri, se nuk do të ketë asnjë dënim në „botën tjetër“...

...Luftoni të gjithë idhujtarët pa dallim, siç ju luftojnë ata juve pa dallim, e dijeni se Zoti është me ata që ruhen. [9:36]

Njësoj, urdhër për të luftuar të gjithë ata që besojnë ndryshe...

O ju që besuat, ç'është me ju, që kur ju thuhet: „Luftoni në rrugën e Zotit!“, ju u rënduat në vend. A mos ishit më të kënaqur me jetën e kësaj bote sesa me atë të ardhmen? Përjetimi i jetës së kësaj bote ndaj asaj së ardhmes nuk është asgjë. [9:38]

Ja, çfarë premtimi mashtrues, i cili ka mashtruar e motivuar xhihadistët atëherë dhe tani. Asnjë dilemë: fe e dhunshme, agresive - mendësi muhamedane!

Nëse nuk shkoni në luftë, Ai do t'ju dënojë me një dënim të rëndë, ju zëvendëson me një popull tjetër dhe Atij nuk i bëhet fare dëm. Zoti është i gjithëfuqishëm për çdo gjë. [9:39]

Kërcënim tipik muhamedan - aspak paqësor e hyjnor! Çfarë duhet të ketë menduar Muhamedi, me cilin popull do t'i zëvendësonte ata që nuk shkojnë në luftë dhe si do ta realizonte këtë zëvendësim?! Ja një segment i mendësisë së tij skandaloze!

Në mos e ndihmofshi atë, atëherë e ka ndihmuar Zoti; kur ata që nuk besuan e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: „Mos u frikëso, Zoti është me ne!“ E Zoti i zbriti qetësi atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ulëtën, kurse fjala e Zotit (është) më e larta. Zoti është më i fuqishmi, më i urti. [9:40]

Ky ajet i dedikohet natës së 16 korrikut 622, kur paria e fisit Kurejsh kishte marrë vendim në kuvend të hapur, që ta vrisnin Muhamedin për agresivitetin e tij kundër Qabesë. Ai, tashmë, kishte filluar të demolonte rekuizitat e kultit të idhujtarisë që ishin aty.

Për t'i shpëtuar vrasjes, Muhamedi, me ndihmën e Ebu Bekrit, u fsheh në shpellë, buzë Medinës. Aty kaloi natën. Ndjekësit shkuan deri të hyrja e shpellës, por brenda nuk kontrolluan. Sipas legjendave islame, ata panë që merimanga kishte ngritur rrjetën e saj në hyrje të shpellës. Ndjekësit kur panë atë rrjetë merimange, thanë se ai nuk duhet të kishte hyrë aty, meqë, po të hynte në shpellë, do ta prishte rrjetën. Ky ishte edhe shkaku që Muhamedi e shenjtëroi merimangën. Nga shpella, Muhamedi dhe Ebu Bekri u arratisën në drejtim të Medinës. Atë ditë, kalifi Ebu Bekri e ka shpallur si ditën NJË të kalendari islam (hixhri).

Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rëndë, luftoni për hir të Zotit me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni. [9:41]

Sërish apel e urdhër për luftë sa më gjithëpërfshirëse, „për hir të Allahut“ (sikur ai të ishte kriminel më ordiner, i cili nuk është në

gjendje të bëjë mrekulli paqësisht, por i duheshin xhihadistët për të luftuar e për të realizuar marrëzitë e tij).

Sikur të ishte fitim i afërt dhe udhëtim mesatar, ata do të vinin pas teje, por për ta ishte largësi e vështirë. Ata do të betohen te Zoti: „Sikur të kishim pasur mundësi, do të dilnim me ju“. E shkatërrojnë veten e tyre; Zoti e di se ata janë rrenacakë. [9:42]

Ky tekst i dedikohet arratisjes së Muhamedit nga Meka në Medinë. Përmbajtja e tij është sërish tepër e përcartë. Në fakt, realistët nuk befasohen, nëse janë të informuar për nivelin intelektual të atyre gjysmanalfabetëve të udhëhequr nga Muhamedi.

Ata që besojnë Zotin dhe botën tjetër, nuk të kërkojnë leje për të luftuar me pasurinë dhe veten e tyre. Zoti i di të sigurtit. [9:44]

Tashmë Muhamedi sugjeron që të luftojnë, kundër kujt e kur t'u teket, edhe pa i kërkuar leje atij.

Vetëm ata që nuk besojnë Zotin dhe botën tjetër dhe që zemrat e tyre janë të dyshimta, kërkojnë leje për luftime. Pra, ata sillen vërdallë në dyshimin e tyre. [9:45]

Sikur nuk i mjaftoi ajeti pararendës, që ai e ritheksoi luftimin e përhershëm xhihadist, „në rrugë të Allahut“ dhe „në emër të Allahut“, si tani në Siri e Irak, pa pasur nevojë t'i merrej leja për luftë. Marrëzi çoroditëse, që nuk i ka hije fare një udhëheqësi. Profetit jo që jo!

O Pejgamber, luftoji jobesimtarët dhe hipokritët dhe sillu rreptë ndaj tyre - vendi i tyre është Xhehenemi, që është përfundimi më i keq. [9:73]

Edhe një urdhër që Muhamedi ia jep vetes së tij (dhe, vetëkuptohet, vartësve të tij), duke e kamufluar për mashtrim, si urdhër i Allahut.

Ky nuk është as urdhër i Allahut, as ajet paqësor. Është urdhër për ushtrim të dhunës ekstreme. Edhe këtë urdhër myslimanët e quajnë të arsyeshëm dhe, prandaj, edhe e besojnë...

Ata që mbetën (pa shkuar në luftë), u gëzuan për qëndrimin e tyre pas të dërguarit të Zotit dhe nuk dëshiruan që të luftonin me pasurinë dhe veten e tyre në rrugën e Zotit. Ata thanë: „Mos dilni (në luftë) në këtë vapë!“ Thuaju: „Zjarri i Xhehene-mit ka vapë më madhe, nëse janë që kuptojnë!“ [9:81]

Ky ajet ka të bëjë me betejën në Tabuk, ku marshuan falangat xhi-hadiste të Muhamedit, por që trupat bizantine nuk dalin në front. Ato u pritën disa ditë, por nuk u shfaqën, duke i lënë trupat e Muhamedit t'i përcëllonte dielli. Muhamedi tashmë ishte përgatitur për t'u përballur me ushtrinë bizantine dhe synonte pushtimin e hapësirave të Sirisë. Kjo është dëshmi se fryma e islamit i kishte motivuar besimtarët myslimanë të zgjeronin pushtimit, meqë preja e luftës i dëfrente dhe i pasuronte.

Gjatë marshimit drejt veriut, Medina-Tabuk, trupat e Muhamedit nënshtruan popullsitë vendore, hebreje e kristiane, i konvertuan përdhunshëm në islam, ndërtnuan 18 xhami të vogla (sipas biografit të Muhamedit, Ibn Isak). Kështu, edhe kjo hapësirë, u përfshi në Uman Medinase (komunitetin).

Ajet që i dedikohet luftës, ajet aspak paqësor, që nuk ka për autor as Allahun muhamedan!

Por i dërguari, e së bashku me të edhe ata që besuan, luftuan me pasurinë dhe veten e tyre dhe atyre u takuan të gjitha të mirat. Ata janë të shpëtuarit. [9:88]

Një vetëlavdërim i Muhamedit, më pak i vlefshëm, sesa po të frynte ndonjë erë freskuese në atë shkretëtirë përcëlluese...

Zoti bleu prej besimtarëve jetët dhe pasurinë e tyre me xhenet. Luftojnë në rrugën e Zotit, mbysin dhe mbyten. (Zoti dha) Premtim, të cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kuran. E kush është zbatues më i sigurt i premimit të vet se Zoti? Pra,

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

gëzojuni tregtisë që bëtë me Të. Ky është sukcesi i madh. [9:111]

Neveritëse! Muhamedi duhet t'i ketë përçmuar ithtarët e tij për ulokë, të cilët edhe të tillë marrëzi e gëlltisnin, madje edhe e besonin. Ata që besojnë se ka Allah dhe ia mveshin atij autorësinë për këtë ajet, vërtet duhet të jenë injorantë e trutredhur!

O ju që besuat! Luftoni jobesimtarët që keni afër jush, e le ta ndiejnë prej jush grushtin e fortë kundër tyre. E dini se Zoti është me të devotshmit. [9:123]

Thirrje tejet luftarake për të luftuar të gjithë ata që nuk janë myslimanë, duke filluar që nga fqinji i parë. Edhe një dëshmi se islami ka për fundament doktrinën dhe praktikën e dhunës. Përmes premtive joshëse dhe dhunës, islami është imponuar dhe përhapur shumë shpejt, për të pasur tashmë qindra milionë besimtarë, që shpresojnë në islamizimin e gjithë botës, rrjedhimisht në shndërrimin e gjithë botës në një kalifat të vetëm islam.

Ne kemi shkatërruar gjenerata para jush (o idhujtarë), sepse nuk besonin, edhe pse të dërguarit u erdhën me argumente të qarta. Kështu i shpërblejmë Ne njerëzit kriminelë.[10:13]

Fragmente legjendare, që nuk përkojnë me historira të vërteta. Është në frymën, stilin e mendësinë e poetëve popullorë, që të sajojnë e propagandojnë legjenda. Ky fragment është menduar ndoshta të shërbejë si kërcënim për ata që nuk e besojnë dhe nuk e praktikojnë marrëzinë muhamedane!

E ata (populli i tij) e konsideruan atë (Nuhin/Noa) rrenacak e Ne e shpëtuan atë dhe ata që ishin bashkë në anije, dhe i bëmë që ata të jenë pasardhës, kurse ata që përgënjeshtruan ajetet tona i përmbytëm. Shih pra, si ishte fundi i gënjeshtarëve.[10:73]

Edhe një legjendë tjetër lidhur me të ashtuquajturën përmbytje madhe (botërore). Allahu i paskësh shpëtuar vetëm Noan me gruan dhe tre djemtë dhe gratë e tyre, si dhe shumë çifte gjallesash, hipur në një arkë...

Nuk di nëse në ndonjë gjuhë tjetër përdoret emërtimi *ark(ë)* për një kuti të madhe me dërrasa druri, për të vendosur gjësende në të, siç quhet në gjuhën shqipe dhe, si e tillë, është përdorur në Bibël!

Gjithandej bëhen përpjekje nga besimtarët, për të arsyetuar disi këtë gënjeshtrë të madhe që e përmbajnë të gjithë „librat e shenjtë“!

Ata kanë dënim në jetën e kësaj bote, e s'ka dyshim se dënimi i botës tjetër është shumë i rëndë. Ata nuk ka kush t'i mbrojë prej ndëshkimit të Allahut. [13:34]

Kërcënim i stërpërsëritur, por gjithashtu i përçartë, meqë nuk është konkretizuar kundër kujt janë gjithë ato kërcënime me dënime tipike muhamedane.

Të Allahut, i të cilit është çka në qiej dhe çka në tokë. Është mjerim për mohuesit, për dënimin e ashpër që i pret.[14:2]

Broçkull tipike muhamedane, që nuk ka për autor Allahun muhamedan. Por sërish kërcënim ndaj besimtarëve politeistë.

Lufto haptas atë për të cilën urdhërohesh, largoju paganëve. [15:94]

Urdhër aspak paqësor e hyjnor për luftimin e paganëve!

Atyre që nuk besuan dhe penguan nga rruga e Allahut, u shtojmë dënim mbi dënim, për shkak se bënë shkatërrime.[16:88]

Kërcënim tipik muhamedan ndaj jomyslimanëve.

Pastaj Zoti yt, atyre që pasi u torturuan, migruan, mandej luftuan dhe qëndruan, dhe pas të gjitha këtyre vuajtjeve, s'ka dyshim se Zoti yt atyre do t'ua falë dhe do t'i mëshirojë. [16:110]

Rëndom folja *xhihad* (shqip: *përpiqem, luftoj*), varësisht nga kontesti, ka edhe kuptime të tjera, si në këtë rast „luftuan“. Nga përmbajtja duket se këtë tekst Muhamedi ia ka dedikuar vetes dhe besimtarëve të tij, pasi u arratisën së bashku nga Meka në Medinë.

Ajet me përmbajtje aspak paqësore, kurse autorësia është e ngatërruar. Allahu jo, por me gjasë as Muhamedi nuk është autor i këtij teksti. Autorësia i mbetet ndonjë bashkëveprimtari ose komisionit „redaktues“ të kalifit Utman.

Kur duam të shkatërrojmë ndonjë vend (popull), i urdhërojmë pasanikët të korruptohen, e ndaj tyre atëherë zbatohet dënimi i merituar dhe i shkatërrojmë krejtësisht. [17:16]

E tmerrshme, çfarë mendësie perverse muhamedane!

Sa e sa gjenerata Ne i kemi shkatërruar pas Nuhut! E mjafton që Zoti yt di dhe sheh mëkatet e robërve të Tij. [17:17]

Vetëkënaqësi kriminale, tipike muhamedante, që nuk ka të bëjë me të vërtetat historike!

Kush ka për qëllim vetëm këtë botë, Ne atij që duam i japim aq sa duam, e pastaj atij i bëjmë të hyjë në Xhehenem i nënçmuar, i përbuzur.[17:18]

Mendësi muhamedane për të stimuluar të keqen për hir të dënimit!
Mendësi sadiste!

Ato janë vendbanime që Ne i shkatërroam, për shkak të zullumit dhe për shkatërrimin e tyre u patëm caktuar kohë të sakta.[18:59]

Sërish legjenda të shëmtuara, të mbingarkuara me mllef, që nuk përkojnë me asnjë të vërtetë historike.

Sa e sa brezni kemi shkatërruar Ne para tyre. Vallë a po sheh ndonjë prej tyre dhe a po dëgjon pëshpëritjen më të vogël të tyre? [19:98]

Sërish legjendë gënjeshtare muhamedane, në shërbim të sforcimit të frikës.

Banorët e qyteteve para tyre nuk i besuan, prandaj Ne i shkatërruam. A mos do të besojnë këta? [21:6]

Sërish broçkull legjendare, që nuk ka të bëjë aspak me realitetit historik. Është pjesë e platformës së Muhamedit për t'i frikësuar sa më shumë turmat injorante!

Mjerimi i tyre vazhdoi ashtu, derisa i bëmë të korrur e të ftohur. [21:15]

Sajesë legjendare, që përmban inate kundër izraelitëve!

Ne e mbrojtëm atë prej atij populli që përgënjeshtrojnë argumentet Tona. Vërtet ai ishte popull i keq, prandaj i përmbytëm. [21:77]

Mendësi e antiprofitit Muhamed, shovinist, racist, fashist! Si mund të bashkëjetojnë myslimanët fundamentalistë me popullin izraelit, kur detyrohen të praktikojnë këso përcaktimesh?! Dhe kjo është duke u konvnuar edhe nacionalistëve izraelitë, për të arsytuar pushtimin e Palestinës dhe luftimet kundër palestinezëve...

Këto janë dy grupime kundërshtare (besimtarë dhe jobesimtarë) që janë zënë rreth Zotit të tyre; e atyre që nuk besuan, u qepën rroba prej zjarri e u hidhet uji i valuar mbi kokat e tyre. [22:19]

Muhamedi i ka frikësuar, deri në asgjësim, besimtarët politeistë dhe hebrenj. Por ai duhet të ketë gënjyer, sepse para nxitjes së armiqësive nga Muhamedi, në Mekë ka mbretëruar një bashkëjetesë paqësore mes besimtarëve politeistë si shumicë e madhe, e besimtarëve hebrenj si pakicë më e vogël, si dhe ca kristianëve ekzotikë, si misionari Vereka (xhaxhai i Hatixhesë). Në Qabenë pagane janë toleruar edhe rekuizitat hebreje e kristiane. Edhe lutjet e Muhamedit janë

toleruar buzë Qabesë, meqë si kryebashkiak i Mekës ishte Ebu Talibi, khaxhai i Muhamedit, njëherazi edhe kujdestari familjar i Muhamedit, derisa ai u angazhua si skllav te Hatixheja.

Për përshkrimet se çfarë dënimi i pret ata në ferr, mjafton tashmë të diskualifikohen, si pjellë dobiçe e mendësisë devijante të Muhamedit!

A tyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtësi, e Zoti ka fuqi për t'i ndihmuar ata. [22:39]

Ky ajet duhet të jetë sajuar në prag të betejës në Bedër, në vitin 624, mes xhihadistëve të Muhamedit dhe fisit Kurejsh të Mekës. „Zoti islam do t'i ndihmojë xhihadistët“ - ky është truku më mashtrues e më motivues që Muhamedi e ka (sh)përdorur, për të brumosur xhihadistë me trimëri luftarake.

Ky nuk është ajet paqësor e hyjnor. As Allahu nuk është autor i tij. *(U luftuan) Ata, të cilët vetëm pse thanë: „Allahu është Zoti ynë!“, u dëbuan pa kurrfarë të drejte. E sikur Allahu të mos i zmbapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastire, kisha dhe xhami, ku në to përmendet shumë emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se Allahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues. [22:40]*

Gënjeshtër ordinere muhamedane kundër banorëve të Mekës, që e kundërshtuan plëngprishësin vandalist Muhamed, për të mos blasfemuar kundër fesë së tyre, meqë kishte filluar t'ua demolonte statujat e rekuizitat e idhujtarisë se tyre (siç veprojnë aktualisht xhihadistët muhamedanë në Siri dhe Irak.

E sa fshatra që ishin zullumqare i shkatërruan Ne, e ato janë të rrënuara mbi kulmet e tyre dhe sa bunarë kanë mbetur shkretë e sa pallate të larta! [22:45]

Nuk janë dëbuar nga Meka aspak padrejtësisht rreth 140 muhamedanë! Ata janë toleruar më gjatë se 12 vjet (01 shkurt 610 - 16 korrik

622), derisa nuk janë bërë agresivë fizikisht, duke i thye skulptura pagane.

Do të kishte qenë një fatkeqësi më pak për njerëzimin, sikur Kurjshët të kishin qenë më të vendosur e më operativë për ta vrarë me kohë Muhamedin!

E ata që për hir të Zotit braktisën atdheun e tyre, u vranë ose vdiqën, Zoti do t'i shpërblejë me shpërblimin më të mirë, e s'ka dyshim, Zoti është shpërblyesi më i mirë. [22:58]

Sërish një premtim motivues për luftime, që po stërpërsëritet, me pak ndryshime, duke e bërë të bezdisshëm *Kuranin* për lexim të këndshëm. Myslimanët vetë nuk janë në gjendje të kuptojnë si është komprometuar Allahu i tyre - si shpërblyesi i vandalistëve ordinerë...

Luftoni me një luftë të denjë për hir të Zotit, se Ai ju zgjodhi ju dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, edhe ky ju quajti myslimanë... [22:78]

Sërish kërcënime e urdhërime për luftë „për hir të Zotit“. Tashmë duhen mashtruar, manipuluar e motivuar xhihadistët, sikur ata qenkan të përzgjedhur nga vetë Allahu për të luftuar për „rrugën e tij“ (meqë vetë Allahu nuk qenkësh i zoti për të luftuar). Ja, „babai Ibrahim“, për të cilin shkenca e historisë ka dilema nëse ka ekzistuar një njeri i tillë, ku dhe kur ka ekzistuar e vepruar. Me këtë ajet Muhamedi e shpalli Abrahamin mysliman, ia arabizon edhe emrin (sepse ai, pavetëdijshëm, është në nismën e krijimit të një perandorie të madhe arabe). Kështu vepronte „analfabeti“ Muhamed, sepse atij i duhej e „drejta historike“ sa më e largët në kohë, për të arsyetuar pushtimin dhe përvetësimin e Qabesë dhe të hapësirave ku mendohet se është sorollatur Abrahami.

As ky ajet nuk ka përmbajtje aspak paqësore. Kështu, po shtohet numri i ajeteve të dhunshme, agresive e fashistoide, saqë po më

krijohet përshtypja sikur po lexoj „Mein Kampf“ të Hitlerit (të cilin ende nuk e kam lexuar, pos një përmbledhjeje të citateve)...

U thamë: „Shkoni ju të dy tek ai popull (izraelit) që i përgënjeshtroi argumentet Tona!“ E Ne pastaj i shkatërruam ata shumë keq.[25:36]

Vazhdon inati fashistoid muhamedan kundër besimtarëve hebrenj...

Po ti mos i dëgjo jobesimtarët e luftoi ata me të (Kuran) me një luftë të madhe. [25:52]

Kush dhe kë këshillon nuk del e qartë. Nga ajetet pararendëse, Allahu e këshillon Muhamedin, që të bëhet sa më i zoti për një luftë të madhe, bazuar në doktrinën kuranore (edhe në këto ajete që po shqyrtojmë).

Do të ishte një inkriminim, po u vlerësua se *Kurani* ka përcaktime paqësore, hyjnore, kur ke parasysh përcaktimet e këtyre ajeteve që u shqyrtohen dhe që do të shqyrtohen në vazhdim.

Pra, përpos Allahut, mos lut zot tjetër e të bëhesh prej të dënuarve! [26:213]

Edhe në këtë ajet mungon konkretizimi kujt i drejtohet dhe si kush të mos bëhet. Edhe pse i përcartë, vetëkuptohet se mbizotërohet nga fryma kërcënuese, aspak hyjnore.

E sa vendbanime, banorët e të cilave u degjeneruan, Ne i kemi shkatërruar, e ja, ato janë shtëpitë e tyre, që pas tyre ato pak kohë janë banuar prej dikujt dhe Ne ishëm trashëgues të tyre. [28:58]

Legjendë aspak historike, por mendësi muhamedane, e dominuar nga urrejtja dhe armiqësia ndaj hebrenjve. Tashmë sikur ngjan se Muhamedi dhe Allahu janë në garë mes tyre, se cili është më barbar, që do të thotë se Muhamedi po sajonte fiksinin e tij Allah, më kriminel sesa mendësia e vet që e mbisundonte.

E kush lufton, ai bën luftë për vete, se Zoti vërtet nuk ka nevojë për askënd në tërë botën. [29:6]

Ky ajet është pothuajse përsëritja e një ajeti të shqyrtuar më lart. Mbase nuk është ndonjë defekt i madh, sepse të sajosh gjithë këto ajete dhe të mos ndodhin përsëritje e kundërshti mes tyre, kjo është e pamundur, sidomos po të kihen parasysh koha, rrethanat e sajimit të tyre dhe autorët injorantë e devijantë psikikë.

Edhe në kohën tonë krijohen ekipe të mëdha, me mundësi të mëdha elektronike, për të hartuar, ta zëmë, projekt-kushtetuta, dhe në fund, mund të rezultojë se ndonjë nen përsëritet ose është në kundërshtim me ndonjë nen tjetër, por e keqja e tmerrshme përmbahet në pyetjen: pse kaq shumë përcaktime këmbëngulëse për dhunë, beteja, luftëra, agresion, pushtime, plaçkitje, përdhunime?

E ata, të cilët luftuan për hirin Tonë, Ne me siguri do t'i orientojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se Zoti është në krahun e bamirësve. [29:69]

Sërish shpërblime motivuese për të luftuar edhe më me përkushtim e trimëri...

Po ka nga njerëzit që blenë tregime boshe, me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së Zotit pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato, ajetet e Zotit, si tallje. Për ta me siguri është përgatitur dënim i turpshëm. [31:6]

Formulim i përçartë, që përmban kërcënim për dënim.

Dhe Zoti i zmbropsi paganët e mllëfosur, duke mos arritur asgjë. Dhe Zoti ua largoi luftën besimtarëve. Zoti është i fuqishëm, ngadhënjës. [33:25]

Fatkeqësisht edhe një marrëzi më tepër, tipike muhamedane!

E ata nga ithtarët e librit, të cilët i ndihmuan paganët, Ai (Zoti) i nxori prej kështjellave të veta dhe në zemrat e tyre u shtiu frikën, ku një grup e mbyti, kurse tjetrin e robëroi. [33:26]

Në këtë ajet Muhamedi ka rrëfyer se çfarë krimesh luftarake ka bërë kundër bashkëvendësve të besimit jahudi. Pra, me *Kuran* dëshmohet se sa barbar ishte Muhamedi kundër jomuslimanëve...

E juve jua la trashëgim tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasurinë e tyre dhe tokën që ende nuk e keni shkelur. Zoti është i gjithë-fuqishëm për çdo send. [33:27]

Këto ajete u dedikohen sulmeve që ndërmori fisi Kurejsh ndaj Medinës. Muhamedi, i këshilluar nga djali i tij i birësuar, urdhëron të hapen kanale të thella e të gjera rreth Medinës, që sulmuesit të mos i afrohen murit rrethues të qytetit, hipur sipër kuajve. Për shkak të kanaleve, ajo është quajtur *Lufta e Varreve*. Dy forcat luftuese qëndruan disa ditë ballë për ballë, pa sulmuar...

Rasti kur është sajuar ajeti dhe ngjarja të bëjnë të mendosh se Muhamedi i ka sajuar ajetet në bazë të rrethanave. Ato nuk kanë të bëjnë me doktrina të formuluar në tryeza pune. Por, vetëkuptohet, sapo është frymëzuar e tunduar nga ngjarjet, Muhamedi e ka bërë formulimin e ajetit dhe ua ka rrëfyer besimtarëve të pranishëm, duke i mashtruar: „Sapo me zbriti nga qielli...“.

Në atë luftë, pjesëtarë të fisit jahudi të Medinës janë akuzuar për ndihmë që u kanë dhënë sulmuesve mekas. Ata, pastaj, janë dënuar për tradhti. Burrat janë ekzekutuar, kurse gratë e fëmijët janë zënë robër. Pasuria e tyre është ndarë mes xhihadistët. 20 % e saj i ka takuar Muhamedit.

Nëse hipokritët dhe ata që kanë zemra të sëmura, dhe ata që përhapin gënjeshtria në Medinë nuk ndalen, Ne do të bëjmë që ti të dominosh mbi ta e pastaj ata nuk do të jenë fqinjë me ty në të, vetëm një kohë të shkurtër. [33:60]

(Do të jenë) Të mallkuar, kudo që të ndeshen, do të kapen dhe do të mbyten. [33:61]

Këto ajete u dedikohen hebrenjve të Medinës, të cilët janë akuzuar për aleatë të paganëve medinas (kushërinjve të Muhamedit). Përcaktim kriminal, gjithsesi! Aspak paqësore e hyjnor!

Ata që u përpoqën t'i mposhtin faktet Tona, ata do të kenë një dënim të keq e të dhembshëm. [34:5]

Përcaktime kërcënuese ndaj atyre që e kundërshtojnë imponimet e islamit. Po vetëkuptohet, aspak profetike e hyjnore, pos për mendësitë devijante muhamedane!

Ndërsa ata (jomyslimanët) që përpiqen t'i mposhtin argumentet Tona janë të dënuar. [34:38]

Kërcënim muhamedan për të imponuar islamin.

E sikur t'i shohësh ata kur i kap frika e nuk kanë shpëtim edhe të kapen prej një vendi afër (do të shihje tmerr të madh). [34:51]

Kërcënim tipik muhamedan kundër atyre që i rezistojnë islamizimit.

Ne u kemi varur në qafë pranga e ato u arrijnë deri te nofulla, ndaj ata mbesin me koka lart. [36:8]

Formulim i përçartë, gjithsesi me përmbajtjen e dhunës. Mendohej se pranga në qafë ishte aq e trashë, sa i prangosuri do të detyrohet ta mbante kokën lart. Dhe vetëm të painformuarit irritohen kur shohin veprimet e xhihadistëve muhamedanë, në kalifatin muhamedan, të quajtur „isis“, kur i prangosin jomyslimanët ose myslimanët e sekteve të tjera. Propagandistët mashtrues myslimanë belbëzojnë se këta xhihadistë nuk iu përmbahen parimeve islame. Por ja që prangat janë të parapara me *Kuranin* muhamedan...

dhe se ushtria jonë do të jetë fitimtare! [37:173]

Prandaj, për një kohë, ti hiqiu tyre. [37:174]

E ti vështroji ata se edhe ata do ta shohin. [37:175]

ISLAMI, religion agresiv (?!)

A mos po kërkojnë shpejtimin e ndëshkimit tonë? [37:176]

E kur të vjen ai në territorin e tyre, mëngjes i shëmtuar do të jetë për ata që u ishte tërhequr vërejtja.[37:177]

Ushtria duhet të jetë ajo që do të hakmerret kundër atyre që nuk i pranojnë sajimet e Muhamedit (meqë në këtë kohë nuk mund të flitet për *Kuran*, sepse ai ende s'ishte kompletuar). Vrazhdësia kriminele muhamedane, që, sa forcohej, aq edhe kriminalizohej...

Sad. Pasha Kuranin që është përplot përkujtme! [38:1]

Ky betim i Allahut në *Kuran*, duke iu drejtuar njëfarë „Sadi“, është absurd! Nuk e dinte Allahu se *Kurani* nuk ishte mbaruar ende për t'u betuar në të?! Një kësi betimi duhet të ketë qenë praktikë vetëm e atyre që e kanë bashkësajuar *Kuranin*...

Por ata që nuk besuan janë në kryeneçësi e kundërshtim.[38:2]

Paragjykim tipik kolektiv muhamedan ndaj jomuslimanëve...

Sa gjenerata para tyre i kemi asgjësuar, të cilët u lutën për shpëtim, po nuk ishte koha e shpëtimit.[38:3]

Një gënjeshtër e stërpërsërtur nga shtysa urryese, që nuk ka të sosur, e mbingarkuar me paragjykime, armiqësi...

Ata janë që përgënjeshtroan librin (Kuranin) dhe atë me çka Ne i dërguam të dërguarit tonë, e më vonë ata do të kuptojnë,[40:70]

e më vonë ata do të kuptojnë.[40:71]

Atyre do t'u vihen prangat dhe zinxhirët në qafat e tyre e do të zhyten. [40:72]

Këto ajete përmbajnë dhunë tipike muhamedane, që ua kalojnë fantazive nazifashiste!

E Ne atyre që nuk besuan patjetër do t'u japim të përjetojnë dënim të ashpër dhe do t'i shpërblejmë me më të keqen e asaj që punuan.[41:27]

Kërcënimin ndaj atyre që nuk konvertoheshin në myslimanë duhet ta ketë formuluar kush tjetër, pos Muhamedit fashistoid!

Kur ata nxitën hidhërimin Tonë, Ne u hakmorëm ndaj atyre dhe i përmbytëm të gjithë. [43:55]

Mendësi tipike kriminele muhamedane!

Ne i zhdukëm disa vendbanime përreth jush, u përsëritëm argumentet ashtu që të kthehen. [46:27]

Me shembullin e krimeve që u kishin bërë fqinjëve të tyre, Muhamedi kërcëronte ata që i rezistonin konvertimin në islam. Barbari tipike muhamedane!

Pra, kur t'i takoni në luftë ata që nuk besuan, mëshojuni në qafë (mbytni) derisa t'i rraskapitni, atëherë lidhini. Pastaj kërkoni dëmshpërblim, derisa lufta të mos pushojë. Kështu, pra, sikur të dojë Allahu, Ai do të hakmerrej ndaj tyre, por Ai dëshiron t'ju sprovtojë me njëri-tjetrin. E ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut, atyre kurrsesi nuk ua humb veprat. [47:4]

Udhëzime e urdhra tepër të konkretizuar e luftarakë, se çfarë duhet të bënin falangat xhihadiste muhamedane ndaj jomyslimanëve. Fantazia kriminale muhamedane nuk kishte të sosur. Për t'i bindur xhihadistët e tij, që të bëhen sa më kriminelë e sa më të pamëshirshëm, Muhamedi i mashtronte ata se, kinse, Allahu do t'i kishte dënuar meritueshëm jomyslimanët, por dëshironte t'i sprovonte xhihadistët, nëse po i zbatonin saktë urdhrat e tij...

E ata që besuan po thonë: „Pse të mos shpallet një sure (që na e obligon luftën)?“ E kur u shpall surja e qartë dhe në të u përmend lufta, i sheh ata, të cilët kanë zemra të dyshimta, të shikojnë me një shikim si të ishin në agoni të vdekjes. I gjetjtë e keqja! [47:20]

Sërish formulim stereotip muhamedan, gjithashtu agresiv, kundër jomuslimanëve. Sërish tematikë luftimi: muhamedanët kundër jomuhamedanëve. Ky ajet duhet të jetë sajuar me rastin e ndonjë polemike ndërmjet Muhamedit dhe besimtarëve të tij. Ai, i zënë ngushtë, i drejtohet zotit me një kërkesë dhe fap, nga qielli i „zbret“ ajeti përkatës. Përmbajtja e këtij ajeti shpreh një gjendje të dëshpëruar shpirtërore të Muhamedit. Ndërsa mallkimi përmbyllës nuk i ka hije as Allahut muhamedan!

E si do të jetë atëherë puna e tyre, kur engjëjt do t'ua marrin shpirtin duke i rrahur në fytyrë dhe shpinë?! [47:27]

Nuk meriton as koment, por vetëm përçmim një broçkull kaq skandaloze!

Ne do t'ju sprovovjmë, derisa t'i njohim luftëtarët dhe ata që ishin të qëndrueshëm nga mesi juaj, por do të sprovovjmë edhe veprat tuaja. [47:31]

Duhet të ketë qenë një bashkëbisedim i Muhamedit me falangat e tij xhihadiste, por që duhet ta „ketë regjistruar“ ndonjëri nga „sekretarët“ e tij si ajet që po i „zbrite“ nga Allahu. Interpretimi: falangat xhihadiste duhet të dëshmohen sa më luftarake e barbare, që të çmohen pastaj nga Allahu dhe nga Muhamedi.

Pra, mos u dobësoni e të kërkonit pajtim (armëpushim), kur ju jeni ngadhënjyes dhe Zoti është me ju dhe nuk ua pakëson veprat tuaja. [47:35]

Porosi luftarake e Muhamedit, siç kuptohet, gjatë betejës.

Edhe për t'i shpënë besimtarët dhe besimtarët në Xhenet, nëpër të cilin rrjedhin lumenj e ku do të jenë përgjithmonë, dhe për të shlyer të këqijat e tyre, kjo është fitore e madhe tek Allahu. [48:5]

Ja edhe një motiv i antiprofitit Muhamed, se përse urdhëron sulmet luftarake. Sigurisht që ajeti është i mangët, sepse është formulim nga

gjysmanalfabetët devijantë. Mjerë fikcioni Allah, sa pervers e ka prezantuar Muhamedi me bashkëveprimtarët e tij! Duhet të ketë pasur të drejtë filozofi antik, kur ka thënë se, po të dinte demi të vizatonte, zotin do ta vizatonte si veten e tij. Kjo i ka ndodhur Allahut, i cili „është vizatuar“ sipas konstruktit Muhamed...

E kush nuk i besoi Allahut dhe të dërguarit të Tij, Ne pra, për jobesimtarët kemi përgatitur zjarr shumë të fortë. [48:13]

Kërcënim muhamedan, i stërpërsëritur! Por, vetëkuptohet, personazhi Allah nuk mund të jetë autor i tekstit. Mjerë ata muhamedanë injorantë, që nuk kanë autonomi për të kuptuar as këtë formulim kaq konkret, që e paraqet Allahun personazh pasiv, në vetën e tretë, njëjës!

Kur të shkoni ju për të mbledhur prenë e luftës, ata që ngelën pas, do të thonë: „Na lejoni edhe ne të vijmë me ju!“ Ata duan ta ndryshojnë vendimin e Zotit! Ti thuaj: „Kurrsesi, ju nuk keni për të ardhur me ne, kështu ka thënë më parë Zoti“ E ata do t’ju thonë: „Jo, por ju na keni zili!“ Por ata janë që kuptojnë pak gjë. [48:15]

Ja motivi kryesor për sulmet luftarake muhamedane: pasurimi nga preja luftës. Edhe myslimanë të tjerë do të dëshironin të kishin hise, edhe pse nuk kanë marrë pjesë në sulmime, por falangat muhamedane nuk i lejojnë. Ata duan ta ndajnë prenë mes tyre, por u takon pasi ta ketë marrë kryehisen e tij „profeti“ Muhamed (20 %).

Edhe ky ajet është shqetësues, tepër komprometues, aspak paqësor, as hyjnor! Megjithatë, myslimani injorant fundamentalist do të thotë se është hyjnor, sepse është i zbritur nga Allahu. Është interesant se si shpërdorohet plaçka e luftës, sa vlerësohet ajo, si manipulohen besimtarët me të. Rezulton se luftërat bëhen vetëm për plaçkë.

Vetë formulimi gjuhësor dëshmon se Allahu nuk është autor.

Vërtet, Allahu që i kënaqur me besimtarët, kur ata nën hijen e atij druri të zotohe-shin Ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, ndaj u dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirim të Hajberit) [48:18]

ISLAMI, religjion agresiv (?!)

...dhe me plaçkitje të tjera të mëdha, të cilat i merrni: Allahu është i gjithëfuqishëm, i urtë. [48:19]

Allahu ju premtoi juve plaçkë të shumta që do t'i merrni, e këtë (të Hajberit) ju shpejtoi dhe pengoi duart e njerëzve kundër jush, e që kjo të jetë një shenjë e mirë për besimtarët, që Ai t'ju drejtojë në rrugën e duhur. [48:20]

Edhe (pre) të tjera, të cilat ju nuk keni pasur fuqi t'i merrni, po Allahu e mbizotëroi atë, e Allahu ka fuqi për çdo gjë. [48:21]

Edhe sikur ata që nuk besuan t'ju luftonin juve, ata do të munden dhe do të kthejnë prapa, pastaj nuk do të gjejnë as mbrojtës, as ndihmës. [48:22]

Seri e ajeteve luftarake, të sajuara për rrethana konkrete të luftimeve. Janë tepër konkrete, sa nuk kanë nevojë për interpretime. Gjithsesi, të neveritshme!

Sërish motivim për luftëra, sepse xhihadistët do të dalin të fituar, kurse „ata që nuk besuan“, që do të thotë të gjithë ata që nuk janë myslimanë, gjithsesi do të përfundojnë të humbur. Dhe jo vetëm kaq. Si të humbur, ata nuk ka kush t'i mbrojtë e t'i ndihmojë, madje as Allahu, sepse janë paganë ose u takojnë feve të tjera.

Vetëkuptohet, vetëm paqësore nuk janë as këto ajete.

Pothuajse e tërë surja 48 i është kushtuar marrëveshjes në Al-Hudaibija (armëpushimi mes Muhamedit dhe përfaqësuesve të Kurjshëve mekas). Kjo marrëveshje i mundësoi Muhamedit, për herë të parë, partneritet në bisedime me përfaqësues të fisit të tij, deri atëherë të pozicionuar tepër armiqësisht kundër tij dhe, njëkohësisht, u krijoi mundësi forcave të tij të pushtojnë oazën Khaibar dhe të dëbojnë fisin jahudi Banu al-Nadir (maj-qershor 628), me ç'rast siguruan pre të madhe luftarake.

Në janar 630, Muhamedi përfundimisht hyri si fitimtar në Mekë dhe e „pastroi“ Qabenë nga statujat dhe fotot e besimtarëve paganë, jahudinj e kristianë...

Surja nr. 48 (Al-Fatih) përmbyllet me ajetin 29:

Muhamedi është i dërguari i Allahut, e ata që janë me të, janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet tyre! Ti i sheh kur përuken, duke rënë me fytyrë në tokë, e i kërkojnë pre Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë, ku mbin flizi i vet, e ai trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet; ajo e mahnit mbjellësin. [48:29]

Nuk meriton as të komentohet ky formulim kaq i ngatërruar, *a la* muhamedan! Por që në fillim rezulton se as personazhi Allah nuk është autor i tekstit!

Vetë Muhamedi duhet ta ketë sajuar këtë ajet, për t'ua rikujtuar sërish, pa ekuivokë, mohuesve të tij, se ai e vetëm ai „është i dërguar i Allahut“. Ndërsa sahabët (bashkëluftëtarët), Muhamedi i prezanton „të ashpër kundër jobesimtarëve“. Në rastin konkret ata janë vrasës e dëbues të pjesëtarëve të fisit jahudi Banu al-Nadir.

Këtu paraqitet edhe karakteri i falangave xhihadiste të Muhamedit. Këta falangistë myslimanët fundamentalistë tashmë i madhërojnë për selefistë (fillestarë) dhe, prandaj, përpiqen t'i imitojnë në të gjitha aspektet.

Besimtarë janë vetëm ata që i besuan Allahut, të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të Allahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata, të vërtetit. [49:15]

Ky ajet përcakton saktësisht se besimtarë nuk mund të jenë njerëz që nuk e besojnë zotin islam dhe „profetin“ Muhamed; që nuk luftuan dhe nuk luftojnë „për hir të zotit“. Nga ky përcaktim rezulton edhe urrejtja e myslimanëve ndaj të gjithë „jobesimtarëve“, kundër të cilëve duhet të luftohet, sipas kaq shumë udhëzimeve të sanksionuara në *Kuran*.

Nuk rezulton se Allahu është autor i këtij teksti, përmbajtja e të cilit, gjithashtu, nuk është paqësore.

Nga ky ajet kuptohet se të gjithë njerëzit e tjerë, që nuk e besojnë „profetin“ Muhamedi (rreth 6 miliardë), nuk janë besimtarë të vërtetë, prandaj janë *kufarë* (fjalë përbuzëse, shoviniste, për ata që nuk janë muhamedanë).

Për qëndrimin muhamedan kundër tyre tashmë u informuam nga ajetet e përzgjedhura, të shfaqura më lart.

Besimtarët e vërtetë (muhamedanë) duhet të dëshmojnë vazhdimisht me luftë „në rrugë të Allahut“, dhe jo vetëm me luftën e tyre fizike, duke sakrifikuar edhe jetën, por edhe pasurinë e tyre...

E, ç'keni ju që nuk jepni për rrugën e Allahut, kur dihet se Allahut i mbesin trashëgim qiejt dhe toka? Nuk janë të barabartë prej jush ata që dhanë nga pasuria e tyre dhe luftuan për çlirim, sepse të tillët kanë vlerë të madhe nga ata që dhanë dhe luftuan. Por të gjithëve Allahu u premtoi të mirat; Allahu di çka punoni.[57:10]

Formulim motivues për falangat xhihadiste muhamedane, që të vazhdojnë të jenë sa më luftarakë. Madje edhe obligues për falangat xhihadiste, që po e terrorizojnë edhe sot popullsinë në Siri, Irak e gjetiu.

Me këtë ajet bëhet vlerësimi i përshkallëzuar i xhihadistëve, në varësi se kur dhe sa kanë luftuar. Shprehja „Zoti di çka punoni“ mund të (keq)kuptohet si kërcënim e frikësim, meqë Allahu mbikëqyrka dhe ditka çfarë punojnë të gjithë. Ustai Muhamed ka prodhuar me mjeshtri shumë frikësime psikologjike, duke e bërë Allahun si një lloj kryepolici botëror.

Nuk rezulton të jetë Allahu autor i këtij formulimi dhunues.

Sot, prej jush nuk pranohet kurrfarë kompensimi, e as prej atyre që nuk kanë besuar: zjarri është vendbanimi juaj, ai është për ju, e sa vendbanim i tmerrshëm që është ai! [57:15]

Kërcënim ndaj atyre që nuk kanë marrë pjesë në luftime.

A e dini për atë që kanë miqësuar një popull, që Allahu ka shprehur mallkim kundër tyre? Ata nuk janë as prej jush, as prej atyre dhe me vetëdije betohen rrejtshëm. [58:14]

Fashistoide! Një popull të tërë e kategorizon si të mallkuar nga Allahu, që në fakt është mendësi autentike e Muhamedit! Kërcënim ndaj konformistëve, që taktizojnë ndaj myslimanëve dhe ndaj jomyslimanëve.

Është ai, që në dëbimin e parë i nxori prej shtëpive të tyre ata nga ithtarët e librit, të cilët nuk besuan. Ju nuk menduat se fortifikatat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të Allahut, po Allahu u erdhi atyre nga nuk e kishin menduar dhe në zemrat e tyre hodhi frikën ashtu, që me duart e veta dhe me duart e besimtarëve të rrezonin shtëpitë e veta. Pra, merrni përvojë, o ju, të zotët e mendjes! [59:2]

Formulim sipas legjendave fantaziste, urryese e armiqësore kundër besimtarëve hebrej.

Sikur Allahu të mos u kishte caktuar atyre shpërnguljen, ata do t'i ndëshkonte në këtë jetë, kurse në jetën tjetër ata i pret dënimi i zjarrit. [59:3]

Këtë, për shkak se e kundërshtuan Zotin dhe të dërguarin e Tij. Pra, kush e kundërshton Zotin, s'ka dyshim se Zoti është ndëshkimfortë. [59:4]

Ju nuk këputët asnjë nga hurmat e buta ose atë e keni lënë të ngritur në rrënjët e tyre, vetëm se me lejen e Zotit e për t'i shtypur kundërshtarët. [59:5]

Në këto ajete Muhamedi kultivon armiqësi te besimtarët myslimanë kundër jahudinëve, që zgjati 14 shekuj. Sipas islamologëve, këto përcaktime janë të arsyeshme, sepse fiset çifute Banu al-Nadir dhe Banu Kuraiza nuk i janë përmbajtur Rregullores së Medinës dhe kanë tradhtuar gjatë *Betejës së Llogoreve*. Fisin Banu al-Nadir, xhihadistët e Muhamedit e kanë dëbuar, kurse fisin Banu Kuraiza e kanë zhdukur. Për shkak të bashkëpunimit me këtë fis, janë zhdukur edhe pjesëtarët e fisit Banu Kilab ibn Amir. Muhamedi martohet me njëren grua të këtij fisi, Al-Nashat bint Rifa, të zënë robinjë, por pastaj e dëbon.

Edhe këto ajete nuk janë aspak paqësore e hyjnore. Përkundrazi, janë tepër të dhunshme, agresive e kriminale kundër besimtarëve jahudinj.

*E atë (pasuri) që prej tyre Allahu ia ktheu të Dërguarit të vet, ju për të nuk i keni ngarë as kuajt, as devetë, por Allahu i bën mbizotëruesit të dërguarit e vet kundër kujt të dojë. Allahu ka fuqi mbi çdo send. [59:6]**

Muhamedi arsyeton plaçkitjen e plaçkës së betejave plaçkitëse!

Kriminel ordiner, por edhe i pafytyrë, meqë këmbëngul që besimtarët t'i binden, për ta madhëruar këtë krim të tij si veprimtari hyjnore...

Atë që Allahu nga banorët e vendeve (jobesimtare) ia dha pa luftë të Dërguarit të vet, ajo i takon Allahut, të Dërguarit, të afërmve, jetimëve, të varfërve, emigrantëve. Që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj. Çfarë ju jep Pejgamberi, atë merrni e çfarë ju ndalon, përmbajuni dhe kini frikë Allahun, se Allahu është ndëshkues i ashpër. [59:7]

Tashmë, Muhamedi ka zënë të mbledhë tatime edhe nga „jobesimtarët“ (në hapësira të pushtuara) dhe i legalizon ato si të drejta, të dhuruara nga Allahu i tij (tashmë edhe tatimmbledhës). Ka të ngjarë se kjo mënyrë e përfitimeve duhet të jetë kushtëzuar me luftime. Ata „jobesimtarë“ që nuk kanë mundur të mbrohen me luftime, kanë paguar. Madje kanë paguar edhe për mosdetyrim të konvertimit në islam. Por, meqë sa ishte gjallë Muhamedi ushtria e tij nuk kishte arritur të pushtonte ndonjë vendshtet tjetër, mund të dyshohet se ky ajet është formuluar nga komisioni i kalifit Utman, ndërkohë që hordhitë ushtarake myslimane kishin pushtuar shumë vende e popuj dhe kishin grumbulluar edhe haraç nga këto pushtime.

*Për krahasim po ofroj edhe shqipërimin nga Hasan E. Nahi:

“E, atë që Perëndia ia ka dhuruar (kthyer prej ngatërrestarëve) Profetit të Vet, e që ju nuk e keni marrë si plaçkë me sulmim as të kuajve, as të deve, por që Perëndia u jep pushtet profetëve të Vet mbi ata që Ai dëshiron. Perëndia është i pushtetshëm për çdo gjë.” [59:6]

Ju (myslimanët) në zemrat e tyre (mynafikëve) jeni frikë më e fortë se frika nga Allahu. Kjo, për shkak se ata janë popull që nuk kuptojnë. [59:13]

„Analfabeti“ Muhamed është përpjekur të krijojë në sytë e jomyslimanët një gjendje të tmerrshme në terren, duke i karakterizuar falangistët e tij xhihadistë më të tmerrshëm edhe se vetë gogoli Allah. Me këtë karakterizim të tyre, ai duhet të ketë pasur të drejtë, meqë legjendat islame flasin për plot krime barbare, që ka ushtruar krimineli Muhamed dhe falangat e tij xhihadiste.

Ia vlen të përsëritet, se as Allahu muhamedan nuk është autor i këtij teksti, nëse bazohemi vetëm në formulimin gjuhësor!

O ju që besuat, nëse keni dalë (prej vendlindjes) për hir të luftës për rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush, mos e zini mik armikun Tim dhe armikun tuaj, duke shprehur ndaj tyre dashuri, kur dihet se ata mohuan të vërtetën që ju erdhi juve. Ata e dëbojnë të Dërguarin dhe ju, sepse ju i besoni Zotit, Zotit tuaj, e ju fshehurazi u ofroni miqësi, por Unë më së miri e di atë që keni fshehur dhe atë që keni publikuar. Ai që punon ashtu nga pala juaj, ai e ka humbur rrugën e drejtë. [60:1]

Tepër barbare për të qenë përcaktim Allahut („të madhërishëm“). Muhamedi, i egërsuar deri në tërbim kundër jomyslimanëve, nuk do të lejojë as miqësi të fshehtë mes fqinjëve, kur ata janë besimtarë muhamedanë dhe jomuhamedanë. Për Allahun të gjithë jomyslimanët përcaktohen si armiq. Dhe jo vetëm kaq.

Sërish frikësim psikologjik meurvejtim të Allahut, i cili edhe nëse myslimanët miqësohen fshehurazi me fqinjët, kushërinjtë dhe të tjerët, ai i mëson të gjitha dhe, prandaj, do t'i ndëshkojë.

Përmbajtja është paksa e ngatërruar, sepse Allahu rezulton herë si autor e herë jo. Ndërsa paqësor jo që jo, sepse e bën të ndaluar dhe të dënueshme miqësinë mes myslimanëve me të tjerët.

Allahu jua ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni

ISLAMI, religjon agresiv (?!)

me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes. [60:9]

Tashmë një pozicionim paksa më ndryshe nga ajeti i shtjelluar më lart. Ky ajet ua ndalon myslimanëve afrimin me kundërshtarët luftarakë. Por, megjithatë, nëse ndodh përafrimi, sipas këtij ajeti, rezulton se atë e pason vetëm dëmtimi i vetvetes. Myslimani do të vihet në dilemë se cilin nga këto dy ajete duhet të zbatojë.

As ky ajet nuk përmban përcaktime paqësore dhe Allahu nuk është autor i tij.

O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull që Allahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu si nuk kanë shpresë jobesimtarët prej të vdekurve në këtë botë, ose në ringjallje. [60:13]

Thirrje shoviniste për armiqësim të muhamedanëve ndaj jahudinjve. Megjithatë, besimtarët myslimanë e pëlqejnë! Viktima mjerane!

Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të rreshtuar si të jenë ndërtesë e fortifikuar. [61:4]

Nuk do koment: Allahu i do ata që janë sa më shumë xhihadistë. Nga përmbajtja e formulimi gjuhësor rezulton se as nuk është Allahu autor i ajetit e as ajeti nuk është paqësor e hyjnor!

T'i besoni Allahut dhe të dërguarit të Tij, të luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë tuaj dhe veten tuaj, kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini. [61:11]

Përcaktim obligues, tepër konkret për myslimanët: t'i besojnë Allahut dhe Muhamedit, të cilët shpesh barazohen mes tyre, dhe të luftojnë „në rrugën e Allahut“...

Allahu nuk rezulton të jetë autor as i këtij formulimi, i cili nuk rezulton të jetë paqësor e hyjnor.

O ti Pejgamber, luftoji jobesimtarët e hipokritët dhe qëndro ashpër kundër tyre; vendi i tyre është xhehenemi, që është një vend i shëmtuar! [66:9]

Edhe ky ajet është tepër agresiv e deciziv në përcaktimin luftarak të myslimanëve kundër „jobesimtarëve“. Sipas këtij ajeti, të gjithë „jobesimtarëve“, që do të thotë të gjithë jomyslimanëve, detyrimisht u është caktuar vendi më i shëmtuar, xhehenemi i „përjetshëm“, ku të dënuarit e tij, sipas doktrinës muhamedane, „përjetësisht vetëm digjen“, sepse përjetësisht duhet të vuajnë dënimin në „botën tjetër“.

Nga përmbajtja e tij rezulton se Allahu i ka dhënë Muhamedit këtë urdhër dhe ai vlen për të gjitha kohërat, edhe pse Muhamedi ka vdekur, që do të thotë se ky ajet nuk ka mundësi të zbatohet më dhe më kot është sanksionuar në *Kuran*.

Sic shihet, ky ajet urdhërues nuk është aspak paqësor e hyjnor, është tepër i dhunshëm dhe luftarak.

U thuhet zebanive: Kapeni atë, vëriini prangat! [69:30]

Urdhër tepër i prerë për prangosje, që nuk i shkon fare një profeti. As Allahut jo që jo!

Pastaj atë futeni në Xhehenem...[69:31]

Urdhër monstruoze, që t'i fërgojnë „jobesimtarët“, meqë prangosja nuk është e mjaftueshme!

Mandej lidhni me zinxhirë prej shtatëdhjetë kutesh. [69:32]

Çfarë do të lidhin me zinxhirë prej 70 kutesh, kur ai është duke u djegur në xhehenem?! Në këtë urdhër shprehet barbaria e Muhamedit, që nuk ka fund!

Sepse ai ka qenë, që nuk e besoi Allahun e madhëruar. [69:33]

Faji i këtij njeriu na qenkësh vetëm mosbesimi ndaj Allahut. Por ka ajete, që Allahu nuk e ngarkon Muhamedin dhe myslimanët të ushtrojnë dhunë ndaj jomuslimanëve, me arsyetimin se po të donte ai, do t'i detyronte të besonin...

Edhe kapitulli (surja) 74 përmban gjumë agresivitet. Kjo sure do të duhej të ishte e dyta për nga radha e „zbritjes“ (sajimit), meqë fillon me ajetin „O ti i mbuluar“. Do të thotë se Allahu e thërret Muhamedin, të sapokthyer nga shpella (1 shkurt 610), i cili, i frikësuar, ka kërkuar nga gruaja që ta mbulojë, që t'i kalonin të dridhurat e frikës, që të ngrihej për t'i dalë zot profetizmit. Por ky ajet nuk duhet të „jetë zbritur“ në atë kohë, meqë Muhamedi ende nuk ishte shndërruar në luftarak. Përkundrazi, vazhdonte ta mbante konspirativ konvertimin e tij në islam, që sapo kishte filluar ta sajonte. Në këtë rast „ai“ (74:16) duhet të jetë ndonjëri, të cilin Muhamedi e ndiqte si armik, në vitet e mëvonshme kur ishte bërë diktator e kriminel i Medinës...

Ne, me të vërtetë, për jobesimtarët kemi përgatitur zinxhirë e pranga dhe flakë zjarri. [76:4]

Vazhdon i shpërftytuari Muhamed, me kompletim të platformës së tij fashistoide!

A nuk i kemi shkatërruar Ne popujt e hershëm? [77:16]

Dhe pastaj, pas tyre, shoqëruam të tjerë, më të vonshëm. [77:17]

Ne ashtu i dënojmë kriminelët. [77:18]

Sërish me legjenda të kota, plagjiatura, duke e ngarkuar personazhin e tij, Allahun, me të gjitha fajet për fatkeqësitë dhe luftërat që u kishin ndodhur izraelitëve...

Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi⁴⁵³, e ai tashmë është shkatërruar! [111:1]

Edhe gruaja e tij [Um Xhamil, konkretizim imi], ajo që barti dru. [111:4]

⁴⁵³Më gjerësisht, arsyetimet spekuluese të teologut Ajatullah Makarem Shirazi në portalin: <http://www.al-quran.de/tafsir/111/1.htm>.

E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur [111:5]

Ebu Leheb (أبو لهب) ishte njëri nga xhaxhallarët e Muhamedit, i cili u shqua si kundërshtar i angazhuar i Muhamedit.

Dy djemtë e Ebu Lehebit (xhaxhai i Muhamedit), Utba ibn Abu Lahab dhe Utayba bin Abu Lahab, ishin të martuar me dy vajzat e Muhamedit, Umm Kulthum bint Muhammad dhe Ruqayya bint Muhammad.

Muhamedi u armiqësua për vdekje me xhaxhanë e tij, Ebu Leheb, kur thirri fisin e tij në një kuvend, për t'ua prezantuar fenë islame dhe veten si „të dërguar“ të Allahut. Aty, xhaxhai autoritar e mallkon nipin, Muhamedin: „Shporru te xhelati yt! Për të na dërguar tek ai na paske grumbulluar!“

Më ka neveritur sidomos poshtërimi për punën që ka bërë gruaja e xhaxhait, Um Xhamil, e cila ka dalë në mal për të mbledhur dru, që i ka ngarkuar mbi kurriz dhe përdor litar për t'i lidhur si barrë!

Kësaj armiqësie Muhamedi duhet t'i ketë dedikuar suren 111, e cila do të duhej të (dis)kualifikohej si legjendë, për një ngjarje historike dhe, prandaj, nuk do të duhet të kishte vend në *Kuran*...

Me këto ajete të sures 111 po e përmbyllim afishimin e ajeteve të dhunshme, agresive, fashistoide, të cilat e shpërshfaqin karakterin e inkriminuar të Muhamedit, duke i shkaktuar, fillimisht fisit të tij, gjithë ato fatkeqësi e armiqësi...

* * *

Gjithë këto ajete, me përmbajtje të dhunshme (rreth 250), i kam identifikuar dhe seleksionuar sipas radhës së tyre në *Kuran*. Ka edhe ajete të tjera të dhunshme, agresive, fashistoide, por meqë ishin paksa më „të buta“, nuk desha që ta stërngarkoj këtë kapitull edhe me to.

Në fakt, po të përmbante *Kurani* vetëm njërin nga këto ajete, siç është, ta zëmë, ajeti 5:33 ose 9:29, do të mjaftonte për të diskredituar

shenjtërinë, hyjnoren dhe paqësoren e gjithë *Kuranit* dhe islamit. Pra, duhet pranuar se *Kurani*, fatkeqësisht, përmban një doktrinë të dhunshme, agresive, luftarake, fashistoide, por këtë fakt nuk e pranojnë besimtarët myslimanë dhe kjo është e vetëkuptueshme, sepse, përndryshe, ata nuk do të ishin besimtarë...

Në vazhdim do të shqyrtojmë edhe disa hadithe, për të vërtetuar edhe përmes tyre, se islami nuk është fe paqësore, por e dhunshme.

Të gjitha hadithet e shqyrtuara këtu janë nga përmbledhja **Sahih al-Bukhari**⁴⁵⁴ dhe kam evidentuar vetëm numrin rendor të tyre, ashtu siç janë në atë përmbledhje. Rëndom, teologët myslimanë hadithet e përmbledhura nga Al-Bukhari i vlerësojnë si më të saktat.

(25) ... Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: „Më është urdhëruar që të luftoj kundër njerëzve, derisa ata të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është Pejgamber i Tij; derisa të fillojnë të falin namazin e të japin zekatin. Kur ta bëjnë këtë, do t’u garantoj jetën dhe pasuritë e tyre, por vetëm sipas së drejtës islame. Ndërkaq, llogaria përfundimtare i përket Allahut xh.sh.“

Pra, Muhamedi mashtron se është urdhëruar nga Allahu i tij, për të luftuar kundër njerëzve, derisa ata të konvertohen në myslimanë. Ky urdhër vlen përjetësisht për muhamedanët. E ata myslimanë që nuk e zbatojnë këtë urdhër, nuk janë muhamedanë të devotshëm.

(26) ...Pejgamberin s.a.v.s e kanë pyetur: - Cila punë është më e vlefshme? Ai është përgjigjur: - Besimi në Allahun dhe në Pejgamberin e Tij. Mandej është pyetur: - E çfarë pastaj? - Lufta në rrugën e Allahut, - është përgjigjur...

⁴⁵⁴<http://www.kuranifisnik.net/kuranifisnik/Download/UploadedFiles/2007.11.6%20-%2019.9%20Sahihul%20Buhari%20-%20Libri%201.htm>

Edhe këtu rezulton i përcartë përcaktimi kryesor i Muhamedit për fenë islame (muhamedane): besimi në zotin mysliman dhe te Muhamedi, si dhe lufta e përhershme „në rrugën e Zotit“.

(36) ... Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: „Allahu me kënaqësi do t'ia plotësojë dëshirën atij që niset në luftë në emër të Allahut; atë e ka shtyrë të niset në luftë, vetëm duke më besuar mua dhe pejgamberëve të mi dhe se nuk do ta kthejë në shtëpi pa dhuratë ose pa pasuri lufte, të cilën e ka merituar, ose do ta fus në Xhenet.

Dhe po të mos i ngarkoja pasardhësit e mi me vështirësi, nuk do të ndahesha nga asnjë front dhe do të doja të vdisja në Rrugën e Allahut, pastaj të jetoj një kohë e të vdes, e pastaj përsëri të jetoj një kohë e të vdes.“

Muhamedi rrëfen joshjet e glorifikuara për xhihadistët të tij. Këto joshje duhet të kenë qenë motivime të fuqishme për rritjen dhe forcimin e shpejtë të ushtrisë xhihadiste të Muhamedit, për beteja, luftëra, agresion pushtues dhe konvertim të përdhunshëm në islam.

Vetë ky rrëfim dëshmon se islami nuk është aspak paqësor e hyjnor, por përkundrazi, brutalisht i dhunshëm.

(123) ... Ka ardhur një njeri dhe e ka pyetur Pejgamberin s.a.v.s.: „O Resulullah, ç'është lufta në emër të Allahut? Disa nga ne luftojnë nga zemërimi e disa nga mendjemadhësia!“ Ai (Pejgamberi s.a.v.s.) e ngriti kokën kah ai e u përgjigj: „Kush lufton që Fjala e Allahut të Madhëruar të mbizotërojë, ai është në rrugën e Allahut të Madhëruar.“

Edhe nga kjo përgjigje e „profetit“ mund të konstatohet se islami nuk është paqësor. Synimi është i qartë: gjithë bota duhet të islamizohet. Lufta nuk duhet të ndalet, derisa të islamizohet edhe njeriu i fundit. Nga përcaktime të tilla janë frymëzuar atëherë, por frymëzohen edhe tani xhihadistët muhamedanë.

(335) ...Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: „Më janë dhënë mua pesë dhurata, të cilat nuk i janë dhënë askujt para meje: fuqia për ta frikësuar armikun nga një distancë e një ecjeje njëmuje; gjithë toka më është bërë vend për të bërë lutje (mesxhid) dhe pastrim, prandaj, cilindro nga ihtarët e mi që e zë ndonjë namaz, le ta falë namazin aty (në tokë të pastër); më është bërë e lejueshme (hallall) pasuria e luftës, që nuk ka qenë e lejueshme për asnjë para meje; më është dhuruar mbrojtja (shefaati) në Ditën e Gjykimit; çdo pejgamber ka qenë i dërguar vetëm për popullin e vet, kurse unë për të gjithë njerëzimin.“

Tepër qartë i ka rrëfyer Muhamedi synimet e tij, që vetëkuptohen si synime të përjetshme të çdo muhamedani. Muhamedi rrëfen edhe dallimet privilegjuese të tij ndaj profetëve pararendës. Atyre nuk u ka takuar plaçka e luftës, Muhamedit po. Atyre u ka takuar të jenë të dërguar (sundimtarë) vetëm për popullin e tyre, kurse Muhamedi është për të gjithë njerëzimin.

Sa për fuqinë e Muhamedit, që ta frikësojë armikun në një distancë prej rreth një mijë kilometra (sa do të mund të ecte njeriu për një muaj), duhet të kuptohet si propagandë luftarake, për të motivuar e trimëruar xhihadistët e tij dhe banorët arabë të vendbanimeve afër Mekës dhe Medinës dhe jo më larg, meqë ai ende nuk ishte në gjendje për të konsoliduar një ushtri të fuqishme dhe të organizuar mirë.

Edhe ky rrëfim dëshmon se islami nuk është fe paqësore!

(1399) ... Umeri tha: „Si po lufton ti kundër idhujtarëve, kur Pejgamberi i Allahut ka thënë: „Më është urdhëruar që të luftoj kundër idhujtarëve derisa të dëshmojnë: La ilahe il-lall-llah, e ai i cili dëshmon kështu, e ruan nga unë pasurinën dhe jetën e vet, me përjashtim të një detyrimi tjetër që e zë asgjë, e dhënia e llogarisë së tij është punë e Zotit“.

Edhe ky hadith dëshmon se islami nuk është fe paqësore, por e dhunshme.

(1652) ...Hafsa ka thënë: „Ne i kemi penguar vajzat tona të moshuara që të dalin (nga shtëpia). Pastaj erdhi një grua, e cila është në bashkëshortësi me njërin nga shokët e Pejgamberit s.a.v.s., i cili bashkë me Pejgamberin e Allahut ka luftuar në 12 luftëra, dhe motra e saj ka qenë me atë në gjastë prej atyre luftërave dhe ka thënë: „Ne i kemi shëruar të plagosurit dhe jemi kujdesur për ta“. Pastaj motra ime e ka pyetur Pejgamberi s.a.v.s.: „A ka pengesë për ndonjërin prej nesh që të mos dalë (në vendin ku falen), për shkak se nuk ka mbulesë?“
- Le ta mbulojë shoqja e saj me një pjesë të mbulesës së vet dhe ashtu le të prezantohet në të mirë dhe lutje me besëdrejtë. (...)

Këtu kemi rrëfime që informojnë për 12 luftëra, të komanduara nga kalifi Muhamed dhe për përcaktimet e Muhamedit ndaj mbulesës për vajza.

Sërish një dëshmi tjetër se islami nuk ishte dhe nuk është fe paqësore, meqë *Kurani* dhe Muhamedi kishin përcaktime luftarake për të plaçkitur, për të përdhunuar gratë e vajzat të zëna robinja, për të konvertuar me dhunë „jobesimtarët“ në myslimanë.

(3590) ... Pejgamberi s. a. v. s ka thënë: „Nuk do të vijë Dita e Gjykimit, derisa nuk do të luftoni me joarabët Huza`a dhe Kerman, fytyrat e të cilëve janë të kuqe, hundët e shtypura, sytë e vegjël, fytyrat si mburojë të mbështjellura me lëkurë, kurse këpucët do t'i kenë prej leshi.“

Ky përcaktim i Muhamedit dëshmon se ai ka synuar sundimin edhe të popujve joarabë, meqë synonte islamizimin e të gjithë botës dhe krijimin e një kalifati botëror islam, në krye të të cilit do të qëndronte vetë. Vetëkuptohet që këto përcaktime vlejnë përjetësisht, për të gjithë muhamedanët.

(3593) ... Umeri r.a. ka dëgjuar Pejgamberin s. a. v. s. duke thënë: „Hebrenjtë do të luftojnë kundër jush, por ju do të ngadhënjoni. Atëherë edhe guri do të flasë: „O myslimanë, ky pas meje është çifut, ndaj vrite!“

Fatkeqësi interesante: pjesëtarët e popujve, ndoshta me prejardhje të përbashkët semite nga „baba“ Abraham-Ibrahim, janë kaq shumë të armiqësuar mes tyre, atëherë dhe tani! Dhe jo vetëm kaq. Këta dy popuj, pos Jezusit dhe Muhamedit, të gjithë „profetët“ i kanë të përbashkët, ndërsa Abrahamin e kanë „baba“ të feve të tyre. Ndoshta pikërisht gara mes tyre, për të përvetësuar profetët dhe historitë e tyre, është „molla e sherrit“, e cila i ka armiqësuar kaq shumë.

Gjatë studimeve të mia për islamin, as në *Kuran*, as në hadithe, as në libra të tjerë nuk më ka rastisur të lexoj për ndonjë armiqësi në Mekë mes arabëve paganë, arabëve hebrenj dhe arabëve të krishterë (vetë xhaxhai i Hatixhesë ishte prift katolik), para dhe gjatë kohës së misionarizmit paqësor të Muhamedit, në vitet 610-620.

Ky parashikim ogurzi i Muhamedit, që i ngjan një porosie, duhet të ketë ndikuar te muhamedanët aq shumë, sa të mos gjejnë forcë për miqësi me hebrenjtë. Kjo nuk mund të quhet porosi paqësore.

(3609) ... Pejgamberi s. a. v. s ka thënë: „Nuk do të ndodhë Dita e Mbrame përderisa nuk luftojnë dy grupe, në mesin e të cilëve do të ketë shumë të mira e idenë do ta kenë të njëjtë. Dita e Mbrame nuk do të ndodhë as derisa të paraqiten dexhallët, rrenacakë do të jenë rreth tridhjetë. Secili prej tyre do të pretendojë se është pejgamber.“

Ky rrëfim i Muhamedit është parashikim për luftën që duhet të ndodhte mes „dy grupimeve“. Se cilat janë këto dy grupime, a kishte ndodhur apo duhej të ndodhte lufta mes tyre, për mua nuk është e qartë. Sërisht edhe një argument se islami nuk është paqësor.

*(3610) ... Ebu Seid el-Hudriu r.a. ka thënë: „Në një rast ishim te Pejgamberi s.a.v.s. Ai ndante plaçkën. I erdhi Dhul-Huvejsiri, i cili ishte nga Ebi Temimi dhe tha: - O i Dërguar i Zotit, ji i drejtë!
- Mjerë për ty! - iu përgjigj ai. - Kush është i drejtë nëse edhe unë nuk jam i drejtë! Ke humbur dhe je shkatërruar nëse unë nuk kam qenë i drejtë.*

- O i Dërguar i Zotit, - tha Umeri, - më lejo që ta vras!
- Hiqu prej tij, - tha, - sepse ai ka bashkëmendimtarë të tjerë. Secili prej jush nuk do të dëshirojë që të fjaloset me ta, të agjërojë me ta. Ata do të lexojnë Kuran, por nuk do të ndikojë tek ata. Atyre feja do t'u kalojë sikur shigjeta kur e vret gjahun e zënë. Po shikove në majë të shigjetës, a duket diçka; po shikove në kordhën e shigjetës, nuk do të hetosh kurr gjë; po të shikosh në trupin e shigjetës, asgjë nuk do të hetosh; po shikove në fletët e shigjetës, as në to nuk do të hetosh kurr gjë. Shigjeta ka kaluar nëpër ushqimin dhe gjakun e tretur. 72 shenja e tyre do të jetë njeriu i zi, një muskul i tij do të jetë sikur gjiri i femrës, ose sikur një copë mishi, e do të tronditet shumë. Ata do të paraqiten kur do të përçahen njerëzit mes tyre. Unë dëshmoj se këtë hadith e kam dëgjuar nga Pejgamberi s.a.v.s. - thotë Ebu Seidi, - dhe dëshmoj se Ali b. Ebi Talibi ka luftuar kundër tyre, por edhe unë kam qenë me të. Ai urdhëroi që ta gjejmë atë njeri. E gjetëm dhe e sollëm. Tek ai pashë atributet, të cilat i përshkroi Pejgamberi s.a.v.s.“

Hadithe me përmbytje të ngatërruar, me informacione spekuluese dhe aspak paqësore. E dyshimtë duhet të jetë edhe përmendja e *Kuranit*, meqë sa ishte gjallë Muhamedi nuk ka pasur *Kuran* të shkruar në format libri. Vetëm kalifi i tretë, pas kalifit Muhamed, i quajtur Utman, ka formuar komision, për përmbledhjen e ajeteve në *Kuran* në format libri, dhe e ka udhëhequr vetë.

(3611) ... Aliu r.a. ka thënë: „Kur ju transmetoj nga Pejgamberi s.a.v.s , më i kënaqur do të isha të bie nga qielli, sesa të gënjej ndaj tij, e kur ju flas për diçka që ka të bëjë me ne, dijeni se lufta është mashtrim. E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë: - Në Ahiri zeman (para Kiametit) do të paraqiten njerëz, që do të jenë të rinj dhe të pakuptueshëm, të cilët do të lexojnë Fjalën më të mirë (*Kuranin*), por do të kalojnë nëpër Islam sikur shigjeta kur kalon në gjahun e zënë, kurse imani nuk do ta kalojë as laringun e tyre. Kudo që t'i hasni, vritni, sepse për vrasjen e tyre në Ditën e Gjykimit do të shpërbleheni.“

Porosi aspak paqësore! Cilët janë këta njerëz dhe si do të identifikohen? Mbase kjo porosi ka prodhuar aq shumë dilema e dyshime për formimin e sekteve dhe „shkollave të drejtësisë“ (siç i quajnë teologët islamë), që kanë garuar e po garojnë mes tyre, për trashëgiminë e vërtetë të Muhamedit. Dhe lufta mes tyre ka filluar tepër herët, qysh në *Betejën e Deveve*, mes forcave të armatosura, të komanduara nga kalifi Ali (djali i xhaxhait të Muhamedit), dhe atyre të komanduara nga Aishja (e veja e Muhamedit). Këtu e kanë zanafillën përçarja dhe armiqësia e madhe, gati 14-shekullore, mes grupimeve sunite dhe shiite.

Edhe ky rrëfim i përçartë është një dëshmi më shumë, se islami nuk mund të vlerësohet si fe paqësore, meqë ka prodhuar kaq shumë luftëra barbare mes 73 sekteve islame.

Në Al-Buhari, sipas rrëfimit të Ebu Hurejrës, shok i Muhamedit, lexojmë:

... I Dërguari i Zotit erdhi te ne dhe tha: „Eja (me mua) të shkojmë te judenjtë“.

Ne shkuam te shkollat e tyre. Atëherë profeti u drejtua para tyre dhe foli: „Judenj! Pranoni Islamin, do t'ju bie më mirë!

Ata iu përgjigjën: „Ebu al-Kasim, Ti e ke proklamuar mesazhin“.

Ai u përgjigj: „Unë edhe tani po jua proklamoj“. Pastaj ai i thirri ata për herë të dytë, dhe hebrenjtë sërish u përgjigjën: „Ebu al-Kasim, Ti e ke proklamuar mesazhin“.

Atëherë ai i thirri për të tretën herë dhe u tha: „Ta kini parasysh se toka i takon Zotit dhe të Dërguarit të Tij dhe prandaj unë do t'u dëboj prej këtu. Kush prej jush ka pronë, duhet ta shesë. Nëse nuk e bën, ju bëj me dije se toka i përket Zotit dhe të Dërguarit të Tij.“⁴⁵⁵

Ky hadith është tepër i drejtpërdrejtë dhe nuk lë hapësirë për spekulime. Sipas përcaktimit të Muhamedit, toka është e zotit dhe e „të

⁴⁵⁵ Sahih al-Buhari, Vëll 4, libri 52, nr. 53.

dërguarit“! Këtu mbetet të diskutohet vetëm nëse ky përcaktim vlente vetëm për tokën e besimtarëve judenj, ose tokën e të gjithëve pa përjashtim, ose vetëm tokat e jomyslimanëve? Ata që e njohin mirë dogmën kuranore do të thoshin se e gjithë toka dhe të gjitha pasuritë e tjera janë të zotit, rrjedhimisht të „të dërguarit të tij“ (Muhamedit).

Konkretisht, këtu kemi përcaktim dedikuar judenjve, i cili, meqë është i Muhamedit, është i përhershëm. Prandaj muhamedanët qysh atëherë janë pozicionuar dhe angazhuar për t'i dëbuar, vrrarë e shpronësuar judenjtë. Këtë e kanë bërë kurdoherë muhamedanët besimtarë, pos në rastet kur nuk kanë qenë në gjendje.

Edhe ky hadith dëshmon se feja islame nuk është paqësore, por e padrejtë, e dhunshme, agresive, fashistoide.

* * *

Këto ajete dhe hadithe dhe të tjera si këto, që në *Kuran* dhe në përmbledhje të autorizuara të haditheve gjenden me bollëk, dëshmojnë se doktrina bazë e islamit është e dhunshme, agresive, fashistoide. Ndryshe nuk mund të (zh)vlerësohen të këtilla përcaktime e mendësi të Muhamedit, për t'i zhdukur të gjithë „jobesimtarët“, siç i përcakton ai të gjithë jomyslimanët. As ambalazhimi i këtyre ajeteve urdhëruese për xhihad të përditshëm e të përhershëm „në emër të Zotit“, nuk i bën ato të drejta, hyjnore, profetike, misionare.

Më herët nuk isha i informuar se kjo dogmë islame, pasrendëse e dogmave hebreje e kristiane, është kaq agresive. Si i painformuar, isha besimtar mysliman. Nuk ishte përzgjedhje imja, sepse fëmija nuk ka mundësi të përzgjedhë. Ishte trashëgimi nga prindërit.

Sa keqardhje ndiej, për të mos thënë turp, pse kam besuar në këtë dogmë deri në moshën madhore, të fillimit të konsolidimit të arsyes racionale. Çlirimim prej saj tashmë e vlerësoj edhe më shumë. Gjithsesi, ndiej keqardhje për të gjithë miqtë e besimit mysliman dhe për të gjithë fetarët viktimë të botës, të cilët u besojnë këtyre dogmave dhe jetojnë me frymën e tyre.

Për konkretizim aktual të doktrinës fetare islame, po sjell disa fatava (ekspertiza ligjore) nga dijetarët kompetentë.

Fatava (ekspertizë ligjore): islami fe sulmuese apo mbrojtëse?

Përgjigjet eksperti ligjor i Arabisë Saudite, Sheik Muhamed bin Salih el-Uthejmin, një nga dijetarët myslimanë më me ndikim të islamit sunit të shekullit XX:

„Çfarë do të thotë „sulm“? Zoti thotë:

„Luftoni ata (jobesimtarët), derisa të zhduket propagandimi i idhujtarëve dhe derisa të aplikohet feja vetëm për Zotin. E në qoftë se ndalen (nga propaganda dhe lufta), atëherë lëreni armiqësinë, përveç atyre që janë zullumqarë.“ [2:193]

Ky është parimi. Islami lejon jomyslimanët të kenë fenë e tyre, nëse ata paguajnë haraç [për myslimanët]. Kjo do të thotë se islami është fe dominuese, rrjedhimisht fe publike.

Pyetje: Këto dispozita [në lidhje me jomyslimanët] nuk po respektohen?

Përgjigje: Po, po, ato po konsolidohen. Për momentin kemi bërë marrëveshje të përgjithshme dhe marrëveshje të veçanta me ata [jomyslimanët]. A kanë myslimanët tani potencial për luftë xhihadi? Unë them: Jo!

Së pari, vetë myslimanët janë të pazhvilluar. Madje, disa prej tyre duan të luftojnë njëri-tjetrin. Së dyti, myslimanët nuk kanë materiale dhe burime të mjaftueshme që t'u mundësojnë atyre fitoren kundër jobesimtarëve. Për këtë arsye, ne tani nuk themi se xhihadi është detyrim për myslimanët. Myslimanët nuk janë në gjendje për të fituar. Allahu nuk e ka urdhëruar Profetin e Tij, Muhamedin, për të luftuar kundër të pafeve kur ai ishte në Mekë, sepse ai [ushtarakisht] ishte i dobët në atë kohë. Ai [Allahu] e ka urdhëruar Muhamedin për të luftuar vetëm kur ai u zhvendos në El-Medina dhe themeloi një shtet.

Pyetje: *Në qoftë se sulmi është një detyrim, do të thotë kjo se ne duhet të sulmojmë vende?*

Përgjigje: *Po. Nëse ne do të ishim në gjendje, ne do t'i sulmonim ata në kryeqytetet dhe në vendet e tyre. Ne lusim Allahun për të na e bërë të mundur këtë.⁴⁵⁶*

Fetvaja (ekspertizë ligjore islame) për çështjen e lirisë fetare⁴⁵⁷

Nga eksperti ligjor Sheikh Saleh al-Fawsan, anëtar i Bordit të Dijetarëve Myslimanë në Arabinë Saudite.

Pyetje: *Ne po e dëgjojmë shpesh kohët e fundit deklaratën: „Islami garanton lirinë e besimit“. Ata që e pohojnë këtë, bazohen në ajetin Kuranor: „Nuk ka dhunë në fe“. [2:256] E, pra, a është e vërtetë kjo?*

Përgjigje: *Kjo është një gënjeshtër, e cila i atribuohet Allahut. Islami nuk e ka shpallur lirinë e fesë. Islami ka shpallur ndalimin e politeizmit dhe mosbesimit dhe urdhëron luftën kundër jobesimtarëve. Po të kishte shpallur islami liri fetare, njerëzimi nuk do të kishte nevojë për Të Dërguarin, as për zbritjen e librave. Njerëzimi nuk do të kishte nevojë për Xhihad, as për betejë sipas vullnetit të Zotit. Nëse do të ishte kështu, secili mund të jetonte si të donte, secili do të ishte i lirë. Jo, përkundrazi, Allahu thotë: „Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër gjë, pos që të më adhurojnë mua.“ [51:56] Zoti nuk ka thënë se secili mund të jetojë sipas dëshirës së tij, por që të më shërbejë mua.*

Allahu thotë gjithashtu: „Luftojini ata (jobesimtarët), derisa të zhduket propagandimi i tyre dhe derisa të aplikohet vetëm feja për Zotin...“ [3:192]. Ai që refuzon t'i lutet Zotit, do të luftohet. Ai nuk duhet të lihet i lirë, por duhet të luftohet derisa të rikthehet në fe ose të vritet.

Islami nuk e ka lirinë fetare, siç mashtrojnë të pafetë. Kjo është një gënjeshtër, e cila i atribuohet Allahut. Zoti ka zbritur librat, ka dërguar Të

⁴⁵⁶ <http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M581c96b872a.0.html>

<http://audio.islamweb.net/audio/index.php?page=FullContent&audioid=112943#112906>

⁴⁵⁷ www.youtube.com/watch?v=8UcdG2nXO3U&feature=related

<http://www.islaminstitut.de/Anzeigen-von-Fatawa.43+M518b0ca8598.0.html>

Dërguarin, ka përcaktuar xhihadin dhe dënimet për të mbrojtur njerëzit nga besimi i rremë dhe të menduarit e korruptuar. Në këtë mënyrë, Zoti dëshiron t'i mbrojë njerëzit, sepse ata janë robër të Allahut. Prandaj, njerëzit duhet të adhurojnë vetëm Allahun, duke mos i bërë Atij partnerë. Përndryshe, duhet të zbatohen ndëshkimet frikësuese, pra ndëshkimet që Allahu ka përcaktuar.

Thënia e Allahut: „Nuk ka dhunë në fe“, nuk do të thotë liri e mendimit, por se ky ajet nuk mund t'i detyrojë njerëzit të besojnë në fe [islame] me zemër. Këtë mund ta bëjë vetëm Zoti: „... ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por Zoti udhëzon kë të dojë ...“ [28:56] Vetëm Allahu mund t'i udhëzojë zemrat. Kjo nuk mund të bëhet me forcë, por vetëm me vullnet të lirë. Ne luftojmë kundër të pafeve dhe politeistëve, pasi Allahu na ka urdhëruar. Ne ftojme për të mirë dhe ndalojnë atë që është e keqe. Ne i shpjegojmë këto dhe nuk themi: „Nuk ka dhunë në fe.“

Ne nuk i detyrojmë njerëzit të besojnë, por i ndëshkojmë ata që largohen nga feja e Islamit. Ai që e fsheh mosbesimin e tij në zemrën e tij, do t'i dorëzohet Zotit. (...)

Kush thotë: „Nuk ka detyrim në fe“, thotë gjithashtu: „Luftojini ata (jobesimtarët), derisa të zhduket propaganda e tyre dhe derisa të aplikohet vetëm feja për Zotin.“ [2:192]. Pra, pse citoni një ajet dhe anashkaloni një tjetër?

Gusht, 2015

Librin e kanë ndihmuar 8 miq, të cilët për shkaqe që vetëkuptohen, kanë dëshiruar të mos u përmenden emrat:

1. NN ka ndihmuar me 900,- Euro
2. NN me 100.000 Lekë të ri (rreth 750,- Euro)
3. NN me 100,- euro
4. NN me 100 US \$
5. 100 me 100 Euro
6. NN me 100 Euro

7. NN me 50 Euro

8. NN me 50 Euro

Botimi është regjistruar në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, me ISBN 978-9951-655-44-6